

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Eruditi, juristi dhe komentuesi

NASER MEKARIM SHIRAZI

KOMENTIMIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT

TIRANË, 2018

Titulli: **KOMENTIMIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT**

(Xhuzi i tetëmbëdhjetë)

Autori: *Eruditi, juristi dhe komentuesi*

Naser Mekarim SHIRAZI

Recensent: **Vullnet MERJA**

E përktheu nga arabishtja:

Sulejman TOMÇINI & H. Selim STAFJA

E redaktoi: **Klodjana Smajlaj**

Korrektura letrare: **Vjollca KARAJ**

Përkujdesja grafike: **Sabrie FEZA**

Kapaku: **Sabrie FEZA**

Botoi: **Shoqata "FLLADI"**

Copyright: **Shoqata "FLLADI"**

Shtypshkronja e shtëpisë botuese **LILLO**

SURJA “EL MU’MINÛN”

E zbritur në Mekë, 118 ajete

Mirësitë e sures “El Mu’minûn”

Transmetimet e përcjella nga i Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe nga Imamët e Familjes së tij (*Paqja qoftë mbi ta!*) kanë vënë në dukje vlerat e kësaj sureje. Në një hadith, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kush e lexon suren “El Mu’minûn” atë e përgëzojnë engjëjt Ditën e Kiametit me ekstrakte dhe borzilok dhe me gjithshka që do t’a kënaqte syrin e tij kur do zbriste engjëlli i vdekjes”¹

Tregohet nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) të ketë thënë: “Atij që e lexon suren “El Mu’minûn” dhe e ka bërë këtë rregull për çdo të premtë (Xhuma), All’llahu do i sjellë një fund të lumtur. Vendi i tij do të jetë në Firdeusin e lartë me Profetët dhe të Dërguarit”.²

Vërtet, mirësitë e sures “El Mu’minûn” nuk qëndrojnë vetëm në leximin e saj, por kjo duhet shoqëruar me thellimin në domethëniet e saj dhe me punë për të vënë në jetë detyrimet e saj. S’ka dyshim se Kur’ani ndërton veten njerëzore dhe e edukon atë. Ai është program praktik pune për përsosjen e njeriut. Nëse ky e zbaton programin e përmbajtjes së Kur’anit në përgjithësi dhe të kësaj surjeje, është njësoj sikur të veprojë në përputhje me ajetet e saj të para, që tregojnë cilësitë e besimtarëve, ai do ketë një shpërblim më të madh nga vlerësimi i lartë.

Prandaj, në një transmetim nga i Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëllimi 7, f. 98.

² Tefsiri “Ruhul Meanij”, vëllimi 18, 3.

thuhet se kur ka zbritur ajeti i parë i kësaj sureje, ai ka thënë: “*Më kanë zbritur dhjetë ajete. Ai që do t'i zbatojë ato, hyn në Xhennet.*”³

Fjala “*ekāme*” që përmendet në vend të fjalës “*kara’a*” - lexon - shpreh një të vërtetë që e kemi përmendur më lart. Qëllimi është të zbatohet ajo që përmbajnë këto ajete dhe jo vetëm leximi i tyre.

Pëmbajtja e sures “El Mu’minûn”

Një pjesë e rëndësishme e kësaj sureje siç duket edhe nga emri i saj, flet për cilësitë dalluese të besimtarëve. Pastaj ajo trajton besimin dhe veprimet në përputhje me të. E ky besim është plotësues për ato cilësi.

Në përgjithësi, tematikat e kësaj sureje mund t'i ndajmë si vijon:

Pjesa e parë fillon me ajetin “**Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët**” dhe përfundon me një numër ajetesh që kujtojnë cilësitë që i ftojnë besimtarët për shpëtim. Këto cilësi janë personale dhe të përgjithshme. Ato mbulojnë aspekte të ndryshme të jetës së personit dhe të shoqërisë.

Përderisa baza e kësaj sureje është besimi (el imanu) dhe njësimi (et teuhidu), **pjesa e dytë** vë në dukje disa nga këto tematika si dhe shenja të tjera të besimtarëve: si njësimi, shenjat e madhështisë së All’llahut në botën e ekzistencës duke numëruar

³ Burimi i mësipërm.

një sërë shembujsh nga kjo botë e çuditshme, si: krijimin e qiellit dhe të Tokës, të njeriut, të kafshëve dhe të bimëve.

Për të përfunduar anët praktike, **pjesa e tretë** shpjegon se çfarë u ka ndodhur disa Profetëve si: Nuhu, Hudi, Musai dhe Isai (*Paqja qoftë mbi ta!*), e po kështu shpjegon disa momente domethënëse dhe mësimdhënëse nga jeta e tyre.

Në **pjesën e katërt**, i Madhëruari dhe i Lartësuari u drejtohet me një mesazh mendjemëdhenjve, të cilët i paralajmëron disa herë me prova logjike dhe disa herë të tjera me shprehje të fuqishme motivuese, që i bëjnë zemrat të kthehen në rrugën e drejtë dhe të adhurimit të Tij, të të Gjithëfuqishmit dhe të Madhërishmit.

Pjesa e pestë, në një studim të përmbledhur, qartëson Ringjalljen.

Pjesa e gjashtë trajton sovranitetin e All'Ilahut mbi botën e ekzistencës dhe të nënshtrimit të botës ndaj urdhrave të Tij.

Së fundi, **pjesa e shtatë** trajton llogaridhënien në Ditën e Kiametit, shpërblimin e mirësisë së bamirësve dhe ndëshkimin e fajtorëve. Surja përfundon me sqarimin e qëllimit se pse u krijua njeriu.

Si përfundim, surja është një tërësi mësimesh teorike dhe praktike për problemet e ndërgjegjësimit dhe të shpjegimit të rrugës së besimtarëve nga fillimi deri në mbarim.

Kjo sure, siç e kemi bërë të qartë më lart, zbriti në Mekë, por disa komentues kanë përmendur se disa nga ajetet e saj kanë zbritur në Medine. Motivi për këtë ishte ekzistenca e ajetit të

zekatit në të, sepse zekati u ligjërua për herë të parë në Medine pas zbritjes së ajetit 103 të sures “Et Teube”: **“Merr nga pasuria e tyre lëmoshë”**, ku i Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) urdhërohet të mbledhë zekatin nga myslimanët.

Por duhet të kihet kujdes se për zekatin ka një kuptim të gjerë, që përfshin si zekatin e detyruar, ashtu edhe atë të pëlqyer (mustehab) dhe domethënia e tij nuk kufizohet vetëm tek zekati i detyruar. Prandaj nëpër transmetime lexojmë se namazi dhe zekati janë sinonime.⁴

Përveç kësaj, disa komentues mendojnë se zekati ishte i detyruar edhe në Mekë, por zbatohej në një formë të zbukuruar, duke ia bërë detyrë secilit mysliman ndihmën e nevojtarëve me një sasi prej parave të tyre. Pastaj, pas krijimit të shtetit islam në Medine, zekati mori formë përfundimtare sipas një programi të caktuar dhe të hollësishëm, u përcaktua sasia e tij dhe personat që do merreshin me të, të cilët i Dërguari i All’llahut (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i dërgonte në krahinat e ndryshme islame për ta mbledhur.⁵

Ajetet 1 - 11

⁴ Në një transmetim nga Imam El Bakiri dhe Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi ata të dy!*) thuhet se “All’llahu e ka bërë obligim zekatin bashkë me namazin”.

⁵ Tefsiri “Ruhul Meanij”, vëllimi 18, f. 2.

Me emrin e Allahut të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët.”

“të cilët janë të përlur në namazin e tyre.”

“të cilët shmangen nga fjalët e kota.”

“të cilët japin zeqatin.”

“të cilët e ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme).”

“përveçse me gratë e tyre ose me skllavet që kanë në zotërim - dhe, për këtë, nuk janë fajtorë.”

“ndërsa ata që kërkojnë përtej kësaj, pikërisht ata janë shkelës (të kufijve).”

“të cilët u përmbahen amaneteve dhe detyrimeve të marra. ”

“Dhe të cilët i kryejnë rregullisht faljet.”

“Pikërisht ata do të jenë trashëgimtarët.”

“Që do ta trashëgojnë Firdeusin, ku do të qëndrojnë përjetësisht.”

Komentimi

Cilësitë e dukshme të besimtarëve

Shkaku i emërtimi të kësaj sureje me emrin “El Mu’minûn” siç u tha më lart, është se në fillimin e saj përmenden ajete, që me shprehje të shkurtëra e domethënëse, sqarojnë cilësitë e besimtarëve. Ajo që tërheq vëmendjen është se ajetet, para se të sqarojnë cilësitë e besimtarëve, vënë në dukje të ardhmen e lumtur të tyre. Ato ndriçojnë pasionin në zemrat e myslimanëve për të arritur te kjo krenari e madhe, nëpërmjet cilësimit me “besimtar”. Ajeti thotë: **“Me të vërtetë janë të shpëtuar besimtarët.”**

Fjala “*eflaha*” vjen nga fjala “*el felhu*” dhe “*el felahu*” që në origjinë do të thotë “*el harthu*”, “*plugim*” dhe “*esh shakku*”, “*çarje*”. Më pas, kjo fjalë është përdorur për çdo fitore, arritje të qëllimit dhe të lumturisë në përgjithësi. Në fakt, fitimtarët pastrojnë rrugët e tyre nga të gjitha vështirësitë dhe pengesat për të arritur shpëtimin dhe lumturinë. Ata çajnë rrugën e tyre për realizimin e qëllimeve të veta në jetë. Fjala “*el felah*”, “*shpëtim*”, ka kuptim të gjerë që përfshin atë material dhe shpirtëror dhe që të dyja këto u takojnë besimtarëve.

Shpëtimi në këtë botë është që njeriu të jetojë i lirë dhe ballëlartë, i fuqishëm dhe i pavarur. Por realizimi i të gjitha këtyre është i mundur veçse nën hijen e besimit dhe të mbështetjes fort tek All’l-lahu dhe mëshira e Tij. Ndërsa shpëtimi në Botën Tjetër është jeta në bollëkun e përjetshëm pranë miqve të merituar e të pastër, jeta e thjeshtë dhe me dinjitet.

Er Ragib El Isfahani, në librin e tij “El Mufredat”, duke shpjeguar këtë fjalë, thekson se “shpëtimi i kësaj bote” përbëhet

prej tri gjërash: të qëndruarit, pasuria dhe krenaria. Ndërsa shpëtimi i Botës Tjetër qëndron në katër gjëra: qëndrim pa zhdukje, pasurim pa varfëri, krenari pa poshtërim dhe dituri pa injorancë.

Pastaj ajeti shpjegon cilësitë duke përforcuar para së gjithash çdo gjë që lidhet me namazin, ku thotë: **“të cilët janë të përlurur në namazin e tyre”**.

Fjala **“khāshiuun”** vjen nga fjala **“khushuu’un”** dhe ka kuptimin e thjeshtësisë (*et teuadu'u*) dhe të kulturës, që njeriu e paraqet me trup dhe me shpirt, kur ndodhet përballë një personaliteti të madh apo përballë një të vërtete të rëndësishme. Tek ai shfaqen dhe duken shenjat e tyre (thjeshtësisë dhe kulturës) në mënyrë të hapur në qenien e tij.

Kur'ani e ka konsideruar **“përluljen”** cilësi të besimtarëve dhe jo faljen e namazit, duke theksuar se namazi nuk është thjeshtë fjalë dhe lëvizje pa shpirt dhe kuptim, përkundrazi ai shfaq tek besimtari kur bën namazin një gjendje të drejtuar plotësisht tek All'llahu, duke e veçuar besimtarin nga të gjithë të tjerët dhe duke e bashkuar atë me Krijuesin. Kështu, besimtari zhytet në lidhjen me All'llahun, e thërret Atë dhe i lutet në një gjendje që ia përfshin të gjithë qenien (trupin). Besimtari e sheh vetveten si një grimcë përpara ekzistencës absolute të All'llahut dhe si një pikë në oqeanin e pafundëm të Tij.

Çastet e këtij namazi konsiderohen si mësim për besimtarët në ndërtimin dhe edukimin e vetvetes si dhe mjet për stërvitjen e vetes dhe lartësimin e anës shpirtërore të tij.

Në një transmetim i ardhur nga i Dërguari më i nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thuhet se kur ai pa një burrë që po lozte me mjekrën e tij duke u falur, i tha: “Nëse do të ishte zemra e tij e përulur, edhe gjymtyrët e tij do të ishin të përulur.”⁶

Me këtë thënie, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tregon se përulja e brendshme (nga thellësia e shpirtit – shënim i përkthyesit) ndikon në veprimet e jashtme të njeriut. Udhëheqësit e mëdhenj të myslimanëve e kryenin namazin e tyre me një përulje të atillë saqë dukej sikur ishin në një botë tjetër. Në një transmetim të ardhur nga i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thuhet: “Ai e ngrinte shikimin e tij nga qielli gjatë namazit dhe sapo i zbriste ndonjë ajet, tundte kokën dhe e hidhte vështrimin nga toka.”⁷

Cilësia e dytë e besimtarëve pas përuljes, sipas asaj që përmend ajeti, është: **“të cilët shmangen nga fjalët e kota.”** Vërtetë, të gjitha lëvizjet dhe veprimet e besimtarëve i sheh të drejtohen nga një objektiv i vetëm, i dobishëm dhe konstruktiv, sepse “fjalët e kota” janë veprime të kota dhe pa vlerë. Siç kanë thënë disa komentues, “fjalë të kota” janë çdo e thënë apo e vepruar që nuk ka dobi. Ndërsa disa të tjerë fjalët e kota i kanë shpjeguar si gënjeshtër dhe padrejtësi.

Të tjerë i kanë shpjeguar të tëra si mëkat.

⁶ Tefsiri “Es Safij” dhe “Mexhmaul Bejjan” , vëllimi 7, f. 99. Fundi i ajetit në studim.

⁷ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëllimi 7, f. 99 dhe tefsiri “El Kebijr”, vëllimi 23, f. 77. Fundi i ajetit në studim.

Të tjerë si mashtrim dhe gënjeshtër.

Të tjerë si sharje dhe kundërsharje.

Disa të tjerë kanë thënë se ajo do të thotë: këngë, zbavitje dhe lojë.

Të tjerë i kanë konsideruar ato idhujtari.

Të gjitha këto konsiderata përbëjnë kriteret e atij kuptimi të përgjithshëm.

Është e natyrshme që shprehja “fjalë të kota” nuk përfshin vetëm veprimet dhe fjalët e pahijshme, por do të thotë edhe pikëpamje të pavlera e të kota, pa asnjë bazë, që e bëjnë robin të harrojë Zotin e vet dhe që e preokupojnë me probleme të padobishme. Pra, “fjalët e kota” i përfshijnë të gjitha këto. Në të vërtetë, besimtarët nuk janë krijuar për t’u marrë me gjykime të gënjeshtërta apo me fjalë të pahijshme, por ata janë të ekspozuar ndaj tyre, siç ka thënë Kur'ani Fisnik.

Ajeti i tretë vë në dukje cilësinë e tretë të besimtarëve të vërtetë, që ka karakter shoqëror dhe material, ku thotë: **“të cilët japin zekatin”**⁸

Ndoshta surja mund të jetë mekase, siç e thamë më lart, dhe ka zbritur në një kohë kur ende nuk ishte ligjësuar zekati me kuptimin e tij të njohur. Prandaj shohim kundërshtitë midis komentuesve në lidhje me shpjegimin e këtij ajeti. Por ajo që duket

⁸ Fjala “zekat” këtu do të thotë se ajo ka një emër të prejardhur nga folja, prandaj përdoret shprehja “fā'ilun”, “japin”. Disa komentues të tjerë kanë thënë se zekati mund të ketë kuptimin e vet të njohur, domethënë një sasi parash. Nisur nga kjo fjala “fā'ilun” merr kuptimin “kryerësit, dhënësit”.

më me vend është se zekati nuk kufizohet me zekatin e detyruar për t'u bërë, përkundrazi ekzistojnë lloje të shumta zekatesh të dëshiruara. Zekati, si detyrim, u ligjërue në Medine, por zekati i dëshiruar ekzistonte para tij.

Komentues të tjerë kanë supozuar se zekati u bë i detyrueshëm si dispozitë e sheriatit në Mekë, por pa u përcaktuar, ku ishte detyrë për çdo mysliman ndihma me çfarëdo mundësie e nevojtarëve. Forma e tij e veçantë u realizua pas udhëheqjes islame dhe krijimit të arkës së thesarit të myslimanëve (Bejtul Mal), kur edhe u caktuan sasitë e tij nga çdo prodhim dhe para, si dhe u vendosën mbledhësit që e mbledhnin atë nga myslimanët me urdhër të të Dërguarit të All'Ilahut (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Për sa i përket asaj që mendojnë disa komentues, si El Fekhr Er Razij dhe El Alusij në "Ruhul Meanij" dhe Er Ragib El Isfahani në "El Mufredat", se fjala zekat këtu do të thotë "bamirësi", "përligjje parash" apo "pastrim shpirti", kjo është larg të vërtetës sepse Kur'ani i Lavdishëm e përmend namazin gjithnjë bashkë me zekatin, ku me zekat ka parasysh shpenzime në para. Nëse do ta shpjegojmë atë ndryshe, atëherë duhej të kishte një lidhje të dukshme, që nuk ekziston në këto ajete.

Cilësia e katërt nga cilësitë e besimtarëve është pastërtia dhe në përgjithësi virtyti, evitimi i çdo mëkati që ka të bëjë me marrëdhëniet të jashtëligjshme seksuale. Ajeti thotë: **"të cilët e ruajnë nderin e tyre** (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme)".⁹ Ata e mbrojnë atë që të mos i kundërvihet virtytit: **"përveçse me gratë e**

⁹ Fjala "*el furuuxhu*", që është shumësi i fjalës "*ferxhun*" është pseudonim i organit të shumimit.

tyre ose me skllavet, që janë në zotërim dhe për këtë nuk janë fajtorë". Meqë instinkti seksual është nga instinktet më të fuqishme tek njeriu dhe për t'u përmbajtur para tij është e domosdoshme që njeriu të ketë frikë prej Zotit dhe të jetë i pajisur me një besim të fortë. Prandaj ajeti që pason, e konfirmon këtë problem duke thënë: **"ndërsa ata që kërkojnë përtej kësaj, pikërisht ata janë shkelës (të kufijve)"**.

Shprehja ruajtja e **"nderit"** mund të jetë aludim për atë se humbja e kujdesit të vazhdueshëm në këtë fushë, e çon individin në rrezikun e ndotjes me devijime të shumta.

Ndërsa shprehja **"me gratë e tyre"** përfshin të dy të martuarit: mashkullin dhe femrën. Ka disa komentues nga Ehli Syneti që kanë gabuar në shpjegimin e këtij ajeti, për të cilin do flasim më pas.

Shprehja **"nuk janë fajtorë"** mund të jetë aludim për mendimin e gabuar të të krishterëve, që përbën devijim për ideologjinë e tyre, sipas të cilës çdo lidhje seksuale përbën veprim të padenjë për njeriun, duke e konsideruar këtë pjesë të virtytit të tyre. Kështu shohim se priftërinjtë katolikë, gra e burra, nga ata që janë ndarë prej botës (ka parasysh asketët dhe murgjit - shënim i përkthyesit), bëjnë një jetë prej beqari dhe e përfytyrojnë martesën në çfarëdolloj forme që të paraqitet, në kundërshtim me pozitën shpirtërore të njeriut. Por shtrimi kështu i këtij problemi është vetëm formal, sepse ata për të ngopur instinktet e tyre, zgjedhin rrugë të fshehta të shumta, që i kanë përmendur librat e tyre.¹⁰

¹⁰ Të shihet "Kissatul Hadharah" i Uill Dijurant-it.

Sidoqoftë, All'llahu nuk ia ka krijuar njeriut instinktin si pjesë të përbërësve më të mirë të tij dhe pastaj ta konsiderojë në kundërshtim me vendin që zë njeriu pranë Tij.

Qenia e grave të martuara të lejuara për burrat në marrëdhëniet e tyre seksuale, me përjashtim të ditëve të periodave mujore dhe të tjera si këto, nuk ka nevojë për shpjegim. Po kështu, nuk ka nevojë për shpjegim edhe qenia e skllaveve të lejuara, kur janë në përputhje me kushtet që i kanë shpjeguar librat e jurisprudencës islame. Askush të mos përfytyrojnë se çdonjëra prej tyre i është lejuar pronarit të saj pa kushte. Në të vërtetë, ato në shumë raste zotërojnë të njëjtat kushte si dhe gratë e martuara.

Ajeti i tetë që po studiojmë, vë në dukje cilësinë e pestë dhe të gjashtë prej cilësive dalluese tek besimtarët. Në të thuhet: **“të cilët u përmbahen amaneteve dhe detyrimeve të marra”**. Mbajtja e amanetit me kuptimin e gjerë të fjalës dhe po kështu mbajtja e premtimit dhe e marrëveshjes para Krijuesit dhe krijesave, përbën një nga cilësitë dalluese të besimtarëve. Amaneti, në kuptimin e tij të gjerë, do të thotë besnikëri ndaj All'llahut dhe të të Dërguarit të Tij, plus besnikëri ndaj njerëzve si dhe ndaj të mirave që All'llahu u ka dhuruar krijesave të Veta. Besnikëria ndaj All'llahut përfshin gjithashtu fenë e vërtetë, librat qiellorë dhe mësimet e Profetëve. Po kështu, konsiderohen besnikëri ndaj All'llahut të gjitha pasuritë, fëmijët dhe postet, që i Madhërishmi dhe i Lartësuari i ka vënë në dorë të njerëzimit. Besimtarët synojnë t'i ruajnë dhe t'i kryejnë ato më së miri. Ata i mbrojnë ato gjatë tërë jetës së tyre dhe ua trashëgojnë fëmijëve të tyre, të cilët edukohen në frymën e kryerjes së amaneteve dhe të ruajtjes së tyre.

Provë për karakterin e përgjithshëm të kuptimit të amanetit këtu, përveç gjerësisë së kuptimit gjuhësor të kësaj fjale, janë transmetimet e shumta rreth shpjegimit të amanetit, që e përshkruajnë atë se është amaneti i Imamëve të mbrojtur, që do të thotë se çdo Imam i transmeton amanetet tek trashëgimtari i tij.¹¹

Nganjëherë shpjegimi i amanetit vjen me kuptimin e tutorësisë në përgjithësi.

Ajo që të tërheq vëmendjen është transmetimi i Zuraras, njërit prej nxënësve të Imam Bakirit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) rreth thënies së të Madhërishmit: **“që amanetet t’jua ktheni atyre që u përkasin”¹², “Dhe jua ktheni tutorësinë atyre që u përket...”¹³.**

Kështu, zbulohet se edhe qeverisja është një amanet hyjnor shumë i rëndësishëm, që duhet të krijohet nga ai që është në gjendje ta drejtojë.

Ekzistojnë shprehje të shumta kur'anore që tregojnë për përgjithshmërinë dhe shumanshmërinë e premtimit, nga të cilat është ajeti: **“Zbatoni besëlidhjen e All’llahut, kur ta merrni mbi vete.”¹⁴**

Vlen të theksohet se disa ajete kur'anore janë shprehur se kjo besëlidhje është kryerja e amanetit, mostradhtia dhe ruajtja e tij. **“Përmbushja e amanetit”**, që u përdor në ajetin e

¹¹ Tefsiri “El Burhan”, vëllimi i parë, f. 380.

¹² Surja “En Nisa”, ajeti 58.

¹³ Tefsiri “El Burhan”, vëllimi i parë, f. 380.

¹⁴ Surja “En Nahl”, ajeti 91.

lartpërmendur, përfshin kuptimin e çuarjes në vend dhe të ruajtjes së tij.

Mbi këtë bazë, neglizhimi në ruajtjen e amanetit, që mund të çojë në dëmtimin apo ekspozimin e tij ndaj rrezikut, duhet të rregullohen nga ai të cilit i është besuar. Ruajtësi i amanetit ka tri detyra: kryerja, ruajtja dhe rregullimi. Duhet patjetër që personi të jetë i angazhuar për sa ka marrë përsipër një amanet dhe ta ruajë atë.

Çuarja në vend e amanetit konsiderohet si një nga bazat më të rëndësishme të rregullit shoqëror, sepse pa një gjë të tillë, në shoqëri do sundonte anarshia. Për këtë shkak, ka popuj ku shumica e tyre nuk i përmbahen fesë, por në kuadrin e përpjekjeve për të penguar trazirat, ata ia imponojnë vetvetes kujdesin për mbajtjen e premtimit dhe të amanetit, duke e konsideruar veten përgjegjës për këto dy parime, të paktën në lidhje me problemet e përgjithshme shoqërore. (Ne e kemi trajtuar me hollësi rëndësinë e amanetit në shpjegimin e ajetit 58 të sures “En Nisa”, në shpjegimin e ajetit të parë të sures “El Ma’ide” si dhe në shpjegimin e ajetit 91 të sures “En Nahl”.)

Ajeti i nëntë nga ajetet në studim, sqaron cilësinë e fundit të besimtarëve, ku thotë: **“dhe të cilët i kryejnë rregullisht faljet.”**

Ajo që tërheq vëmendjen është se cilësia e parë e besimtarëve ishte përrulja gjatë namazit dhe e fundit, kryerja rregullisht e saj. Me një fjalë, ajo fillon me namazin dhe përfundon po me të. Pse? Sepse falja (namazi) është lidhja më e rëndësishme midis Krijuesit dhe krijesës dhe shkolla më e pasur për edukimin e njeriut.

Namazi është mjet për vigilencën e njeriut dhe mbrojtësja më e mirë nga mëkatet dhe gabimet.

Shkurtimisht themi se nëse falja (namazi) kryhet sipas etikës së vet të domosdoshme, kthehet në një bazë të sigurtë për të gjitha veprat e mira.

Vlen të theksohet se dy ajetet, i pari dhe i fundit, përfshijnë çështje që ndryshojnë njëra nga tjetra. Ajeti i parë përmban namzin në mënyrë individuale, ndërsa tjetri namzin në grup. Namazi i parë përfshin përluljen dhe drejtimin e brendshëm kah All'Ilahu. Përlulja konsiderohet thelbi i namazit, sepse ka ndikim në të gjitha organet e trupit të njeriut. Ndërsa ajeti i fundit vë në dukje etikën dhe kushtet e rregullsisë së namazit për sa i përket kohës, vendit dhe numrit. Ai ua bën të qartë besimtarëve të vërtetë domosdoshmërinë e mbrojtjes dhe të kujdesit ndaj kësaj etike dhe të kushteve gjatë kryerjes së namazit të tyre.

Ne e kemi shpjeguar rëndësinë e namazit në vëllimet e ndryshme të këtij Komentimimi. Për këtë mund t'i referoheni Komentimit të ajetit 114 të sures "Hud", shpjegimit të ajetit 103 të sures "En Nisā'" dhe shpjegimit të ajetit 14 të sures "Tāhā".

Pas paraqitjes dhe sqarimit të këtyre cilësive të lavdërueshme, ajeti që pason e bën të qartë rezultatin e këtyre cilësive, duke thënë: **"Pikërisht ata do të jenë trashëgimtarët..."**.

Ata do të trashëgojnë Ferdeusin, shtëpi të larta e jetë të përhershme: **"...që do të trashëgojnë Firdeusin, ku do të qëndrojnë përjetësisht."**

Fjala “Firdeus” është me prejardhje latine, por disa mendojnë se ajo është fjalë arabe. Disa të tjerë mendojnë se ajo është fjalë persiane dhe do të thotë “kopsht” ose “kopsht i veçantë”, ku mblidhen të gjitha të mirat dhe dhuntitë e All’llahut. Prandaj, emërtimi i saj si Xhennet i lartë dhe më i preferuari i kopshteve, është i drejtë.

Ka mundësi që shprehja “*jerithune*” të tregojë për fitimin e Xhennetit nga ana e besimtarëve pa ndonjë lodhje, siç merr trashëgimtari trashëgimin pa ndonjë lodhje. Është e vërtetë se njeriu, për ndërtimin e vetvetes dhe afrimin me All’llahun, bën përpjekje të mëdha. Ai sakrifikon kohën dhe i heq vetes qetësinë, por ky shpërblim i bukur është shumë më i madh sesa vlera e këtyre veprimeve të thjeshta dhe duket sikur besimtari e fiton Firdeusin pa ndonjë lodhje e vështirësi.

Po ashtu, duhet të kihet parasysh një transmetim i përcjellë nga Profeti më i nderuar (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në të cilin thuhet: “*Secili prej jush ka dy shtëpi: një në Xhennet dhe një në Xhehennem. Nëse ndonjëri vdes dhe shkon në Zjarr (Xhehennem), shtëpinë e tij e trashëgojnë banorët e Xhennetit*”.¹⁵

Po ashtu, shprehja “*jerithuune*”, trashëgojnë, në ajetin e kaluar është aludim për rezultatet e punës së besimtarëve, që janë si trashëgimi që e trashëgojnë në fund. Sidoqoftë, kjo pozitë e lartë, siç del nga pamja e jashtme e ajetit të lartpërmendur, është vetëm për besimtarët, të cilët i kanë këto cilësi, sepse ka banorë të Xhennetit që gëzojnë pozita më pak të rëndësishme sesa këta besimtarë.

¹⁵ “Bihārul Enuār”, vëllimi 8, f. 91.

Hulumtime

1- Paevitueshmëria e shpëtimit të besimtarëve

Përzgjedhja e kohës së shkuar për foljen “*efleha*” për shpëtimin e besimtarëve, është një konfirmim i fortë se shpëtimi i tyre është i natyrshëm, sikur të ishte realizuar që më parë. Edhe fjala “*kad*” ka ardhur si konfirmim rishtazi i kësaj çështjeje. Shprehjet “*khaashi’uun*” - “*të përulur*”; “*mua’riduun*” - “*të shmangur*”; “*rā’uun*” - “*përmbajtës*”; dhe “*hāfidhuun*” - “*ruajtës*”, kanë ardhur në formën e kryefjalës ose të foljes së kohës së tashme si tregues se këto cilësi të dallueshme nuk janë të përkohshme për besimtarët e vërtetë, por të përhershme.

2- Përulja - shpirti i namazit

Nëse rukuja (përkulja), rënia në sexhde, leximi dhe lartësimi (tesbihi) përbëjnë trupin e namazit, drejtimi i brendshëm kah e vërteta e namazit, kah Ai që e thërret namazfalësi, përbëjnë shpirtin e namazit. Përulja nuk është tjetër veçse drejtim i brendshëm me modesti e thjeshtësi. Bazuar në këtë qartësohet se besimtarët nuk e shikojnë namazin si trup pa shpirt, përkundrazi drejtimi i të gjithëve është kah e vërteta e namazit dhe kah brendësia e tij.


Ka shumë njerëz që dëshirojnë me shumë zell të jenë të përlur gjatë namazit të tyre, por nuk mund ta realizojnë një gjë të tillë. Për realizimin e përlurjes dhe drejtimit të plotë kah All'llahu gjatë namazit dhe gjatë të gjitha ibadeteve të tjera, rekomandohet sa vijon:

1. Pajisja me njohuri të tilla, që e bëjnë botën në sytë e njeriut të vogël dhe të pavlerë dhe që e bëjnë All'llahun të madh dhe madhështor, me qëllim që falësin e namazit të mos e preokupojë kjo botë dhe çfarë ka ajo, për shkak të shkrirjes së tij me All'llahun gjatë kohës së bisedës së fshehtë dhe adhurimit të Tij.

2. Të interesuarit për çështje të ndryshme e pengon njeriun nga përqëndrimi i mendimeve dhe i shqisave të tij. Prandaj, sa më shumë që njeriu largohet nga preokupimet e tij, aq më tepër e arrin përqëndrimin dhe drejtimin kah All'llahu gjatë adhurimit.

3. Përzgjedhja e vendit të faljes së namazit dhe i adhurimeve të tjera ka një ndikim të madh në këtë drejtim. Prandaj, falja e namazit e shoqëruar me mendje të preokupuar me probleme të tjera përveç namazit, konsiderohet e papëlqyeshme. Po ashtu, namazi nuk është mirë të falet në vende ku kalojnë njerëzit, apo para pasqyrës dhe fotografisë. Prandaj është e preferuar që faltoret (xhamitë) islame të jenë sa më të thjeshta, të vogla në madhësi dhe me sa më pak zbukurime, me qëllim që i tërë drejtimi të përqendrohet kah All'llahu, Krijuesi i qiejve dhe i Tokës.

4. Evitimi i mëkateve është një faktor ndikues në drejtimin kah All'llahu, sepse mëkati dhe faji e thellojnë ndarjen midis zemrës së myslimanit dhe Krijuesit të tij.



“Me të vërtetë, Ne e kemi krijuar njeriun prej palcës së baltës.”

“E pastaj, e bëmë atë pikë fare dhe e vumë në një vend të sigurt (mitër).”

“E mandej, pikën e farës e bëmë droçkë gjaku, e pastaj e bëmë copëz mishi pa formë; mandej, me atë mish bëmë eshtrat, pastaj i veshëm eshtrat me mish dhe pastaj e bëmë atë (njeriun) krijesë tjetër (duke i futur shpirtin). Qoftë lartësuar All’llahu, Krijuesi më i përsosur!”

“Mandej, pas kësaj ju do të vdisni.”

“Pastaj, ju me siguri që do të ringjallen në Ditën e Kiametit.”

Komentimi

Etapat e plotësimit të embrionit në mitër

Përmendja e cilësive të besimtarëve të vërtetë, në ajetet e kaluara dhe shpërblimi i madh që u ka caktuar atyre All’llahu, nxisin në zemër dëshirën për t’u bashkuar me radhët e tyre. Por, në çfarë mënyre?

Ajetet që po studiojmë si dhe një pjesë e ajeteve që pasojnë, bëjnë të qartë rrugën për të përfituar besimin dhe dijen, ku Kur'ani e merr njeriun për dore për në “botën e shpirtit” për t’i zbuluar atij të fshehtat e brendshme që përbëjnë “rrugën shembullore”. Ajetet që pasojnë, tërheqin vëmendjen e njeriut për botën e dukshme, për krijesat e habitshme të botës së ekzistencës si dhe rrugëtimin në botën e horizonteve, që ndryshe quhet “udhëtimi eksplorues”.

Ajeti i parë thotë: **“Me të vërtetë, Ne e kemi krijuar njeriun prej palcës së baltës”**.¹⁶

Po, ky është hapi i parë i krijimit të njeriut nga All’lhu me tërë madhësinë, gatishmërinë dhe meritën e Tij. Njeriu është nga krijesat më të përkryera të Tij, që e ka krijuar nga një baltë e shpërfillur. Me krijimin e njeriut nga kjo baltë del në dritë fuqia e të Madhërishmit dhe të Lartësuarit në këtë krijim të mrekullueshëm.

Ajeti që vijon, shton: **“E pastaj e bëmë atë pikë fare dhe e vumë në një vend të sigurtë (mitër)”**.

Në fakt, ajeti i parë vë në dukje fillimin e ekzistencës së tërë njerëzimit nga Ademi dhe bijtë e tij dhe se të gjithë ata u krijuan nga balta. Ndërsa ajeti pauses vë në dukje përhershmërinë dhe vazhdimësinë e brezave të njeriut nëpërmjet vendosjes së pikës së farës së mashkullit në vezoren e femrës në mitër. Ky studim ngjan me atë të dy ajeteve: shtatë dhe tetë të sures “Es Sexhde”, që thonë: **“I Cili ka përsosur çdo gjë që ka krijuar. Ai e ka filluar**

¹⁶ Fjala “es sulāletu”, sipas formës “asāratun” ka kuptimin e diçkaje që përftohet nga një diçka tjetër, që në të vërtetë është rezultat i saj. (Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, fundi i ajetit në studim.)

krijimin e njeriut prej baltës. Pastaj bëri që paraardhësit e tij të krijohen prej një pike të lëngut të shpërfillur.”.

Përdorimi i shprehjes *“kararun mekinun”*, domethënë *“vend i sigurtë”*, për mitrën, tregon për rëndësinë e mitrës në trup, e cila qëndron në një vend të sigurtë e të ruajtur nga të gjitha anët. Atë e ruan shtylla kurrizore nga njëra anë, nga ana tjetër kocka e fuqishme e legenit dhe nga ana e tretë mbulesat e shumta të barkut. Mbrojtja e dy duarve përbën kështjellën e katërt të saj. Të gjitha këto dëshmojnë për vendndodhjen e sigurtë të mitrës.

Ajeti i tretë vë në dukje etapat e habitshme dhe mbresëlënëse të përshkallëzimit të pikës së farës në etapat e saj të ndryshme dhe i marrjes prej saj të një forme të caktuar në çdonjërin prej tyre në atë vendndodhje të sigurtë: Ne krijuam nga ajo pikë fare një droçkë në formën e një pike gjaku të mpiksur, pastaj e ndërruam atë dhe e bëmë një copë mishi të paformë. Pastaj, nga kjo copë mishi e paformë krijuam kockat dhe së fundi i mveshëm këto kocka me mish. Për këtë ajeti thotë: **“Pastaj, pikën e farës e bëmë droçkë gjaku e pastaj e bëmë copëz mishi pa formë, mandej me atë mish bëmë eshtrat, pastaj i veshëm eshtrat me mish.”.**

Këto katër etapa të ndryshme bashkë me pikën e farës përbëjnë pesë etapa, ku secila prej tyre është një botë e habitshme më vete, plot me çudira që janë studiuar me hollësi nga shkenca e Embrionologjisë. Për to janë shkruar libra dhe janë bërë Hulumtime të shumta e të thella në epokën tonë. Por Kur'ani ka folur rreth këtyre etapave të zhvillimit të embrionit të njeriut dhe ka vënë në dukje çudirat e tij atëherë kur ende nuk kishte lindur kjo shkencë dhe që nuk kishte gjekundi ndonjë gjurmë.

Në fund, ajeti vë në dukje etapën e fundit, që në të vërtetë konsiderohet etapa e krijimit të njerëzimit, me shprehje të thella dhe me përmbajtje të madhe: **“pastaj, e bëmë atë (njeriun) krijesë tjetër (duke i futur shpirtin). Qoftë i lartësuar All’llahu, Krijuesi më i përsosur!”**.

E bekuar qoftë kjo fuqi e pashoqe që krijon në errësirën e mitrës këtë pamje të mrekullueshme dhe që nga një pikë uji formon gjithë këto gjëra të habitshme.

E bekuar qoftë kjo dije, kjo urtësi, dhe ky organizim, që krijoi në këtë ekzistencë të thjeshtë gjithë këto mundësi dhe merita! I lartësuar qoftë All’llahu, fuqia e të Cilit duket në atë që ka krijuar.

Vlen të kujtojmë se fjala *“el khālik”* (Krijuesi) vjen nga fjala *“el khalku”* (krijim) dhe në origjinë do të thotë “përcaktim”.¹⁷

Kjo fjalë përdoret kur dëshirohet të pritët një copëz lëkure, ku personi duhet të përcaktojë përmasat e copës së nevojshme dhe pastaj ta presë. Fjala *“el khalk”* përdoret me kuptimin e përcaktimit për shkak të rëndësisë së përcaktimit të përmasave të një sendi para prerjes së tij.

Ndërsa shprehja **“Krijuesi më i përsosur”** shtron pyetjen: A ekziston tjetër krijues përveç All’llahut?!

Disa komentues kanë sjellë justifikime për këtë ajet, ndërkohë që ai nuk ka nevojë fare për to, sepse fjala *“el khalk”* do të thotë *“tekdiyr”* “përcaktim” dhe *“es sun'u”* “bërje”, përdoret edhe për të tjerë veç All’llahut. Por ekziston një ndryshim

¹⁷ “Mukhtaru Es Sihahu”

thelbësor midis dy krijimeve. All'llahu i krijon lëndët dhe pamjet e tyre, ndërsa njeriu i prodhon gjërat e tij prej atyre që i ka krijuar All'llahu. Njeriu mund të ndryshojë pamjen e atyre lëndëve si ai që ndërton një shtëpi, ku përdor lëndë të para si llaç, beton e tulla, apo si ai që bën (prodhon) një makinë apo automobil prej hekuri.

Nga ana tjetër, për krijimin e All'llahut nuk ka asnjë kufi: **“All'llahu është Krijuesi i çdo gjëje.”**¹⁸ Ndërkohë shohim se ajo që bën njeriu është shumë e kufizuar. Shumë herë, njeriu gjen të meta tek ajo që bën, që pastaj duhet të riparohen, ndërsa All'llahu i krijon krijesat pa asnjë të metë apo cen.

Pastaj, aftësia e njeriut për të prodhuar gjësend, ka ardhur me lejen e All'llahut, sepse çdo gjë në botë lëviz me lejen e All'llahut, deri edhe gjethet në pemë, siç e lexojmë në suren “El Mā’ide”, ajeti 110, ku flitet për Isain (*Paqja qoftë mbi të!*): **“se si me vullnetin Tim krijoje një figurë shpendi prej balte”**.

Ajeti pasardhës kalon nga trajtimi i çështjes së njësimi dhe njohjes së parimit në një mënyrë të hollësishme dhe të bukur tek çështja e Ringjalljes, ku thuhet: **“Mandej, pas kësaj, ju do të vdisni.”**

Me qëllim që njeriu të mos mendojë se vdekja është fundi i çdo gjëje, ajeti thotë: **“Pastaj, ju me siguri që do të ringjallen në Ditën e Kiametit.”** Me një fjalë, krijimi juaj me këtë pamje të habitshme, nuk ka qenë i kotë, apo sa për të jetuar disa ditë të kufizuara. Ajeti shton se ju do të ringjallen në Ditën e Kiametit në një shkallë më të lartë dhe në një botë më të gjerë.

¹⁸ Surja “Er Ra’d”, ajeti 16.

Hulumtime

1- Konstatimi i fillimit të krijimit dhe i Ringjalljes me një provë të vetme

Ajetet e lartpërmendur, për të konstatuar praninë e All'llahut, fuqinë dhe madhësinë e Tij, kanë përdorur si argument po atë argument që përmendet në suren "El Haxh" për të konstatuar Ringjalljen dhe pikërisht etapat e ndryshme të krijimit të njeriut në botën e embrionit. Po ashtu, fundi i këtyre ajeteve përmend çështjen e Ringjalljes.¹⁹

Në të vërtetë, mund ta njohësh madhësinë e All'llahut në krijimin e njeriut në errësirat e mitrës, ku në çdo etapë merr forma të reja të habitshme.

Nëse do mundeshim të regjistronim etapat e zhvillimit të embrionit në mënyrë të plotë në një film kinematografik dhe ta shfaqnim, do të kuptonim se sa madhështore janë mrekullitë që fshihen në këtë punë. Me përparimin që ka bërë shkenca e Embrionologjisë në kohët e sotme, me Hulumtimet e shkencëtarëve dhe provat e tyre laboratorike në lidhje me këtë çështje, bëhen të qarta shumë prej enigmave, e kur njeriu njihet

¹⁹ Në fillimin e sures "El Haxh", gjatë shpjegimit të ajeteve 5 dhe 8 trajtuam provat e ringjalljes, nga të cilat ekspozimin e etapave të embrionit në mitër.

me to, nuk mund të mos thërrasë pa dashje: **“Qoftë lavdëruar All’Ilahu, Krijuesi më i përsosur!”** Kjo nga njëra anë.

Nga ana tjetër, shohim krijimin në etapat e tij të njëpasnjëshme dhe marrjen prej tij të formave të reja në çdo etapë. Si pasojë, shfaqjen prej asaj pike të vogël uji, të njeriut ekzistues në formën e tij të plotë. E gjitha kjo tregon fuqinë dhe aftësinë e All’Ilahut për ta risjellë njeriun rishtazi në jetë. Kështu, me një shembull të vetëm mund të provojmë dy probleme njëherazi.²⁰

2- Etapa e fundit në plotësimin e embrionit të njeriut në mitër

Ajo që tërheq vëmendjen është se ajetet e kaluara përdorin fjalën *“el khalk”* (krijim) për pesë etapat e embrionit, ndërsa për etapën e fundit përdor fjalën *“el insha’ ”*. Siç kanë thënë gjuhëtarët, fjala *“el insha’ ”* do të thotë “krijim i diçkaje të shoqëruar me edukimin e saj. Përdorimi i kësaj fjale tregon se kjo etapë ndryshon qartë nga etapat e tjera (siç janë etapa e pikës së farës, e droçkës së gjakut, e mishit dhe e kockës). Këtë etapë Kur'ani e përmend me anën e një fjalie konçize: **“Pastaj, e bëmë atë (njeriun) krijesë tjetër”**, të cilën e pason direkt me thënien: **“Qoftë i lartësuar All’Ilahu, Krijuesi më i përsosur!”**.

Cila është kjo etapë që dallohet për këtë rëndësi?

²⁰ Etapat e embrionit dhe madhësitinë e Krijuesit të tij, ne i trajtuam në shpjegimin e ajetit 6 të sures “Āli Imrân”: **“Ai ju formon në mitër, ashtu siç dëshiron Vetë”**.

Ajo është etapa kur embrioni futet në fazën e jetës njerëzore. Atij i formohen ndjenjat dhe lëvizja, ose sipas shprehjeve të transmetimeve islame: “i futet shpirti”.

Këtu njeriu braktis jetën bimore hopthi për t’u futur në botën e kafshëve dhe prej këtu në botën njerëzore. Distanca me etapën pararendëse zgjerohet në atë shkallë, sa që ajeti ka përdorur për të shprehjen “pastaj e bëmë” sepse shprehja “pastaj krijuam”, nuk është e plotë, sepse në këtë etapë njeriu merr një formë të veçantë që e lartëson atë nga krijesat e tjera, që ta meritojë mëkëmbësinë e All’llahut në Tokë dhe të mbajë amanetin, nga i cili hoqën dorë malet dhe qiejt për shkak të paaftësisë së tyre për ta mbajtur atë. Këtu pëstillet “bota e madhe” në një “trup të vogël” me të gjitha çudirat e saj dhe All’llahu e meriton me të vërtetë shprehjen: **“Qoftë i lartësuar All’llahu, Krijuesi më i përsosur!”**

3- Veshja e mishit mbi kocka


Autori i Komentimit “Fi Dhilalil Kur'an”, gjatë shpjegimit të këtij ajeti, përmend një fjalë të habitshme dhe pikërisht atë se embrioni pasi kalon etapën e “droçkës së gjakut” dhe të “copës së mishit pa formë”, qelizat e tij kthehen në qeliza kockore dhe pastaj në mënyrë graduale, ato vishen me muskuj dhe mish. Prandaj, shprehja **“pastaj i veshëm eshtrat me mish”** përbën një çudi shkencore që zbulon një sekret që deri në atë kohë nuk e dinte asnjë person, sepse Kur'ani nuk thotë: “Ne e ndërruam copën e mishit pa formë kocka dhe mish”, por thotë: **“e pastaj e bëmë copëzë mishi pa formë, mandej me atë mish bëmë eshtrat, pastaj i veshëm eshtrat me mish.”** Me një fjalë, së pari copëza e

mishit pa formë u shndërrua në kocka, pastaj ato u veshën me mish.

4- Veshja, mbrojtje për eshtrat!

Përdorimi i fjalës “veshje” për të shprehur muskujt dhe mishin, në të vërtetë na zbulon formën e shëmtuar të njeriut nëse ky do ta humbte këtë veshje, që mbulon eshtrat. (Në një rast të tillë, skeleti eshtror do kishte një formë tmerruese, siç e kemi vënë re të gjithë apo i kemi parë fotografitë e tij.) Veç kësaj, kjo veshje e mbron trupin. Pra, mishi dhe muskujt ruajnë kockat, sepse në mungesë të tyre, kockat marrin goditje që çojnë në thyerjen e tyre. Kështu, mishi kryen funksionin e veshjes për eshtrat, por edhe të mbrojtjes së tyre nga i nxehti apo i ftohti. Dhe e tërë kjo na e bën të qartë fuqinë dhe përpikmërinë e shprehjes së Kur'anit.

Ajetet 17 - 22



“Nëpërmjet tij (ujit), Ne bëjmë për ju kopshte hurmash dhe rrushi, ku ka shumë fruta për të ngrënë.”

“Si dhe pemën që rritet në malin e Sinait e që u jep vaj dhe mëlmesë, atyre që e hanë.”

“Vërtet, edhe te bagëtitë për ju ka shenja (për të medituuar): ju pini atë që gjendet në barkun e tyre, hani mishin e tyre, nxirrni shumë dobi të tjera.”

“Dhe udhëtoni me ato, ashtu siç udhëtoni me anije.”

Komentimi

Edhe një herë me botën e njësimit

Thamë se Kur'ani trajton rrugët e fitimit të besimit pas përmendjes së cilësive të besimtarëve. Po kështu, ajetet e kaluara flisnin për shenjat madhështore të All'llahut në lidhje me ekzistencën tonë. Ajetet që kemi në studim trajtojnë botën e së dukshmes, horizontet e gjithësisë dhe madhështinë e krijimit të Tokës dhe të qiejve. Ajeti i parë thotë: **“Ne kemi krijuar mbi ju shtatë qiej.”**

Fjala *“et tarā'ik”* është shumësi i fjalës *“tarīkatun”* që do të thotë *“rrugë”* ose *“shtresë”*. Nëse do prananim domethënien e parë të fjalës *“et tarā'ik”*, kuptimi i ajetit do të ishte: *Ne krijuam sipër jush shtatë rrugë* dhe mund të shpjegohet se ato janë rrugët

nga kalojnë engjëjt, ashtu siç mund të jenë trajektoret e lëvizjes së yjeve në qiell. Sipas kuptimit të dytë, fjala “*et tarā'ik*” në ajet merr kuptimin e shtatë shtresave të qiellit.

Ne kemi folur për shtatë qiejt shumë herë para kësaj. Nëse qëllimi i numrit “shtatë” është të tregojë sasi të madhe, atëherë kuptimi i ajetit është: Ne krijuam mbi ju shumë botë yjesh, planetesh dhe trupash të tjerë qiellorë. Shprehja “shtresë” nuk lidhet me teorinë e Platonit, i cili e përfytyronte atë si një lëvozhgë qepe, të vendosura njëra mbi tjetrën. Kur'ani, në asnjë mënyrë, nuk ka parasysh këtë kuptim, por me fjalët “rrugë” dhe “shtresa” ka parasysh botët që mbështjellin Tokën në distanca të përcaktuara, të cilat për ne paraqiten njëra mbi tjetrën, disa afër e disa larg. Nëse numri shtatë është përdorur në ajet si numërim, atëherë ajeti do të thotë se: Ne krijuam gjashtë botë sipër jush, plus botën tuaj që e shikoni (grupin e palëvizshëm, planetet dhe yjet) dhe këto botë nuk i ka arritur njeri deri më sot.

Nëse do të shihnim me vëmendje sistemin diellor dhe nëse do të studionim vendndodhjen e planeteve të ndryshëm rreth Diellit, do të zbulonim një shpjegim tjetër të këtij ajeti, dhe pikërisht se nga nëntë planete që rrotullohen rreth Diellit, dy prej tyre: Merkuri dhe Venera, e kanë orbitën nën orbitën e Tokës, ndërkohë që gjashtë planetet e tjera e kanë orbitën jashtë orbitës së Tokës. Në këtë mënyrë, ato u ngjajnë gjashtë shtresave që janë njëra mbi tjetrën. Së bashku me orbitën e Hënës, që rrotullohet rreth Tokës, bëhen shtatë orbita që duken si shtatë shtresa.²¹

²¹ Për t’u njohur me shtatë qiejt, shih shpjegimin e ajetit 29 të sures “El Bekare”.

Ndoshta mund të fanatzohet se meqë bota është kaq e madhe dhe e gjerë, a mundet që All'illahu i Madhëruar të jetë i pavëmendshëm në administrimin e saj?

Mirëpo ajeti në fjalë i jep menjëherë përgjigje kësaj duke thënë: **“Nuk jemi të pakujdesshëm ndaj krijesave Tona.”**. Theksimi këtu i çështjes së krijesave është aludim se vetë çështja e krijimit të gjithësisë përbën në vetvete provën për njohjen që All'illahu i Madhëruar ka për krijesat e Veta dhe kujdesin e Tij ndaj tyre. A mundet që Krijuesi të jetë i pakujdesshëm ndaj krijesave të Tij?

Por ajeti mund të ketë si objektiv ato rrugë të shumta nëpër të cilat lëvizin engjëjt përmbi ju. Ne nuk jemi të pakujdesshëm ndaj jush. E po kështu, engjëjt Tanë ju kontrollojnë dhe janë dëshmitarë të veprave tuaja.

Ajeti që pason, vë në dukje një nga aspektet e fuqisë së All'illahut, që konsiderohet nga bekimet e qiejve dhe të Tokës që është shiu. Në ajet thuhet: **“Ne zbresim ujë nga qielli me masë të caktuar.”**.

Ne e zbresim ujin nga qielli me masë të caktuar që të mos mbytet toka nga rënia e tij me shumicë. Por ai nuk është as i paktë që të mos mjaftojë për të ujitur bimët dhe për të pirë kafshët. Me të vërtetë, nëse ne kalojmë nga studimi rreth qiellit tek Toka, do të shohim se uji është një nga dhuratat më të rëndësishme hyjnore dhe baza e jetës së të gjitha krijesave. Me këtë rast, ajeti thekson një problem akoma më të rëndësishëm, siç është ajo e rezervave të ujërave nëntokësorë, duke thënë: **“pastaj e depërtojmë atë në Tokë. Por nëse dëshirojmë, Ne jemi në gjendje ta heqim atë tërësisht.”**.

Ne e dimë se korja sipërfaqësore e Tokës përbëhet nga dy shtresa: njëra e depërtueshme dhe tjetra e padepërtueshme. Sikur të ishte korja e Tokës e tëra e depërtueshme, atëherë shiu do të depërtonte menjëherë në thellësi të Tokës dhe pas rënies së shirave, edhe nëse këto do të vazhdonin gjatë, do fillonte thatësira dhe nuk do të ishim në gjendje të gjenim as edhe një pikë të vetme uji.

Nëse sipërfaqja e tokës do përbëhej prej argjili, atëherë shiu do mbetej në sipërfaqe, ku do të ndotej e qelbej dhe do t'ia zinte frymën njeriut duke u bërë shkak për vdekjen e tij, ndonëse ai përbën bazën e jetës.

Por All'Ilahu i Gjithëmëshirshëm e ka bërë koren e parë të sipërfaqes së Tokës të depërtueshme. Atë e pason korja e padepërtueshme, që ruan ujërat nëntokësorë si rezervë për njerëzit, të cilët në rast nevojë, e nxjerrin atë nëpërmjet ndërtimit të puseve, ose ai del vetvetiu nëpërmjet burimeve, pa u ndotur dhe pa i shkaktuar njeriut asnjë lëndim.²²

Ka mundësi që ky ujë, që e nxjerrim nga thellësitë e tokës dhe me të cilin shuajmë etjen, të jetë krijuar nga pikat e shiut që kanë rënë para mijëra vitesh dhe është depozituar në thellësi të tokës deri në ditët tona, pa u ndotur dhe pa u prishur.

Sidoqoftë, Ai që krijoi njeriun për të jetuar dhe e bëri ujin bazën e jetës së tij, madje nga më të rëndësishmit, që para krijimit të tij, krijoi dhe depozitoi për të edhe shumë burime të tjera nga ky element jetësor.

²² Duhet të kihet parasysh se uji i ndotur, në më të shumtën e herës, pastrohet kur kalon nga korja e depërtueshme.

Natyrisht, ekzistojnë rezerva të këtij elementi jetësor edhe në majat e maleve në formën e borës, e cila gjatë vitit shkrin dhe zbret poshtë nëpër luginë, ndërkohë që një pjesë e saj ka mbetur në majë të maleve prej mijëra, madje edhe prej qindra mijëra vjetësh në pritje të urdhrit për t'u shkrirë, në vartësi të ndryshimit të nxehtësisë së tokës dhe për të zbritur në formë përrenjsh nëpër luginë, për të ujitur tokat dhe largimin e etjes prej saj.

Vërehet përdorimi i nyjes “fi” në shprehjen “fi el erdi”. Me këtë duket se ajeti ka parasysh burimet nëntokësore të ujit dhe jo ato sipërfaqësore.

Ajeti që vjen, e vë theksin tek mirësia dhe begatia që sjell shiu dhe pikërisht tek prodhimet bujqësore që vijnë si rezultat i tij. Ajeti thotë: **“Nëpërmjet tij (ujit), Ne bëjmë për ju kopshte hurmash dhe rrushi, ku ka shumë fruta për të ngrënë”**, duke shtuar se krahas hurmave dhe rrushit, që konsiderohen nga prodhimet më të rëndësishme bujqësore, ekzistojnë edhe lloje të tjera e të shumta frutash.

Ndoshta shprehja **“prej tyre për të ngrënë”** është theksim i asaj që prodhimet e këtyre kopshteve që kanë të mira të mëdha, nuk kufizohen vetëm tek frutat. Ushqimet përbëjnë një pjesë të të mirave të tyre. Këto kopshte, duke përfshirë edhe ato të hurmave, kanë shumë lloje të tjera dobish për jetën e njerëzve. Kështu, njeriu prodhon rrogozë prej gjetheve të tyre për t'u ulur dhe disa herë të tjera bën edhe rroba për veshje. Prej trungjeve të tyre ndërton shtëpi për të jetuar, ndërsa prej rrënjëve, gjetheve dhe frutave të tyre, prodhon barna si dhe tagji për kafshët, ndërkohë që trungjet dhe degët i përdor si lëndë djegëse.

El Fakhru Razij në shpjeguesin e tij hamendëson se ajeti, me thënien e tij: **“prej tyre për të ngrënë”** do të thotë se “jeta dhe jetesa juaj mbështeten tek këto kopshte”, siç mund të mbështetet dhe të jetojë filani nga puna e fistekut; domethënë, jeta e tij mbështetet në punën e atij tjetrit.

Tërheqim vëmendjen në ajetet e mësipërme se burimi i jetës së njeriut qëndron tek uji i pikës së farës dhe burimi i jetës së bimëve është uji i shiut. Në të vërtetë, këto dy modele e kanë jetën nga uji. Me të vërtetë, urtësia dhe ligji i All’llahut është i njëjti në çdo gjë.

Pastaj ajeti pasardhës vë në dukje se krahas kopshteve të palmave, të pjergullave dhe të pemëve të tjera frutore, është edhe një pemë tjetër e bekuar: **“...si dhe pemën që rritet në malin e Sinait e që u jep vaj dhe mëlmesë atyre që e hanë.”**²³.

Çfarë kuptohet me shprehjen **“Mali i Sinait”**?

Në lidhje me këtë shprehje, shpjeguesit kanë dhënë dy hamendësime: Së pari, ajo aludon për malin e njohur Tur në shkretëtirën e Sinait. Kur Kur'ani i Lavdishëm e përshkruan pemën e ullirit si pemë që rritet në malin e Turit, kjo bëhet sepse arabët e Hixhazit kalonin pranë këtyre pemëve të bekuara kur drejtoheshin nga veriu, ku ndodhet rajoni i Turit në jug të shkretëtirës së Sinait, siç e provon qartë pozicioni i tij gjeografik.

Mundësia e dytë: “Turi i Sinait” është cilësor dhe do të thotë “mal që ka të mira dhe dobi”, ose “mal me shumë pemë”

²³ Domethënë, pemën e ullirit dhe vajin që hahet me bukë.

apo “mal i bukur”. Kjo sepse “Tur” do të thotë “mal” dhe “Sina” do të thotë “zotërues i bekimit, bukurisë dhe i pemëve”.

Fjala “*sibgun*” në origjinë do të thotë “ngjyrë”. Meqë njeriu e ngjyen bukën e tij në lëng, fjala “ngjyrë” iu vu të gjitha llojeve të ekstrateve. Sidoqoftë, fjala “ngjyrë” ndoshta është aludim për vajin e ullirit, i cili hahet me bukë, ose lloje buke me lëng të nxjerrë nga pemë të tjera.

Këtu na lind një pyetje: Pse vihet theksi vetëm në tre fruta: hurmat, rrushi dhe ulliri?

Përgjigje: Në këtë përgjigje duhet patjetër t'i kushtojmë vëmendje një çështjeje shkencore dhe pikërisht faktit që shkencëtarët e ushqimeve kanë konfirmuar se është e rrallë të gjesh frut që ka dobi më shumë për trupin e njeriut në masën e dobive të këtyre tre frutave.

Vaji i ullirit ka rëndësi të jashtëzakonshme për prodhimin e fuqisë dhe ndërtimin e trupit, sepse nxehtësia e prodhuar nga ngrënia e tij është e madhe. Ai është mik i ngushtë i mëlçisë, heq sëmundjet e veshkave dhe i mbron ato, forcon nervat dhe së fundi konsiderohet si eliksiri i shëndetit.

Ndërsa hurmat janë përshkruar në atë mënyrë, saqë nuk kemi vend për to në këtë përmbledhje. Sheqeri i tyre është nga sheqernat më të preferuar dhe më të shëndetshëm. Shumë specialistë të ushqimeve mendojnë se hurmat janë shkaku që nuk lejojnë goditjen nga sëmundjet kanceroze. Shkencëtarët kanë zbuluar se në hurma ka trembëdhjetë lëndë jetësore, pesë lloje vitaminash dhe si pasojë konsiderohet si një burim i pasur me vlera ushqimore.

Për sa i përket rrushit, siç mendojnë disa shkencëtarë, ai është një barnatore natyrore. Cilësitë e tij ngjajnë me qumështin e nënës. Ai përfiton një fuqi nxehtësie në trup, që barazohet me dyfishin e asaj që prodhojnë mishrat; ushqen gjakun, largon helmet nga trupi dhe vitaminat e tij i japin njeriut fuqinë dhe forcën më të mirë.²⁴

Pas shpalljes së një aspekti të të mirave të All'llahut në botën e bimëve që rriten si pasojë e shiut, vjen studimi i një aspekti tjetër i të mirave dhe dhuratave të All'llahut në botën e kafshëve: **“Vërtet, edhe te bagëtitë për ju ka shenja (për të menduar).”**²⁵

Pastaj ajeti shpjegon fjalën *“el ibretu”* dhe thotë: **“ju pini atë që gjendet në barkun e tyre.”** Me të vërtetë, bagëtitë japin qumështin e shijshëm që konsiderohet ushqim i plotë. Ky i jep trupit nxehtësi të madhe. Qumështi del nga gjaku me hope për t'u njohur me fuqinë e All'llahut, i Cili arrin të krijojë një ushqim të pastër e të shijshëm nga gjëra që të duken të ndotura.

Pastaj ajeti shton: **“Ju keni prej tyre shumë dobi dhe hani prej tyre”**, plus mishin që konsiderohet si një nga pjesët kryesore të ushqimit, për të cilin ka nevojë trupi. Po ashtu përfitohet nga lëkurët e kafshëve në prodhimin e veshjeve, të tendave të fuqishme dhe jetëgjata; përfitohet nga leshi i tyre në prodhimin e veshjeve dhe të shtrojës e mbulojës; madje përfitohet edhe nga jashtëqitjet e tyre për të plehëruar pemët dhe bimët.

²⁴ Për më tepër njohuri rreth këtyre tre frutave jetësorë, shih shpjegimin e ajetit 11 të sures “En Nahl”.

²⁵ Këtu është përdorur fjala *“ibratun”* (përvojë) në formën mohuese për të treguar madhështinë e saj.

Po ashtu, kafshët përdoren për t'u hipur në tokë si anijeve në det: **“dhe udhëtoni me ato ashtu siç udhëtoni me anije.”**²⁶

Të gjitha këto veçanti dhe dobi të bagëtive konsiderohen me të drejtë mësim dhe përvojë për ne. Ato i mësojnë njeriut të mirat që i ka krijuar All'llahu, ashtu siç ngjall tek ai ndjenjat e falënderimit dhe të lavdërimit për All'llahun.²⁷

Pyetja e vetme e mbetur është: Si ka mundësi që si kafshët e samarit ashtu edhe anijet janë vënë në një nivel të vetëm?

Nëse e shohim si çështje të vetme, përgjigjja do të jetë e qartë dhe pikërisht se njeriu gjatë jetës së tij ka nevojë të hipë herë në tokë e herë në det ku përdoren anijet.

Kjo shprehje është e njëjtë me atë që përdoret në ajetin 70 të sures “El Isrā’”, ku folëm për atë që All'llahu u dhuroi bijve të Ademit: **“ua kemi bërë të mundur që të udhëtojnë në tokë dhe në det.”**.

²⁶ Çështjen e përfitimit nga kafshët e kemi trajtuar gjerësisht në shpjegimin e ajetit 80 të sures “En Nahl”.

²⁷ Në shpjegimin e ajetit 14 të sures “En Nahl” si dhe në shpjegimin e ajetit 65 të sures “El Haxh” kemi parë rëndësinë e anijeve dhe veçoritë e lëndëve të ndryshme që futen në përdorimin e tyre.

“Por paria e popullit të tij, që nuk besonte, tha: ‘Ky është veçse njeri si ju e do vetëm të madhërohet mbi ju. Sikur të kishte dashur All’l-lahu, do të dërgonte engjëj; nuk kemi dëgjuar diçka të tillë nga të parët tanë të lashtë.’”

“Ai është njeri i marrë, prandaj lëreni atë njëfarë kohe!”

Komentimi

Logjika e frikacakëve të verbuar nga mendjemadhësia

Ajetet e kaluara folën për Njësimin (Teuhidin), njohjen e All’l-lahut dhe shkaqet e madhështisë së Tij në botën e krijesave. Kurse ajetet që po studiojmë dhe ajetet që do vijjnë, trajtojnë të njëjtën çështje me gjuhën e Profetëve të mëdhenj nëpërmjet historisë së jetës së tyre.

Ato fillojnë me të parin Profet që shprehu vendosmërinë dhe thirri për njësimin. Nuhun (*Paqja qoftë mbi të!*): **“Ne e dërguam Nuhun te populli i tij dhe ai tha: ‘O populli im, adhuron All’l-lahun! Ju nuk keni zot tjetër të vërtetë përveç Tij, vallë, a nuk keni frikë (prej Tij)?’”** Pra, pas kësaj shpalljeje të qartë, si ka mundësi që të mos evitoni adhurimin e idhujve?

Por paria e të pasurve prej popullit të Nuhut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe e të verbuarve nga mendjemadhësia si dhe një grumbull njerëzish, të cilët nga jashtë ta mbushin syrin, ndërsa në

realitet janë të zbrazët, thonin: **“Ky është veçse njeri si ju e do vetëm të madhërohet mbi ju.”**.

Kështu, sipas tyre, e meta e parë e Nuhut ishte qenia e tij njeri dhe ata e akuzuan se donte pushtet. Ndërsa thëniet e tij për All’llahun, për teuhidin, për fenë dhe për besimin i quanin komplot për të realizuar qëllimet e tij. Pastaj shtonin: **“Sikur të kishte dashur All’llahu do të dërgonte engjë.”**. Dhe si për t’i vënë kapak këtij argumentimi të pabazë dhe bosh, thonin: **“nuk kemi dëgjuar diçka të tillë nga të parët tanë të lashtë.”**.

Por këto fjalë boshe nuk ndikuan në anën shpirtërore të këtij Profeti të madh. Ai e vazhdoi thirrjen e vet për tek All’llahu. Në veprën e tij nuk kishte asnjë provë se dëshironte të arrinte ndonjë privilegj mbi të tjerët, apo se donte të merrte pushtet mbi ta. Prandaj shpejtuan t’i drejtonin akuza të tjera duke e quajtur të çmendur, akuzë kjo që iu është bërë të gjithë Profetëve të All’llahut gjatë historisë. Ata thonin: **“Ai është njeri i marrë, andaj lëreni atë njëfarë kohe!”**

Idhujtarët politeistë përdorën shprehjen **“ai ka xhindet”** kundër këtij Profeti të dërguar (që do të thotë se ai kishte një lloj çmendurie), me qëllim që të mbulonin të vërtetën e qartë. Fjalët e Nuhut (*Paqja qoftë mbi të!*) ishin prova më e mirë për vlerën e madhe të punës dhe mendjes së tij. Por ata me fjalë të tilla synonin të thonin se të gjitha këto gjëra janë të vërteta, por puna është se marrëzia i shfaq atij pamje të shkëputura, ku ndonjëra prej tyre mund të lidhet me arsyen!!

Ndërsa shprehja **“prandaj lëreni atë njëfarë kohe”** mund të tregojë se ata kundërshtarë prisnin vdekjen e Nuhut (*Paqja qoftë mbi të!*) moment pas momenti, me qëllim që të qetësonin veten e

tyre. Por mund të tregojë edhe konfirmim prej tyre të çmendurisë së tij dhe thonin: Prisni derisa të shërohet nga kjo sëmundje.²⁸

Sidoqoftë kundërshtarët i drejtuan Nuhut (*Paqja qoftë mbi të!*) tre akuza të trilluara dhe kontradiktore dhe secilën prej tyre e konsideronin si provë që hidhte poshtë kumtin (mesazhin) e tij.


E para: Pretendimi i njerëzve se ata janë të dërguar të All'llahut është pretendim i gënjeshtërt, sepse nuk kishte ndodhur ndonjë gjë e tillë më parë. Nëse All'llahu do donte një gjë të tillë, do të kishte dërguar engjëjt e Tij si kumtues për njerëzit!

E dyta: Ai është njeri që kërkon pushtet dhe fjalët e tij janë pretekst për realizimin e synimeve të veta!

E treta: Ai nuk zotëron ndonjë mendje të shëndoshë dhe gjithçka që thotë s'janë tjetër veçse fjalë të rastësishme!

Meqë përgjigjja për këto akuza të trilluara është diçka shumë e qartë dhe ka ardhur në ajetet e tjera kur'anore, ajetet e tanishme nuk i janë referuar përgjigjes ndaj tyre, sepse është e sigurtë nga njëra anë, që udhëheqësi i tyre të jetë njëri prej tyre dhe nga lloji i tyre që të njohë problemet e tyre dhe të ndjejë dhimbjet e tyre. Përveç kësaj, të gjithë Profetët kanë qenë njerëz. Nga ana tjetër, gjatë shfletimit të historisë së Profetëve dhe paraqitjes së jetës së tyre, qartësohet se problemi i vëllazërimit dhe i thjeshtësisë mohon çdo epitete për pushtet tek ata. Po kështu vlera e mendjeve dhe e veprave të tyre u provua edhe për armiqet e

²⁸ Siç kanë thënë disa komentues: "Kjo shprehje tregon thënien e kundërshtarëve të Nuhut (*Paqja qoftë mbi të!*) që thanë: "Burgoseni atë për një fare kohe". Ndërsa disa të tjerë kanë thënë se ata synonin që ta linin atë në gjendjen ku ishte. Por të dyja këto shpjegime nuk duken se janë të vërteta.



“(Nuhu) tha: ‘O Zoti im, më ndihmo, sepse ata më quajnë për gënjeshtar!’”

“Dhe Ne i shpallëm atij: ‘Ndërto anijen nën Sytë (mbikëqyrjen) dhe frymëzimin Tonë e, kur të vijë urdhri Ynë e të vërshojë uji nga furra, ngarko në anije prej çdo lloj gjallese nga një çift dhe familjen tënde, përveç atyre që janë dënuar të humbasin, dhe mos M’u drejto për ata që kanë bërë të këqija se ata, me të vërtetë, do të mbyten.’”

“Kur të hipësh në barkë ti dhe ata që janë me ty, thuaj: ‘Qoftë lavdëruar All’lahu, i cili na shpëtoi prej popullit të padrejtë.’”

“Dhe thuaj: ‘Zoti im, më zbarko në vend të bekuar, se Ti je më i miri për të na zbarkuar.’”

“Sigurisht që këto ishin shenja. Në të vërtetë, jemi Ne që i vëmë në provë (njerëzit).”

Komentimi

Fundi i jetës së një populli kokëfortë

Ajetet e shkuara paraqitën akuzat që armiqtë i bënë Nuhut (*Paqja qoftë mbi të!*). Por nga ajete të tjera kur'anore del shumë qartë se lëndimi i Nuhut (*Paqja qoftë mbi të!*) nga armiqtë e tij nuk u kufizua vetëm në këto problem, por përfshinte çdo mjet që mund të përdorej për lëndimin e tij. Ndërkohë, Nuhu (*Paqja qoftë mbi të!*) mbledhi gjithçka që mund të mbledhte për t'i orientuar ata në rrugën e drejtë dhe për t'i shpëtuar nga kthetrat e idhujtarisë dhe të mosbesimit. Kur e humbi shpresën sepse asnjë nuk i besoi asaj që kishte sjellë, përveçse një grupi të vogël, i bëri thirrje All'Ilahut që ta ndihmonte. Në ajet lexojmë: “(Nuhu) **tha: O Zoti im, më ndihmo sepse ata më quajnë gënjeshtar.**”²⁹

Këtu zbriti Shpallja e All'Ilahut për përgatitjen e shpëtimit të Nuhut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe të shokëve të tij të paktë dhe për shkatërrimin e idhujtarëve kokëfortë: **“Dhe Ne i shpallëm atij: ‘Ndërto anijen nën Sytë Tanë (mbikëqyrjen) dhe frymëzimin Tonë.’**”.

Fraza **“nën Sytë Tanë (mbikëqyrjen)”** tregon përpjekjet tuaja në këtë rrugë do të jenë nën mbrojtjen Tonë, prandaj puno me bindje e me mendje të qetë dhe mos u frikso prej asgjëje.

Përdorimi i frazës **“frymëzimin Tonë”** na zbulon neve se Nuhu (*Paqja qoftë mbi të!*) e mësoi ndërtimin e anijes me anë të frymëzimit hyjnor sepse historia nuk përmend që njeriu të ketë ndërtuar një mjet të tillë deri në kohën e Nuhut (*Paqja qoftë mbi*

²⁹ Shkronja “ba” në shprehjen “bima kedh’dhibune” ndoshta është shkakore ose si krahasim. Ndërsa “ma” mund të jetë kundrinor ose lidhëse. Por kuptimi i tyre në të dyja rastet është i ndryshëm. Ky ndryshim nuk është i rëndësishëm, prandaj kini kujdes!

të!). Për këtë shkak, Nuhu e ndërtoi anijen në atë formë të përshtatshme me qëllimin e tij dhe ai dëshironte që ajo të ishte sa më e mirë.

Më pas ajeti thotë se kur të vijë urdhri i All'llahut, shenjë e të cilit ishte vërshimi i ujit nga furra, dije se koha e përmbytjes u afrua, prandaj nga çdo lloj kafeje zgjidh një çift, mashkull e femër dhe hipi ato në anije. Ajeti thotë: **"...e, kur të vijë urdhri Ynë e të vërshojë uji nga furra, ngarko në anije prej çdo lloj gjallese nga një çift dhe familjen tënde, përveç atyre që janë dënuar të humbasin..."**

Pastaj ajeti shton e thotë: **"...dhe mos M'u drejto për ata që kanë bërë të këqija se ata, me të vërtetë, do të mbyten."** Ky paralajmërim ka ardhur me qëllim që Nuhu (*Paqja qoftë mbi të!*) të mos ndikohet nga dhembshuria njerëzore, ajo e babait, apo nga dhembshuria e tij ndaj bashkëshortes së vet e të kërkojë shpëtim për ata ndërkohë që ata e humbën të drejtën e ndërmjetësit të tij (Nuhut) për shpëtim.

Ajeti pasardhës thotë: **"Kur të hipësh në barkë ti dhe ata që janë me ty, thuaj: 'Qoftë lavdëruar All'llahu, i cili na shpëtoi prej popullit të padrejtë.'"**

Pas falënderimit dhe lëvdatave për të madhin Zot, i cili ju mirësoi me këtë mirësi të madhe, që është mirësia e shpëtimit prej kthetrave të të padrejtëve, lutju Atij në këtë mënyrë: **"Dhe thuaj: 'Zoti im, më zbarko në vend të bekuar, se Ti je më i miri për të na zbarkuar.'"**

Fjala "*munzelun*" mund të jetë emër vendi që do të thotë: Pas përmbytjes ne i lutemi All'llahut që të na zbresë në një vend me mirësi të shumta që të jetojmë në të, të lumtur e të qetë.

Po ashtu mund të ketë kuptimin: Na zbrit në një vend të përshtatshëm sepse pas përmbytjes gjenden rreziqe që i kërcënojnë pjestarët e anijes se ata nuk kanë vendbanim, as ushqim të mjaftueshëm, mund të goditen nga sëmundjet, etj. Për këtë, Nuhu (*Paqja qoftë mbi të!*) e luti Zotin e tij që ta zbritte në një vend të begatë.

Ajeti i fundit, prej ajeteve në fjalë, flet në formë të përmbledhur për këtë histori ku thotë:

“Sigurisht që këto ishin shenja...” Pra, në këto ndodhi që i ndodhën Nuhut (*Paqja qoftë mbi të!*), në triumfin e tij ndaj kundërshtarëve dhe armiqve të padrejtë dhe në zbritjen dënimit të ashpër e të rëndë mbi ata kundërshtarë ka shenja dhe tregues për të zotët e mendjeve të shëndosha. Më pas ajeti vazhdon: **“...Në të vërtetë, jemi Ne që i vëmë në provë (njerëzit).”**. Pra, sigurisht, Ne i sprovovjmë të gjithë. Kjo fjali mund të jetë treguese për sprovën e vazhdueshme të popullit të Nuhut (*Paqja qoftë mbi të!*) nga ana e All’llahut dhe kur dështuan në sprovim, i dënoi ata përveç besimtarëve.

Po ashtu, fjalia mund të jetë treguese se provimi i All’llahut është në çdo kohë dhe në çdo vend për të gjithë njerëzit. Ajo që përmendet në këto ajete, nuk ka qenë e posaçme për njerëzit në kohën e Nuhut (*Paqja qoftë mbi të!*), por përfshin njerëzit e të gjitha kohëve. Punëkeqët shkatërrohen dhe punëmirët vazhdojnë rrugëtimin e tyre.

Ajetet në fjalë janë mjaftuar me çështjen e ndërtimit të anijes dhe hipja e Nuhut dhe e pasuesve të tij në të. Ato nuk tregojnë për fundin e gjynahqarëve dhe nuk flasin me detaje për ata. Ato mjaftohen me thënies se ata morën atë që u kishte

premtuar All'illahu "...se ata, me të vërtetë, do të mbyten.". Sepse, premtimi është i patjetërsueshëm dhe nuk mund të shkelet.

Duhet thënë se gjendet një bisedë e gjatë për popullin e Nuhut dhe për qëndrimet e tyre ndaj këtij Profeti të madh dhe për fundin e tyre të dhembshëm. Po ashtu ka shumë fjalë për historinë e anijes, për shpërthimin e ujit nga furra, për ndodhinë e përmbysjes, për mbytjen e djalit të Nuhut (*Paqja qoftë mbi të!*). Pjesën më të madhe të këtyre thënieve i kemi sqaruar në Komentimin e sures "Hud". Me shpresën të All'illahu, një pjesë tjetër do ta përmendim në Komentimin e sures "Nuh".

Ajetet 31 - 41

“Pas tyre, Ne krijuam një brez tjetër.”

**“A tyre u çuam një të Dërguar nga gjiri i tyre, që u tha:
'Adhuroni All'llahun! Ju nuk keni zot tjetër, përveç Tij! Vallë a
nuk frikësoheni?!’”**

**“Por paria e popullit të tij, e cila nuk besonte dhe e mohonte
takimin në Botën Tjetër dhe, së cilës, i kishim dhënë të mira në
këtë botë, tha: 'Ky është vetëm njeri si ju, ha nga ato që hani
edhe ju dhe pi nga ato që pini edhe ju!’”**

**“Nëse ju i bindeni një njeriu si ju, me siguri, do të jeni të
humbur!”**

**“A ju premtan ai që, kur të vdisni e të bëheni pluhur dhe eshtra,
do të ringjallen vërtet?!’”**

“Sa premtim qesharak që është!”

**“Nuk ka jetë tjetër përveç jetës së kësaj bote, ne jetojmë e
vdesim e nuk do të ringjallemi më.”**

**“Ai është vetëm një njeri që trillon gënjeshtër për All'llahun,
prandaj nuk i besojmë atij.”**

**“(I dërguari) tha: 'O Zoti im, më ndihmo, sepse ata më akuzojnë
se gënjej!’”**

“(All'llahu) tha: 'Së shpejti do të pendohen!’”

**“E, me të drejtë i kaploi ata një zë i tmerrshëm dhe Ne i bëmë si
gjethe të fishkura. Larg qoftë (nga mëshira e All'llahut) populli i
padrejtë!”**

Komentimimi

Fundi i dhembshëm për popullin e Themudit

Këto ajete flasin për popujt që erdhën pas popullit të Nuhut (*Paqja qoftë mbi të!*). Logjika e tyre është si e jobesimtarëve të mëparshëm. Gjithashtu, ajetet sqarojnë fundin e tyre të dhimbshëm duke plotësuar atë që hulumtuan ajete e mëparshme.

Ajeti i parë thotë: **“Pas tyre, Ne krijuam një brez tjetër.”**.

Fjala "karnun" rrejd nga fjala "el iktiranu" që do të thotë "el kurbu", "afërsi". Për këtë, kjo fjalë përdoret edhe për një grup që jeton në një kohë të njëjtë. Gjithashtu, kjo fjalë përdoret edhe për kohën e tyre. Përshkrimi i shekullit me 30 vite apo me 100 vite, bazohet tek ajo çfarë është e njohur te kombet e ndryshme.

Meqenëse njerëzit nuk mund të jetojnë pa një udhëheqës nga ana e All'llahut, Ai dërgoi Profetët e Tij që të ftojnë në Teuhid dhe të zbatojnë drejtësinë e Tij në mesin e njerëzve. Ajeti vijues thotë: **“Atyre u çuam një të Dërguar nga gjiri i tyre, që u tha: ‘Adhuroni All'llahun! Ju nuk keni zot tjetër, përveç Tij...’”** Kjo është baza e thirrjes së Profetëve. Ajo është thirrja në Njëtim (Teuhid), baza e të gjitha ndreqjeve individuale dhe shoqërore. Pas kësaj, i Dërguari i All'llahut u thotë atyre se pas kësaj thirrjeje ju duhet të hiqni dorë e të largohen nga idhujtaria dhe politeizmi: **“...Vallë a nuk frikësoheni?!”**.

Por, kush ishte ai popull? Kush ishte Profeti i tyre?

Pas Hulumtimeve të ajeteve të ngjashme me këtë ajet komentuesit kanë thënë se ka dy alternativa:

E para: Ata janë populli i Themudit, të cilët kanë jetuar në veri të Hixhazit. All'llahu dërgoi Profetin Salih (*Paqja qoftë mbi të!*) për udhëzimin e tyre. Mirëpo ata nuk besuan dhe u bënë të padrejtë. All'llahu i shkatërroi ata me britmë, zë nga qielli (rrufeja vrasëse). Dëshmitar i këtij Komentimimi dhe argument i vërtetësisë së tij është "*sajhatu*" që përmendet në fund të ajeteve në fjalë, e cila përmendet edhe në ajetin 67 të sures "Hud" dhe është e veçantë për popullin e Salihut (*Paqja qoftë mbi të!*).

E dyta: Është për popullin e Adit, Profet i të cilëve ishte Hudi (*Paqja qoftë mbi të!*). Ajetet e tjera e përmendin këtë menjëherë pas përmendjes së Nuhut (*Paqja qoftë mbi të!*). Ky është tregues i rregullsisë së këtij Komentimimi.³⁰ Mirëpo, dënimi i popullit të Adit ka qenë me furtunë (erë) të fuqishme, siç e përmendin ajetet 6 dhe 7 të sures "El Hakk", e cila vazhdoi shtatë ditë dhe i shkatërroi ata. Kështu që Komentimimi i parë është më i mirë.

Tani të shohim se cili ishte reagimi i atij populli kokëfortë ndaj Teuhidit që thëriste në të ky Profet i madh.

Ajeti pasues thotë: **"Por paria e popullit të tij, e cila nuk besonte dhe e mohonte takimin në Botën Tjetër dhe, së cilës, i kishim dhënë të mira në këtë botë, tha: 'Ky është vetëm njeri si ju, ha nga ato që hani edhe ju dhe pi nga ato që pini edhe ju!'".** Vërtet, populli i cili jetoi në luks të plotë, Kur'ani e quan "*el*

³⁰ Për këtë shih suren "Hud", ajeti 50, suren "A'raf", ajeti 65 dhe suren "Shuara", ajeti 123.

meleu", sepse e jashtmjë e tyre të mbush syrin kurse brendia e tyre është e zbrazët nga dita.

Meqenëse thirrja e të Dërguarit të All'llahut ishte në kundërshtim me dëshirat e tyre, me interesat e tyre armiqësore dhe me sundimin e tyre të padrejtë, ata kundërshtuan dhe u larguan nga përmendja e All'llahut. Ata e mohuan Jetën Tjetër dhe debatonin me të Dërguarin e tyre me të njëjtën logjikë si kundërshtarët e popullit të Nuhut (*Paqja qoftë mbi të!*). Ata bazoheshin tek të qenit e të Dërguarve njerëz në refuzimin e profetësisë së tyre.

Pastaj disa prej tyre u thanë disa të tjerëve: **"Nëse i bindeni një njeriu si ju, me siguri që do të jeni të humbur!"**.

Ata budallenj nuk ia vunë veshin kësaj të vërtete. Me këto yshtje djallëzore, ata donin nga njerëzit që të udhëhiqeshin në luftë kundër Profetëve. Ndërkohë i turpëronin dhe talleshin me ata që shkonin pas tyre dhe që mbështeteshin në ndihmën e qendrës së Shpalljes hyjnore, e cila ua mbushte zemrën me dritë dhe dije hyjnore, duke pretenduar se një gjë e tillë ishte kufizim për liritë e njeriut.

Pastaj ata mohuan Ringjalljen që qëndronte si një mburojë e fortë përballë ndjekësve të dëshirave dhe padronëve të kënaqësive, duke thënë: **"A ju premtom ai që kur të vdisni e të bëheni pluhur dhe eshtra do të ringjallen vërtet?!"**. për të jetuar një jetë të re... **"sa premtim qesharak që është!"**. Jo besimtarët pyesnin: A mund të ndodhë Ringjallja edhe pse njerëzit janë bërë pluhur dhe pjesëzat e tyre janë shpërndarë sa andej këndeje? Vërtet, ajo është e pamundur!!! Me këto fjalë ata shtuan

këmbënguljen në mohimin e Ringjalljes duke thënë: Ne e shohim vazhdimisht vdekjen e disave njerëzve dhe lindjen e disa të tjerëve që zënë vendin e atyre që vdesin dhe nuk ka jetë pas vdekjes. Për këtë ajeti thotë: **“Nuk ka Jetë Tjetër përveç jetës së kësaj bote, ne jetojmë e vdesim e nuk do të ringjallemi më.”**.

Së fundi ata i përmbloodhën akuzat drejtuar Profetit të tyre duke thënë: **“Ai është vetëm një njeri që trillon gënjeshtër për All’llahun, prandaj nuk i besojmë atij.”**. Ai nuk ka mesazh nga All’llahu, as Ringjallje dhe as program hyjnor, prandaj është e pamundur që një mendje e zgjuar ta besojë një gjë të tillë.

Kur këmbëngulja e jobesimtarëve u tiranizua dhe u zhduk edhe pika e fundit e turpit të tyre, ata u bënë kryelartë ndaj All’llahut dhe mohuan mesazhin e Tij. Ata i mohuan mrekullitë e Profetëve të Tij me mburrje e me krekosje. All’llahu e plotësoi arumentin e Tij për ata. Kështu që ky Profet i madh iu drejtua All’llahut të Madhëruar duke: **“O Zoti im, më ndihmo, sepse ata më akuzojnë se gënjej!”**. *O Zoti im, më ndihmo, sepse ata kanë nëpërkëmbur gjërat e shenjta, më kanë akuzuar siç kanë dashur dhe kanë përgënjeshtruar thirrjen time.*

All’llahu i Madhëruar dhe i Lartësuar iu përgjigj siç e tregon ajeti me fjalët: **“(All’llahu) tha: ‘Së shpejti do të pendoheni!’”** Por ata do pendohen Ditën kur ky pendim nuk do t’u hyjë më në punë.

Kështu ndodhi: **“E me të drejtë i kaploi ata një zë i tmerrshëm”**, u ra rrufeja e vdekjes me tmerrin e saj të madh dhe shkatërrimin e saj fshirës, u përmbysën banesat e tyre dhe u kthyen në gërmadha. Kjo ishte aq e shpejtë dhe aq vetëtimthi deri në atë shkallë saqë nuk u dha mundësi as të iknin dhe si pasojë, u

varrosën nëpër banesat e tyre, siç e vë në dukje ajeti Fisnik: **“Ne i bëmë si gjethe të fishkura.”**. Me një fjalë, Ne i bëmë ata si bar i tharë që e merr vazhda me vete: **“Larg qoftë (nga mëshira e All’llahut) populli i padrejtë!”**.

Hulumtime

1- Jeta në luks dhe pasojat e saj fatale

Ajetet e kaluara sqaruan lidhjen midis luksit (jetesës së krerëve të pasur) dhe mosbesimit e mohimit të takimit të All’llahut, që është një e vërtetë e njohur. Ata që bëjnë jetë luksi ua lëshojnë frerin epsheve të tyre kafshërore. Dihet se këta nuk e pranojnë kontrollin hyjnor, nuk e pranojnë Ditën e Ringjalljes, ku i pret gjykimi i Gjykatës së Drejtësisë së All’llahut. Sipas tyre, pranimi i këtyre çështjeve ua dobëson ndërgjegjen dhe i nxit njerëzit kundër tyre. Prandaj, ata njerëz nuk e njohin adhurimin ndaj All’llahut, mohojnë parimin dhe rilindjen dhe e shohin jetën siç e përshkruajnë ajetet e mësipërme: **“Nuk ka Jetë Tjetër përveç jetës së kësaj bote; ne jetojmë e vdesim e nuk do të ringjallemi më.”**.

Kjo është parulla e tyre që shpreh çmendurinë dhe humbjen e tyre të hapur: le ta shfrytëzojmë këtë rast. As ndonjë e mirë nuk ka ardhur dhe as ndonjë mesazh hyjnor nuk ka zbritur. Kush pretendon një gjë të tillë, ai është gënjeshtar. Një zog në dorë

është më mirë sesa dhjetë të tillë në pemë. Kështu, ata e justifikonin mohimin e tyre për Ditën e Ringjalljes.

Përveç kësaj, realizimi i një jete të tillë luksi, nuk arrihet asnjëherë përveçse nëpërmjet grabitjes së të drejtave të të tjerëve dhe keqtrajtimit të tyre. Një gjë e tillë arrihet duke mohuar kumtet e Profetëve dhe të Kiametit. Prandaj shohim se ata që jetojnë në pasuri dhe luks, i përbuzin të gjitha vlerat qiellore dhe mohojnë çdo gjë që vjen nga All'llahu i Madhëruar.

Këta budallenj u bënë robër të dëshirave të tyre personale, dolën nga nënshtrimi ndaj All'llahut, duke u transformuar në skllëvër të dëshirave dhe epsheve të tyre. Jo vetëm kaq, por edhe robër të robërve të tjerë me një psikologji të rënë dhe me zemra të zeza sterrë, me një perspektivë të errët, pavarësisht se disa mendojnë që ata janë të pasur dhe kështu do jetojnë gjithnjë. Por shqetësimi që i kaplon nga ndëshkimi i All'llahut, nga mbarimi i pasurisë dhe i bollëkut të tyre dhe frika nga vdekja, nuk i lë ata të qetë.

2- “Pluhuri” dhe “kockat”

Pas vdekjes, trupi i njeriut dekompozohet dhe kthehet në pluhur, por ajeti i kaluar e vendos pluhurin para kockave. Përse?

Kjo mund të jetë aludim për dy pjesë shumë të rëndësishme të përbërësve të trupit, që janë mishi dhe kockat. Mishi dekompozohet i pari dhe bëhet pluhur, ndërkohë që kockat mbeten edhe për njëfarë kohe derisa edhe ato kthehen në pluhur.

Ndoshta fjala “*pluhur*” këtu është aludim për gjysh-stërgjyshët shumë të vjetër që janë bërë pluhur. Ndërsa fjala “*kocka*” është aludim për baballarët, të cilëve u janë dekompozuar trupat, por u kanë mbetur kockat dhe që ende nuk janë kthyer në pluhur.³¹

3- Ç’do të thotë “*githa’un*”?

Ne u njohëm me fatin e popullit të Themudit, i cili siç e përmendën ajetet e mësipërme, u transformua në “*githa’un*”. Kjo fjalë ka kuptimin e bimëve të thara të grumbulluara që qëndrojnë në ujërat e përrenjve. Po kështu, kjo fjalë përdoret edhe për emërtimin e shkumës që krijohet në kusi nga uji i valuar. Krahasimi i trupave të vdekur me këtë fjalë është provë e dobësisë së tyre përfundimtare, copëtimit të tyre dhe humbjes së çdo vlere, sepse bimët e thara që qëndrojnë sipër ujërave të përrenjve, pasi mbaron rrëkeja janë krejtësisht pa vlerë dhe nuk lënë asnjë gjurmë. (Ne e shpjeguam hollësisht britmën qiellore në Komentimin e ajetit 67 të sures “Hûd”). Ky ndëshkim nuk ishte i veçantë vetëm për popullin e Themudit sepse edhe popuj të tjerë u zhdukën me këtë ndëshkim.


4- Përfundimi i përgjithshëm

Ajo që tërheq vëmendjen është se shprehja e fundit e ajeteve që po studiojmë, e nxjerr çështjen nga korniza e saj, duke e bërë ligj të përgjithshëm: “**Larg qoftë** (nga mëshira e All’llahut)

³¹ Tefsiri “Ruhul Meanij”, fundi i ajetit në studim.

populli i padrejtë!". Ky është një konkluzion përfundimtar i të gjitha këtyre ajeteve. Ajo që u tha lidhur me mohimin, përgënjeshttrimin e Shpalljeve hyjnore, për Ringjalljen, ndëshkimin e dhimbshëm dhe fundin e keq, nuk veçohen vetëm për një grup të caktuar, por përfshijnë të gjithë keqbërësit gjatë historisë.

Ajetet 42 - 44



“Pas tyre, Ne krijuam brezni të tjera.”

“Asnjë popull nuk mund ta shpejtojë apo ta ngadalësojë kohën e caktuar për të.”

“Ne i kemi nisur të Dërguarit Tanë njëri pas tjetrit. Sa herë që një i Dërguar i shkonte ndonjë populli, atë e quanin gënjeshtar! Prandaj Ne i kemi bërë ata (popuj) të ndjekin njëri-tjetrin (në shkatërrim) dhe i kemi bërë histori që rrëfehen. Qoftë larg (nga mëshira e All’llahut) populli që nuk beson!”

Komentimimi

Vdekja e popujve kokëfortë njëri pas tjetrit

Pasi foli për historinë e popullit të Nuhut, Kur'ani vë në dukje se popuj të tjerë erdhën pas tij dhe para Profetit Musa (*Paqja qoftë mbi të!*). Në ajet thuhet: **“Pas tyre Ne krijuam brezni të tjera”** sepse ky është urdhri i All'llahut dhe ligji i Tij në krijim. Bollëku i All'llahut nuk ndërpritet për robtë e Tij. Nëse ndonjë grup synon të qëndrojë kundër rrugës së përsosjes njerëzore, Ai e zhduk dhe e shtyn marshimin përpara.

Për këta popuj ka histori të caktuara dhe afat kohor të kufizuar: **“Asnjë popull nuk mund ta shpejtojë apo ta ngadalësojë kohën e caktuar për të.”**. Nëse del urdhri përfundimtar për mbarimin e jetës së tyre, ata do të zhduken menjëherë, pa u shtuar apo pakësuar as edhe një moment.

Fjala *“el exhel”* do të thotë moshë, kohë dhe afat i një gjëje. Është sikur të themi: Koha e këtij çeku është tre muaj, që do të thotë se afati i tij mbaron pas tre muajsh ose në një afat a datë të caktuar.

Siç kemi thënë më parë, afati është dy llojesh: afati i “paracaktuar” dhe ai “kushtor”. Afati i paracaktuar do të thotë mbarim i moshës së njeriut, apo i një brezi të çfarëdoshëm dhe ai

nuk mund të ndryshojë. Ndërsa afati kushtor do të thotë se mund të ndryshojë sipas ndryshimit të kushteve, duke u shtuar apo pakësuar. Ne kemi folur për këtë më parë gjerësisht.³²

Sidoqoftë, ajeti i kaluar vë në dukje “afatin e paracaktuar”.

Ajeti tjetër zbulon të vërtetën e vazhdimit të dërgimit të Profetëve gjatë historisë me thirrje për tek All’llahu, duke thënë: **“Ne i kemi nisur të Dërguarit Tanë njërin pas tjetrit.”**

Fjala “tetra” vjen nga fjala “el ueter” që ka kuptimin e “njëri pas tjetrit”. Kurse “teuaturul ekhbari”, do të thotë ardhja e lajmeve njëri pas tjetrit dhe nga grumbullimi i tyre, njeriu bindet për vërtetësinë e tyre. Kjo fjalë në origjinë vjen nga fjala “el ueter” që ka kuptimin e kordës së harkut, ku korda lidh dy anët e harkut duke qëndruar në pjesën e pasme për të realizuar afrimin e tyre. (Nga ana ndërtimore, fjala “tetra” në origjinë është “uetra”, por “u-ja” është shndërruar në “t”).³³

Sidoqoftë, Profetët, mësuesit qiellorë, vinin njëri pas tjetrit për të drejtuar dhe udhëhequr njerëzit, porse disa popuj kokëfortë vazhdonin mosbesimin dhe mohimin, prandaj ajeti thotë: **“Sa herë që një i Dërguar i shkonte një populli, atë e quanin gënjeshtar!”**.

Kur ky mosbesim e përgënjeshtroi e tejkaloi cakun e vet dhe për ta mbaroi argumenti: **“Ne i kemi bërë ata (popuj) të ndjekin njëri-tjetrin (në shkatërrim)”**, domethënë Ne i zhdukëm popujt kokëfortë njërin pas tjetrit dhe i fshimë nga ekzistenca. Zhdukja e tyre ishte e atillë sa që nuk mbeti prej tyre veçse

³² Për më shumë shih shpjegimin e ajetit 2 të sures “El En’âm”.

³³ Fjala “tetra” në origjinë vjen nga fjala “uetra”, ku “u-ja” u transformua në “t”.

historira që qarkullojnë midis njerëzve: **“dhe u kemi bërë histori që rrëfihen”** duke vënë në dukje se çdo popull ekspozohet për zhdukje dhe prej tyre mbeten vetëm disa individë dhe disa gjurmë këtu e atje. Disa herë nuk mbetet prej tyre asnjë gjurmë. Këta popuj kokëfortë dhe keqbërës ishin pjesë e grupit të dytë.³⁴

Ajeti, siç kanë vënë në dukje ajetet e mëparshëm, thotë: **“Qoftë larg (nga mëshira e All’llahut) populli që nuk beson!”**. Me të vërtetë, ky fat është rezultat i mosbesimit tek All’llahu. Çdo grup që nuk ka besim, që është kokëfortë dhe keqbërës, do të shijojë këtë fat. Ai zhduket në atë mënyrë sa që të mos i mbetet asgjë, përveç kujtimit nga historia dhe në bisedat e njerëzve.

Ata nuk kanë qenë larg nga mëshira e All’llahut vetëm në këtë botë, por edhe nga mëshira e Botës Tjetër ata do të jenë larg, sepse shprehja e ajetit ka ardhur me kuptim të përgjithshëm dhe i përfshin të gjithë.

³⁴ Fjala “*El Ehêdîthu*” është shumësi i fjalës “*hadîthun*” (tregim, histori) dhe shpjegimi i saj është siç u tha më lart. Por disa kanë supozuar se ajo mund të jetë shumësi i fjalës “*Uhduuthetun*” me kuptimin e lajmeve të çuditshme për të cilat flasin njerëzit - “Shpjeguesi i Madh”; fundi i ajeteve në studim.

“Pastaj dërguam Musain dhe vëllanë e tij, Harunin, me mrekullitë Tona dhe autoritet të qartë,”

“te Faraoni dhe paria e tij, por ata ishin njerëz arrogantë dhe nuk i pranuan.”

“Ata thanë: ‘Vallë a t’u besojmë dy njerëzve që janë si ne, ndërkohë që populli i tyre na shërben neve?!”

“Kështu, ata të dy i shpallën për gënjeshtarë, prandaj ishin nga të shkatërruarit.”

“Në të vërtetë, Ne i dhamë Librin (Teuratin) Musait, që ata të udhëzohen në rrugë të drejtë.”

Komentimi

Ngritja e Musait dhe vdekja e faraonëve

Deri tani u fol për popuj të cilëve iu dërguan të Dërguar para Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe që u zhdukën. Ndërsa ajetet që po studiojmë tani flasin shumë shkurtimisht rreth revoltës së Musait dhe Harunit kundër faraonëve dhe për fundin e këtyre mendjemëdhenjve. Ajeti i parë thotë: **“Pastaj dërguam Musain dhe vëllanë e tij Harunin, me mrekullitë Tona dhe autoritet të qartë.”**.

Ekzistojnë shumë transmetime rreth asaj që synon fjala “*el ājat*” dhe shprehja “*sultânun mubînun*” dhe për ndryshimin midis tyre.

1- Disa komentues kanë thënë se “*el ājat*” janë mrekullitë që All’llahu ia dha Musa ibn Umrانيت (shtatë mrekullitë). Ndërsa shprehja “*sultânun mubînun*” ka kuptimin e logjikës së qartë dhe të argumentit mbrojtës që i dha forcë Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) përballë faraonëve.

2- Disa komentues të tjerë thonë se fjala “*el ājat*” ka kuptimin e të gjitha mrekullive të Musait (*Paqja qoftë mbi të!*). Ndërsa shprehja “*sultānun mubînun*” ka kuptimin e disa prej mrekullive të rëndësishme të Musait, si shkopi i tij dhe dora e bardhë, sepse këto kishin veçanti që e ndihmuan Musain të fitonte kundër faraonëve.

3- Disa të tjerë kanë supozuar se fjala “*el ājat*” tregon për ajetet e Teuratit dhe sqarues për mësimin e studimin e të tjerave të ngjashme. Kurse shprehja “*sultānun mubînun*” tregon për mrekullitë e Musait (*Paqja qoftë mbi të*).

Por nëse vështrojmë përdorimet e fjalës “*sultānun mubînun*” në Kur'anin e Lavdishëm, do të shohim se Komentimimi i parë është më afër të vërtetës, sepse fjala “*sultānun*” apo “*sultānun mubînun*” përmendet në Kur'an me kuptimin e provës dhe të logjikës së qartë.³⁵

Me të vërtetë, Ne dërguam Musain dhe vëllanë e tij Harunin me këto mrekulli të qarta “**te Faraoni dhe paria e tij**”. Përse ajeti flet vetëm për parinë (domethënë për shoqërinë e pasur dhe kokëfortë ose siç quhet ndryshe klasa e Fisnikëve) dhe nuk thotë se mesazhi i tyre ishte për të gjithë popullin e Egjiptit?!

Ndoshta ajo është aludim për atë që faraonët ishin baza e degjenerimit dhe nëse ata do të ndreqeshin, puna e të tjerëve do ishte e lehtë. Përveç kësaj, ata ishin paria e vendit dhe siç dihet,

³⁵ Në suren “En Neml”, ajeti 21, lexojmë: “**Nëse nuk do të më sjellë arsyetim bindës, do ta dënoj me dënim të rëndë ose do ta ther!**” Ndërsa në ajetin 23 të sures “En Nexhm”, lexojmë: “**Këto janë vetëm emra që ua kemi ngjitur (idhujve) ju dhe të parët tuaj, kurse All’Ilahu nuk ju ka dërguar për ata asnjë provë**”.

asnjë vend nuk mund të rregullohet po qe se nuk janë në rregull udhëheqësit e tij. Por ata **“ishin njerëz arrogantë”**, sepse nuk iu nënshtruan shpalljes së të vërtetës dhe logjikës së qartë.

Në fakt, faraonët ishin arrogantë dhe shtypës, siç e thotë edhe ajeti: **“ishin gjindje që e rrihnin lart”**. Ndryshimi midis dy shprehjeve: **“arrogantë”** dhe **“gjindje që e rrihnin lart”** qëndron në atë se shprehja e parë mund të jetë aludim për arrogancën e tyre ndaj thirrjes së Musait (*Paqja qoftë mbi të!*), ndërsa shprehja e dytë aludim se arroganca në formën e përhershme ishte program i tyre dhe ndërtimi i tyre mendor dhe shpirtëror.

Supozohet, gjithashtu, se shprehja e parë të jetë aludim për mendjemadhësinë dhe arrogancën e faraonëve dhe e dyta aludim për atë që ata dispononin fuqi të madhe dhe një jetë të veçantë e të dallueshme prej të tjerëve. Ky ishte edhe shkaku i arrogancës së tyre.

Një nga provat e qarta të ndjenjës së tyre për t’u kapërdisur është thënia e tyre: **“Vallë, a t’u besojmë dy njerëzve që janë si ne, ndërkohë që populli i tyre na shërben neve?!”**³⁶

Ata nuk u mjaftuan me thënien se nuk donin të ndiqnin Musain dhe Harunin, por donin që Musai dhe Haruni të ishin skllevërit e tyre të përhershëm. Kështu, ata akuzuan Profetët

³⁶ Njeriu emërtohet edhe *“el beshër”*, sepse fytyra dhe lëkura e tij janë lakuriq, në kundërshtim me sa paraqiten kafshët, të cilat kanë një veshje natyrore të veçantë dhe të të gjitha llojeve, që ka ardhur si pasojë e paaftësisë së tyre për t’u mbështetur në mjetet e jetesës. All’llahu ua kompensoi këtë paaftësi duke u dhuruar këtë veshje natyrore. Ndërsa, për sa i përket njeriut, kjo iu garantua në sajë të zgjuarsisë dhe mendjes së tij.

(*Paqja qoftë mbi ta!*) për arrogancë në një kohë që ishin më të këqinj nga çdo arrogant, gjë që e dëshmojnë thëniet e tyre.

Sidoqoftë, ata iu kundërvunë Musait dhe vëllait të tij Harunit me këto prova boshe në kundërshtim me të vërtetën: **“Kështu, ata të dy (Musain dhe Harunin) i shpallën për gënjeshtarë, andaj ishin nga të shkatërruarit.”**.

Kështu përfunduan armiqhtë e bijve të Izraelit, që përbënin një pengesë të fortë ndaj thirrjes së Musait dhe të Harunit për tek All’Ilahu i Madhërishëm.

Pas kësaj filloi etapa e mësimimit dhe e edukimit të bijve të Izraelit. All’Ilahu zbriti në këtë etapë Teuratin për Musanë, i cili i thirri bijtë e Izraelit që të udhëhiqeshin nga ky libër dhe që ta zbatonin atë, siç e përmend ajeti i fundit këtu: **“Në të vërtetë, Ne i dhamë Librin (Teuratin) Musait, që ata të udhëzohen në rrugë të drejtë.”**.

Ajetet e kaluara, kur flasin për Musanë dhe vëllanë e tij, Harunin gjatë etapës së ballafaqimit të tyre me faraonët, përdorën numrin dyjës³⁷, ndërsa këtu ajeti Fisnik flet për zbritjen e Librit qiellor “Teuratin”, duke ia veçuar vetëm Musait (*Paqja qoftë mbi të!*). Kjo sepse ai ishte Profet i dërguar dhe të cilit iu zbrit Libri dhe Sheriati (ligji). Përveç kësaj, Musai ishte duke u falur në malin e

³⁷ Në gjuhën arabe ka numër njëjës, shumës dhe dyjës. Numri dyjës është shumësi për dy veta, sende etj.

Turit kur zbriti Teurati, ndërsa Haruni ndodhej midis bijve të Izraelit.³⁸

Ajeti 50



“Ne e bëmë birin e Merjemes dhe nënën e tij mrekulli për njerëzimin dhe i strehuam rrëzë një kodre të qetë me burime uji.”

³⁸ Folëm me hollësi rreth Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe për mënyrën e dërgimit e të luftës së tij kundër faraonëve në Komentimin e ajeteve 103-162 të sures “A’râf”, si dhe në shpjegimin e ajeteve 8-97 të sures “Tâhâ”.

Komentimi

Një shpallje tjetër nga shpalljet e All'llahut (ose një ajet tjetër nga ajetet e All'llahut)

Ky ajet, i cili është vazhdim i ajeteve të mëparshme, që flisnin për jetën e disa Profetëve, flet për Isain (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe nënën e tij Merjemen. Ai thotë: **“Ne e bëmë të birin e Merjemes dhe nënën e tij mrekulli për njerëzimin.”**. Ajeti përdor shprehjen **“birin e Merjemes”** në vend që të përmendë emrin e Isait (*Paqja qoftë mbi të!*), me qëllim që të tërheqë vëmendjen për të vërtetën e lindjes së tij nga një nënë, pa baba, me urdhër të All'llahut. Kjo lindje në vetvete është një nga mrekullitë e mëdha të All'llahut.

Shtazania e Merjemes (*Paqja qoftë mbi të!*) pa e prekur njeri dhe lindja Isait (*Paqja qoftë mbi të!*) prej saj, përbëjnë dy anë të një të vërtete të vetme, e cila dëshmon për madhësitë krijuese të All'llahut të Lartësuar dhe për fuqinë e Tij.

Pastaj ajeti thekson të mirat e mëdha që All'llahu me bujari të madhe ia fali kësaj nëne të zgjuar dhe birit të saj, duke thënë: **“dhe i strehuam rrëzë një kodre të qetë me burime uji.”**

Fjala *“er rebuetu”* vjen nga fjala *“er riba”* që ka kuptimin e shtimit dhe të rritjes. Kurse këtu ka kuptimin e *“vendit të ngritur”*.

Fjala “*el muîn*” vjen nga “*el ma’an*” sipas formës “*she’nun*” dhe ka kuptimin e rrjedhjes së ujit. Fjala “*el maul maîn*” do të thotë “ujë që rrjedh”. Disa mendojnë se fjala “*el maîn*” vjen nga fjala “*el ajn*” që do të thotë “*burim që duket*”, i cili mund të shihet thjesht me sy.³⁹


Në këto që u tha gjendet një aludim i përgjithshëm për një vend të qetë, të gjelbëruar, plot bekime dhe të mira, të cilin All’llahu i Madhërishëm dhe i Lartësuar ia dhuroi kësaj nëne dhe djalit të saj, duke i vendosur në vend të sigurtë larg të keqes së armiqve ku të kryenin të sigurtë detyrat e tyre.

Komentuesit kanë mendime të ndryshme në lidhje me këtë vend. Disa mendojnë se lindja e Isait (*Paqja qoftë mbi të!*) ndodhi në “En Nāsira” (një nga qytetet e Shamit). All’llahu e vuri atë dhe nënën e tij në një vend të sigurtë dhe të begatshëm dhe e ruajti nga e keqja e armiqve, të cilët donin t’i bënë keq pasi mësuan lindjen dhe të ardhmen e tij.

Të tjerë mendojnë se ky vend i sigurtë është Egjipti, sepse Merjemja (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe i biri Isai (*Paqja qoftë mbi të!*) kaluan njëfarë kohe nga jeta e tyre në Egjipt, ku kërkonin shpëtim nga e keqja e armiqve.

Të tjerë kanë thënë se Isai (*Paqja qoftë mbi të!*) lindi në Damask, ndërsa disa të tjerë në “Er Remletu”, në verilindje të Jeruzalemit ku Isai dhe nëna e tij (*Paqja qoftë mbi të!*) jetuan në të gjitha këto vende njëfarë kohe nga jeta e tyre. Ka mundësi që lindja e Isait (*Paqja qoftë mbi të!*) të ketë ndodhur në shkretëtirën e

³⁹ Në rastin e parë, fjala “*el mîmu*” (“m-ja”) është thjesht pjesë e fjalës, sipas formës “*feilun*”. Në rastin e dytë “*el mîmu*” (“m-ja”) është e tepërt dhe ka ardhur sipas formës “*mef’uulun*” – “*methelun mubînun*” (shembull i qartë).



“O të Dërguar! Hani nga të lejuarat dhe bëni vepra të mira! Vërtet, Unë e di mirë çfarë bëni ju!”

“Vërtet, kjo feja juaj është një fe e vetme, ndërsa Unë jam Zoti juaj, prandaj frikësohuni prej Meje!”

“Por ata (popuj ku u çuan të Dërguarit) u ndanë në grupe në çështje të fesë së tyre. Çdo grup ishte i kënaqur me atë që kishte.”

“Prandaj, lëri ata në padijen e tyre për një farë kohe!”

Komentimi

E gjithë bashkësia (ymeti) është një dorë e vetme

Ajetet e kaluara flisnin për të shkuarën e Profetëve dhe të popujve të tyre. Ndërsa këta ajete u drejtohen të gjithëve, duke thënë: **“O të Dërguar! Hani nga të lejuarat dhe bëni vepra të mira! Vërtet, Unë e di mirë çfarë bëni ju!”**.

O të Dërguar, dallimi midis jush dhe njerëzve të tjerë nuk qëndron në atë se ju nuk keni cilësitë e tyre, siç është nevoja për të ngrënë e për të pirë, për të fjetur dhe pushuar, por në lartësimin tuaj. Për sa i përket asaj që njerëzit vrapojnë të ngopin pasionet dhe dëshirat e tyre me atë që është e mirë apo e keqe dhe që ngrënien e kanë kthyer në qëllim të tyre kryesor, vetet tuaja janë të pastra dhe për ju janë zgjedhur gjërat e lejuara dhe veprat e mira.

Midis dy shprehjeve **“hani nga të lejuarat”** dhe **“bëni vepra të mira”** ka një lidhje të qartë. Cilësia e ushqimit ndikon në shpirtin e njeriut, në mendjen dhe sjelljen e tij. Transmetimet islame kanë përmendur se ngrënia e ushqimit të ndaluar (haram) e ndalon përgjigjen e lutjes.

Transmetohet nga i Dërguari më i nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se një burrë e ka pyetur për përgjigjen e lutjes së tij. Profeti i ka thënë: *“Pastro ushqimin që ha dhe mos fut në barkun tënd haramin (të ndaluarën)”*.⁴⁰

Thënia e të Madhërishmit: **“Unë e di mirë çfarë bëni ju!”** është në vetvete një provë e pavarur e domosdoshmërisë së bërjes së veprave të mira, sepse njeriu kur e di se All'llahu i kontrollon veprimet e tij, se Atij nuk i fshihet asgjë dhe se Ai do i kërkojë llogari me hollësi për to, s'ka dyshim se do ta përqendrojë vëmendjen tek kjo gjë, e cila e ndihmon në ndreqjen e veprimeve të veta. Përveç kësaj, kjo shprehje e ajetit ngjall tek njeriu ndjenjën e domosdoshmërisë së falënderimit të All'llahut për të lejuarat që i ka dhënë nga të mirat e Tij, duke ndikuar gjithashtu në veprimtarinë e tij.

⁴⁰ “Uesailu Shija”, vëllimi 4; Lutja, kapitulli 67, h. 4. Ne e kemi trajtuar shpjegimin e kësaj në ajetin 186 të sures “El Bekare”.

Me këtë, ajeti vërteton tre ndikime për punën e dobishme:

I pari: Ushqimi i lejuar, i cili siguron kthjelltësi dhe fortësi të zemrës.

I dyti: Falënderimi i All'llahut të Madhërishëm për të mirat që ka dhuruar me mëshirën e Tij.

I treti: Ndjenja e vigjilencës kundrejt mbikqyrjes së All'llahut të Madhëruar në të gjitha veprimet.

Fjala "*et tajib*" do të thotë çdo gjë e pastër dhe e dëlirë. Ajo është antonim i fjalës "*el khabiih*" i keq, i neveritshëm. Er Ragib El Isfahani në librin "*El Mufredat*" thotë se "*et tajib*" ka kuptimin e çdo gjëje që e gëzon njeriun nga ana shpirtërore, ndërsa nga ana ligjore, ai është gjë e lejuar dhe e pastërt.

Kur'ani i Lavdishëm i ka përmendur "*et tajibin*" dhe "*et tajibet*" në shumë burime:

"O të Dërguar! Hani nga të lejuarat."⁴¹ Pastaj problemi nuk kufizohet vetëm tek të Dërguarit, por:

"O besimtarë! Hani nga ushqimet e lejuara që jua kemi dhënë."⁴² Jo vetëm kaq, por ajo që të lidh me vendin e afërt me All'llahun është e lejuara nga veprat dhe fjalët.

"Tek Ai ngjiten fjalët e bukura, ndërsa veprën e mirë Ai e ngre vetë."⁴³

⁴¹ Surja "*El Mu'minûn*", ajeti 51.

⁴² Surja "*El Bekare*", ajeti 172.

⁴³ Surja "*Fâtir*", ajeti 10.

Një nga privilegjet e mëdha të njeriut mbi të gjitha krijesat ekzistuese është se All'llahu i Madhëruar i ka dhënë atij mjete jetese të lejuara: **“Në të vërtetë, Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit: ua kemi bërë të mundur që të udhëtojnë në tokë dhe në det, u kemi dhënë ushqime të mira e të lejuara dhe i kemi ngritur lart mbi shumë prej atyre që kemi krijuar.”**⁴⁴

Po ashtu në një transmetim të përmbledhur i ardhur nga Profeti më i nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që ia shton kuptimin kësaj të vërtete ku thotë: *“O njerëz! All'llahu është i mirë dhe nuk lejon asgjë përveç të mirës së lejuar”*.⁴⁵

Pastaj, ajeti i thërret të gjithë Profetët dhe pasuesit e tyre për të njësuar Zotin dhe për t'iu përmbajtur frikës ndaj Tij: **“Vërtet, kjo feja juaj është një fe e vetme”**. Kështu që kontradiktat ekzistuese midis jush si dhe midis Profetëve nuk janë absolutisht provë për shumëllojshmëri: **“Unë jam Zoti juaj, andaj frikësohuni prej Meje!”**.

Jemi para një thirrjeje të arsyeshme për unitetin e popullit dhe për t'i dhënë fund çdo gjëje që shkakton përçarje, që njerëzit të jetojnë si një komb i vetëm, ashtu siç është edhe All'llahu Zoti i tyre i vetëm.

Prandaj, njerëzit duhet të ndjekin Profetët (*Paqja qoftë mbi ta!*) nëse këta bëjnë thirrje për të ndjekur mësimet e njësuar me një bazë të vetme në çdo vend: “Njësimi i All'llahut dhe njohja e së vërtetës. Vëmendja dhe kujdesi për Ringjalljen, përsosja në jetë,

⁴⁴ Surja “El Isrâ”, ajeti 70.

⁴⁵ Tefsiri “Kurtubij”, vëllimi 7, f. 4519. Fundi i ajetit në studim.

përfitimi nga gjërat e lejuara, kryerja e punëve të dobishme, mbrojtja e së drejtës dhe e parimeve njerëzore”.

Disa komentues mendojnë se fjala *“ummetun”* këtu ka kuptimin e fesë dhe të besimit dhe jo të bashkësisë, por përemri shumë në fjalinë **“Unë jam Zoti juaj”** është argument se fjala *“ummetun”* ka kuptimin e tërë njerëzve.

Fjala *“ummetun”* ka ardhur në Kur'anin e Lavdishëm në më të shumtën e herëve, me kuptimin e bashkësisë. Ndërsa ardhja e saj me kuptimin e fesë si për shembull: **“Ne i kemi gjetur etërit tanë në këtë fe dhe po ndjekim gjurmët e tyre”** është e rrallë.⁴⁶

Ajo që tërheq vëmendjen është se këtë kuptim ka edhe ajeti 92 i sures *“El Enbijâ”* me një ndryshim të thjeshtë: **“Vërtet, kjo është feja juaj - besimi i vërtetë, e Unë jam Zoti juaj, ndaj më adhuron Mua!”**. Ndërkohë që ajetet e kaluara, që i paraprinë këtij ajeti, sqaruan jetën e shumë prej Profetëve. Fjala *“hadhihi”* këtu tregon për popujt e Profetëve të kaluar, që sipas mësimave të All'llahut përbënin një popull të vetëm, ku të gjithë u aktivizuan për realizimin e një qëllimi të vetëm.

Ajeti në vazhdim e paralajmëron njerëzimin për ndarjet dhe kontradiktat. Pasi në ajetin e kaluar iu bë thirrje atyre për t'iu përmbajtur unitetit, ky ajet thotë: **“Por ata (popuj ku u çuan të Dërguarit) u ndanë në grupe në çështje të fesë së tyre”,** gjë që të shkakton habi sepse **“Çdo grup ishte i kënaqur me atë që kishte.”**.

⁴⁶ Surja *“Ez Zuhruf”*, ajeti 23.

Fjala “ez zuburu” është shumësi i fjalës “zubretun”, sipas formës “lukmetun” dhe ka kuptimin e një tufe qimesh që kanë kafshët në zverk (kreshtë), të cilën bariu e mbledh për ta ndarë nga pjesa e mbetur e qimeve. Pastaj kjo fjalë u përdor si emërtim për çdo gjë që shkëputet nga origjina e tij. Kështu, ajeti thotë: **“Por ata (popuj ku u çuan të Dërguarit) u ndanë në grupe në çështje të fesë së tyre”** duke aluduar për ndarjen e kombit në grupe dhe shtresa të ndryshme.

Disa të tjerë supozojnë se fjala “ez zuburu” është shumës i fjalës “zebûrun”, që do të thotë “libër” dhe ka kuptimin që çdo grup prej tyre i përmbahej një libri të zbritur dhe mohonte librat e tjerë qiellorë. Ndonëse burimi i tyre është një, shprehja **“Çdo grup ishte i kënaqur me atë që kishte”** e mbështet shpjegimin e parë. Çdo parti fliste atë që i pëlqente dhe këmbëngulte në mendimin e vet.

Ajeti paraqet një të vërtetë psikologjike dhe shoqërore, dhe pikërisht atë që fanatizmi injorant i partive dhe i grupeve i pengon ata që të arrijnë tek e vërteta, sepse secili prej tyre mund të zgjedhë një rrugë të veçantë për vete duke u futur në një guackë të mbyllur që nuk lejon të futet një dritë e re në zemrën e saj dhe as një fllad moral në shpirtin e saj, për t’i zbuluar asaj një të vërtetë prej të vërtetave.

Kjo gjendje ka ardhur si pasojë e egoizmit të tepruar dhe të kokëfortësisë që përbëjnë armikun më të madh të së vërtetës dhe të unitetit të kombit. Të krenuarit me mënyrën e jetesës që bën çdo grup dhe përbuzja e mënyrave të tjera, e bën njeriun të mbyllë veshët përballë çdo zëri që vjen në kundërshtim me atë që ai beson e mendon, të mbulojë kokën me petkat e veta, apo të ikë me

vrap nga frika e daljes në dritë e së vërtetës, që është në kundërshtim me sa ishte mësuar. Kur'ani i Lavdishëm na kujton, gjithashtu, gjendjen e mosbesuesve idhujtarë në kohën e Nuhut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe me gojën e këtij Profeti të dërguar: **“Sa herë që i thirrja për t’i falur Ti, ata shtinin gishtërinjtë në vesh dhe mbuloheshin me petkat e tyre duke këmbëngulur me mendjemadhësi (në mosbesim).”**⁴⁷

Njeriu nuk mund ta shpëtojë veten dhe të arrijë tek e vërteta veçse duke i dhënë fund kësaj gjendjeje si dhe kokëfortësisë së tij.

Ajeti i fundit këtu thotë: **“prandaj, ti lëri ata në padijen e tyre deri në një kohë!”**. Me një fjalë, lëri në gjendjen e tyre derisa t’u vijë afati i tyre apo derisa t’u vijë ndëshkimi i All’llahut. Ata nuk kanë fat tjetër veç këtij, sepse këmbëngulën të mbeteshin në padijen e tyre dhe në labirinthet e saj.

Fjala *“hûinun”* mund të jetë treguese për kohën e vdekjes, ose për zbritjen e ndëshkimit ose i të dyjave së bashku.

Ndërsa fjala *“gamratun”*, sipas formës *“darbatun”*, në origjinë vjen nga fjala *“gamrun”*, që do të thotë prishje dhe shkatërrim i çdo gjëje. Pastaj fjala *“gamrun”* dhe *“gāmīrun”* u përdorën për emërtimin e ujit të vrullshëm, i cili merr me vete çdo gjë që i del përpara dhe vazhdon rrjedhën e vet. Më pas, kjo fjalë u përdor për injorancën dhe fatkeqësitë ku zhytet njeriu. Kurse ajeti i kaluar e ka përdorur në kuptimin e shkujdesjes, të humbjes, të injorancës dhe të largimit nga feja e Zotit.

⁴⁷ Surja “Nûh”, ajeti 7.

Ajetet 55 - 61

٥٥ ٥٦ ٥٧ ٥٨ ٥٩ ٦٠ ٦١
 ٥٥ ٥٦ ٥٧ ٥٨ ٥٩ ٦٠ ٦١
 ٥٥ ٥٦ ٥٧ ٥٨ ٥٩ ٦٠ ٦١
 ٥٥ ٥٦ ٥٧ ٥٨ ٥٩ ٦٠ ٦١
 ٥٥ ٥٦ ٥٧ ٥٨ ٥٩ ٦٠ ٦١
 ٥٥ ٥٦ ٥٧ ٥٨ ٥٩ ٦٠ ٦١
 ٥٥ ٥٦ ٥٧ ٥٨ ٥٩ ٦٠ ٦١

Komentimi

Të nxituarit në bërjen e veprave të mira

Ajetet e mëparshme paraqitën grupet kokëforta, të cilat i kaploi fanatizmi dhe egoizmi, që u kapën fort pas mendimeve të tyre humbëse dhe që u gëzuan me atë që kishin. Ndërsa ajetet që po studiojmë këtu, vënë në dukje disa përfytyrime egoiste, të tilla si: **“A mos mendojnë ata se Ne, duke u ardhur në ndihmë me pasuri dhe djem”** e se Ne **“po anojmë drejt tyre me të mira?!”**.

A mendojnë ata se paratë e tyre në sasi të madhe dhe numri i madh i fëmijëve që kanë, janë provë se janë në të vërtetën dhe se janë afër pozitës së tyre me All’llahun? **“Kurrësi, por ata nuk janë të vetëdijshëm (për këtë).”**. Pasuria e madhe e tyre dhe numri i shumtë i fëmijëve janë një lloj torture apo parathënie torture për ndëshkimin e All’llahut. Ata nuk e kuptojnë se mbulimi i tyre me të mira nga Zoti i tyre është bërë me qëllim që ata të ngatërrohen në ndëshkimin e All’llahut. Dhe ndëshkimi i tyre bëhet akoma më i dhimbshëm, sepse njeriu nëse i mbyllen dyert e të mirës që nuk e ka pasur dhe i vjen ndëshkimi, ky ndëshkim nuk do jetë i dhimbshëm në atë masë sa do të jetë për ata që jetojnë në mes të bollëkut dhe pastaj hidhen në korridoret e burgut dhe biruca të frikshme. Dhimbja e këtyre të fundit do jetë shumë e madhe.

Po ashtu, shtimi i të mirave ua shton atyre pakujdesinë dhe mendjemadhësinë, gjë që i ndalon të kthehen në rrugën e drejtë dhe të arsyeshme.

Pikërisht këtë vënë në dukje shumica e ajeteve të Kur'anit në kuadrin e tërheqjes dhe rendjes pas të mirave.⁴⁸

Fjala *"numid'du"* rrjedh nga fjala *"el imdād"*, që do të plotësim i një mangësie pa pengesë dhe çuarja e një gjëje deri në fundin e saj.

Pas mohimit të përfytyrimeve të atyre të shkujdesurve, këto ajete paraqesin gjendjen e besimtarëve dhe të atyre që nxitojnë për tek të mirat, duke nxjerrë në pah cilësitë e tyre kryesore. Ai thotë: **"Me të vërtetë, ata që dridhen nga frika e Zotit të tyre."** Fjala *"khashjetun"* nuk do të thotë frikë absolute, por ka kuptimin e një frike të shoqëruar me madhim dhe vlerësim.

Fjala *"el mushfik"* vjen nga fjala *"el ishfāk"* me origjinë nga fjala *"esh shefak"*, që është drita e përzier me errësirë. Fjala *"el mushfik"*, ka kuptimin e frikës së përzier me dashurinë dhe respektin.

Meqë frika është e lidhur me ndjenjat dhe shprehja e frikës ka anën e vet praktike, të dyja këto fjalë janë përmendur në ajet së bashku, për të sqaruar shkakun dhe pasojën. Ato do të thonë se frika e përzier me madhimin e All'llahut tashmë ka zënë vend në zemrat e tyre dhe shenjat e saj duken në veprimet dhe angazhimet e tyre në përputhje me udhëzimet dhe mësimet e All'llahut. Për këtë, frika ndikon në veprimtarinë e njeriut, duke e larguar nga

⁴⁸ Për të mësuar më shumë rreth problemit të rendjes pas të mirave, mund t'i referoheni shpjegimit të ajetit 182 të sures "El A'râf".

kryerja e mëkateve dhe duke e shtyrë drejt marrjes përsipër të përgjegjësive të veta.

Pastaj ajeti shton: ata **“që besojnë në shpalljen e Zotit të tyre”**.

Pas etapës së besimit në ajetet e All’llahut vjen etapa e pastrimit të tij nga çdo dyshim dhe bërje shok. Ajeti thotë: **“që nuk i shoqërojnë asgjë (në adhurim) Zotit të tyre”**.

Mohimi i politeizmit ka ardhur si pasojë e besimit në ajetet e All’llahut të Madhërishëm. Ai është shkaku i besimit. Domethënë, besim tek All’llahu do të thotë besim tek cilësitë e përhershme e të qëndrueshme të të Madhërishmit dhe mohim i politeizmit (i bërjes shok Zotit). Sidoqoftë, kjo shprehje përmban mohimin e të gjitha llojeve të politeizmit, qofshin ato të hapura apo të fshehta.

Pas kësaj vjen etapa e besimit tek Ringjallja dhe e kujdesit të veçantë që besimtarët e vërtetë i kushtojnë kësaj çështjeje, e cila i ndihmon ata në mënyrë praktike për të kontrolluar dhe sunduar mbi veprat dhe fjalët e tyre. Ajeti thekson: **“dhe që kur japin atë që japin, zemrat e tyre i kanë plot frikë ngaqë do të kthehen te Zoti i tyre.”**.

Ata nuk janë si një person dembel dhe i pavendosur, i cili punon sa më pak dhe pastaj mendon sikur është nga të afruarit me All’llahun, duke u kapluar nga habia dhe mendjemadhësia, aq sa i sheh të tjerët të vegjël dhe të ndyrë. Të tillë njerëz nuk mund të qetësohen dhe as të gëzohen me një punë më të madhe sado që ajo të jetë e pastër dhe e lartë por, ata kryejnë punë të dobishme që

janë të barabarta me adhurimin e njerëzve dhe të xhindeve. Megjithëkëtë thonë: *"O sa fitim i paktë në një rrugë kaq të largët!"*

Pas shpjegimit që ajetet e mëparshme u bëjnë këtyre katër cilësive, ajeti thotë: **"Ata nxitojnë të bëjnë vepra të mira dhe për këto punë janë të parët."** Lumturia e vërtetë nuk janë siç i përfytyrojnë të kamurit e shkujdesur dhe të kapërdisur me jetën e kësaj bote. Përkundrazi, lumturia vjen nga kryerja e veprave të dobishme në përpjekje për të fituar afrimin me All'llahun, ashtu siç bëjnë besimtarët e singertë, të cilët karakterizohen nga veçoritë e lartpërmendura të besimit dhe të moralit dhe që nxitojnë të bëjnë vepra të mira.

Ajetet e shkuara na vizatuan një pamje të qartë të cilësive të këtij shembulli që ndjekin besimtarët. Ato filluan me frikën e përzier me madhimin e All'llahut, që përbën shtytësin drejt besimit tek Ai dhe të mohimit të politeizmit (bërjes shok All'llahut) dhe përfundojnë me besimin tek ringjallja, që është gjyqi i drejtësisë hyjnore, që krijon ndjenjën e përgjegjësisë dhe e shtyn njeriun drejt çdo pune të mirë e të lejueshme. Ato veçuan katër veçori të besimtarëve që kanë të njëjtin rezultat.

Fjala *"jusariune"* do të thotë (*et tesabik*), *"garim"*. Kjo është një shprehje e bukur e cila përshkruan gjendjen e besimtarëve kur ata garojnë drejt një objektivi të madh dhe të lartë. Po ashtu, tregon konkurrencën e tyre të palodhur në kryerjen e veprave të dobishme.

Ajetet 62 – 67

“Por kur i dënuam pasanikët e tyre (në betejën e Bedrit), atëherë ata vajtonin.”

“(U thuhet): ‘Mos u lutni sot! Ju nuk do të keni ndihmë prej Nesh.’”

“Juve ju janë lexuar vargjet e Mia, por ju tërhiqeshit mbrapa,”

“me kryelartësi! Ju flisnit kotësira për të (Kur'anin), si dikush që rrëfen natën përralla.”

Komentimi

Zemrat në injorancë janë të humbura

Meqë veçoritë e besimtarëve janë shkaku i kryerjes së veprave të mira, siç u vu në dukje në ajetet e kaluara, këtu shtrohet pyetja: Përse këto cilësi dhe kryerja e këtyre veprave nuk i bëhen të mundura çdonjërit?

Ajeti i parë nga ajetet në studim përgjigjet për këtë duke thënë: **“Ne nuk ngarkojmë askënd përtej mundësive të tij.”** Me një fjalë, çdo njeri ngarkohet sipas mendjes dhe fuqisë së tij.

Ky është theksim se detyrat e ligjshme, me të cilat ngarkon sheriatu, janë në kufijtë e fuqisë së njeriut dhe se ato bien nëse kapërcehen këta kufij. Dijetarët e Parimeve të Fikhut (*Usulul Fikh*)

thonë se ky rregull sundon për të gjitha detyrimet ligjore dhe atyre që u paraprijnë detyrimeve të tilla.

Mund të lindë pyetja: Si mund t’u kërkohet llogari të gjithë njerëzve për të gjitha veprat e tyre, qofshin të vogla apo të mëdha?

Ajeti përgjigjet: **“...te Ne është Libri që flet të vërtetën dhe askujt nuk do t’i bëhet padrejtësi.”**. Ekziston Libri i veprave të njeriut, i ruajtur nga All’llahu i Madhëruar dhe i Plotëfuqishëm, që flet të vërtetën për të gjitha gabimet që kryen njeriu, i cili nuk mund t’i mohojë ato.⁴⁹

Ndoshta qëllimi i Librit që ndodhet tek All’llahu është “El Leuhul Mahfuudh” dhe shprehja “*ledejna*”, “*te Ne*”, e konfirmon këtë shpjegim.

Si përfundim, ajeti i lartpërmendur konfirmon ruajtjen e veprave të atyre që i kryejnë ato, të mira qofshin apo të këqija. Ato janë të regjistruara me hollësi e përpikmëri. Besimi në këtë të vërtetë i nxit të mirët dhe të dobishmit për të kryer vepra të mira dhe për t’u larguar nga veprat e këqija.

Shprehja “**që flet të vërtetën**”, me të cilën cilësohet fleta e veprave të njerëzve, i ngjan thënies: Filan letër ka shprehje të qartë, domethënë nuk ka nevojë për sqarime, sikur ajo të fliste vetvetiu. Ajo nxjerr në dritë të vërtetën.

⁴⁹ Ne e kemi trajtuar gjerësisht Librin e veprave të njeriut dhe të vërtetën e tij në shpjegimin e ajetit 13 të sures “El Isrâ” si dhe kur shpjeguam ajetin 49 të sures “El Kehf”.

Shprehja **“dhe askujt nuk do t’i bëhet padrejtësi”** vë në dukje se s’ka padrejtësi dhe as arbitraritet, s’ka as shkujdesje në Ditën e Llogaridhënies. Çdo gjë ndodhet në Regjistrin e njohur.

Meqë këto të vërteta ndikojnë në ndërgjegjen e njerëzve, ajeti pasues shton se ata mosbesues kokëfortë janë të zhytur në padije të vazhdueshme dhe në shkujdesje deri në atë shkallë saqë neglizhojnë edhe atë që i pret nga kërcënimi: **“Por zemrat e tyre (jobesimtarëve të Mekës) janë mospërfillëse ndaj këtij (Kur'anit).”**⁵⁰

Kjo zhytje në padije dhe injorancë nuk lejon njohjen e këtyre të vërtetave dhe i pengon të humburit që të vijnë në vete dhe tek All’llahu i Madhërishëm.

Ky ajet shton: **“Ata kanë punë të tjera më të këqija se këto e të cilat po vazhdojnë t’i bëjnë.”**. Komentuesit kanë sjellë shpjegime rreth thënies së All’llahut: **“Ata kanë punë të tjera më të këqija sesa këto.”**. Disa kanë thënë se ato kanë kuptimin e veprave të këqija që kryejnë njerëzit nga padija (për këtë fjala *“dhalike”* tregon për padijen dhe injorancën e tyre). Punët janë mëkatet që kryen njeriu pa dije dhe ndërgjegje. Të tjerë kanë thënë se ajo që nënkuptohet është se ata përveç mosbesimit të tyre, kanë kryer lloje të ndryshme veprash të këqija. Të tjerë kanë supozuar ndryshime të mëdha në programet e jobesimtarëve nga ato të besimtarëve.

Në fund të fundit, këto shpjegime nuk ndryshojnë midis tyre dhe ato mund të përmbliidhen. E rëndësishme është tërheqja e

⁵⁰ Fjala *“hadha”* (ky) mund të jetë tregues për Librin e Veprave në Ditën e Llogaridhënies ose për Kur'anin e Lavdishëm, ose për veprat e të devotshmëve, për të cilat kanë folur ajetet e mëparshme.

vëmendjes se burimi i veprimeve të këqija fshihet në zhytjen e zemrave në injorancë.

Por ata pasanikë mbeten në këtë shkujdesje për sa kohë vazhdojnë të jetojnë në bollëkun e tyre. Nëse do t'u vijë ndëshkimi, ata do klithnin si egërsira nga ashpërsia e ndëshkimit hyjnor, siç thotë ajeti: **“Por kur i dënuam pasanikët e tyre (në betejën e Bedrit), atëherë ata vajtonin.”**

U thuhej: **“Mos u lutni sot! Ju nuk do të keni ndihmë prej Nesh.”**

Por pse këtu përdoret vetëm fjala *“el mutrifin”* (pasanikët), ku dihet se mëkatarë nuk janë vetëm këta? Shkaku është ose tek të qenurit e tyre udhëheqës të të humburve, ose sepse ndëshkimi i tyre do të jetë shumë i madh, ose sepse ky ndëshkim mund të jetë i kësaj bote ose i Botës Tetër, ose i të dyjave së bashku. Ata i godet ndëshkimi në këtë botë ose në Tjetrën dhe kështu lartësohen klithmat e tyre në kërkim të ndihmës, por nuk do të ndihmohen.

Ajeti pasardhës zbulon shkakun e këtij fati të zi: **“Juve ju janë lexuar vargjet e Mia, por ju tërhiqeshit mbrapsht”** në vend të përfitimit prej tyre dhe të përqendrimit të vëmendjes tek realiteti.

Fjala *“tenkisinun”* vjen nga fjala *“en nukûs”* që do të thotë *“të ecësh mbrapsht”*.

Fjala *“e’akâb”* është shumësi i *“akabun”* dhe do të thotë *“thembër”*.

Kjo fjali është metonimi për një person që dëgjon fjalë të padëshiruara dhe për pasojë trembet deri në atë shkallë saqë ikën i trembur duke ecur me majat e thembrave.

Pastaj ai nuk kthehet mbrapsht thjesht duke dëgjuar shpalljet e All'Ilahut, por bëhet si ai që ajeti e përshkruan me fjalën "mendjemadh".⁵¹

Përveç asaj që u tha, "si dikush që rrëfen natën përralla", ata bisedonin gjatë netëve të tyre duke thënë kotësira për Profetin dhe Kur'anin.


Fjala "sāmiren" vjen nga fjala "semere", sipas formës "nasere", që ka kuptimin e të biseduarit natën. Disa kanë thënë se ajo do të thotë hije e hënës gjatë natës, ku përzihet e zeza me të bardhën. Meqë politeistët arabë mblidheshin rreth Qabes gjatë netëve me hënë dhe ku bisedat e tyre të kota përqendroheshin në më të shumtën rreth Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kjo fjalë është përmendur këtu për këtë qëllim. Fjala "samra'" përdoret për atë ngjyra e të cilit është një përzierje e të bardhës me diçka të zezë.

⁵¹ Ekzistojnë mendime të ndryshme midis komentuesve se për cilin është përdorur përemri "bihi". Disa mendojnë se ai përdoret në vend të Xhamisë së Shenjtë dhe shenjtërisë së Mekës, sepse shërbyesit e Qabes kapërdiseshin duke e konsideruar veten e tyre si të zotë të Xhamisë së Mekës. Por kjo mundësi është e dobët, sepse ajetet e kaluara nuk e kanë trajtuar Qabenë dhe Xhaminë e Shenjtë. Kështu, me sa duket, ky përemër është përdorur në vend të Kur'anit të Lavdishëm dhe Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Në këtë mënyrë, kuptimi i ajetit do të ishte: Ju u bëtë mendjemëdhenj ndaj Kur'anit dhe Profetit të Islamit. Ose ajeti tregon për ecjen e tyre mbrapsht, pavarësisht se nuk e kuptonin këtë, për shkak të mendjemadhësisë së tyre.

Ndërsa fjala *"tehxhurun"* vjen nga fjala *"hexhrun"* që në origjinë do të thotë *"largim"* dhe *"shkëputje"*. Këtu ka ardhur me kuptimin e përçartjes që vjen nga sëmundja, sepse fjalët e tyre në atë moment nuk janë të goditura dhe të ngjallin krupën. Po kështu, fjala *"el huxhru"*, sipas formës *"kufrun"*, do të thotë *"sharje"* dhe si pasojë edhe ajo të ndjell ndjenjën e largimit dhe të shkëputjes.

Fjala *"tehxhuruun"* në ajet ka ardhur me kuptimin e sharjes, duke thënë: idhujtarët arabë zhvillonin biseda natën deri në orët e vona duke folur përçart dhe duke sharë si të sëmurë.

Natyrisht ky model ishte ai i frikacakëve dhe i të dobtëve shpirtërisht, të cilët vrapojnë të përdorin errësirën e natës për të thurur sharje, duke humbur logjikën e shëndoshë, që do t'ua bënte të mundur të bisedonin si burrat në dritë të diellit. Ata zgjodhën errësirën e natës, larg shikimit të njerëzve, për të arritur tek qëllimet e tyre të mbrapshta. Kështu, ata vrapuan të përdorin sharjet dhe kotësitat me qëllim që të shprehnin urrejtjen e tyre injorante. Kur'ani i Lavdishëm u thotë atyre se shkak i dëshpërimit tuaj dhe i asaj që do të merrni nga ndëshkimi i dhembshëm i All'Ilahut është se ju u bëtë mendjemëdhenj ndaj pranimi të vërtetës dhe nuk u jeni nënshtruar me thjeshtësi shenjave dhe argumenteve të All'Ilahut. Po ashtu, bashkëpunimi juaj me Profetin nuk ka qenë në formë logjike dhe të drejtë. Nëse nuk do ishit refuzues dhe mendjemëdhenj ndaj të vërtetës dhe ndaj të Dërguarit, ju do të ishit të udhëzuar në rrugën e të vërtetës dhe të lumturisë.



“Vallë, a nuk kanë medituuar ata mbi Fjalën (Kur'anin) apo atyre u ka ardhur ajo që nuk u kishte ardhur të parëve të tyre?”

“Apo ata nuk e kanë njohur të Dërguarin e tyre, prandaj e mohojnë atë?”

“Apo thonë: ‘Ai është i çmendur?’ Jo, ai ua sjell të Vërtetën atyre, por shumica prej tyre e urrejnë të Vërtetën.”

“Sikur e Vërteta të ishte sipas dëshirave të tyre, atëherë do të shkatërroheshin qiejt dhe Toka dhe gjithçka që gjendet në to. Ne u kemi dërguar atyre Këshillën (Kur'anin), por ata shmangen nga ajo.”

“A po kërkon shpërblim prej tyre? Shpërblimi i Zotit tënd është më i mirë. Ai është më i miri i furnizuesve.”

“Ti i fton ata në rrugën e drejtë.”

“Por ata që nuk besojnë Jetën Tjetër, shmangen nga rruga e drejtë.”

Komentimi

Justifikimet e ndryshme të mohuesve

Ajetet e kaluara folën për kundërshtimin e jobesimtarëve dhe për mendjemadhësinë e tyre ndaj të Dërguarit më të madh (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ndërsa ajetet e tanishme trajtojnë përligjjen e tyre në këtë fushë dhe përgjigjen ndaj tyre. Këta shpjegojnë motivet e vërteta të kundërvënies së politeistëve ndaj Kur'anit dhe të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ato mund t'i përmbledhim në pesë etapa.

E para: **“Vallë, a nuk kanë medituuar ata mbi Fjalën (Kur'anin)?”**

Shkaku i parë i trishtimit të tyre ishte pamundësia për të menduar rreth përmbajtjes së thirrjes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Nëse do mendonin me kujdes, nuk do kishin ndonjë problem.

Në etapën e dytë, ajeti thotë: **“...apo atyre u ka ardhur ajo që nuk u kishte ardhur të parëve të tyre?”**. Ajeti, me mosmiratim, pyet: A ishte thirrja për njësim e ringjallje, udhëheqje për vepra të dobishme vetëm për ta dhe jo për të parët e tyre, që të protestonin se ajo ishte sajese (bidat) duke thënë: “All'llahu, përderisa është i

butë dhe i dashur me robtë e Tij, përse nuk ua dërgoi atë të parëve të tyre?”

Por kjo u takon atyre ta thonë, sepse Islami nga ana parimore ka përmbajtjen e të gjitha kumteve (mesazheve) që kanë sjellë Profetët (*Paqja qoftë mbi ta!*). Prandaj ky justifikim është i palogjikshëm dhe i pakuptimtë.

Në etapën e tretë, ajeti thotë: **“Apo ata nuk e kanë njohur të Dërguarin e tyre, prandaj e mohojnë atë?”**.

Pra, nëse kjo thirrje do vinte nga një person i panjohur dhe i dyshimtë, ka mundësi që ata t’i quanin fjalët e tij të vërteta, porse ky person është i dyshimtë dhe i panjohur për ne dhe mund të mashtrohem prej fjalëve të tij. Mirëpo, ata e njohin shumë mirë të kaluarën tënde. Ata të quanin ty Muhammedi *Besink*. E pranojnë arsyen tënde, dijen tënde dhe besnikërinë tënde. I njohin shumë mirë prindërit e tu, fisin tënd, prandaj ata nuk kanë asnjë argument që mos të të njohin.

Në etapën e katërt, ajeti thotë: **“Apo thonë: ‘Ai është i çmendur?’”**- domethënë i luajtur mendsh. E thënë shkurt, pasi e pranojnë se ti nuk je i panjohur për ta, ata vënë në dyshim shëndetin tënd mendor dhe të fusin tek të marrët, sepse ajo për të cilën ti bën thirrje, nuk përputhet me mentalitetin e tyre. Pikërisht për këtë, ata e përdorin këtë si provë për çmendurinë tënde.

Në hedhjen poshtë të këtyre akuzave, Kur'ani i Lavdishëm thotë: **“Jo, ai ua sjell të Vërtetën atyre”** dhe fjalët e tij janë dëshmi e kësaj të Vërtete, duke shtuar: **“por shumica prej tyre e urrejnë të Vërtetën.”**.

Po. Fjalët e të Dërguarit janë të arsyeshme dhe të urta, por ata i mohonin ato për shkak se nuk përputheshin me pasionet dhe preferencat e tyre shpirtërore. Kështu, ata i ngjitën atij akuzën e çmendurisë, ndërkohë që s'është e domosdoshme që e Vërteta të jetë në harmoni me dëshirat e njerëzve: **“Sikur e Vërteta të ishte sipas dëshirave të tyre, atëherë do të shkatërroheshin qiejt dhe Toka dhe gjithçka që gjendet në to.”**.

Sepse nuk ka ndonjë masë që mund të përcaktojë dëshirat e njerëzve; përveç kësaj, në më të shumtën, ato anojnë nga e keqja dhe degjenerimi. Nëse ligjet e ekzistencës do të ndiqnin ato, atëherë anarshia do përfshinte gjithësinë dhe bota do të degjeneronte.

Si konfirmim për këtë, ajeti thotë: **“Ne u kemi dërguar atyre Këshillën (Kur'anin), por ata shmangen prej tij.”**⁵² Me një fjalë, Ne u dhamë atyre Kur'anin, që është baza e kujtesës dhe e drejtimit nga All'llahu dhe shkak për lartësimin dhe nderin e tyre, por ata e kundërshtuan këtë fener ndriçues, i cili u ndriçon atyre rrugën e lumturisë dhe të nderit.

⁵² Shprehja “*dhikrihim*” këtu ka kuptimin e Këshillës apo të Kur'anit – (shënim i përkthyesit) mund të shpjegohet me kuptimin “kujtesë e tyre” dhe “ngulitje”. Por mund të shpjegohet edhe me kuptimin e nderit dhe të pozitës së tyre në shoqërinë njerëzore.

2. Fjala “*el kharaxh*” dhe “*el kharāxh*” vijnë nga fjala “*el khurūxh*” dhe do të thotë gjësend i nxjerrë nga paratë apo të ardhurat nga toka bujqësore. Por këtu, fjala “*el kharaxh*” ka kuptim më të gjerë sesa “*el kharaaxh*”. Siç thotë Ragib El Isfahani në “El Mufredat”: “*el kharaxh*” është më i rëndësishëm sesa “*el kharaaxh*” dhe e ka vënë “*el kharaxh-in*” të lidhur me të ardhurat. All'llahu i Madhëruar thotë: **“A po kërkon shpërblim prej tyre?”** Dhe fjala “*el kharaxh*” përdoret në më të shumtën për taksën e tokës apo pagesën e saj.

Në etapën e pestë, ajeti thotë: “A është preteksti i ikjes së tyre nga e Vërteta, se ti u kërkon pagesë për thirrjen tënde? **“A po kërkon shpërblim prej tyre? Shpërblimi i Zotit tënd është më i mirë. Ai është më i miri i furnizuesve.”**⁵³

Nëse një udhëheqës fetar kërkon shpërblim nga njerëzit kundrejt predikimit dhe thirrjes për të Vërtetën, ai do t’u jepte atyre që justifikohen motivin për kundërvënien dhe kundërshtimin e tij. Ata i kundërvihen atij nën pretekstin se nuk kanë mundësi monetare dhe e akuzojnë se atë për të cilën i thirrte njerëzit e bënte veçse për përfitime personale.

Në shtesë të kësaj, njerëzit nuk posedojnë asnjë gjë të cilën mund t’ia dhurojnë All’lilahu. A nuk është All’lilahu i Madhëruar dhe i Lartësuar Furnizuesi i robëve të Vet me mjetet e jetesës? Kur’ani Fisnik, duke bërë sqarimet e këtyre pesë etapave, provon se ata idhujtarë budallenj nuk i nënshtrohen të Vërtetës dhe se pretekstet e tyre në mohimin e të vërtetës ishin pretekste të dobëta.

Pastaj vjen ajeti tjetër me një konkluzion të përgjithshëm për gjithçka kaloi: **“Ti i fton ata në rrugën e drejtë...”**. Rruga e drejtë i ka provat e qarta dhe drejtësia e saj është e njohur. Rruga e drejtë është rruga më e shkurtër midis dy pikave. Ajo është vetëm një, ndërsa rrugët e tërthorta dhe me zigzage, majtas e djathtas, nuk mbarojnë kurrë.

Ajeti tjetër paraqet rezultatin natyror të kësaj çështjeje, duke thënë: **“...por ata që nuk besojnë Jetën Tjetër shmangen nga rruga e drejtë.”**.

Fjala “*nakib*” vjen nga “*en nekb*” dhe “*en nukûb*” dhe do të thotë “*shmangie nga rruga*”. Shprehja “*nekebet ed dun’ja*” qëndron përballë “*ikbal ed dun’ja*” dhe do të thotë largim prej botës dhe kundërshtim i saj prej robit.

Është e qartë se këtu me “*rrugë*” kihet parasysh ajo që thotë ajeti i kaluar. Është e pranuar se ai që shmanget prej saj, në Botën Tjetër e ka vendin në zjarr, një fat shumë i keq, sepse robi në Botën e Përtejme pendohet për veprat e kësaj bote.

Mosbesimi i robit për Botën Tjetër është i lidhur me shmangien e tij nga rruga e së Vërtetës që vjen nga mungesa e ndjenjës së përgjegjësisë. Tregohet se Aliu, prijësi i besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “*All’llahu na ka treguar dyert, rrugën dhe udhët si dhe drejtimin prej nga mund të shkosh tek Ai. Kush shmanget nga mbretërimi ynë, apo preferon të tjerë në vendin tonë, ai është i shmangur nga rruga*”.⁵⁴

Hulumtime

1- Ndjekja e së Vërtetës apo e dëshirave personale?

Ajeti i kaluar vinte në dukje në mënyrë kalimtare kontradiktën midis përmbajtjes ndaj së Vërtetës dhe dëshirave personale, që përbën një theksim me kuptim të madh. Në ajet thuhet: “**Sikur e Vërteta të ishte sipas dëshirave të tyre, atëherë**

⁵⁴ “*Usûlul Kafij*”, siç e ka transmetuar shpjeguesi “*Nûruth Thekalejn*”, vëllimi 3, f. 549.

do të shkatërroheshin qiejt dhe Toka dhe gjithçka që gjendet në to.”. Shpjegimi i kësaj çështjeje nuk është i vështirë për shkaqet që vijojnë:

a) S’ka dyshim se dëshirat e njerëzve janë të ndryshme dhe shumë herë të atilla që kundërshtojnë njëra-tjetrën. Edhe tek një njeri i vetëm, dëshirat e tij mund të jenë kontradiktore.

Nëse e Vërteta do t’u nënshtrohej dëshirave, atëherë rezultati do të ishte përhapja e anarshisë. Përse?

Sepse çdo individ ka idhullin dhe objektin e vet të adhurimit. Nëse gjithë këta zota të shumtë dhe kontradiktorë do të drejtonin botën e pafundme, atëherë do të shfaqej degjenerimi dhe do të sundonte anarshia. Dhe kjo gjë nuk është sekret për askënd.

b) Dëshirat e njerëzve, edhe nëse i mbyllim sytë para kundërshtive të tyre, priren nga degjenerimi dhe e keqja. Nëse ekzistencën dhe shoqërinë njerëzore e mbisundojnë ato, atëherë rezultati nuk do të jetë tjetër veçse degjenerim, urrejtje dhe ngatërresa.

c) Priret dhe dëshirat kanë një përmasë të njëjtë dhe nuk i shohin gjërat veçse nga një kënd i vetëm, duke injoruar përmasat e tjera. Dihet se një ndër faktorët e rëndësishëm të degjenerimit dhe të shkatërrimit është ndjekja e një përmase të vetme dhe neglizhimi i përmasave të tjera.

Përmasat e dimensioneve të ajetit që po studiojmë ngjajnë me atë që ka ardhur në ajetin 22 të sures “El Enbijâ’”: **“Sikur në**

qiej dhe në tokë të kishte zota të tjerë përveç All'llahut, si qiejt ashtu dhe Toka do të shkatërroheshin."

Është e ditur se e Vërteta është si rruga e vetme e drejtë, e pashoqe, ndërsa dëshirat personale janë të shumta, njëlloj si idhujt e idhujtarëve. Cilin prej tyre të ndjekim: të Vërtetën apo dëshirat? A të ndjekim dëshirat që përbëjnë burimin e degjenerimit në qiell dhe në tokë dhe në gjithçka që ekziston, apo të Vërtetën, që është simbol i bashkimit dhe i njësimi, i rregullit dhe i harmonisë?

Përgjigja është shumë e qartë.

2- Cilësitë e udhëheqësit

Ajetet e kaluara bënë të qartë një numër cilësish që duhet të kenë udhëheqësit në rrugën e së Vërtetës. Ata duhet të jenë të njohur për mirësi dhe drejtësi dhe idhujtarëve nuk u ka mbetur asnjë justifikim për këtë. I Madhërishtmi thotë: **"Apo ata nuk e kanë njohur të Dërguarin e tyre, prandaj e mohojnë atë?"**.

Nëse të Dërguarit do të ishin të panjohur, atëherë dyfytirëshit do të justifikoheshin me këtë dhe do të mohonin mesazhet qiellore.

Një çështje tjetër është se të Dërguarit nuk u dorëzohen kurrë dëshirave të njerëzve dhe nuk pranojnë që njerëzit të kënaqen me devijimin që iu është bërë zakon, siç ndodh aktualisht, ku shohim rëndom mbështetjen absolute për të gjitha dëshirat e njerëzve (pavarësisht degjenerimit të madh që sjellin). Për këtë, të Dërguarit vazhdonin punën e tyre me këmbëngulje të

vazhdueshme për përhapjen e doktrinės së të Drejtës, pavarësisht kundërshtimit të madh dhe urrejtjes së njerëzve ndaj tyre.

3- Pse shumica e njerëzve nuk priren nga e Vërteta?

Ajetet e Kur'anit Fisnik e qortojnë "shumicën" e njerëzve, ndërkohë që shohim se "shumica" e miraton ose e mohon rregullimin e një diçkaje. Ata janë kriteri i të mirës dhe i të shëmtuarës në shoqëri, gjë që ngre një pikëpyetje të madhe. Këtu nuk është fjala për ajetet që flasin për shumicën, - duke shtuar përemrin "*hum*" (ata), me të cilin kihet parasysh shumica e jobesimtarëve dhe politeistëve si dhe të tjerët si ata, - por fjala është për ajetet që përmendin thënien "shumica e njerëzve". Si përshembull: **"Por shumica e tyre (njerëzve) nuk e falënderojnë."**⁵⁵

"Ndërsa shumica e njerëzve nuk e dinë."⁵⁶

"Ndonëse shumica e njerëzve nuk e besojnë."⁵⁷

"Shumica e njerëzve, sado të dëshirosh ti, nuk janë besimtarë."⁵⁸

"Por shumica e njerëzve kurrsesi nuk duan të besojnë."⁵⁹

⁵⁵ Surja "El Bekare", ajeti 243.

⁵⁶ Surja "El A'rāf", ajeti 187.

⁵⁷ Surja "Hûd", ajeti 17.

⁵⁸ Surja "Jûsuf", ajeti 103.

⁵⁹ Surja "El Isrâ", ajeti 89.

“Nëse i bindesh shumicës së njerëzve që gjenden në tokë, ata do të të shmangin nga rruga e All’liahut.”⁶⁰

Nga ana tjetër, disa ajete kur'anore i kanë kushtuar rëndësi vijës së shumicës së besimtarëve duke e konsideruar si kriter të vërtetë e të rregullt për të tjerët. Në ajetin 115 të sures “En Nisā’” thuhet: **“Këdo që e kundërshton të Dërguarin pasi i është dhënë udhëzimi dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne e lëmë të ecë andej nga është nisur dhe do ta përcëllojmë në zjarrin e Xhehennemit. Eh, sa vendbanim i keq që është ai!”**.

Mund të mendohet se Islami është kundër demokracisë, e cila mbështetet në opinionin e shumicës së njerëzve, por këtë e ka hedhur poshtë me forcë Kur'ani. Duke u thelluar në ajetet dhe transmetimet islame dhe duke i krahasuar me njëri-tjetrin sqarohet kuptimi i vërtetë se shumica, po të ishin besimtarë të vetëdijshëm që ndjekin të vërtetën dhe refuzojnë gënjeshtren, do ta meritonin respektin dhe opinionin e tyre do të kishte vlerësim e do të pranohej.

Por nëse shumica do ishte një grup i paditur e i ndërgjegjshëm, por që u dorëzohen dëshirave dhe epsheve të tyre me vetëdije, atëherë nuk lejohet bindja ndaj tyre e as nuk merret për bazë opinionin e tyre, sepse ndjekja e tyre të çon në humbje dhe errësirë, siç thotë Kur'ani i Lavdishëm.

Mbi këtë bazë, nëse do të donim realizimin e “demokracisë së shëndoshë” duhet të synonim së pari të ndërgjegjësonim njerëzit dhe të formonim një shoqëri besimtare dhe të ndërgjegjshme. Pastaj duhet të mbështeteshim mbi pikëpamjen e

⁶⁰ Surja “El En’ām”, ajeti 116.

shumicës si kriter i drejtësisë së qëllimeve shoqërore. Përndryshe, demokracia e shumicës është e humbur dhe nuk prodhon asgjë, përveç humbjes së shoqërisë dhe tërheqjes së saj drejt Xhehennemit.

Është e domosdoshme të përmendet se ne besojmë që mendimi i shumicës së ndërgjegjëshme dhe besimtare do jetë i respektuar dhe i pranuar nëse nuk është në kundërshtim me Librin, Synetin dhe dispozitat e All'Ilahut.

Strehimi i kombeve dhe i popujve në kohën tonë tek opinionimi i shumicës, vjen për shkak të mungesës së një kriteri të besueshëm që u shërben interesave të përgjithshme, të dobishme apo dëmtuese. Këto shoqëri nuk kërkojnë të ndriçohen me Librin e All'Ilahut, as nuk i përmbahen mesazhit të Profeti fisnik dhe as asgjë nuk kanë, përveçse të kthehen tek opinionimi i përgjithshëm. Sunduesit nuk përpiqen për ndërgjegjësimin e njerëzve që udhëheqin e sundojnë, përkundrazi përpiqen që shkujdesja e njerëzve të vazhdojë sa më shumë, në mënyrë që njohjet e tyre të jenë sa më të pakta në lidhje me përparimin dhe lulëzimin e jetës së tyre, me qëllim që të kenë mundësi të vazhdojnë sundimin mbi njerëzit dhe të luajnë me fatin e tyre. Prandaj, ata e kanë kthyer shumicën numerike në kriter për t'u mbyllur gojën zërave kundërshtues.

Nëse thellohem në problemin e shoqërive bashkëkohëse, ligjeve dhe regjimeve në fuqi, do të shohim se fatkeqësitë më të mëdha atyre u vijnë për shkak të përqafimit të të ashtuquajturit opinion i shumicës.

Sa ligje të këqija dhe sa vendime të shëmtuara ka marrë “ shumica ”! Sa shumë grindje dhe luftra kanë shpërthyer për shkak të opinionit të shumicës injorante! Nuk ka padrejtësi dhe agresione më të mëdha sesa ato që shumica i ka konsideruar si të drejta dhe të ligjshme!!

Ajetet 75 – 80

“Ne i dënuam ata njëherë, por ata nuk iu përulën Zotit të tyre e as nuk i drejtuan lutje.”

“Dhe, kur u hapim atyre derën e një dënimi të madh, atëherë zhyten në dëshpërim.”

“Është Ai që jua ka krijuar dëgjimin, shikimin dhe zemrën. Eh, sa pak që e falënderoni ju!”

“Është Ai që ju ka sjellë në Tokë dhe para Tij do të mbliidheni të gjithë.”

“Është Ai që jep jetë dhe vdekje dhe Atij i përket ndërrimi i ditës dhe i natës. Vallë, a nuk kuptoni?”

Komentimi

Rrugët e ndryshme të ndërgjegjësimit hyjnor

Ajetet e kaluara paraqitën pretekstet me të cilat justifikoheshin mohuesit e së vërtetës për të refuzuar mesazhet dhe për të lënduar Profetët. Ndërsa këto ajete trajtojnë mbarimin e preteksteve dhe të ndërgjegjësimit të tyre nga All'llahu i Madhërishëm.

Ajeti i parë thotë se *“Ne nganjëherë i mbulojmë ata me kujdesin tonë dhe i furnizojmë me mjete jetese nga bollëku i të mirave, me qëllim që të zgjohen”,* por: **“Sikur Ne t’i mëshironim ata dhe t’ua**

largonim fatkeqësinë, sërish ata do të endeshin të hutuar në humbjen dhe mosbesimin e tyre.”.

All’llahu i Lartësuar i vë në provë ata se ndoshta vetëdijësohen, atëherë kur nuk do t’i ndihmojë dot mëshira e të Madhërishmit. Por një kategori e madhe prej tyre nuk u zgjuan as edhe atëherë kur u ra fatkeqësia turpëruese: **“Ne i dënuam ata, por ata nuk iu përulën Zotit të tyre e as nuk i drejtuan lutje.”.**⁶¹

Fjala *“et tedarru’u”* siç e kemi thënë, vjen nga fjala *“eder’uu”* që do të thotë *“gji”*. Kështu fjala *“et tederru’u”* do të thotë *“mjelje”*. Pastaj, kjo fjalë është përdorur me kuptimin e dorëzimit të përzier me thjeshtësinë dhe nënshtrimin.

Ky ajet tregon se idhujtarët nuk u pastruan nga këmbëngulja dhe mendjemadhësia e tyre dhe as u dorëzuan ndaj të vërtetës edhe kur u ballafaquan me fatkeqësitë që ranë mbi ta.

Fjala *“et tedarru’u”* në transmetime shpjegohet si ngritje e dy duarve lart për lutje dhe përbën një prej të vërtetave të këtij kuptimi të gjerë.

All’llahu i Madhëruar e vazhdon këtë mëshirë, këto të mira si dhe ndëshkimet, ndërsa idhujtarët vazhdojnë padrejtësitë dhe

⁶¹ Fjala *“istekānū”* vjen nga fjala *“es sukūunu”*, që do të thotë *“heshtje kur je në gjendjen e nënshtrimit dhe të përuljes”*. Disa kanë thënë se ajo vjen nga fjala *“keunun”*, që do të thotë *“të qëndruarit në një vend me nënshtrim dhe përulje”*. Sido që të jetë, kjo fjalë sqaron gjendjen e robit të nënshtruar ndaj Zotit të tij. Disa e kanë shpjeguar këtë fjalë me kuptimin e lutjes (dua’së), sepse përbën një nga kriteret e nënshtrimit dhe të thjeshtësisë. Ndërsa mundësia e tretë është se ajo vjen nga fjala *“el kejn”*, sipas formës *“ajnun”*, sepse ajo, gjithashtu, do të thotë *“nënshtrim”*. Në fakt, të gjitha këto kuptime janë të afërta.

kokëfortësinë e tyre: **“Dhe kur u hapim atyre derën e një dënimi të madh, atëherë zhyten në dëshpërim.”**.⁶²

Në fakt, ekzistojnë dy lloje ndëshkimi hyjnor: ndëshkimi me vuajtje dhe sëmundje dhe ndëshkimi i shkëlqes nga rrënjët. Qëllimi i ndëshkimit të parë është të vihen njerëzit në gjendje të vështirë dhe në vuajtje për të kuptuar se sa të dobët janë e për ta braktisur anijen e mendjemadhësisë.

Ndërsa qëllimi i ndëshkimit të dytë, i cili u bie këmbëngulësve në mendjemadhësi, është zhdukja e tyre nga jeta dhe pastrimi i saj nga pengesat e tyre, sepse atyre nuk u ka mbetur e drejta për të jetuar nën regjimin e të Vërtetës dhe drejtësisë. Prandaj, këto gjemba duhet të shkulet nga rruga e përsosjes së njerëzimit.

Midis komentuesve ekzistojnë mendime të ndryshme në lidhje me qëllimin e ajetit: **“derën e një dënimi të madh”**.

Shumë mendojnë se fjala është për vdekjen, pastaj dënimin dhe ndëshkimin në Ditën e Kiametit.

Të tjerë mendojnë se ajo nënkupton një thatësi të madhe, që kaluan idhujtarët për vite të tëra si pasojë e lutjes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sa që nuk gjenin gjë për të ngrënë dhe u detyruan të hanë gjëra të neveritshme.

⁶² Fjala “*el mublis*” vjen nga fjala “*el iblas*”, me kuptimin e dhimbjes së madhe që vjen si rezultat i ndikimit të madh të ngjarjes që e shtyn njeriun në heshtje, në zhgënjim dhe në humbje shprese.

Disa të tjerë mendojnë se është dënimi i dhimbshëm që u ra idhujtarëve nga goditja e shpatave të ushtrisë islame në betejën e Bedrit.

Ekziston mundësia që ajeti mund të mos ketë parasysh vetëm një grup të caktuar, por është paraqitje e ligjit të përgjithshëm dhe gjithëpërfshirës të ndëshkimeve të All'llahut, që fillon me mëshirën, paralajmërimin dhe ndëshkimin edukativ, dhe përfundon me dënimin kapital, me shkuljen nga rrënjët dhe shkatërrimin.⁶³

Pastaj, Kur'ani i Lavdishëm trajton problemin nga një kënd tjetër vështirimi: numërimin e të mirave hyjnore për t'i shtyrë njerëzit drejt falënderimit: **"Është Ai që jua ka krijuar dëgjimin, shikimin dhe zemrën. Eh, sa pak që e falënderoni ju!"**. Theksi vihet tek dëgjimi, shikimi dhe mendja, sepse ato janë organet me të cilat njeriu njeh çështjet dhe problemet e ndjeshme. Problemet që lidhen me shqisat kapen me dëgjim dhe shikim. Ndërsa problemet joshqisore kapen nga mendja.

Mjafton të dihet rëndësia e dy shqisave: e dëgjimit dhe e shikimit, për të përfytyruar gjendjen e njeriut që i humbet ato, të cilit i errësohet bota para syve. Nëse këto dy shqisa humbasin qysh në lindje, atëherë bashkë me to humbasin edhe shqisa të tjera. Kështu shurdhi i lindur, natyrisht që është edhe memec. Përdorimi e gjuhës lidhet me dëgjimin e njeriut. Me humbjen e këtyre të dyjave, njeriu humbet mjetin e lidhjes së tij me të tjerët.

⁶³ Ajeti që thotë: **"ata që nuk besojnë tek Bota Tjetër"**, që e përmendëm para këtyre ajeteve, e mbështet këtë shpjegim.

Pas këtyre dy shqisave, që përbëjnë çelësin e kuptimit të botës materiale, vjen mendja që nxjerr mendime nga furnizimi që i bëjnë shqisat. Mendja e kalon materialen duke arritur deri te metafizika. Detyra e mendjes është të kritikojë, të nxjerrë përfundime, të rregullojë, të përgjithësojë dhe të analizojë informacionet e ardhura nga shqisa e të parit dhe e të dëgjuarit si dhe nga shqisat e tjera. A nuk e meritojnë qortimin ata që nuk e falënderojnë Atë për këto tre mjete të njohjes? A nuk mjafton thellimi në hollësitë e këtyre mjeteve si provë për të njohur Krijuesin dhe mirësinë e Tij të madhe ndaj robëve?

Përmendja e dëgjimit dhe e shikimit para mendjes në ajetin në fjalë, është e lehtë të kuptohet. Por pse është vendosur dëgjimi para shikimit? Ka mundësi, siç thonë dijetarët, që së pari funksionon dëgjimi i të porsalindurit, pastaj shikimi. Dy sytë janë të mbyllur gjatë jetës në mitër dhe ato nuk kanë asnjë gatishmëri dhe aftësi për të parë valët e dritës, prandaj mbeten të tillë (mbyllur) edhe pas lindjes për njëfarë kohe. Pastaj gradualisht fillojnë dhe mësohen me dritën.

Ndërsa dy veshët nuk janë kështu. Disa mendojnë se ata janë të aftë të dëgjojnë edhe në mitër.⁶⁴ Ata dëgjojnë rrahjen e zemrës së nënës.

Sqarimi i tri dhuntive të mësipërme përbën një shtysë për të njohur dhuruesin e këtyre të mirave, që është Dhuruesi dhe Bamirësi i vetëm i të mirave. (Dijetarët e besimit e shohin falënderimin e Bamirësit si bazë të domosdoshmërisë së njohjes së Zotit me mendje).

⁶⁴ Ne kemi folur rreth tre organeve të shqisave në shpjegimin e ajetit 78 të sures "En Nahl".

Ajeti tjetër trajton krijimin e njeriut prej dheut nga All'llahu i Madhërishëm. Ai thotë: **“Është Ai që ju ka sjellë në Tokë dhe para Tij do të mblidheni të gjithë.”**⁶⁵

Meqë Ai ju ka krijuar prej toke, ju do të ktheheni tek ajo përsëri dhe pastaj Ai ju Ringjall: **“Para Tij do të mblidheni të gjithë.”**

Nëse do mendoni në krijimin tuaj nga dheu, që nuk ka ndonjë vlerë, do të orientoheshit nga Krijuesi i ekzistencës, do mësonit bujarinë, butësinë dhe bamirësinë e Tij ndaj jush dhe do t’ju udhëhiqte drejt besimit ndaj Tij dhe Ringjalljes.

Pasi përmend krijimin e njeriut, ajeti i lartpërmendur trajton prova të tjera për mrekullinë e asaj që ka krijuar All'llahu i Lartësuar: **“Është ai që jep jetë dhe vdekje dhe Atij i përket ndërrimi i ditës dhe i natës. Vallë, a nuk e kuptoni?”**.

Me këtë renditje, retorika kur'anore fillon me motivin e zgjimit të zemrës dhe të nxitjes së saj në njohjen e Zotit të vet të Lartësuar dhe përfundon me përmendjen e disa prej shenjave në veta e në horizonte. Thënia e bekuar paraqet rrugëtimin e njeriut që nga lindja e deri në vdekje si dhe kthimin e tij tek All'llahu i Madhërishëm. Të gjitha etapat plotësohen me vullnetin e All'llahut të Plotfuqishëm e të Urtë.

Ajo që tërheq vëmendjen është se All'llahu e ka përmendur lindjen dhe vdekjen përkrah ndryshimit midis natës dhe ditës. Kjo sepse drita dhe errësira në botën e ekzistencës janë si vdekja dhe


⁶⁵ “Fjala “dhere’e” vjen nga fjala “edh dher’u” sipas formës “zerun” që në origjinë do të thotë “krijim”, “ekzistencë” dhe “paraqitje”. Por fjala “dheruun” do të thotë “përhapje” apo “shpërndarje”.

jeta e krijesave. Ashtu si krijesat lëvizin dhe aktivizohen nën valët e dritës dhe fshihen nën perden e errësirës, po kështu edhe gjallesat fillojnë lëvizjen dhe veprimtarinë e vet në dritën e jetës dhe fshihen në errësirën e vdekjes, ku të dyja kanë vetinë e lëvizjes graduale.

Kemi thënë më parë se “ndryshimi” i natës nga dita mund të ketë kuptimin e ardhjes së tyre njëra pas tjetrës, ku nata pason ditën dhe po kështu dita pason natën. Ndryshimi gradual dhe dallimi midis tyre sjell katër stinët dhe drejton ciklin e jetës në botën e bimëve në kuadrin e një regjimi preciz.

Të gjitha këto çështje mund të jenë rruga drejt njohjes së All'llahut, natyrisht nëse njeriu i kupton dhe u kushton vëmendje dhe nëse thellohet në to me zgjuarsia.

Prandaj, ajeti në fund thotë: **“Vallë, a nuk kuptoni?”**.



“Por ata thonë, ashtu siç kanë thënë të mëparshmit.”

“Ata pyesin: ‘Vallë, pasi të vdesim e të bëhemi eshtra e dhé, vërtet do të ringjallemi?!’”

“Kjo na është premtuar neve dhe të parëve tanë, por këto janë vetëm përralla të popujve të lashtë.”

“Thuaj: ‘E kujt është Toka dhe gjithçka që gjendet në të, nëse e dini?’”

“Ata do të thonë: ‘Të All’liahut!’ E ti thuaju: ‘Vallë, a nuk po ia vini veshin?’”

“Thuaj: ‘Kush është Zoti i shtatë qiejve dhe Zoti i Fronit Madhështor?’”

“Ata do të thonë: ‘All’lahu!’ E ti thuaju: ‘Vallë, a nuk keni frikë ju?’”

“Thuaj: ‘Kush është Ai që ka në dorë pushtetin mbi çdo gjë, i Cili mbron, por prej Tij nuk mund të mbrohet askush, nëse e dini?’”

“Ata thonë: ‘All’l-lahu.’ E ti thua ju: ‘Atëherë, përse magjepseni’?!“

“Ja! Ne ua kemi zbuluar atyre të Vërtetën, por ata janë gënjeshtarë.”

Komentimi

Kur'ani u bën thirrje ndërgjegjeve për gjykim

Ajetet e kaluara u bënë thirrje mohuesve të All’l-lahut dhe të ringjalljes që të mendoheshin rreth krijimit të botës së ekzistencës dhe shenjave të horizonteve dhe të shpirtit. Kurse ajetet këtu shtojnë se ata (mohuesit) i braktisën mendjet dhe ndoqën paraardhësit e tyre, duke i imituar ata në mënyrë të verbër. **“Por ata thonë ashtu siç kanë thënë paraardhësit.”**

Pastaj ata i kapi habia: **“Ata pyesin: Vallë pasi të vdesim e të bëhemi eshtra e dhé, vërtet do të ringjallemi?!“**.⁶⁶

Por kjo nuk besohet!: **“Kjo na është premtuar neve dhe të parëve tanë”** por ishin premtime të gënjeshtërtë; **“por këto janë vetëm përralla të popujve të lashtë.”** Me një fjalë, sipas tyre, ringjallja e krijesave s’është veçse përrallë. Po kështu, edhe

⁶⁶ Vënia e dheut përpara kockave mund të ketë kuptimin ose për kthimin e dheut në jetën e parë, që është më e habitshme sesa kthimi i kockave, ose sepse stërgjyshërit u kthyen në dhe’ ndërsa etërit në kocka, ose sepse mishi i njeriut kthehet në dhe’ para kockave. Pastaj edhe kockat kthehen në dhe’.

llogaridhënia e Libri janë përralla të tjera e kështu edhe Xhenneti e Xhehennemi.

Por meqë jobesimtarët dhe idhujtarët e kishin shumë frikë Botën Tjetër dhe tmerrin e saj me llogaridhënien dhe drejtësinë e Librit, ata justifikoheshin dhe përpiqeshin ta bënë të pranueshëm kundërshtimin e tyre ndaj të Vërtetës dhe kapjes së tyre pas të pavërtetës.

Për këtë, ajetet që po studiojmë, i japin një goditje të fuqishme kësaj logjike të dobët në tre mënyra: duke i kujtuar njeriut se All'llahu është Poseduesi i tërë botës ekzistuese, është Sunduesi i kësaj ekzistence dhe është Sovran mbi të (ekzistencën në tërësi). Dhe nga të gjitha Hulumtimet njeriu arrin të njohë fuqinë e All'llahut dhe lehtësinë e Ringjalljes nga ana e Tij. Gjithashtu, arrin të kuptojë se drejtësia dhe urtësia e Tij e bëjnë të detyrueshme pasimin e kësaj jete me një Jetë Tjetër.

Ajo që tërheq vëmendjen është se Kur'ani merr nga idhujtarët pohimin për të gjithë çështjen. Ai përmend thënie të tyre për të provuar dorëzimin e tyre.

Së pari, ai thotë: **“Thuaj: ‘E kujt është Toka dhe gjithçka që gjendet në të nëse e dini?’”**.

Pastaj ajeti shton se ata i besojnë All'llahut, Krijuesit të ekzistencës, sipas thirrjes së natyrës së pastër që vjen vetvetiu duke u përgjigjur: “të All'llahut”. Ti thuaju atyre: **“Vallë, a nuk po ia vini veshin?”**. Si ka mundësi të përfytyroni pamundësinë e ringjalljes së të vdekurve pas pranimit tuaj të hapur?

Pastaj e urdhëron Profetin rishtazi që t'i pyesë ata: **"Thua: 'Kush është Zoti i shtatë qiejve dhe Zoti i Fronit Madhështor?'"**. Pastaj vjen përgjigjja që buron nga natyra e pastër, me të cilën All'llahu i ka krijuar njerëzit, që është pohimi i sundimit të All'llahut të Madhëruar, duke thënë: "All'llahu". Por pas këtij pranimi të qartë, përse nuk e keni frikë All'llahun dhe nuk njihni ringjalljen dhe rilindjen e njeriut përsëri: **"E ti thua: 'Vallë, a nuk keni frikë ju?'"**.

Pyeti ata edhe një herë për sovranitetin e All'llahut mbi qiejt dhe Tokën: **"Thua: 'Kush është Ai që ka në dorë pushtetin mbi çdo gjë?'"**. Kush është Ai që i strehon të pastrehët e të privuarit dhe që nuk ka nevojë për strehën e askujt? **"Ai mbron, por prej Tij nuk mund të mbrohet askush, nëse e dini?"**

Ata pranojnë se bota është në pronën dhe pushtetin e Tij dhe detyrimi i të tjerëve është vetëm vepër e Tij: **"Ata thonë: 'All'llahu'"**.

"E ti thua: 'Atëherë, përse magjepseni?'" Me një fjalë, si mund të thoni se i Dërguari (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ju bën magji juve, pavarësisht nga të gjitha këto pohime dhe pranime nga ana juaj?!

Ato janë të vërteta që ju i pranoni në çdo fazë; keni rënë dakord se All'llahu i Madhëruar, është Poseduesi i Ekzistencës dhe Krijuesi i saj. Ai është Drejtuesi, Krijuesi, Sunduesi dhe Strehuesi. Atëherë, si ka mundësi që Ai që zotëron të gjitha këto fuqi e aftësi, gjithë këtë pushtet dhe urtësi, të mos jetë në gjendje ta kthejë njeriun në pluhur dhe ta ringjallë përsëri, siç e krijoi herën e parë?

Përse largoheni nga nënshtrimi ndaj të Vërtetës? Përse e akuzoni Profetin më të nderuar për magji, ndërkohë që zemrat tuaja i pranojnë këto të vërteta?

Së fundmi, me një shprehje përmbledhëse por që ka kuptim të madh, Kur'ani thotë se ajo nuk është as magji dhe asgjë tjetër: **“Ja! Ne ua kemi zbuluar atyre të Vërtetën, por ata janë gënjeshtarë.”**.

All'llahu ua ka bërë njerëzve të qarta të vërtetat, duke u dërguar atyre Profetë dhe të Dërguar, por ata e kanë kundërshtuar urdhrin e Tij dhe nuk i janë përgjigjur inkurajimit të Tij për ta adhuruar, për të zbatuar ligjet e Tij që të udhëheqin drej çdo të mire dhe që të shpëtojnë nga çdo e keqe.

Hulumtime

1- Kuptimi i një numri fjalësh

Fjala *“el esâtîru”* është shumësi i fjalës *“ustûratun”*. Disa gjuhëtarë kanë thënë se ajo vjen prej fjalës *“es satru”* me kuptimin e rreshtit. Me këtë emërtohen fjalët që rreshtohen në një rresht të vetëm. Ndërsa fjala *“el ustûratu”* përdoret për shkrimet apo rreshtat e shkruara që kanë lënë të vjetrit, sepse shkrimet e të vjetërve përmbajnë legjenda dhe përralla të paqena. Kështu që

fjala “*el esâtîru*” u përdor për emërtimin e tregimeve dhe historive të kota dhe të gënjeshtërtë. Fjala “*el esâtîru*” në Kur'an përsëritet nëntë herë. Të gjitha rastet kanë ardhur në gojën e jobesimtarëve për t'u provuar kundërshtimin e tyre Profetëve të All'llahut të Lartësuar.

Fjala “*er rabb*”, siç e thamë në shpjegimin e sures “Muhammed”, do të thotë “pronar ndreqës”, prandaj dhe nuk përdoret për çdo pronar, por veçohet për pronarin që synon rregullimin dhe ndreqjen, që e ruan shumë mirë administrimin e pronës së tij. Kjo fjalë përdoret disa herë edhe për emërtimin e edukatorit dhe të mësuesit.

Fjala “*el melekûtu*” vjen nga “*el mulku*” sipas formës “*kufrun*”, që do të thotë “qeverisje” dhe “pronësi”. Shtimi i shkronjës “*el uâ'u*” dhe i “*et tâ'u*”, sigurisht në gjuhën arabe, është bërë për konfirmim dhe hiperbolizim.

Fjala “*el arshu*” do të thotë “*krevat me këmbë të larta*”. Nganjëherë kjo fjalë përdoret për çatitë, apo gjëra të ngjashme me to. Kur kjo fjalë lidhet me All'llahun e Madhëruar, ajo ka kuptimin e gjithë botës së ekzistencës.

Ndonjëherë kjo fjalë është përdorur për “*metafizikën*” në vend të fjalës “*kursijjun*”, që do të thotë “bota fizike dhe materiale e të tjera të ngjashme me të” si përshembull: “**Kursi-u i Tij shtrihet mbi qiejt dhe Tokën.**”⁶⁷

⁶⁷ Çështjen e Fronit e studiuam gjerësisht në shpjegimin e ajetit 54 të sures “El A'râf”.

2- Konfirmimi i Ringjalljes duke u mbështetur në fuqinë e përgjithshme të All'llahut

Nga ajetet e Kur'anit del si përfundim se shumica e kundërshtimeve të mohuesve të Ringjalljes vërtitet rreth problemit të rilindjes trupore dhe të habisë së tyre nga kthimi i shpirtit dhe i jetës rishtazi tek njeriu pasi bëhet dhé. Prandaj, ajetet rendisin një numër shenjash të fuqisë dhe aftësisë së All'llahut në botën e ekzistencës, duke konfirmuar krijimin e saj nga hiçi, me qëllim që të besonin në jetën pas vdekjes dhe fshirjen e pamundësisë së saj nga përfytyrimi i tyre.

Këto ajete e kanë studiuar këtë çështje nëpërmjet sqarimit të fuqisë së All'llahut në Tokë dhe mbi banuesit e saj, fuqisë së Tij mbi qiejt dhe Fronin madhështor, fuqisë së Tij në administrimin e botës së ekzistencës dhe të Ringjalljes. Këto tre rrugë janë gurë prove për një kuptim të vetëm. Gjithashtu, ka mundësi që secili prej këtyre tre Hulumtimeve të vërë në dukje pikëpamjen e mohuesve të Ringjalljes. Nëse mohimi juaj për Ringjalljen do të vinte për shkak se kockat e vjetëruara kanë dalë nga sfera e qeverisjes së All'llahut dhe pronësia e Tij, kjo do ishte gabim, sepse ju e pranoni se All'llahu i Madhëruar është pronar i Tokës dhe i gjithçkaje që ndodhet në të.

Nëse mohimi juaj vjen sepse Ringjallja e të vdekurve ka nevojë për një zot të aftë dhe të fuqishëm, ju e pranoni se All'llahu është Zoti i qiejve dhe i tokës.

Edhe nëse mosbesimi dhe mohimi i juaj vjen për shkak të dyshimit që keni në lidhje me organizimin e botës pas jetës së re dhe pas Ringjalljes së të vdekurve. Përsëri edhe kjo nuk qëndron,

sepse ju keni pranuar organizimin e Tij dhe keni pranuar fuqinë dhe aftësinë e Tij për të administruar e drejtuar botën e ekzistencës dhe të të gjitha qenieve ekzistuese duke marrë përsipër përgjegjësinë e kujdesit ndaj saj, të drejtimit dhe administrimit të problemeve të saj. Kështu që përsëri nuk ka vend për mohimin tuaj. Përgjigjja ndaj femohuesve në të tre rastet është një përgjigje harmonike dhe e njëjtë: **“Ata thonë: ‘All’lahu”**, që konfirmon shpjegimin e parë.


3- Ndryshimi i fundit të ajeteve

Ajo që tërheq vëmendjen është se pas pyetjes së parë dhe përgjigjes së saj, vjen shprehja: **“Vallë, a nuk po ia vini veshin?”**.

Pas pyetjes së dytë dhe përgjigjes së saj vjen shprehja: **“Vallë, a nuk keni frikë ju?”**.

Dhe pas pyetjes së tretë dhe përgjigjes së saj, vjen shprehja: **“Atëherë, përse magjepseni?”**.

Këto shprehje janë një paralajmërim i fortë për mosbesuesit dhe mosaprovim i gjendjes së gënjeshtërt ku ata ndodheshin, që vjen në formë graduale dhe fazë pas faze. Kjo është një metodë e njohur që shkrihet e harmonizohet me metodat e njohura në mësimin e edukimit logjik. Nëse edukatori do kishte nevojë për të dënuar dikë, së pari fillon me paralajmërimin e butë, pastaj me paralajmërim të vendosur dhe pas kësaj me dhunë.



“All’l-lahu nuk ka zgjedhur për Vete ndonjë bir dhe përveç Atij s’ka asnjë zot tjetër, përndryshe çdo zot do të merrte atë që ka krijuar dhe do të ngriheshin njëri mbi tjetrin. Qoftë i lartësuar Ai nga shpifjet e tyre!”

“Ai di të padukshmen dhe atë që shihet. Ai është shumë lart mbi zotat që ia quajnë Atij për shok!”

Komentimi

Përçarja e tërheq botën drejt shkatërrimit

Ajetet e kaluara trajtuan hulumtime për Ringjalljen, qeverisjen dhe teologjinë, ndërsa këto ajete trajtojnë hedhjen poshtë të idhujtarisë. Ato paraqesin një aspekt të degjenerimit të politeistëve, duke u dhënë atyre përgjigje me prova të qarta: “All’l-lahu nuk ka zgjedhur për Vete ndonjë bir dhe përveç Atij nuk ka asnjë zot tjetër.”.

Mendimi se Zoti ka një bir nuk kufizohet vetëm tek të krishterët, të cilët e konsiderojnë Profetin Isa (*Paqja qoftë mbi të!*) si bir të vërtetë Të tij! Idhujtarët i konsideronin engjëjt si vajza të

All'Ilahut. Ndoshta të krishterët e morën këtë mendim nga idhujtarët e vjetër. Nisur nga fakti se biri është pjesë e të atit, ata mendonin se engjëjt, apo Krishti kanë pjesë nga Zoti, që përbën shfaqjen më të qartë të politeizmit.

Pastaj ajeti bën të qartë kotësinë dhe pavërtetësinë e bërjes shok Zotit. Nëse do të kishte zota të ndryshëm që sundojnë botën, atëherë çdonjëri prej tyre do kishte krijesat e veta të veçanta, të cilat do t'i qeveriste dhe do të drejtonte punët e tyre.

Mbi këtë bazë dhe si pasojë e saj, në botë do të kishim sisteme të ndryshme sepse secili prej zotave do të administronte zonën e vet me sistem të veçantë: **“përndryshe çdo zot do të merrte atë që ka krijuar”**, gjë që është në kundërshtim me njësimin e sistemit sundues të kësaj bote.

“Dhe do të ngriheshin njëri mbi tjetrin.” Ky është rezultati i pashmangshëm i të gjitha luftrave, sepse secili grup do synonte të fitonte mbi të tjerët e të vendoste hegjemoninë e vet. Kjo në vetvete do të ishte shkaku i copëtimit të sistemit të njëjtë sundues në botë.

Në fund të ajetit vjen shenjtërimi i All'Ilahut të Madhërishëm me fjalët: **“Qoftë i lartësuar Ai nga shpifjet e tyre!”**.

Dhe ajka e fjalëve është ajo që gjejmë në mënyrë të qartë të sundimi i një rregulli të përbashkët për të gjithë rrafshin e ekzistencës. Ligjet sunduese të kësaj bote në tokën dhe qiellin e saj janë të njëjtë. Sistemi në fuqi është i njëjtë edhe për një grimcë të vetme. Krijuesi sundon Sistemin Diellor si dhe sistemet e tjera të mëdha. Nëse ne do të mund të shikonim një pamje të zmadhuar të

një grimce të vetme, do të vërenim se ajo është në formën e Sistemit Diellor

Shkencëtarët, në eksperimentet e tyre rreth shkencave të ndryshme, duke përdorur pajisjet më preçize dhe më moderne, kanë argumentuar se sistemi sundues në të gjithë këtë ekzistencë është një. Kjo nga njëra anë.

Nga ana tjetër, ndryshimet dhe dallimet janë gjithnjë bashkëudhëtarë të shumëllojshmërisë. Nëse cilësitë e dy sendeve do ishin të ngjashme plotësisht, atëherë nuk do kishim dy por një send të vetëm dhe nuk do kishte nevojë për t'i konsideruar si dy sende. Nëse do supozonim se kjo botë ka shumë zota të ndryshëm, atëherë ndikimi i këtij numri të shumtë do të ndikonte edhe tek krijesat e botës dhe te sistemi drejtues dhe nuk do të gjendej sistemi unik i krijimit.

Përveç kësaj, duhet shtuar se çdo ekzistues duhet të synojë të përsosë ekzistencën e vet. Atëherë, vetëm ekzistenca e plotë nga të gjitha anët nuk ka nevojë për përsosje në vetekzistencë. Nëse do të supozonim ekzistencën e zonave të veçanta për çdo zot nga këta t'ashtuquajtur zota, sigurisht që ata nuk do të kishin përsosje absolute dhe natyrisht që do të synonin përsosjen e vetvetes, do përpiqeshin të aneksonin dhe t'i merrnin për vete pjesët e mbetura të zonave. Ky synim për përsosje dhe konkurrencë në fuqi, do ishte një pretekst për ta bërë botën viktimë në kthetrat e atyre që ndjehen defiçitarë dhe që kërkojnë të sundojnë mbi të tjerët. Rezultati i kësaj do ishte prishja dhe shkatërrimi i botës.

Kështu, të dyja fjalitë në ajet janë treguese të një argumenti të vetëm logjik dhe nuk gjendet kufizim i fjalisë.⁶⁸

Pyetja e vetme e mbetur në këtë ekspozë është: A është i saktë shembulli i përmendur nëse supozojmë se zotat përpiqen të triumfojnë dhe të imponojnë një sundim absolut? Ndërsa nëse i supozojmë të mençur dhe të ditur këta zota, atëherë çfarë e pengon që bota të drejtohej mbi bazën e konsultimit midis vetë zotave?

Kësaj pyetjeje i jemi përgjigjur në shpjegimin që i kemi bërë ajetit 22 të Sures “En Nisā” gjatë studimit të shembullit të ndalimit të ndërsjellë dhe s’ka nevojë që ta përsërisim edhe një herë këtu.

Ajeti që vijon u jep përgjigje idhujtarëve të mashtruar, duke thënë: **“Ai di të padukshmen dhe atë që shihet.”** Me një fjalë, All’lhu di anën e dukshme të gjërave e të sendeve dhe ç’kanë ato në brendësi. Atëherë, si ka mundësi që ju të mendoni se ka një zot tjetër, të cilin e njihni ju e nuk e njih Zoti që ju ka krijuar dhe që di të padukshmen dhe atë që shihet në këtë botë?

⁶⁸ Dijetari Et Tabatabai në Tefsirin “*El Mizān*” jep një kuptim tjetër për fjalinë “dhe ndoshta njëri prej tyre mbi tjetrin”, përfundimi i të cilit është se sistemet sunduese në botë qëndrojnë përballë njëri-tjetrit, njëllor si sistemi sundues në shkretëtira dhe dete, dhe ndonjëherë janë në distancë me njëri-tjetrin njëllor si rregulli që sundon në sistemin diellor dhe në sistemin sundues në rruzullin tokësor, që konsiderohet pjesë e atij sistemi tërësor. Pas organizimit, që është një organizim tërësor dhe i përgjithshëm, disa i lartëson në atë mënyrë që, nëse shpëputet prej tij çka është poshtë tij, atëherë ai që është poshtë pushon së vepruari dhe ai që është më poshtë vihet më sipër. Kjo është njëllor si rasti i një zoti, që ka një organizim më të lartë në lidhje me zotin të cilit i delegon një organizim që nuk i përshtatet dhe që është më pak i vlefshëm, duke lartësuar në pozitë një zot mbi një tjetër (Tefsiri “*El Mizān*”, vëllimi 15, f. 66).

Ky sqarim i ngjan atij që ka ardhur në ajetin 18 të Sures Jûnus: “...Thuaj: ‘A po i tregoni All’llahut për diçka që Ai nuk e di në qiej dhe në Tokë’?!...”

Me këtë shprehje, përfytyrimet e tyre të kota marrin fund: “Ai është shumë lart mbi zotat që ia quajnë Atij për shok!”.

Fundi i këtij ajeti i ngjan fundit të ajetit 18 të sures “Jûnus” ku thuhet: “Qoftë i lavdëruar Ai dhe i lartësuar mbi gjithçka që ia shoqërojnë Atij (në adhurim)”. Kjo tregon se problemi është një. Po ashtu, kjo shprehje është një kërcënim që u drejtohet idhujtarëve se All’llahu që di të fshehtën dhe të dukshmen, di edhe se çfarë thoni e flisni dhe do t’ju kërkojë llogari për to në Ditën e Kiametit në gjyqin e Tij të drejtë.

Ajetet 93 – 98

Kërkoni mbrojtjen e All'llahut nga nxitjet e djajve

Këto ajete, duke iu drejtuar të Dërguarit më të nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) rrënjësin qëllimet e ajeteve të kaluara në kërcënimin e mosbesuesve dhe idhujtarëve kokëfortë me llojet e ndëshkimit hyjnor: **“Thuaj (o Muhammed): ‘O Zoti im sikur të ma tregoje dënimin që u ke premtuar atyre,’”**⁶⁹ **“atëherë, o Zoti im, mos më lër mua me popullin keqbërës!”** është një lutje dhe thirrje për shpëtim nga zhdukja duke u shkëputur nga keqbërësit, të cilët i pret ndëshkimi më i keq i mundshëm. S’ka dyshim se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk ka bërë punë të tilla që e ekspozojnë atë për ndëshkim dhe nuk është e drejtë hyjnore që i pafajshmi të merret për mëkatar. Përkundrazi, edhe nëse një rob e adhuron All'llahun në një popull, All'llahu i Madhërueshëm e shpëton atë nga fatkeqësia që përfshin të tjerët.

Kjo lutje nga ana e të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) bëhej me urdhër të All'llahut të Madhërishëm për dy qëllime:

I pari, që të paralajmëroheshin mosbesimtarët dhe idhujtarët për fundin e keq, ku i Dërguari më i nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) duhej t’ia

⁶⁹ Fjala “Imma” (ose) në ajetin e mësipërm vjen nga pjesëza “in” kushtore plus pjesëzën “ma”. Ato përdoren këtu si konfirmim. Me qëllim që pjesëza “in” kushtore t’i përgjigjet foljes së lidhur me “nunin” të konfirmimit, duhet që ato të ndahen nga pjesëza “ma”.

dorëzonte veten All'llahut të Madhërishëm dhe të Lartësuar dhe të kërkonte prej Tij shpëtimin.

I dyti, le ta dinë të gjithë shokët dhe pasuesit e tij se çdo të thotë t'i dorëzohesh të vërtetës dhe të mos mendojnë se ata janë të sigurtë nga ndëshkimi i Tij.

Por çfarë kihet parasysh me këtë ndëshkim?

Shumica e shpjeguesve mendojnë se ai është ndëshkimi i kësaj bote me të cilin i ka dënuar All'llahu idhujtarët, siç ishte edhe mundja e tyre e hidhur, që u shkaktoi gjatë betejës së Bedrit.⁷⁰ Surja "El Mu'minûn" ka zbritur në Mekë në ditën kur besimtarët përballeshin me presione të fuqishme. Prandaj këto ajete ishin si balsam për plagët e tyre dhe si dëfrim për zemrat e tyre. (Me këtë kuptim ka ardhur edhe në suren "Junûs", ajeti 46).

Disa komentues supozojnë se ai përfshin si ndëshkimin e kësaj bote, ashtu edhe atë të Botës Tjetër së bashku.⁷¹

Por shpjegimi i parë duket më afër me atë që kërkon të njoftojë ajeti.

Në konfirmim të këtij problemi dhe në mohim të çdo dyshimi të armiqve për qetësimin e mendjes së të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të besimtarëve, ajeti pasues shton: **"Dhe me të vërtetë, Ne jemi në gjendje të të tregojmë ty çfarë u kemi premtuar atyre."**

⁷⁰ Të shihen tesiret: "Mexhmaul Bejjan", vëllimi 7, f. 117; "El Mizân", "Fi Dhilalil Kur'ân", Rûhul Xhinnân", Rûhul Meâni. Fundi i ajetit në studim.

⁷¹ Tesiri "El Kebîr", fundi i ajetit në studim.

Pas kësaj, fuqia e All'llahut të Madhërishëm u duk qartë në fusha të ndryshme, siç ishte beteja e Bedrit ku një pakicë besimtarësh fituan mbi të gjithë armiqtë e shumtë me fuqinë e besimit dhe me mbështetjen e All'llahut të Madhëruar dhe të Lartësuar.

Pastaj All'llahu e urdhëron të Dërguarin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që të ndjekë një politikë të butë në thirrjen në rrugën e drejtë dhe fenë e të vërtetës: **“Largoje të keqen me atë që është më e mirë!”**. Me një fjalë, largoje armiqësinë dhe të këqijat e tyre me falje dhe mirësi. Fjalës së tyre të turpshme përgjigjju me logjikë të ekuilibruar. **“Ne i dimë mirë shpifjet e tyre.”** All'llahu e di se veprat e tyre të shëmtuara, fjalët e tyre të pista dhe lëndimi i egër i tyre, e bëjnë Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të vuajë. Por Ai, qoftë i adhuruar dhe i Lartësuar, fton për mospërgjigje me të njëjtën monedhë. Përkundrazi, ju detyron që përgjigja të jetë me atë që është më e mira. Kjo është rruga më e mirë për zgjimin e të pakujdesshmëve dhe të të mashtruarve.

Pastaj lexon urdhrin për të kërkuar ndihmën dhe mbështetjen e All'llahut përballë intrigave të djallit. **“Dhe thuaj: ‘O Zoti im, kërkoj të më mbrosh nga nxitjet e djajve’**, që është një lutje për të shpëtuar nga pritrat e shejtanit dhe nga rrengjet e tij të fshehta. Dhe lutja nuk është vetëm për nxitjet e djajve, por vazhdon në kërkesën e ndihmës dhe mbështetjes dhe për praninë e tyre tek ai: **“Dhe tek Ti mbështetem o Zoti im, që të mos i kem pranë meje”**, pra praninë e djajve në takimet e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), pasi kjo çon në shkujdesjen e të pranishmëve në to dhe humbjen e tyre.

Hulumtime

1- Ç'janë nxitjet e djajve?

Fjala “*el hamazāt*” është shumësi i fjalës “*hemzetun*”, që ka kuptimin e lëvizjes me forcë. Ajo u përdor për emërtimin e shkronjës “*el hemzetu*”, sepse të çon në një lëvizje të fuqishme në fundin e qiellzës.

Disa shpjegues kanë thënë se “*el hemzatu*” ka kuptim të njëjtë me fjalët “*el gamzu*” dhe “*er remzu*”, por kuptimi i fjalës “*er remzu*” është më i lehtë, pastaj vjen “*el gamzu*” më e rëndë dhe në fund vjen “*el hamazatu*”, që është më e fortë se dy të parat.⁷²

Meqë fjala “*djall*” ka ardhur në shumës (djajtë), ajo përfshin djajtë e xhindeve dhe të njerëzve, të hapur e të fshehur. Në komentimin e Ali ibn Ibrahimit lexojmë se Imami (*Paqja qoftë mbi të!*) për kuptimin e ajetit: “**O Zoti im, kërkoj të më mbrosh nga nxitjet e djajve**” ka thënë se është fjala për nxitjet e djallit që hyjnë në zemrën tënde.”⁷³

Kur i Dërguari (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me gjithë pastërtinë dhe pozitën që kishte tek All'llahu, i drejtohet të Madhërishmit me këtë lutje, atëherë çfarë mund të mendohet për përgjegjësinë e të tjerëve? Ata duhet t'i luten All'llahut pa iu dridhur syri, pa rënë nën ndikimin e nxitjeve të djajve, jo vetëm kaq, por pa praninë e djajve në takimet e tyre. Ata që e duan të Vërtetën dhe që shkrihen në të, i drejtohen me

⁷² Tefsiri “*Rûhul Meanij*”.

⁷³ Tefsiri “*Nûruth Thekalejn*”, vëllimi 3, f 552.

lutje e thirrje All'llahut dhe ia delegojnë Atij punët e tyre, me qëllim që Ai t'i mbrojë nga nxitjet e djajve dhe nga poshtërsitë e tyre.

2- Përgjigjja ndaj së keqes me të mirë


Një nga rrugët më të mira dhe më ndikuese në luftën kundër armiqve të fuqishëm dhe kokëfortë, është përgjigjja ndaj së keqes me të mirë. Ky qëndrim u zgjon atyre ndjenjat dhe i bën t'i kërkojnë llogari vetes për veprimet e këqija që kanë kryer dhe në më të shumtën, të kthehen në rrugën e arsyes. Këtë sjellje e gjejmë mjaft të qartë dhe të dukshme në jetën e të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të Imamëve të rrugës së drejtë (*Paqja qoftë mbi ta!*), të cilët u përgjigjeshin të këqijave të mëkatarëve me të mirë dhe me gjëra të dobishme. Kështu ata fitonin dashurinë e tyre në përgjigjen ndaj të vërtetës dhe në refuzimin e të pavërtetës.

Kur'ani i Lavdishëm e përmend këtë sjellje për myslimanët disa herë pasi e konsideron si parim bazë për çrrënjosjen e të këqijave. Në ajetin 34 të sures "Fussilet" lexojmë: **"Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë."**

Është për t'u theksuar se kjo gjë është vetëm për rastet kur armiku nuk e shfrytëzon këtë thjesht për të përfituar nga ky parim dhe nuk e shikon mirësinë që i bëhet apo faljen ndaj tij si një dobësi që mund të shpie në inkurajimin e armiqësisë dhe të keqbërjes.

Ndjekja e kësaj rruge nuk do të thotë të bësh pazare me armikun, apo t'i dorëzohesh atij. Ky mund të jetë shkak që All'llahu, qoftë i Madhëruar dhe i Lartësuar, i dha urdhër të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) menjëherë pas përmendjes së kësaj porosie, që t'i kërkonte Atij ndihmë kundër nxitjeve dhe yshtjeve të djajve dhe kundër pranisë së tyre rreth e qark tij.

Ajetet 99 - 100



“Kur i vjen vdekja ndonjërit prej tyre (jobesimtarëve), ai thotë:
‘O Zoti im, më kthe,’”

“‘që të bëj vepra të mira në botën që kam lënë!’ Kurrresi! Me të vërtetë, kjo është një fjalë të cilën ai (kot) e thotë! Prapa (vdekjes së) tyre do të ketë një (kohë) ndarëse, deri në Ditën kur do të ringjallen.”

Komentimi

Kërkimi i të pamundurës

Këto dy ajete pasojnë atë që trajtuan ajetet e kaluara në lidhje me kokëfortësinë e idhujtarëve dhe fajtorëve, kapjen e tyre të fortë pas gënjeshtërisë dhe kotësisë. Ata trajtojnë gjendjen e rëndë të tyre kur t'u vijë vdekja, nëse vazhdojnë rrugën e padrejtësisë dhe të gënjeshtërisë: **“Kur i vjen vdekja ndonjërit prej tyre (jobesimtarëve) ai thotë: ‘O Zoti im më kthe!’”**.⁷⁴

Kur mëkatari idhujtar detyrohet të lërë këtë botë për të kaluar në një botë tjetër, bien perdet e shkujdesjes dhe të kryelartësisë prej tij dhe ai e sheh me sytë e vet fatin e tij të dhimbshëm pa mall e pa krenari. Çdo gjë që i interesonte atij kthehet në pluhur e hi. Ai në këtë ditë shikon rezultatin e bëmave të veta dhe të mëkateve e fajeve që ka kryer. Klithmat dhe ulërimat e tij ngrihen e lartësohen: **“O Zoti im, më kthe!”**.

Më kthe mua, o Zot “që të bëj vepra të mira në botën që kam lënë!”. Por ligji i krijimit është i drejtë, nuk lejon një kthim të tillë. Ai nuk lejon të kthehet as i miri dhe as i keqi. Kështu, atij i vjen përgjigja e prerë: *“Jo, në asnjë mënyrë.”*

“Me të vërtetë, kjo është një fjalë të cilën Ai (kot) e thotë!” Fjalë që nuk vijnë nga thellësia e tij (atij që i ka ardhur vdekja) dhe as nga vullneti i tij. Këto janë fjalë të një njeriu keqbërës, që i përsërit ato kur ndjen ndëshkimin apo ardhjen e vrasësit për ta ekzekutuar, sepse sapo të qetësohet furtuna me të cilën përballet, ai kthehet në veprimet e tij të shëmtuara të mëparshme. Kjo ngjan

⁷⁴ Fjala *“hatta”* (derisa) në fakt është qëllim për fjalinë e mospërmendur. Nga shprehja e shkuar, kuptohet se aludimi i saj është: **“Ata vazhdojnë në këtë gjendje derisa ndonjërit prej tyre i vjen vdekja”**. Kjo del nga shprehja: **“Ne jemi më në dijeni nga ajo që ata e përshkruajnë”**, nga e cila është përfituar në dy ajetet e kaluara. (Mendojeni mire.)

me atë që ka ardhur në ajetin 28 të sures “El En’ām”: **“por edhe sikur të ktheheshin, prapë do të bënin ato që u ishin ndaluar.”**.

Ajeti në fund vë në dukje botën e varrit të errët me një shprehje të shkurtër, por me kuptim të madh: **“Prapa (vdekjes së) tyre do të ketë një (kohë) ndarëse deri në Ditën kur do të ringjallen.”**.

Hulumtime

1- Kush është bashkëbiseduesi në thënien e të Madhërishmit: “O Zoti im, më kthe!”

Vihet re se fjala “*rab’bun*” vjen në formë të zbutur “*rab’bi*”, që do të thotë “*Zoti im*”. Këtu në fillim fjalia tregon se bashkëbiseduesi është All’llahu i Madhëruar dhe i Lartësuar, por pjesa që vjen pas “*erxhaûn*” në formën e shumësit, e përjashton mundësinë që biseduesi të jetë All’llahu, qoftë i Madhëruar dhe i Lartësuar. Këto dy shprehje në fjalinë e kaluar ngjallin pyetje dhe pikëpyetje.

Disa shpjegues mendojnë se bashkëbiseduesi është All’llahu dhe se forma e shumësit këtu është në shenjë respekti për madhimin. Por përdorimi i formës së shumësit në bashkëbisedimin me një person, nuk është i përdorur në gjuhën arabe, sidomos në kohën e shkuar dhe s’ka një tjetër të ngjashëm

në Kur'anin e Lavdishëm. Kjo tregon se ky shpjegim është i dobët.⁷⁵

Një numër tjetër shpjeguesish kanë thënë se bashkëbiseduesit janë engjëjt e ngarkuar për kapjen e shpirtave dhe fjala "Rrab'b" (Zot) është një lloj kërkesë ndihme prej All'llahut, gjë që është e zakonshme në jetën tonë të përditshme ku njeriu kërkon ndihmën e All'llahut në raste vështirësish dhe ngushtice dhe nuk thërret njerëzit për shpëtim duke thirrur: "Ja Rrab'b! Ja Rrab'b"! (O Zot! O Zot!) Më shpëtoni! Nxitoni me ndihmën tuaj! Ky shpjegim duket më afër logjikës dhe arsyes.

2- Shpjegimi i shprehjes "në botën që kam lënë"

Në ajetet e kaluara lexuam se mosbesuesit i kërkojnë ndihmë All'llahut që t'i kthejë në këtë botë për të bërë vepra të mira që s'i bënë dot sa ishin gjallë.

Disa komentues e dijetarë për thënien e të Madhërishmit "**që kam lënë**" kanë mendimin se tregon për pasurinë që kanë lënë për shkak të përdorimit të shprehjes "lënia e të vdekurit" në formë të zakonshme.

⁷⁵ Disa komentues e mendojnë frazën e ajetit 9 të sures "El Kasas": "**Ky (djale) është gëzim për mua dhe për ty, prandaj mos e vrisni**", të cilën gruaja e Faraonit e tha kur Musai u nxorr nga uji, një shembull të kësaj shprehjeje, ku në fillim bashkëbiseduesi është Faraoni, ndërsa shprehja e fundit tregon se bashkëbisedues janë shoqëruesit dhe ushtarët e Faraonit, të cilët ishin ngarkuar të vrisnin djemtë e bijve të Izraelit.

2 "*Usulul Kafij*", vëllimi 3, f. 503 dhe "*Theuābul A'amal*", Men la jehderuhul fakijh, siç e ka transmetuar komentuesi i tefsirit "Nûruth Thekalejn", vëllimi 3, f. 552.

Një tansmetim i ardhur nga Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) e konfirmon dhe e përforcon këtë kuptim. Ai ka thënë: “*Kush nuk paguan një karat zekat, nuk është besimtar dhe as mysliman*”. Edhe fjala e të Madhërishmit: “**O Zoti im, më kthe që të bëj vepra të mira në botën që kam lënë**”, ka kuptimin që të jap zekatin që nuk e kam dhënë.

Ndërkohë, disa të tjerë mendojnë se ky kuptim është më i gjerë dhe tregon për të gjitha veprimet e dobishme që ka lënë njeriu. Kështu, kuptimi do ishte: “*O Zot! Më kthe mua që të shlyej atë që lashë pa bërë nga punët e dobishme*”.

Hadithi i lartpërmendur nuk bie në kundërshtim me këtë Komentimim të përgjithshëm që është vërtetësi e qartë për të, duke ditur se ata njerëz pendohen për shanset e humbura. Për këtë, ata duan të kthehen në jetë për të përfituar prej tyre për punë të dobishme.

Me sa duket, Komentimimi i dytë është më afër logjikës dhe fjala “*leal’lee*”, që ka ardhur në fjalinë “*që të bëj vepra të mira në botën që kam lënë*”, mund të jetë shenjë e mosqetësimit të atyre devijuesve për të ardhmen e tyre. Pendimi është rezultat i kushteve të veçanta që dalin në pah kur atyre u vjen vdekja. Nëse do të vinin në këtë botë, ata do të kishin vazhduar të njëjtat vepra. Kjo përbën thelbin e të vërtetës.

3- Ç'është ajo që mohon fjala "kursesi"?

Fjala "kel'la", në arabisht vjen me kuptimin "pengim" dhe "zgjatje e ndikimit të thënies së biseduesit". Asaj i përgjigjet me përpikmëri fjala "ej" që përdoret për aprovimin e fjalëve.

Në përgjigje të pyetjes së shtruar më lart, disa kanë thënë se fjala "kel'la" mohon kërkesën e jobesimtarëve për t'u kthyer në jetën e kësaj bote. Me një fjalë, rruga e kthimit është e mbyllur dhe nuk mund të kthehen në asnjë mënyrë.

Disa të tjerë kanë thënë se kjo fjalë ka ardhur për të mohuar pretendimet e atyre që thonin: *"Nëse do kthehemi në këtë botë, ne do të kompensojmë atë që na iku nga punët e dobishme"*. Atyre iu thuhet: *"Kjo s'është tjetër veçse pretendim i gënjeshtërt. Nëse do të ktheheshit, ju do vazhdonit të punonit njëloj dhe do silleshit si më parë"*.

Po ashtu, duhet të kihet parasysh se kjo kërkesë, pavarësisht se ka ardhur në ajetin që po studiojmë vetëm nga ana e idhujtarëve, nuk u përket vetëm atyre. Ajo është kërkesë e të gjithë fajtorëve, keqbërësve dhe të devijuarve, që ndërsa pendohen në ditën e vdekjes për çfarë u ka shpëtuar, kur shohin fatin e tyre të dhimbshëm me sy të perënduar, i luten All'llahut që t'i kthejë në jetën e kësaj bote, por All'llahu i dëbon duke u thënë "kursesi".

4- Çfarë është Barzaku?

Ku është ajo?

Cili është argumenti që vërteton ekzistencën e Barzakhut, midis kësaj bote dhe Botës Tjetër?

Së fundi, cila do të jetë gjendja e besimtarëve dhe e të devotshmëve dhe cila do të jetë gjendja e jobesimtarëve dhe e keqbërësve në të?

Këto pyetje u trajtuan nga ajetet dhe Hulumtimet e mëparshme, prandaj do t'u përgjigjemi në përputhje me sa na lejon shkrimi i këtij libri.

Fjala “*Barzakh*” në origjinë ka kuptimin e diçkaje që qëndron si pengesë midis dy sendeve. Pastaj është përdorur për gjithçka që gjendet midis dy sendeve. Prandaj fjala “*Barzakh*” erdhi si provë për një botë që gjendet midis kësaj bote dhe Jetës së Përtejme.

Argumentin e pranisë së botës së ndërmjetme “*Barzakh*”, apo të jetës së varrit, apo të botës së shpirtërave, e gjejmë në mesin e argumenteve tradicionale (*naklije*). Për këtë botë flasim qartë ajetet kur'anore, disa herë haptazi e disa herë të nënkuptuara.

Ajeti që po studiojmë “**Prapa vdekjes së tyre do të ketë një (kohë) ndarëse deri në Ditën kur do të ringjallen**” është i qartë në lidhje me ekzistencën e botës ndarëse (*Barzakh*), pavarësisht se disa kanë thënë se fjala “*el barzakh*” në këtë ajet do të thotë: “*pengues*” ose “*ndalues nga kthimi në këtë botë*”. Por ky kuptim duket i huaj sepse shprehja “**deri në ditën kur do të ringjallen**”

është provë e ndodhjes së botës ndarëse “*Barzakh*”, midis kësaj bote dhe Botës Tjetër dhe jo midis njeriut dhe kësaj bote.

Ndër ajetet që e deklarojnë haptazi ekzistencën e kësaj bote, janë ajetet e veçanta kushtuar jetës së dëshmorëve, siç është ajeti 169 i sures “*Âli Imrân*”: **“Kurrresi mos i quani të vdekur ata që janë vrarë në rrugën e All’lauhut! Jo, janë të gjallë duke u ushqyer te Zoti i tyre.”**. Këtu mesazhi i drejtohet Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’lauhut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ndërsa ajeti 154 i sures “*El Bekare*” ua dërgon kumtesën të gjithë besimtarëve duke thënë: **“Dhe mos thoni për ata që vriten në rrugën e All’lauhut se janë të vdekur! Jo! Ata janë të gjallë, ndonëse ju nuk e ndjeni.”**.

Dhe bota e “*Barzakh-ut*” nuk është vetëm për besimtarët e shkallës së lartë, si për shembull dëshmorët, por edhe për jobesimtarët dhe shtypësit si Faraoni dhe bashkëpunëtorët e tij. Këtë e deklaroi ajeti 46 i sures “*Gafir*”: **“Ata do të çohen para Zjarrit në mëngjes dhe mbrëmje (në jetën e varrit) e kur të arrijë Ora (e Kiametit) do të thuhet: ‘Hidhni ithtarët e Faraonit në dënimin më të rëndë.’”**.

Edhe ajete të tjera e kanë përmendur botën e “*Barzakh-ut*”, por jo me atë qartësi dhe formë si ajetet e mësipërme.

Ajo që duhet të tërheqë vëmendjen në lidhje me çështjen e “*Barzakh-ut*” është se ajetet, me përjashtim të ajetit që kemi në studim tani dhe që e përmend atë në formë të përgjithshme, e kanë paraqitur “*Barzakh-un*” në mënyrë të veçantë, siç u përmend për dëshmorët apo për bijtë e Faraonit.

Por është e qartë se jeta e varrit nuk është e kufizuar vetëm për bijtë e Faraonit, sepse në botë ka shumë të atillë; dhe as për dëshmorët sepse Kur'ani Fisnik i ka konsideruar si dëshmorë edhe Profetët, të sinqertët dhe të drejtët, siç thuhet në ajetin 69 të sures “En Nisā”: **“Kushdo që i bindet All’liahut dhe të Dërguarit do të jetë me ata të cilëve All’lillahu u ka dhënë shumë dhunti: me Profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët!”**.

Në fund të këtij hulumtimi, me lejen e All’liahut, do të themi se “*Barzakh*” pëfshin të gjithë njerëzit ose për një grup prej tyre.

Për sa u përket historive, ekzistojnë shumë transmtime si tek grupi i shiitëve, ashtu edhe tek ai i synitëve, që flasin me shprehje të ndryshme për botën e “*Barzakh*-ut”, botën e varrit, apo botën e shpirtërave. Me një fjalë, për botën ndarëse ndërmjet kësaj bote dhe Botës Tjetër.

1- Në një hadith të njohur që përmendet te thëniet e shkurtra të Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) në librin “Nehxhul Belaga” thuhet se kur ai mbërriti në varrezat e Kufës gjatë kthimit të tij nga lufta e Siffinit, u drejtua nga varret dhe u thirri të vdekurve me fjalët: “*O banorë të shtëpive të vetmuara, të vendeve të shkreta dhe varreve të errëta! O banorë të baltës! O banorë të afërsisë! O banorë të vetmisë! O banorë të shkretisë! Ju keni vdekur para nesh, por ne do ju ndjekim pas! Këtu shtëpitë janë banuese, të vejat e të vetë u martuan. Paratë dhe pasuria janë ndarë. Këto janë lajmet tek ne. Po ju, çfarë lajmesh keni?”*

Pastaj u kthye nga shokët e tij dhe u tha: *“Nëse ata do të lejoheshin të flisnin, do ju kishin njoftuar se furnizimi më i mirë është devotshmëria.”*¹

Është e qartë se këto fjalë nuk përmbajnë as metafora e as epitete, por na bëjnë me dije të vërtetën e ekzistencës së jetës në *“Barzakh”* pas vdekjes. Të vdekurit, nëse do iu lejohej, do të mund të bisedonin me ne.

2- Në një transmetim tjetër të përcjellë nga El Esbeg ibn Nebate, thuhet: Prijësi i besimtarëve, Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) doli nga Kufa, eci derisa erdhën luftëtarët dhe e kaluan. Ne e ndoqëm pas dhe e gjetëm të shtrirë në tokë, por nuk kishte poshtë asnjë rrobë.

Kamberi i tha: *“O prijës i besimtarëve! As edhe një rrobë të thjeshtë nuk paske poshtë teje?”*

Ai i tha: *“Jo. A s’është ajo veçse toka e besimtarit dhe shtërningesa e tij në qëndrimin e tij?”*

El Esbegu thotë: *“I thashë: O Prijës i besimtarëve, ne e mësuam se ka qenë e do të jetë dheu i besimtarëve. Por çfarë është shtërningesa e saj në qëndrimin e tij?”*

Aliu u përgjigj: *“O ibn Nebeta! Nëse do ju zbulohej, do t'i kishit parë shpirtrat që gjenden në këtë tokë në formën e rrethit ku shkëmbejnë vizita dhe zhvillojnë biseda. Në këtë tokë ndodhen shpirtrat e të gjithë*

¹ “Nehxhul Belêga”, fjalët e shkurtra, numër 130.

besimtarëve, por në luginën Berhut¹ ndodhen shpirtrat e jobesimtarëve.”²

3- Në një tregim tjetër thuhet se Imam Ali ibn El Husejn (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Varri ose është kopsht nga kopshtet e Xhennetit, ose gropë nga gropat e Zjarrit.”³

4- Transmetohet se Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Barzakhu është varr. Është puna e mirë dhe ndëshkimi. Ai ndodhet midis kësaj bote dhe Tjetrës. Për Zotin, nuk kemi frikë nga asgjë për ju përveçse jetës në Barzakh.”⁴

5- Në librin e “El Kafij” thuhet se Imami u pyet se ç’është “Barzakh” dhe ai u përgjigj: “Varri nga koha e vdekjes deri në Ditën e Kiametit.”⁵

6- Shejkh El Kulejni transmeton në librin “El Kafij” nga Ali ibn Ibrahim, ky nga i ati, nga El Hasan ibn Mahbubi, nga Ebu Uel’lad El Hannat dhe nga Ebu Abdullah, Imam Sadiku: “I thashë: T’u bëfsa kurban! Thonë se shpirtrat e besimtarëve janë në gushat e zogjve të gjelbërt rreth Fronit”. Ai tha: “Jo. Besimtari është më i nderuar tek All’llahu dhe s’ka mundësi që shpirtin e tij ta vendosë në një gushë zogu. Ai (shpirti) qëndron në trupa si trupat e tyre.”⁶

7- Në një transmetim tjetër i ardhur nga Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) në librin e “El Kafij” lexojmë: E pyeta atë për

¹ Kjo është lugina Hadramut në të cilën ndodhet një pus i vjetër e i thellë që quhet pusi i Berhut. Transmetohet nga Profeti (Paqja dhe bekimet e All’llaht qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) se në të ndodhen shpirtrat e jobesimtarëve dhe të munafikëve. (V.M)

² “Biharul Anuar”, vëllimi 6, f. 243.

³ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëllimi 2, f. 553.

⁴ Po aty.

⁵ Po aty, f. 554.

⁶ “Usulul Kafij”, siç e ka sjellë “Biharul Enuar”, vëllimi 6, f. 268.

shpirtin e besimtarëve. Ai m'u përgjigj: *"Ata ndodhen në dhoma në Xhennet. Ushqehen prej ushqimeve të tij dhe pinë prej pijeve të tij. Ata thonë: 'O Zoti ynë! Na e sill orën (e llogarisë) dhe na e realizo atë që na ke premtuar!'"*¹

8- Autori i librit "El Kafij" përcjell nga Sehl ibn Zijad, nga Ismail ibn Muhran, nga Derset ibn Ebu Mensur, nga ibn Muskan, nga Ebu Basir, nga Ebu Abdullahu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili ka thënë: *"Shpirtrat janë në formën e trupave në një pemë të Xhennetit ku prezantohen dhe shkëmbejnë pyetje. Nëse vjen një nga shpirtrat, ata thonë: "Lëreni atë se ka shpëtuar nga një tmerr i madh". Pastaj e pyesin: Çfarë ka bërë filani? Dhe çfarë ka bërë filani? Nëse u thotë atyre e lashë atë të gjallë, kijeni frikë atë. Nëse u thotë atyre vdiq, atëherë i thonë: "ka vdekur, ka vdekur."*²

Transmetimet e sipërpërmendura me Xhennet dhe Ferr kanë parasyshtë dy "*Barzakha*" por jo dy kthime Ditën e Kiametit dhe ndryshimi midis tyre është i madh.

Transmetimet në këtë fushë janë të shumta dhe janë renditur në kapituj të ndryshëm, prej të cilëve mund të kujtojmë:

- Transmetime që flasin për pyetjen rreth varrit dhe ndëshkimit.
- Transmetime që trajtojnë lidhjen e shpirtrave me familjet e tyre dhe njohjen e gjendjes së tyre.
- Transmetime që flasin për natën e Miraxhit dhe të lidhjes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me shpirtrat e Profetëve dhe të të Dërguarve.

¹ "Biharul Enuar", vëllimi 6, f. 269.

⁸⁵ "Bihārul Anuār", vëllimi 6, f. 269.

- Transmetime që bëjnë fjalë për vuajtjet e njeriut, për rezultatet e veprave të veta, qofshin ato të mira apo të këqija, pas vdekjes së tij etj.¹

El Barzakh dhe lidhja me botën e shpirtave

Megjithëse shumë prej atyre që pretendojnë se lidhen me botën e shpirtave janë gënjeshtarë, apo vuajnë nga një lloj iluzioni dhe fantazie, është provuar se lidhja me botën e shpirtave mund të ndodhë. Kjo iu është realizuar disa shkencëtarëve, saqë ata kanë arritur disa të vërteta nëpërmjet rrugës së shpirtave.

Vetë ky problem është provë e qartë për ekzistencën e botës së “*Barzakhut*” dhe të vërtetës së saj. Ato vënë në dukje se pas jetës në këtë botë dhe vdekjes dhe para Kiametit në Botën e Përtejme ekziston edhe një botë tjetër që qëndron më vete.² Po kështu, provat logjike për të provuar privimin e shpirtit dhe të mbetjes së tij pas shkatërrimit të trupit, janë një provë tjetër e ekzistencës së botës së “*Barzakhut*”.

Pamje nga bota e “Barzakhut” (jetës së ndërmjetme)

Dijetarët e Islamit janë dakort në lidhje me origjinën e ekzistencës së “*Barzakhut*” dhe për të mirat dhe të këqijat që ndodhin në të me disa ndryshime të pjesshme. Dijetarët synitë dhe

¹ Këto transmetime i mblodhi i ndjeri Abdullah Shub’ber në një libër që e titulloi “*Teslijatu El Fauā’id fī Bejjani El Meuti uel Mādi*”.

² Për të mësuar më shumë në lidhje me këtë, shihni çështjen e lidhjes me shpirtat në librin “*Audatu Er Rûhi ue El Ittisālu biha*” dhe librin “*El Alem ba'del Meuti*”.

shiitë janë dakort për ekzistencën e *"Barzakhut"*, me përjashtim të një numri të vogël të pakonsiderueshëm.

Argumenti i dakordësisë së dijetarëve rreth *"Barzakhut"* është e qartë. Ai është thënia e qartë e ajeteve kur'anore për ekzistencën e *"Barzakhut"* dhe të së mirës dhe të ndëshkimit që, siç e thamë, ndodhen në të. Një prej atyre ajeteve është ai që flet për dëshmorët: **"Kurrresi mos i quani të vdekur ata që janë vrarë në rrugën e All'Ilahut! Jo! Ata janë të gjallë duke u ushqyer te Zoti i tyre. Janë të gëzuar për çfarë u ka dhënë All'Ilahu nga dhuntitë e Tij dhe gëzohen edhe për ata që ende nuk u janë bashkuar e që kanë ngelur pas tyre (dhe ende nuk kanë rënë martirë), sepse nuk do të frikësohen (për çfarë i pret) dhe nuk do të pikëllohen (për çfarë kanë lënë pas)."**¹

Dhe jo vetëm ky grup prej njerëzish të mirë që All'Ilahu u ka dhënë dhunti dhe të mira, por aty është edhe grupi i shtypësve më të egër dhe i kriminelëve, që All'Ilahu i torturon, si tortura e bijve të Faraonit pas vdekjes dhe para Kiametit, siç ka vënë në dukje ajeti 46 i sures *"El Gāfir"*.

Transmetimet në lidhje me këtë janë konseguente dhe të vazhdueshme dhe nuk ka diskutim për ekzistencën e *"Barzakhut"*. E rëndësishme është të njihet *"Barzakh"* dhe forma e tij. Për të janë përmendur pamje të ndryshme, nga të cilat më e qarta është ajo që shpirtat e njerëzve, pasi lënë këtë botë, hyjnë në trupa të bukur e të lartë, larg gjurmëve të kësaj materieje të pistë, por ata janë në formën e trupave tanë. Për secilin prej tyre thuhet *"trup shembullor"*. Ai nuk është tërësisht i privuar dhe as thjesht material. Disa e ngjasojnë atë me gjendjen në të cilën gjendet

¹ Sure *"Āli Imrān"*, ajetet 169 dhe 170.

shpirti kur atë e sheh njeriu në gjumë, ku pamja i një gjëje të mirë e gëzon shpirtin, ndërsa pamja e gjërave të dhimbshme e torturon atë. Kjo ndikon në trupin tonë: ne qajmë kur shohim një ëndërr të bezdisshme dhe frikësohemi nga tmerri i asaj që shikojmë, ose qeshim nga thellësia e zemrës nga diçka interesante nga ajo që ëndërrojmë gjatë gjumit tonë.

Një grup tjetër mendon se shpirti kryen aktivitete të ndryshme në trupin shembullor. Jo vetëm kaq, por shkojnë edhe më tej dhe pikërisht se shpirtrat me aftësi të fuqishme mund të shkëputen nga trupi dhe lëviz në "trupin shembullor" me dëshirën e vet ose nëpërmjet hipnozës. Kështu, ai lëviz nëpër botë për t'u njohur me disa çështje.¹

Jo vetëm kaq, por disa kanë thënë se trupi shembullor ndodhet në trupin e çdo njeriu dhe ai shkëputet prej tij në fillim të jetës së "Barzakhut". Një gjë e tillë, siç kemi thënë, mund të ndodhë në këtë botë.

Edhe nëse ne i refuzojmë të gjitha këto cilësime të trupit shembullor, në fakt nuk mund të mohohet e gjithë tematika, për shkak të haditheve të shumta që flasin për të dhe pengesë logjike për të.

Në këtë mënyrë sqarohet edhe përgjigjja e atij që kundërshton dhe thotë se të pranosh trupin shembullor do të

¹ Dijetari E Mexhlisij, në trajtimin që i bën kësaj teme në "Bihārul Enuār" (Detrat e Dritave), deklaron se ngjashmëria e jetës së varrit (El barzakh) me ëndërrën dhe me atë që njeriu sheh, ka ardhur në shumë tregime dhe mundet që personalitetet e fuqishme e të larta të kenë disa trupa shembullorë. Me këtë shpjegohen tregimet që flasin për prezencën e Imamëve të ditur që ndodhen në prag të vdekjes dhe i merr kjo e fundit "Biharul Enuar", vëllimi 6, f. 261.

thotë domosdoshmërisht të pranosh mishërimin, që do të thotë kalimi i shpirtit nga një trup tek një tjetër.

Këtij kundërshtimi i është përgjigjur shumë qartë Shejkh El Behaj, i cili ka thënë: “Mishërimi, që shumica e myslimanëve e quajnë të parregullt, është kthimi i shpirtit, pas dekompozimit të trupit në të cilin ishte, për t’u vendosur në një trup tjetër në këtë botë”.

Për sa i përket specifikës së shpirtit në "trupin shembullor" në botën e “*Barzakhut*” deri në Ditën e Kiametit dhe pastaj kthimin e tij në trupin e parë me urdhër të All’liahut të Madhërishëm, ai nuk ka lidhje me mishërimin. Ne e mohojmë me forcë mishërimin dhe e quajmë jobesimtar atë që beson në të, sepse ata thonë për përjetësinë e shpirtit dhe se ai gjithmonë kalon nga një trup në një tjetër dhe mohojnë ringjalljen trupore në Botën Tjetër.¹

Pretendimi për ekzistencën e "trupit shembullor" në brendësi të trupit material e largon përgjigjen për këtë ndërlirim, sepse shpirti nuk kalon nga një trup në një tjetër, por braktis disa prej formave të tij dhe vazhdon në një formë tjetër në jetën e tij të varrit.

Pyetja e fundit është se nga ajetet kur'anore mësojmë se nuk ekziston jetë “*Barzakh*” për një grup njerëzish, siç thuhet në dy ajetet 55 dhe 56 të sures “Er Rrûm”: **“Ditën kur të vijë Ora (e Kiametit) keqbërësit do të betohen se kanë qëndruar (në tokë) veçse për një kohë të shkurtër. Kështu, ata shmangen nga e Vërteta. Ata, të cilëve u është dhënë dituria dhe besimi, do të thonë: ‘Ju, me të vërtetë, keni qëndruar aq sa ju ka caktuar**

¹ “Bihārul Enuār”, vëllimi 6, f. 277.

All'Ilahu në Libër - deri në Ditën e Ringjalljes. E ja, kjo është Dita e Ringjalljes, por ju nuk e keni ditur.'".

Përgjigjja e këtij kundërshtimi ka ardhur në transmetime, ku thuhet se njerëzit janë tre grupesh: grupi besimtar dhe i sinqertë në besimin e vet, grupi i sinqertë në mosbesimin e vet dhe grupi i mesëm dhe i dobët. Bota e "*Barzakhut*" u takon dy grupeve të para, ndërsa për grupin e tretë jeta e "*Barzakhut*" konsiderohet si gjendje e mosnjohjes (Për t'u njohur më shumë me këto tregime, mund të shfletoni vëllimin e gjashtë të "*Bihārul Enuār*" - studimit të gjendjeve të "*Barzakhut*" dhe të varrit).

“Zjarri do t’ua përcëllojë fytyrat dhe buzët (aq sa do t’u duken dhëmbët).”

Komentimi

Një aspekt i ndëshkimit të keqbërësve

Ajetet e kaluara bënë fjalë për botën e “*Barzakhut*”. Ato pasohen nga ajete që trajtojnë Kiametin si dhe një aspekt të gjendjes së fajtorëve e mëkatarëve në Botën Tjetër.

Ajeti i parë, prej ajeteve në fjalë, fillimisht thotë: **“Kur të fryhet në Sur (Ditën e Ringjalljes), atëherë midis tyre nuk do të ketë lidhje farefisnore dhe ata as që do të pyesin për njëri-tjetrin.”**. Duke u mbështetur në ajetet e Kur'anit të Lavdishëm, dihet se fryerja në *Sur* bëhet dy herë: herën e parë në fund të kësaj bote, ku do të vdesë gjithçka që ndodhet në tokë dhe në qiej, dhe herën e dytë kur fillon ringjallja nga varret për t’iu kthyer një jete të re dhe kur përgatiten për dhënien e llogarisë dhe ndëshkimin.

“Fryerja në Sur” do të thotë t’i biesh borisë. Por kjo shprehje ka një kuptim të veçantë që do ta sqarojmë, në dashtë Zoti, në shpjegimin e ajetit 68 të sures “*Ez Zumer*”.

Sido që të jetë, ajeti i lartpërmendur vë në dukje dy fenomene nga ato të Ditës së Kiametit.

Fenomeni i parë: Mbarimi i çështjes së lidhjes farefisnore, sepse lidhja familjare dhe fisnore që sundon në jetën e njerëzve në këtë botë, shumë herë çon në shpëtimin e fajtorëve nga ndëshkimi, ngaqë ata kërkojnë ndihmë e shpëtim nga të afërmit në zgjidhjen e problemeve të tyre. Ndërsa gjendja në Ditën e Kiametit do të jetë e ndryshme, ku çdo njeri dhe vepër e tij nuk do të kenë ndihmë dhe as dobi nga biri, motra apo prindi i tij.

Fenomeni i dytë: Është sundimi i frikës tek të gjithë. Asnjëri nuk pyet për gjendjen ku ndodhet tjetri për shkak të frikës së madhe nga ndëshkimi hyjnor. Ajo, siç e kemi parë në fillim të sures "El Haxh" do të jetë: **"Ditën që do të shihni atë, çdo grua me fëmijë në gji do ta harrojë fëmijën e saj dhe çdo grua shtatzanë do ta hedhë barrën e vet. Njerëzit do t'i shihni si të dehur, ndonëse ata nuk do të jenë të dehur, por dënimi i All'llahut është i ashpër."** Ndërsa shprehja **"dhe ata as që do të pyesin për njëri-tjetrin"** supozohet të ketë për qëllim moskërkimin e asnjërit prej tyre të ndihmës së tjetrit, sepse të gjithë ata e dinë se një gjë e tillë është e kotë.

Disa komentues kanë thënë se ajo çfarë dëshirohet nga kjo shprehje është mospyetja për farefisninë dhe është konfirmim i thënies së të Madhërishmit: **"midis tyre nuk do të ketë lidhje farefisnore."**

Komentimi i parë duket më i qartë se të tjerët, pavarësisht se midis tyre nuk ka ndonjë kontradiktë dhe shprehja e sipërme mund të aludojë për të gjitha këto kuptime së bashku.

Disa shpjegues të tjerë mendojnë se nga disa ajete mund të përfitohet në lidhje me pyetjet e njerëzve Ditën e Kiametit, siç ka ardhur në ajetin 27 të sures "Es Saffât" ku fajtorët pyesin njëri-

tjetrin, ndërsa përballeshin me Zjarrin: **“e do t’i afrohen njëri-tjetrit, duke u grindur”**, apo siç e tregon kjo sure në ajetin 50 për banorët e Xhennetit që në orën kur vendosen e zënë vend në Xhennet, takojnë njëri-tjetrin: **“Ata do t’i qasen njëri-tjetrit dhe do të bisedojnë.”**. Ata pyesin njëri-tjetrin për shokët e tyre në jetën e kësaj bote që devijuan dhe nuk ndoqën rrugën e tyre dhe si pasojë përfunduan në Zjarr.

Një kuptim të njëjtë me këtë ka ardhur edhe në ajetin 35 të Sures “Et Tûr”, ku duket se si harmonizohen këto ajete me ajetin që kemi në studim. Edhe ato tregojnë se njerëzit në Ditën e Kiametit nuk bëjnë pyetje.

Nëse do të thellohem imtësisht në kuptimin e ajeteve që po studiojmë, do të na qartësohej edhe përgjigjja për këtë pyetje. Ajetet e veçanta që vërtetojnë pyetjen e njëri-tjetrit, në fakt flasin për kohën e stabilizimit të tyre në Xhennet ose në Zjarr, ndërkohë që ajetet që po studiojmë, i mohojnë pyetjet e ndërsjella të njerëzve në Ditën e Ringjalljes kur sundon një tmerr mbi të gjithë, aq sa njerëzit harrojnë gjithçka kanë rreth e rrotull tyre, të hutuar nga tmerrri i Ringjalljes. Me fjalë të tjera, për Kiametin ekzistojnë qëndrime dhe për çdo qëndrim ka një çështje të caktuar. Vështirësitë e përmendura lindin nga mosdiagnostikimi i këtyre qëndrimeve.

Pasi ndodh Kiameti fillon etapa e llogaridhënies dhe e matjes së veprave me një peshore të posaçme: **“Ata, të cilëve u rëndohet peshorja (e punëve të mira) janë të shpëtuar.”**.

Fjala “*el meuāzînu*” është shumësi i fjalës “*mizānun*”, që është një mjet për peshimin (peshore), siç kemi thënë më parë.

Peshorja nuk ka kuptimin e peshores në këtë botë që përdoret për peshimin e sendeve. Në këtë ajet, ajo do të thotë: “mjet i përshtatshëm për matjen e vlerës së veprave të njeriut”. Domethënë, fjala peshore ka kuptim të gjerë dhe përfshin të gjitha mjetet e matjes. Siç ka ardhur në transmetimet e ndryshme, me peshore maten veprat dhe njerëzit dhe si matës shërbejnë udhëheqësit e mëdhenj të Islamit. Në një transmetim thuhet se *“Peshoret janë prijësi i besimtarëve dhe Imamët nga gjeneza e tij.”*¹

Mbi këtë bazë, të Dërguarit dhe trashëgimtarët e tyre janë ata, me të cilët maten njerëzit dhe veprat e tyre, për të parë se deri në ç'shcallë u ngjajnë atyre. Me këtë dallohen njerëzit: cili është i rëndë e cili i lehtë, cili është i shtrenjtë, e cili i pavlerë, cili është i ditur, e cili injorant. Po kështu, neve na sqarohet sekreti i përmendjes së peshoreve në formën e shumësit, sepse udhëheqësit e mëdhenj të njerëzve në të shkuarën, që ishin peshore të matjes, janë shtuar gjatë historisë.

Ka mundësi që Profetët, Imamët dhe adhuruesit e singertë të All'Ilahut, të jenë shembull udhëheqës në një fushë të caktuar ose në shumë fusha, sipas rrethanave me të cilat kalojnë. Ata patën disa cilësi që u shquan më shumë se disa të tjera, kështu që secili prej tyre u bë peshore e asaj cilësie për të cilën u bë i njohur.

“Sa për ata që do të kenë peshoren të lehtë”, që janë ata që humbën besimin dhe veprën e mirë, pesha e tyre është e lehtë në Ditën e Kiametit, sepse ata humbën kapitalin e ekzistencës së tyre. “Mu ata do të jenë (njerëzit) që kanë humbur vetveten duke qëndruar përherë në Xhehennem.”.

¹ “Bihārul Enuār”, vëllimi 7, f. 251, botimi i ri.

Shprehja **“kanë humbur vetveten”** është një deklaratë për të vërtetën e humbjes së kapitalit më të madh prej fajtorëve, domethënë të ekzistencës së tyre në tregun e tregtisë së kësaj bote pa arritur të fitojnë asgjë.

Ajeti që pason, shpjegon torturën e dhimbshme të tyre: **“Zjarri do t’ua përcëllojë fytyrat.”** Gjuhët e zjarrit dhe flaka e tij përcëlluese do t’i godasë fytyrat e tyre siç godet shpata: **“dhe buzët** (aq sa do t’u duken dhëmbët)”. Nga dhimbja e madhe dhe tortura e zjarrit, ata do përjetojnë vrenjtje dhe nxirje në fytyrë.

Fjala *“telfehu”* vjen nga fjala *“lefhu”* sipas formës *“fet’hun”* dhe do të thotë në origjinë “goditje shpate”. Këtu është përdorur si sinonim për flakën e zjarrit, dritën përvëluese të Diellit dhe erën e nxehtë të shkretëtirës, që godasin fytyrën e njeriut sikur të ishte goditje shpate.

Ndërsa fjala *“kalihun”* vjen nga fjala *“kelûhun”* sipas formës *“fuûlun”* dhe do të thotë *“vrenjtje”* dhe *“ngrysjë e fytyrës”*. Një numër i madh komentuesish e kanë shpjeguar atë si tërheqje të lëkurës së fytyrës në atë mënyrë, saqë duken dhëmbët e përparmë dhe mbyllja e tyre bëhet e pamundur.²

Hulumtime

² Tefsiri i “Kurtubijut” dhe tefsiri “El Kebijr”, vëllimi 23, f. 123; Tefsiri “Mexhmaul Bejjan” dhe tefsiri “El Mizân”, fundi i ajetit në studim.

1- Dita kur njeriu nuk tregon ndonjë vëmendje

Botëkuptimet dhe mentalitet që sundojnë jetën materiale të njerëzve në këtë botë do të ndryshojnë në Botën Tjetër, përfshirë këtu edhe marrëdhëniet miqësore dhe lidhjet familjare që zgjidhin shumë probleme në këtë jetë dhe disa herë përbëjnë edhe sistemin që sundon mbi të gjitha marrëdhëniet shoqërore.

Nëse përkatësia ndaj fiseve dhe familjeve nuk është në kundërshtim me besimin tek All'Ilahu i Madhëruar dhe për punë të dobishme, ajo është e papranueshme në Ditën e Kiametit, ku nuk ka përkatësi familjare, apo fisnore për individ, grup apo fis. Nëse njerëzit këtu ndihmojnë njëri-tjetrin dhe ia zgjidhin problemet, e mbështesin apo krenohen me të, ata nuk do jenë kështu në Ditën e Kiametit. Atë ditë nuk ka dobi nga pasuria e madhe dhe as nga fëmijët: **“në Ditën kur askujt nuk do t'i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek All'Ilahu.”**³

Edhe ata që i përkasin Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekiemt e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i nënshtrohen këtij ligji. Prandaj shohim se i Dërguari (*Paqja dhe bekiemt e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe Imamët e pastër i dëbuan nga vetja ata që ishin të afërt me përkatësinë hashimite ose për shkak të mosbesimit të tyre, ose për shkak të devijimit të tyre nga Islami origjinal. Ata e shfaqën neverinë e tyre si dhe i lanë duart prej tyre, megjithëse tregohet se i Dërguari (*Paqja dhe bekiemt e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka

³ Surja “Esh Shu'arā”, ajetet 88 dhe 89.

thënë: “Ditën e Kiametit, çdo përkatësi origjine⁴ ndërpritet, përveç atyre që i përkasin lidhjes time dhe gjenezës time”.⁵

Dijetari Et Tabatabai (*All’llahu qoftë i kënaqur me të!*) thotë në tefsirin “El Mizān” se ky transmetim është i njëjti me atë që kanë transmetuar disa transmetues synitë në librat e tyre. Herë e përcjellin nga Abdullah ibn Umer, herë tjetër nga Umer ibn Khattab dhe herë të tjera nga sahabë të tjerë të Profetit (*Paqja dhe bekiemt e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Vëmë re se ajeti që po studiojmë ka karakter të përgjithshëm. Ai flet për ndërprerjen e të gjitha lidhjeve gjinore në Ditën e Kiametit. Dhe këtë e mbështesin parimet kur'anore dhe jeta e Profetit (*Paqja dhe bekiemt e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në trajtimin e të devijuarve, gjë që tregon se nuk ka ndonjë dallim midis njerëzve në këtë fushë. Në një transmetim të Ibn Shehr Ashub në librin e tij “El Menakib” transmeton nga Tauus El Jemamij, nga Imam Zejnul Abidin (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili ka thënë: “All’llahu e krijoi Xhennetin për këdo që iu nënshtrua dhe është i mirë, qoftë ai edhe një skllav etiopian, dhe krijoi Ferrin për këdo që nuk i nënshtrohet, qoftë ai edhe nga zotërinjtë kurejshë.”⁶

2- Historia prekëse e El Esmaiuj-ut

⁴ Fjala “el haseb” do të thotë “krenari e njeriut për baballarët dhe gjyshërit” dhe nganjëherë edhe “moral i shëndoshë” për vetë personin. Këtu qëllimi i kuptimit është i pari. (Mund të shfletoni “Lisanul Arab” fjala heseb).

⁵ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëllimi 7, f. 119, fundi i ajetit në studim.

⁶ “El Menakibu” i Ibn Shehr Ashuub (siç e ka transmetuar tefsiri Nûruth Thekalejn”, vëllimi 3, f. 564.

Është me vend këtu të përmendim historinë e transmetuar nga El Gazali në librin e tij “Bahrul Mehebbeti” për El Esmaj-un, që mbështet atë që iu referuam dhe që përmban çështje që meritojnë vëmendje.

El Esmaj-u thotë: Po bëja Tauaf (rrotullim rreth Qabes) në një natë me hënë, kur dëgjova një zë të butë të një burri që po i kërkonte ndihmë Zotit të tij. Desha të shoh se kush ishte ai që e nxirrte këtë zë dhe pashë se ishte një djalë i bukur, truphedhur, tek i cili rrezatonte mirësia. Ishte varur tek mbulesa e Qabesë dhe në bisedën e tij thoshte:

“O Zoti im! O Sundimtari im! Sytë kanë fjetur dhe yjet mungojnë. Ti je Mbreti i gjallë dhe i përjetshëm. Nuk të kap as dremitja dhe as gjumi. Mbretërit i kanë mbyllur dyert e tyre dhe në to kanë vendosur rojat dhe portierët e tyre. Çdo i dashur është çliruar nga i dashuri i tij. Por dera Jote është e hapur për lypësat. Ja unë, një mëkatar i varfër, një gabues i gjorë, po lyp para derës Tënde! Erdha tek Ti dhe lutem për mëshirën Tënde, o Mëshirues, që të vështrosh nga unë me butësinë Tënde Fisnike!”

Pastaj djaloshi tha këto vargje:

*O Ti që u përgjigjesh të ngushtuarit në errësirë,
o Zbulues i brengës dhe i fatkeqësisë e i sëmundjes,
kanë fjetur vizitorët e Tu për qark Shtëpisë dhe u zgjuan,
por syri Yt, o i Pavdekshëm, nuk fjeti.
Nëse bujarinë Tënde nuk e do ai që harxhon pa masë,*

kush do i shpërblejë mëkatarët me mirësi?

Më dhuro mua bujarinë Tënde, që preferon dhurimin para harxhimit,

o Ti, për të Cilin përgjërohen njerëzit në Xhaminë e Shenjtë!

Pastaj e ngriti kokën nga qielli dhe vazhdoi lutjen:

*“O Zoti im! O Zotëria im! O Sundimtari im! Të jam nënshtruar me
dijen dhe njohjen time. Ty të takon lavdërimi, ndërsa mirënjohja është e
imja. Nëse të kam kundërshtuar, këtë e kam bërë nga padija dhe Ti ke
argumentin kundër meje.”*

Ngriti kokën nga qielli përsëri duke bërë thirrje me sa zë që
kishte: *“O Zoti im! O Zotëria im! O Sundimtari im! Bota nuk
hijeshohet, veçse me përmendjen Tënde. Fundi nuk është i kënaqshëm
veçse me faljen Tënde! Ditët nuk janë të kënaqshme, veçse me
nënshtrimin ndaj Teje. Zemrat nuk kënaqen, veçse me dashurinë Tënde.
Xhenneti nuk është i kënaqshëm, veçse me faljen Tënde”.*

El Esmajj-u shton se djaloshi vazhdoi lutjen e tij drejtuar
Zotit të vet derisa i ra të fikët. U afrova tek ai dhe e pashë me
kujdes. Por ç’të shihja! Ai ishte Ali ibn Husejn Zejnul Abidin
(*Paqja qoftë mbi të!*). Ia mora kokën dhe ia vura në prehërin tim.
Qava shumë mbi të. Pikat e lotëve të mi i ranë në faqe dhe e sollën
në vete. Hapi sytë dhe tha: “Kush më pengoi nga përmendja e
Sundimtarit Tim?” I thashë: “Ti je nga shtëpia e profetësisë dhe
mineral i Mesazhit. A nuk ka zbritur për ju ajeti i Pastrimit? A nuk
ka thënë All’llahu për ju: ‘O Familja e Profetit! Në të vërtetë,

All'llahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t'ju pastrojë plotësisht.”⁷

Imami u ngrit nga sexhdja dhe tha: “O Esmaj! Eh, eh! Zoti krijoi Xhennetin për ata që i nënshtrohen. A nuk e ke dëgjuar fjalën e All'llahut: **“Kur të fryhet në Sur** (Ditën e Ringjalljes), **atëherë midis tyre nuk do të ketë lidhje farefisnore dhe ata as që do të pyesin për njëri-tjetrin?”**.”⁸

El Esmaj thotë: *“Kur e pashë atë në këtë gjendje, e lashë dhe vazhdova rrugën time.”*⁹


3- Përshtatja e ndëshkimit me gabimin

Në të kaluarën ne vumë theksin tek ndëshkimi i All'llahut dhe thamë se ai është në përputhje me mëkatet dhe gjynahet që kryhen. Edhe ajetet e kaluara përmendën djegien e madhe të fytyrave në zjarrin përvëlues derisa ato të nxihen dhe të duken dhëmbët. Ky është ndëshkimi i atyre, që peshoret i kanë të lehta dhe që u mungon besimi. Duke iu referuar këtij kuptimi, del se ata ngryseshin dhe nxiheshin kur dëgjonin ajetet hyjnore dhe disa herë edhe talleshin me to, uleshin e bisedonin me tallje dhe përbuzje. Kështu që ndëshkimi do t'u përshtatet veprave të tyre.

⁷ Surja “El Ahzāb”, ajeti 33.

⁸ Surja “El Mu'minūn”, ajeti 101.

⁹ “Deti i Dashurisë” i El Gazaliut, f. 41 dhe 44 (shkurtimisht).



“(Dhe atyre do t’u thuhet): “Vallë, a nuk ju lexoheshin Shpalljet Tona dhe i quanit ato gënjeshtre?!”

“Ata do të thonë: ‘O Zoti ynë, neve na mposhti e keqja (tekat dhe dëshira) jonë dhe ishim një popull i humbur.’”

“O Zoti ynë, nxirrna prej Xhehennemit e, nëse kthehemi prapë tek e keqja, atëherë jemi keqbërës të vërtetë.”

“Ai do t’u thotë: ‘Rrini aty të përbuzur dhe mos Më flisni asgjë!’”

“Mes robëve të Mi, ishte një grup i cili thoshte: ‘O Zoti ynë, ne kemi besuar, andaj na fal dhe na mëshiro! Ti je më i miri i mëshiruesve!’”

“Por ju (o jobesimtarë) i keni talluar ata (aq shumë), sa ju bënë të më harronit Mua së përmenduri, e përherë i përqeshnit ata.”

“Unë i kam shpërblyer ata sot për durimin e tyre e ata, me të vërtetë, janë të shpëtuar.”

Komentimi

Mos flisni!

Ajetet e kaluara folën për ndëshkimin e dhimbshëm të banorëve të Zjarrit, ndërsa ajetet që po studiojmë, trajtojnë paraqitjen e një ane të bisedës së All'llahut me banorët e Zjarrit. I Madhërishmi dhe i Lartësuari iu drejtohet atyre me qortimin: **“Vallë, a nuk ju lexoheshin Shpalljet Tona dhe i quanit ato gënjeshtër?!”.**

A nuk ju kam dërguar shpallje dhe prova të qarta nëpërmjet të Dërguarve?! A nuk ua kam sjellë argumentin Tim juve? Megjithatë, ju keni vazhduar të përgënjeshtroini dhe të mohoni.

Duke parë se foljet “tutla” dhe “tukedh’dhibun” janë përmendur në kohën e tashme, kuptojmë se fjala është për vazhdimësinë. Neve na bëhet e qartë vazhdimi i leximit të shpalljeve hyjnore për ta si dhe fakti që ata vazhdonin përgënjeshttrimin!

Ata, në përgjigjen e tyre, e pranojnë: **“Ata do të thonë: ‘O Zoti ynë, neve na mposhti e keqja (tekat dhe dëshira) jonë dhe ishim një popull i humbur.’”.**

Fjala “esh shakuatu” dhe “esh shakāuatu” kanë kuptim të kundërt me lumturinë dhe duan të thonë se mjetet e ndëshkimit dhe të fatkeqësisë janë me bollëk. Thënë ndryshe, nënkuptojnë se e keqja dhe fatkeqësia e godasin njeriun, ndërsa lumturi do të thotë se kushtet e të mirave dhe të mirësisë janë me bollëk.

Fatkeqësia dhe lumturia s’janë tjetër veçse rezultat i veprave, fjalëve dhe qëllimeve tona. Të mendosh se lumturia dhe fatkeqësia janë pjesë e vetes së njeriut që nga lindja, s’është tjetër veçse një mendim që përmendet për të kapërdirë ikjen nga pesha,

përgjegjësia dhe kërkesa e ndjesës për veprat në kundërshtim me të Vërtetën, ose shpjegim injorant i veprave dhe i veprimeve.

Prandaj shohim që fajtorët nga banorët e Zjarrit e pranojnë haptazi se All'llahu i përfundoi provat për ta, se ata vetë ishin shkaku për gjendjen e tyre të trishtë, sepse ata ishin të humburit.

Ndoshta ata me këtë pranim kërkojnë të fitojnë kënaqësinë dhe mëshirën e All'llahut, prandaj menjëherë shtojnë: **“O Zoti ynë, na nxirr prej Xhehennemit e nëse kthehemi prapë tek e keqja, atëherë jemi keqbërës të vërtetë.”**. Ata e thonë këtë, sikur nuk e dinë se Kiameti është shtëpia e ndëshkimit dhe jo shtëpia e punës dhe se kthimi në këtë botë është një gjë e pamundur.

Prandaj përgjigja e All'llahut të Madhërishëm dhe të Lartësuar është e ashpër ndaj tyre: **“Rrini aty të përbuzur dhe mos më flisni asgjë!”**. Shprehja *“ekhseuu”*, është folje e formës urdhërore dhe zakonisht përdoret për të dëbuar qentë. Përdorimi i saj për njerëzit ka kuptimin e përbuzjes dhe të ndëshkimit.

Pastaj All'llahu, qoftë i Madhëruar dhe i Lartësuar, jep një provë të kësaj duke thënë: A harruat? **“Mes robëve të Mi ishte një grup i cili thoshte: ‘O Zoti ynë, ne kemi besuar andaj na fal dhe na mëshiro! Ti je më i miri i mëshiruesve!’”**. Por ju talleshit aq shumë me ta, sa që tallja dhe përqeshja e juaj ju bëri të harronit kujtimin dhe përmendjen Time: **“Por ju (o jobesimtarë) i keni talluar ata (aq shumë), sa ju bënë të më harronit Mua së përmenduri, e përherë i përqeshnit ata.”**.

Ndërsa ju po vuani gjendjen më të keqe e ndëshkimit më të dhimbshëm dhe nuk mund t'ju ndihmojë askush nga fati që ju meritoni.


Në këtë mënyrë katër ajetet e fundit bëjnë të qartë shkakun kryesor të dëshpërimit të banorëve të Zjarrit si dhe shkakun e fitores dhe shpëtimit të banorëve të Xhennetit në mënyrë të hapur.

Grupi i humbur ishte ai që qëndronte pas dëshpërimit të vet, pasi ai tradhtoi deri në atë shkallë, sa që Ditën e Kiametit u bisedua me ta siç bisedohet me qentë për shkak të talljeve që u bënë banorëve të së Vërtetës dhe shpërfilljes së besimit të tyre të lartë. A ka fat më të merituar për tallësit me besimtarët sesa ky?!

Ndërsa grupi i devotshëm fitoi shpërblimin më të mirë nga All'Ilahu dhe kjo në sajë të durimit dhe drejtësisë së tyre në përballimin e armiqve kokëfortë dhe mendjemëdhenj, si dhe të vazhdimit me besnikëri të rrugës së All'Ilahut.

Ajetet 112 - 116





“Ai do t’u thotë (jobesimtarëve): ‘Sa vjet keni qëndruar në Tokë?’”

“Ata do të përgjigjen: ‘Kemi qëndruar një ditë ose një pjesë dite. Pyesni ata që i kanë numëruar!’”

“Ai do të thotë: ‘Keni qëndruar shumë pak. Eh, sikur ta kishit ditur!’”

“Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne (për t’ju gjykuar)?!”

“I lartësuar është All’llahu, Sundimtari i Vërtetë! S’ka zot tjetër të vërtetë, përveç Atij, Zotit të Fronit Madhështor!”

Komentimi

Bota dhe mosha e shkurtër e saj

Meqë ajetet e kaluara trajtuan ndëshkimin e dhimbshëm të banorëve të Zjarrit, ajetet në fjalë, përmendin një lloj tjetër ndëshkimi, që është ndëshkimi psikik që u dërgohet prej All'Ilahut të Madhëruar banorëve të Zjarrit për talljen e tyre.

Ajeti i parë thotë: **“Ai do t’u thotë (jobesimtarëve): ‘Sa vjet keni qëndruar në Tokë?’”** I Madhërishmi dhe i Lartësuari do t’i pyesë ata në Ditën e Kiametit se sa vite jetuan mbi Tokë.

Fjala *“el erdu”* (Toka) në këtë ajet e po kështu në Kur’an, siç do ta shohim në të ardhmen, tregon se pyetja bëhet për masën e moshës së tyre në këtë botë, në krahasim me ditët e Botës Tjetër.

Disa komentues kanë arritur deri aty, saqë thonë se ajo që kërkohet me këtë sqarim është pyetja për masën e pritjes së tyre në kohën që ishin në botën e *“Barzakhut”*. Kjo është shumë larg, sipas të jashtmes së ajetit, edhe pse ka dëshmi të pakta për këtë në ajetet e tjera.¹⁰

¹⁰ Në suren *“Rrûm”*, ajetet 55-56, lexojmë: **“Ditën kur të vijë Ora (e Kiametit), keqbërësit do të betohen se kanë qëndruar (në Tokë) veçse për një kohë të shkurtër. Kështu ata shmangen nga e Vërteta. Ata, të cilëve u është dhënë dituria dhe besimi, do të thonë: ‘Ju, me të vërtetë, keni qëndruar aq sa ju ka caktuar All’Ilahu në Libër - deri në Ditën e Ringjalljes, - e ja kjo është Dita e Ringjalljes, por ju nuk e keni ditur.”** Këto dy ajete bëjnë të qartë se kërkesa për sqarim dhe përgjigja i përket qëndrimit në jetën e varrit (El Barzakh). Nëse i marrim ato si provë për ajetet që po studiojmë, përsëri fjala është për qëndrimin në jetën e *“Barzakhut”*. Por, siç e thamë, provat që ekzistojnë në ajetet që po studiojmë, janë sjellë para tyre dhe bëjnë të qartë se kërkesa e shpjegimit dhe përgjigja i përkasin qëndrimit në këtë botë.

Nga ky krahasim, ata dalin në përfundimin se jeta në këtë botë është shumë e shkurtër: **“Ata do të përgjigjen: ‘Kemi qëndruar një ditë ose një pjesë dite.’”**.

Në të vërtetë, moshat e gjata në këtë botë janë si një re në një qiell veror nëse do t'i krahasonim me jetën në Botën Tjetër, ku të mirat janë të pavdekshme dhe ku ndëshkimi i Zjarrit është i pakufishëm.

Dhe për konfirmim apo përgjigje të saktë, thanë: **“Pyesni ata që i kanë numëruar!”**. Me një fjalë: O Zot, pyet ata që dinë të numërojnë numrat dhe t'i llogarisin me saktësi, kur i krahasojnë ata njërin me tjetrin. Por përdorimi i fjalës *“el ad'dadîn”* (numëruesit) mund të ketë parasysh engjëjt që llogarisin moshën e njerëzve dhe veprat e tyre me precizion, sepse ata e njohin shumë më mirë se të tjerët llogaritjen.

Këtu All'illahu u thotë: **“Keni qëndruar shumë pak. Eh, sikur ta kishit ditur!”**.

Në Ditën e Kiametit, ata do ta mësojnë se sa e shkurtër është mosha e kësaj bote të kufizuar në krahasim me moshën në Botën Tjetër që është e përhershme. Mosha në të parën s'është veçse sa një e mbyllur dhe e hapur e syrit, por ata e përfytyronin atë të përjetshme, sepse perdja e shkujdesjes dhe ndikimi i saj ua kishte mbyllur zemrat duke i bërë të mos shikonin të Vërtetën dhe të talleshin me Botën Tjetër, të cilën e llogarishnin si një premtim shumë të largët. Prandaj All'illahu, qoftë i Madhëruar dhe i

Lartësuar, u thotë atyre: Sikur ju do ta dinit, do ta kuptonit këtë të Vërtetë tek e cila arritët Ditën e Kiametit në botën tuaj.¹¹

Ajeti ka përdorur një mënyrë tjetër prekëse për të zgjuar dhe mësuar këtë grup: **“Mos vallë keni menduar që ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne (për t’ju gjykuar)?!”**. Kjo shprehje e shkurtër, por me kuptim të thellë, sqaron një nga provat më të forta të Ringjalljes dhe të përlllogaritjes së veprave dhe të shpërblimit. Kjo do të thotë se jeta e kësaj bote do ishte e kotë nëse nuk do të ishte Kiameti dhe Ringjallja. Kjo botë me problemet që ka dhe me gjithçka që ka vendosur në të All’llahu, si: mënyrat e sjelljes, përgjegjësitë dhe programet, janë të kota e pa kuptim nëse do të ishin vetëm për disa ditë të numëruara. Këtë do ta shpjegojmë në trajtesat që do të vijjnë.

Meqë krijimi nuk është i kotë dhe përbën një çështje të rëndësishme dhe kërkon një provë serioze, ajeti shton: **“I Lartësuar është All’llahu, Sundimtari i Vërtetë! S’ka zot tjetër të vërtetë përveç Atij, Zotit të Fronit Madhështor!”**.

Ai që bën një punë të kotë, në fakt është injoranti dhe i pandërgjegjshëm, apo i dobëti dhe i pamunduri. Ndërsa All’llahu, i Cili posedon cilësitë më të përkryera, që është Sundimtari dhe sundon mbi të gjitha krijesat, që është e Vërteta dhe nga i Cili nuk vjen asgjë përveç të Vërtetës, si ka mundësi ta krijojë ekzistencën kot së koti, pa ndonjë qëllim?!

¹¹ Nyja “*Leu*” (nëse, sikur) në ajetin e kaluar është nyje kushtore, siç kemi thënë edhe më lart. Këtu ka një fjali aluduese: “Nëse ju do ta dinit, do kishit mësuar se ju nuk keni qëndruar veçse pak”. Disa shpjegues kanë thënë se nyja “*leu*” këtu ka kuptimin e fjalës “*sa mirë sikur*” dhe kështu fjalia do të ishte në këtë formë: “Sa mirë sikur ta dinit këtë çështje në botën tuaj”.

Nëse ndonjë person ka iluzion se mund të gjendet dikush që ta ndalojë All'llahun për të arritur qëllimin e Tij, shprehja: **"S'ka zot tjetër të vërtetë përveç Atij, Zotit të Fronit Madhështor!"** e mohon një gjë të tillë dhe konfirmon qenien e Sunduesit, Sundimtarit që e ka një qëllim në krijimin prej Tij të botës.

Me pak fjalë, duke përmendur fjalën "All'llah", që është theksim për cilësitë e Tij të përsosura që ka në vetvete. Ajeti përmend qartazi katër cilësi të Tij, siç janë: All'llahu është zotëruesi i gjithçkaje, Sunduesi i gjithçkaje, e Vërteta absolute ekzistuese, Ai nuk ka shok dhe Plotfuqishmëria e Tij. Të gjitha këto janë argument se Ai, i Lartësuar, nuk bën punë të kota. Po kështu konfirmon se Ai nuk e krijoi njerëzimin kot.

Fjala "*el arsh*" (Froni), siç e kemi theksuar më parë, është aludim për atë që e tërë bota e ekzistencës i nënshtrohet qeverisjes së All'llahut (sepse "Fron" nga ana gjuhësore do të thotë "krevat me këmbë të larta" dhe përdoret vetëm prej qeveritarëve. (Ky është epiteli i qeverisjes absolute të All'llahut). Për t'u njohur më gjerë me kuptimin e fjalës "Fron" në Kur'anin e Lavdishëm, mund të shihet shpjegimi më model, siç është shpjegimi i ajetit 54 i sures "El A'rāf".

Shkaku i përshkrimit të Fronit si Fisnik është se fjala "Fisnik" do të thotë "i ndershëm", "i kujdesshëm" dhe "shumë i mirë". Meqë Froni i All'llahut të Madhërishëm dhe të Lartësuar i ka këto cilësi, ai u quajt Fisnik.

Duhet gjithashtu të themi se fjala "Fisnik" nuk përdoret vetëm për të mençurit, por në gjuhën arabe u vihet edhe të tjerëve veç atyre, siç e tregon surja "El Haxh" në ajetin 50, kur flet për besimtarët

e dobishëm: **“Për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira ka falje dhe dhunti Fisnike”**. Pra, furnizim të begatë, siç thotë Er Ragib El Isfahani në “Mufredatin” e tij, se fjala *“kerijm”* nuk thuhet përveçse për të mirat e shumta, si për shembull për atë që shpenzon para e mall për pajisjen e një ushtrie në rrugën e All’liahut.

Hulumtime

Vdekja nuk është fundi i jetës

Thamë se midis argumenteve të shtruara për të argumentuar Ringjalljen dhe Botën e Përtejme, është edhe “studimi i sistemit të botës”. Ose me fjalë të tjera, studimi i “krijimit të parë” është dëshmi për ekzistencën e krijimit tjetër.

Nga njëra anë, e shohim botën e ekzistencës kaq të gjerë, kaq madhështore dhe të sistemuar e të organizuar në mënyrë kaq të habitshme, saqë edhe shkencëtarët më të mëdhenj kanë pranuar se sekretet e botës janë të mëdha dhe e bëjnë njeriun të pafuqishëm ndaj tyre. Dijet e njeriut, sado të mëdha të jenë, nuk formojnë as edhe një faqe të një libri shumë të madh. Madje njohuritë e tij në lidhje me këtë ekzistencë nuk janë tjetër veçse “abc-ja” e këtij libri madhështor nga krijimi dhe nga të fshehtat e tij.

Çdonjëra prej galaksive madhështore ka miliarda yjësi. Numri i galaksive dhe distancat midis tyre janë kaq të mëdha, saqë të shkaktojnë habi kur i llogarit me shpejtësinë e dritës, duke ditur se shpejtësia e dritës është 300 mijë kilometra në sekondë. Përpikmëria e përdorur në ndërtimin e njësisë më të vogël të kësaj bote në vetvete është përdorur edhe për ndërtimin e të gjitha galaksive me çfarë kanë brenda.

Njeriu, me sa dimë ne, përbën krijesën më të përsosur të ekzistencës. Ai është rezultati më i lartë i kësaj bote, e megjithatë përballet me dhimbje e probleme të shumta gjatë jetës së tij të shkurtër, derisa arrin periudhën më të vështirë të saj. Sapo mbaron periudhën e fëmijërisë, me dhimbjet dhe problemet e saj dhe merr frymë lirisht, kur hyn në etapën e adoleshencës do të rinisë me ulje-ngritjet e saj të forta dhe shkatërruese.

Dhe ende pa zënë vend mirë në këtë etapë, i vjen etapa tjetër plot me lloj-lloj dhimbjesh dhe vështirësish, që është etapa e burrërisë dhe pastaj e pleqërisë. Nga e gjitha kjo, atij i bëhet e qartë se sa i dobët dhe i paaftë është.


A mund të besohet se qëllimi i krijimit të kësaj qenieje madhështore e të habitshme, të jetë thjesht sa për të krijuar një krijesë të quajtur “njeri”, që të vijë në këtë botë për të kaluar disa vite dhe që të kalojë nëpër të gjitha këto etapa plot me dhimbje dhe vështirësi, që të hajë një sasi ushqimi, të veshë rroba, të flejë dhe të ngrihet nga gjumi dhe pastaj të vdesë e të mbarojë çdo gjë? Nëse kjo është e vërteta, atëherë a s’do të thotë se kjo është kotësi?

A mundet që këto krijesa madhështore të bëheshin thjesht për disa qëllime të ulëta, si ngrënia, pirja dhe fjetja?

Imamgjinoni sikur njerëzit të qëndrojnë miliona vite në këtë botë, të ndërrohen breza të tërë, të zhvillohen shkencat e natyrës dhe të sigurojnë me shumicë ushqime, veshje, banim më të mirë dhe ta ngrejë nivelin e mirëqenies njerëzore, por përsëri lind pyetja: A janë krijuar këto forma të ekzistencës vetëm për qëllime tokësore?

Mbi këtë bazë, vetëm studimi i kësaj bote të madhe është provë e qenies së saj vetëm se një parathënie e një bote më të gjerë, që dallohet nga ekzistenca e përhershme, dhe besimi ynë në të i jep kuptimin e përshtatshëm jetës sonë dhe e shpëton atë nga vogëlsirat. Prandaj nuk habitemi nga përfytyrimi i filozofëve materialistë, që nuk besojnë te Kiameti dhe Bota Tjetër dhe që e konsiderojnë këtë botë të pavlerë dhe të paqëllimtë. Nëse edhe ne do të besonim në këtë mënyrë, atëherë edhe ne do të orientoheshim nga rrruga e tyre dhe do të thonim se nëse vdekja është pika e fundit, atëherë krijimi i ekzistencës do kthehej thjesht në diçka të parëndësishme. Prandaj lexojmë në ajetin 62 të sures “El Uāki’a”: **“Sigurisht që ju e dini krijimin e parë (prej një pike fare), atëherë përse nuk mendoni?!”**.

Ajetet 117 - 118



“Ai që pos All’llahut, adhuron zot tjetër, duke mos pasur kurrfarë prove për këtë, me siguri do të japë llogari vetëm te Zoti i tij. Me të vërtetë, nuk ka shpëtim për mohuesit.”

“Dhe thuaj (o Muhammed!): ‘O Zoti im, fal dhe mëshiro, se Ti je më i miri i mëshiruesve!’”

Komentimi

Të fituarit dhe të humburit

Meqë ajetet e kaluara bënë fjalë për çështjen e Ringjalljes dhe paraqitën cilësitë e All'llahut, ajeti i parë, prej ajeteve në fjalë, trajton Njësimin (*Teuhidin*), duke mohuar politeizmin dhe konfirmon parimin dhe Ringjalljen. Ajeti thotë: **“Ai që pos All'llahut adhuron zot tjetër duke mos pasur kurrfarë prove për këtë, me siguri do të japë llogari vetëm te Zoti i tij.”**¹²

Me të vërtetë, idhujtarët politesitë mbështeten tek iluzionet dhe s'kanë asnjë provë për sa pretendojnë, përveçse si papagaj imitojnë etërit e tyre në kapjen pas përrallave dhe legendave që nuk kanë asnjë bazë të vërtetë. Që këtej, ata mohojnë Ringjalljen, pavarësisht nga qartësia e argumenteve të saj dhe ndriçimit të së vërtetës së saj. Ata e pranojnë bërjen shok All'llahut pa asnjë argument të vërtetë. Dhe është e natyrshme që ata të ndëshkohen, sepse kanë shkelur gjykimin logjik me këmbët e tyre dhe kanë marrë drejtimin e rrugëve të errëta të jobesimtarëve dhe të idhujtarëve me ndërgjegje të plotë.

Në fund, ajeti thotë: **“Me të vërtetë, nuk ka shpëtim për mohuesit.”** S'ka më bukur sesa fillimi i kësaj sureje! **“Me të**

¹²Disa komentues mendojnë se shprehja **“me siguri do të japë llogari vetëm te Zoti i tij”** është kushtorja e shprehjes **“Ai që pos All'llahut adhuron zot tjetër”** dhe e konsiderojnë fjalinë **“duke mos pasur kurrfarë prove për këtë”** si fjali kundërshtuese që ka ardhur në mes pyetjes kushtore dhe përgjigjes së saj, që përbën edhe qëllimin përfundimtar. Por disa komentues të tjerë mendojnë se shprehja **“duke mos pasur kurrfarë prove”** është përgjigje për kushtin dhe fjalia **“me siguri do të japë llogari”** është e degëzuar prej saj. Por kjo mundësi nuk harmonizohet me kulturën arabe, që imponon lidhjen e përgjigjes për kushtin me nyjen *“fe”*, kështu që bëhet: *“duke mos pasur kurrfarë prove”*. Komentues të tjerë kanë shkuar deri aty sa të thonë se kjo fjali është mbiemër ose shprehje rrethanore. Por alternativa e parë duket më afër logjikës, megjithëse nuk ka ndonjë ndryshim në kuptim, që të meritonte tërheqjen e vëmendjes.

vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët.” Po ashtu, s’ka më bukur sesa fundi i saj që e konfirmon fillimin: **“nuk ka shpëtim për mohuesit”**. Kjo është pamja e përgjithshme e jetës së besimtarëve dhe e jobesimtarëve nga fillimi deri në fund.

Surja mbyllet me këtë ajet të begatë si përfundim të përgjithshëm, duke iu drejtuar të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): **“Dhe thuaj (o Muhammed): ‘O Zoti im, fal dhe mëshiro, se Ti je më i miri i mëshiruesve!’”**.

Grupi i idhujtarëve e zgjodhi rrugën, grupi tjetër ka humbur rrugën dhe kryen padrejtësi, ti o i Dërguar dhe ata që janë me ty, lutjuni All’llahut, Zotit tuaj, që t’ju falë dhe t’ju mëshirojë me butësinë e Vet të gjerë dhe fisnike.

S’ka dyshim se urdhri për lutje këtu është i përgjithshëm për të gjithë besimtarët, pavarësisht se bashkëbiseduesi këtu është vetë Profeti.

Transmetohet se fillimi i sures: **“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët”** dhe fundi i saj janë prej thesareve të Fronit. Ai vepron sipas tre ajeteve të saj nga fillimi dhe merr këshilla nga katër ajetet e fundit të saj, ai ka arritur të shpëtojë dhe ka fituar.¹³

Ka mundësi që tre ajetet që vijnë pas shprehjes: **“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët”** dhe që bëjnë thirrje për faljen, për evitimin e dërdëllisjeve dhe fjalëve të kota, si dhe i treti për Zekatin, të kenë për synim: i pari, organizimin e marrëdhënieve midis njerëzve me Zotin e tyre; tjetri, organizimin

¹³ Tefsiri “El Kebijr”, vëllimi 23, f. 128, fundi i ajetit në fjalë. Botuar nga shtëpia botuese “El Behijetul Misrijeh” – Kajro.

e këtyre marrëdhënieve me vetë njerëzit, dhe i treti, organizimin e tyre me vetveten.

Kurse qëllimi i katër ajeteve të fundit, duke filluar nga ajeti 115 dhe çfarë e pason, që flasin për qëllimin e krijimit, Ringjalljen dhe Teuhidin dhe për lidhjen e fortë me All'llahun si dhe të drejtuarit kah Ai.

O Zot! Të lutemi me të drejtën e besimtarëve, që u ke premtuar në këtë sure shpëtimin, në pararojë të të cilëve qëndron i Dërguari (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe Ehli Bejtin e tij (Paqja qoftë mbi ta!), të na bashkosh me këtë grup të devotshmish dhe të na shkruash ndër të fituarit!

O Zot! Na shpërble me mëshirën dhe mbrojtjen Tënde sepse Ti je Mëshiruesi i mëshiruesve!

O Zot! Bëje të mirë fundin e veprave tona! Na ruaj nga çdo gabim dhe devijim! Ti je i Plotfuqishmi mbi çdo gjë! Amin, o Zot i botëve!

Fund

Përktheu: **Sulejman Tomçini**

Sure “Nur”

Kjo sure ka zbritur në Medinë dhe ka 64 ajete

Mirësia e sures “En Nur”

Në një hadith të transmetuar prej të Dërguarit të All'Ilahut (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), thuhet: “Atij që lexon suren “En Nur” i jepen shpërblim nga dhjetë të mira, aq sa është numri i të gjithë besimtarëve të kaluar dhe i atyre të tanishëm.”¹⁴

Në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), thuhet: “Përforcojini pasuritë dhe nderin tuaj me këndimin e sures “En Nur”. Me këtë sure ju forconi edhe gratë tuaja; atij që e këndon këtë sure vazhdimisht çdo ditë e çdo natë, derisa të vdesë, nuk do t'i bëjë imoralitet asnjëri prej pjesëtarëve të familjes”.¹⁵

Interesimi i madh për përmbajtjen e sures “En Nur”, qëndron në faktin se në të bëhet thirrje, që të luftohen motivet që çojnë në devijimin nga rruga e drejtë dhe në imoralitet. Gjithashtu, në këtë sure bëhet i qartë qëllimi themelor i hadithit dhe i transmetimit të lartpërmendur si dhe kuptimi i tyre praktik.

Përmbajtja e sures “En Nur”

¹⁴ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 7, f. 122, fillimi i sures “En Nur”.

¹⁵ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, në fundin e ajetit që është objekt studimi; libri “Shpërblimi për punët” i autorit “Es Saduk, f. 109 (sipas asaj që është cituar në tefsirin “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 568).

Kjo sure mund të konsiderohet e veçantë, sepse ajo flet për pastërtinë, virtytin, nderin dhe për luftën kundër degjenerimit moral. Të gjitha mësimet e saj kanë për qëllim pastrimin e shoqërisë prej punëve të ulëta e të turpshme. Kur'ani Famëlartë e realizon këtë objektiv nëpërmjet etapave të mëposhtme:

Etapë e parë: Në të shpjegohet qartë dënimi i ashpër për gruan e për burrin që kryejnë imoralitet, në përputhje të plotë me përmbajtjen e ajetit 2 të kësaj sureje.

Etapë e dytë: Këtu shpjegohet qartë se dënimi ligjor për imoralitetin zbatohet vetëm sipas kushteve shumë shtrënguese. Gjithashtu, në këtë etapë shpjegohet se për zbatimin e dënimit për këtë faj, është kusht të dëshmojnë katër dëshmitarë burra, se ata kanë parë me sytë e tyre të kryejnë imoralitet një burrë e një grua, të huaj për njëri-tjetrin.

Nëse burri dëshmon se gruaja e tij është imorale, por për dëshminë e tij s'ka dëshmitarë, atëherë gjykatësi vendos të zbatohet mallkimi i ndërsjellë, pasi të dy të betohen se thonë të vërtetën.

Gjithashtu, atë që akuzon një grua të martuar për imoralitet dhe nuk sjell katër dëshmitarë okularë, gjykatësi e dënon me katër të pestat e dënimit që parashikon ligji kur bën imoralitet një i pamartuar: të rrihet publikisht me tetëdhjetë goditje me kamxhik lëkure. Kuptohet që kjo masë kaq e rreptë është vënë, me qëllim që askujt të mos i shkojë ndërmend të nëpërkëmbë paprekshmërinë e të tjerëve dhe t'i cënojë ata në nder, duke menduar se do të shpëtojë prej dënimit për akuzën e rreme e të pavërtetuar me dëshminë e katër dëshmitarëve.

Më pas, në këtë sure përshkruhet ndodhia e njohur me emrin “shpifja”, që ka të bëjë me rastin kur u akuzua për imoralitet njëra prej grave të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Menjëherë pas kësaj ngjarjeje, Kur’ani Famëlartë e sqaroi çështjen, duke e bërë të qartë për myslimanët se sa larg mund të shkojë e keqja e shpifjes dhe akuzimi në nder i të tjerëve. Gjithashtu, Kur’ani Famëlartë shpjegon të keqen e madhe që sjell përhapja e akuzës për imoralitet për të goditur nderin e njerëzve. Në vijim, në këto ajete zbulohen edhe llojet e dënimeve hyjnore që e presin cilindo që bën të tilla shpifje e akuza.

Etapa e tretë: Në ajetet e kësaj sureje trajtohet njëra prej rrugëve më të rëndësishme për largimin e degjenerimit moral dhe bëhet e qartë në atë mënyrë, që askush të mos mendojë se Islami interesohet vetëm për dënimin e fajtorëve.

Në këtë sure flitet për shikimet epshore që hedh burri mbi gruan dhe anasjelltas, për veshjen islame të gruas myslimane, sepse shkaqet e degjenerimit moral fillojnë pikërisht me shikimet epshore dhe me veshjen e gruas në kundërshtim me ligjin e fesë islame.

Etapa e katërt: Si hap të parë për të shpëtuar prej ndotjes që sjell mosruajtja e nderit, në Kur’anin Famëlartë bëhet thirrje për martesën me sa më pak shpenzime, me qëllim që të realizohet ngopja e instinkteve në mënyrë të ligjshme.

Etapa e pestë: Ajetet e kësaj sureje e bëjnë të qartë edukatën e bashkëveprimit të ndërsjellë, shpjegojnë parimet për edukimin e fëmijëve dhe moslejimin e tyre për të hyrë në dhomën e prindërve

gjatë orëve kur ata pushojnë e janë në intimitetin e tyre bashkëshortor; ajetet shpjegojnë se fëmijët mund të hyjnë në dhomën e prindërve vetëm me lejen e tyre. Kuptohet se ky rregull ka si qëllim ruajtjen e mendimeve të fëmijëve prej devijimit nga rruga e drejtë. Gjithashtu, ajetet bëjnë të qartë edhe edukatën e përgjithshme të jetës familjare.

Etapa e gjashtë: Në ajetet e kësaj sureje përmenden çështje të veçanta që kanë të bëjnë me Njeshmërinë e All'lahut (*Teuhidin*) – (All'lahu është Zoti Një dhe i Vetëm). Gjithashtu, nëpërmjet Hulumtimeve të shtruara hapur, këtu flitet për parimet e fillimit të krijimit, për Ringjalljen pas vdekjes dhe për përvetësimin e mësimave të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Dihet se besimi që All'lahu është Zoti Një dhe i Vetëm (*vahdâniyet*), besimi në profetësinë, në fillimin e krijimit dhe në Ringjalljen pas vdekjes, të gjitha këto janë në mbështetje të programeve për edukimin moral të individit e të shoqërisë. Kjo do të thotë se besimi në Njeshmërinë e All'lahut është baza, kurse punët e tjera janë degë që mbështeten mbi të. Ajetet e kësaj sureje sqarojnë se, sa më shumë që të forcohet baza, aq më shumë mbushen degët me gjethe e japin fruta.

Hulumtimet mbi këto ajete flasin edhe për qeverinë botërore të besimtarëve punëmirë si dhe për shumë mësim të tjera islame.

"Sure, të cilën Ne e zbritëm dhe Ne bëmë obligim të domosdoshëm (zbatimin e dispozitave që theksohen), në këtë sure Ne paraqitëm dispozita të qarta që ju të merrni mësim."

"(është dispozitë obliguese): laviren e lavirin t'i rrihni secilin prej atyre të dyve me nga njëqind të goditura dhe, nëse me të vërtetë keni besuar në All'llahun e në Ditën e Gjykimit, mos u tregoni zemërbutë ndaj atyre të dyve në zbatimin e dispozitave të All'llahut; gjatë zbatimit të dënimit të atyre të dyve le të jenë të pranishëm një grup prej besimtarëve."

"Laviri nuk martohet me asnjë tjetër përveçse me një lavire, ose me një idhujtare; edhe lavirja nuk martohet me asnjë tjetër përveçse me një lavir, ose me një idhujtar, pasi kjo (martesa me ata që bëjnë imoralitet) është e ndaluar për besimtarët."

Komentimi

Masa e dënimit ligjor për laviren dhe lavirin

Kjo sure është emërtuar "En Nur" - "dritë", sepse ajeti i dritës është prej ajeteve më të rëndësishme që spikat në të, duke shtuar se përmbajtja e saj e shtrin ndriçimin edhe në çështje që kanë të bëjnë me nderin e me pastërtinë e burrit, gruas, familjes, me ngrohtësinë e me devotshmërinë e njerëzve. Ajetet e kësaj sureje u japin jetë zemrave me Njësimin e All'llahut (*Teuhidin*), me

besimin në Ringjalljen pas vdekjes, si dhe me besimin në thirrjen e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Në ajetin e parë të kësaj sureje thuhet: **“Sure, të cilën Ne e zbritëm dhe Ne bëmë obligim të domosdoshëm** (zbatimin e dispozitave që theksohen); **në këtë sure Ne paraqitëm dispozita të qarta që ju të merrni mësim.”**.

Fjala “*suretun*” është marrë prej fjalës “*sùur*”, që do të thotë: “*mur i lartë*”. Më pas, fjala “*sùur*” është përdorur për muret që rrethonin qytetet për t’i mbrojtur prej sulmeve të armiqve, pasi ato e ndanin qytetin prej zonës përreth. Gradualisht, fjala “*suretun*” – “*sure*” filloi të përdoret për të treguar çdo kaptinë prej 114 kaptinave (sureve) të Kur’anit Famëlartë. Disa prej gjuhëtarëve kanë thënë se fjala “*suretun*” tregon një ndërtesë të madhe e të lartë. Gjithashtu, kjo fjalë përdoret edhe për çdo pjesë të një ndërtese të lartë, ashtu siç përdoret edhe për pjesët e ndryshme të Kur’anit, për të treguar se ato janë të ndara nga njëra-tjetra.¹⁶

Sido që të jetë, kjo shprehje tregon se në këtë sure ka dispozita dhe tema që trajtojnë çështje të besimit, të edukatës, urdhra hyjnorë me një rëndësi tepër të madhe dhe të gjitha këto janë prej All'llahut të Lartësuar.

Këtë kuptim e përforcon fjala e ajetit: “*feradnàhà*” - **“Ne i bëmë ato obligim.”**. Rrënja e kësaj fjale është “*fard*”, që do të thotë “*prerja e një sendi të fortë dhe ushtrimi i forcës mbi të*”, ashtu siç e ka shpjeguar Ragibi në fjalorin e tij “*Muferdàtu Elfàdhil-Kur’àn*”.

¹⁶ Fjalori: “*Lisànul arab*”. Vëll I. 4, lënda: “*sùur*”.

Fraza e ajetit: **“dispozita të qarta”**, mund të jetë një shenjë treguese për të ecur në rrugën e të vërtetave, që vijnë menjëherë pas besimit në Njësimin e All'lahut (*Teuhid*), si: besimi në fillimin e krijimit, në Ringjalljen pas vdekjes dhe në profetësinë. Fraza *“feradnâhâ”*, **“Ne i bëmë ato obligim”**, thekson se urdhrat hyjnorë dhe dispozitat e ligjit të fesë, shpjegohen në këtë sure me qartësinë më të madhe. Thënë ndryshe, një pjesë e ajeteve të kësaj sureje trajtojnë çështje të besimit dhe pjesa tjetër dispozitat e ligjit të fesë.

Fraza e këtij ajeti: **“dispozita të qarta”**, mund të ketë edhe kuptimin: argumente të mbështetura mbi këto dispozita të ligjit të fesë.

Kurse fraza e ajetit **“që ju të merrni mësim”**, thekson akoma më shumë se rrënjët e besimit të vërtetë dhe mësimet praktike të Islamit, e kanë zanafillën qysh në krijimin e pastër të njerëzimit.

Për të gjitha këto, fundi i këtij ajeti konsiderohet si një lloj kujtese për të marrë mësim.

Pas këtij parashtrimi në vija të përgjithshme, kjo sure shpalos dispozitën e parë, urdhrin e formës së prerë në lidhje me laviren e lavirin: **“Laviren e lavirin t'i rrihni, secilin prej atyre të dyve me nga njëqind të goditura.”**.

Për të theksuar akoma edhe më shumë rëndësinë e kësaj dispozite, ajeti përsëri urdhëron: **“dhe, nëse me të vërtetë keni besuar në All'lahun e në Ditën e Gjykimit, mos u tregoni zemërbutë ndaj atyre të dyve në zbatimin e dispozitave të All'lahut.”**.

Me qëllim që të plotësohet kuptimi i rezultatit për këtë ndëshkim hyjnor, në fundin e ajetit bëhet fjalë edhe për një çështje tjetër: **“gjatë zbatimit të dënimit të atyre të dyve le të jenë të pranishëm një grup prej besimtarëve.”**.

Në këtë sure janë përfshirë tre mësimë:

1- Dispozita për dënimin e grave dhe të burrave që praktikojnë imoralitetin.

2- Zbatimi i kësaj dispozite hyjnore larg ndjenjës së zemërbutësisë për atë që ngarkohet me zbatimin e dënimit. Zemërbutësia në zbatimin e ligjit të All'llahut është zemërbutësi e rreme dhe çon në prishjen dhe degradimin e shoqërisë. Prandaj, Kur'ani Famëlartë e ka vënë besimin në All'llahun e në Ditën e Llogarisë përballë zemërbutësisë që mund të shfaqet ndaj lavirit ose lavires, në kohën e zbatimit të dispozitës së ligjit të fesë mbi ata të dy. Në të vërtetë, zbatimi i dispozitave hyjnore pa u ndikuar prej ndjenjave, tregon besimin e vërtetë në fillimin e krijimit dhe në Ringjalljen pas vdekjes, besimin e plotë në All'llahun, të Gjithëditurin, të Urtin; duke besuar plotësisht se çdonjëra prej dispozitave të All'llahut është vënë për një qëllim shumë të lartë dhe me një objektiv shumë të qartë. Veç kësaj, besimi në Ditën e Gjykimit, bën që njeriu të ndjejë përgjegjësi për çdo veprim që është në kundërshtim me dispozitat e All'llahut të Lartësuar.

Me këtë rast përmendim një hadith të ardhur prej të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ku thuhet: “Një qeveritar urdhëron që dënimi ligjor të zbatohet, duke e rrahur të dënuarin me një goditje më pak; këtij qeveritari, në Ditën e Llogarisë para All'llahut të Lartësuar do t'i

thuhet: *Përse e bëre këtë?* Ai do të thotë: *Si mëshirë për robtë e Tu; atëherë, atij do t'i thuhet: A je më i mëshirshëm se Unë?* Për këtë qeveritar urdhërohet që të futet në zjarr. Një qeveritar tjetër urdhëron që dënimi ligjor të zbatohet, duke e rrahur të dënuarin me një goditje më shumë. Edhe këtij qeveritari do t'i thuhet: *Përse e bëre këtë?* Ai do të përgjigjet: *Që ata të mos e kundërshtojnë më urdhrin Tënd!* Atëherë, All'llahu do t'i thotë: *A ke ti më shumë urtësi sesa Unë në vënien e dispozitave?* Edhe për këtë do të urdhërohet që të futet në zjarr".¹⁷

3- All'llahu e ka bërë obligim praninë e një numri besimtarësh në sheshin ku do të zbatohet dënimi ligjor për lavirin dhe laviren, me qëllim që njerëzit të marrin mësim, kur të shohin me sytë e tyre zbatimin e drejtë të dispozitës së All'llahut mbi fajtorët.

Duke hedhur një vështrim mbi rrethin shoqëror të njerëzve, konstatohet se degjenerimi moral i një individi nuk mbetet vetëm tek ai, por depërton edhe te të tjerët. Prandaj, për të plotësuar pastrimin, duhet që dënimi të zbatohet patjetër në prani të një grupi besimtarësh, pra në sytë e njerëzve, ashtu siç e kryen haptazi edhe ata të dy fajin e rëndë.

Me këtë shpjegim bëhet e qartë edhe përgjigjja për pyetjen: Përse Islami e çon respektin për njeriun deri në kufirin e ofendimit e të fyerjes publike? Për këtë jepet shpjegimi vijues: derisa faji i kryer në fshehtësi nuk është marrë vesh prej njerëzve dhe nuk ka arritur në derën e gjykatësit, atëherë nuk ka ndonjë problem që fajtori ta mbajë të fshehur fajin në brendësi të vetes; por ai e ka

¹⁷ Tefsiri "Kebijr", vëll 23, f. 148.

detyrë që të pendohet menjëherë dhe t'i kërkojë All'llahut falje për të. Për këtë gjendje, edhe All'llahu e mbulon atë faj me dashamirësinë e Tij dhe e do atë që e mbulon fajin. Por kur faji bëhet i njohur me argumente ligjore, atëherë duhet të zbatohet patjetër dënimi në përputhje me dispozitën hyjnore. Zbatimi i dënimit për këtë faj ka si qëllim zhdukjen sa më shpejt të ndikimit të keq të atij faji, përndryshe e keqja e pallogaritshme e tij do të ketë terren të lirë për t'u përhapur. Shoqëria e shëndoshë e ka detyrim që t'i kushtojë rëndësi zbatimit të dispozitave të ligjit fetar, sepse përsëritja e një faji të tillë, jo vetëm që është një sfidë për dënimin e parashikuar në dispozitat ligjore, por bën që të humbë efekti i atyre dispozitave në lidhje me ruajtjen e sigurisë e të qetësisë në shpirtrat e njerëzve. Duke u nisur nga kjo e vërtetë, bëhet detyrim që dënimi i parashikuar në dispozitën e ligjit të fesë, të zbatohet haptazi, me qëllim që kur të shohin me sytë e tyre ndëshkimin e fajtorit, njerëzit do të frenohen dhe do të qëndrojnë larg rrugëve që çojnë tek kjo e keqe e madhe.

Shumë njerëzve u intereson më shumë të mburren para të tjerëve me "bëmat" e tyre, në vend që të ruhen prej dënimit që mund të zbatohet mbi ta, për shkak të asaj vepre të keqe që kanë bërë. Pikërisht për këtë shkak, është bërë detyrim që dënimi ligjor për imoralitetin të zbatohet në prani të njerëzve. Zbatimi para njerëzve i kësaj dispozite hyjnore, me siguri që i ndalon punëkëqinjtë që të vazhdojnë në imoralitet. Nga ky këndvështrim, zbatimi i ndëshkimit të parashikuar në dispozitën e ligjit të fesë në prani të njerëzve, do të jetë një frenues i fuqishëm.

Pas shpjegimit të dispozitës për zbatimin e ndëshkimit për imoralitetin, në ajetin e dytë të grupit të ajeteve që janë objekt i studimit tonë, vjen edhe dispozita e martesës me personat mbi të

cilët është zbatuar dispozita e ligjit të fesë për imoralitet: **“Laviri nuk martohet me asnjë tjetër përveçse me një lavire, ose me një idhujtare; edhe lavirja nuk martohet me asnjë tjetër përveçse me një lavir, ose me një idhujtar, pasi kjo (martesa me ata që bëjnë imoralitet) është e ndaluar për besimtarët.”**.

Interpretuesit e Kur'anit Famëlartë kanë kundërshtime në mesin e tyre, në lidhje me faktin nëse ky ajet është një shpjegim për një dispozitë hyjnore, apo një njoftim për një çështje të natyrshme.

Disa mendojnë se ajeti bën të qartë vetëm një prirje konkrete dhe njofton se të degjeneruarit preferojnë të degjeneruarat dhe anasjelltas. Kurse besimtarët e pastër qëndrojnë mbi këto, prandaj ata nuk ia lejojnë vetes që të martohen me gra të kësaj kategorie, gjithnjë për të ruajtur pastërtinë e tyre. Ky është edhe kuptimi që dëshmojnë fjalët e ajetit, megjithëse ai ka ardhur në formën e një fjalie kallëzore.

Një pjesë tjetër e interpretuesve të Kur'anit Famëlartë, shohin në këtë fjali të ajetit, një dispozitë ligjore dhe një urdhër hyjnor, që i ndalon besimtarët të martohen me laviret, si dhe besimtarët që të martohen me lavirët, sepse devijimet morale në të shumtën e herës janë si sëmundjet infektive, pa harruar se janë edhe një turp i madh. Prandaj, besimtarët kujdesen që të qëndrojnë sa më larg rrugëve që çojnë në imoralitet.

Këtu duhet të shtojmë edhe të ardhmen e errët e të dyshimtë të fëmijëve të lindur në mjedise të ndotura e të dyshimta; çfarë i pret fëmijët e lindur prej martesës me gratë imorale?!

Pikërisht për shkak të këtyre veçantive, Islami e ka ndaluar për besimtarët martesën me personat mbi të cilët është zbatuar ndëshkimi ligjor për imoralitet.

Argument për këtë ndalim është vetë fraza e ajetit: “**...pasi kjo** (martesa me ata që bëjnë imoralitet) **është e ndaluar për besimtarët**”. Siç shihet, edhe kjo frazë e ndalon në mënyrë kategorike imoralitetin.

Argumenti i fundit që vërteton se imoraliteti është punë e ndaluar rreptësisht (haram), janë hadithet e shumta të transmetuara prej Profetit më të nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), si dhe transmetimet e ardhura prej Imamëve të ruajtur prej mëkateve. Hadithet e transmetimet e shpjegojnë këtë ajet dhe e konsiderojnë një dispozitë hyjnore, që shprehet tekstualisht për ndalimin e formës së prerë të imoralitetit.

Edhe interpretuesit e mëdhenj të Kur'anit Famëlartë kanë shkruar në lidhje me shkakun e zbritjes së këtij ajeti dhe kanë thënë: Një burrë prej myslimanëve i kërkoi leje të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që të martohej me një grua të quajtur “Um'm Mehzul”, e cila ishte e deklaruar si prostitutë, madje në portën e shtëpisë së saj kishte edhe një flamur (shenjë që tregonte se aty jeton një prostitutë). Pas kësaj ngjarjeje, zbriti ajeti i mësipërm.¹⁸ Hadithi është transmetuar prej Ibni Ab'bàsit, Ibni Umerit, Muxhàhidit, Katàdes dhe Ez Zehrij'jit. Duhet theksuar se qëllimi në fjalët e këtij ajeti, është

¹⁸ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 7, f. 125, fundi i ajetit që është objekt studimi; tefsiri i “Kurtubij'jit”, në komentimin e këtij ajeti, prej ku është cituar edhe hadithi.

ndalimi i formës së prerë, edhe pse në dukje, siç u tha më sipër, ajeti është në formën e fjalisë kallëzore.

Këtë që u tha e përforcojnë edhe transmetimet e ardhura prej Imam Bakirit dhe prej Imam Sadikut, të cilët kanë thënë: “Ata janë burra e gra që kanë jetuar në kohën e të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe që njiheshin si praktikues të prostitucionit. Kur'ani e shpalli këtë kategori burrash e grash të ndaluar për besimtarët. Prandaj, kushdo që i përket kësaj kategorie dhe mbi të është zbatuar dënimi për imoralitet, dispozita e ligjit të fesë urdhëron ndalimin taksativ dhe thotë: Mos bëni martesë me atë njeri, derisa të mësohet se ai është penduar dhe ka bërë “*teube*”.¹⁹

Shumë prej dispozitave kanë ardhur në formën e fjalive kallëzore, sepse nuk është e domosdoshme që fjalia të jetë urdhërore për kryerjen ose moskryerjen e një veprimi.

Vlen të tërheqim vëmendjen se në atë kohë politeistët shfaqnin zemërbutësi e dashamirësi ndaj imoralëve, çka vërteton se imoraliteti dhe idhujtaria janë si dy binjakë që ngjajnë me njëri-tjetrin. I Dërguari më i nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “*Laviri nuk bën imoralitet duke qenë besimtar; ashtu edhe hajduti nuk vjedh duke qenë besimtar. Kur i bëjnë këto punë, prej tyre zhvishet besimi, ashtu siç hiqet këmisha prej trupit*”.²⁰

¹⁹ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan” vëll. 7, f. 125, fundi i ajetit që është objekt studimi.

²⁰ “Usûlul Kâfij”, vëll. 2, f. 32 (shtypshkronja “Dârul-kutubil-islamij’jeh”, botim i vitit 1388 H); sipas asaj që është cituar prej tefsirit “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 571.

Hulumtime

1- Rastet kur mbi imoralin zbatohet dënimi sipas dispozitës ligjore

Në ajetin e nderuar është përmendur dispozita në përgjithësi, por prej saj përjashtohet imoraliteti nga ana e të martuarit dhe e të martuarës, sepse dënimi për këta të fundit është ekzekutimi, në rastin kur vërtetohet kryerja e krimit.

Në tekstin e Kur'anit, fjalët "*i martuar*" dhe "*e martuar*" jepen në format "*muhas'san*" për burrin dhe "*muhas'saneh*" për gruan, në kuptimin "*i mbrojtur*" dhe "*e mbrojtur*"; nga ky kuptim, burri i mbrojtur është ai që ka një grua, e cila jeton së bashku me të. Gjithashtu, grua e mbrojtur është gruaja e martuar dhe burri jeton së bashku me të; pra janë konditat e plota për plotësimin e nevojave të instinktit në rrugë ligjore dhe, nëse të martuarit bëjnë imoralitet, mbi ata zbatohet dispozita e ligjit të fesë dhe dënimi i tyre është ekzekutimi.

Me ekzekutim dënohet edhe incesti (kryerja e marrëdhënieve seksuale me femrën, me të cilën burri e ka të ndaluar të martohet).

Edhe prostitucioni me dhunë e detyrim, ose me rrëmbim, dënohet me ekzekutim. Në disa raste, masa e dënimit është rrahja dhe internimi. Gjithashtu, për dënimet e parashikuara në dispozitën për dënimin e atyre që bëjnë imoralitet, ka edhe dispozita të tjera, të cilat trajtohen në librat e *fikhut* - jurisprudencës islame.

2- Përse lavirja është përmendur e para?

Imoraliteti është një veprim që bie ndesh me nderin dhe qëndron në shkallën më të ulët të veprimit të keq; madje e keqja për gruan është edhe më e rëndë, sepse nderi i saj është më i rëndësishëm sesa nderi i burrit. Prandaj, dalja kundër këtij rregulli, në të vërtetë është një rebelim shumë i madh e shumë i rëndë, duke shtuar se përfundimi i shëmtuar i imoralitetit është më i rëndë dhe më i madh për gruan, ndonëse e keqja e këtij veprimi të ulët është e rëndë si për gruan, ashtu edhe për burrin.

Ka më shumë mundësi që gruaja të jetë burimi i tundimit dhe i joshjes, që çon në kryerjen e imoralitetit. Prandaj në shumë raste, gruaja konsiderohet si shkaku origjinal për kryerjen e këtij krimi. Pikërisht për këtë të vërtetë, edhe ajeti i nderuar ka përmendur në fillim laviren dhe pastaj lavirin. Për të gjitha këto të këqija që sjell imoraliteti, gratë e ndershme besimtare dhe burrat e ndershëm besimtarë, u qëndrojnë larg rrugëve që çojnë në të tilla punë të ndaluara.

3- Përse zbatohet dënimi haptazi?

Ajeti i nderuar ka ardhur në mënyrën urdhërore, pra e bën të detyrueshme praninë e një grupi prej besimtarëve në zbatimin e dënimit për imoralitet. Megjithatë, Kur'ani nuk e ka vënë kusht që dënimi të kryhet patjetër në prani të shumë njerëzve, por këtë e ka lënë sipas rasteve. Është e mjaftueshme edhe prania e tre personave ose edhe më shumë, nëse vendoset kështu nga gjykatësi.²¹

Filozofia e kësaj dispozite është e qartë, sepse:

E para: Synohet që vendimi për zbatimin e dispozitës të jetë një mësim për të gjithë njerëzit dhe një shkak për pastrimin e shoqërisë.

E dyta: Turpërimi i fajtorit të jetë një ndalues për kryerjen e këtij faji në të ardhmen.

E treta: Kur dënimi zbatohet në praninë e një grupi njerëzish, gjykatësi dhe të ngarkuarit me zbatimin e ligjit, nuk mund të akuzohen me asnjë lloj akuze, si për shembull për marrje ryshfeti, marrëveshje të përkohshme, diskriminim në zbatimin e dënimit, ose akuza të tjera të ngjashme me to.

E katërta: Prania e një grupi njerëzish pengon kokëfortësinë dhe lënien mangët në zbatimin e dënimit.

E pesta: Prania e një grupi njerëzish ndalon përhapjen e zërave dhe të akuzave kundër gjykatësit. Gjithashtu, e ndalon

²¹ Disa interpretues të Kur'anit dyshojnë në lidhje me çështjen e pranisë së një grupi prej besimtarëve në kohën e zbatimit të dënimit për imoralitet, ndërkohë që urdhri për praninë e tyre është fare i qartë, por kjo nuk ka qëllim të thotë se prania e tyre është në shkallën e veprimit të preferuar (*mustehab*).

kriminelin që në të ardhmen të bëjë punë që e shkatërrojnë shoqërinë. Këtu duhen shtuar edhe dobitë e tjera që ka prania e një grupi njerëzish gjatë zbatimit të dënimit mbi fajtorin.

4- Si ishte masa e dënimit në të kaluarën për imoralitetin?

Ajetet 15 dhe 16 të sures *“En Nisa”* njoftojnë se para zbritjes së sures *“En Nur”*, dënimi për laviren ishte burgim i përjetshëm, ashtu siç thuhet në ajetin **“...i mbyllni ato në shtëpitë derisa të vdesin”**; kurse për lavirin e pamartuar ajeti urdhëron që të ndëshkohet, por pa e caktuar masën e këtij ndëshkimi. Me zbritjen e sures *“En Nur”*, dënimi me burgim të përjetshëm për gruan e martuar u zëvendësua me ekzekutimin e saj. Gjithashtu, u caktua edhe masa e ndëshkimit për të pamartuarin me njëqind rrahje me kamxhik. (Për informacione më të zgjeruara, lexo tefsirin *“Komentimin i Përsosur i Kur'anit”* në Komentimin e ajeteve 15 dhe 16 të sures *“En Nisa”*.)

5- Ndalimi i tejkalimit të masës dhe lënia mangët në zbatimin e dënimit

Njeriu duhet të mos ndikohet nga ndjenjat njerëzore, në mënyrë që ai të mos preket nga asnjë lloj mendimi që mund të jetë në kundërshtim me zbatimin e ndëshkimit që urdhëron dispozita e ligjit të fesë. Prandaj kërkohet që nxjerrja e vendimeve në lidhje me dënimin, të jetë patjetër në përputhje të plotë me dispozitën hyjnore dhe, kur faji vërtetohet, duhet të tregohet patjetër vendosmëri pa asnjë ndikim prej ndjenjave njerëzore të rreme dhe

të veprohet vetëm sipas së drejtës. Përndryshe, valët e së keqes do të sjellin një dëm shumë të madh mbi sistemin shoqëror.

Nëse shohim me kujdes në këtë ajet të nderuar, do të vërejmë se në të ka ardhur edhe fraza, **“keni besuar në All'Ilahun”**, domethënë: kur vendimi ka ardhur prej All'Ilahut, s'ka dyshim se ai është akoma më i qartë dhe shumë më i arsyeshëm se pozitat e zemërbutësisë e të mëshirës nga ana e zbatuesve të dispozitës hyjnore. Kjo frazë e ajetit tregon qartë se vetëm atëherë kur mbaron shfaqja e ndjenjave për zbutjen e dënimit dhe për zbatimin e një dispozite ligjore, që është vënë për të mirën e shumicës së njerëzve, besimi bëhet zotërues në mendjet e tyre. Megjithatë, ekziston edhe një pakicë që anon nga ushtrimi i dhunës, mirëpo ky anim shpreh një devijim prej thirrjes së Zotit të Gjithëfuqishëm, të Urtit, të Cilit nuk i mungon asgjë dhe që s'ka nevojë për asgjë nga drejtësia e bamirësia që janë aq të dukshme. Kështu që nuk mbetet rrugë tjetër, përveç zbatimit të dispozitave të All'Ilahut, si të vetmet udhëzuese në rrugën e drejtë; prandaj, myslimani nuk duhet as të shtojë e as të pakësojë ndonjë gjë gjatë zbatimit të dispozitës që ka vënë All'Ilahu i Gjithëpushtetshëm.

6- Kushtet e ndalimit të martesës me laviren dhe lavirin

Më sipër thamë se është e ndaluar martesa me laviren dhe lavirin. Gjithashtu, hadithet e nderuara e kanë specifikuar këtë kusht në lidhje me ata që janë të deklaruar për praktikimin e imoralitetit dhe që nuk kanë bërë *teube*. Hadithet shpjegojnë qartë se kur lavirja e laviri nuk janë të njohur si praktikues të këtij veprimi të keq, ose kanë hequr dorë prej tij, e kanë pastruar veten prej imoralitetit dhe e ruajnë nderin e tyre, në këtë gjendje s'ka asnjë pengesë martesa me ta.

Në rastin e dytë, pra kur ata janë penduar dhe kanë bërë *teube*, nuk është i përshtatshëm cilësimi i tyre si lavir e lavire, sepse ajo gjendje për ta ishte e përkohshme dhe tashmë ka kaluar. Kurse për rastin e parë, ka ardhur ky kusht në transmetimet islame, kusht të cilin e përforcon edhe shkaku i zbritjes së ajeteve që janë objekt studimi. Në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) tregohet se atë e ka pyetur juristi i dëgjuar Zuràreh për Komentimin e ajetit: **“Laviri nuk martohet me asnjë tjetër përveçse me një lavire”** dhe Imami i ka thënë: *“Me gra dhe burra të njohur si praktikues të imoralitetit, me njerëz të kësaj kategorie, ose me ata mbi të cilët është zbatuar dënimi i parashikuar në dispozitën për praktikuesit e imoralitetit ose me atë që njihet si lavir, është e ndaluar martesa derisa të mësohet se ai/ajo është penduar dhe ka bërë teube.”*²² Ka edhe transmetime të tjera që kanë ardhur në këtë kuptim.

7- Filozofia e ndalimit kategorik të imoralitetit

Për askënd nuk është e panjohur e keqja e prostitucionit mbi individin e mbi shoqërinë; megjithatë, e gjykojmë të domosdoshme të shpjegojmë kuptimin e kësaj të keqeje fare shkurt, duke thënë: Ushtrimi i imoralitetit dhe përhapja e këtij veprimi të shëmtuar, e çon familjen drejt shkatërrimit.

Edhe marrëdhëniet bir-baba, kjo e keqe e madhe i bën të errëta dhe negative.

²² “Uesailu Shija”, vëll. 14, f. 325.

Përvoja ka treguar se fëmijët, të cilëve nuk u dihet prejardhja, shndërrohen në keqbërës të rrezikshëm për shoqërinë.

Gjithashtu, ky veprim kaq i keq çon në përplasje në mesin e atyre që ndjekin pasionet e dëshirat me rrugë joligjore.

Përveç kësaj, edhe përhapja e llojeve të ndryshme të sëmundjeve psikike dhe të lëkurës të shkaktuara nga ushtrimi i prostitucionit. Këto lloj sëmundjesh nuk janë të panjohura për njerëzit.

Prej rezultateve të mënxyrshme të prostitucionit është edhe dështimi i barrës së nënave dhe kryerja e krimeve të kësaj natyre. (Për më shumë informacion, lexo tefsirin “Komentimim i Përsosur i Kur’anit” në Komentimin e fundit të ajetit 32 të sures “El Isra”)

Komentimi

Dënimi për shpifjen

Njerëz me qëllim të keq mund të shfrytëzojnë atë që është shkruar tekstualisht në ajetet e mëparshme, në lidhje me zbatimin e dënimit të ashpër që parashikon dispozita e All'Ilahut për laviren dhe lavirin. Qëllimkëqinjtë mendojnë se për ta është punë e lehtë, që të shpifin për gratë e martuara krejtësisht të pastra; por ajetet vijuese theksojnë dënime të ashpra për ata që shpifin për nderin e grave të martuara dhe që e sfidojnë këtë dispozitë të ligjit të All'Ilahut për qëllimet e tyre të ulëta. Në dy ajetet që janë objekt studimi, ka ardhur shpjegimi i qartë për ruajtjen e paprekshmërisë së grave të martuara e të ndershme. Për të ruajtur respektin ndaj këtyre grave prej të ligës së ngatërrestarëve, ajeti i nderuar njofton: **“Dhe ata që shpifin për gratë e ndershme e nuk sjellin katër dëshmitarë”**, domethënë për ata që akuzojnë gratë e ndershme për një punë që është në kundërshtim me nderin – pra i akuzojnë ato për imoralitet – nëse nuk sjellin katër dëshmitarë, burra të drejtë, që të vërtetojnë pretendimet e akuzuesve, dispozita për këta akuzues është: **“...ata t'i rrihni me nga tetëdhjetë të goditura...”** dhe në vijim, ajeti shton edhe dy dispozita të tjera: **“...dhe kurrë mos e pranoni dëshminë e tyre; të këtillë janë të pabesueshëm.”**.

Me këtë dispozitë, personat shpifës, jo vetëm që do të vuajnë ndëshkimin e rëndë fizik, por ajeti urdhëron që fjala e dëshmia e tyre të mos merren në konsideratë, me qëllim që në të ardhmen, ata të mos kenë mundësi të luajnë me nderin e të tjerëve. Me zbatimin e kësaj dispozite mbi këta shpifës, e keqja që ata bënë tashmë është damkosur në ballin e tyre dhe puna e tyre në shoqëri është diskredituar. Të gjitha këto masa merren për të ndaluar punëkëqinjtë, që ata të mos njollosin emrin e mirë që gëzojnë njerëzit e pastër.

Ky shtrëngim kaq i rëndë në dispozitën ligjore për të ruajtur nderin e pastërtinë e individit, nuk është i veçantë vetëm për çështjen e akuzës së rreme për imoralitet. Në shumë mësimë islame, ne vëmë re interesin e madh që i kushton Islami ruajtjes së nderit të gruas së pastër besimtare dhe të burrit të pastër besimtar.

Në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut thuhet: *“Kur besimtari akuzon vëllain e tij, besimi tretet në zemrën e tij (akuzuesit), ashtu siç tretet kripa në ujë”*.²³

Por Madhështori, i Gjithëpushtetshmi, i Urti, i Lartësuari, të Cilit nuk i mungon asgjë dhe që s'ka nevojë për asnjë send, nuk e mbyll kurrë portën e mëshirës së Tij për ata që pendohen, që kërkojnë falje për fajet dhe që punojnë për të pastruar veten e tyre. Gjithashtu, porta e pendimit është e hapur edhe për ata që i kanë lënë mangët punët që kishin detyrim të kryenin dhe, për këtë, ata nxitojnë t'i kompensojnë ato ashtu siç duhet.

²³ “Usulul Kafij”, vëll. 2, f. 269, kapitulli: “Akuza dhe mendimi i keq për tjetrin”.

Në ajet thuhet: **“Me përjashtim të atyre që më vonë pendohen e përmirësohen; me të vërtetë, All'llahu është shumë Falës dhe Mëshirues.”**.

Interpretuesit e Kur'anit kanë mendime të ndryshme në lidhje me faktin nëse ky përveçim i referohet frazës së ajetit para këtij: **“të këtillë janë të pabesueshëm”**, apo frazës tjetër të ajetit: **“dhe kurrë mos e pranoni dëshminë e tyre”**. Nëse përveçimi u referohet të dyja frazave, kjo do të thotë se pranimi i dëshmisë dhe heqja e damkosjes së tyre si njerëz të pabesueshëm, arrihet vetëm pasi ata kanë bërë *teube* e janë penduar; por nëse përveçimi i referohet frazës së fundit, do të thotë se gjykimi i tyre si njerëz të pabesueshëm bie prej tyre në të gjitha dispozitat islame. Megjithatë, dëshmia e tyre do të vazhdojë të mbetet pa vlerë derisa të jenë gjallë dhe prej tyre nuk do të pranohet kurrë asnjë dëshmi.

Duhet sqaruar se në parimet e bazave të *fik'hut* Islam (jurisprudencës islame) thuhet: përveçimi i ardhur pas disa frazave, i referohet frazës së fundit, me përjashtim të rasteve kur ka shembuj krahasues që shprehen se përveçimi përfshihet në të gjitha këto fraza. Pikërisht këtu gjendet një shembull i tillë, domethënë: kur bie gjykimi për pabesueshmëri prej një personi, për shkak të *teubes* që ai ka bërë dhe pendimit që ka shprehur para All'llahut të Lartësuar, atëherë nuk mbetet më argument për të mos pranuar dëshminë e tij, sepse mospranimi ishte për shkak të shpifjes; por kur bëri *teube* dhe iu rikthye cilësia e drejtësisë, ai nuk mund të quhet më njeri i pabesueshëm.

Transmetimet e ardhura prej Ehli Bejtit e forcojnë këtë kuptim. Transmetohet prej Ahmed bin Muhammedit, prej Hysen

bin Seidit, prej Nadr bin Suuejdit dhe Ham'màdit se Kasim bin Sulejmani ka thënë: "E pyeta Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që shpifi në nder për një burrë tjetër. Burri shpifës u ndëshkua për këtë shpifje, por më pas ai bëri *teube* dhe prej tij dimë se ka bërë vetëm punë të mira. I drejtova pyetjen: *A është e vlefshme dëshmia e këtij personi?* Imami më tha: *Po çfarë thuhet te ju për këtë?* Unë i thashë: *Thonë se pendimi i tij është midis atij dhe All'Ilahut dhe se dëshmia nuk i pranohet kurrë.* Ai më tha: *Shumë keq kanë thënë! Babai im thoshte: Kur ai bën teube dhe prej tij dimë që bën vetëm punë të mira, dëshmia e tij është e lejuar*".²⁴

Në lidhje me këtë çështje kanë ardhur edhe transmetime të tjera që shprehin të njëjtin kuptim, por ka vetëm një transmetim që mundëson ruajtjen.

Është e domosdoshme të theksojmë se në tekstin e Kur'anit në ajetin **"dhe kurrë mos e pranoni dëshminë e tyre"**, fjala *"ebeden"* - *"kurrë"* është një argument që tregon se dispozita është përgjithësuese, prandaj mendimi që fjala e ajetit *"kurrë"* e ndalon ndikimin e *teubes*, është i gabuar.

Hulumtime

1- Qëllimi me fjalën "shpifin"

²⁴ "Uesailu Shija", vëll. 18, f. 282, libri: "Dëshmitë", kapitulli nr. 36.

Në tekstin e ajetit, fjala “shpifin” ka ardhur si folje e vetës së tretë, në kohën e tashme të numrit shumës “jermùne”. Kjo fjalë në rrënjën e saj do të thotë “qëllon me shigjetë”, ose “gjuan me gurë”; shpifësi në të shumtën e kohës, me shpifjen që bën, në fakt qëllon e poshtëron të tjerët. Kjo fjalë këtu është përdorur si e barasvlershme me fjalën “akuzon”, i shan të tjerët dhe i përshkruan ata me cilësi që nuk janë aspak të vërteta. Prandaj të gjitha akuzat, sharjet e fjalët e tij, janë si shigjeta me të cilat qëllohet mbi një person dhe e plagos atë.

Mbase ky është edhe shkaku që kjo fjalë është përdorur në këto ajete dhe në ajetet që do të shohim më vonë, por duhet thënë se ajo është përdorur e pakushtëzuar. Ajeti nuk ka ardhur me fjalët: “të cilët i qëllojnë gratë e martuara me imoralitet”, por në trajtën: **“Dhe ata që shpifin për gratë e ndershme”**, sepse fjala e tekstit “jermùne”, në kuptimin “qëllojnë”, veçanërisht kur vihet përballë krahasimesh gjuhësore, ka në brendësi të saj edhe kuptimin e imoralitetit. Fakti që fjala “imoralitet” në tekstin e ajetit, nuk thuhet drejtpërdrejt, shpreh një lloj respekti të veçantë për gratë e pastra. Kjo shprehje kur’anore është një shembull i dallueshëm për të respektuar njerëzit e pastër si dhe një model për të respektuar edukatën dhe nderin në çdo bisedë.

2- Përse duhen katër dëshmitarë?

Dihet se në ligjin e fesë islame, për të vërtetuar një të drejtë, ose një faj të kryer, është e mjaftueshme dëshmia e dy burrave të drejtë, qoftë edhe për të vërtetuar krimin e vrasjes. Kurse për të vërtetuar imoralitetin, All'Ilahu i Lartësuar ka vënë kusht të dëshmojnë katër burra të drejtë. Pa dyshim që kjo kërkesë është vënë për shkak se njerëzit edhe mund të nxitohen në gjykimin e

tyre për çështje të tilla e mund të zgjaten në fjalë aq shumë, sa të hedhin mbi tjetrin akuzën për imoralitet, edhe thjesht vetëm nga një dyshim që mund të kenë. Pikërisht për këtë shkak, Islami e ka shtrënguar shumë çështjen e dëshmisë për imoralitet, gjithmonë me qëllimin që të ruhet paprekshmëria e nderit të njerëzve; kurse për çështje të tjera, ashtu siç u tha më lart, qoftë edhe për vërtetimin e krimit të vrasjes, dispozita e Islamit kërkon vërtetimin vetëm me dy dëshmitarë të drejtë.

Përveç kësaj, për vrasjen e një njeriu, akuza është e njëanshme, pra kriminel i është vetëm një person, kurse krimi i imoralitetit është i dyanshëm. Nëse për të vërtetuar ose për të mohuar një krim prej krimeve të tjera kërkohen dy dëshmitarë për një të akuzuar, në rastin e imoralitetit kemi dy të akuzuar, dhe kështu numri i dëshmitarëve patjetër që duhet të jetë katër dëshmitarë.

Të njëjtat fjalë përmban edhe transmetimi vijues i ardhur prej Ebu Hanifes, i cili tregon: “E pyeta Ebu Abdullahun (Imam Sadikun): *Cili krim është më i rëndë, imoraliteti apo vrasja?* Ebu Abdullahu m’u përgjigj: *Vrasja*. Unë e pyeta përsëri: *Atëherë, pse për vrasjen duhen dy dëshmitarë, kurse për imoralitetin nuk pranohet dëshmia e dy vetëve, por patjetër duhet të dëshmojnë katër burra?* Ai më tha: *O Ebu Hanife, çfarë argumenti keni ju?* I thashë: *Te ne është vetëm hadithi i transmetuar prej Umerit, që njofton se All'illahu ka bërë detyrim për njerëzit në dëshminë vetëm dy fjalë. Ai më tha: Nuk është kështu, o Ebu Hanife, sepse për krimin e imoralitetit kemi të bëjmë me dy zbatime dënimi. Prandaj nuk lejohet që po ata dy dëshmitarë të dëshmojnë për secilin të akuzuar, sepse për këtë krim, dënimi është i barabartë si për burrin, ashtu edhe për gruan, kurse për krimin e vrasjes,*

*dënimi do të zbatohet vetëm për vrasësin dhe nuk ka se si të zbatohet mbi të vrarin”.*²⁵

Në krimin e imoralitetit ka edhe raste kur dënimi zbatohet vetëm mbi një të palë (në rastin e imoralitetit me detyrim e të ngjashme me këtë), por duhet theksuar se këto janë raste të veçanta. Ajo që dihet është se krimi i imoralitetit kryhet me dëshirën e të dyja palëve dhe se dispozitat vihen për shumicën e individëve dhe jo për raste të veçanta.

3- Kushti i rëndësishëm për pranimin e pendimit

Shpeshherë e kemi përsëritur se *teube* nuk do të thotë thjesht shqiptimi me fjalë i pendimit nga ana e njeriut për punën e keqe të kryer dhe shprehja e vendosmërisë prej tij për të hequr dorë prej saj në të ardhmen. Jo! Përveç kësaj kërkohet që personi të kompensojë për fajin që bëri. Kur burri akuzon një grua të pastër, ose një burrë të pastër dhe pastaj akuzuesi pendohet e bën *teube*, ai ka për detyrë të rehabilitojë atë që e ka dëmtuar me akuzën e tij. Kompensimi realizohet duke e përgënjeshtruar akuzën të të gjithë ata që e kanë dëgjuar prej tij.

Fjala e ajetit “*ue eslehu*”, “**përmirësohen**”, që ka ardhur pas fjalës “*tàbù*”, “**u penduan**” (bënë *teube*), tregon pikërisht këtë të vërtetë; pra, në fillim është detyrë të bëhet *teube-ja* dhe pastaj i penduari të përmirësojë dëmin e shkaktuar me shpifjen e tij dhe të vërë në vend nderin e personit, të cilit ia nxu fytyrën. Nuk është e

²⁵ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 574.

drejtë që njeriu të akuzojë vëllain e tij padrejtësisht në mënyrë publike dhe pastaj të kërkojë faljen e All'Ilahut për shpifjen e bërë. Natyrisht që All'Ilahu nuk e pranon një pendim të tillë.

Një përcjellës i transmetimeve të ardhura prej Imamëve të myslimanëve, tregon: E pyeta Imamin nëse pranohet dëshmia e një burri që shan në nder gratë e martuara, kur mbi atë është zbatuar ndëshkimi për sharjen, por që më pas është penduar. Imami m'u përgjigj: "Po!" Unë e pyeta: Si është pendimi që ai bën? Imami tha: "Burri vjen dhe përgënjeshton veten e vet te Imami dhe thotë: *Në të vërtetë, unë shpifa për filanen... dhe bën teube për atë që ka thënë*".²⁶

4- Dispozita për sharjen (për hedhjen e fjalëve diskredituese)

Në librin e dënimeve ka një kapitull të veçantë me titull "Dënimi për sharjen" (për hedhjen e fjalëve diskredituese).

Në gjuhën arabe, fjala "*kadhif*" do të thotë *hedhja e një sendi në drejtim të një objekti të largët*, por ajo është përdorur si e barazvlershme me fjalën "*remà*" - *gjuajti, qëllloi, hodhi diçka mbi dikë* - domethënë ai lëshon fjalë me qëllim për të akuzuar tjetrin në nder, ose thënë ndryshe: fjala e tekstit "*kadhif*" është sharje që ka lidhje me këto punë.

Kur sharja bëhet me fjalë të qarta, në çdo gjuhë që të jetë shqiptuar e në çdo formë që të jetë thënë ajo, dënimi për këtë veprim, ashtu siç e thamë më lart, është tetëdhjetë të rrahura me kamxhik; por kur sharja nuk është thënë me fjalë të qarta, atëherë sharësi vetëm qortohet. (Në ligjin e fesë islame nuk ka dënime për

²⁶ "Uesailu Shija", vëll. 18, f. 283, kapitujt "Dëshmitë", kapitulli nr. 36, vëll. 1.

qortimin. Për këtë, qortimi është lënë në vendimin e gjykatësit, që të vendosë masën e dënimit në përputhje me veçantitë e fajtorit, me mënyrën se si ka ndodhur faji dhe me kushte të tjera.)


Kur një person akuzon një grup njerëzish dhe akuzën e tij e përsërit për secilin prej të akuzuarve, ai ballafaqohet me dënimin për sharjen, për çdo akuzë që ka bërë; por kur ai i ka akuzuar ata vetëm një herë, atëherë mbi atë zbatohet vetëm një dënim, që të vihet në vend e drejta për gjithë të akuzuarit, nëse ata të gjithë kërkojnë prej gjykatësit dënim vetëm një herë. Kur secili prej të akuzuarve ngren padi më vete, fajtori do të dënohet sipas numrit të padive.

Çështja e akuzimit të tjetrit në nder padrejtësisht dhe pa e vërtetuar akuzën me katër dëshmitarë, është e një rëndësie kaq të madhe sa edhe në rastet kur i akuzuari vdes, trashëgimtarët e tij kanë të drejtë të kërkojnë zbatimin e dënimit mbi fajtorin, për akuzën që ai ka bërë kundër trashëgimlënësit të tyre; por meqenëse ky gjykim ka lidhje me të drejtën e një personi, kërkuesi i të drejtës së tij gëzon të drejtën që fajtori të kërkojë falje prej tij dhe me këtë falje, mbi fajtorin nuk zbatohet më dënimi për shpifje e për sharje. Bëjnë përjashtim rastet kur fajtori e përsërit fajin e tij në dëm të një personi të caktuar, në atë mënyrë që vihet në rrezik nderi i gjithë shoqërisë. Atëherë, llogaridhënia për këtë faj të përsëritur, patjetër do të jetë e vështirë.

Kur dy vetë shajnë njëri-tjetrin, bie zbatimi i dënimit për të dy, por gjykatësi i qorton të dy, prandaj nuk i lejohet asnjë personi t'i përgjigjet sharjes me një sharje të ngjashme, por i shari ka të drejtë të kërkojë prej gjykatësit zbatimin e dënimit që parashikon dispozita e ligjit të fesë për sharësin fajtor.

Sidoqoftë, kjo dispozitë e ligjit Islam ka për qëllim ruajtjen e reputacionit dhe të nderit të njerëzve. Gjithashtu, ajo ka qëllim të ndalojë përhapjen e punëve të liga shoqërore e morale, prej të cilave shoqëria vihet në provë. Sikur ngatërrestarët të lireshin të lirë të shanin e të akuzonin të tjerët sipas interesave të tyre personale, shoqëria do të merrte një goditje të pariparueshme dhe nderi e dinjiteti i njerëzve do të nëpërkëmbeshin për shkak të akuzave të pathemelta e të gabuara; madje puna do të arrinte deri aty, sa burri të dyshonte në gruan e tij, babai do të mendonte keq për djalin e vet, nëse është apo nuk është i biri. Me një fjalë, dyshimi e mendimi për keq do të ishin zotërues në të gjithë shoqërinë. Në një gjendje të tillë, qarkullimi i sharjeve e i akuzave do të prekte edhe ata që janë me të vërtetë njerëz të pastër nga ana morale. Pikërisht për ta ndaluar këtë, kërkohet të punohet me vendosmëri dhe në përputhje me ligjin Islam për trajtimin e keqbërësve dhe të atyre që përhapin shpifjet.

Shpifësit e akuzuesit për imoralitet pa asnjë argument e pa asnjë dëshmitar, duhet të rrihen në prani të njerëzve me nga tetëdhjetë goditje me kamxhik për çdo akuzë që ata bëjnë kundër tjetrit për imoralitet, sepse vetëm kështu ruhet dinjiteti e nderi i njerëzve.



“Dhe ata që akuzojnë gratë e veta pa pasur dëshmitarë tjetër përveç vetvetes; dëshmia e çdonjërit prej atyre të dyve (burrit e gruas) është: të betohet katër herë në All'llahun se ai thotë të vërtetën.”

“E pesta (herë e betimit) është: mallkimi i All'llahut rëntë mbi atë nëse ai gënjen!”

“Dhe ajo (gruaja e akuzuar prej burrit të saj) nuk dënohet, nëse ajo betohet katër herë në All'llahun se ai gënjen.”

“Betimi i pestë i saj është: zemërimi i All'llahut le të bjerë mbi atë nëse ai ka qenë i vërtetë!”

“Dhe, sikur të mos ishte mirësia e mëshira e All'llahut ndaj jush (ju do të mbaronit); All'llahu është Pranuesi i pendimit, Ai është i Urti.”

Shkaku i zbritjes

Transmetohet prej Ibni Ab'bàsit se Sa'd bin Ubàdeh (i pari i ensarëve) prej tribusë Hazrexh, i tha të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në prani të disa sahabëve: “O i Dërguar i All'llahut, sikur unë ta akuzoja gruan time që ka kryer imoralitet me një burrë, në të vërtetë, nuk do të revoltohesha kundër tij, derisa të sillja katër dëshmitarë. Betohem në All'llahun se nuk do të sillja katër dëshmitarë derisa ai të mbaronte punë e të shkonte, sepse nëse do të flisja për atë që pashë, mbi shpinën time do të binin tetëdhjetë kamxhikë”. Pas këtyre fjalëve, i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: “O ensarë, a e dëgjuat se ç' tha i pari juaj?”

Ensarët thanë: “Mos e qorto atë! Ai është mendjemadh; është martuar vetëm me virgjëresha dhe çdo grua që ai ka divorcuar, asnjë burrë prej nesh s'ka guxuar t'i propozojë për martesë”.

Ndërkaq, Sa'd bin Ubadeh tha: “O i Dërguar i All'llahut, kurban t'u bëfshin babai e nëna ime! Betohem në All'llahun, padyshim që unë e di se ajo (masë dënimi) është prej All'llahut dhe se është e drejtë, por u çudita prej asaj që të njoftova”. I Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: “All'llahu ka vendosur vetëm këtë”. Atëherë Sa'di tha: “Të vërtetën ka thënë All'llahu dhe i Dërguari i Tij”.

Pas pak, djali i xhaxhait të tij (Sa'dit), Hilâl bin Umej'jeh erdhi prej kopshtit të tij, i cili tha se natën kishte parë një burrë me gruan e tij dhe, kur u gdhi, ai erdhi tek i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që e njoftoi: “Në darkë unë shkova te gruaja ime, por së bashku me të

gjeta një burrë. I pashë me këta dy sy dhe i dëgjova fjalët e tyre me këta dy veshë”.

Të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i erdhi shumë rëndë nga ajo që dëgjoi, madje kjo gjendje dukej qartë në fytyrën e tij. Atëherë, Hilali i tha: “E shikoj nga ngjyra e fytyrës tënde se të vjen shumë rëndë, por All'llahu e di se unë them të vërtetën dhe shpresoj që Ai do të më japë një rrugëdalje”.

I Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) vendosi që ai të ndëshkohej me rrahje. Ndërkohë u mblodhën ensarët dhe thanë: “Edhe ne jemi sprovuar me atë që tha Sa’di. A mos do të rrahësh Hilalin dhe nuk merr në konsideratë dëshminë e tij?” Ndërkaq zbriti shpallja. Ata i ndërprejnë fjalët, sapo mësuan se po zbriste shpallja; All'llahu i Lartësuar njofton me fjalën e Tij: **“Dhe ata që akuzojnë gratë e veta...”**; Atëherë, i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: “Sihariq o Hilal, All'llahu i Lartësuar të dha rrugëdalje”.

Menjëherë Hilali tha: “Në të vërtetë, unë e shpresoja këtë prej All'llahut të Lartësuar”.²⁷

Me zbritjen e ajeteve që janë objekt studimi, myslimanët mësuan zgjidhjen e drejtë të këtij problemi. Shpjegimin për këtë problem do ta shikojmë në vijim.

²⁷ Tefsiri “Mexhmaul Bejjàn”, vëll. 7, f. 128; tefsiri “Fij Dhilalil Kur’àn”; tefsiri “Nuruth Thekalejn”; tefsiri “El Mijzàn”, në fundin e komentimit të ajeteve që janë objekt studimi (me disa ndryshime).

Komentimi

Ndëshkimi për atë që akuzon gruan e vet

Prej shkakut të zbritjes së këtyre ajeteve, arrihet në përfundimin se në to kemi të bëjmë me një rast të veçantë të dispozitës, që parashikon dënimin për atë që shpif për një grua të martuar. Ky rast i veçantë është: nuk zbatohet ndëshkimi për shpifjen (rrahje me tetëdhjetë kamxhikë) kur burri akuzon gruan e tij se ajo ka bërë imoralitet me një burrë tjetër. Në këtë rast, dëshmia e burrit pranohet, ndonëse dëshmia e tij mund të jetë ose jo e vërtetë. Për këtë, Kur'ani Famëlartë jep zgjidhjen më të mirë:

Burri e ka detyrim të betohet katër herë se ai thotë të vërtetën në pretendimin e tij, ashtu siç thuhet në ajetin e nderuar: **“Dhe ata që akuzojnë gratë e veta pa pasur dëshmitarë tjetër përveç vetvetes; dëshmia e çdonjërit prej atyre të dyve (burrit e gruas) është: të betohet katër herë në All'llahun se ai thotë të vërtetën. E pesta (herë e betimit) është: mallkimi i All'llahut rëntë mbi atë nëse ai gënjen!”** Duke u bazuar mbi këtë ajet, burri e ka detyrim të thotë: “Betohem në All'llahun se unë them të vërtetën në akuzën që i bëj gruas time për imoralitet”; këtë frazë, ai e përsërit katër herë. Nga njëra anë, me këtë betim ai ka për qëllim të vërtetojë pretendimin e tij dhe nga ana tjetër, ai heq prej vetes zbatimin e ndëshkimit që parashikon dispozita për shpifje

kundër gruas së martuar. Prandaj në herën e pestë, ai thotë: *“Mallkimi i All'Ilahut rëntë mbi mua nëse unë gënjej.”*.

Me betimin e burrit, gruaja gjendet në kryqëzim të dy rrugëve: ose të pohojë akuzën që hedh burri i saj mbi të, ose ta mohojë në përputhje me atë që thuhet në ajetet vijuese.

Në rast se gruaja e vërteton akuzën e burrit kundër asaj, ajo dënohet.

Kurse, për rastin kur gruaja e mohon akuzën që bën i shoqi kundër saj, ajeti njofton: **“Dhe ajo (gruaja e akuzuar prej burrit të saj) nuk dënohet, nëse ajo betohet katër herë në All'Ilahun se ai gënjen. Betimi i pestë i saj është: zemërimi i All'Ilahut le të bjerë mbi atë nëse ai ka qenë i vërtetë.”**. Sipas kësaj renditjeje, edhe gruaja betohet pesë herë kundrejt pesë betimeve të burrit. Me këtë mënyrë betimi, gruaja e mohon akuzën që i bëhet duke e përsëritur betimin katër herë: “Betohem në All'Ilahun se ai gënjen me akuzën që më bën për imoralitet” dhe, në betimin e pestë, ajo thotë: “Zemërimi i All'Ilahut le të bjerë mbi mua, nëse ai është i vërtetë në dëshminë e tij.”.

Këto dëshmi prej të dyve quhen shfajësime me anë të mallkimit të vetvetes, sepse në dëshminë e të dyve është përdorur fjala “mallkim”. Me këtë betim, në lidhje me të dy bashkëshortët, renditen katër dispozita përfundimtare:

E para: Ndarja e tyre pa divorc.

E dyta: Burri e ka të ndaluar përgjithmonë të shkojë me atë grua, domethënë: s'ka mundësi rikthimi në jetën bashkëshortore me një kontratë të re martese.

E treta: Nuk zbatohet dispozita për ndëshkimin e burrit për shpifje dhe as dispozita për ndëshkimin e gruas për imoralitet. Kur njëri prej atyre të dyve i refuzon këto betime, nëse refuzuesi është burri, mbi të zbatohet dispozita për shpifjen dhe nëse refuzuesja është gruaja, mbi të zbatohet dispozita për imoralitetin e gruas së martuar.

E katërta: Fëmija që lind pas këtij procesi gjyqësor nuk e merr atësinë e burrit dhe ai i lihet vetëm gruas.

Në ajetet që janë objekt studimi nuk kanë ardhur hollësi në lidhje me këtë dispozitë, por në ajetin e fundit të grupit të këtyre ajeteve, thuhet qartë: **“Dhe sikur të mos ishte mirësia e mëshira e All'Ilahut ndaj jush (ju do të mbaronit); All'Ilahu është Pranuesi i pendimit, Ai është i Urti.”**.

Ky ajet thekson se dispozitat që u përmendën më lart, tregojnë se shfajësimi me anë të mallkimit të vetvetes është një mirësi nga ana e All'Ilahut, sepse me këtë arrihet të zgjidhet në mënyrën më të drejtë problemi me të cilin ballafaqohen të dy bashkëshortët.

Së pari, burri nuk detyrohet të heshtë kundrejt veprimeve të këqija të gruas së tij. Gjithashtu, me këtë dispozitë, ai gëzon të drejtën që këtë problem ta ngrejë te gjykatësi ligjor.

Së dyti, as gruaja nuk i nënshtrohet zbatimit të dispozitës për aktin e imoralitetit që zbatohet mbi gruan e martuar, thjesht për shkak të një akuze të hedhur mbi të prej burrit të saj, sepse dispozita e ligjit Islam i jep gruas të drejtën të mbrojtë veten.

Së treti, burri nuk e ka detyrim të gjejë katër dëshmitarë për këtë problem, që ata të vërtetojnë këtë akuzë të urryer dhe të zbulojnë këtë skandal të turpshëm.

Së katërti, ndarja e bashkëshortëve nuk lejon kurrësi që ata të dy në të ardhmen, të rikthehen në jetën bashkëshortore me një kontratë të re martese. Kjo dispozitë është vënë për shkak se vazhdimësia e jetës bashkëshortore për ata të dy është krejtësisht e pamundur, sidomos kur akuza është e vërtetë. Gjithashtu, edhe gruaja ka marrë një goditje të rëndë shpirtërore nëse akuza është e rreme. Të gjitha këto e bëjnë jetën e përbashkët tepër të vështirë, që nuk mund të reduktohet vetëm në një jetë të ftohtë e të fishkur. Me fjalë të tjera, rezultat i kësaj akuze do të jetë vetëm një armiqësi që vjen duke u trashur midis burrit e gruas.

Së pesti, ajetet që janë objekt studimi, e shpjegojnë qartë edhe të ardhmen e fëmijës që lind pas kësaj akuze.

Të gjitha këto lehtësime janë mirësi prej All'llahut të Lartësuar dhe mëshirë që Ai derdh mbi robtë e Tij për zgjidhjen e këtij problemi në mënyrë të drejtë. Sikur të vërejmë më me kujdes në këtë dispozitë, do të konstatojmë se ajo nuk bie në kundërshtim me domosdoshmërinë e dëshmisë nga ana e katër burrave, sepse përsëritja katër herë e betimit prej burrit dhe prej gruas, e kompenson plotësisht praninë e katër dëshmitarëve.

Hulumtime

1- Përse janë përveçuar dy bashkëshortët prej zbatimit të dispozitës së ndëshkimit për shpifjen?

Pyetja e parë që shtrohet vetvetiu këtu, është:

Cila është e veçanta e dy bashkëshortëve, nga ku ka dalë kjo dispozitë përveçuese në lidhje me të drejtën e tyre?

Përgjigjen e kësaj pyetjeje nga njëra anë e gjejmë në shkakun e zbritjes së këtij ajeti, pra: pamundësia e burrit që të heshtë kur ai sheh që gruaja e tij e tradhton me një burrë tjetër.

Si është e mundur që burri të mos reagojë kur sulmohet nderi i tij?! Kur burri i drejtohet gjykatësit me deklaratë të hapur dhe kërkon ndihmën e tij, në të vërtetë ai e di se do të përballet me zbatimin e ndëshkimit që parashikon dispozita për shpifjen në nder të gruas së martuar, për shkak se gjykatësi mund të jetë i bindur se ai nuk thotë të vërtetën në ankesën e tij. Nëse ai do të përpiqet të sjellë katër dëshmitarë, do të jetë shumë e vështirë, sepse kështu do të preket vetë ai në nder dhe incidenti mund të mbyllet pa patur mundësi burri për të sjellë katër dëshmitarë në kohën e përshtatshme.

Dihet se të huajt e akuzojnë njëri-tjetrin me lehtësi, kurse tek bashkëshortët ndodh shumë rrallë që njëri prej tyre të akuzojë tjetrin për imoralitet.

Ky është shkakun që Ligjvënësi ka vendosur: Për problemin e vërtetimit të akuzës për imoralitet, duhet të dëshmojnë detyrimisht katër dëshmitarë, por jo për rastin kur burri akuzon për imoralitet gruan e vet, përndryshe zbatohet ndëshkimi që parashikon dispozita për sharjen mbi atë që akuzon palën tjetër

për imoralitet. Por çështja nuk qëndron kështu në rastin e dy bashkëshortëve. Për këtë, dispozita e mësipërme i ka veçuar ata, sepse problemi i tyre ka specifika të veçanta.

2- Mënyra e shfajësimit me anë të mallkimit të vetvetes

Pas shpjegimeve që përmendëm gjatë komentimit të këtij ajeti, arritëm në detyrimin që burri të përsërisë katër herë betimin, për të vërtetuar se akuza që ai ka hedhur kundër gruas së vet për imoralitet është e vërtetë. Kështu, ai shpëton prej zbatimit të ndëshkimit që parashikon dispozita për shpifjen kundër gruas së martuar. Gjithashtu, katër betimet e burrit zënë vendin e katër dëshmitarëve dhe në betimin e pestë, ai pranon që mbi atë të bjerë mallkimi i All'lahut, nëse ka bërë dëshmi të rreme.

Dispozita të tilla gjejnë zbatim vetëm në një mjedis Islam të përkushtuar dhe në një mjedis qytetar, ku burri e sheh si detyrim që të paraqitet para gjykatësit, për të argumentuar me katër betime në mënyrë të prerë pretendimin e tij, pa asnjë dyshim e pa asnjë ngurrim; kurse në betimin e tij të pestë, burri kërkon prej All'lahut që Ai të lëshojë mallkimin e Tij mbi të, nëse ka bërë akuzë të rreme. Të gjitha këto e ndalojnë burrin nga nxitimi për të hedhur një akuzë të gabuar mbi gruan e tij.

Nga ana tjetër, gruaja padyshim që ka të drejtë ta mbrojë veten, sidomos kur është e pafajshme për akuzën që bëhet kundër saj, por edhe ajo ka detyrim të betohet katër herë me radhë dhe të dëshmojë se akuza që i bëhet nuk është e vërtetë. Kështu kemi një balancim të dëshmive të burrit e të gruas dhe, meqenëse e

akuzuara është gruaja, atëherë në dëshminë e pestë, ajo e mbron veten me një frazë akoma edhe më të fuqishme dhe i lutet All'llahut, që Ai të lëshojë mbi të zemërimin e Tij, nëse ajo nuk thotë të vërtetën.

Ne dimë se fjala “mallkim” do të thotë *largim prej mëshirës së All'llahut*. Kurse fjala “zemërim” është edhe më e rëndë sesa mallkimi, sepse zemërimi hamendëson dënimin dhe dënimi është më shumë sesa largimi prej mëshirës.


Për këtë ndryshim në kuptim, ne kemi thënë në komentimin e sures “El Fatiha”, se fraza “**mbi të cilët ka rënë zemërimi**” është shumë më e rëndë se fraza “**ata që kanë rënë në rrugën e humbjes**” megjithëse edhe ata që kanë rënë në rrugën e humbjes, me siguri që janë larg mëshirës së All'llahut të Lartësuar.

3- Dënimi i hequr në këtë ajet

Në ajetin e fundit prej ajeteve që janë objekt studimi, ka ardhur një fjali kushtore, në të cilën nuk është përmendur ndëshkimi për gruan: “**Dhe sikur të mos ishte mirësia e mëshira e All'llahut ndaj jush** (ju do të mbaronit); **All'llahu është Pranuesi i pendimit, Ai është i Urti**”, por në këtë frazë nuk përmendet rezultati i kësaj mirësie e mëshire. Duke hedhur vështrimin në shembujt krahasues, për ne bëhet e qartë përgjigja e këtij kushti, që është heshtja për atë që zbulohet, për shkak të rëndësisë së saj të madhe, sepse në mendjen e burrit lindin përfytyrime të shumta në lidhje me veprimet e gruas së tij dhe çdo përfytyrim tek ai merr një kuptim të ri; pikërisht këtu mund të jetë

edhe përgjigja për kushtin, e cila është: Sikur të mos ishte mirësia e All'llahut dhe mëshira e Tij për ju, patjetër që Ai do të zbulonte punët tuaja dhe do t'ju diskreditonte. Ose sikur të mos ishte mirësia e All'llahut dhe mëshira e Tij për ju, patjetër që Ai do t'ju dënonte menjëherë dhe do t'ju asgjësonte. Ose sikur të mos ishte kjo mirësi e mëshirë, All'llahu i Gjithëpushtetshëm nuk do të kishte vënë dispozita të tilla kaq të hollësishme për edukimin tuaj.²⁸

Ajetet 11 - 16



²⁸ Në tefsirin “El Mizàn” përgjigja e kushtit është përmendur në një formë, e cila i përfshin të gjitha komentet e tjera. Në këtë tefsir, për interpretimin e këtij ajeti, thuhet tekstualisht: “Sikur të mos ishin mirësitë që All'llahu ka dhuruar për ju, si mirësia e fesë, mirësia që Ai e pranon pendimin prej fajtorëve, si dhe vënia e ligjeve që rregullojnë jetën tuaj, patjetër që ju do të ishit në vështirësi të mëdha, do të ishit asgjësuar prej mëkateve e prej gabimeve tuaja dhe sistemi i jetës do t'ju ishte shkatërruar prej injorancës tuaj.”.



“Padyshim se ata që trilluan shpifjen janë një grup prej jush; ju mos e merrni atë si ndonjë dëm për ju, përkundrazi, ajo do të jetë në dobinë tuaj; secili prej atyre do të ketë dënimin sipas pjesëmarrjes në mëkat dhe ai që barti pjesën më të madhe (të shpifjes) do të ketë dënimin më të madh.”

“Kur ju e dëgjuat atë (shpifjen), përse besimtarët dhe besimtare të mos mendonin të mirën si për vete dhe të thonin: kjo është shpifje e qartë?”

“Përse ata nuk sollën katër dëshmitarë për këtë? Dhe, derisa ata nuk sollën dëshmitarë, tek All'llahu ata janë gënjeshtarët.”

“Dhe, sikur të mos ishte mirësia e All'llahut dhe mëshira e Tij ndaj jush, në këtë botë e në Botën Tjetër, mbi ju do të binte një dënim shumë i madh për shkak të asaj që ju bëtë.”

“Kur ju e lakonit atë (shpifjen) me gjuhët tuaja e me gojën tuaj thonit gjëra për të cilat nuk keni asnjë dijeni; ju e menduat atë gjë pa rëndësi, ndërsa tek All'llahu ajo është e madhe.”

“Kur e dëgjuat atë, përse nuk thatë: nuk na takon neve të flasim për këtë; i Larti je vetëm Ti, kjo është një shpifje e madhe.”

Shkaku i zbritjes

Për zbritjen e këtyre ajeteve është përmendur se shkaku qe shpifja që bënë hipokritët mbi nderin e gruas së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Në lidhje me këtë ngjarje, Aishja, gruaja e të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “I Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kur kishte për qëllim të dilte për ndonjë fushatë, hidhte short midis grave të tij. Gruaja, së cilës i binte shorti, do ta shoqëronte të Dërguarin e All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Aishja vazhdon: “Në njëjërën prej fushatave,¹ ku mori pjesë vetë i Dërguari Dërguari i All'llahut, shorti më ra mua dhe kështu unë dola së bashku me të. Kjo ka ndodhur pasi kishte zbritur ajeti i hixhabit (mbulesës). Unë udhëtoja brenda dhomëzës së posaçme për gratë, të montuar mbi samarin e devesë (*hùdexh*). Vazhduam të udhëtojmë derisa i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e përfundoi atë fushatë.

Karvani jonë po udhëtonte në drejtim të Medines dhe i Dërguari (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) urdhëroi pushimin e natës. Edhe unë ndalova aty ku u dha urdhri për të qëndruar. Ndërkaq, unë eca me këmbë derisa e kalova ushtrinë dhe pasi kreu nevojat personale, u nisa për te deveja ime. Gjatë kthimit m'u këput varësja e ra përtokë dhe, ndërsa unë po e kërkoja, ata të karvanit që udhëtonin me mua, shkuan te deveja ime, duke menduar se unë jam brenda dhomëzës

¹ Është fjala për fushatën kundër fisit çifut “Benù Mustalik”, në vitin e pestë të hixhretit.

së posaçme. Ata e vunë samarin mbi shpinën e devesë dhe u nisën për udhëtim. Në ato kohë, gratë ishin me peshë të lehtë dhe akoma nuk ishin rënduar nga dhjami i tepërt, sepse hanin vetëm një lloj supe të holluar, të quajtur *aleka*. Prandaj, njerëzit nuk e kishin dalluar dot se unë nuk isha brenda dhomëzës. Veç kësaj, unë isha shumë e re. U vonova duke kërkuar varësen dhe kur e gjeta, ushtria ishte larguar. U ktheva në vendqëndrimin e ushtrisë, por aty nuk dëgjohej asnjë zë; thërrisja, por askush nuk përgjigjej. Në këtë gjendje, vazhdova ecjen dhe shkova te vendi ku kisha ndaluar me devenë time, duke menduar se kur ata do ta kuptonin se nuk isha brenda në dhomëz, do të ktheheshin të më kërkonin. Po rrija ndenjor aty ku isha dhe ndërkaq më zuri gjumi.

Në praparojë të ushtrisë ishte lënë Safvân bin Muat'tal Es Selemij. Ai kishte udhëtuar nga fundi i natës dhe arriti pranë vendit ku isha unë; ai pa një njeri të veshur me të zeza që po flinte dhe u afrua. Më njohu sapo më pa (sepse më kishte parë edhe para urdhrit për mbulimin e gruas). Kur u zgjova, e pashë para meje. U mbulova me mbulesën e kokës dhe pasha All'llahun, ai nuk më tha asnjë fjalë. Ndërkaq, e afroi devenë e tij pranë meje, duke mbajtur në dorë kapistrën. Unë hipa mbi deve dhe ai u nis duke tërhequr devenë për kapistre. Kështu e vazhduam udhëtimin, derisa arritëm ushtrinë. Pasi ndaluam për pushimin e drekës, filluan pëshpëritjet për mua. Qysh këtu filloi edhe shkatërrimi i atyre që u përzier në përhapjen e shpifjes.

Ai që filloi ta përhapte shpifjen ishte Abdullah bin Ebû Selûli. Kur hymë në Medine, qëndrova e sëmure për një muaj. Ndërkaq, njerëzit pëshpërisnin shpifjen që kishin trilluar shpifësit kundër meje. Nuk dija asgjë se ç'thuhej. Gjatë kohës që kisha dhimbje, nuk po e shihja më prej të Dërguarit të All'llahut (*Paqja*

dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) atë dashamirësinë që tregonte më parë ndaj meje kur ankohesha. Kur ai hynte të më shihte, më përshëndeste me selam dhe pastaj pyeste: “Hë, si dukesh?” Pas kësaj, ai largohej dhe kjo gjë më ngjallte dyshime, pa ditur asgjë për të keqen që qarkullonte. Kur u ndjeva më mirë, fillova të ngrihem për të shkuar në banjo, e shoqëruar prej Um'm Mistahut, e cila ishte shoqëruesja jonë për në banjo (Ne shkonim në banjo vetëm natën. Kështu ndodhte para se banjot të ndërtoheshin pranë banesave tona. Gjatë kohës për të cilën po flas, ne ndiqnim zakonet e arabëve të parë, të cilët e konsideronin si gjë të rëndë të kishin banjot pranë banesave, pavarësisht se sa vuanin nga moskryerja e nevojave në kohën e duhur.).

Unë dhe Um'm Mistahu dolëm dhe ajo qëndroi para shtëpisë time. U mbështollëm me rrobat tona. Ndërkohë Um'm Mistahu u vrenjt në fytyrë dhe tha: “Ja dhe ky!” Unë i thashë: “Si flet me përçmim për një njeri që ka marrë pjesë në luftën e Bedrit?!” Ajo tha: “A nuk e ke dëgjuar se ç'ka thënë?” - “Çfarë?” - e pyeta. Ajo më tregoi për fjalët e atyre që e kishin kurdisur shpifjen. Kjo që mësova ma rëndoi edhe më shumë sëmundjen.

Kur u ktheva në shtëpi, hyri tek unë i Dërguari i All'lahut (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), më përshëndeti me selam dhe pastaj më pyeti: “Hë, si dukesh?” I kërkoja leje të shkoja te prindërit e mi, sepse doja ta mësoja të plotë lajmin prej tyre. I Dërguari i All'lahut më dha leje dhe unë shkova tek ata. Sapo u takova me nënën time, i thashë: “O nëna ime, ç'thonë njerëzit?” Ajo më tha: “O vajza ime, mos e merr për ndonjë gjë të madhe. Beto hem në All'lahun, rrallëherë mund të ketë ndodhur që një grua të jetë martuar me një burrë që e do atë e

që shemrat të mos kenë thënë fjalë të shumta kundër saj”. Unë thashë: “I Plotpushtetshëm është vetëm All'llahu! Si është e mundur të flasin njerëzit kështu?!” Qava gjithë natën, derisa u gdhi dhe lotët nuk më shterronin.

Ndërkaq, shpallja hyjnore po vonohej, prandaj i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thirri Ali bin Ebu Talibin dhe Usame bin Zejdin, që të këshillohej me ta për të ndarë gruan e tij. Usame i theksoi të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) atë që dinte dhe i tha se gruaja e tij ishte krejtësisht e pafajshme. Gjithashtu, ai i tha se e dinte sa shumë e donte atë grua, duke iu drejtuar me këto fjalë: “O i Dërguar i All'llahut, për gruan tënde nuk dimë gjë tjetër përveç faktit se ajo është grua e mirë”. Kurse Ali bin Ebu Talibi i tha: “O i Dërguar i All'llahut, përse e shtrëngon veten kaq shumë? Nuk është vetëm ajo, gra të tjera ka sa të duash, por ti thirre shërbyesen dhe ajo do të të thotë të vërtetën”. I Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e thirri Berijren dhe i tha: “O Berijre, a ke parë ndonjë gjë që të ka bërë të dyshosh?” Berijre i tha: “Jo! Betohem për Atë që të ka dërguar ty me të vërtetën, nuk kam parë ndonjë punë kundër saj, që mund të them se është sado pak e errët. Ajo është një grua në moshë fare të re, që vazhdon të flejë në brumin e familjes së saj, ndërkohë që pulat vijnë dhe e çukisin atë brumë”.

Pas këtij këshillimi, i Dërguari i All'llahut u ngjit në minberin e xhamisë dhe i kërkoi Abdullah bin Ubej'jit që ta shfajësonte atë. Ai tha: “O myslimanë, cili prej jush më shfajëson për një burrë që më fyen, duke hedhur fjalë për njerëzit e familjes time? Pasha All'llahun, për familjen time s'kam ditur gjë tjetër përveç së

mirës! Myslimanët përmendën një burrë, për të cilin unë di vetëm të mira. Përveç kësaj, ai ka hyrë në shtëpinë time vetëm duke qenë i shoqëruar me mua”.

U ngrit Sa’d bin Muàdh El Ensàrij dhe tha: “O i Dërguar i All'llahut, unë të shfajësoj prej tij. Nëse ai është prej fisit Eus, unë ia pres kokën dhe, nëse është prej vëllezërve tanë, prej anëtarëve të fisit Hazrexh, nëse na urdhëron, ne e zbatojmë urdhrin tënd.”.

Pas fjalës së Sa’d bin Muàdhit, u ngrit menjëherë Sa’d bin Ubàdeh, prijësi i fisit Hazrexh, i cili njihej si burrë i mirë, porse në atë çast e rrëmbeu fanatizmi i madhështisë së fisit dhe i tha Sa’d bin Muàdhit: “Pasha All'llahun po gënjen! Ti s’ke fuqi ta vrasësh atë!” Ndërkaq u ngrit Usejd bin Hadijri, që ishte djali i xhaxhait të Sa’d bin Muàdhit dhe i tha Sa’d bin Ubàdehut: “Ti po gënjen! Patjetër që do ta vrisnim! Vërtet je hipokrit (munàfik) dhe polemizon shumë rreth hipokritëve.”. U revoltuan të dyja palët, pra ata të fisit Eus dhe ata të fisit Hazrexh dhe situata mund të arrinte deri aty sa të fillonte lufta midis tyre. I Dërguari i All'llahut (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) vazhdonte të ishte mbi minber dhe bënte thirrje për qetësi. Më në fund, ata u qetësuan dhe e ndaluan grindjen.

Aishja vazhdon të tregojë: “Atë ditë qava gjatë gjithë kohës. Lotët më rridhnin çurg dhe as gjumi nuk më zinte; qava dy net e një ditë pa mbyllur sytë fare, madje prindërit e mi menduan se nga e qara do të më çahej zemra.

Prindërit më rrinin afër, ndërsa unë vazhdoja të qaja. Një grua prej ensarëve erdhi dhe kërkoi leje të hynte tek unë. Ajo u ul dhe filloi të qante së bashku me mua. Ndërkaq hyri te ne i Dërguari i All'llahut (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe

mbi familjen e tij!) dhe u ul. Ai nuk ishte ulur pranë meje qysh nga koha kur njerëzit kishin filluar të flisnin keq për mua. Kishte kaluar afërsisht një muaj pa hyrë tek unë dhe pa pyetur fare për mua. Kur u ul, ai tha dëshminë dhe m'u drejtua me këto fjalë: "O Aishe, mua më kanë thënë kështu e kështu, por nëse ti je e pafajshme, shumë shpejt All'llahu do të të shfajësojë. Nëse ke bërë ndonjë faj, atëherë kërkoji All'llahut të ta falë dhe pendohu para Tij, sepse kur robi e pohon fajin që ka bërë dhe bën teube (pendohet), Ai ia pranon pendimin dhe e fal atë".

Pasi e mbaroi fjalën e tij, i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) më fshiu lotët derisa nuk ndjeva të më dilte as edhe një pikë. I thashë babait: "Jepi përgjigje të Dërguarit të All'llahut për mua!" Ai më tha: "Pasha All'llahun, nuk di ç'ti them!" I thashë edhe nënës time: "Jepi përgjigje atij për mua!" Por edhe nëna më tha: "Pasha All'llahun, nuk di ç'ti them të Dërguarit të All'llahut!"

Atëherë, unë u thashë: "Jam një grua shumë e re në moshë; nuk këndoj shumë prej Kur'anit, por pasha All'llahun, unë kam menduar se ju i keni dëgjuar këto fjalë dhe mbase ato janë ngulitur në zemrat tuaja, derisa edhe i besuat. Nëse u them se jam e pafajshme dhe All'llahu e di që jam e tillë, ju nuk më besoni; nëse unë do t'ju pohoj një punë, për të cilën All'llahu e di se unë jam e pafajshme, patjetër që do të më besonit. Për ju të dy, unë nuk po gjej shembull tjetër përveç fjalës së babait të Jusufit (*Paqja e qoftë mbi ata të dy!*): "Durimi është më i mirë. Vetëm All'llahu është Ndihmës për fjalët që ata thonë".

Pastaj u ktheva dhe u shtriva mbi shtratin tim. Në këtë kohë, unë e dija mirë se isha e pafajshme dhe isha e bindur se

All'lahu do të më shfajësonte. Por, pasha All'lahun, kurrë nuk më shkonte në mendje që për të më shfajësuar mua, All'lahu do të zbriste shpallje që do të këndohej. Thellë në shpirt nuk doja që për mua All'lahu të fliste me fjalë që do të lexoheshin e do të këndoheshin; në të vërtetë, unë shpresoja që i Dërguari i All'lahut (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të shihte në ëndërr se All'lahu më shfajëson nga kjo shpifje".

Aishja vazhdon: "Pasha All'lahun, sa shumë i donte i Dërguari i All'lahut (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kuvendet e tij, por askush nuk doli prej njerëzve të shtëpisë, derisa atij i zbriti shpallja. Ai dukej shumë i lodhur. Djersët i kullonin çurg ndonëse ishte ditë dimri dhe e gjitha kjo i erdhi nga pesha e rëndë e shpalljes që i zbriti, por që e gëzoi shumë. Ai filloi të qeshte dhe e para fjalë që nxorri nga goja ishte: "Sihariq o Aishe, All'lahu të shfajësoi!" Nëna ime më tha: "Çohu dhe shko tek ai!" Unë i thashë: "Pasha All'lahun, nuk shkoj tek ai! Unë nuk do të falënderoj asnjë përveç All'lahut, i Cili për të më shfajësuar mua, zbriti shpalljen".

Në shpallje thuhet:

"Padyshim se ata që trilluan shpifjen janë një grup prej jush..."
deri në fundin e dhjetë ajeteve.

Ebu Bekri shpenzonte për Mistah bin Ethatheh që e kishte të afërm, por kur All'lahu i Lartësuar i zbriti këto ajete për të më shfajësuar mua, ai tha: "Pasha All'lahun, nuk do të shpenzoj kurrë më për Mistahun, pas kësaj që ai tha për Aishen!" Por All'lahu i Lartësuar zbriti menjëherë ajetin e mëposhtëm:

“Të ndershmit e të pasurit prej jush të mos betohen se nuk do t’u japin të afërmve e të varfërve dhe atyre që për hir të All’lلاهut lanë vendlindjen, por le t’ua falin (gabimin) dhe mos t’ua marrin për të madhe; a nuk dëshironi që All’lلاhu t’u falë edhe juve? All’lلاhu fal dhe mëshiron shumë.” (sure “En Nur”, ajeti 22)

Me zbritjen e këtij ajeti, Ebu Bekri tha: “Pasha All’lلاهun, unë dua që All’lلاhu të m’i falë mëkatet!” – dhe menjëherë rifilloi të shpenzonte për Mistahun, madje u betua edhe një herë: “Pasha All’lلاهun, kurrë nuk do ta ndërpres shpenzimin për të!”

Aishja vazhdon: “Para zbritjes së këtij ajeti, i Dërguari i All’lلاهut (*Paqja dhe bekimet e All’lلاهut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kishte pyetur për çështjen time edhe Zejnebin, të bijën e Haxheshit dhe i kishte thënë: “O Zejneb, çfarë di ti, ose çfarë ke parë?” Ajo ishte përgjigjur: “O i Dërguar i All’lلاهut, unë e ruaj veshin e syrin tim dhe nuk di gjë tjetër përveç të mirës”. Në të vërtetë, ndër të gjitha gratë e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’lلاهut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ajo nuk fliste mirë për mua, por All’lلاhu e ruajti derisa iu përvesh edhe motrës së vet, Hamnehes. Ja, kështu u shkatërrua kush u shkatërrua prej atyre që u morën me shpifjen.¹

Vërtetimi i çështjes

¹ Tefsiri “El Mijzàn”, vëll. 15, f. 96-100.

Pavarësisht nga sa është përmendur në burimet islame në lidhje me këto dy shkaqe, në shkakun e parë ka disa gjëra të paqarta që ngjallin diskutim. Ja disa prej tyre:

1- Prej këtij transmetimi, pa marrë parasysh kontradiktat që janë në të, mësohet se i Dërguari më i nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ra nën ndikimin e fjalëve të përhapura dhe kjo e çoi atë deri aty, sa të këshillohej me shokët e tij për një çështje kaq personale. Kjo gjë çoi edhe në ndryshimin e sjelljes së tij ndaj Aishes, nga e cila qëndroi larg për një kohë relativisht të gjatë.

Mirëpo ky shpjegim nuk është në përputhje me pagabueshmërinë e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), pasi edhe çdo mysliman me besim të rrënjësor, nuk duhet të bjerë nën ndikimin e fjalëve të përhapura pa pasur ndonjë argument. Nëse myslimani ndikohet prej atyre fjalëve, patjetër që do të ndryshojë edhe sjelljen e tij, por ai që ka besim të rrënjësor, nuk dorëzohet as prej fjalëve të përhapura dhe as prej ndikimit të tyre. Atëherë, si mund të jetë ndikuar ai, të cilin e ka ruajtur All'llahu prej gabimeve?

A mund të besohet se krahas qortimit të ashpër, të përmendur në ajetet që janë objekt studimi, të mos shtrohet pyetja: Përse disa besimtarë ranë nën ndikimin e fjalëve të përhapura? Përse ata nuk kërkuar katër dëshmitarë, përfshirë edhe vetë Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)? Këto pyetje, në vlerësimin më të vogël, na shtojnë drejt dyshimit mbi vërtetësinë e shkakut të parë të zbritjes.

2- Megjithëse ajetet tregojnë qartë se dispozita për sharjen (akuza për një vepër që është në kundërshtim me nderin), ka zbritur para ndodhisë së shpifjes, përse Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), nuk e thirri Abdulla bin Ebu Selulin dhe disa të tjerë prej atyre që u bënë përhapës të fjalëve, dhe të zbatonte mbi ta ndëshkimin që parashikon dispozita e urdhëruar nga All'llahu për fajin e akuzës në nder pa argument? (Mbetet të thuhet se ajetet që njoftojnë dispozitën për ndëshkimin e atij që ngren akuza për imoralitet pa argument, si dhe ajetet që njoftojnë ngjarjen e shpifjes, kanë zbritur njëherësh dhe se dispozita për sharjen në nder u shpjegua vetëm atëherë, që të ishte në përshtatje me problemin e shpifjes. Me këtë shpjegim shohim mohimin e këtij problemi, porse shkaku mbetet në fuqi).

Për sa i përket shkakut të zbritjes, lind një diskutim rreth disa çështjeve, prej të cilave përmendim:

1- Ai që e hodhi shpifjen ishte vetëm një person, ndërkohë që ajetet thonë se ata ishin një grup, të cilët e përhapën shpifjen dhe me fjalët e tyre mbushën gati të gjithë Medinen. Fakti që në ajet është përmendur fraza “*një grup besimtarësh*”, do të thotë se në të qortohen edhe ata që e besuan shpifjen si të vërtetë.

2- Shtrohet pyetja: Kur Aishja, sipas shpifjes së përhapur, e paska bërë këtë faj dhe më pas u vërtetua e kundërta, përse Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk e zbatoi ndëshkimin që parashikon dispozita për akuzën në nder, në mënyrë që Aishja të merrte të drejtën e saj?

3- Si është e mundur që Profeti më i nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të urdhëronte vrasjen e një personi vetëm me dëshminë e një gruaje?

Duke ditur se konkurrenca midis shemrave është një gjë e zakonshme, gjithashtu edhe devijimi nga e vërteta e drejtësia, ose që ndonjëra prej atyre grave të bëjë ndonjë gabim, më e pakta, është diçka e mundshme.

Këtu nuk është e rëndësishme ajo që thuhet në shkaku të zbritjes, por ajo që ne mësojmë prej këtij grupi ajetesh: se një njeri i pafajshëm u akuzua për imoralitet në kohën e zbritjes së këtyre ajeteve dhe se fjalët e përhapura, ashtu siç kuptohet prej argumenteve ekzistuese në këtë ajet, qarkullonin në Medinë. Kjo akuzë ishte ngritur kundër një personi me rëndësi të veçantë në shoqërinë e kohës. Gjithashtu, nga ajeti mësohet se një grup prej hipokritëve, që hiqeshin se kishin pranuar Islamin, në të vërtetë kishin për qëllim ta prishnin shoqërinë islame me anë të fjalëve që ata përhapnin; por zbritja e këtyre ajeteve ua preu atyre rrugën fuqishëm, veçanërisht me ngjarjen e shëmtuar të shpifjes, çka bëri që të devijuarit nga rruga e drejtë si dhe hipokritët e urryer, të strukeshin nëpër vrimat e tyre.

Cilido që të ketë qenë shkaku i zbritjes së këtyre dispozitave, në të vërtetë s'ka të bëjë fare vetëm me të, sepse ato nuk janë të vlefshme vetëm për atë kohë e vetëm për atë vend. Jo! Ato dispozita janë të vlefshme në çdo mjedis e në çdo kohë.

Pas këtij trajtimi, do të fillojmë interpretimin e këtyre ajeteve, për të parë se si Kur'ani e tregon me një gjuhë të qartë e me retorikën më të përkryer këtë ngjarje të veçantë dhe i studion me hollësi pjesët e saj.

Komentimi

Ngjarja ndikuese e shpifjes

Në ajetin e parë të grupit të ajeteve që janë objekt studimi, pa e shtruar origjinën e ngjarjes, thuhet: **“Padyshim se ata që trilluan shpifjen janë një grup prej jush.”**. Në të vërtetë, prej shenjave të gjuhës së qartë dhe retorikës së arritur të Kur'anit, është edhe heqja e fjalive të shtuara dhe të mjaftuarit me kuptimet që kanë fjalët gjithëpërfshirëse.

Fjala e ajetit *“el ifk”* – *“shpifje”* ashtu siç e shpjegon edhe Ragib El-Isfehàni në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'anit, ka për qëllim nxjerrjen e çdo gjëje prej asaj që është në të vërtetë dhe që mund të jetë kundër personit për të cilin thuhet. Fjala *“el ifk”* përdoret edhe për erërat që ndërrojnë drejtimin dhe që thirren me fjalën *“të shtrembëruarat”*. Më pas, kjo fjalë është përdorur për çdo gjë të devijuar nga e vërteta, ose nga ajo që është më e drejta dhe, nga ky këndvështrim, edhe gënjeshtërsi i thuhet *“el ifk”* – *“shpifje”*.

Në tefsirin *“Mexhmaul Bejjan”*, Et Tabresij thotë se fjala *“el ifk”* nuk mund të përdoret për çdo gënjeshtëri, por thuhet për një gënjeshtëri shumë të madhe, që e ndërron objektin nga gjendja e tij origjinale. Bazuar mbi këtë shpjegim, mësohet se fjala *“el ifk”* – *“shpifje”* bën të qartë në vetvete, rëndësinë e madhe të asaj ngjarjeje; në të njëjtën kohë, ajo zbulon se sa e gënjeshtërt ishte akuza e hedhur.

Fjala e ajetit *“usbetun”* – *“grup”* në origjinën e saj shpreh lidhjen e muskujve të trupit me njëri-tjetrin në formën e një rrjete

të shpërndarë në të gjithë trupin; më pas, kjo fjalë është përdorur për të treguar një grup njerëzish të bashkuar me një qëllim të vetëm.

Përdorimi i kësaj fjale zbulon lidhjen e ngushtë e të fortë midis komplotistëve në përhapjen e ngjarjes së shpifjes, të cilët në të vërtetë formonin një rrjetë të thurur, të fortë e të gatshme për të zbatuar komplotin.

Disa kanë thënë se fjala “*usbetun*” - “*grup*” përdoret për grupe njerëzish nga dhjetë deri në dyzet persona.¹

Gjithsesi, Kur’ani siguron dhe qetëson shpirtat e besimtarëve, te të cilët lëshimi i kësaj akuze mbi një njeri krejtësisht të pastër, ka shkaktuar dhimbje. Në ajet, atyre u thuhet: **“ju mos e merrni atë si ndonjë dëm për ju, përkundrazi, ajo do të jetë në dobinë tuaj”**, sepse kjo shpifje zbuloi të vërtetën e një numri armiqsh të shpartalluar e hipokritësh frikacakë. Gjithashtu, me këtë shpifje u diskreditua puna e atyre që hiqeshin si myslimanë, por që vazhdimisht dyshonin, sepse në të vërtetë ata nuk ishin të tillë. Kështu, ajeti ua nxiu fytyrat një herë e përgjithmonë.

Sikur të mos ndodhte kjo ngjarje, puna e tyre nuk do të diskreditohej kurrë në këtë mënyrë dhe, me siguri, ata do të ishin shumë më të rrezikshëm për myslimanët.

Kjo ngjarje u mësoi myslimanëve se ata që ndiqnin përhapësit e shpifjes, shkonin drejt vështirësive e përkeqësimit të

¹ Cituar prej tefsirit “Rûhul Me’âni”. Në këtë kuptim është marrë prej librit “Es Sihâh”.

gjendjes; ajeti u thotë atyre se duke ndjekur përhapësit e shpifjes, ata bëheshin vetë të tillë, duke e besuar shpifjen. Gjithashtu, ajeti i mësoi myslimanët se ata e kanë detyrë që t'i kundërvihen fuqishëm kësaj shpifjeje. Përveç kësaj, ngjarja e shpifjes u dha atyre edhe një mësim tjetër dhe i porositi që të mos shihnin anën e jashtme të ngjarjes së dhimbshme, por të vështrojnë në thellësi të saj, sepse aty do të kishte mirësi të shumta, ndonëse nga jashtë dukej një ngjarje shumë e keqe.

Në këtë ajet, të tërheq vëmendjen përemri *“lekum”* – *“për ju”* pasi ai përfshin të gjithë besimtarët në këtë ngjarje. Në fakt, kjo është e vërteta, sepse në çdo ngjarje që ndodh, besimtarët nuk mund të ndahen nga njëri-tjetri, sepse ata janë së bashku në gëzime e në hidhërim.

Në vijim, ajeti përmend dy çështje:

Çështja e parë:

“...secili prej atyre do të ketë dënimin sipas pjesëmarrjes në mëkat...”

Ajeti thekson se përgjegjësia më e madhe bie mbi shpatullat e fajtorëve kryesorë, por as të tjerët nuk do të mbeten pa marrë përsipër një pjesë të saj; pra çdo individ do të mbajë përgjegjësinë e tij kundrejt çdo komploti.

Çështja e dytë:

“...dhe ai që barti pjesën më të madhe (të shpifjes) do të ketë dënimin më të madh.”

Disa prej interpretuesve të Kur'anit kanë thënë se personi për të cilin flet ajeti është Abdulla bin Ebù Selùli, kreu i përhapësve të shpifjes.

Interpretues të tjerë kanë thënë se ajeti flet për Mistah bin Ethàtheh dhe Hasàn bin Thàbitin, si vërtetues të asaj shpifjeje.

Sidoqoftë, personi që u aktivizua më shumë se të tjerët në këtë ngjarje dhe që ndezi zjarrin e shpifjes, është kreu i atij grupi, i cili do të ndëshkohet me një ndëshkim të rëndë, për shkak të fajit të tij të madh. (Ka mundësi që fjala e ajetit “*teuel'là*” - mori mbi vete, u aktivizua më shumë - t'i jetë adresuar kreut të përhapjes së shpifjes.)

Ajeti vijues u drejtohet atyre besimtarëve që u mashtruan prej fjalëve të shpifësve e ranë nën ndikimin e tyre. Për këtë, Kur'ani i qorton rëndë duke u thënë: **“Kur ju e dëgjuat atë (shpifjen), përse besimtarët dhe besimtare të mos mendonin të mirën si për vete?”**

Pra, përse ju nuk u hodhët kundër hipokritëve furishëm, por kënaqeshit me fjalët që ata lëshonin, ndonëse ato prekën edhe besimtarë të tjerë, që ishin në të njëjtën pozitë me ju? Përse nuk e hodhët poshtë këtë akuzë dhe të thonit se kjo fjalë është rrenë e shpifje, ashtu siç thotë ajeti: - **“...dhe të thonin: kjo është shpifje e qartë?”**

Ju e dinit mirë të kaluarën e keqe të këtij grupi hipokritësh, ashtu sikurse edhe pastërtinë e personit të akuzuar dhe, me argumentet e shumta që kishit në dorën tuaj, ishit të sigurtë se kjo akuzë nuk ishte e vërtetë.

Gjithashtu, ju e dinit se ç'komplete kurdisnin armiqtë e hipokritët kundër Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), prandaj e meritoni plotësisht qortimin e rëndë, jo vetëm për shkak se nuk iu kundërvutë fjalëve të rreme që ata përhapnin, por edhe sepse heshtët përballë shpifjes dhe, me dashje ose pa dashje, u përzier në përhapjen e këtyre fjalëve.

Në këtë ajet bie në sy fakti se në vend që t'u thotë: "*keni detyrë të përmirësoni mendimin për akuzuesin dhe të vërtetoni akuzën që ai bën*", u drejtohet me fjalët: "**Kur ju e dëgjuat atë (shpifjen), përse besimtarët dhe besimtare të mos mendonin të mirën si për vete?**" Kjo formë shprehjeje, siç thamë më sipër, tregon se shpirtërisht besimtarët ishin si një trup i vetëm dhe kur akuzohej njëri prej tyre, ishte sikur akuza të bëhej kundër të gjithë besimtarëve. Shembulli i atyre në këtë akuzë është si shembulli i një personi që ankohet se ka dhimbje vetëm në njëren gjymtyrë, por në të vërtetë, ai ndien dhimbje në të gjitha gjymtyrët e trupit të tij.

Ja, kështu duhet të hidhet myslimani për të mbrojtur vëllezërit e motrat e tij në fe, sikur të mbronte vetveten.

Në të vërtetë, fjala "*e enfusi*" – "*veten*" është përdorur edhe në ajete të tjera të Kur'anit po me këtë kuptim, ashtu siç ka ardhur edhe në ajetin 11 të sures "*El Huxhuràt*": "**mos e thërrisni veten tuaj (njëri-tjetrin) me nofka.**". Për sa i përket mbështetjes në burrat besimtarë e në gratë besimtare, ajeti thekson fuqinë e besimit për të sprapsur mendimin e keq të të tjerëve.

Edhe atëherë kur qortimi ka natyrë morale, përsëri presupozon mos-heshtjen e besimtarëve kundrejt një akuze të tillë

të keqe dhe ka për qëllim që besimtarët të mos jenë mjet në dorën e përhapësve të atyre shpifjeve të rreme.

Më pas, ajetet prekin anën gjyqësore të problemit dhe thonë: **“Përse ata nuk sollën katër dëshmitarë për këtë?”**; pra përse ju nuk u kërkuat atyre të sillnin katër dëshmitarë?

“Dhe, derisa ata nuk sollën dëshmitarë, tek All'llahu ata janë gënjeshtarët.”

Ky qortim shpjegon faktin se dispozita e dëshmisë së katër dëshmitarëve, si dhe dispozita që parashikon ndëshkimin e atij që lëshon akuza për nderin e personit nëse ai nuk sjell katër dëshmitarë, kanë zbritur para ajeteve që trajtojnë ngjarjen e shpifjes.

Për sa i përket pyetjes se përse Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk e zbatoi këtë dispozitë, përgjigja është e qartë: Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk ka ndërmarrë asnjë veprim derisa për atë problem të kishte mbështetje nga ana e njerëzve. Veç kësaj, në atë gjendje, zbatimi i dispozitës për ndëshkimin e atij që shan gratë në nder, mund të çonte në një rezistencë negative ndaj disa dispozitave të All'llahut, qoftë edhe në formë të përkohshme. Historianët kanë përmendur se i tillë ishte qëndrimi ndaj këtij problemi.

Në fund, ajeti vijues i përmbledh këto qortime dhe njofton:

“Dhe, sikur të mos ishte mirësia e All'llahut dhe mëshira e Tij ndaj jush, në këtë botë e në Botën Tjetër, mbi ju do të binte një dënim shumë i madh për shkak të asaj që ju bëtë.”

Fjala e ajetit “*efedhtum*” ka kuptimin e daljes së ujit me shumicë, por në disa raste të tjera është përdorur edhe në kuptimin e të depërtuarit në ujë. Duke u nisur nga kuptimi i kësaj fjale, rezulton se përhapja e shpifjes ishte zgjeruar aq shumë, saqë kishte përfshirë të gjithë besimtarët me në krye propaganduesit kryesor të shpifjes, që ishin hipokritët.

Ajeti vijues trajton studimin e mësipërm dhe njofton se besimtarët u vunë në provë me këtë faj kaq të madh si rezultat i tolerancës së tepruar që ata treguan. Në ajet thuhet: **“Kur ju e lakonit atë (shpifjen) me gjuhët tuaja”**; pra si është e mundur që ju e miratuat këtë akuzë të rreme dhe filluat ta qarkulloni shpifjen dhe arritët deri aty sa: **“e me gojën tuaj thoni gjëra për të cilat nuk keni asnjë dijeni; ju e menduat atë gjë pa rëndësi, ndërsa tek All'Ilahu ajo është e madhe.”**.

Në këtë aspekt, ajeti thekson tri lloje mëkatesh të mëdha:

I pari: pranimi i fjalëve të përhapura dhe përcjellja e tyre lart e poshtë.

I dyti: shpërndarja e atyre fjalëve pa i vërtetuar dhe pa ditur asgjë se sa të vërteta janë.

I treti: zvogëlimi i rëndësisë së fjalëve të përhapura dhe të konsideruarit e tyre si zbavitje, në një kohë kur ato preknin identitetin e shoqërisë islame dhe nderin e saj, si dhe disa myslimanë në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Në këtë ajet bie në sy se herë është përdorur shprehja “*bi elsinetikum*”- **“me gjuhët tuaja”** dhe herë tjetër shprehja “*bi efuàhikum*” - **“me gojët tuaja”**, megjithëse të gjitha fjalët dalin me

anë të gjuhës e të gojës. Me këtë mënyrë të shprehuri, besimtarëve u thuhet: Ju nuk kërkuat argument për fjalët që pranuat dhe as nuk keni argument që t’jua lejojë përhapjen e atyre fjalëve. E vetmja gjë që kishit në dorë ishte që të bënit zhurmë me gjuhët tuaja dhe të lëviznit gojën.

Duke pasur parasysh të ligën e kësaj ngjarjeje, por që disa myslimanë e zvogëluan, ajeti thekson edhe një herë se sa e rëndë ishte ajo, prandaj ua tërheq vëmendjen dhe u flet besimtarëve drejtpërdrejt: **“Kur e dëgjuat atë, përse nuk thatë: nuk na takon ne të flasim për këtë; i Larti je vetëm Ti, kjo është një shpifje e madhe.”**

Ajeti i nderuar edhe më parë i ka qortuar ata, për shkak se nuk menduan siç duhet për personin që lëshoi kundër tyre akuzën e rreme. Me fjalë të tjera, ajeti u thotë besimtarëve: Përveç detyrës që kishit për të pasur mendim jo të mirë për akuzuesin, patjetër që duhej t’i lejonit vetes të flisni për akuzën që ai lëshoi dhe të mos e qarkullonit atë në mesin tuaj. Si është e mundur që ju të bëheni përhapës të asaj akuze?!

Ju kishit detyrë të çuditëshit prej kësaj akuze të madhe dhe përhapjes së gjerë që ajo mori. Gjithashtu, ju kishit detyrë të përmendnit All'llahun e Gjithëfuqishëm dhe të kërkonit strehim vetëm tek Ai, që t’u pastronte nga përhapja e saj. Por me keqardhje, ju e zvogëluat rëndësinë e së keqes që kishte ajo akuzë, e cila pavarësisht nga përmasat e mëdha që mori, u përhap me lehtësi, ngaqë ju jo vetëm që u bëtë vegël në duart e hipokritëve komplotistë, por edhe propagandues për përhapjen e kësaj akuze të rreme.

Gjatë interpretimit të ajeteve vijuese do të trajtohet faji i sajimit të akuzave të rreme, motivet shtytëse për fabrikimin e akuzave të tilla, si dhe rrugët për luftimin e tyre.

Ajetet 17 - 20

[illegible]

“All'Ilahu u këshillon që një gjë të tillë të mos e përsëritni më kurrë, nëse me të vërtetë jeni besimtarë.”

“All'Ilahu shpjegon qartë për ju argumentet, Ai është i Gjithëdituri, i Urti.”

“Ata që kanë qëllim përhapjen e imoralitetit ndër besimtarët, i pret një dënim shumë i dhimbshëm, në këtë botë e në Botën Tjetër; All'Ilahu di (të fshehtat) që ju nuk i dini.”

“Sikur të mos ishte mirësia e All'Ilahut dhe mëshira e Tij ndaj jush, (menjëherë mbi ju do të zbriste dënimi) por All'Ilahu është shumë i butë dhe shumë i mëshirshëm.”

Komentimi

Ndalimi i rreptë i përhapjes së imoralitetit

Edhe ky grup ajetesh flet për ngjarjen e shpifjes, si dhe për rezultatet e mbrapshta e të dhimbshme që sjell përhapja e akuzave të rreme për imoralitet, sidomos akuzimi në nder i njerëzve të ndershëm. Aq e rëndësishme është kjo çështje, sa që Kur'ani Famëlartë e ka përmendur disa herë. Në të tregohen rrugët e ndryshme që ndikojnë në përhapjen e shpifjeve për imoralitet dhe jepen zgjidhje për to, me qëllim që një ngjarje e tillë e dhimbshme të mos përsëritet më në shoqërinë islame.

Në fillim, ajeti njofton: **“All'llahu ju këshillon që një gjë të tillë të mos e përsëritni.”**¹

Pra, prej shenjave të besimit është që njeriu të mos orientohej drejt mëkateve të mëdha. Nëse e bën një gjë të tillë, kjo tregon se ai ose nuk ka besim, ose e ka shumë të dobët atë. Fjala e përmendur në këtë ajet përbën njëërën prej shtyllave të pendimit (*teubes*), sepse nuk mjafton vetëm pendimi për atë që ke bërë në të kaluarën, por kërkohet patjetër edhe vendosmëria për të mos e përsëritur atë mëkat në të ardhmen; vetëm kështu është i plotë pendimi.

Për ta theksuar këtë të vërtetë edhe më shumë, për të treguar se kjo nuk është fjalë e zakonshme, por e ka burimin nga All'llahu, i Gjithëdituri, i Urti, si dhe për të shpjeguar të vërtetat me ndikim veprues në të ardhmen e njeriut, i Plotpushtetshmi, i Gjithëfuqishmi dhe i Larti thotë: **“All'llahu shpjegon qartë për ju argumentet, Ai është i Gjithëdituri, i Urti.”**

All'llahu ka dijeni të plotë për hollësitë e punëve tuaja dhe, për të mirën tuaj, Ai i nxjerr dispozitat e Tij në përputhje me Urtësinë e Tij udhëzuese për në rrugën e drejtë; me fjalë të tjera, vetëm All'llahu ka dijeni për nevojat tuaja, për gjërat që ju dëmtojnë dhe për ato që ju sjellin dobi. Kjo është në përputhje me dijen e Tij pambarimisht të gjerë, prandaj edhe dispozitat e

¹ Prej kësaj fjalie është hequr fjala “lâ” - “mos” dhe, sipas këtij vlerësimi, ajeti do të ishte: “All'llahu ju këshillon që ju kurrë të mos i ktheheni më këtij zakoni”; nëse nuk do ta konsiderojmë të hequr, atëherë folja “*jeidhukum*” - “ju këshillon” do të thotë: **ju ndalon**, në kuptimin: “All'llahu ju ndalon t'i riktheheni një veprë të tillë”.

urdhrrat e Tij dalin prej urtësisë së Tij dhe janë në përshtatje me nevojat tuaja.

Për të vërtetuar urdhrin dhe për ta bërë të qartë se ligji është i përgjithshëm dhe gjithëpërfshirës, i Larti njofton me fjalën e Tij: **“Ata që kanë qëllim përhapjen e imoralitetit ndër besimtarët, i pret një dënim shumë i dhimbshëm, në këtë botë e në Botën Tjetër.”**.

Këtu të tërheq vëmendjen fakti se Kur’ani Famëlartë nuk ka thënë: “Ata që përhapin të keqen”, por **“Ata që kanë qëllim përhapjen e imoralitetit ndër besimtarët.”**. Me këtë shprehje tregohet rëndësia e madhe që i kushton Kur’ani kësaj çështjeje; me fjalë të tjera, askush nuk duhet të mendojë se kjo dispozitë ishte e veçantë vetëm për gruan e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ose për ndonjë person tjetër që ishte në pozitën e saj. Jo! Dispozita është për çdo besimtar e besimtare. Në të s’ka asnjë përveçim. Ajo i përfshin të gjithë, pavarësisht se çdo gjendje ka veçoritë e saj dhe çdo çështje mund të ketë më shumë ose më pak veçanti se të tjerat.

Gjithashtu, është detyrë të tërheqim vëmendjen se përhapja e imoralitetit nuk kufizohet vetëm në përhapjen e akuzave të rreme kundër një myslimani besimtar, mbi të cilin hidhet akuza për një punë që është në kundërshtim me nderin. Ky është vetëm një prej aspekteve të kësaj çështjeje. Shprehja e trajtuar ka një kuptim shumë të gjerë, sepse në fjalët e ajetit përfshihet edhe çdo veprim që ndihmon në përhapjen e imoralitetit dhe të punëve të urryera.

Në Kur’anin Famëlartë, fjala *“el fahshài”*, në të shumtën e herëve është përdorur për të treguar një punë që e prish nderin,

por nga ana gjuhësore, ashtu siç ka thënë edhe Ràgib El-Isfehàni në fjalorin e tij “Mufredàt Elfàdhul-Kur’ànì”, kjo fjalë ka një kuptim shumë të gjerë. Prandaj në Kur’an, kjo vepër paraqitet edhe me fjalët “*el fash*”, “*el fahshài*” dhe “*el fâhishetu*”, që janë sinonime të fjalës “*imoralitet*”. Të gjitha këto fjalë tregojnë se e keqja që shpreh kuptimi i tyre është shumë më e madhe se vetë veprimi i kryer dhe se vetë shpifjet e përhapura.

Disa herë, Kur’ani e përdor këtë fjalë në këtë kuptim të gjerë, ashtu siç thuhet në ajetin 37 të sures “Esh Shuarà”: **“Dhe ata që i qëndrojnë larg mëkateve të mëdha dhe imoralitetit.”**

Me këtë shpjegohet qartë kuptimi i gjerë që ka kjo fjalë e ajetit.

Fraza e ajetit të Kur’anit Famëlartë: **“i pret një dënim shumë i dhimbshëm, në këtë botë”**, tregon ndëshkimet që parashikon dispozita, ose dënimet ligjore, si dhe reagimet nga ana e shoqërisë. Me fjalë të tjera, kjo frazë tregon të gjitha situatat e vështira që do të kalojnë njerëzit në këtë botë, për shkak të punëve të këqija që kanë bërë. Siç e pamë, e keqja arrin deri në mospranimin e dëshmisë prej atyre që i janë nënshtruar ndëshkimit të parashikuar për akuzimin e gruas në nder pa sjellë katër dëshmitarë, duke përfshirë edhe dënimin e tyre si njerëz të këqinj, damkosjen e tyre në sytë e shoqërisë si mëkatarë, dhe diskreditimin e punës së tyre. Të gjitha këto rezultate të rënda në këtë botë renditen në bazë të fjalëve e të punëve të tyre të këqija.

Për sa i përket ndëshkimit të tyre të dhimbshëm, ai do të jetë për shkak të largimit prej mëshirës së All'Ilahut dhe për shkak

se ata e kanë merituar të jenë nën zemërimin e All'llahut. Për këtë, ata do të dënohen në zjarr.

Ajeti mbyllet me frazën: **“All'llahu di (të fshehtat) që ju nuk i dini.”**. All'llahu ka dijeni të plotë për përfundimin e mjerueshëm që i pret në këtë botë e në Botën Tjetër ata që e përhapin imoralitetin.

All'llahu i Lartësuar ka dijeni të plotë rreth asaj që ata bluajnë në zemrat e tyre, si dhe sa shumë dëshirë kanë ata për ta kryer këtë faj, ashtu siç ka dijeni të plotë edhe për punët që i praktikojnë të mbuluara me maska mashtruese; kurse ju, as nuk i dini e as nuk i kuptoni mashtrimet e tyre.

S'ka dyshim se vetëm All'llahu i Lartësuar, me diturinë e Tij të gjithanshme, i zbret dispozitat e Tij, me qëllim që të ndalojë kryerjen e këtyre punëve të këqija.

Ajeti i fundit e përsërit çështjen që është objekt studimi dhe që u trajtua edhe në ajetet e mëparshme: ngjarjen e shpifjes, luftimin e imoralitetit dhe të sharjes në nder të besimtarëve të pastër. Pikërisht kjo e vërtetë theksohet edhe një herë në fjalën e të Lartit: **“Sikur të mos ishte mirësia e All'llahut dhe mëshira e Tij ndaj jush (menjëherë mbi ju do të zbriste dënimi), por All'llahu është shumë i butë dhe shumë i mëshirshëm.”**.

Hulumtime

1- Ç'do të thotë “përhapje e imoralitetit”?

Njeriu, si krijesë shoqërore, jeton në shoqëri dhe shoqëria njerëzore gëzon një paprekshmëri që nuk duhet të jetë më e vogël sesa paprekshmëria personale e vetë njeriut. Prandaj, pastërtia e individit ndihmon në pastërtinë e shoqërisë dhe anasjelltas; po ashtu, edhe e keqja e njeriut ndikon për keq në të gjithë shoqërinë. Bazuar mbi këtë parim, Islami e ka luftuar ashpër çdo punë që përhap helmin e degjenerimit moral në shoqëri, helm që e shtyn këtë të fundit drejt greminës e degradimit të plotë.

Ky është edhe shkaku që Islami e lufton ashpër edhe përgojimin e thashethemet (përcjelljen e fjalëve sa te njëri te tjetri), sepse ato i zbulojnë të metat e fshehura dhe e përkeqësojnë paprekshmërinë e shoqërisë.

Islami e ka bërë detyrim mbulimin e të metave. Shkak për këtë është ndalimi i përhapjes së fajeve në shoqëri, në mënyrë që të metat të mos marrin karakter të përgjithshëm e të përfshijnë të gjithë individët.

Të metës që duket sheshit, ne i japim rëndësi më shumë sesa fajit që bëhet në fshehtësi. Për këtë, Imam Ali bin Mûsà Kadhimi ka thënë: *“Ai që e përhap të keqen është i braktisur, kurse atij që e mbulon të keqen, i falen mëkatet.”*¹

Për të njëjtin shkak, Kur'ani Famëlartë dënon ashpër kryerjen e fajeve haptazi, siç është përhapja e akuzave për imoralitet, që u përmend në ajetet e mësipërme, sepse fajet janë si zjarri që depërton në barin e thatë; ato që kryhen haptazi e

¹ “Usûl Kâfij”, vëll. 2, kapitulli: “Mbulimi i të metave”.

gërrryejnë shoqërinë e pastër islame, derisa e shembin dhe e shkërmoqin atë. Prandaj, është detyrim që të shpejtohet lufta e madhe për shuarjen e këtij zjarri, ose më e pakta lokalizimi i tij. Nëse flakët e tij shtohen, ose nëse vetë ne e çojmë këtë zjarr prej një vendi në një vend tjetër, ai do t'i djegë të gjithë dhe pas kësaj përhapjeje, ai zjarr as do të mund të shuhet e as të vihet nën kontroll.

Përveç kësaj, sikur ta dinin të gjithë njerëzit të keqen e madhe që ka faji i përhapjes së akuzave të rreme për imoralitet dhe për çdo punë tjetër jo të denjë, do të ruhej patjetër shoqëria prej njollosjes e degjenerimit; nga ana tjetër, kjo do të shërbente si mjet për të ndaluar edhe përhapjen e akuzave për imoralitet. Përhapja e akuzave për imoralitet dhe kryerja haptazi e fajëve dhe e veprave të turpshme e të ndaluara, janë prej punëve që e shembin murin që ndalon të turpshmen. Gjithashtu, kryerja sheshit e punëve të ndaluara dhe e çdo lloj shpifjeje, e ul rëndësinë e mëkateve në mendimin e njerëzve dhe bën që në to të përzihen shumë veta.

Në një hadith të transmetuar prej të Dërguarit më të nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), thuhet: “Ai që përhap akuza për imoralitet, është sikurse ai që e bën imoralitetin.”.¹

Në një transmetim të përcjellë nga Muha'med bin Fadli, prej Imam Mùsà bin Xhaferit, ai tregon: “I thashë: Njëri prej vëllezërve më njoftoi për një punë që e urrej dhe, kur e pyeta atë, më tha se edhe ai e urrente. Për të njëjtën punë më njoftuan edhe disa burra të tjerë dhe ishin burra që u besohet fjala. Imami më

¹ Burimi i mësipërm.

tha: 'O Muhammed, veshi e syri yt kanë gënjyer për vëllain tënd. Nëse te ti dëshmojnë pesëdhjetë vetë prej atyre që dinë të pjesëtojnë dhe të thonë një fjalë të vërtetë ose gënjeshtër, ti mos thua asnjë fjalë që mund të prekë e të shkatërrojë burrërinë e tyre; përndryshe, ti do të jesh prej atyre, për të cilët All'llahu i Gjithëpushtetshëm thotë: **'Ata që kanë qëllim përhapjen e imoralitetit ndër besimtarët, i pret një dënim shumë i dhimbshëm, në këtë botë e në Botën Tjetër.'**"¹dhe²

Përhapja e imoralitetit ka forma të ndryshme e të shumta. Ndonjëherë, ajo mund jetë në trajtën e stisjes së një akuze të rreme dhe përhapjes së saj ndër njerëzit.

Rrugë tjetër për përhapjen e imoralitetit mund të jetë ndërtimi i qendrave të degjenerimit dhe të punëve të ndaluara. Imoraliteti mund të përhapet edhe nëpërmjet shtimit të mjediseve dhe të mjeteve që favorizojnë kryerjen e mëkatit si dhe inkurajimit të njerëzve për të bërë sa më shumë faje e mëkate.

Një rrugë tjetër mund të jetë kryerja e fajeve sheshit, pa pasur respekt për fenë dhe pa u ruajtur prej ligjit, apo pa u merakosur për edukatën e njerëzve në përgjithësi. Të gjitha këto që u thanë, e lehtësojnë përhapjen e imoralitetit, duke pasur parasysh se fjala *imoralitet* ka një kuptim shumë të gjerë.

¹ Libri "Thevâbul Aëmalı" –"Shpërblimi i punëve", f. 247; sipas asaj që është thënë në tefsirin "Nuruth Thekalejn", vëll. 3, f. 582.

² Për këtë çështje ka edhe përveçime, prej të cilave është edhe problemi i dëshmisë në gjykatë, ose rastet e ndalimit të punëve të këqija, kur s'ka rrugë tjetër, vetëm duke e bërë të njohur për të tjerët punën e keqe që e ka bërë dikush, ose duke e dëshmuar punën e keqe kundër personit që e ka kryer atë.

2- E keqja e madhe e përhapjes së fjalëve të pavërteta

Stisja dhe përhapja e fjalëve të rreme çon në një gjendje, në të cilën bëhen zotërues shqetësimi, diktati i trazimit të brendshëm dhe mungesa e besueshmërisë ndër njerëzit. Të gjitha këto janë prej gjërave më të rëndësishme që përmban lufta psikologjike e kolonialistëve, përveç ngjalljes së panikut e përhapjes së frikës nga mposhtja ushtarake e politike.

Kur armiku s'ka mundësi të dëmtojë drejtpërdrejt, atëherë ai praktikon përhapjen e akuzave të rreme, me qëllim që njerëzit të ndihen të frikësuar e të shqetësuar dhe që ata të merakosen vetëm për veten e tyre. Me të tilla mënyra veprimi, armiku ka për qëllim t'i largojë njerëzit prej problemeve më të rëndësishme që ata kanë; njëkohësisht, me përhapjen e akuzave të rreme, armiku synon të shpalosë para syve të njerëzve mundësitë e mëdha që ka, si dhe t'i bindë mendjet e njerëzve se ai qëndron më lart se ata në të gjitha fushat. Për këtë, ai propagandon fuqinë shkatërruese të armëve që disponon, si dhe metodat e përdorura kundër njerëzve të mirë, me qëllim që t'i izolojë ata dhe t'i ndajë njerëzit prej tyre.

Sipas shkaqeve të zbritjes që tashmë njihen mirë dhe që ne i pamë në ajetet që janë objekt studimi, hipokritët ndoqën edhe rrugën më të ulët për të njollosur zërin e mirë që gëzonte Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Me qëllim që të ulnin autoritetin e tij të shenjtë ndër njerëzit, hipokritët stisën akuzën e rreme që prekte pastërtinë e nderit të njërës prej grave të tij. Përgjatë rrugës së stisjes, ata përgjonin edhe rastin më të vogël që u dilte përpara. Tashmë dihet se ky veprim i hipokritëve (*munafikëve*) çoi në çoroditjen e mendjeve të myslimanëve, futi dëshpërimin në zemrat e tyre deri në atë

shkallë, saqë u turbulluan të gjithë. Besimtarët u shqetësuan shumë dhe kjo gjendje vazhdoi, derisa zbriti shpallja që i shpëtoi besimtarët, ua zhyti hundën në llucë hipokritëve për akuzën e rreme që kishin stisur dhe bëri që dënimi i tyre të ishte mësim për të tjerët.

Ndonëse stisja e akuzave të rreme konsiderohet si një lloj lufte në shoqëritë ku sundon diktatura, shoqëri në të cilat njerëzit e kanë humbur lirinë, sërish shkak i kësaj stisjeje mbetet hakmarrja, larja e hesapeve kundër personave të caktuar, ulja e besueshmërisë në personalitetet e mëdha dhe devijimi i opinionit publik prej problemeve thelbësore.


Neve nuk na intereson shumë të dimë faktorët që çuan në stisjen e akuzave të rreme, sepse më e rëndësishme është të paralajmërohet shoqëria që të mos bjerë pre e mashtrimit të atyre që stisin akuza të rreme, apo të atyre që i përhapin ato te njerëzit. Qëllimi kryesor i atyre që stisin shpifjen e akuzën e rreme si dhe i atyre që i përhapin ato, është që masa e njerëzve të bëhen përhapës të shpifjeve e të akuzave të rreme dhe kështu, të shkatërrojnë me duart e veta shoqërinë e veten e tyre. Ne duhet t'i mësojmë njerëzit që t'i groposin akuzat e rreme sapo ato të shfaqen, përndryshe kemi gëzuar zemrën e armikut. Në të njëjtën kohë, ne jemi bërë prej atyre që do të ndëshkohen në këtë botë e në Botën Tjetër, ashtu siç thuhet tekstualisht në ajetet që trajtuam më lart.

Ne pamë se ajetet e mësipërme e konsiderojnë punë të urryer zvogëlimin e rëndësisë së përhapjes së shpifjeve e të akuzave të rreme. Në këto ajete thuhet qartë se kjo gjë, jo vetëm që është një gabim shumë i rëndë, por edhe një krim i madh. Në të

vërtetë, zvogëlimi i fajit është një faj i dytë. Kush bën një faj dhe e ndjen të keqen e madhe të tij, ky njeri pendohet për atë ç'ka bëri dhe për të shpresohet se do të bëjë *teube* e se do të përmirësohet.

Për sa i përket atij që e zvogëlon rëndësinë e fajit dhe thotë: “Jam shumë i lumtur që faji im të jetë vetëm ky”, ai njeri ecën në një rrugë të rrezikshme dhe do të vazhdojë të bëjë faje të tjera. Në një transmetim të ardhur prej Imam Aliut thuhet: “*Faji më i rëndë është kur fajtori e konsideron fajin e tij si një gjë pa rëndësi.*”¹

Ajetet 21 - 26



¹ “Nehxhul Belaga”, “Fjalët e shkurtra”, nr. 348.

“Të këqijat janë për të këqinjtë dhe të këqinjtë janë për të këqijat; të mirat janë për të mirët dhe të mirët janë për të mirat; ata janë të pafajshëm për ato që thuhën kundër atyre; për ata (të akuzuarit padrejtësisht) ka falje të madhe dhe një furnizim të begatshëm.”

Komentimi

Ndëshkimet janë llogaridhënie

Pavarësisht se ky grup ajetesh nuk e trajton drejtpërdrejt ngjarjen e shpifjes, ai konsiderohet si plotësues i studimit rreth kësaj çështjeje. Këto ajete paralajmërojnë të gjithë besimtarët për ndikimin që kanë mendimet djallëzore, të cilat në fillim duken si të habitshme, por duhet pasur kujdes ndaj tyre, përndryshe rezultati do të jetë shumë i keq dhe nuk do të jetë e mundur që ato të kapen me lehtësi. Individit, qysh në dyshimin e parë, e ndjen djallëzinë që ka në përhapjen e akuzave të rreme për imoralitet, ose për çdo faj tjetër. Prandaj del detyrë të qëndrohet fuqishëm e me vendosmëri kundër një djallëzie të tillë, me qëllim që ajo të ndalohet dhe të merren të gjitha masat e duhura që edhe mendimi për përhapjen e shpifjeve dhe akuzave për imoralitet, të mos gjejë terren ku të përhapet.

Ajeti i parë i grupit të ajeteve që janë objekt studimi, u flet besimtarëve në vetën e dytë dhe u thotë: **“Ju që keni besuar, mos ndiqni gjurmët e djallit; ai që ndjek gjurmët e djallit (le të dijë) se djalli urdhëron imoralitetin e punën e urryer.”**.

Kur me fjalën “shejtàn”- “djall”, kemi parasysh çdo krijesë që sjell mundim, fyerje, imoralitet dhe shkatërrim, për ne bëhet e qartë se ky paralajmërim përfshin të gjitha dimensionet e jetës tonë. Pra, besimtari i pastër dhe i virtytshëm e ka të pamundur të anojë qoftë edhe një herë të vetme nga imoraliteti, pasi degradimi deri në të arrihet duke ecur në rrugën e degjenerimit hap pas hapi:

Hapi i parë: Shoqërimi me të njollosurit e me ata që kanë devijuar nga rruga e drejtë.

Hapi i dytë: Pjesëmarrja në kuvendet e tyre.

Hapi i tretë: Mendimi për të kryer faje.

Hapi i katërt: Kryerja e punëve të ngjashme me fajet.

Hapi i pestë: Kryerja e fajeve të vogla.

Hapi i gjashtë: Sprovimi me faje të mëdha.

Në etapën e fundit njeriu ia dorëzon veten një kriminel, që ta çojë drejt greminës dhe, padyshim, të gjitha këto s’janë gjë tjetër veçse “khutuvâtish’shejtàn”- “hapat e djallit”.

Në vijim, ajeti thekson njëren prej mirësive më të mëdha, që njeriut i është dhuruar nga All’llahu për t’u udhëzuar në rrugën e drejtë: **“...dhe, sikur të mos ishte mirësia e All’llahut dhe mëshira e Tij ndaj jush, asnjëri prej jush kurrë nuk do të**

pastrohej (prej mëkateve), por All'llahu e pastron atë që Ai do; All'llahu është Dëgjuesi, i Gjithëdituri.”.

Padyshim që mirësia e mëshira hyjnore e shpëtojnë njeriun prej degjenerimit, prej devijimit nga rruga e drejtë dhe prej të gjitha mëkateve e fajeve. All'llahu, i Gjithëpushtetshmi, i ka dhënë njeriut mendjen dhe, me mirësinë e Tij, ka dërguar për njerëzit Profetë. Ai ia ka lehtësuar njeriut rrugët e lartësimit e të orientimit dhe e ka ndihmuar atë të plotësojë të mirën. Përveç këtyre dhuntive, All'llahu i ka përfshirë në mëshirën e Tij ata që janë pastruar në saje të mirësisë së veçantë prej Tij dhe në saje të përforsimeve që Ai u ka dhënë, të cilat konsiderohen si elementi më i rëndësishëm për pastrimin e shpirtit.

E kemi përsëritur disa herë se fraza e ajetit “*men jeshàu*”- “**atë që Ai do**”, nuk është në kuptimin e dëshirës së pajustificuar. All'llahu i Lartësuar udhëzon në rrugën e drejtë vetëm ata robë të Tij, që punojnë për ta arritur atë rrugë; pra, Ai udhëzon ata që ecin në rrugën e drejtë dhe që luftojnë në të. Pikërisht këta njerëz, All'llahu i kap për dore dhe i ruan prej cytjeve e kurtheve të djallit, derisa ata të arrijnë objektivin më të lartë.

Thënë ndryshe: mirësia dhe mëshira hyjnore për ta, herë do të jenë të natyrës ligjore, nëpërmjet rrugës së të Dërguarve dhe të Librave Qiellorë e të mësimave hyjnore, që janë në ato libra (duke përfshirë këtu edhe përgëzimet e paralajmërimet qiellore), e herë tjetër do të jenë të natyrës konstruktive, nëpërmjet rrugës së përforsimeve me morale hyjnore.

Ajetet që janë objekt studimi, kanë qëllim pjesën e dytë dhe kjo del qartë prej argumentit që gjendet në frazën “*men jeshàu*” -

“atë që Ai do”; gjithashtu, këtu del detyrë të tërhiqet vëmendja se në rrënjën e saj, fjala e ajetit **“zekà”** – **“pastroi”** ka kuptimin e rritjes dhe të punës për rritjen, porse ajo, në shumicën e rasteve, ka ardhur në kuptimin e pastrimit e të vetëpastrimit.

Gjithsesi, ekziston mundësia e kthimit të këtyre kuptimeve në një origjinë të vetme, pasi rritja dhe orientimi nuk mund të realizohen pa hequr pengesat dhe pa u pastruar prej punëve të ndaluara e të ulëta.

Disa prej interpretuesve të Kur'anit Famëlartë kanë përmendur edhe shkaqet e zbritjes së ajetit të dytë prej grupit të ajeteve që janë objekt studimi. Ata janë shprehur se ky ajet zbulon lidhjen kompakte me ajetet e mëparshme. Gjithashtu, ata kanë thënë se ky ajet ka zbritur në lidhje me disa sahabë, të cilët u betuan të mos u jepnin ndihma financiare atyre që u ngatërruan në problemin e shpifjes dhe që e përhapën këtë akuzë te njerëzit; madje, ata u betuan se nuk do të ishin më pranë tyre as në raste fatkeqësish. Pas kësaj ngjarjeje zbriti menjëherë ky ajet, i cili jo vetëm që i ndaloi sahabët prej këtij reagimi të ashpër, por edhe i urdhëroi që t'i falnin ata që kishin gabuar dhe të tregoheshin zemërgjerë.

Ky shkak për zbritjen e këtyre ajeteve është përmendur në tefsirin e “Kurtubij’jit”, sipas një transmetimi të radhitur nga Ibni Ab’bàsi dhe Dah’hàku. Gjithashtu, këtë shkak e ka përmendur edhe i ndjeri Et Tabresij, sipas transmetimit të Ibni Ab’bàsit. Të njëjtin shkak për zbritjen e këtij ajeti e kanë përmendur edhe interpretues të tjerë të Kur’anit Famëlartë gjatë komentimit të ajeteve që janë objekt studimi. Vërehet se ky shkak i përmendur për zbritjen e ajetit të dytë të këtij grupi, ka karakter

gjithëpërfshirës, pra nuk u adresohet vetëm sahabëve që u betuan, por i përfshin të gjithë myslimanët.

Megjithatë, disa interpretues prej Ehli Syneetit këmbëngulin se ky ajet ka zbritur në lidhje me qëndrimin e Ebu Bekrit, kur ai u betua që të mos i jepte asnjë ndihmë financiare djalit të hallës së tij, Mistah bin Ethàtheh, për shkak se kishte përhapur akuzën e shpifjes; por duhet theksuar se përemrat e përdorur në këtë ajet kanë ardhur në numrin shumë, çka tregon se një grup prej myslimanëve vendosën ta ndërprisnin ndihmën që u jepnin atyre që e përhapën shpifjen, porse ajeti i ndaloi ata nga vendimi i marrë.

Dihet se ajetet e Kur'anit nuk janë vetëm për personat që janë përmendur në shkakun e zbritjes, por përfshijnë të gjithë besimtarët deri në Ditën e Kiametit. Këto ajete i urdhërojnë të gjithë myslimanët që të mos dorëzohen para emocioneve të çastit dhe të mos mbajnë qëndrime të ashpra ndaj atyre që gabojnë.

Do t'i rikthehemi komentimit të këtij ajeti, duke pasur në konsideratë këtë shkak për zbritjen e tij.

Kur'ani Famëlartë urdhëron: **“Të ndershmit e pasur prej jush, të mos betohen se nuk do t'u japin të afërmve, të varfërve dhe atyre që emigruan për hir të All'Ilahut.”**.

Kjo shprehje e ajetit zbulon se ndër ata që u ngatërruan në ngjarjen e shpifjes, kishte edhe prej atyre që kishin emigruar në rrugën e All'Ilahut dhe që u mashtruan prej hipokritëve (*munafikëve*); por All'Ilahu, për shkak të së kaluarës së tyre të lavdishme, nuk lejoi që ata të nxirreshin jashtë shoqërisë islame.

Gjithashtu, Islami nuk lejoi që ata të ndëshkohen më shumë nga sa e meritonin.

Në rrënjën e saj, fjala e ajetit “je’teli” – **“të mos betohen”** ka kuptimin: lë, heq dorë.

Duke u bazuar mbi këtë sqarim dhe në përputhje me kuptimin e parë, ajeti thotë: Ndalojeni betimin për të prerë ndihmat.

Kurse në kuptimin e dytë, ajeti thotë: Ndalohet lënia mangët e ndihmës për atë kategori njerëzish, për shkak se ata ranë në këtë gabim.

Më pas, ajeti shton: **“por le t’ua falin atyre (gabimin) dhe mos t’ua zënë për të madhe.”**. Qëllimi me këtë frazë të ajetit është stimulimi i myslimanëve, që ata të jenë të prirur për të falur e për të qenë tolerues ndaj të tjerëve, sepse: **“All’Ilahu është Gjithëfalësi dhe Mëshirëploti.”**.

Të habit fakti se ndërkohë që në ajetet e mësipërme, ata që e përhapën shpifjen qortohen me fjalë shumë të ashpra, ky ajet i nderuar lëviz prej qortimit të ashpër ndaj tyre dhe kalon në ndalimin e tejkalimit të kufirit në ndëshkimin e tyre. Këtë qëndrim ajeti e paraqet me tri fjali shumë zbutëse. Fjalja e parë urdhëron falje e tolerancë.

Më pas, ajeti në formë pyetjeje, thotë: A nuk doni që edhe juve t’ju falë All’Ilahu? Por për të merituar faljen e Tij, duhet që edhe ju të falni dhe të jeni tolerues.

Për të përforcuar këtë porosi hyjnore, Kur'ani Famëlartë përmend dy prej cilësive të All'llahut: *"Gàfûru"* - *"Gjithëfalësi"* dhe *"Rrahijmun"* - *"Mëshirëploti"*.

Ja, kështu u flet ajeti njerëzve dhe u thotë: Ju nuk keni mundësi të jeni më të kujdesshëm se All'llahu, sepse këtë gjykim e ka bërë vetë Ai dhe All'llahu ju urdhëron që të mos i ndërprisni ndihmat për ata që gabuan.

S'ka dyshim se të gjithë ata myslimanë që u ngatërruan në ngjarjen e shpifjes, nuk ishin pjesëmarrës në komplot, por qenë hipokritët, ata që e stisën shpifjen dhe pastaj u ndoqën nga myslimanët e paformuar.

Gjithashtu, s'ka dyshim se të gjithë ata që u ngatërruan në ngjarjen e shpifjes janë prej atyre myslimanëve që kanë lënë mangët detyrën e tyre si të tillë, prandaj ata, për shkak se u bënë përhapës të shpifjes, padyshim që janë fajtorë. Megjithatë, në mes dy grupeve - hipokritëve dhe myslimanëve të mashtruar - ka një dallim të madh. Prandaj, duke u bazuar mbi këtë dallim, mashtruesit e të gabuarit nuk duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë.

Gjithsesi, në këto ajete ka një mësim të madh për të tashmen dhe të ardhmen e myslimanëve; ato u kujtojnë myslimanëve se nuk duhet ta tejkalojnë kurrë kufirin e vendosur për ndëshkimin e fajtorëve, si dhe nuk duhet që këta të fundit të nxirren jashtë shoqërisë islame dhe t'u mbyllet në fytyrë porta e ndihmës. Ky urdhër kërkon që edhe ata që gabuan, të ruhen e të bëjnë kujdes, që të mos thellohen më shumë në devijimin e tyre

prej rrugës së drejtë; përndryshe, ata do të bien në prehërin e armikut, ose do të kalojnë në anën e tij.

Këto ajete përshkruajnë formën e maturisë së Islamit në fushën e tërheqjes së njerëzve. Në të njëjtën kohë, ato përshkruajnë edhe rastet kur të pandreqshmit duhet të nxirren jashtë shoqërisë islame. Ajetet e mësipërme, që flasin për ngjarjen e shpifjes dhe për ndëshkimet e rënda, që bëhen detyrim të zbatohen mbi ata që akuzojnë të tjerët në nderin e tyre pa dëshmitarë okularë, formojnë atë që quhet “forca e shtytjes”. Kurse ajetet që janë objekt i studimit të tanishëm, flasin për falje e për zemërgjerësi dhe njoftojnë se All'illahu është Gjithëfalësi dhe Mëshirëploti. Kjo do të thotë se këto ajete zbulojnë atë që quhet “forca e tërheqjes”.

Pastaj ajeti i rikthehet çështjes së sharjes në nder dhe akuzimit të grave të pafajshme besimtare për imoralitet: **“Ata që akuzojnë gratë e ndershme besimtare të pafajshme, me të vërtetë ata janë të mallkuar në këtë botë e në Botën Tjetër dhe ata i pret një dënim shumë i madh.”**. Ky ajet i nderuar përmend tri cilësi të grave të ndershme besimtare të pafajshme dhe çdonjëra prej tyre përbën një argument më vete kundër padrejtësisë së madhe me të cilën ato u përballën, për shkak se u akuzuan në nder. Ajeti i cilëson ato gra me fjalën “*el muhsanàti*”, domethënë: *gra të ndershme të pastërta*, kurse cilësinë tjetër të grave të akuzuara, ajeti e shpreh me fjalën “*el gâfilàti*”, që do të thotë: *ato janë larg çdo akuze për njollosjen e tyre*, ndërsa cilësia e tretë me të cilën i përshkruan ato ajeti, është: “*el mu'minàti*”, domethënë: *besimtare*.

Ajeti zbulon edhe ndëshkimin e rëndë që i pret ata që e stisën këtë shpifje të ulët.¹

Gjithashtu, fjala e ajetit *“el gâfilâti”*, të tërheq vëmendjen, për faktin se ajo tregon se ato janë gra krejtësisht të pastra nga çdo devijim; ato janë krejtësisht të pastra jo vetëm nga çdo njollasje për imoralitet, por as nuk e dinë se kjo punë ekziston. Ndodh që njeriu mund të jetë përballë fajit dhe nuk i shkon fare në mendje se jashtë tij ekziston edhe ky faj. Kjo gjendje është etapa më e lartë e devotshmërisë.

Ka mundësi që me fjalën *“el gâfilâti”*, të jetë qëllimi për të treguar se ato gra nuk kanë fare dijeni për shpifjen që thuhet për to, prandaj as nuk e mbrojnë veten nga një akuzë e tillë. Rezultati: ajeti shtron për studim një temë të re. Ajetet e mëparshme flasin për ata që e stisën akuzën, të cilët ka mundësi të njihen e të ndëshkohen; porse këtu është fjala për ata që i përhapën fjalët dhe që e fshehën veten e tyre, me qëllim që mbi ta të mos zbatohet dispozita ligjore për përhapësit e shpifjeve. Ajeti thotë: Ata që maskohen nuk e marrin dot me mend se me këtë veprim do të jenë gjithmonë të ekspozuar ndaj ndëshkimit hyjnor, sepse All'llahu i Lartësuar i largon ata prej mëshirës së Tij në këtë botë, dhe ata i pret një ndëshkim shumë i rëndë në Botën Tjetër.

Ky ajet, megjithëse ka zbritur pas ngjarjes së shpifjes, ka lidhje me të dhe, si të gjitha ajetet e tjera që kanë zbritur për një shkak të veçantë, kuptimi i tij nuk ka të bëjë vetëm me një gjendje të caktuar.

¹ Tefsiri *“El Mijzân”*, vëll. 15, f. 122, fundi i ajetit që është objekt studimi.

Por ajo që të habit, është këmbëngulja e disa interpretuesve të Kur'anit Famëlartë, si Fakhru Rràziz në tefsirin "El Kebijr" dhe të tjerë, të cilët thonë se kuptimi i këtij ajeti ka të bëjë vetëm me akuzën drejtuar grave të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*); madje këtë faj të rëndë ata e rendisin në gradën e mohimit (*kufr*). Argumentin për këtë mendim të tyre, ata e nxjerrin prej fjalës së ajetit "*luinù*" - "**janë të mallkuar**". Megjithatë, thjesht vetëm lëshimi i akuzës për imoralitet, nuk mund të jetë shkak për ta çuar akuzuesin deri në etiketimin e tij si mohues, edhe pse faji mund të jetë tepër i rëndë, siç është në të vërtetë akuzimi në nder i grave të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Nëse do të ishte me të vërtetë kështu, atëherë përse Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk i trajtoi përhapësit e shpifjes, siç trajtohen ata që e braktisin fenë e tyre? Mirëpo ajetet vijuese që ne i shpjeguam më sipër, urdhërojnë të mos tejkalohet masa e ndëshkimit të vendosur për ta dhe mos të teprohet në ndëshkimin e tyre. Kjo do të thotë se faji i tyre nuk mund të jetë i barabartë me mohimin e All'llahut.

Duhet sqaruar se fraza e ajetit "**mallkimi i All'llahut**", vërteton dënimin për mohuesit dhe për ata që kryejnë faje të mëdha. Por për të vërtetuar llojin e ndëshkimit, kanë ardhur ajetet që flasin për dispozitën që parashikon ndëshkimin e personit që shan në nder një grua të ndershme. Njëkohësisht ka ardhur edhe ajeti i veçantë, që shpjegon dhe i jep zgjidhje rastit të veçantë, kur burri akuzon për imoralitet gruan e tij pa katër dëshmitarë. Ajeti jep si zgjidhje mallkimin e ndërsjellë "*el'liàn*" në prani të gjykatësit ligjor. Në këtë ajet, fjala "*mallkim*" është përsëritur dy herë kundër gënjeshtarëve që stisin akuza të rreme në nder, për njerëz

krejtësisht të pastër; gjithashtu, fjala *“mallkim”* është përdorur shpesh në burimet islame, si për shembull në hadithin e njohur: *“Për verën, All'llahu ka mallkuar dhjetë kategori njerëzish...”*.

Ajeti vijues cakton vendin dhe gjendjen e atyre që lëshojnë akuza të rreme mbi njerëzit në fushën e së drejtës hyjnore dhe thotë: **“Ditën kur do të dëshmojnë kundër atyre gjuhët e tyre, duart e tyre dhe këmbët e tyre për punët që ata kanë bërë.”**.

Në atë Ditë, gjuhët e tyre do të thonë fjalë që atyre nuk ua do shpirti dhe do të shohin se si shpalosen para tyre të vërtetat. Atë Ditë, për kriminelët nuk do të jetë e nevojshme të gjenden argumentet e të sillen dëshmitarët okularë për punët e liga që kanë bërë, sepse do të shohësh që ata vetë do t'i pohojnë fajet që kanë kryer, do ta demaskojnë punën që kanë bërë dhe këtë pohim, ata e bëjnë kundër dëshirës së tyre. Atë Ditë, atyre nuk u sjell dobi kundërshtimi i akuzave të drejtura ndaj tyre.

Atë Ditë, kundër mëkatarëve do të dëshmojnë duart e këmbët e tyre dhe, ashtu siç njoftojnë ajetet kur'anore, do të flasin lëkurët e trupit të tyre si të ishin shirit mbi të cilat është regjistruar e gjithë puna e tyre; lëkurët e tyre do të flasin për punët që ata kanë bërë dhe për fajet që ka kryer secili prej tyre, pasi gjurmët e krimeve të bëra janë shkruar mbi lëkurën e secilit gjatë gjithë jetës, ashtu siç janë në të vërtetë. Ajo është Dita kur të vërtetat do të dalin sheshit, është Dita kur ata do të diskreditojnë vetveten, është Dita e zbulimit të të fshehtave.

Në disa ajete të Kur'anit Famëlartë, kur flitet për Ditën e Gjykimit, thuhet qartë: **“Sot Ne i mbyllim gojët e tyre dhe Ne do të na flasin duart e tyre, kurse këmbët e tyre do të dëshmojnë për punët që ata kanë bërë.”** (sure “Jasin”, ajeti 65).

Për këtë të vërtetë s'ka asnjë kundërshtim, pasi është plotësisht e mundshme. Atë Ditë, gjuhët s'kanë mundësi të flasin dhe prandaj do të dëshmojnë të gjitha gjymtyrët e trupit, kurse duart e këmbët do të dëshmojnë me fjalë, sikur të fliste gjuha; kështu do të dalin sheshit të gjitha punët e fajet që ata kanë bërë.

Hulumtime

1- Kush janë “të këqijat” dhe “të këqijtë”?

Interpretuesit e Kur'anit Famëlartë kanë përmendur përkufizime të ndryshme në lidhje me fjalët e ajetit: “të këqijat”, dhe “të këqijtë” si dhe “të mirat” dhe “të mirët”.

a- Thuhet se qëllimi me termin “të këqijat” është fjala e keqe, akuza, shpifja dhe rrena, që lëshojnë ata që gabojnë dhe fajtorët; e kundërta është fjala “të mirët”. Qëllimi me frazën “të mirët” është fjala e njerëzve të mirë e të pastër, ashtu siç thuhet edhe në proverbin e njohur: “Ena pjek çka brenda”.

b- Thuhet se fjala “të këqijat” është në kuptimin e punëve të këqija dhe përfshin çdo punë të keqe e të padëshiruar që bëjnë njerëzit e ligj. E kundërta e kësaj është fjala “të mirat”, që thuhet për njerëzit e mirë.

c- Fjala “të këqijat” ka kuptimin: gratë imorale dhe “të këqijtë” ka kuptimin: burrat imoralë. Të kundërtat e tyre, “të

mirat", ka kuptimin: gratë e pastra dhe **"të mirët"** ka kuptimin: burrat e pastër.

Fjalët e ajeteve kanë pikërisht këtë kuptim të fundit, pasi edhe shembujt krahasues e përforcojnë atë.

a) Këto ajete kanë ardhur pas atyre që trajtojnë ngjarjen e shpifjes dhe pas ajetit: **"Laviri nuk martohet me asnjë tjetër përveçse me një lavire, ose me një idhujtare; edhe lavirja nuk martohet me asnjë tjetër përveçse me një lavir, ose me një idhujtar, pasi kjo (martesa me ata që bëjnë imoralitet) është e ndaluar për besimtarët."**

Ky interpretim është në përputhje me kuptimin e ajeteve që janë objekt studimi.

b) **"Ata janë të pafajshëm për ato që thuhet kundër atyre."** Qëllimi me këto fjalë janë gratë dhe burrat e pastër prej kësaj ndyrësie dhe është një argument tjetër që e vërteton saktësinë e këtij interpretimi.

c) Mbiemrat cilësorë krahasues në këtë ajet kanë ardhur në numrin shumës të rregullt (në gjuhën arabe ka shumës të rregullt dhe shumës të parregullt). Me fjalën *"el khabijthùne"* që është e gjinisë mashkullore, qëllimi është për burrat imoralë; gjithashtu, prej këtij rregulli gramatikor mësojmë se fjala *"el khabijthàti"* është shumësi i rregullt i gjinisë femërore dhe ka për qëllim gratë imorale.

d) Në transmetimin e ardhur prej Imam Bekirit dhe Sadikut, thuhet: "Kjo fjalë është si shembulli i fjalës së të Lartit: **"Laviri nuk martohet me asnjë tjetër përveçse me një lavire, ose**

me një idhujtare...", pra, pati prej atyre që donin të martoheshin me gra të përdala, por All'Ilahu i ndaloi nga kjo martesë, sepse Ai nuk mund të jetë i kënaqur që besimtarët të martohen me gra imorale."¹

Gjithashtu, në transmetimet e ardhura në librin "En Nikàhu" - "Martesa" lexojmë se si shokët e Imamit (Imam Sadikut) kërkonin herë-herë shpjegime prej tij në lidhje me martesën me **"të këqijat"** dhe përgjigjja e tij për ta ishte negative. Kjo tregon se "e keqja", ka kuptimin e gruas imorale dhe nuk përdoret as në kuptimin e fjalës së keqe dhe as në kuptimin e punës së turpshme.²

Pyetje: Me *"të keqen"*, ose me *"të mirën"* e këtij grupi grash e burrash, a është qëllimi për nderin, apo ka lidhje me degjenerimin në mendim, në punë, ose në fjalë?

Më i drejti është kuptimi i parë i ajetit, sepse ai është në përputhje me atë që ka ardhur në ajetet e hadithet, megjithëse disa hadithe u japin një kuptim shumë të gjerë dy fjalëve: *"të këqijat"* dhe *"të mirët"*, që janë përmendur në këtë ajet dhe nuk e reduktojnë kuptimin vetëm në degjenerimin moral e në pastërtinë morale të personit.

Duke u bazuar mbi këtë këndvështrim, nuk është gabim të thuhet se kuptimi i parë mund të jetë i veçantë dhe, nisur nga qëllimi më i lartë i dispozitës, është plotësisht e mundur që ky kuptim të përgjithësohet e të zgjerohet.

¹ Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", vëll. 7, f. 135, fundi i ajetit që është objekt studimi.

² "Vesàilush Shija", vëll. 14, f. 337, kapitulli 14: "Ç'është e ndaluar në krushqi?"

Me fjalë të tjera: Ajeti i mëparshëm shpjegon prirjen e të ngjashmes drejt të ngjashmes si ajo, pavarësisht nga veçantitë e saj, pasi subjekti studion nderin dhe degjenerimin moral.

2- A është kjo konstruktive apo ligjore?

Shembujt vijues do të vënë theksin mbi rrugën konstruktive që përputhet me të gjitha krijesat, madje edhe me grimcat e ekzistencës në tokë e në qiej dhe që është tërheqja e sendit drejt të ngjashmit me të, ashtu siç i tërheq elektriciteti statik copat e vogla të letrës.

Të ndriçuarit i tërheq drita.

Ata që janë për në zjarr, prirjen drejt atyre që janë në zjarr.

Pra, i ngjashmi ndjek të ngjashmin dhe çdo grup homogjen është i kënaqur me individët e vet. Kjo e vërtetë bën që ajeti që është objekt studimi, të jetë si ajeti: **“edhe lavirja nuk martohet me asnjë tjetër përveçse me një lavir, ose me një idhujtar.”**. Ajeti i nderuar tregon një dispozitë ligjore, e cila e ndalon martesën me gra që njihen për punë që prishin nderin.

Atëherë, a nuk ka për të gjitha dispozitat ligjore rrënjë konstruktive?

A nuk kemi këtu, harmonizim në mes rrugëve hyjnore, rrugëve ligjore dhe atyre konstruktive? (Për më shumë shpjegime, referohu në komentimin e ajetit që përmendëm.)

3- Përgjigje ndaj komentimit

Komentimi: Gjatë historisë ose edhe në jetën tonë, ne hasemi me situata që nuk janë në përputhje me ligjin e mësipërm. Një shembull për këtë është përmendur edhe në Kur'anin Famëllartë: **“Për ata që mohuan, All'llahu sjell shembull gruan e Nuhut dhe gruan e Lûtit; të dyja ishin nën kurorën e dy robve prej robve Tanë të mirë, por të dyja i tradhtuan ata...”** (sure “Et Tahrîm, ajeti 10).

Si shembull të kundërt, Kur'ani përmend gruan e Faraonit, si model të besimit e të pastërtisë: **“Për ata që besuan, All'llahu sjell shembull gruan e Faraonit, e cila tha: O Zoti im, me mëshirën Tënde bëj për mua një shtëpi në Xhennet dhe më shpëto mua prej Faraonit e prej brutalitetit të tij, më shpëto edhe prej popullit mizor.”** (sure “Et-Tahrîm, ajeti 11).

Situata të ngjashme me këto dy ngjarje ka pasur edhe në fillimet e Islamit, kur disa prej udhëheqësve të myslimanëve u vunë në provë me gra të këqija. Disa të tjerë, All'llahu me mirësinë e Tij, bëri që të kishin gra besimtare, të cilat janë përmendur në historinë islame.

Në përgjigje të pyetjes, themi: Për çdo ligj ka përveçime, prandaj është e domosdoshme të përmendim dy çështje:


a- Gjatë interpretimit të ajetit që është objekt studimi, ne thamë se me fjalën **“të keqen”**, qëllimi ishte për degjenerimin moral dhe kryerjen e punëve që prishin nderin; kurse me fjalën **“të mirën”**, qëllimi është e kundërta e fjalës **“të keqen”**. Bazuar

mbi këtë sqarim, përgjigjja për pyetjen e mësipërme është e qartë: Gratë e Profetëve nuk kanë devijuar kurrë dhe nuk i kanë tradhtuar kurrë ata, por qëllimi me fjalën “tradhti” në lidhje me ngjarjen e gruas së Nuhut e të Lutit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!*), ka lidhje me spiunimin që ato të dyja bënë për interes të jobesimtarëve dhe jo tradhti në kuptimin e nderit. Si rregull, kjo e metë numërohet prej të metave të neveritshme. Ne e dimë se mjedisi familjar i Profetëve (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!*) ka qenë i pastër nga të tilla dukuri dhe qëllimi ishte që ato të mos ndërthureshin me qëllimin e profetësisë për thirrjen drejtuar njerëzve që të besonin në mesazhin hyjnor.

b- Përveç kësaj, gratë e Profetëve, në fillim nuk kanë qenë jobesimtare, por më pas, ato ranë disa herë në rrugën e humbjes. Prandaj Profetët i kanë vazhduar marrëdhëniet me to përpara se ato të bien në rrugën e humbjes; gjithashtu, duhet vënë në dukje se gruaja e Faraonit, në kohën kur është martuar, nuk besonte në Zotin e Musait, sepse në atë kohë, Musai nuk kishte lindur. Ajo besoi në mesazhin hyjnor, pasi All'llahu e dërgoi Musain me mesazhin e Tij. Për gruan e Faraonit s'kishte rrugëdalje tjetër: ose të vazhdonte jetën bashkëshortore me Faraonin, ose të luftonte. Dhe ajo zgjodhi rrugën e luftës derisa ra dëshmore.

Ajetet 27 - 29

[illegible]



“Ju që keni besuar, mos hyni në shtëpitë e të tjerëve pa kërkuar leje dhe pa i përshëndetur njerëzit e saj; kjo është më mirë për ju dhe kështu merrni mësim.”

“Nëse aty nuk gjeni asnjë, atëherë mos hyni në ato (shtëpi) derisa të lejoheni dhe, nëse u thuhet kthehuni, menjëherë kthehuni (andej nga erdhët), kjo është më e ndershme për ju; All'illahu ka dijeni të plotë për punët që ju bëni.”

“Nuk bëni asnjë mëkat nëse hyni në shtëpitë e pabanuara, në ato ka përfitim për ju dhe, All'illahu ka dijeni të plotë për atë që ju e bëni sheshit dhe për atë që ju e mbani fshehur.”

Komentimi

Mos hyni në shtëpitë e të tjerëve derisa të lejoheni!

Këto ajete bëjnë të qartë një aspekt të edukatës së bashkëjetesës dhe të edukatës shoqërore islame, e cila ka lidhje të ngushtë me probleme të përgjithshme që kanë të bëjnë me ruajtjen e nderit, pra: për mënyrën e hyrjes në shtëpitë e të tjerëve dhe kërkimin e lejes për të hyrë në to.

Në ajetin e parë të këtij grupi, i Larti i urdhëron besimtarët me fjalën e Tij: **“Ju që keni besuar, mos hyni në shtëpitë e të tjerëve pa kërkuar leje dhe pa i përshëndetur njerëzit e saj”**, pra, kur të hyni në shtëpitë e të tjerëve, duhet të zbatoni rregullin; në radhë të parë, t’i njoftoni njerëzit e shtëpisë për qëllimin tuaj dhe të merrni miratimin e tyre.

Në këtë ajet të tërheq vëmendjen përdorimi i foljes *“teste’nisù”* – *“kërkoni shoqërimin me fjalë të buta”* dhe nuk është thënë **“kërkoni leje”**, sepse folja e dytë është vetëm kërkesë për të hyrë, kurse folja e parë, në rrënjën e saj ka kuptimin e të shoqëruarit me dashamirësi; pra, kërkimi i lejes, i shoqëruar me dashamirësi, butësi, njohje dhe sinqeritet; Gjithashtu, kjo fjalë shpjegon se leja duhet kërkuar me edukatë, shoqërisht e miqësisht, larg nga çdo lloj ashpërsie e morali të keq. Nëse do të *“notonim”* në brendësi të kësaj fjale, në të do të gjejmë shumë edukatë rreth kësaj çështjeje: kur të kërkoni leje mos thërrisni me zë të ashpër, mos trokitni në portën e tjetrit me forcë dhe lejen mos e kërkoni me fjalë të këqija; mos hyni derisa të lejoheni dhe, pasi të hyni, së pari përshëndetni me *selam* (paqe e shpëtim), sepse ajo fjalë shpreh ndjenjat e paqes dhe përcjell mesazhin e dashurisë e të miqësisë.

Në këtë dispozitë të tërheqin vëmendjen dimensionet e mëdha njerëzore dhe ndjenjat e qarta që përmbajnë dy frazat e ajetit: *“dhàlikum khajrun lekum”*- **“kjo është më mirë për ju”** dhe *“leal’lekum tedhek’kerùne”*- **“dhe kështu merrni mësim”**.

Këto dy fraza janë një argument që vërteton se dispozitat në fjalë i kanë rrënjët në thellësi të ndjenjave e të mendjeve të njerëzve. Nëse njeriu do të shohë me hollësi, do të vërejë se ato përmbajnë të mirën dhe përmirësimin.

Në vijim, Kur’ani e shpalos këtë dispozitë me një fjali tjetër dhe, në ajetin e dytë të këtij grupi ajetesh, urdhëron: **“Nëse aty nuk gjeni asnjë, atëherë mos hyni në ato (shtëpi) derisa të lejoheni.”**.

Ka mundësi që me këtë frazë të ajetit, qëllimi të jetë për rastin kur në atë shtëpi mbase gjendet dikush, porse ai që ka të drejtën e lejimit nuk ndodhet aty dhe, në këtë gjendje, burri s’ka të drejtë të hyjë në shtëpinë e tjetrit. Ose në shtëpi nuk gjendet asnjë, por i zoti i saj mund të jetë diku afër, ose mund të jetë në shtëpinë e fqinjëve, kështu që duke trokitur në portë, ose duke i thirrur të zotit të shtëpisë, ai mund të dëgjojë dhe të vijë që të lejojë për të hyrë. Gjithsesi, çështja e shtruar ka kuptimin: Mos hyr në shtëpinë e tjetrit pa leje!

Në vijim, ajeti shton: **“dhe nëse u thuhet kthehuni, menjëherë kthehuni** (andej nga erdhët), **kjo është më e ndershme për ju.”**.

Ajeti tregon se burri nuk duhet të shqetësohet kur nuk lejohet të hyjë, pasi ka të ngjarë që i zoti i shtëpisë mund të mos jetë në

gjendje për të pritur njerëz, ose mund të mos e ketë shtëpinë të përgatitur për këtë gjë.

Ka njerëz që shtyhen nga kureshtja e tepërt dhe, kur u refuzohet mikpritja nga të zotët e shtëpisë, nuk largohen dot pa dëgjuar ndonjë fjalë nga brenda shtëpisë, ose pa shikuar ndonjë gjë nga vrima e çelësit si spiunët, me qëllim që të zbulojnë ndonjë të fshehtë të banorëve të asaj shtëpie dhe pastaj atë që panë ta përhapin te të tjerët. Për të gjitha këto, ajeti thotë: **“All'Ilahu ka dijeni të plotë për punët që ju bëni.”**

Meqenëse për çdo dispozitë ka përjashtime si dhe për të larguar problemet e domosdoshmëritë në mënyrë të arsyeshme prej rrugës së njeriut, ajeti i fundit i grupit të ajeteve që janë objekt studimi, thotë: **“Nuk bëni asnjë mëkat nëse hyni në shtëpitë e pabanuara, në ato ka përfitim për ju.”**

Dhe në fund ajeti njofton:

“All'Ilahu ka dijeni të plotë për atë që ju e bëni sheshit dhe për atë që ju e mbani fshehur.” Me këtë frazë, ajeti tregon se disa mund ta shfrytëzojnë këtë përveçim dhe mund të futen në shtëpitë e pabanuara, me qëllim që të zbulojnë ndonjë të fshehtë; ose burri hyn në shtëpitë ku s'ka njeri, pa e ditur se ato shtëpi janë të banuara, porse All'Ilahu ka dijeni të plotë për të gjitha këto gjëra. Gjithashtu, All'Ilahu ka dijeni për të gjithë ata që e keqpërdorin përfitimin prej këtij përveçimi.

Hulumtime

1- Siguria dhe liria për gratë e shtëpisë

Në jetën e njeriut ka dy dimensione: njëri është dimension i individual dhe tjetri dimension i shoqëror i tij. Kjo do të thotë se për njeriun ka dy jetë: një jetë të veçantë dhe një jetë në bashkësi. Secila nga këto dy jetë ka veçoritë dhe rregullat e saj. Në mjedis shoqëror, njeriu është i detyruar t'u nënshtrohet kufizimeve të shumta nga ana e veshjes dhe e lëvizjeve, domethënë ai e përjeton jetën e tij vetëm nën këtë rregull gjatë njëzet e katër orëve. Njeriu është i lodhur dhe irritohet, sepse ai ka dëshirë të jetë i lirë natë-ditë dhe të pushojë larg nga këto pranga me familjen dhe fëmijët e tij. Prandaj, ai gjen strehim në shtëpinë e tij private dhe qëndron përkohësisht i veçuar prej shoqërisë, pasi brenda në shtëpinë e tij, ai shpëton prej kufizimeve që i imponon jeta në shoqëri me të tjerët. Për të gjitha këto, shtëpia private duhet të ketë një siguri dhe paprekshmëri të mjaftueshme.

Nëse çdo kalimtar do të donte të hynte në shtëpinë e të tjerëve, atëherë nuk do mbetej asgjë nga paprekshmëria e banesave të njerëzve dhe ato nuk do të kishin as siguri e as liri; pra, banesa do të kthehej në një mjedis publik si tregu e rruga. Për të gjitha këto, gjatë shekujve kanë ekzistuar te njerëzit tradita e zakone të veçanta; madje të gjitha ligjet e botës e ndalojnë hyrjen në shtëpitë e të tjerëve pa marrë leje dhe shprehen qartë se ai që kërkon të hyjë në shtëpinë e tjetrit, ka detyrë të presë derisa të lejohet për të hyrë në atë shtëpi. Në raste të një domosdoshmërie tepër të madhe dhe me qëllim që të ruhet rendi e siguria, ose për qëllime të tjera të rëndësishme, ligji e lejon hyrjen në shtëpinë e

tjetrit të një numri të kufizuar njerëzish të autorizuar, pa kërkuar leje prej të zotit të shtëpisë.

Dispozitat islame i shprehin tekstualisht mësimet dhe edukatën e veçantë në të tilla raste, madje në këtë fushë është e vështirë të gjendet një ligj i ngjashëm me ligjin islam.

Në një hadith *sherif* lexojmë se sahabiu i lavdishëm Ebu Sejd El Khuderij i kërkoi leje të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për të hyrë tek ai, kur të dy ishin para portës. I Dërguari i All'llahut i tha: “Mos kërko leje, ti je para portës”.¹

Në hadithet islame shprehet qartë domosdoshmëria e marrjes së lejes edhe kur djali dëshiron të hyjë në shtëpinë e babait ose të nënës së tij, ose edhe kur babai do të hyjë në shtëpinë e djalit të vet.²

Në një hadith të ardhur prej të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), lexojmë përgjigjen në formë dialogu, që ai i dha pyetjes së një burri, i cili e pyeti: “A të kërkoj leje edhe kur të hyj te nëna ime?” I Dërguari i All'llahut i tha: “Po”; Burri vazhdoi duke thënë: “Asaj s’ka kush i shërben përveç meje. A duhet të kërkoj leje sa herë që hyj tek ajo?” I Dërguari i All'llahut i tha: “A dëshiron ta shohësh atë lakuriq?” Burri iu përgjigj: “Jo”. Atëherë, i Dërguari i All'llahut i tha: “Kërkoji leje për të hyrë tek ajo!”³

¹ Tefsiri “Kebijr”, vëll. 23, f. 138, fundi i ajetit që është objekt studimi.

² I njëjti burim.

³ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 586.

Imam Bakiri transmeton një hadith të përcjellë prej Xhàbir bin Abdullah El Ensàrij, i cili tregon: “Dola së bashku me të Dërguarin e All'lahut (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili donte të shkonte te Fatimja. Kur arritëm para portës, ai e shtyu atë me dorën e vet dhe pastaj tha: “Es Selamu Alejkum!” Fatimja u përgjigj: “Alejkes Selamu ja Resulullah!” Pastaj, ai e pyeti: “A të hyj?” Menjëherë ajo tha: “Hyr, o i Dërguar i All'lahut”. Por i Dërguari i All'lahut i tha: “A të hyjë edhe ai që është me mua?” Ajo u përgjigj: “O i Dërguar i All'lahut, nuk e kam kokën të mbuluar”. Ai i tha: “O Fatime, hidh mbi kokë njërën anë të rrobës tënde të sipërme” - dhe ajo ashtu bëri. Pastaj i tha: “Es Selamu Alejkum!” Edhe ajo tha: “Ue Alejkes Selamu ja Resulullah”; E pyeti: “A të hyj?” Ajo u përgjigj: “Po, o i Dërguar i All'lahut!”

Ai tha: “Edhe ai që është me mua?” Ajo tha: “Edhe ai që është me ty”.

Xhabiri tregon: Në fillim hyri i Dërguari i All'lahut (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe menjëherë pas tij hyra edhe unë.¹

Ky hadith shpjegon qartë se si Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që është modeli që duhet të ndjekin të gjithë myslimanët, bënte shumë kujdes edhe në këto punë, madje deri në hollësitë më të vogla.

Ebù Abdullah Es Sàdiku ka thënë: “Kërkimi i lejes bëhet tri herë: herën e parë ata dëgjojnë; herën e dytë bëjnë kujdes, dhe herën e

¹ Burimi i mësipërm.

tretë, nëse duan, lejojnë dhe nëse nuk duan, nuk lejojnë; prandaj, ai që kërkon leje duhet të largohet menjëherë”¹.

Disa interpretues të Kur’anit kanë thënë se duhet të ketë patjetër një ndarje në kohë në mes tri herëve të kërimit të lejes për të hyrë në shtëpinë e tjetrit. Kjo duhet të bëhet për shkak se i zoti i shtëpisë mund të mos jetë gati me rrobën e përshtatshme, mund të dojë ta ndërrojë veshjen, ose do të rregullojë dhomën e pritjes, prandaj atij i duhet dhënë kohë që të përgatisë veten e shtëpinë e tij për të pritur mikun; gjithashtu, edhe miku duhet të largohet pa u shqetësuar dhe pa u revoltuar nëse nuk e lejojnë të hyjë.

2- Cili është qëllimi me frazën e ajetit: “shtëpi të pabanuara”?

Në përgjigje të kësaj pyetjeje, duhet theksuar se interpretuesit e Kur’anit kanë mendime të ndryshme në lidhje me qëllimin e shprehur në këtë frazë të ajetit. Disa kanë thënë se kjo frazë u referohet shtëpive në të cilat nuk banon një person i caktuar dhe atyre që janë për të gjithë njerëzit, si hanet anës rrugëve, hotelet, banjot publike dhe të ngjashmeve me to. Kështu

¹ “Vesàilush Shija”, vëll. 14, “Kapitujt e kurorës”, kapitulli nr. 23.

thuhet shprehimisht në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut.¹

Të tjerë kanë thënë se bëhet fjalë për shtëpitë e kthjera në gërmadha, që s'kanë as mure e as dyer dhe ku hyn kushdo. Duhet thënë se ky interpretim është shumë larg nga e vërteta që shpreh fraza e ajetit përkatës, sepse nuk mund të ketë njeri që do t'i linte sendet e tij në të tilla shtëpi gërmadha.

Disa të tjerë kanë thënë se fraza e ajetit bën fjalë për magazinat e depot e tregtarëve, ku njerëzit lënë për ruajtje mallrat, me qëllim që ato të shiten. Në magazina të tilla mund të hyjë kushdo që ka lënë aty sendet e veta. Edhe ky interpretim duket se nuk është në përputhje me qëllimin e ajetit.

Ka mundësi që ajeti të ketë për qëllim shtëpitë, në të cilat nuk banon asnjë njeri dhe njerëzit lënë aty sendet e mallrat e tyre për ruajtje (amanet), por vetëm pasi më parë kanë marrë miratimin e pronarit të asaj shtëpie, i cili është garantues për ruajtjen dhe për lëvizjen e mallrave në rast nevojë.

Disa nga këto interpretime nuk janë në kundërshtim me njëri-tjetrin, porse interpretimi i parë përputhet më shumë me kuptimin dhe me qëllimin që shprehin fjalët e ajetit; gjithashtu, bëhet e qartë se personit që ka lënë mallrat e sendet e veta në një shtëpi të tillë, nuk i lejohet të hyjë në të pa lejen e pronarit të saj, madje edhe në rast se aty nuk ndodhet askush.


3- Dënimi për atë që vjedh në shtëpitë e të tjerëve

¹ Burimi i mësipërm.

Në librat e Fik'hut e të Hadithit thuhet se kur një person vjedh brenda një shtëpie dhe aty ka parë një grua të pambuluar, banorët e asaj shtëpie e kanë detyrim ta ndalojnë atë nga kjo punë dhe, nëse ai nuk heq dorë, atëherë ata e gjuajnë me gurë; nëse ai sulmon, atëherë ata mund ta mbrojnë nderin e tyre me një mjet që shkakton plagë. Nëse ky person vritet në këtë situatë, vrasësi as nuk dënohet e as nuk paguan shumën e caktuar për shlyerjen e gjakut (*dijet*).

Banorët e shtëpisë nuk janë të detyruar t'i ndjekin këto hapa njërin pas tjetrit, por ata kanë detyrë që ta ndalojnë këtë vjedhës me rrugën më të lehtë dhe më pas mund të kalojnë në përdorimin e dhunës.

Ajetet 30 - 31



[illegible]



“Thua ju besimtarëve të ndalojnë shikimet (të mos shikojnë gjërat që janë të ndaluara të shihen) dhe të ruajnë pjesët e turpshme të trupit, kjo është më e pastër për ata; All'Ilahu ka dijeni të hollësishme për punët që ata bëjnë.”

“Thua ju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre; të mos i zbulojnë stolitë e tyre, me përjashtim të atyre që janë të dukshme; le të mbulojnë kokën e gjoksin dhe gratë të mos ia tregojnë bukuritë e tyre askujt përveç burrit të tyre, babës së vet, ose babës së burrit të vet, djemve të vet, ose djemve të burrit të vet, vëllezërve të vet, ose djemve të vëllezërve të vet, ose djemve të motrave të veta, ose grave të tyre (atyre që u përmendën), si dhe robërshave, të cilat i kanë në pronësinë e tyre, ose shërbëtorëve meshkuj, të cilët nuk ndjejnë nevojë për femra, ose fëmijëve që nuk kanë arritur pjekurinë për gra dhe, le të mos i përplasnin këmbët për të zbuluar stolitë e tyre të mbulura; pendohuni tek All'Ilahu të gjithë o besimtarë, sepse kështu do të shpëtoni.”

Shkaku i zbritjes

Në lidhje me shkakun e zbritjes së ajetit të parë të ajeteve që janë objekt studimi, në librin “El Kâfij” citohet fjala e Imam Bakirit, i cili tregon: Një djalë i ri prej ensarëve priti një grua në Medine. Në atë kohë, gratë mbuloheshin deri prapa veshit. Djali e pa që po vinte dhe pasi ajo kaloi, ai e shikoi atë me vëmendje të madhe, madje hyri edhe në një rrugicë, nga ku vazhdonte ta shikonte gruan nga mbrapa. Aq shumë u hutua duke e shikuar atë grua, sa që u përplas me një mur, ose me një xham, dhe nga përplasja u gjakos në fytyrë. Vetëm kur gruaja u largua, ai e pa gjakun që i rridhte mbi rroba. Në këtë gjendje, ai tha: “Pasha All'llahun, do të shkoj tek i Dërguari i All'llahut dhe do ta njoftoj për këtë që më ndodhi”. Ai shkoi dhe kur i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e pa në atë gjendje, i tha: “Ç’është kjo?” - dhe djali i tregoi. Ndërkaq zbriti Xhibrili (*Paqja qoftë mbi të!*) me ajetin: **“Thuaju besimtarëve të ndalojnë shikimet** (të mos shikojnë gjërat që janë të ndaluara të shihen) **dhe të ruajnë pjesët e turpshme të trupit, kjo është më e pastërt për ata; All'llahu ka dijeni të hollësishme për punët që ata bëjnë.”**¹

Komentimi

1- Luftimi i zbulimit dhe i pabesisë së syve

¹ “Vesàilush Shija”, vëll. 14, f. 39; tefsiret: “Nuruth Thekalejn”, “El Mizàn” dhe “Rùhul Meànij”, me disa ndryshime në komentimin e ajetit që është objekt studimi.

Në fillim të kësaj sureje kemi thënë se ajo i kushtohet nderit e pastërtisë, si dhe pastrimit të njerëzve prej të gjitha çoroditjeve gjinore. Hulumtimet e këtij grupi ajetesh janë në përputhje të plotë me njëri-tjetrin dhe trajtojnë dispozitat e veçanta, që kanë të bëjnë me hedhjen e shikimit mbi një grua të huaj për shikuesin dhe me mbulimin e gruas. Nuk ka asnjë që të mos e dijë se ky studim është prej hulumtimeve të veçanta që kanë lidhje me sharjen e grave në nder.

Në radhë të parë, ajeti urdhëron: **“Thuaju besimtarëve të ndalojnë shikimet** (të mos shikojnë gjërat që janë të ndaluara të shihen) **dhe të ruajnë pjesët e turpshme të trupit.”**.

Fjala e ajetit *“jagud’dù”*, në rrënjën e saj, ka kuptimin *“pakësim”*, por ajo përdoret më shumë për uljen e zërit dhe të shikimit. Ky është edhe shkakun që ajeti i urdhëron besimtarët të ulin sytë dhe të pakësojnë edhe shikimet. Kjo shprehje brilante ka ardhur në këtë formë, për të treguar se sytë duhet të qëndrojnë të mbyllur plotësisht, aq sa njeriu të mos njohë as rrugën e tij, në kuptimin që ai të mos e hedhë shikimin mbi një grua që nuk është prej të afërmve të tij; pra të mos hedhë shikimin mbi një grua, me të cilën ai ka të drejtë të martohet. Kjo do të thotë se besimtari nuk duhet t’i hedhë sytë mbi një grua që kalon rrugës, por duhet t’i mbajë të ulur dhe të shikojë tokën, sepse vetëm kështu e vërteton fjalën e ajetit që urdhëron uljen e shikimit dhe njëkohësisht, e ka larguar këtë pamje prej mendjes së tij.

Të tërheq vëmendjen fakti se Kur’ani Famëlartë nuk e ka përcaktuar objektin, për të cilin duhet ulur shikimi; pra, ka hequr foljen kalimtare, me qëllim që ky urdhër të jetë argument i

përgjithshëm, domethënë: ajeti urdhëron uljen e shikimit prej të gjitha gjërave, të cilat All'illahu i ka bërë të ndaluara të shikohen.

Në vijim, ky grup ajetesh, sidomos ajeti i dytë, flet për çështjen e veshjes islame të gruas (*hixhabin*). Ajeti shpjegon qartë për ne qëllimin me frazën “hedhjen e shikimit” mbi gratë, me të cilat burri ka të drejtë të martohet. Këtë kuptim e përforcon edhe shkaku i zbritjes që e përmendëm më sipër.

Gjithashtu, bëhet e qartë se kuptimi i ajetit që është objekt studimi, nuk është ndalimi i hedhjes së shikimit mbi gratë, me të cilat burri mund të martohet dhe që disa e konsiderojnë shikim të natyrshëm, duke thënë se edhe ky shikim është i lejuar. Jo, shikimi mbi gruan me të cilën burri mund të martohet, nuk është i lejuar, sepse shikimi i njeriut ka dimensione të mëdha dhe shtrihet mbi hapësira të gjera. Ai shikim përfshin një rreth shumë të zgjeruar dhe kur ndesh mbi një grua jo të afërme, burri ka detyrim që atë grua të mos e shikojë më, por të vazhdojë rrugën me sy hapur. Është pikërisht ky kuptimi i frazës “të ulin shikimin”.

Dispozita e dytë në këtë ajet është “ruajtja e pjesëve të turpshme të trupit”. Këtu kjo dispozitë ka ardhur me frazën “*ue jahfedhù furùxhehum*”. Siç e shpjeguam edhe më lart, fjala “*ferxh*” në gjuhën arabe do të thotë: hapje, ndarje në mes dy sendeve, porse këtu ka ardhur në kuptimin e pjesëve të turpshme të trupit.

Qëllimi me ruajtjen e pjesëve të turpshme të trupit, ashtu siç ka ardhur edhe në transmetime, është mbulimi i këtyre pjesëve që të mos shihen. Në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut lexojmë fjalën e tij: “Në çdo ajet të Kur'anit ku përmendet fjala “*ferxh*” - pjesët e turpshme të trupit – qëllimi është për

prostitucionin, me përjashtim të këtij ajeti, ku me këtë fjalë, qëllimi është ruajtja e atyre pjesëve që të mos i shikojnë të tjerët.”¹

Islami e ndalon shikimin mbi gruan e huaj, sepse ai nxit instinktët dhe epshin, prandaj ky ndalim është: **“kjo është më e pastër për ata.”**.

Me këtë frazë mbyllet ajeti që është objekt studimi për çështjen e hedhjes së shikimit mbi gruan e huaj.

Më pas, ajeti i paralajmëron burrat që i shikojnë me epsh gratë e huaja për ta, por që e justifikojnë veprimin e tyre, duke thënë se nuk ishte veprim i qëllimshëm. Por ajeti njofton: **“All'Ilahu ka dijeni të hollësishme për punët që ata bëjnë.”**.

Ajeti vijues i shpjegon detyrat e grave në këtë fushë dhe thekson detyrat e ngjashme me ato të burrave, duke thënë: **“Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre dhe të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre.”**.

Me këtë frazë të ajetit, All'Ilahu e ka bërë të ndaluar shikimin në pjesët e turpshme të grave, ashtu siç e ka bërë të ndaluar edhe shikimin në pjesët e turpshme të burrave. All'Ilahu e ka bërë detyrim për gratë që ato t'i mbulojnë pjesët e turpshme të trupit, në mënyrë që të mos i shikojnë as burrat e as gratë, ashtu siç e ka bërë detyrim edhe për burrat.

Më pas, ajeti me tri fjali trajton çështjen e veshjes islame të gruas (*hixhabin*): **“gratë të mos i zbulojnë stolitë e tyre me përjashtim të stolive që janë të dukshme.”**.

¹ “Usûlul Kâfij”: tefsiri i Ali bin Ibrâhimit, vëll. 2, f. 101; (sipas citimit prej tefsirit “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 587, 588).

Interpretuesit e Kur'anit kanë mendime të ndryshme në lidhje me interpretimin e fjalës “*zijnetehun'ne*”- “**stolitë e tyre**”, që është detyrim të jenë të mbuluara, si dhe rreth stolive që lejohet të jenë të dukshme.

Disa kanë thënë se stolia që mbahet e mbuluar, është vetë bukuria natyrore e gruas (bukuria e trupit të gruas), por përdorimi i kësaj fjale me këtë kuptim, është shumë i ngushtë.

Të tjerë kanë thënë se ajeti është në kuptimin e zbulimit të pjesës së trupit ku vihet stolia, por zbulimi i kësaj stolie do të thotë të zbulohet edhe ajo pjesë e trupit, si për shembull krahu, kurse vetë stolia është e lejuar të mbahet. Nga ky këndvështrim, ndalimi është i veçantë për ato stoli që vihen mbi trupin e gruas. Natyrisht që zbulimi i kësaj stolie është një sinonim për zbulimin e asaj pjese të trupit. Dy interpretimet e fundit kanë një përfundim të vetëm, pavarësisht se çështjen e ndjekin në dy rrugë të ndryshme.

Në të vërtetë, e kemi për detyrë ta interpretojmë ajetin në kuptimin që kanë fjalët e tij, pa marrë parasysh ndonjë dispozitë paraprake. Kështu, interpretimi sipas fjalëve të ajetit është interpretimi i tretë.

Duke u bazuar mbi këtë, gratë s'kanë të drejtë të zbulojnë stolitë e tyre që janë të mbuluara. Meqenëse është detyrim që trupi i gruas të mos jetë i zbuluar, atëherë nuk duhet zbuluar rroba për t'u dukur stolia që është nën të, si për shembull këmisha, pasi teksti i Kur'anit e ndalon këtë zbulim të pjesës së trupit të gruas.

Transmetimet e ardhura prej Ehli Bejt, e kanë komentuar këtë kuptim dhe fjalën “**stolitë e tyre**” me llojet e ndryshme të bizhuve që vihen në llërën e krahut.

Në shumë transmetime të tjera, fraza e ajetit **“stolitë e dukshme”** është komentuar me unazat, bojën për lyerjen e syve (*kohl*) dhe të ngjashme me to. Nga të gjitha këto, ne kuptojmë se **“stoli të fshehura”** janë ato që vihen poshtë mbulesës së kokës dhe të gjoksit (nën hixhab).

2- **“(besimtaret) bukurinë e tyre të mos ia tregojnë askujt përveç”:**

- 1- **“burrit”**
- 2- **“babës”**
- 3- **“babës së burrit”**
- 4- **“djemve të vet”**
- 5- **“djemve të burrit”**
- 6- **“vëllezërve të vet”**
- 7- **“djemve të vëllezërve të vet”**
- 8- **“djemve të motrave të veta”**
- 9- **“grave të tyre (atyre që u përmendën)”**
- 10- **“robëreshave që i kanë në pronësinë e tyre”**
- 11- **“shërbëtorëve meshkuj që nuk ndjejnë nevojë për femra”**
- 12- **“fëmijëve që nuk kanë arritur pjekurinë për gra”**

3- Ajeti shpjegon edhe dispozitën e katërt dhe thotë:

“le të mos i përplasnin këmbët për të zbuluar stolitë e tyre të mbuluara”, pra gratë e kanë për detyrë të ruhen shumë, ta ruajnë nderin e tyre, të qëndrojnë sa më larg prej çdo sendi e prej çdo veprimi që eksiton epshin në zemrat e burrave, me qëllim që të mos akuzohen se kanë devijuar prej rrugës së nderit.

Gratë kanë detyrë t'i kontrollojnë veprimet e tyre me seriozitetin më të madh, madje te burrat të mos arrijë as tringëllima e vathëve të varura në veshët e grave të huaja për ta. Të gjitha këto masa tregojnë se sa me hollësi i shikon Islami punët që kanë të bëjnë me ruajtjen e nderit.

Ajeti përfundon me thirrjen drejtuar të gjithë besimtarëve, burra e gra, që të pendohen e të bëjnë teube dhe të kthehen në rrugën e All'lahut për të shpëtuar. Në ajet urdhërohet: **“pendohuni tek All'lahu të gjithë o besimtarë, sepse kështu do të shpëtoni.”.**

Ajeti u thotë të gjithë besimtarëve: O njerëz, pendohuni e bëni teube për fajet që keni bërë. Tani ju u njohët me të vërtetat e dispozitave islame, prandaj kthehuni tek All'lahu që të shpëtoni; përndryshe për ju nuk do të ketë shpëtim, për shkak të devijimeve tuaja të rrezikshme nga rruga e drejtë, përveçse me dashamirësinë e All'lahut e me mëshirën e Tij, prandaj dorëzoheni punën tuaj tek All'lahu i Lartësuar.

Është e vërtetë që s’kishte kuptim të flitej për fajë e mëkate rreth kësaj çështjeje para se All'llahu t’i zbriste këto dispozita; por ne dimë se një pjesë prej çështjeve të veçanta që lidhen me degjenerimin moral, kanë edhe anën logjike dhe, sipas terminologjisë, ato janë prej “të pavarurave logjike”. Kjo është e mjaftueshme për t’u përcaktuar përgjegjësia.

Hulumtime

1- Filozofia e veshjes islame për gruan (hixhabi)

Diskutimi rreth hixhabit (veshjes islame të gruas), për ata që ndjekin modën perëndimore në kohën e sotme, kohë që edhe ata vetë e kanë quajtur si shekulli i lakuriqësisë dhe i lirisë seksuale, nuk është një diskutim që ngjall gëzim, pasi hixhabin e përfytyrojnë si një legjendë që u takon shekujve të kaluar.

Por imoraliteti i pakufishëm dhe shtimi i problemeve që burojnë prej këtyre “lirive” që s’kanë as cak e as kufi, po çon gradualisht në shfaqjen e interesit për të dëgjuar edhe rreth veshjes islame të gruas (*hixhabit*).

Në mjedise islame e fetare janë zgjidhur edhe çështje të tjera. Në vijim do të japim përgjigje bindëse për shumë nga pyetjet e shtrura.

Krahas problemeve të tjera, rëndësia e çështjes që po trajtojmë, kërkon një studim të gjerë e të thellë.

Problemi që shtrohet është (dhe këtë e themi duke kërkuar ndjesë): Vallë, vërtetë shfrytëzohen gratë nga burrat, për të ndjerë kënaqësi me anë të dëgjimit, shikimit e prekjes (përveç marrëdhënieve intime) dhe janë nën pushtetin e plotë të të gjithë burrave, apo këto gjëra janë të veçanta vetëm për gratë e tyre?

Diskutimi ka si bosht rrotullimi pyetjen: A duhet që gratë të mbeten në një garë që nuk merr fund kurrë, për të ekspozuar trupat e tyre, me qëllim që të vënë në lëvizje epshet dhe dëshirat e burrave? A duhet të eliminohen këto punë prej mjedisit shoqëror dhe ato të lihen të jenë të veçanta vetëm për familjen dhe jetën bashkëshortore?

Islami mbështet rrugën e dytë dhe veshjen islame të gruas (*hixhabin*) e konsideron pjesë të kësaj rruge, në një kohë kur perëndimorët dhe ata që hiqen si perëndimorë histerikë, mbështesin rrugën e parë.

Islami thotë se punët që kanë të bëjnë me seksin, qoftë kryerja e marrëdhënieve intime, ose kërkimi i kënaqësisë me anë të dëgjimit, ose shikimit ose prekjes, është i veçantë vetëm me gratë, përndryshe shoqëria do të njollosej e do të merrte rrugën e degjenerimit dhe, fraza **“kjo është më e pastër për ata”** që ka ardhur në ajetin e parë të grupit të ajeteve që janë objekt studimi, thekson pikërisht këtë çështje.

Në të vërtetë, filozofia e hixhabit (veshjes islame të gruas) nuk është e panjohur për askënd dhe kjo për shkaqet e mëposhtme:

1- Zbulimi i trupit të grave, i shoqëruar me elementë të kozmetikës e me llastime si dhe me veprime të tjera të ngjashme, të gjitha këto i eksitojnë burrat, veçanërisht të rinjtë, ua shkatërrojnë nervat e tyre dhe shihet se nga kjo, acarimi i nervave tek ata është bërë një gjendje zotëruese, madje disa herë ajo kthehet në burim për sëmundjet psikike. Dihet se nervat e njeriut kanë një kapacitet të kufizuar dhe s'kanë mundësi të jenë gjithnjë në gjendje acarimi, për shkak të eksitimit që marrin nga jashtë.

A nuk thonë mjekët psikologë, se gjendja e vazhdueshme e eksitimit është shkak për sëmundjet psikike?

Ne e dimë se instinkti seksual tek njeriu është instinkti më i fuqishëm e më i thellë; nga ana tjetër dimë se përgjatë historisë, ky instinkt është bërë shkak për ngjarje të përgjakshme e krime të mënxyrshme, madje thuhet se pas çdo incidenti të rëndësishëm gjendet një grua.

A nuk është nxitja e instinkteve seksuale një lojë me zjarrin?

A është logjike kjo punë?

Islami dëshiron për myslimanët, për burrat e për gratë, që të dyja palët të jenë shpirtërisht të qeta e të sigurta, të kenë nerva të shëndosha dhe shikim e dëgjim të pastër, pra të shikojnë e të dëgjojnë vetëm gjëra të lejuara dhe jo gjëra të ndaluara. Të gjitha këto në filozofinë e veshjes islame të gruas myslimane përbëjnë një tërësi të vetme.

2- Statistika të besueshme shpjegojnë qartë rritjen e numrit të divorceve dhe shpërbërjen e familjes në të gjithë botën dhe kjo po ndodh për shkak të lakuriqësisë së grave. Shumica e njerëzve

janë ndjekës të dëshirave, por në një mjedis të tillë lakuriqësie të grave, sigurisht që dashuria e burrit për një grua ndërron dhe kalon në dashuri për një grua tjetër, madje ditë për ditë e për çdo orë.

Ndërsa në mjediset ku veshja islame e gruas është dominuese dhe e shoqëruar me mësimet e tjera islame, vërehen marrëdhënie të ngushta në mes të burrit e gruas dhe dashuria në mes tyre është e përbashkët. Kurse në tregun e lakuriqësisë e të lirisë seksuale, ku gruaja është thjesht një mall që shitet e blihet, ose në vlerësimin më të vogël, është bërë objekt që ta shikojnë e ta dëgjojnë burrat, tek ajo humb lidhja dhe paprekshmëria e martesës, themelet e familjes shpërbëhen me shpejtësi, si të ishin pëlhurë merimange dhe pasojat e këtij pësimi të rëndë bien mbi fëmijët, të cilët me shkatërrimin e familjes, humbin njerëzit e tyre më të dashur dhe ngrohtësinë familjare.

3- Përhapja e prostitucionit dhe shtimi i lindjeve të fëmijëve jashtë martesës ligjore, konsiderohen prej rezultateve më shkatërruese të anulimit të veshjes islame të gruas (*hixhabit*) dhe për këtë nuk është e nevojshme të ketë statistika, pasi dukuritë e kësaj gjendjeje janë të dukshme në shoqëritë perëndimore.

Ne nuk themi se shkaku kryesor për përhapjen e prostitucionit dhe shtimit të numrit të fëmijëve të paligjshëm kushtëzohet vetëm në anulimin e veshjes islame të gruas (*hixhabit*) dhe të mosmbulimit të saj. Gjithashtu, nuk themi se kolonializmi fatal me problemet politike shkatërruese që ai mbart, s'kanë asnjë rol në problemin që është objekt studimi, por themi se zhveshja është nga shkaqet e forta që çojnë në përhapjen e prostitucionit e në shtimin e numrit të fëmijëve të paligjshëm.

Gjithashtu, ne dimë se përhapja e prostitucionit dhe shtimi i numrit të fëmijëve të jashtëligjshëm, kanë qenë dhe janë burim i llojeve të ndryshme të krimeve në shoqëritë njerëzore, të hershme e moderne.

Në një gjendje të tillë shoqërore, për ne bëhen të qarta dimensionet e rrezikshme të këtij problemi.

Sipas statistikave, numri i fëmijëve të jashtëligjshëm në Britani ka arritur në pesëqind mijë fëmijë në vit dhe se shkencëtarët i kanë paralajmëruar autoritetet përgjegjëse për pasojat e kësaj gjendjeje, e cila nuk është ashtu siç thonë – për shkak të kundërshtimit të çështjeve morale e fetare, pasi në të vërtetë, gjendja përkeqësohet nga rreziku që përbëjnë fëmijët e lindur jashtë martesës për sigurinë e shoqërisë. Specialistët e fushës së kriminalistikës kanë konstatuar se pikërisht ky kontigjent fëmijësh janë të përfaqësuar në pjesën më të madhe të dosjeve të veçanta të krimeve.

Nga sa u tha, kuptohet mirë rëndësia e këtij problemi, që në të vërtetë është një fatkeqësi e madhe për të gjithë ata që nuk besojnë në një fe dhe nuk interesohen për moralin.

Sa më shumë që të përhapet degjenerimi seksual në shoqëritë njerëzore, aq më shumë shtohet edhe kërcënimi e rreziku në dëm të vetë atyre shoqërive. Hulumtimet e shkencëtarëve të fushës së edukimit kanë argumentuar shfaqjen e punëve që janë në kundërshtim me nderin dhe përmasat e mëdha që ka marrë shkujdesja ndaj punës e prapambetja në të, si dhe mungesa e ndjenjës së përgjegjësisë në shkollat e përziera e në institucionet e tjera ku punojnë së bashku burra e gra.

4- Çështja e përçmimit të gruas dhe ulja e personalitetit të saj në shoqëritë perëndimore është e një rëndësie shumë të madhe dhe s'ka nevojë për shifra. Kur vetë shoqëria dëshiron lakuriqësinë e gruas, është normale që këtë të fundit e ndjek kërkesa e gruas për mjetet e kozmetikës dhe të veshjeve diskredituese, si dhe degradimi në sjellje, por bashkë me këto bie poshtë edhe personaliteti i saj në një shoqëri që ka në qendër tërheqjen seksuale të gruas, përdorimin e saj në mjetet e informacionit, ose në reklamimin e mallrave, si dhe shfrytëzimi i saj si karrem për të thithur sa më shumë turistë.

Pikërisht nga kjo gjendje, gruaja humb të gjithë vlerën e saj njerëzore. Në një mjedis të tillë shoqëror, rinia e bukuria e saj bëhen burimi i vetëm për krenarinë e për respektin ndaj saj; madje në këtë mjedis, gruas nuk i ka mbetur asgjë nga qenia njeri, përveç faktit se tashmë ajo është bërë një mjet për të ngopur epshet e bishave me fytyra njerëzore.

Si është e mundur për gruan, që të shkëlqejë nga ana kulturore dhe të lartësohet nga ana morale, në një shoqëri të tillë?!

Me të vërtetë, është për të ardhur keq që gruaja del nëpër skena të ndryshme dhe luan në emër të artit, megjithëse me këtë lojë ajo bëhet e famshme dhe fiton jo pak para, por njëkohësisht në shoqërinë ku jeton, ajo degradon deri në cakun e përçmimit. Drejtuesit e kësaj shoqërie të degjeneruar moralisht, e përdorin gruan për të prezantuar e për t'u shfaqur në sfilatat e ndryshme që organizohen për reklamimin e veshjeve ekstravagante, ose në shfaqjet argëtuese të natës.

Kjo është gjendja e gruas në shoqëritë perëndimore, ndërsa në shoqërinë islame ajo luan rolin e saj pozitiv, ku krahas ruajtjes së veshjes islame, jep ndihmesën e saj në të gjitha fushat, ashtu siç e ka dhënë gjithmonë, deri edhe në prapavijën e frontit në mbështetje të luftimeve, madje edhe me pjesëmarrjen e saj të drejtpërdrejtë në fushën e luftës në rrugën e All'lahut.

Kjo ishte njëra anë e filozofisë jetësore të çështjes së veshjes islame (*hixhabit*) të gruas myslimane. Në Islam, kjo filozofi është në përputhje të plotë me interpretimin tonë të ajetit që është objekt studimi.

2- Vështirësia që sjellin kundërshtarët e veshjes islame të gruas (*hixhabit*)

Le të shohim edhe kritikën që kundërshtarët i bëjnë veshjes islame (*hixhabit*) të gruas myslimane dhe t'i studiojmë ato qoftë edhe në formë të shkurtër:

1- Kundërshtarët e veshjes islame (*hixhabit*) thonë se gruaja përbën gjysmën e shoqërisë, kurse veshja islame (*hixhabi*) e izolon atë prej jetës shoqërore. Ky izolim bëhet shkak që gratë që mbajnë veshjen islame, të jenë të prapambetura nga ana kulturore dhe të mos përfitojnë prej potencialeve të mëdha të lulëzimit të ekonomisë. Gjithashtu, për shkak të veshjes islame, gratë myslimane nuk kanë vend në institucionet kulturore e shoqërore; veç kësaj, kundërshtarët e veshjes islame shtojnë se gratë, për shkak të saj, bëhen thjesht materiale konsumi pa ndonjë rëndësi për shoqërinë.

Duhet theksuar se mbartësit e një mendësie të tillë i kanë anashkaluar me shkujdesje të plotë disa çështje, ose hiqen sikur janë të shkujdesur ndaj tyre:

E para: Kush ka thënë se veshja islame (*hixhabi*) e gruas e izolon atë në shoqëri?

Nëse në të kaluarën ishte e vështirë t'i përgjigjeshim kësaj pyetjeje, nuk mendojmë se sot, në shoqëritë islame, ka ndonjë që e mohon praninë e gruas në institucionet arsimore, shëndetësore e shoqërore, deri edhe në universitete.

Me pak fjalë, realiteti i shoqërisë islame në ditët tona, është përgjigja më e mirë për këtë pyetje. Nëse në të kaluarën flisnim për mundësinë e pjesëmarrjes së gruas në jetën shoqërore, sot e shikojmë atë të përfaqësuar në të tilla institucione dhe, ashtu siç thonë filozofët, ky është argumenti më i mirë që vërteton mundësinë e ekzistencës së fenomenit, prandaj s'ka nevojë të sillen argumente që të vërtetojnë realitetin.

E dyta: Përveç kësaj që u tha, a nuk konsiderohet punë e mirëfilltë administrimi i shtëpisë, rritja dhe edukimi i fëmijëve të shëndetshëm, që janë burrat e gratë e ardhshme, të cilët do të drejtojnë mekanizmat e ekonomisë e të politikës së vendit?

Ata që nuk e marrin në konsideratë këtë përgjegjësi të gruas si punë pozitive, janë krejtësisht injorantë për rolin e saj në familje, në edukimin dhe në ndërtimin e një shoqërie të shëndoshë e aktive; madje, ata nuk njohin as gjendjen e atyre grave që, së bashku me burrat e vet, dalin në mëngjes nga shtëpitë e tyre,

ashtu siç ndodh rëndom në vendet perëndimore, dhe drejtohen për në institucionet e qendrat e punës, duke lënë fëmijët nën kujdesin e të tjerëve, ose nëpër institucionet parashkollore, ose edhe duke i mbyllur fëmijët brenda në shtëpi e duke i lënë pa asnjë kujdesje, derisa të kthehen nga puna të rraskapitur nga lodhja.

Të tillë të shkujdesuar edhe ndaj dashurisë për fëmijët, nuk e kuptojnë se kështu, ata shkatërrojnë personalitetin e fëmijëve dhe e ekspozojnë shoqërinë para rreziqeve të paparashikuara.

2- Gjithashtu, kundërshtarët e veshjes islame të gruas thonë se ajo e pengon atë në aktivitetin e saj shoqëror dhe nuk është në përputhje me kohën moderne. Për këtë, ata shtrojnë pyetjen: Si mundet gruaja, që të ruajë në të njëjtën kohë veshjen e saj islame, krahas kujdesit për fëmijën e për punën?!

Ata janë kaq të shkujdesuar saqë nuk e dinë se veshja islame e gruas nuk është rroba që hidhet përsipër, apo të tjera të ngjashme, por mbulimi i trupit të saj dhe, nëse gruaja vesh edhe atë që ata kanë shumë qejf ta emërtojnë si “ferexhe”, është edhe më mirë. Me veshjen e saj islame, gruaja mbulon kokën, por jo fytyrën e duart. Le të shikojmë gratë në fshatrat tona, të cilat megjithëse mbajnë veshjen islame, punojnë në arat e familjes, nëpër orizore, mbjellin e korrin dhe bëjnë të gjitha punët që kërkojnë të mbjellat. Me këtë aktivitet, gratë myslimane e kanë vërtetuar në praktikë mundësinë e gruas për të ruajtur veshjen e saj islame (*hixhabin*) pa u penguar aspak, madje as në kryerjen e punëve më të rënda.

3- Kundërshtarët e veshjes islame të gruas i kundërvihen asaj me pretendimin se ajo i veçon gratë prej burrave dhe shton te këta të fundit dëshirën e tyre të zjarhtë, në vend që ta shuajë atë, sepse siç thotë proverbi: *“Burri dëshiron më shumë gjënë nga e cila ndalohet”*.

Kjo mënyrë arsyetimi është sofizëm i qartë. Sikur njeriu të krahasojë shoqërinë tonë në kohën e sundimit të tiranit me shoqërinë e sotme, para tij do të shfaqet e plotë dhe e qartë gjendja e gruas në shoqërinë islame. Nëse dje, heqja e veshjes islame bëhej me imponim, sot në shoqërinë islame kjo veshje është e përgjithshme. Degjenerimi ishte shumë i përhapur në atë kohë. Në shumicën e familjeve, shkujdesja për anën morale shtohet nga dita në ditë, krahas shtimit të numrit të divorceve dhe rritjes së lindjeve të fëmijëve të paligjshëm, duke përfshirë këtu edhe mijëra vështirësi të tjera, të cilat sillnin forma të ndryshme të shthurjes në shoqëri. Të gjitha këto punë të mbrapshta janë eliminuar, madje janë shkukur me gjithë rrënjë dhe kështu, në shoqërinë tonë islame është kthyer paqja.

Nëse me lejen e All'Ilahut gjendja do të vazhdojë në këtë rrjedhë, do të kemi mundësi të zgjidhim të gjitha problemet, shoqëria jonë do të arrijë në shkallën e pastërtisë së plotë dhe grua do të ruajë pozitën e saj të lartë.

3- Përfshirja e fytyrës dhe i pëllëmbëve të duarve

Në mesin e *fukahave* (juristëve) të ligjit të fesë, ka mendime të ndryshme nëse dispozita e veshjes islame të gruas përfshin apo

jo mbulimin e fytyrës dhe shputave të duarve, prej kyçit të dorës e deri në majën e gishtave.

Shumica e *fukahave* (juristëve) mendojnë se fytyra dhe shputat e duarve përjashtohen nga dispozita e veshjes islame e gruas, ndërkohë që *fukaha* (juristë) të tjerë shprehen se duhen mbuluar patjetër fytyra dhe dy shputat e duarve. Kuptohet që përjashtimi i fytyrës dhe i shputave të duarve nga mbulimi, bëhet në rastin kur nuk kemi gjendje të përhapjes së imoralitetit, ndryshe patjetër që është detyrim që edhe fytyra e shputat e duarve të jenë të mbuluara.

Në ajetin që është objekt studimi, kemi shembuj krahasues që e përforcojnë këtë përjashtim dhe që mbështesin mendimin e parë:

a) Përjashtimi i stolive të jashtme në ajetin që është objekt studimi, qoftë kur qëllimi është për vendin ku vihet stolia ose vetë stolia, tregon se nuk është detyrim as mbulimi i fytyrës e as i shputave të duarve.

b) Dispozita e ajetit që është objekt studimi, tregon se është detyrim që mbulesa e kokës të mbulojë qafën dhe kraharorin. Siç shihet, kjo dispozitë nuk flet për mbulimin e fytyrës dhe, ky është një argument për këtë mendim.

Për ta sqaruar akoma më mirë këtë çështje, duhet thënë se gratë e arabëve, në të vërtetë, e mbanin pjesën e sipërme të veshjes islame (*khimâr*) të gruas dhe dy anët e kësaj rrobe i hidhnin mbi supe, në atë mënyrë që mbeteshin zbuluar qafa dhe një pjesë e kraharorit. Kurse Islami e përmirësoi këtë gjendje dhe e urdhëroi mbulimin e qafës dhe të krejt kraharorit, duke e lëshuar mbulesën

e kokës deri afër mesit, por duke mbetur i zbuluar vetëm rrethi që përfshin fytyrën.

c) Shumë transmetime islame të ardhura për këtë çështje e përforcojnë mendimin tonë;¹ por ka edhe të tjera që i kundërshtojnë transmetimet e grupit të parë, megjithëse të dytat nuk e kanë gradën e plotë të qartësisë dhe, në rrugën e bashkimit të dy grupeve të transmetimeve, themi se preferohet edhe mbulimi i fytyrës dhe i shputave të duarve, kur gjendja favorizon përhapjen e imoralitetit dhe të devijimit nga rruga e drejtë. Dokumentet historike vërtetojnë se mbulimi i fytyrës së gruas nuk ka qenë i përgjithshëm në fillimet e Islamit (shpjegimi i detajuar për këtë çështje jepet në librat e *fikhut* dhe të haditheve në kapitullin “Martesa”).

4- Cili është qëllimi me fjalën e ajetit: “grave të tyre”?

Në komentimin e ajetit që është objekt studimi, thamë se grupi i nëntë i personave që gruaja mund t’ua tregojë stolitë e saj, janë gratë. Duke marrë në konsideratë frazën e ajetit “*gratë e tyre*”, kuptojmë se me të, qëllimi është për gratë myslimane dhe jo për ato që nuk janë të tilla. Filozofia e këtij rregulli qëndron në faktin se jomyslimanet mund t’ua përshkruajnë burrave të vet atë çka shohin prej stolive të grave myslimane; prandaj ky veprim nuk është i drejtë të bëhet prej myslimaneve.

Në transmetimin e ardhur prej Imam Sadikut, në librin “*Kush nuk e ka arritur juristin e fesë*”, lexojmë: “Gruaja myslimane

¹ “Vesàilush Shija”, vëll. 1, f. 561, kapitulli 106 prej kapitujve të veprimeve paraprahe të kurorës.

nuk duhet të zbulohet në prani të grave jehudije ose të krishtera, sepse ato pastaj ua përshkruajnë atë burrave të tyre”.¹

5- Komentimi i frazës së ajetit: “si dhe robërve, që ajo ka në pronësi”

Kjo frazë e ajetit ka një kuptim shumë të gjerë dhe tregon se është e mundur që gruaja të dalë pa veshjen e plotë islame në prani të robit që ajo e ka pronë të vetën; porse disa hadithe thonë se kjo dalje e gruas është vetëm për daljen ndër gratë robëresha të saj, qofshin ato edhe jomyslimane, sepse kjo dispozitë nuk i përfshin robërit meshkuj. Në një transmetim të ardhur prej prijësit të besimtarëve, Imam Aliut, lexojmë: “*Robi nuk i shikon flokët e pronares së tij*”.²

Në transmetime të tjera flitet se kjo është dispozitë e përgjithshme dhe përfshin robëreshat dhe robërit, porse kjo është në kundërshtim me rezervën për ruajtje.

6- Komentimi i frazës së ajetit: “ose shërbëtorëve meshkuj që nuk ndjejnë nevojë për gra”

¹ “*Kush nuk e ka arritur juristin e fesë*”, vëll. 3, f. 561, sipas asaj që thuhet të tefsirin “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 593.

² “*Vesailush Shija*”, kapitulli 124 prej kapitujve “*Veprimet paraprake të martesës*”.

Fjala e ajetit “*el irbeti*, në rrënjën e saj, ashtu siç thotë Ràgibi në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'anit, ka kuptimin e nevojës së madhe që e shtyn njeriun të gjejë një zgjidhje për problemin që ka.

Gjithashtu edhe fjala *nevojë*, është përdorur në formë përgjithësuese; kurse qëllimi me frazën “ose shërbëtorëve meshkuj që nuk ndjejnë nevojë për gra”, është për burrat që kanë dëshira seksuale, pra kanë nevojë për grua. Bazuar mbi këtë shpjegim, “ata që nuk ndjejnë nevojë për femra”, janë burrat, të cilët në bazë nuk kanë dëshira seksuale. Atëherë, cili është qëllimi me këtë frazë? Për këtë ka mendime të ndryshme në mesin e interpretuesve të Kur'anit Famëlartë.

Disa interpretues të Kur'anit kanë thënë se bëhet fjalë për të moshuarit, te të cilët është shuar dëshira për femër (si gratë e moshuara, ose grave që u ka kaluar mosha për martesë dhe, nga kjo pikëpamje, burrat e përmendur në ajet janë bërë si gratë e moshuara).

Të tjerë kanë thënë se qëllimi me këtë fjalë është për burrin që s'ka testet.

Interpretues të tjerë të Kur'anit kanë thënë se qëllimi me këtë frazë të ajetit është burri që nuk e ka organin seksual.

Interpretimin tek i cili mund të mbështetemi, e gjejmë në transmetimin e ardhur prej Imam Bekirit dhe prej Imam Sadikut, të cilët kanë thënë: “*Është burri budalla që nuk shkon te gratë*”, pra qëllimi me këtë frazë të ajetit janë burrat mendjeshkurtër, që nuk ndjejnë dëshira seksuale asnjëherë dhe që mund të përdoren për

punë të thjeshta dhe për t'u shërbyer të tjerëve. Vetë fjala e ajetit “*et’tàbi’ijne*”, e përforcon këtë kuptim.¹

Meqenëse përshkrimi i mungesës së dëshirës për seks, vërtetohet vetëm për shtresën e të moshuarve, në asnjë rast nuk përjashtohet mundësia e zgjerimit të kuptimit të ajetit dhe të përfshihet edhe kjo shtresë. Në transmetimin e ardhur prej Imam Kadhimit, ky kuptim përforcohet edhe më shumë, megjithatë edhe burrat e kësaj shtrese nuk bëhen prej të afërmve të gruas, pra prej burrave me të cilët gruaja e ka të ndaluar të martohet; qëllimi i mirëfilltë këtu është se gruaja nuk e ka detyrim të mbulojë kokën ose një pjesë të duarve në prani të kësaj shtrese burrash.

7- Cili fëmijë përjashtohet prej kësaj dispozite?

Ne thamë se kategoria e dymbëdhjetë e personave para të cilëve gruaja nuk i fsheh stolitë e saj, janë fëmijët që nuk kanë arritur moshën e pjekurisë seksuale.

Fjala e ajetit “*lem jadhherù*”, disa herë ka kuptimin “*nuk dinë*” dhe herë të tjera ka kuptimin “*nuk sulmojnë*”. Kjo fjalë ka ardhur në të dyja kuptimet, sipas përdorimit të saj në ajetet e Kur’anit, domethënë herë ka ardhur në kuptimin e parë dhe herë në të dytin. Një shembull për këtë fjalë që shpreh kuptimin e dytë,

¹ Për më shumë sqarime, referohu në librat: “Xhevàhirul Kelàm”, vëll. 29, f. 94; “Vesàilush Shija”, kapitulli 111, prej *Veprimeve paraprake të martesës*, vëll. 14, f. 148; si dhe në “Et Tehdhijb”, vëll. 7, f. 468.

e shohim në ajetin 20 të sures “El Kehf”: **“nëse ata mësojnë për ju, do t’ju ekzekutojnë me gjuajtje me gurë.”**.

Edhe në ajetin 8 të sures “Et Teube” lexojmë: **“(si mund të besohet në) ata, të cilët nëse mundeni prej tyre, nuk përfillin as që jeni farë e fis e as marrëveshje.”**.

Duhet theksuar se ky dallim në kuptim nuk është aq i madh në raport me ajetin që është objekt studimi, pasi qëllimi në të janë fëmijët që akoma nuk kanë prirje ndaj seksit të kundërt, për shkak se janë ende të pafuqishëm, si dhe nuk kanë dijeni për këto punë; megjithatë, gratë myslimane e kanë detyrim të jenë të mbuluara në prani të fëmijëve, kur këta të fundit kanë arritur moshën në të cilën dallojnë dëshirat seksuale dhe ndihen të fuqishëm për to.

8- Përse nuk janë përmendur xhaxhai dhe daja ndër të afërmit?

Kjo pyetje shtrohet pas hulumtimeve mbi ajetet që janë objekt studimi: Përse vetëm xhaxhai dhe daja nuk janë përmendur ndër të afërmit, kur ata janë prej tyre?

Ka të ngjarë që Kur’ani, duke mos i përmendur ata të dy në këtë ajet, ka për qëllim të ruajë retorikën e gjuhës në shprehjet e tij, duke mos përmendur as edhe një fjalë më tepër. Në të vërtetë, përveçimi nga dispozita e djalit të vëllait dhe djalit të motrës argumenton se halla dhe tezja konsiderohen prej të afërmeve të

dikujt; kështoj qartësohet se xhaxhai dhe daja e një gruaje janë të afërm të saj.

Me fjalë të tjera, ndalimi është i dyanshëm: nga njëra anë, vajzat e motrës dhe vajzat e vëllait janë prej të afërmeve të burrit dhe, është e natyrshme që nga ana tjetër edhe xhaxhai, edhe daja të jenë prej afërmeve.


9- Ndalimi i rrugëve të eksitimit me anë të shenjave

Ajeti që është objekt studimi, e ndalon që gruaje të ecë duke i mëshuar tokës me forcë, me qëllim që të tjerët të dëgjojnë tingujt që lëshojnë byzylykët e bizhutë e vëna në kërcirin e këmbës.

Ky ndalim tregon se sa hollë e shikojnë dispozitat islame dhe sa shumë rëndësi u kushtojnë ato problemeve të veçanta që kanë lidhje me nderin e njerëzve. Ajeti e thotë prerë se nuk lejohet që gratë të bëjnë të tilla veprime.

Islami nuk e lejon eksitimin e epsheve të rinisë me botimin dhe shpërndarjen e fotografive pornografike, ose të filmave me subjekt erotik, apo tregimet e romanet që përshkruajnë gjendjet seksuale të paligjshme. Mjedisi Islam duhet të jetë i pastër dhe i shëndetshëm nga të tilla gjëra që i tërheqin individët e shoqërisë drejt greminës së shthurjes dhe drejt errësirave të imoralitetit. Me fjalë të tjera, kërkohet kujdes i veçantë ndaj çdo pune që i nxit të rinjtë e të rejat, që të kalojnë në degjenerimin moral dhe të bëjnë vepra të turpshme.

Ajetet 32 - 34



“Dhe martojini (të pamartuarit) me të pamartuarat edhe robërit e robërshat tuaja që janë të ndershëm e të ndershme; nëse janë të varfër, All'llahu i begaton ata me mirësitë e Tij; All'llahu është shumë bujar dhe i Gjithëdituri.”

“Dhe ata që s’kanë mundësi të martohen, le të përmbahen derisa All'llahu t’i begatojë me mirësitë e Tij; nëse ata që janë në pronësinë tuaj kërkojnë prej jush që të lirohen kundrejt kompensimit, atëherë t’ia jepni këtë mundësi me marrëveshje, nëse e dini që ata janë të besueshëm dhe u jepni atyre nga pasuria që u ka dhënë All'llahu; mos i detyroni robërshat tuaja të prostitutojnë për shkak të ndonjë përfitimi të kësaj bote, derisa ato dëshirojnë të jenë të pastra dhe, kush i detyron ato me dhunë (të prostitutojnë), All'llahu i fal ato pas atij detyrimi; All'llahu fal shumë, Ai është Mëshirëploti.”

“Ne kemi zbritur për ju argumente të qarta dhe shembuj prej atyre që ishin para jush, si këshillë për të ruajturit.”

Komentimi

Këshilla për martesë me pak shpenzime

Ajeti i parë i grupit të ajeteve që janë objekt studimi, qysh në fillim shtron rrugë të sigurtë e të shumta për të ndaluar degjenerimin moral dhe imoralitetin. Çdonjëra prej këtyre rrugëve e lartëson popullin, individin e shoqërinë dhe i ngren në një shkallë më të lartë pastërtie. Gjithashtu, këto rrugë mundësojnë marrjen e qëndrimeve të drejta. Ato e ndalojnë popullin të shkojë prapa, ose të rrokulliset në greminat e punëve të ulëta. Ajetet që janë objekt studimi theksojnë me përparësi rrugët për luftimin e prostitucionit, të cilat janë: martesë me sa më pak shpenzime dhe sa më larg dukurive të hipokrizisë e mburrjes me shpenzime të tepërta, sepse ngopja e instinkteve në mënyrë të drejtë e ligjore, është rruga më e mirë për të shkëlqyer rrënjët e fajeve. Thënë ndryshe: çdo veprim i keq duhet të shoqërohet me një veprim të mirë.

Për të gjitha këto, ajeti i parë që është objekt studimi, thotë: **“Dhe martohuni (të pamartuarit) me të pamartuarat edhe robërit e robëreshat tuaja që janë të ndershëm e të ndershme.”**

Fjala e ajetit “*el ejàmà*” në rrënjën e saj, ka kuptimin e gruas që s’ka burrë, por kjo fjalë thuhet edhe për burrin që s’ka grua, pra në kuptimin e saj hyn cilido që s’ka grua dhe përdoret ose për beqarin, ose për atë që është martuar më parë.

Me fjalën “*uenkihù*”, ajeti urdhëron: *Martohuni!* Meqenëse martesë realizohet me miratimin e zgjedhjen e lirë të të dyja palëve, qëllimi me urdhrin “*martohuni*” është përgatitja për martesë me dhënien e ndihmës financiare, sigurisht në rast nevojë, ose gjetja e një gruaje të përshtatshme, ose nxitja për martesë, duke përfituar nga ndërmjetësimi i njerëzve për zgjidhjen e problemeve që mund të dalin.

Me pak fjalë, kuptimi i ajetit ka shtrirje shumë të gjerë dhe përfshin çdo hap e çdo bisedë që bëhet për çështjen e realizimit të martesës; gjithashtu, s’ka asnjë mendim kundër, që vetë origjina e bashkëpunimit islam e bën të detyrueshme ndihmën që myslimanët duhet t’i japin njëri-tjetrit në këtë çështje.

E gjitha kjo është shprehur shumë qartë për të theksuar rëndësinë e veçantë të martesës, pasi me të vërtetë, ajo është ngjarje me rëndësi shumë të madhe dhe me dimensione të gjera. Në një transmetim të ardhur prej prijësit të besimtarëve, Imam Aliut, lexojmë fjalën e tij: “*Ndërmjetësimi më i preferuar është ai në mes dy vetëve për martesë, derisa All'llahu t’i bashkojë ata.*”¹

Në një transmetim tjetër të ardhur prej Imam Musa Kadhimit, lexojmë fjalën e tij: “*Tri kategori do të jenë nën hijen e arshit të All'llahut në Ditën e Gjykimit, në Ditën kur s’ka hije tjetër*

¹ “*Vesàilush Shija*”, vëll. 14, f. 27, kapitulli nr. 12 prej kapitujve të martesës.

përveç hijes së Tij: burri që ka martuar vëllain e vet mysliman, ose ka martuar shërbyesin e vet, ose ka mbajtur të fshehtë një sekret të tij.”¹

Në hadithin e ardhur prej të Dërguarit më të nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), përmendet personi që përpiqet ta martojë sa më shpejt vëllain e tij mysliman: *“Për çdo hap që ai hedh, ose për çdo fjalë që ai thotë për punën e martesës, atij i shkruhet sikur ka falur namaz gjithë natën dhe sikur ka agjëruar gjithë ditën.”²*

Beqaria justifikohet nga disa faktorë, të tillë si: varfëria, ose mungesa e mundësive të domosdoshme. Në fakt, këta faktorë mund të ngrenë një mur që e pengon martesën; por ndodh që justifikim për të mos u martuar dhe për të formuar familje, mund të jetë edhe frika e mbajtjes së përgjegjësive që sjell martesa. Për të gjitha këto, Kur'ani Famëlartë thotë: **“nëse janë të varfër, All'llahu i begaton ata me mirësitë e Tij; All'llahu është shumë bujar dhe i Gjithëdituri.”**

Fuqia e All'llahut është aq e gjerë, saqë përfshin mbarë botën e ekzistencës; gjithashtu, edhe dituria e Tij është shumë e gjerë. Ai ka dijeni për të gjitha qëllimet e punët e fshehta dhe për ato që bëhen sheshit; All'llahu ka dijeni të plotë edhe për dëshirat e atyre që kërkojnë të martohen, me qëllim që të ruajnë nderin e pastërtinë e tyre morale. Njerëz të tillë besimtarë All'llahu i përfshin me bujarinë e me mirësinë e Tij.

Në fund të këtij studimi, për këtë çështje do të bëjmë një analizë, ku do të përmendim disa hadithe e transmetime.

¹Burimi i mësipërm.

² Burimi i mësipërm.

Në disa raste, pavarësisht nga përpjekja e të gjithëve për të përgatitur të gjitha gjërat që kërkon martesë e njeriut, ata nuk kanë sukses në këtë punë, çka do të thotë se për një periudhë kohe, burri do të jetë i privuar nga martesë. Megjithatë, ai nuk mendon të kalojë në rrugën e prostitucionit dhe ta konsiderojë atë një veprim të lejuar, të diktuar nga domosdoshmëria; prandaj, ajeti vijues e urdhëron njeriun që të qëndrojë i pastër dhe i ndershëm, duke thënë: **“Dhe ata që s’kanë mundësi të martohen, le të përmbahen derisa All'Ilahu t’i begatojë me mirësitë e Tij.”**.

Gjatë periudhës që burri s’ka mundësi të martohet, e ka detyrë të qëndrojë larg rrugëve që të çojnë në punë të ndyra e në prostitucion; ai duhet ta përballojë përkohësisht këtë provim hyjnor, pasi për kryerjen e punëve imorale nuk pranohet asnjë justifikim. Prandaj është e domosdoshme që gjatë kësaj periudhe kohore, burri të vërë në provë forcën e besimit, personalitetin dhe devotshmërinë e tij.

Islami bën kujdes edhe për robtë, të cilët nga ana shoqërore janë të pafuqishëm për ta menaxhuar jetën e tyre, prandaj Kur’ani Famëlartë trajton edhe çështjen e lirimit të robërve me marrëveshje kundrejt kompensimit. Kjo marrëveshje në gjuhën e Kur’anit quhet *“mukâtebeh”*, që do të thotë: robi nënshkruan një marrëveshje, se ai do të bëjë një punë të caktuar, ose do të paguajë një shumë si kompensim për lirimin e tij. Ajeti thotë: **“nëse ata që janë në pronësinë tuaj kërkojnë prej jush që të lirohen kundrejt kompensimit, atëherë t’ia jepni këtë mundësi me marrëveshje, nëse e dini që ata janë të besueshëm.”**.

Kjo frazë e ajetit ka kuptimin: kur ata të jenë rritur fizikisht, kur në ta të dalloni aftësinë për të lidhur kontratë dhe kur të kenë mundësi të kryejnë punën për të cilën zotohen.

Por nëse ata nuk e mbajnë besën sipas marrëveshjes që bënë, atëherë nuk duhet t'u jepet liria kundrejt kompensimit, sepse në radhë të parë do të dëmtohen vetë robërit; pastaj lirimi i tyre kur ata s'kanë mundësi të mbajnë premtimin e dhënë, sjell dëm edhe për shoqërinë. Për këtë bëhet detyrim shtyrja e lirimit të tyre deri në një kohë kur të mendohet se ata kanë arritur të kenë fuqi dhe aftësi për të vendosur, me qëllim që ata të mos përballen me probleme që s'kanë mundësi t'i zgjidhin dhe s'kanë mundësi as të plotësojnë atë që u është besuar. Kur'ani Famëllartë bën thirrje që ata të ndihmohen dhe urdhëron: **“dhe jepuni atyre nga pasuria që u ka dhënë All'Ilahu.”**

Në mesin e interpretuesve të Kur'anit ka mendime të ndryshme rreth kësaj pasurie që urdhërohet t'u jepet robërve. Një numër i madh prej tyre kanë thënë që atyre t'u jepet një pjesë prej zekatit, ashtu siç thuhet në ajetin 60 të sures “Et Teube”, që edhe robërit të kenë mundësi ta shlyejnë borxhin e marrë për të siguruar lirimin e tyre.

Të tjerë kanë thënë se pronari i robit e ka detyrë të japë vullnetarisht një pjesë prej borxhit që i detyrohet robi kundrejt lirimit të tij, ose e ndihmon atë që të rikthehet te pronari i vet, me qëllim që të fitojë mundësitë për të ndërtuar jetën në liri.

Ka mundësi që qëllimi me këtë fjalë të ajetit të jetë: në fillim i jepet robit një shumë parash si kapital, me të cilën ka mundësi të bëjë tregti, ose të nisë një punë apo të administrojë punët e tij

personale dhe kështu atij i krijohen mundësitë që të shlyejë pjesë-pjesë shumën që i është dhënë në mirëbesim. Këto tre interpretime nuk janë në kundërshtim me njëri-tjetrin, prandaj ka mundësi që ajeti, që është objekt studimi, t'i përmbajë të tre.

Kjo fjalë e ajetit ka për qëllim të nxisë myslimanët që ta mbështesin këtë shtresë të pafuqishme të shoqërisë me ndihmat e tyre, që edhe ata të fitojnë lirinë sa më shpejt që të jetë e mundur.

Në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut në lidhje me komentimin e këtij ajeti, lexojmë fjalën e tij: *“Hiq prej robit pjesët e shlyerjes së borxhit që ti nuk dëshiron t'i pakësosh dhe mos shto mbi ato që ke në veten tënde.”*¹

Duhet theksuar se shumë njerëz ua jepnin lirinë robërve të tyre, duke nënshkruar marrëveshje me shumën më të mëdha nga sa kishin dhënë për blerjen e tyre dhe hiqeshin sikur po i ndihmonin ata. Imam Sadiku e ka denoncuar këtë veprim dhe ka shpjeguar se ulja e kompensimit që paguan robi për fitimin e lirisë duhet të jetë reale.

Në vijim të trajtimit të çështjes së martesës, ky ajet thekson njërin prej punëve të këqija që praktikonin adhuruesit e kësaj bote ndaj robërshave të tyre, duke thënë: **“mos i detyroni robërshat tuaja të prostitutojnë për shkak të ndonjë përfitimi të kësaj bote.”**

Në lidhje me shkakun e zbritjes së këtij ajeti, disa interpretues të Kur'anit kanë thënë: Abdullah bin Ubej kishte në pronësi gjashtë robërsha, të cilat i detyronte të prostitutonin në

¹ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 601.

favor të tij. Kur zbritën ajetet e Kur'anit që ndalonin prostituimin, ato erdhën te Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe paraqitën tek ai ankesën e tyre kundër pronarit të vet. Atëherë zbritën ajetet që janë objekt studimi dhe ndaluan kryerjen e një faji të tillë.¹

Ky ajet tregon se sa shumë ishin përhapur punët e ulëta dhe degjenerimi moral dhe sa zotëruese ishte bërë kjo gjendje në kohën e injorancës para Islamit. Madje disa prej këtyre punëve vazhduan edhe pas shfaqjes së Islamit, derisa zbritën ajetet që janë objekt studimi, të cilët i ndaluan rreptësisht ato.

Edhe në shekullin që jetojmë, shohim se njerëzimi e praktikon këtë punë me shumë vrull dhe pikërisht në vendet që konsiderohen si të qytetëruara e të kulturuara, vende që hiqen se mbrojnë të drejtat e njeriut; kur kjo punë shumë e keqe praktikohet sheshit dhe shpesh, disa njerëz të ligj, i mashtrojnë fare lehtë vajzat e reja e të pafajshme, si edhe gratë injorante, dhe i shtynjë ato drejt qendrave të prostitucionit, duke i detyruar më pas që të praktikojnë prostitucionin në dobi të tyre; ata ua mbyllin kështu dyert e shpëtimit dhe i orientojnë drejt frekuentimit të këtyre qendrave, prej të cilave ata grumbullojnë pasuri kolosale. Është shumë e dhimbshme të flitet për këto punë, të cilat janë jashtë sferës së çështjeve që trajtohen në këtë libër.

Pavarësisht se bota bashkëkohore pretendon se është botë e kulturuar dhe se janë eliminuar dukuritë e skllavërisë së vjetër, në të vërtetë në të, krimet dhe imoraliteti kanë marrë përhapje shumë

¹ Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", fundi i ajetit që është objekt studimi; tefsiri i "Kurtubij'jit" (me disa ndryshime).

më të egër se në kohët e kaluara. Lusim All'llahun që ta ruajë njerëzimin nga e liga e atyre që pretendojnë këtë lloj qytetërimi.

Vlen të përmendet se fraza e ajetit: **“derisa ato dëshirojnë të jenë të pastra”**, nuk është në kuptimin: nëse ato e duan imoralitetin; s’ka ndonjë ndalesë që ato të detyrohen, por është në kuptimin e mohimit të problemit në mënyrë të plotë, sikur ky problem të mos ekzistojë. Në të vërtetë, çështja e imponimit të atyre femrave për të ushtruar prostitucion me qëllim përfitimi, vërtetohet në gjendjen kur ato s’kanë rrugë tjetër, përveçse t’i binden atij imponimi. Në këndvështrimin e Islamit, shitja e trupit të femrës dhe përhapja e imoralitetit në çdo formë të tij, është padyshim prej mëkateve të mëdha.

Kjo frazë e ajetit ka ardhur për të ngacmuar xhelozinë e atyre pronarëve të robërshave, nëse me të vërtetë ata kanë sado pak prej saj. Në tërësinë e kuptimit të saj, kjo frazë e ajetit do të thotë: nëse robërshat, edhe pse janë shtresa më e ulët, nuk dëshirojnë të prostitutojnë, atëherë përse ju i detyroni ato të praktikojnë këto punë kaq të ulëta, në një kohë kur e mbani veten për shtresë të lartë?

Si mbyllje, sipas metodës që ndjek Kur’ani, në fundin e këtij ajeti hapet rruga e pendimit për fajtorët, të cilët nxiten të përmirësohen: **“dhe, kush i detyron ato me dhunë (të prostitutojnë), All'llahu i fal ato pas atij detyrimi; All'llahu fal shumë, Ai është Mëshirëploti.”**.

Kjo fjali, ashtu siç thamë, mund të jetë një shenjë që tregon se pronarët që i impononin robërshat të prostitucionin, janë

penduar për veprimin e tyre dhe janë të përgatitur të bëjnë teube e të përmirësojnë vetveten.

Ose kjo fjali e ajetit mund të jetë një shenjë që tregon se robërshat e praktikojnë këtë punë kaq të keqe, të imponuara prej pronarëve të tyre.

Gjithnjë në vazhden e programit të Kur'anit, shohim se ajeti i fundit prej ajeteve që janë objekt studimi, jep rezultatet e problemit të shtruar në mënyrë të përmbledhur, duke e shtrirë vështirimin edhe në hulumtimet e mësipërme dhe njofton: **“Ne kemi zbritur për ju argumente të qarta”**; gjithashtu, për ju Ne kemi zbritur edhe mësimet të nxjerra nga pësimet e popujve të kaluar, si këshillë për ju, që të përfitoni prej tyre në ditët e sotme. Ajeti përfundon me frazën: **“dhe shembuj prej atyre që ishin para jush, si dhe këshillë për të ruajturit.”**.

Hulumtime

1- Martesa është rrugë hyjnore

Edhe në ditët e sotme, martesat vazhdojnë të lidhen sipas traditave shoqërore të ardhura prej zakoneve të gabuara dhe ndonjëherë edhe mitike. Veç kësaj, duhet theksuar se martesa sot është bërë një problem aq i vështirë, saqë i riu e ka të pamundur të gjejë mjetet e duhura për ta realizuar atë. Po t'i heqim këto pengesa, do të kuptojmë se martesa konsiderohet një veprim që e

ka zanafillën me krijimin e njeriut dhe është në harmoni me ligjin e krijimit. Nga ky këndvështrim, martesë është domosdoshmëri që mundëson vazhdimësinë e njerëzimit, është qetësim për shpirtin e njeriut dhe pushim për trupin e tij. Njëkohësisht, me martesën zgjidhen problemet shpirtërore dhe shoqërore, prandaj Islami ecën në harmoni të plotë me krijimin, madje ai ka shprehje e fraza shumë të bukura dhe mbresëlënëse që flasin për rëndësinë e madhe të martesës. Nga tërësia e këtyre shprehjeve është edhe hadithi mjaft i njohur, i ardhur prej të Dërguarit më të madh (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), në të cilin ai i urdhëron myslimanët me këto fjalë: “Martohuni, lini pasardhës dhe shtohuni, sepse në Ditën e Gjykimit unë do të mburrem para popujve të tjerë me numrin tuaj të madh, qoftë edhe me fëmijët e dështuar.”¹

Në një hadith tjetër, i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thotë: “Ai që martohet, ka plotësuar gjysmën e fesë së tij, prandaj le ta ketë frikë All'llahun për gjysmën tjetër.”²

Shkaku i këtij kujdesi kaq të madh që tregon Islami për martesën, qëndron në faktin se instinktet seksuale janë më të fuqishmet e më të egrat tek njeriu, madje ato janë në konkurrencë me të gjitha instinktet e tjera, prandaj devijimi i tyre nga rruga e drejtë e vë fenë e njeriut para rrezikut. Për të gjitha këto, hadithi tjetër profetik thotë: “Më të këqinjët nga ju janë beqarët.”³

¹ “Sefijnetul Bihàri”, vëll. 1, f. 561, lënda: “Martesa”.

² Burimi i mësipërm.

³ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 7, f. 104, fundi i ajetit që është objekt studimi.

Ky është edhe shkaku se pse ajetet që janë objekt i studimit tonë, nxisin për martesë, pa përmendur këtu hadithet e shumta që qarkullojnë në mesin e myslimanëve dhe që bëjnë thirrje për bashkëpunim të ndërsjellë për të martuar beqarët dhe për të dhënë ndihma për këtë qëllim, secili sipas mundësisë.

Feja islame i ngarkon prindërit me përgjegjësi të shumta ndaj fëmijëve të tyre. Prindërit që tregohen të pakujdesshëm ndaj martesës së fëmijëve të vet, në të vërtetë janë bërë pjesëmarrës në devijimin e tyre nga rruga e drejtë, ashtu siç e lexojmë në një hadith të ardhur prej të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ku thuhet: “Ai që ka një djalë në moshën e martesës, ka edhe mundësi ta martojë dhe nuk e bën këtë gjë, nëse ndodh diçka, mëkati për atë punë do të rëndojë mbi të dy.”¹

Për të njëjtin shkak, mësimet islame e theksojnë me të madhe çështjen e martesës me sa më pak shpenzime dhe me *mehër* (shuma që i paguan burri gruas kur vihet kurora) sa më të vogël, me qëllim që para beqarëve të shemben të gjitha pengesat e ngritura në rrugën e martesës së tyre. Në një hadith të ardhur prej të Dërguarit më të nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thuhet: “Prej fatkeqësive që vijnë nga gruaja është shuma e lartë e kurorës (*mehri*).”²

¹ Burimi i mësipërm.

² “Vesàilush Shija”, vëll. 15, f. 10, kapitulli nr. 9, prej kapitujve të shumës së kurorës (*mehrit*).

Në një hadith tjetër, që vjen në ndjekje të hadithit të parë, lexojmë: *“Prej fatkeqësive që vijnë prej asaj (gruas) janë shpenzimet e shumta për të.”*¹

Ajeti që trajtuam tregon se varfëria s’ka mundësi të bëhet pengesë për martesën, sepse All’llahu do t’i pasurojë edhe të varfrit me martesën.

Duke u bazuar mbi këtë, ajeti gjykon dhe dënon të gjithë ata që i largohen martesës me argumentin se janë të varfër dhe nuk e marrin përsipër përgjegjësinë hyjnore e njerëzore të saj për shkak të justifikimeve të kota.

Shkaku që theksohet kaq shumë rëndësia e martesës është se burri, pasi martohet, ndjen se ka një përgjegjësi në jetë dhe kështu, ai e shton fuqinë e tij për të fituar pasuri me rrugë të lejuara (*hallall*). Në ditët e sotme, ne shohim në shumë raste se beqarët janë kthyer në endacakë, për shkak se kanë frikë të marrin përgjegjësitë që vijnë prej martesës, ndërsa burri i martuar fiton një personalitet shoqëror. Ky i fundit, në martesë ndjen përgjegjësinë e ruajtjes së gruas së tij, të nderit të familjes, ndërtimit të një jete të lumtur dhe të një të ardhmeje më të bukur për familjen e vet. Kështu, burri i martuar i shfrytëzon të gjitha fuqitë e tij për të siguruar të ardhura që mund të merren në konsideratë; ai bën ekonomi në shpenzime, me qëllim që ta mposhtë varfërinë sa më shpejt që të jetë e mundur. Pikërisht për të gjitha këto, Imam Sadiku ka thënë: *“Furnizimi vjen së bashku me gratë e me njerëzit e familjes.”*²

¹ Burimi i mësipërm.

² Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 595.

Në një hadith të ardhur prej të Dërguarit më të nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tregohet se si i është përgjigjur ai, një burri që iu ankua për varfërinë e tij; I Dërguari i All'llahut i tha vetëm një fjalë: "*Martohu!*" Burri u martua dhe më pas e pa veten në gjendje të mirë.¹

Furnizimet hyjnore dhe fuqitë shpirtërore të padukshme e ndihmojnë të martuarin që ta ruajë pastërtinë e vetes dhe të familjes së tij; prandaj, çdo besimtar ka detyrë të jetë plotësisht i sigurtë në premtimin e All'llahut, ashtu siç ka thënë i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): "*Ai që heq dorë prej martesës nga frika e varfërisë, ka mendim të keq për All'llahun, të Gjithëfuqishmin, i Cili thotë: "...nëse ata janë të varfër, All'llahu i begaton me mirësitë e Tij..."*"²

Ka edhe shumë hadithe të tjera që flasin për çështjen e martesës, por po t'i trajtonim të gjitha, do të dilnim jashtë sferës së këtij tefsiri.

2- Qëllimi me frazën e ajetit: "*...robërit e robëreshat tua që janë të ndershëm e të ndershme...*"

Në ajetet që janë objekt studimi, të tërheq vëmendjen fakti se kur ato flasin për martesën e meshkujve dhe të femrave, urdhërojnë për martesë të shpejtë dhe mosmarrjen parasysh të pengesave, kurse për martesën e robërve dhe të robëreshave, kërkohet plotësimi i kushtit të përmirësimit të tyre.

¹ "*Vesailush Shija*", vëll. 14, f. 25, kapitulli nr. 11, prej kapitujve "*Veprimet paraprake të martesës*".

² Burimi i mësipërm, f. 24, prej kapitujve "*Veprimet paraprake të martesës*".

Disa interpretues të Kur'anit Famëlartë, ndër të cilët edhe dijetari poliedrik, autori i tefsirit "El Mizàn", gjithashtu edhe i tefsirit "Es Sàfi", janë shprehur se qëllimi i ajetit me fjalën "*pastërtinë*", është për ruajtjen e nderit; domethënë ata duhet të jenë të vetëdijshtë për detyrimet që sjell martesë. Ky kusht duhet të plotësohet patjetër edhe për gratë e burrat e lirë.

Interpretues të tjerë kanë thënë se me fjalën "*pastërtinë*", qëllimi është për pastërtinë e tyre nga ana morale dhe për pastërtinë e besimit, sepse njerëzit e mirë kanë një status të veçantë nga pikëpamja e nderit dhe e pastërtisë. Megjithatë, pyetja mbetet ende e shtruar: Përse ky kusht nuk është përmendur në ajet edhe për njerëzit e lirë?

Qëllimi i ajetit mund të ketë lidhje me faktin se shumica e robërve në atë kohë kishin një nivel kulturor e moral shumë të ulët; ata nuk kishin asnjë përgjegjësi dhe nuk i merrnin në konsideratë ndjenjat e jetës së përbashkët. Nëse ata do të martoheshin, me siguri që do t'i linin gratë e veta me shumë lehtësi; prandaj, në një gjendje të tillë, ajeti e bëri detyrim pastrimin e përmirësimit të robërve e të robërshave, derisa të ishin të gatshëm për martesë dhe të kishin arritur në atë nivel, që mund të kuptonin e të mbanin përgjegjësitë e tyre pas martesës.

3- Si bëhet lirimi i robit me marrëveshje kundrejt kompensimit?

Më sipër thamë se Islami vuri një program të shkallëzuar për lirimin e robërve nga robëria dhe urdhëroi shfrytëzimin e rasteve të përshtatshme që e mundësonin këtë gjë. Në të vërtetë,

çështja e lirit të robërve me marrëveshje kundrejt kompensimit, është një dispozitë që duhet ndjekur, ashtu siç ka ardhur tekstualisht në ajetet që janë objekt studimi.

Fjala e ajetit "*mukàtebeh*" në rrënjën e saj, është në kuptimin e numrit shumës, domethënë: nga bashkimi i shkronjave del fjala dhe, meqenëse marrëveshja në mes pronarit dhe robit bëhet duke e shkruar marrëveshjen që përputhet me qëllimin, ky qëllim në tekstin e ajetit ka ardhur me fjalën "*mukàtebeh*", pra marrëveshje e lidhur ndërmjet pronarit e robit, me qëllim që ky i fundit të fitojë lirinë. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, rob ka detyrim të përgatisë një shumë parash të siguruara nga puna e tij e lirë dhe atë ta shlyejë me këste. Vetëm pasi ta ketë shlyer edhe këstin e fundit të shumës, ai kërkon prej pronarit dëshminë që vërteton lirinë e tij.

Islami ka urdhëruar që këto këste të mos jenë më të larta se vlera e vetë robit.

Kur rob për ndonjë shkak s'ka mundësi t'i paguajë të gjitha këstet, sipas premtimit të shkruar në marrëveshjen e lidhur me pronarin e tij, atëherë bëhet detyrim që pjesa e mbetur të paguhet prej "Shtëpisë së Pasurisë", ose prej zekatit që do të japë pronari i robit. Disa prej *fukahave* (juristëve të ligjit të fesë islame) janë shprehur qartë, duke thënë: kur pronari ka detyrim të japë zekat, ai duhet t'i llogarisë këto këste në zekatin e tij, për shkak se marrëveshja për lirinë e robit kundrejt kompensimit, është detyrim të zbatohet dhe asnjëra palë s'ka mundësi ta prishë atë.

Me këtë shpjegohet qartë se çështja e lirit të robërve zgjidhet me lehtësi dhe kjo rrugë mundësonte që edhe robërit të jetonin si njerëz të lirë e të pavarur, derisa të shlyenin të gjitha

këstet. Pronarët e robërve nuk mund t'i dëmtonin ata për shkak të pamundësisë për të shlyer këstet; gjithashtu, pronarët s'kishin të drejtë të mundonin e të fyenin robërit që kishin në pronësi.

Marrëveshja për lirimin e robit kundrejt pagesës, ka dispozita e degë të shumta që përmenden në librat e *fikhut* në kapitullin: *Lirimi i robit me marrëveshje kundrejt kompensimit*.

Ajetet 35 - 38

[illegible]

Komentimi

Ajeti i dritës

Filozofët, interpretuesit e Kur'anit Famëlartë dhe tradicionalistët islamë, kanë thënë shumë fjalë në lidhje me qëllimin e ajeteve që janë objekt studimi. Në fakt, edhe këto ajete janë të lidhura me ajetet e mëparshme, në të cilat u shpalos çështja e ruajtjes së nderit dhe e luftimit të prostitucionit me të gjitha rrugët.

Meqenëse garancia për zbatimin e dispozitave hyjnore, qëndron në faktin se mposhtja e instinkteve shpërthyesë dhe, në mënyrë të veçantë, mposhtja e instinkteve seksuale si më të fuqishmet tek njeriu, realizohet vetëm duke u mbështetur në besim, edhe studimi jonë është mbështetur mbi të dhe mbi ndikimin e tij të fuqishëm.

Ajeti i parë i grupit të ajeteve që janë objekt studimi, njofton: **“All'Ilahu është dritë** (udhëzues) **e qiejve dhe e tokës.”**

Sa fjali e bukur dhe e ëmbël! Sa fjalë të çmuara! All'Ilahu është Drita udhëzuese e qiejve dhe e tokës, është Drita që mbulon e ndriçon të gjitha sendet.

Disa interpretues të Kur'anit mendojnë se fjala *“en'nùru”* – **“dritë”** në këtë ajet ka kuptimin *“Udhëzuesi”*; disa të tjerë

mendojnë se ka kuptimin “Ndriçuesi” dhe një grup tjetër e kanë interpretuar në kuptimin “Hijeshia e qiejve dhe e tokës”.

Të gjitha këto interpretime janë të vërteta, por duhet theksuar se kuptimi i kësaj fraze të ajetit ka dimensione shumë më të gjera. Në Kur’anin Famëlartë dhe në hadithet islame, fjala “dritë” ka ardhur me disa kuptime, prej të cilave përmendim:

1- Kur’ani Famëlartë e ka përmendur fjalën “dritë” në kuptimin e dritës, në ajetin 15, të sures “El Màide”: **“prej All'Ilahut erdhi te ju dritë dhe një libër i qartë.”**.

Gjithashtu, fjala e ajetit “**dritë**” në kuptimin *dritë*, ka ardhur edhe në ajetin 157 të sures “El Arâf”: **“dhe vepruan me dritën që u zbriti së bashku me atë; ata janë të shpëtuarit.”**.

2- Fjala “**dritë**” e ajetit është komentuar edhe me besimin, ashtu siç përmendet në ajetin 257 të sures “El Bekare”: **“All'Ilahu është Mbikëqyrësi i atyre që besuan, ai (besimi) i nxjerr ata prej errësirave në dritë.”**.

3- Fjala “**dritë**” e ajetit është komentuar me udhëzimin hyjnor, ashtu siç ka ardhur në ajetin 122 të sures “El En’âm”: **“Vallë, ai që ishte i vdekur dhe Ne e ngjallëm e i dhamë dritë, me të cilën ai ecën mes njerëzve, a është i ngjashëm me atë që ka mbetur në errësira dhe nuk del nga ato?”**.

4- Fjala “**dritë**” e ajetit është komentuar me fenë islame, ashtu siç e lexojmë në ajetin 32 të sures “Et Teube”: **“dhe All'Ilahu nuk do tjetër, veçse të plotësojë dritën e Tij edhe pse jobesimtarët e urrejnë këtë.”**.

5- Fjala “**dritë**” e ajetit është interpretuar me Profetin më të nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ashtu siç e lexojmë në ajetin 34 të sures “El Ahzàb”, ku thuhet se ai është: “**thirrës për në rrugën e Tij dhe pishtar ndriçues.**”.

6- Fjala “**dritë**” e ajetit është interpretuar me dijen dhe njohjen, ashtu siç ka ardhur në hadithin mjaft të përhapur: “*Dituria është dritë, të cilën All'lahu e ndez në zemrën e atij që Ai do.*”¹

Të gjitha këto janë një pjesë e kuptimit të fjalës “dritë”. Është detyra jonë të shikojmë në hollësitë, në veçoritë dhe në peshoren e dritës, që të bëhet e qartë se ajo dallohet për veçoritë e mëposhtme:

1- Drita është gjëja më e bukur dhe më e dashur në këtë botë; ajo është burimi i çdo bukurie e dashamirësie.

2- Drita është gjëja më e shpejtë, ashtu siç kanë vërtetuar shkencëtarët më në zë të botës, sipas të cilëve, shpejtësia e saj është 300000km/sek. Me këtë shpejtësi, rrezja e dritës i vjen rrotull globit tokësor shtatë herë në më pak se një sekond, ose siç thuhet në gjuhën e zakonshme, sa një lëvizje e syrit.

Shpejtësia e dritës është njësia matëse me të cilën maten distancat shumë të largëtan dermjet yjeve. Si njësi matëse për matjen e distancave ndërmjet yjeve, ose ndërmjet yjeve dhe tokës përdoret shprehja “vit drite”, domethënë distanca që përshkon drita gjatë një viti.

¹ “Misbàhush Sherij’ati”, f. 16.

3- Në saje të dritës mund të shihen sendet në këtë botë, pra pa të nuk do të shihej asgjë. Drita në vetvete është e dukshme dhe ndriçon sendet e tjera.

4- Drita e diellit renditet në llojet më të rëndësishme të dritës në botën tonë. Ajo i rrit lulet e bimët. Me dritën e diellit vazhdon jeta. Ajo simbolizon ekzistencën e qenieve të gjalla në globin tonë. Pa të, asnjë qenie nuk mund të jetojë.

5- Sot është vërtetuar se në dritën e diellit ose edhe në dritat e tjera, mund të shihen të gjitha ngjyrat. Po të mos ishte drita, të gjitha krijesat do të jetonin në errësirë të plotë.

6- Dielli është burimi i të gjitha llojeve të energjive që ekzistojnë (përveç energjisë bërthamore): energjia që përfitohet nga lëvizja e erërave, nga uji i lumenjve, nga rënia e ujit në katarakte etj. Po të shihnim te të gjitha krijesat e gjalla, do të gjenim se ato kanë lidhje me dritën e diellit.

Dielli është burimi i nxehtësisë që ngroh të gjitha krijesat e gjalla, madje edhe e nxehtësisë së zjarrit që përfitohet prej drurit, ose prej qymyrit të drurit, ose prej qymyrgurit, ose prej naftës dhe nënprodukteve të saj. Sipas hulumtimeve shkencore, të gjitha burimet e nxehtësisë që u përmendën, e kanë origjinën ose te bimët ose te gjallesat, të cilat kanë përfituar prej dritës së diellit e prej nxehtësisë së tij dhe e kanë depozituar atë në trupat e vet. Për rrjedhojë, edhe lëvizja e motorëve dhe e makinave është prej begative të dritës së diellit.

7- Drita e diellit vret mikrobet e viruset e dëmshme. Nëse nuk do të ishte drita e diellit, toka do të shndërrohej në një spital të madh; banorët e saj do të sprovoheshin me lloje sëmundjesh të

ndryshme dhe, në mënyrë të pashmangshme, do të shkonin drejt vdekjes nga njëri çast në tjetrin.

Sa më shumë që të shikojmë në imtësitë e botës së dritës si një dukuri unike, aq më shumë bëhet i qartë për ne ndikimi i rëndësishëm i saj dhe begatitë e mëdha që vijnë prej saj.

Duke hedhur një vështrim mbi këto dy parathënie, kur duam të bëjmë një përngjasim me Qenien e Shenjtë të Zotit të botëve (megjithëse pozita e Tij e madhe dhe e lartë nuk ka të ngjashme e as të njëjtë), ne nuk do të gjenim asnjë shprehje më të mirë e më të përshtatshme sesa fjala “*dritë*”. All'llahu i Lartësuar i krijoi të gjitha sendet në botën e ekzistencës dhe e ndriçoi këtë botë. Me mirësitë e Tij, Ai u dha jetë krijesave të gjalla; me mirësinë e Tij, Ai i furnizon ato me ushqim dhe, sikur vetëm për një çast të ndërpritej mëshira e Tij për to, të gjitha sa janë do të ishin në errësirë dhe do të asgjësoheshin.

Të tërheq vëmendjen fakti se çdo krijesë është e lidhur me All'llahun me një masë të caktuar dhe përfiton prej dritës me të njëjtën masë.

Kur'ani është dritë, sepse është fjala e All'llahut.

Feja islame është dritë, sepse është feja e All'llahut.

Profetët janë drita, sepse ata janë të dërguarit e All'llahut.

Besimi (*imani*) është dritë, sepse është simboli i lidhjes së ngushtë me të Gjithëpushtetshmin.

Dituria është dritë, sepse ajo është rruga për njohjen e të Gjithëfuqishmit.

Për të gjitha këto Kur'ani thotë: **“All'Ilahu është dritë (udhëzues) e qiejve dhe tokës.”**.

Kur e përdorim fjalë “dritë” në kuptimin e saj të gjerë, do të thotë se Zoti është i dukshëm në Qenien e Tij dhe i dukshëm për të tjerët. Kështu, përdorimi i fjalës “dritë” për Qenien e Shenjtë bëhet një e vërtetë, në të cilën nuk ka më asnjë dyshim, sepse asgjë në botë nuk është më e dukshme se All'Ilahu i Lartësuar, dhe të gjitha sendet duken vetëm në saje të mirësisë së ekzistencës së Tij.

Në librin *“Et Teuhid”* citohet Imami Ali bin Mùsà Err Rridà, i cili kur është pyetur për kuptimin e fjalës së të Lartit: **“All'Ilahu është dritë (udhëzues) e qiejve dhe tokës”**, ka thënë: *“Udhëzues për banorët e qiejve dhe të tokës.”*.

Në fakt, kjo është vetëm njëra prej veçorive të dritës hyjnore, sepse drita e Zotit nuk mund të reduktohet vetëm në një të tillë. Megjithatë, të gjitha fjalët që janë thënë në lidhje me interpretimin e këtij ajeti mund të përmbliidhen në një frazë të vetme: ato tregojnë vetëm njërin prej dimensioneve të kësaj Drite, për të Cilin s'ka të ngjashëm.

Vlen të përmendet edhe përmbajtja e ardhur në paragrafin e dyzet e shtatë prej lutjes së emërtuar: *“El Xheushenul Kebijr”* (Mburoja e Madhe), që përshkruan cilësitë e larta të All'Ilahut me këto fraza: *“O Dritë e dritave! O Ndriçues i dritës! O Krijues i dritës! O Sistemues i dritës! O Përcaktues i dritës! O Dritë e çdo drite! O Dritë para çdo drite! O Dritë pas çdo drite! O Dritë mbi çdo dritë! O Dritë që s'ka të ngjashme si Ty!”*

Të gjitha dritat e ekzistencës e marrin dritën e tyre prej dritës së Tij dhe përfundojnë tek ajo.

Kur'ani Famëlartë e ka bërë të qartë këtë fakt, pas shpjegimit të të vërtetave të mësipërme, kur përshkruan dritën hyjnore me një shembull të mrekullueshëm dhe tepër të hollësishëm: **“Shembulli i dritës së Tij ngjason me një llambë të vendosur në një zgavër të errët; llamba gjendet brenda një qelqi si të ishte yll vezullues e që ndizet prej (vajit të) një peme të bekuar, prej ullirit, që nuk është as i lindjes e as i perëndimit; vaji i tij ndriçon pothuaj edhe pa e prekur zjarri; dritë mbi dritë; All'illahu udhëzon kah drita e Vet atë që do; All'illahu sjell shembuj për njerëzit; All'illahu ka dijeni të plotë për të gjitha sendet.”.**

Për të shpjeguar këtë shembull, duhet të trajtojmë kuptimin e disa fjalëve të ajetit të nderuar:

Fjala *“el mishkât”* – **“zgavër”** në rrënjën e saj do të thotë: e hapura e bërë në murin e shtëpisë, për të vënë llambën me vaj, me qëllim që ajo të mos fiket prej erës; ose ndodh që në murin e shtëpisë të lihet një e hapur e vogël dhe në anën e përparme të kësaj të hapure, që bie nga brenda dhomës, vihet një xham, me qëllim që dhoma të ndriçohet nga jashtë e nga brenda, si dhe për ta ruajtur llambën prej erërave. Gjithashtu, kjo fjalë përdoret edhe për ndriçuesit e hershëm, të punuar prej qelqi, në formën e një prizmi me bazë drejtkëndëshi dhe nga sipër i hapur, me qëllim që të dalë ajri i nxehtë dhe brenda këtij *“abazhuri”* vihej llamba.

Thënë ndryshe, fjala *“el mishkât”* – **“zgavra”** është vendi ku futet llamba që të mos e fikë era dhe ajo bëhet zakonisht në murin e dhomës, me qëllim për të përqendruar ndriçimin dhe reflektimin e dritës.

Fjala e ajetit “*ez'zuxhàxheh*” – “**xham**” në rrënjën e saj përdoret për gurët transparentë, por edhe për të emërtuar fletët e tejdukshme të xhamave, sepse ato punohen prej lëndëve metalike. Kurse në këtë ajet, kjo fjalë ka kuptimin e xhamit që vihet mbi llambë për të ruajtur ndriçimin, për ta rritur atë dhe për të sistemuar hyrjen e daljen e ajrit.

Fjala “*el misbàh*” – “**llamba**” e përmendur në këtë ajet, është përdorur në kuptimin e enës, në të cilën futej vaji dhe fitili që ndizet.

Fraza e ajetit: “**që ndizet prej (vajit të) një peme të bekuar, prej ullirit, që nuk është as i lindjes e as i perëndimit**”, tregon për energjinë që prodhon kjo llambë me atë lëndë djegëse që nuk mbarohet kurrë dhe vaji i ullirit është prej lëndëve djegëse më të mira, që përdoren tek llambat. Gjithashtu, ajeti njofton se ky vaj përftohet prej frutit të pemës së ullirit, e cila është e ekspozuar ndaj diellit nga të gjitha anët në mënyrë të barabartë, pra pema nuk është në anën lindore të kopshtit anës murit, i cili pengon arritjen e rrezeve të diellit tek ajo; gjithashtu, kjo pemë nuk është as në anën perëndimore, nga ku rrezet e diellit do të binin vetëm nga njëra anë e saj dhe për rrjedhojë, frutat e ullirit nuk do të piqeshin mirë dhe, natyrisht, që as vaji që do të merrej prej një ulliri të tillë, nuk do të ishte i kulluar.

Pas këtij shpjegimi, për ne bëhet e qartë se që të ndriçojë llamba në mënyrë të mjaftueshme, ka nevojë për katër gjëra:

“Ruajtësi i dritës së llambës” të jetë i atillë, që të mos e pakësojë dritën që jep ajo, por ta përqendrojë dhe ta reflektojë atë, kurse xhami që mbulon llambën e sistemon rrymën e ajrit rreth fitilit të

ndezur; prandaj mbulesa e llambës duhet të jetë e tejdukshme, që të mos e pengojë dritën të ndriçojë. “Llamba” është burimi i dritës.

E fundit nga katër gjërat mbetet “lënda djegëse” e pastër, e tejdukshme dhe e gatshme për të marrë flakë. Kjo lëndë djegëse është aq e pastër saqë në të pasqyrohet fytyra e njeriut, madje ajo ndriçon vetvetiu, pa rënë mbi atë asnjë ndezës, apo një thëngjill i ndezur.

Të gjitha këto fraza zbulojnë të vërtetën e anës së jashtme të problemit. Nga ana tjetër, interpretuesit më në zë të Kur'anit kanë bërë shumë komente në lidhje me këtë përngjasim dhe kanë thënë se është për çdo dritë hyjnore që të jetë.

Disa interpretues të tjerë të Kur'anit kanë thënë se qëllimi me fjalën “dritë” në këtë ajet, është udhëzimi në rrugën e drejtë që vë All'llahu në zemrat e besimtarëve, ose thënë ndryshe, besimi që ka zënë vend mirë në zemrat e tyre.

Disa të tjerë kanë thënë: I ngjashmi me dritën këtu, është në kuptimin e Kur'anit, i cili ndriçon zemrat e njerëzve.

Të tjerë kanë thënë: Fjala “dritë” në këtë ajet tregon Profetin më të nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Disa të tjerë kanë thënë se është një shenjë për argumentet e Njësimit (besimit se All'llahu është Zoti Një dhe i Vetëm) dhe për drejtësinë hyjnore.

Të tjerë kanë thënë se kjo fjalë është fryma e bindjes dhe e devotshmërisë, që janë bazë e çdo të mire dhe lumturie.

Të gjitha këto interpretime kanë sjellë gjithçka që ka ardhur në Kur'an dhe në hadithet islame me titullin: "Vërtetuesit e dritës". Gjithsesi, esenca e dritës është vetëm një; ajo është vetë drita hyjnore. Burimi i kësaj drite është Kur'ani, Shpallja dhe ardhja e Profetëve. Të gjitha këto burojnë prej argumenteve të Njësimit dhe janë rezultat i dorëzimit para gjykimit të All'llahut, si dhe kapjes fort pas devotshmërisë.

Shpjegimi më i qartë për këtë është se drita e besimit, që gjendet në zemrat e besimtarëve, përmban katër elementët e domosdoshëm që e bëjnë llambën të ndriçojë:

a) "*el misbàhu*" - "**llamba**" është rrezja e besimit në zemrën e besimtarit dhe rruga e udhëzimit.

b) "*ez'zuxhàxheh*" - "**xhami**" është zemra e besimtarit që sistemon vetë besimin dhe e ruan besimtarin nga çdo e keqe.

c) "*el mishkàt*" - "**zgavra**" është zemra e besimtarit; me fjalë të tjera, personaliteti i besimtarit, ndërgjegjja e tij, dituria e tij dhe mendimi që e ruan besimin e tij prej fortunave të fajeve dhe gabimeve.

d) "*shexheretin mubàreketin zejtùnetin*"- "**druri i bekuar i ullirit**" është shpallja hyjnore, e cila padyshim është në kufirin më të lartë të qartësisë e të pastërtisë. Kjo shpallje ndez dritën e besimit në zemrat e besimtarëve dhe kjo dritë është prej dritës së All'llahut, e cila ndriçon qiejt e tokën; kjo dritë lind në zemrat e besimtarëve dhe ndriçon trupat e fytyrat e tyre.

Argumentet e shumta logjike në lidhje me dritën e shpalljes janë kriteri për të vërtetuar frazën e ajetit: **“dritë mbi dritë”**.

Zemrat e gatshme për të pritur dritën e All'Ilahut janë të qeta. Është pikërisht ky, qëllimi me frazën e ajetit: **“All'Ilahu udhëzon kah drita e Vet atë që do.”**. Bazuar mbi këtë fjalë të ajetit, ruajtja e dritës së All'Ilahut (e udhëzimit në rrugën e drejtë dhe në besim), kërkon njohuri, dituri, ndërgjegjësim, moral, ndërtim të vetvetes dhe, të gjitha këto, për të qenë si ajo *“zgavra”* ku ruhet kjo llambë.

Për të rregulluar këtë dritë hyjnore, ashtu siç e rregullon xhami dritën e llambës, lind nevoja për një zemër të përgatitur.

Njëkohësisht, edhe furnizimi hyjnor duhet të jetë i vazhdueshëm që t'u japë zemrave energjinë, ashtu siç i jep energji llambës vaji që nxirret nga pema e ullirit, të cilën Kur'ani e ka emërtuar me frazën: **“një pemë e bekuar, ulliri”**.

Është detyrim që drita hyjnore të ruhet prej njollosjeve e prirjeve materialiste dhe nga devijimi në drejtim të lindjes, ose nga devijimi në drejtim të perëndimit, pasi ky devijim çon në shkatërrim dhe asgjësim.

Për të mobilizuar fuqitë e njeriut në mënyrën më të drejtë dhe që njeriu të qëndrojë larg prej çdo mendimi të importuar e të devijuar, ajeti thotë: **“vaji i tij ndriçon pothuaj edhe pa e prekur zjarri.”**.

Çdo interpretim që përmban një dispozitë me prirje të njëanshme, ose mendimin dhe besimin personal të interpretuesit, ose që në të shprehen rryma majtiste, ose djathtiste, ose mite, çon

në njollosjen e kësaj peme të bekuar dhe e pakëson fuqinë ndriçuese të llambës, madje nganjëherë e shuan krejt atë.

Ky ishte ai shembulli që përmend All'llahu për dritën e Tij në këtë ajet, sepse vetëm Ai ka dijeni të plotë për të gjitha sendet.

Nga sa u tha më lart, për ne bëhen të qarta thëniet që kanë ardhur në transmetimet e Imamëve të ruajtur prej mëkateve, në lidhje me interpretimin e këtij ajeti. Ata kanë thënë se “zgavra” është zemra e Profetit të Islamit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), “llamba” është drita e diturisë, “xhami” është i porositori i tij Aliu dhe “pema e bekuar” është miku i All'llahut, hazreti Ibrahim (i) (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*); prej pasardhësve të Ibrahimit kanë ardhur Profetët. Kurse fraza e ajetit: “**as i lindjes e as i perëndimit**”, ka kuptimin: çdo prirje nga jehuditë e nga kristianët. Kjo frazë është një anë tjetër e dritës së udhëzimit në rrugën e drejtë dhe të besimit, është një kriter shumë i qartë, por në asnjë mënyrë nuk do të thotë se ky ajet është i veçantë vetëm për këtë kriter.

Disa interpretues të Kur'anit janë shprehur se drita hyjnore është Kur'ani, ose argumentet logjike, ose vetë Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), por edhe ky interpretim ka rrënjë të përbashkëta me interpretimin e mësipërm.

Deri tani kemi përmendur veçoritë e dritës hyjnore dhe të besimit nëpërmjet përngjasimit me një llambë me fuqi të madhe ndriçuese.

Dhe tani është detyrë të dimë se ku është vënë kjo llambë dhe ç'formë ka vendi i saj. Në fillim duhet bërë e qartë, ashtu siç njofton ajeti vijues, se drita në atë zgavër ndodhet: “(ajo dritë)

është në ato shtëpi (xhamitë) në të cilat All'llahu lejoi të lartësohet" dhe, që ato shtëpi të ishin të siguruara prej djajve, armiqve dhe oportunistëve, ajeti njofton: **"në ato përmendet emri i Tij"**, që në to këndohet Kur'an dhe flitet për të vërtetat hyjnore.

Disa interpretues të Kur'anit, këtë ajet e konsiderojnë të lidhur me atë që është para tij.¹ Disa të tjerë mendojnë se kjo frazë e ajetit që është objekt studimi, lidhet me frazën vijuese të tij, por duhet theksuar se ky interpretim është shumë larg saktësisë.

Për sa u përket pyetjeve që kanë bërë disa në lidhje me ndikimin e kësaj drite mahnitëse në shtëpitë e lartpërmendura, përgjigjja është e qartë: në shtëpitë e përmendura në këtë ajet, bëjnë rojë burra të fuqishëm e vigjilentë, të cilët i ruajnë këto llamba ndriçuese; ata burra bëjnë hulumtime rreth burimit të dritës dhe, pasi janë njohur me vendin ku ndodhet ajo, shkojnë me vrap drejt saj.

Por, cili është qëllimi me këto shtëpi?

Përgjigjja jepet në frazën e fundit të ajetit, kur përmenden veçoritë e punës që bëjnë ata burra në ato shtëpi. Ajeti njofton se

¹ Vlerësimi mund të jetë: *"kjo zgavër është në shtëpitë... ose: kjo llambë është në shtëpitë...; kjo pemë është në shtëpitë e dritës së All'llahut"*, mirëpo autorët e interpretimit të dytë mendojnë se fraza **"në shtëpitë"** i referohet fjalës *"juseb'bihu"*, **"dhe t'i bëhen Atij lutje"**; kuptimi i ajetit do të ishte: *"i luten Atij në mëngjes e në mbrëmje"*; por ky interpretim nuk është në përputhje me fjalën e ajetit **"në ato"**, e cila konsiderohet si përsëritje e panevojshme. Përveç kësaj, ky interpretim nuk është në përputhje as me hadithet që kanë ardhur për këtë çështje.

ata i luten të Gjithëpushtetshmit në mëngjes e mbrëmje dhe thotë:
“dhe t’i bëhen Atij lutje mëngjes e mbrëmje.”¹

“Ata janë burra që nuk i pengon as tregtia (udhëtimi i largët për tregti) e as shit-blerja (në vend) që të përmendin All'llahun, të falin namazin dhe të japin zekatin; ata kanë frikë atë Ditë, në të cilën do të tronditen zemrat dhe shikimet.”

Këto veçori tregojnë se ato shtëpi janë të fortifikuara me urdhrin e All'llahut dhe janë qendra ku përmendet Ai; në to shpjegohen të vërtetat e Islamit e mësimet e All'llahut. Në këtë kuptim të gjerë padyshim që përfshihen xhamitë, shtëpitë e profetëve dhe, në mënyrë të veçantë, shtëpia e Profetit tonë (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ashtu siç janë shprehur disa interpretues të Kur'anit, por nuk ka ndonjë argument që të përforcojë reduktimin e kuptimit vetëm në këto vende.

Në një transmetim të ardhur prej Imam Bekirit në lidhje me interpretimin e kësaj fraze të ajetit, lexojmë: *“Janë shtëpitë e profetëve, si dhe shtëpia e Aliut.”*²

¹ Fjala e ajetit *“bilguduv’vi”*, ka kuptimin *“mëngjes”*. Ragib El Esfehànij, në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'anit, e shpjegon kuptimin e kësaj fjale duke thënë se kjo kohë fillon qysh në fillimin e ditës. Përballë kësaj fjale, Kur'ani ka vënë fjalën tjetër: *“uel àsàli”*, që do të thotë *“mbrëmje”*, pra nga mëngjesi deri në mbrëmje. Fjala e ajetit *“uel àsàli”* ka ardhur në numrin shumë për fjalën *“el esijl”*, në kuptimin e kohës për faljen e namazit të mbasdites. Në lidhje me faktin se përse fjala *“bilguduv’vi”* në këtë ajet, ka ardhur në numrin njëjës, kurse fjala *“uel àsàli”* ka ardhur në numrin shumë, Fakhrurr Rràzij thotë: *“Kjo është bërë sepse shumësi i fjalës së parë në gjuhën arabe është rrënjë e fjalës, por ajo nuk vjen në atë numër”*.

² Tefsiri *“Nuruth Thekalejn”*, vëll. 3, f. 607.

Nga një hadith i ardhur prej Profetit më të madh (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), mësojmë se kur e lexoi këtë ajet, u pyet se për cilat shtëpi bëhej fjalë. Ai u përgjigj se bëhej fjalë për shtëpitë e Profetëve. Ndërkaq u ngrit Ebu Bekri dhe tha: “O i Dërguar i All'llahut, kjo shtëpi ku jemi, a është prej tyre?” Ebu Bekri e kishte fjalën për shtëpinë e Aliut e të Fatimes. I Dërguari i All'llahut i tha: “Po, është prej shtëpive më të mira.”¹

Të gjitha këto tregojnë për kriteret e qarta, që zakonisht janë përmendur në hadithet e në transmetimet mbi interpretimet e Kur'anit.

Çdo shtëpi e tillë ndërtohet me urdhër të All'llahut, që aty të përmendet emri i Tij dhe të bëhen lutje drejtuar vetëm Atij nga mëngjesi deri në mbrëmje. Në ato shtëpi ka burra, të cilët nuk i ndalon tregtia nëpër vende të largëta që ata ta përmendin All'llahun; ato janë vende të dritave hyjnore, të besimit dhe të udhëzimit në rrugën e drejtë.

Këto shtëpi kanë disa veçori:

E para: Janë ndërtuar me urdhrin e All'llahut.

E dyta: Muret e tyre janë ngritur dhe ndërtimi është përsosur për të penguar depërtimin e djajve.

E treta: Janë shtëpi në të cilat përmendet All'llahu.

E katërta: Në ato shtëpi ka burra që bëjnë rojë ditë-natë; ata janë burra që i luten vetëm All'llahut dhe madhërojnë vetëm Atë.

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 7, f. 144, fundi i ajetit që është objekt studimi.

Këta burra nuk i ndalojnë punët e kësaj bote në përmendjen e All'Ilahut.

Shtëpitë me këto veçori janë burime të udhëzimit në rrugën e drejtë dhe të besimit (*iman*).

Këtu duhet tërhequr vëmendja në lidhje me dy fjalët e ajetit: *tixhàretun* - "tregti" dhe "bej'un" - "shitblerje". Këto dy fjalë duket se kanë të njëjtin kuptim, por në të vërtetë, midis tyre ka dallim: fjala "tregti" ka kuptimin e punës së vazhdueshme, kurse fjala "shitblerje" tregon një veprim që kryhet vetëm një herë, ose një veprim kalimtar.

Gjithashtu, duhet të tërhiqet vëmendja se ajeti nuk ka thënë: ata burra asnjëherë nuk janë marrë me tregti e me shitblerje, por: **"Ata janë burra që nuk i pengon as tregtia (udhëtimi i largët për tregti) e as shit-blerja (në vend) që të përmendin All'Ilahun."**

Ata janë burra që kanë frikë Ditën e Gjykimit dhe drejtësinë hyjnore, kanë frikë atë Ditë në të cilën do të tronditen zemrat dhe shikimet prej tmerrit dhe ashpërsisë së saj. Folja e kohës së tashme të ardhshme "*jekhàfune*" - "frikësohen", tregon se ata janë vazhdimisht të frikësuar dhe është kjo frikë që i shtyn të mbajnë përgjegjësitë për të plotësuar misionin e tyre në jetë.

Ajeti i fundit i këtij grupi ajetesh thekson shpërblimin e madh që do të kenë ruajtësit e dritës së udhëzimit në rrugën e drejtë dhe të dashuruarit me të Vërtetin. Në ajet thuhet: "(ata luten) **që All'Ilahu t'i shpërblejë me më të mirën për punët që kanë bërë dhe që Ai t'ua shtojë të mirat."**

Këtu s'ka asgjë për t'u çuditur, sepse mirësia hyjnore është me të vërtetë e pakufizuar. Ajeti njofton: **"All'Ilahu e furnizon pa masë atë që do."**

Në lidhje me kuptimin e frazës: **"me më të mirën e punëve që kanë bërë"**, disa interpretues të Kur'anit kanë thënë se ajo tregon të gjitha punët e mira, qofshin ato prej obligimeve (*vaxhib*) ose prej punëve të pëlqyeshme (*mustehab*), qofshin punë të vogla ose të mëdha.

Interpretues të tjerë të Kur'anit mendojnë që kjo frazë e ajetit tregon se All'Ilahu e shpërblen punën e mirë me dhjetë të mira si ajo e disa herë me shtatëqind punë të mira si ajo, ashtu siç thuhet në ajetin 160 të sures "El En'am": **"kush vjen me një të mirë, ai shpërblehet dhjetëfish"**; gjithashtu, në ajetin 261 të sures "El Bekare", në lidhje me shpërblimin për ata që shpenzojnë në rrugën e All'Ilahut, thuhet se do të jetë i barabartë me shtatëqindfish ose edhe më shumë.

Qëllimi me frazën e mësipërme mund të interpretohet edhe kështu: All'Ilahu i shpërblen të gjitha punët e tyre me më të mirën e atyre punëve dhe ndonëse në to përfshihen punët e thjeshta dhe ato mesatare, Ai i ka ngritur të gjitha në nivelin e punëve më të mira kur i shpërblen ata.

Ky shpërblim nuk është larg mëshirës së All'Ilahut dhe mirësisë së Tij. Drejtësia kërkon që shpërblimi të jetë i barabartë me punën e bërë në rrugën e All'Ilahut, por mëshira e All'Ilahut është aq e madhe saqë përfshin të gjitha sendet; Ai dhuron pa masë e pa asnjë kufi, sepse Qenia e Tij e shenjtë është e pakufizuar;

gjithashtu, edhe mirësitë e Tij nuk mbarojnë kurrë, por edhe bujaria e Tij nuk njihet kurrë.

Hulumtime

Gjatë komentimit të këtyre ajeteve kemi shpalosur shumë çështje dhe na kanë mbetur vetëm disa transmetime që duhet të përmenden në këtë studim:

1- Në librin “Reudatul Kâfij” lexojmë një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut, në lidhje me interpretimin e ajetit të dritës. Ai ka thënë: Fjala “*el mishkât*” - “*zgavra*” është zemra e Muhammedit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*); fjala “*el misbâh*” - “*llamba*” është drita në të cilën gjendet dituria; fjala “*ez'zuxhâxheh*” - “*xhami*” është zemra e Aliut ose vetë ai.¹

2- Në një transmetim tjetër në lidhje me interpretimin e fjalës së ajetit “*rixhâlun*” - “*burra*”, thuhet se ata janë mbrojtësit e shpalljes hyjnore e të udhëzimit në rrugën e drejtë, të cilët nuk i pengon as tregtia, as shitblerja e as punët e tjera, që të përmendin All'llahun. Kur hyn koha për faljen e namazit, ata e kryejnë

¹ “Tefsiri “Nuruth Thekalejn” vëll. 3, f. 602-603, fundi i ajetit që është objekt studimi (me pak shkurtime).

menjëherë detyrën, e cila është një e drejtë që i takon vetëm All'lahut.¹

Ata janë burra që kanë si shqetësim kryesor përmendjen e All'lahut dhe para kësaj nuk vënë asgjë, pavarësisht se kanë një aktivitet ekonomik në jetën e tyre.

3- Në ajetet që janë objekt studimi, pema e ullirit është cilësuar si pemë e bekuar. Në kohën kur zbriste Kur'ani, pema e ullirit kishte një rëndësi shumë të madhe, rëndësi që është bërë e qartë në ditët e sotme. Shkencëtarët më në zë, në saje të hulumtimeve e të eksperimenteve që kanë bërë në lidhje me veçoritë e llojeve të bimëve dhe pemës së ullirit në veçanti, kanë thënë se pema e ullirit është me të vërtetë pemë e bekuar. Fruti i saj është shumë dobishjellës; ajo na jep vajin më të mirë, i cili ka një rol jetësor në ruajtjen e shëndetit të trupit.

Ibni Ab'basi ka thënë: *“Të gjitha pjesët e pemës së ullirit janë të dobishme dhe sjellin kënaqësi e dobi, madje edhe prej hirit të drurit të saj ka dobi. Pema e ullirit është pema e parë që mbiu pas tufanit të Nuhut (Paqja e All'lahut qoftë mbi të!); është një pemë për të cilën janë lutur të gjithë Profetët dhe e kanë bekuar atë.”.*

4- Interpretuesit më në zë të Kur'anit kanë bërë disa interpretime në lidhje me frazën e ajetit **“dritë mbi dritë”**. Në tefsirin “Mexhmaul Bejjan”, i ndjeri Et Tabresij ka thënë: “Kjo frazë tregon se Profetët kanë një paraardhës të vetëm dhe se janë ngarkuar me misionin e profetësisë njëri pas tjetrit, që të vazhdonin rrugën e udhëzimit”.

¹ “Tefsiri “Nuruth Thekalejn” vëll. 3, f. 609.

Në tefsirin e tij, Fakhru Rraziu thotë: “Kjo frazë tregon përqendrimin e rrezeve të dritës”; kurse në lidhje me besimtarin thotë: “Besimtari mban katër qëndrime: kur All'llahu i dhuron atij, ai e falënderon Atë; kur besimtari goditet nga ndonjë pesim i rëndë, ai bën durim dhe tregon vendosmëri; kur besimtari flet, thotë të vërtetën; kur gjykon në mes dy vetëve, ai vendos me drejtësi. Besimtari është njeri i ndërgjegjshëm edhe në mes të injorantëve; ai është si i gjalli në mes të të vdekurve. Besimtari ecën midis pesë dritave: fjala e tij është dritë, puna e tij është dritë, qëndrimi i tij në vendbanimin e vet është dritë, udhëtimi i tij është dritë dhe qëllimi i tij është drita e All'llahut në Ditën e Gjykimit.

Kuptimi mund të jetë ky: drita e parë që përmend ajeti, tregon dritën e udhëzimit hyjnor me anë të shpalljes hyjnore dhe drita e dytë, tregon dritën e udhëzimit me anë të logjikës. Ose drita e parë është drita e udhëzimit ligjor, kurse drita e dytë është drita e udhëzimit strukturor; kështu kemi dritë mbi dritë.

Kjo frazë e ajetit është interpretuar nëpërmjet burimeve të ndryshme të dritës; herë është interpretuar me Profetët, herë tjetër me llojet e dritës dhe herë tjetër me format e ndryshme të saj. Të gjitha këto interpretime janë të mundshme në të njëjtën kohë, sepse kuptimi i ajetit është shumë i gjerë.

Ajetet 39 - 40

[illegible]

“Punët e mohuesve janë si mirazhi në një rrafshirë, ku i eturi e mendon si ujë derisa i afrohet dhe nuk gjen asgjë; por aty gjen All'Ilahun, para të Cilit ai (mohuesi) do të japë llogari (për punët që ka bërë); All'Ilahu është i shpejtë në marrjen në llogari.”

“Ose (punët e mohuesve) janë si errësirat në një det të thellë, ku atë e mbulojnë dallgë mbi dallgë dhe mbi ato (dallgët) re të dendura, errësira njëra mbi tjetrën, aq sa kur nxjerr dorën e tij nuk e sheh dot; atij që nuk i jep dritë All'Ilahu, ai nuk do të ketë dritë.”

Komentimi

Punë e pavërtetë

Ajetet e mësipërme bëjnë fjalë për dritën e All'Ilahut, dritën e besimit e të udhëzimit në rrugën e drejtë dhe e bëjnë më të qartë krahasimin midis atyre që All'Ilahu ua ka ndriçuar zemrat. Ajetet që janë objekt studimi trajtojnë botën e mohimit, injorancës dhe ateizmit obskurantist; gjithashtu, ajetet flasin për mohuesit e hipokritët, të cilët gjenden në: **“errësira njëra mbi tjetrën”**. E kundërta e mohuesve janë besimtarët, jeta dhe mendimet e të cilëve janë: **“dritë mbi dritë”**.

Ajeti i parë flet për ata që kërkojnë ujë në shkretëtirën e thatë e përvëluese, por nuk gjejnë gjë tjetër veç mirazhit, kështu që vdesin nga etja; ndërsa besimtari e ka gjetur ujin në dritën e

besimit, ka gjetur burimin e udhëzimit dhe është qetësuar pranë këtij udhëzimi.

Në ajet thuhet: **“Punët e mohuesve janë si mirazhi në një rrafshirë, ku i eturi e mendon si ujë derisa i afrohet dhe nuk gjen asgjë”**, por gjen All'llahun te punët e tij: **“por aty gjen All'llahun, para të Cilit ai (mohuesi) do të japë llogari (për punët që ka bërë); All'llahu është i shpejtë në marrjen në llogari.”**.

Fjala e ajetit *“seràbin”* – **“mirazh”** në rrënjën e saj do të thotë *“rrugë e rrëpirë”*; por kjo fjalë përdoret për të treguar shkëlqimin që shihet në shkretëtirat e në pjerrësitë e zhveshura, pa bimësi, dhe që nga larg duken si ujë, por në të vërtetë është thjesht pasqyrimi i rrezeve të diellit.¹

Disa mendojnë se fjala e ajetit *“kij'ah”*, ka ardhur në numrin shumë me kuptimin: rrafshirë e gjerë në të cilën s'ka as ujë e as bimësi. Me këtë fjalë quhen shkretëtirat, ku në shumicën e rasteve shfaqet fenomeni i mirazhit; por ka edhe prej interpretuesve të Kur'anit, si dhe gjuhëtarë, që mendojnë se kjo fjalë është në numrin njëjës.²

Pavarësisht se midis dy fjalëve ka dallim nga ana e kuptimit, forma e ajetit kërkon që kjo fjalë të jetë në numrin njëjës, sepse fjala *mirazh* që përmendet në të është në këtë numër dhe

¹ Fizikantët bashkëkohorë thonë se kur ngrihet grada e nxehtësisë, ajri pranë tokës zgjerohet dhe shtohet rrallimi i tij. Në këto kushte krijohet një gjendje temperature e ajrit e paqëndrueshme, që ndryshon sipas sipërfaqes së tokës me të cilën është pranë. Nga ky fenomen pasqyrohen valët e dritës dhe ndodh *mirazhi*.

² Lexo tefsiret: *“Mexhmaul Bejjan”*, vëll. 7, f. 146; tefsirin e *“Kurtubij'jit”*; tefsiri *“Kebijr”*, vëll. 24, f. 7, si dhe fjalorin e Ragib El Esfehàni'jit: *“Mufredat elfadhul-Kur'ani”*.

fenomeni i mirazhit shfaqet vetëm në disa pjesë të një vendi të tillë.

Në vijim, ajeti i dytë sjell një shembull për punën e mohuesve dhe njofton: **“Ose (punët e mohuesve) janë si errësirat në një det të thellë, ku atë e mbulojnë dallgë mbi dallgë dhe mbi ato (dallgët) re të dendura”**; për rrjedhojë punët e mohuesve janë: **“errësira njëra mbi tjetrën, aq sa kur nxjerr dorën e tij, nuk e sheh dot.”**.

Në jetën e njerëzve, drita e vërtetë është vetëm ajo e besimit. Pa të, zotëruese mbi jetën bëhen errësirat. Gjithashtu, drita e besimit është një dashamirësi nga All'Ilahu.

Në ajet thuhet: **“atij që nuk i jep dritë All'Ilahu, ai nuk do të ketë dritë.”**.

Për të kuptuar thellësinë e këtij shembulli, duhet të shohim me kujdes kuptimin e fjalës *“luxh'xhij'jin”* – **“det i gjerë dhe i thellë”**. Në rrënjën e saj, kjo fjalë ka kuptimin e ndjekjes së një pune të çfarëdoshme, por zakonisht përdoret për të treguar punët e paplotësuara; më vonë, ajo u përdor për dallgët e detit që vijnë njëra pas tjetrës, apo për qetësimin e dallgëve të detit njëra pas tjetrës. Kjo fjalë ka këtë kuptim, sepse sa më i thellë dhe i gjerë të jetë deti, aq më shumë shtohen dallgët e tij.

Përfytyroni një det të trazuar e të thellë! Ne e dimë se drita e diellit është lloji më i fuqishëm i dritave. Por në thellësi të detit, drita depërton vetëm në një masë të caktuar, që nuk i kalon shtatëqind metra, prandaj aty sundon errësira e përhershme.

Gjithashtu, ne e dimë se kur uji i detit është i qetë, sipërfaqja e tij i pasqyron rrezet e diellit në mënyrën më të mirë, kurse dallgët i thyejnë këto rreze, duke e penguar dritën të depërtojë në thellësi. Kur deti është i dallgëzuar, drita depërton në ujë në një masë më të vogël dhe, nëse mbi këtë det të trazuar qëndrojnë edhe retë e zeza e të dendura, errësira shtohet dhe bëhet edhe më e madhe.¹

Kur thellësisë së detit i shtohet errësira e dallgëve të trazuara si dhe ajo e reve të zeza nga lart, atëherë terri shtohet edhe më shumë.

Në një errësirë të tillë nuk është e mundur të shihet asgjë, sado afër nesh të jetë. Edhe nëse vëmë një send para syve tanë, e kemi të pamundur ta shikojmë.

E tillë është gjendja e mohuesve, të cilët janë të privuar prej dritës së besimit dhe sprovohen me këto errësira. Një gjendje të kundërt me mohuesit kanë besimtarët, të cilëve All'illahu ua ka ndriçuar zemrat dhe rrugën, prandaj për ta vërtetohet plotësisht fjala e ajetit, se janë në: **“dritë mbi dritë”**.

Disa interpretues të Kur'anit janë shprehur se jobesimtarët janë sprovuar me tri lloje errësirash. Ato janë: errësira e besimit të gabuar, e fjalës së gabuar dhe errësira e sjelljes së keqe. Me fjalë të tjera, punët e jobesimtarëve në thelbin e tyre janë errësirë; të tilla

¹ Duhet të theksojmë se fjala *“sehàbu”* - *“re”* ashtu siç shpjegohet edhe në fjalorin *“Lisànul-areb”*, ka kuptimin e reve që lëshojnë shiun. Zakonisht, këto re janë të grumbulluara njëra mbi tjetrën.

janë edhe fjalët që pasqyrojnë besimet e tyre, si edhe punët e tyre të errëta.

Disa të tjerë kanë thënë: Këto tri errësira shprehin fazat e injorancës së jobesimtarëve; faza e parë është se ata nuk dinë; faza e dytë është se ata nuk e dinë që me të vërtetë nuk dinë, ndërsa faza e tretë e injorancës së tyre është se, krahas paditurisë së tyre, ata mendojnë se me të vërtetë dinë dhe kështu jetojnë në errësirën e plotë të injorancës.

Një grup tjetër prej interpretuesve të Kur'anit janë shprehur se bazë për njohjen, ashtu siç thuhet në Kur'anin Famëlartë, janë tri gjëra: zemra, syri dhe veshi (me fjalën "zemër" kuptohet "mendja"), ashtu siç lexojmë në ajetin 78 të sures "En Nahl": **"All'Ilahu u nxorri nga barqet e nënave tuaja dhe nuk dinit asgjë dhe Ai u pajisi me (shqisat) dëgjim, shikim dhe me zemër (mendje)";**¹ mohuesit, me mosbesimin e tyre kanë humbur jo vetëm mendjen, por edhe dëgjimin e shikimin, prandaj ndodhen në errësira të vendosura njëra mbi tjetrën.

Në këto interpretime s'ka asnjë kontradiktë dhe ky ajet i përfshin të tre ata.

Nga dy ajetet që janë objekt studimi, mund të arrijmë në një konkluzion të përgjithshëm: ajeti i parë i shëmbëllen punët e jobesimtarëve me një dritë të rreme, si mirazhi që shikon njeriu i etur në një shkretëtirë të thatë; por ai mirazh nuk do ta shuajë

¹ Tefsiri "Kebijr", fundi i ajetit që është objekt studimi.

etjen e tij, përkundrazi, do të bëjë që ai të lodhet edhe më shumë në kërkim të ujit, por pa ndonjë rezultat konkret.


Në vijim, Kur'ani kalon në trajtimin e kësaj drite të rreme, e cila në fakt shpreh punët e hipokritëve dhe shpjegon se brendësia e tyre është errësirë, frikë dhe egërsi. Në errësirën e hipokrizisë, shqisat e njeriut janë të paralizuara, prandaj atyre u duket bota e errët, madje aq e errët saqë nuk shohin as veten. Në këtë gjendje, ata e kanë të pamundur të shohin edhe të tjerët.

Në këto errësira, njeriu është në vetmi të plotë dhe në injorancë të përhershme. Në këtë errësirë, ai nuk e gjen dot rrugën e tij. Në udhëtimin e tij s'ka asnjë shok; ai s'ka as ku të qëndrojë dhe nuk gjen asnjë mjet për të shpëtuar, sepse nuk përfiton asgjë prej burimit të dritës, pra prej mëshirës e mirësisë së All'llahut të Gjithëfuqishëm, sepse Ai e ka vulosur zemrën e hipokritit me injorancë e me rrugën e humbjes që ndjek.

Më lart thamë se drita është burimi i të gjitha llojeve të bukurisë, është burim i jetës dhe i lëvizjes; e kundërta e dritës është errësira, e cila konsiderohet si burimi i të këqijave, i vdekjes, i mosekzistencës, i qetësisë së plotë dhe i heshtjes.

Errësira është burimi i frikës dhe i urrejtjes. Ajo është binjake e shqetësimit, e brengosjes dhe e hidhërimit. E tillë është gjendja e atyre që e kanë humbur dritën e besimit dhe janë zhytur në errësirat e mohimit e të mosbesimit.

Ajetet 41 - 42



“A nuk e di se All'Ilahun e madhëron ç'ka në qiell e në tokë, madje edhe shpendët fluturues; çdo njëri nga ata e di lutjen e tij dhe madhërimin (që ka detyrë të bëjë); All'Ilahu ka dijeni të plotë për punët që ata bëjnë.”

“Vetëm All'Ilahut i takon sundimi i qiejve e i Tokës dhe tek All'Ilahu është e ardhmja.”

Komentimi

Të gjithë e madhërojnë All'Ilahun

Ajetet e mëparshme flisnin për dritën e All'Ilahut, për udhëzimin në rrugën e drejtë, për besimin dhe për errësitat e shumëfishta të mohimit e të rrugës së humbjes.

Ndërsa ajetet që janë objekt studimi flasin për argumentet e dritave hyjnore dhe për shkaqet e udhëzimit në rrugën e drejtë. Ajeti i parë i drejtohet drejtpërdrejt Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i thotë: **“A nuk e di se All'Ilahun e madhëron ç'ka në qiell e në tokë?”**; All'Ilahun e madhërojnë edhe shpendët fluturues në gjendjen e tyre, në saje të mundësisë që u japin dy krahët për të bërë adhurimin e tyre lart në qiell.

Ajeti njofton: **“madje edhe shpendët fluturues; çdonjëri nga ata e di lutjen e tij dhe madhërimin (që ka detyrë të bëjë); All'Ilahu ka dijeni të plotë për punët që ata bëjnë.”**.

Ky madhërim i përgjithshëm është një argument që vërteton se vetëm All'Ilahu është Krijuesi i të gjitha krijesave; njëkohësisht vërteton se cilësia e krijimit që e ka vetëm All'Ilahu i

Lartësuar, tregon se vetëm Ai është Sunduesi i të gjithë ekzistencës. Ky argument vërteton se çdo gjë e gjallë, do të kthehet tek All'llahu, i Plotpushtetshmi, i Gjithëfuqishmi, të Cilit nuk i mungon asgjë dhe s'ka nevojë për asgjë. All'llahu, i Larti, njofton me fjalën e Tij: **“Vetëm All'llahut i takon sundimi i qiejve dhe i Tokës dhe tek All'llahu është e ardhmja.”**.

Ky ajet ka lidhje me ajetin para tij, për faktin se ajeti i parë, në frazën e fundit njofton se All'llahu ka dijeni të plotë për punët e të gjithë njerëzve, kurse ajeti që kemi në studim, njofton se All'llahu ka dijeni të plotë për ata që e madhërojnë Atë.

Në të vërtetë, ky ajet tregon urtësinë e drejtësisë hyjnore në botën e ardhshme. Gjithashtu, ai njofton se të All'llahut janë gjithçka gjendet në qiej e në tokë, se vetëm Ai është Sunduesi e Fuqiploti i drejtë për të ardhmen e njerëzve dhe për gjithçka që ekziston.

Hulumtime

1- Kuptimi i shprehjes së ajetit: “a nuk e di?”

Shumë interpretues të Kur'anit mendojnë se kuptimi i kësaj shprehjeje është: A nuk e di ti, se madhërimi i përgjithshëm që bëjnë të gjitha krijesat e botës për All'llahun, nuk mund të kuptohet me anë të shikimit, por kuptohet me zemër dhe mendje?

Kjo çështje është shumë e qartë, prandaj dhe ajeti ka përdorur shprehjen **“a nuk e di?”**.

Pavarësisht se në këtë ajet, fjala i drejtohet Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), shumë interpretues të Kur'anit mendojnë se ajeti u drejtohet të gjithë njerëzve. Ata shpjegojnë se kjo mënyrë komunikimi është prej mënyrave të shpalljes së Revelatës, që Kur'ani Famëlartë ndjek në shumë ajete të tij.

Disa interpretues të tjerë të Kur'anit janë shprehur se fjala është e veçantë për Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) gjatë etapës së ëndrrës e të shikimit me sy, sipas fuqisë që i kishte dhuruar All'llahu, me qëllim që ai të shihte adhurimin që bëjnë të gjitha krijesat për All'llahun e Lartësuar. I Plotfuqishmi i ka dhënë të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) fuqi, që ta kuptojë jo vetëm këtë lloj adhurimi, por edhe adhurimin që bëjnë për All'llahun të gjithë robtë e Tij të singertë, të cilët janë kapur vetëm në udhëzimin e Tij.

Për sa u përket njerëzve të zakonshëm, çështja ka të bëjë me fuqinë që ata kanë për të kuptuar me anë të mendjes madhërimit të All'llahut që bëjnë të gjitha qeniet, por jo duke e parë me sy.¹

2- Madhërimi i përgjithshëm i të gjitha krijesave

Ajete të ndryshme të Kur'anit Famëlartë flasin për katër adhurime që bëjnë për All'llahun krijesat e kësaj gjithësie të

¹ Tefsiri “Es Sâfij”, fundi i ajetit që është objekt studimi.

madhe. Ato janë: “*madhërimi*” - “*tesbih*”, “*falënderimi e lavdërimi*” - “*hamd*”, “*përulja me krye në tokë*” - “*sexhde*” dhe “*falja e namazit*” - “*lutja*”. Ajeti që është objekt studimi trajton vetëm adhurimin “*tesbih*” dhe lutjen “*namazin*”.

Ajeti 15 i sures “*Er Rrad*” flet për sexhden e përgjithshme dhe thotë: **“Për All'llahun bëjnë sexhde të gjithë sa janë në qiej e në tokë.”**.

Kurse ajeti 44 i sures “*El Isrà*” flet për “*madhërimin*” - “*tesbih*” dhe “*falënderimin*” - “*hamd*” që bëjnë të gjitha krijesat: **“S’ka asnjë send që nuk e madhëron** (thotë subhanAll'illah) **e nuk i shpreh falënderimet Atij** (thotë elhamdulilah).”. Çështjen e madhërimit dhe të falënderimit të përgjithshëm (*tesbih* dhe *hamd*) që bëjnë krijesat, ne e kemi trajtuar gjatë komentimit të ajetit 44 të sures “*El Isrà*”. Gjithashtu, kemi trajtuar edhe interpretimet e ndryshme që janë bërë në lidhje me këtë ajet. Këtu do të përmendim një përmbledhje të komentimit të këtij ajeti. Për këtë ajet janë dhënë dy interpretime që duhet të trajtohen me kujdes.

Ato janë:

1- Të gjitha grimcat e kësaj bote – ato me logjikë dhe ato pa logjikë – kanë një lloj perceptimi dhe ndijimi; ato e madhërojnë dhe e falënderojnë All'llahun, pavarësisht se ne nuk e kuptojmë madhërimin e falënderimin e tyre. Në lidhje me këtë interpretim ka disa argumente kur’anore.

2- Qëllimi me “*madhërimin*” - “*tesbih*” dhe me “*falënderimin*” - “*hamd*”, është ai që shprehet me frazën “*gjuha e gjendjes*”, domethënë: ekzistenca dhe të fshehtat e saj të habitshme që gjenden në çdo krijesë flasin qartë për madhësitë e Krijuesit, të

diturisë dhe të urtësisë së Tij, që nuk kanë kufinj. Çdo krijesë e bukur dhe çdo objekt artistik shkakton habi e mahnitje, madje edhe një tabllo e vogël apo fragmenti i një poezie të bukur, e falënderon dhe e madhëron autorin e saj. Me këtë madhërim e falënderim, ajo zbulon cilësitë e atij autori (duke e falënderuar atë); nga ana tjetër, ajo mohon që autori i saj të ketë ndonjë të metë apo mangësi (ky është madhërimi që ajo bën për autorin e saj). Atëherë, si qëndron puna e falënderimit dhe e madhërimit në këtë gjithësi të madhe, me të gjitha gjërat e habitshme e të panjohura që ajo ka e që s'mbarohen kurrë?! (Për më shumë informacion në lidhje me këtë çështje, lexo komentimin e ajetit 44 të sures "El Isrâ" të tefsirit tonë.)

Fraza e ajetit **"All'llahun e madhëron ç'ka në qiell e në tokë"**, ka kuptimin: madhërimi që bën për All'llahun kush është në qiej e në tokë, por fjala **"kush"** në tekstin e ajetit, ka ardhur me fjalën **"men"**, që tregon qeniet me logjikë. Prandaj madhërimi në këtë frazë është madhërim i ndërgjegjshëm e me vullnet. Gjithashtu, ajo tregon se edhe shpendët kanë ndjenja, sepse vetë fjala **"et'tajru"**- **"shpendët"** ka ardhur pas fjalës **"men"**- **"kush"**. Kjo nuk është diçka e çuditshme, sepse në ajete të tjera të Kur'anit flitet për ndjenja që janë të veçanta te disa lloje shpendësh fluturues (referohu në komentimin e ajetit 36 të sures "El En'âm" të këtij tefsiri).

3- Madhërimi i veçantë i shpendëve

Ku qëndron shkaku i përmendjes së madhërimit të All'llahut prej shpendëve ndër të gjitha krijesat, veçanërisht kur ato i shtrijnë krahët në qiell?

Shpendët, me shumëllojshmërinë e tyre, karakterizohen nga cilësi të veçanta, që tërheqin shikimin e çdo të mençuri, kur i sheh se si fluturojnë këto trupa (disa prej të cilëve kanë peshë të rëndë) në qiell, në kundërshtim me ligjin e tërheqjes; madje, ato fluturojnë në ajër me shpejtësi nga një pikë në një pikë tjetër të globit, qëndrojnë lart mbi stuhitë e erërave me krahë të shtrirë, pa ndjerë asnjë lodhje e pa asnjë mundim. Në të vërtetë, mënyra se si fluturojnë këto shpendë shkaktonte çudi.

Akoma më e çuditshme tek këta shpendë, është fakti se si i kuptojnë ata uruganet e atmosferës si dhe njohuritë e hollësishme që kanë për gjendjen gjeografike të tokës gjatë migrimeve që bëjnë nga njëri kontinent në një tjetër, apo prej Polit të Veriut deri në Polin e Jugut.

Shpendët kanë një aparat orientues të fshehtë e të mahnitshëm, që i drejton ata drejt objektivit ku do të shkojnë në udhëtimet e gjata, edhe atëherë kur qielli është i mbuluar me re të dendura e të zeza. Të gjitha këto janë vetëm disa prej cilësive të shpendëve, që shkaktojnë habi e çudi. Argumente më të qarta, që kanë të bëjnë me çështjen se si orientohen shpendët, ne i shohim te shpendët e natës, të cilët kanë një “radar” të mahnitshëm, që i lajmëron ata gjatë fluturimit në errësirë për çdo pengesë që mund të kenë përpara; madje, disa lloje shpendësh kanë aftësi të shikojnë edhe peshkun nën ujë dhe aty e kapin me kthetrat e veta me shpejtësinë e rrufesë. Kjo është një karakteristikë e habitshme.

Te shpendët ka edhe cilësi të tjera të çuditshme që përmenden në Kur'anin Famëlartë.

4- Fraza e ajetit “çdonjëri nga ata e di lutjen e tij dhe madhërimin (që ka detyrë të bëjë)”

Përemrin që përmban folja “alime”- “e di”, disa interpretues të Kur'anit e lidhin me fjalën “kul'lun”- “çdonjëri” dhe me këtë interpretim, bëhet i qartë kuptimi i frazës së mëparshme të ajetit: “ç'ka në qiell e në tokë”, domethënë edhe shpendët e dinë lutjen e madhërimin që bëjnë.

Interpretues të tjerë të Kur'anit kanë thënë se përemri i foljes “e di” i bashkangjitet All'Ilahut të Lartësuar dhe sipas këtij interpretimi, kuptimi i kësaj fraze të ajetit është: All'Ilahu ka dijeni për madhërimin e për falënderimin që bën çdonjëri prej tyre.

Interpretimi i parë është më i përshtatshëm me fjalët e ajetit.

Në saje të këtij sistemi “çdokush” që madhëron All'Ilahun, e di mënyrën se si e bën madhërimin, ka dijeni edhe për kushtet dhe veçoritë e lutjes së tij.


Kur madhërimi bëhet me ndërgjegje prej këtyre qenieve, del fare qartë kuptimi i kësaj fjale, por kur ai bëhet “me gjuhën e gjendjes”, kuptimi është: çdonjëri prej atyre ka një sistem të veçantë, që shpreh me një formë ose me një tjetër, madhërimin për All'Ilahun e Lartësuar; gjithashtu, çdonjëra prej qenieve pasqyron fuqinë e All'Ilahut si dhe urtësinë e Tij.

5- Cili është kuptimi i fjalës “salât”?

Disa interpretues të Kur'anit, si i ndjeri Et Tabresij në “Mexhmaul Bejjan” dhe El Alusij’ji në “Ruhul Bejan”, kanë thënë se fjala e ajetit “**sàlat**” ka kuptimin “*lutje*”.

Ky është kuptimi në fjalor i kësaj fjale dhe me këtë kuptim e praktikojnë lutjen të gjitha krijesat e tokës e të qiellit, pra i luten All'lahut me “gjuhën e gjendjes” së tyre, ose i luten me fjalët e veta dhe të gjitha i kërkojnë Atij mëshirë, sepse vetëm Ai është Zotëruesi i mëshirës dhe i Larti; Atij nuk i mungon asgjë dhe s’ka nevojë për asgjë; Ai e shfaq mëshirën e Tij duke derdhur mbi ata mirësitë e Veta, secilit sipas aftësisë që ka.

Qëllimi më i lartë i lutjes dhe i madhërimit tregon se të gjitha krijesat i dinë nevojat e tyre, dinë edhe si duhet të luten. Përveç kësaj, në përputhje me ajetet që cituam më lart, të gjitha krijesat janë të nënshtruara ndaj All'lahut, janë dorëzuar para ligjeve të krijimit dhe në brendësi të tyre përsërisin lavdërime për cilësitë e plotësuara të Krijuesit të Lartësuar. Me madhërimin që bëjnë, ato mohojnë çdo mangësi për All'lahun e Gjithëpushtetshëm.



“A nuk e shikon se si i drejton All'llahu retë, pastaj i bashkon, i grumbullon dhe i stivon njëra mbi tjetrën, atëherë ti sheh shiun të rrjedhë prej tyre; Ai lëshon prej qiellit nga retë e mëdha si male breshër dhe me atë (me breshërin) Ai godet atë që do dhe e largon atë prej atij që Ai do dhe, shkëlqimi i vetëtimës së resë gati sa nuk të merr sytë.”

“All'llahu bën rrotullimin e natës e të ditës; në të gjitha këto ka fakte për ata që dinë të shohin.”

“Çdo gjallesë All'llahu e krijoi prej ujit; ka prej tyre (gjallesave) që ecin duke u zvarritur mbi barkun e vet, ka prej tyre që ecin me dy këmbë, ka prej tyre që ecin me katër këmbë; All'llahu krijon gjithçka që Ai dëshiron, All'llahu ka fuqi për çdo gjë.”

Komentimi

Anë tjetër e krijimit të mahnitshëm

Në këto ajete ballafaqohemi me një anë tjetër të mahnitshme të krijimit, me argumentet shkencore dhe me urtësinë e madhe të tij. Të gjitha këto janë dëshmi që vërtetojnë se Krijuesi është Zoti Një dhe i Vetëm.

Kur'ani Famëlartë i flet edhe një herë tjetër në vetën e dytë Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i thotë: **“A nuk e shikon se si i drejton All'llahu retë, pastaj i bashkon, i grumbullon dhe i stivon njëra mbi tjetrën”,** dhe pasi i stivon retë njëra mbi tjetrën, ti i shikon pikat e shiut që dalin prej reve, të bien mbi malet, fushat dhe shkretëtirat. Në ajet thuhet: **“atëherë ti sheh shiun të rrjedhë prej tyre.”**

Fjala “*juzxhi*” - “*drejton*”, do të thotë: i drejton ato (pikat e shiut) të shpërndara këtu e atje, me dashamirësi dhe me mënyrën më të përshtatshme për të sistemuar krijesat.

Kjo mënyrë e të shprehurit është plotësisht e vërtetë për retë, pasi çdo pjesë e tyre ngrihet lart prej detit dhe pastaj “dora” e Fuqisë Hyjnore i grumbullon dhe i stivon ato njëra mbi tjetrën.

Fjala e ajetit “*rukàmen*” ka kuptimin e sendeve të vëna njëra mbi tjetrën.

Për fjalën e ajetit “*el vedka*”, shumë dijetarë mendojnë se ka kuptimin e pikave të shiut, kurse Ragib El Esfehanij thotë në fjalorin e tij të fjalëve të Kur’anit, se ajo ka kuptimin e pikave të vesës, që notojnë në ajër në kohën me shi.

Në këtë ajet, kuptimi i parë është më i përshtatshëm dhe tregon dashamirësinë e All'llahut, pasi kjo fjalë këtu tregon pikërisht pikat e shiut që bien, dhe jo pikëzat e shiut që qëndrojnë pezull në ajër. Këtu duhet shtuar se Kur’ani Famëlartë, sa herë që përmend fjalën “**re**” dhe zbritjen e begative të All'llahut prej qiellit, ka për qëllim shiun që rrjedh prej reve. Me shiun, toka gjallërohet pas thatësirës, që e kishte bërë të dukej si e vdekur; shiu rikthen jetën tek pemët e tek bimësia dhe shuan etjen e njerëzve e të kafshëve.

Gjithashtu, Kur’ani Famëlartë tregon një dukuri tjetër të mahnitshme prej dukurive të qiellit: “**Ai lëshon prej qiellit nga retë e mëdha si male breshër**”; prej reve që duken si male dhe që qëndrojnë varur në qiell, All'llahu lëshon pikat e shiut në formë bore e breshëri. Në të vërtetë, kjo është një sprovë mbi ata që All'llahu dëshiron t’i ndëshkojë, pasi breshëri dëmton dhe shkatërron të mbjellat e pemët, madje godet dhe shkakton vështirësi të mëdha për njerëzit e për kafshët. Për këtë, ajeti njofton: “**dhe me atë** (me breshërin) **Ai godet atë që do**”, ose e largon breshërin prej atij që Ai nuk dëshiron ta ndëshkojë: “**dhe e largon atë prej atij që Ai do**”.

All'llahu, herë lëshon shi që e bën tokën pjellore, e herë tjetër, me urdhrin e Tij, shiu bëhet breshër pa pësuar uji asnjë ndryshim në përbërjen e tij, përveç formës, dhe me këtë breshër Ai

godet për të shkaktuar vështirësi për cilin të dëshirojë; madje ndodh që breshëri disa herë të jetë edhe shkatërrues.

Ky fakt tregon madhështinë e fuqinë e All'lahut të Lartësuar, i Cili ka bërë që dobia e njeriut dhe dëmi i tij, si dhe jeta e vdekja e tij, të jenë krah për krah, madje edhe të përziera njëra me tjetrën.

Në fundin e ajetit, All'lahu, i Larti, thekson një dukuri tjetër prej dukurive qiellore, e cila në të vërtetë është prej argumenteve të Teuhidit (All'lahu është Zoti Një dhe i Vetëm). I Gjithëfuqishmi njofton me fjalën e Tij: **“shkëlqimi i vetëtimës së resë gati sa nuk të merr sytë.”**.

Reja, e cila në fakt është e përbërë prej pikave të ujit, përmban në vetvete ngarkesa elektrike që japin një dritë aq të fortë në formën e vetëtimës, sa të merr sytë. Kjo dritë shoqërohet me një zhurmë të madhe shurdhuese, që shkaktohet prej shkarkesës elektrike të reve; madje, zëri që vjen prej këtyre shkarkesave elektrike të reve është aq i fortë saqë tronditet e gjithë hapësira.

Në të vërtetë, kjo fuqi shumë e madhe që del prej mesit të këtyre avujve të lehtë, është jo vetëm mbresëlënëse, por edhe e mahnitshme.

Përgjigje për një pyetje

Shtrohet pyetja: Ç'është ai mal në qiell, prej të cilit zbret breshëri?

Interpretuesit e Kur'anit i kanë dhënë përgjigje të ndryshme kësaj pyetjeje, disa prej të cilave përmenden më poshtë:

1- Disa kanë thënë se fjala “male” e përdorur këtu, është alegori, si për shembull kur themi: një mal me ushqime, ose një mal me dituri. Nga ky këndvështrim, ajeti ka kuptimin e breshërit të shkaktuar prej reve, që është i grumbulluar si mal në mesin e qiellit; një pjesë prej këtij breshëri, All'llahu e zbret mbi vendet e banuara, kurse një pjesë tjetër mbi shkretëtirë dhe me të godet atë që do.

2- Të tjerë kanë thënë se qëllimi me fjalën “male” janë retë e grumbulluara njëra mbi tjetrën, që ngjajnë si mal.

3- Autori i tefsirit “Fij Dhilalil Kur’àn” ka dhënë një shpjegim tjetër dhe, me sa duket, ky është edhe interpretimi më i përshtatshëm. Ai shkruan: “Dora” e All'llahut i drejton retë dhe i shtyn nga njëri vend në tjetrin; pastaj i bashkon, i hedh njëra mbi tjetrën dhe, kur ato ngarkohen me peshë, prej tyre rrjedh uji me rrebesh të madh. Në këto re, që tashmë duken në formën e vargmaleve të mëdha e të pashkëputura, ka copëza akulli. Për ne që jemi në tokë, “malet” e reve nuk duken, por ato i shikojnë fare qartë ata që udhëtojnë me avion, i cili ose fluturon sipër reve, ose kalon përmes reve. Kështu, udhëtari që është në avion shikon me të vërtetë male shumë të mëdha, me maja të larta e me humnera të frikshme, ultësira e faqe malesh të thepisura; thënë ndryshe: ai është fotograf i një të vërtete, të cilën njerëzit e shohin vetëm atje lart.¹

Për formimin e breshërit në qiell, shkencëtarët mendojnë se pikat e shiut pasi shpëputen prej reve, gjatë rënies në drejtim të tokës, mund të ndodhë që të ndeshen me ndonjë shtresë ajri të ftohtë dhe nga temperatura e ulët, ato shndërrohen në kokrriza uji

¹ Tefsiri “Fij Dhilalil Kur’àn”, vëll. 6, f. 109.

të ngrirë. Këto kokrriza shtyhen lart nga stuhitë e mëdha në lartësitë e atmosferës dhe kështu ato futen në mes të reve, ku marrin ujë të ri, pra e shtojnë masën prej ujit që u mvishet kokrrizave të akullta dhe, nga pesha që marrin, bien poshtë; kur kalojnë edhe një herë tjetër nëpër shtresën e ajrit shumë të ftohtë, ato bien mbi tokë në formë breshëri.

Sa herë që të përsëritet ky proces, aq herë më të mëdha bëhen kokrrizat e breshërit dhe, për rrjedhojë, ato shtojnë në peshë; për shkak të peshës, furtunat në qiell nuk mund t'i shtyjnë më ato lart edhe një herë tjetër, ose në rastet kur furtunat janë qetësuar, atëherë breshëri bie mbi tokë.

Me këtë shpjegim shkencor bëhet akoma më i qartë qëllimi i fjalës së ajetit **“male”**, sepse formimi i breshërit me kokrriza të mëdha e të rënda, është i mundur vetëm në gjendjen kur retë janë të grumbulluara njëra mbi tjetrën dhe kur furtunat në atmosferë i hedhin kokrrizat e breshërit në mes të reve, aty ku ato fitojnë fuqi më të madhe në saje të ujit që marrin prej reve.¹

¹ Përsëritja e parafjalës *“min”* - *“prej”* tri herë në frazën e ajetit tonë: *“ue junez'zilu mines'semai min xhibàlin fijhà min beredin”*. Parafjala e parë *“min”* - *“prej”* është në vend të kryefjalës; parafjala e dytë i bashkangjitet kryefjalës dhe për të tretën *“min”*, ashtu siç thamë më lart, ka interpretime të ndryshme. Sipas interpretimit të parë, ajo është fjalë shpjeguese dhe me këtë shpjegim, kuptimi i frazës është: *“Ai bën të zbresë (breshër) prej maleve (reve të dendura) në qiell”*. Në këtë frazë është hequr veprimi i foljes *“zbret”*, që është breshëri e që në këtë shënim është vënë në kllapa. Duke marrë në konsideratë krahasimin e fjalëve, sipas interpretimit të dytë e të tretë që ne përmendëm më lart, kuptohet se parafjala *“min”* - *“prej”* është shtesë për sqarim, (ashtu siç ka ardhur në tefsirin *“Rûhul Meànij”*, sipas transmetimit të ardhur prej El Akhfesh), ose përdoret për të treguar pjesë.

Disa autorë tefsiresh thonë se ajetet që janë objekt studimi theksojnë qartë fjalën *“male akulli”*, domethënë: male ku ka një lloj akulli.

Shprehja e ajetit *“male akulli”* tregon se kësaj fraze duhet t’i kushtohet një vëmendje e madhe, sepse shpikja e aeroplanëve dhe mundësia e fluturimit me to në lartësi relativisht të mëdha, i ka zgjeruar horizontet e diturisë së njerëzve; aeroplanët u kanë mundësuar shkencëtarëve të arrijnë deri në retë e padukshme, të përbëra prej grumbujve të ujit të ngrirë, që me të drejtë mund të quhen male akulli.

Njëri prej shkencëtarëve të ish-Bashkimit Sovjetik e ka përdorur disa herë termin *“male resh”* dhe *“male akulli”* gjatë shpjegimit që ai ka dhënë rreth problemit të furtunave të dëborës. Me këtë shpjegim, për ne bëhet e qartë se në qiell ekzistojnë male prej akulli.

Ajeti vijues i këtij grupi ajetesh, thekson njërën prej mrekullive të krijimit e të madhësisë së All'Ilahut të Lartësuar. Aty thuhet se All'Ilahu i krijoi natën e ditën me të gjitha veçoritë e tyre: **“All'Ilahu bën rrotullimin e natës e të ditës; në të gjitha këto ka fakte për ata që dinë të shohin.”**

Duke folur për kuptimin e foljes *“juka’libu”* - *“rrotullon”*, disa interpretues kanë thënë se kur hyn njëra prej këtyre të dyjave, All'Ilahu e shuan tjetrën.

Disa të tjerë kanë thënë se bëhet fjalë për shkurtimin e njëres dhe zgjatjen e tjetrës; kjo ndodh në mënyrë graduale dhe ka lidhje me katër stinët.

Interpretues të tjerë kanë marrë në konsideratë ndryshimin e temperaturës nga e nxehtë në të ftohtë, si dhe fenomene të tjera që ndodhin gjatë natës e ditës.

Gjithsesi, në këto interpretime s'ka asnjë kontradiktë, madje të gjitha këto mund të përmbliken në kuptimin e foljes "juka'l'libu" - "rrotullon". Këtë të vërtetë e ka argumentuar edhe shkenca, e cila ka shpjeguar se ardhja e natës dhe e ditës njëra pas tjetrës, si dhe ndryshimet graduale që vijnë prej këtij "rrotullimi", kanë një efekt shumë të rëndësishëm për vazhdimësinë e jetës. Pikërisht, në këtë ka një mësim të madh për ata që dinë të shikojnë.

Nëse nxehtësia e diellit do të ishte e njëjtë, kjo do të shkaktonte rritjen e nxehtësisë së ajrit; për rrjedhojë, nxehtësia e madhe do t'i vriste gjallesat dhe do t'ua lodhte nervat, porse ardhja e natës dhe e ditës në mënyrë të alternuar, vë një barazpeshim të efektit të fuqishëm të nxehtësisë së diellit dhe e bën atë të përshtatshme për jetën.

Edhe ndryshimet graduale gjatë orëve të natës e të ditës janë shkak për ndodhjen e katër stinëve. Këto ndryshime janë një faktor me ndikim shumë të madh në zhvillimin e bimësisë, në jetën e gjallesave, në rënien e shiut dhe në formimin e ujërave nëntokësorë, që janë prej thesareve të tokës.¹

Ajeti i fundit prej ajeteve që janë objekt studimi, thekson argumentin e *Teuhidit* (All'Ilahu është Zoti Një dhe i Vetëm), që në fakt vërteton edhe shfaqjen e formave të ndryshme të jetës. Në të

¹ Këtë studim në tefsirin tonë "El Emthel" e kemi bërë në komentimin e ajetit 6 të sures "Junus".

thuhet: **“Çdo gjallesë All'Ilahu e krijoi prej ujit”**, domethënë: të gjitha krijesat e kanë origjinën nga uji, pavarësisht formave të ndryshme që kanë ato. Ajeti përsëri njofton: **“ka prej tyre (gjallesave) që ecin duke u zvarritur mbi barkun e vet”**, siç ecin zvarranikët; **“prej tyre ka që ecin me dy këmbë”**, si njeriu dhe shpendët; **“ka prej tyre që ecin me katër këmbë”**, si kafshët.

Krijimi nuk është i kufizuar vetëm në këto tri kategori krijesash. Jeta e gjallë ka edhe forma të tjera të shumta, madje aq të shumta saqë është e pamundur të numërohen, qofshin ato gjallesa detare, tokësore, ose insekte; shumëllojshmëria e gjallesave arrin në mijëra e mijëra specie. Pikërisht për këtë shkak, ajeti mbyllet me njoftimin: **“All'Ilahu krijon gjithçka që Ai dëshiron, All'Ilahu ka fuqi për çdo gjë.”**.

Hulumtime

1- Ç’kuptim ka fjala e ajetit: *“prej ujit?”*

Për ç’lloj uji bëhet fjalë në ajetin që është objekt studimi?

Për këtë çështje, interpretuesit e Kur'anit kanë bërë tre interpretime:

a- Fjala “*ujë*” në këtë ajet, ka për qëllim spermatozoidin. Shumë prej interpretuesve të Kur'anit e kanë paraqitur me këtë kuptim. Gjithashtu, ky kuptim përmendet edhe në disa hadithe.

Por ky interpretim ka një problem, i cili lidhet me faktin se jo të gjitha gjallesat e kanë origjinën nga spermatozoidi. Disa gjallesa mikroskopike janë një qelizë e vetme; gjallesa të tjera shumohen prej ndarjes së qelizave dhe jo prej spermatozoidit. Kështu, interpretimi i mësipërm nuk është përgjithësues.

b- Sipas interpretimit të dytë, fjala e përdorur në ajet ka për qëllim shfaqjen e krijesës së parë. Në disa hadithe thuhet se gjëja e parë që krijoi All'llahu është uji dhe pastaj prej tij, Ai krijoi njeriun.

Ky interpretim është në përputhje me teoritë e reja, të cilat thonë se gjallesa e parë u shfaq në ujëra dhe kjo është një dukuri sunduese e thellësive të detrave e të brigjeve të tyre. (Është e kuptueshme se Fuqia që e krijoi këtë qenie të gjallë me të gjithë përbërësit e saj dhe që u kujdes për të në fazat e saj të pastajme, është një fuqi shumë më e lartë se natyra; pra ajo nuk mund të jetë tjetër, përveçse fuqia e All'llahut të Lartësuar.)

c- Interpretimi i fundit për krijimin e gjallesave nga uji, thotë se ky i fundit është elementi bazë i përbërjes së gjallesave dhe gjendet me shumicë në trupin e tyre. Veç kësaj, gjallesat nuk mund të vazhdojnë jetën pa të.

Midis këtyre tre interpretimeve nuk ka asnjë kontradiktë, por duhet thënë se interpretimi i parë dhe ai i dytë duken më afër kuptimit që shprehin fjalët e ajetit.¹

2- Përgjigje për një pyetje

Kafshët nuk përmbliidhen vetëm në tre llojet që u përmendën: zvarranikët, dykëmbëshit dhe katërkëmbëshit. Shtrohet pyetja: A ka edhe kafshë të tjera me më shumë se katër këmbë?

Përgjigja për këtë pyetje mund të merret prej vetë ajetit, domethënë prej fjalës së të Lartit, i Cili thotë: **“All'Ilahu krijon gjithçka që Ai dëshiron.”**. Kjo frazë e ajetit përfshin të gjitha llojet e kafshëve, duke shtuar edhe kafshët më të rëndësishme që përdor njeriu prej tre llojeve të lartpërmendura.

Disa mendojnë se kafshët që kanë më shumë se katër këmbë, gjatë ecjes mbështeten vetëm mbi katër këmbë dhe këmbët e tjera janë ndihmëse për ato të katërta.^{2dhe3}

¹ Disa përkrahës të evolucionit mbështeten në këtë ajet për të vërtetuar teorinë e tyre, por ne e kemi theksuar pavërtetësinë e Teorisë së Evolucionit gjatë komentimit të ajetit 26 të sures “El Hixhr”. Nuk është kusht që ajetet e Kur’anit të jenë në përputhje me teoritë, sepse ato flasin për të vërteta të pandryshueshme, kurse teoritë shkencore ndryshojnë.

² Tefsiri i “Kurtubij’jit” dhe tefsiri “Kebijr”, vëll. 24, f. 16, fundi i ajetit që është objekt studimi.

³ Kjo çështje duhet parë me kujdes të madh edhe nga ana gjuhësore, për faktin se përemri “hum” – “tyre” dhe fraza “minhum” – “prej tyre”, pavarësisht se është shumë e tregues qeniet me logjikë, në ajet është përdorur edhe për qeniet pa

3- Format e ndryshme të jetës

Jeta konsiderohet si dukuria më mahnitëse në botë. Ajo është një sekret të cilin shkencëtarët deri tani s'kanë mundur ta zbërthejnë e t'ia gjejnë simbolet. Të gjithë thonë se gjallesat janë krijuar prej lëndësh pa jetë, por asnjë nuk e di se si ka ndodhur ky ndryshim i vrullshëm dhe si është bërë shndërrimi i lëndës pa jetë në një qenie të gjallë. Deri tani, asnjë laborator nuk e ka realizuar shndërrimin e një sendi pa jetë në një qenie me jetë, ndonëse për këtë kanë punuar e vazhdojnë të punojnë me mijëra shkencëtarë.

Ky është një iluzion i largët, që shkencëtarëve u duket se e shikojnë herë pas here, por iluzioni patjetër që mbetet i tillë. Dituria njerëzore nuk mund t'i zbulojë sekretet e jetës me ndërlikimet e saj të mëdha, për shkak se vetë ato sekrete i përkasin një shkalle të lartë.

Në kushtet e tanishme, të gjallët lindin prej të gjallëve dhe asnjë i gjallë nuk lind prej një sendi pa jetë. Megjithatë, kjo gjendje s'ka qenë e tillë në të kaluarën shumë të largët; thënë ndryshe, jeta e ka një histori kur është shfaqur.

Pra, si dhe në ç'kushte u shfaq jeta?

Kjo është një enigmë, e vërteta e së cilës nuk është bërë kurrë e qartë. Akoma më e mahnitshme është shumëllojshmëria e jetës në këtë formë të plotësuar, duke filluar prej gjallesës

logjikë; gjithashtu, edhe përemri lidhor "men" - "kush" tregon qeniet me logjikë, por në fjalët e këtij ajeti është përdorur disa herë edhe për qeniet pa logjikë.

mikroskopike njëqelizore e deri te balenat e mëdha, gjatësia e disa prej të cilave i kalon tridhjetë metrat; madje, vetëm njëra nga balenat ngjan me një mal prej mishi që shëtit nëpër oqeanë.

Jeta e gjallë varion prej qindra-mijëra lloje insektesh të ndryshme deri në mijëra lloje shpendësh të bukur, ku secili lloj ka botën dhe të fshehtat e veta të veçanta.

Librat e zoologjisë në ditët e sotme zënë një vend të rëndësishëm në të gjitha bibliotekat e botës. Në këto libra, autorët shpalosin anë të ndryshme prej sekreteve të këtyre gjallesave, sidomos të gjallesave ujore.

Në ujëra ka pasur gjithmonë sekrete dhe vazhdon të ketë, por njohuritë tona janë fare të pakta për të gjetur se ku e kanë fundin, pavarësisht sa i madh dhe i thellë është zhvillimi ynë shkencor. E vërteta është: All'llahu është më i madhi; Ai i krijoi të gjitha këto gjallesa; Ai u ka dhënë të gjitha gjallesave çdo gjë që ato kanë nevojë. Të gjitha këto vërtetojnë se sa e madhe është fuqia e Tij dhe sa e thellë e sa e gjerë është dituria e Tij.

I Plotpushtetshëm dhe i Gjithëfuqishëm është vetëm Ai, që s'ka nevojë për asgjë dhe që nuk i mungon asgjë. Çdonjërin prej gjallesave, Ai e ka vënë në kushtet më të përshtatshme për të, i ka siguruar ushqimin dhe gjithçka tjetër që ajo ka nevojë; por akoma më e mahnitshme se kjo, është se të gjitha këto qenie, Ai, i Gjithëfuqishmi, i krijoi vetëm prej ujit dhe prej një sasive të pakët dheu.

“Mos vallë në zemrat e tyre ka sëmundje, apo ata dyshojnë dhe kanë frikë se All'lahu dhe i Dërguari i Tij do të gjykojnë me padrejtësi kundër tyre? Por jo, ata vetë janë të padrejtë.”

Shkaku i zbritjes

Interpretuesit e Kur'anit kanë përmendur dy shkaqe për zbritjen e këtij grupi ajetesh:

Thuhet se këto ajete kanë zbritur në lidhje me një hipokrit që ishte në konflikt me një hebre. Ky i fundit i bëri thirrje hipokritit që të shkonin për gjykim tek i Dërguari i All'lahut (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), por edhe hipokriti i bëri thirrje hebreut Ka'b bin Eshraf (në disa transmetime thuhet se hipokriti u shpreh hapur e qartë: “*Ka mundësi që Muhammedi të mos gjykojë me drejtësi mes nesh.*”).

Gjithashtu, tregohet se midis Aliut dhe Osmanit (ndërsa sipas një transmetimi tjetër, midis Aliut e Mugijreh bin Vail) pati një konflikt në lidhje me një parcelë toke, që ky i fundit e kishte blerë prej Aliut. Parcela e tokës ishte me gurë dhe për këtë, ai deshë ta anulonte shitjen, duke mos e marrë tokën me pretekstin se ajo ishte me të meta. Ai i tha: “Në mes ne të dyve është i Dërguari i All'lahut (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)”. El Hakem bin Ebul Às (që ishte prej hipokritëve) tha: “Nëse ngren padi kundër djalit të xhaxhait të tij që të gjykojë ai, atëherë shko të gjykohesh tek ai”. Ndërkohë

zbritën ajetet që janë objekt studimi, të cilat e kundërshtojnë fuqishëm mendimin e hipokritëve. Ky transmetim ka ardhur prej Ebu Xhafer El Bakir, ose prej një të afërmi të tij.¹

Komentimi

Besimi dhe pranimi i gjykimit të All'llahut

Ajetet e mësipërme flisnin për besimin në All'llahun, për argumentet e Njësimit të Tij – *Teuhidin* (All'llahu është Zoti Një dhe i Vetëm), si dhe për argumentet e Njësimit të All'llahut në botën e ekzistencës. Kurse ajetet që janë objekt studimi trajtojnë ndikimin e besimit dhe pasqyrimin e Njësimit të All'llahut – *Teuhidit* (besimi se All'llahu është Zoti Një dhe i Vetëm) në jetën e njeriut dhe bindjen e nënshtrimin e tij ndaj të Vërtetit dhe së vërtetës.

Ajeti i parë i këtij grupi ajetesh njofton: **“Ne kemi zbritur argumente të qarta”**, argumente që i ndriçojnë zemrat me dritën e besimit, me dritën Njësimit të All'llahut – *Teuhidit* (All'llahu është Zoti Një dhe i Vetëm), që shtojnë dritë e gëzim në mendjen e njeriut dhe errësirat në jetën e tij i shndërrojnë në dritë mbi dritë.

¹ Tefsiri: “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 7, f. 150; tefsiri: “Rùhul-Meàni”; tefsiri “Et Tibjàn”; tefsiri i “Kurtubij’jit”; tefsiri “Kebijr” vëll. 24, f. 20; tefsiri “Es Sàfij dhe tefsiri “Nuruth Thekalejn” vëll. 3, f. 615, fundi i ajetit që është objekt studimi (me disa ndryshime).

Këto argumente të qarta shtrojnë rrugën për besimin (*imanin*), ndonëse udhëzimi hyjnor luan rolin kryesor.

Ajeti sqaron: **“All'llahu udhëzon në rrugën e drejtë atë që do.”**. Ne dimë se vullneti i All'llahut dhe dëshira e Tij nuk i nënshtrohen llogaridhënies dhe i Plotpushtetshmi, i Gjithëfuqishmi, e fut dritën e udhëzimit vetëm në zemrat e përgatitura për ta pranuar atë, pra në ato zemra që janë të gatshme të luftojnë në rrugën e Tij, në zemrat e atyre që kanë bërë hapa për t'u afruar tek Ai; këto zemra, All'llahu i ndihmon sipas punës që kanë bërë, me qëllim që të arrijnë dashamirësinë e kënaqësinë e të Gjithëfuqishmit, Atij që s'ka asnjë të metë e që s'ka nevojë për asgjë.

Ajeti i dytë shpreh qortimin ndaj një grupi hipokritësh, të cilët pretendonin se kishin besuar, në një kohë kur në zemrat e tyre nuk kishte asgjë nga drita e All'llahut. Për këtë grup hipokritësh, ajeti njofton: **“Ata (hipokritët) thonë: i kemi besuar All'llahut e të Dërguarit të Tij dhe jemi të bindur; por më pas një grup prej tyre largohen; të këtillë nuk janë besimtarë.”**.

Çfarë besimi është ky, që nuk i kapërcen kufijnjtë e gjuhës së tyre dhe që s'ka asnjë ndikim në punët e tyre?

Ajeti vijues përmend një argument të qartë dhe tregon arsyen se përse ata nuk janë besimtarë: **“Kur thirren që ndërmjet tyre të gjykojë All'llahu dhe i Dërguari i Tij, një grup prej tyre nuk i përgjigjen asaj (thirrjes).”**

Për të theksuar akoma edhe më shumë se ky grup hipokritësh janë adhurues të kësaj bote dhe për ta diskredituar politeizmin e tyre, ajeti vijues sqaron: **“Por, nëse e drejta (në atë**

gjakim) u takon atyre, ata shkojnë tek ai të bindur e me respekt”, madje shkojnë tek ai plotësisht të dorëzuar e të nënshtruar.

Shprehja e parë në këtë ajet flet për thirrjen për të besuar në All'llahun e në të Dërguarin e Tij (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kurse në shprehjen e dytë - dhe konkretisht fjala e ajetit “*lijahkume*” - “*që të gjykojë*”, folja është në numrin njëjës e në vetën e tretë; pra vetë fjala e ajetit tregon se ai që do të gjykojë është i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) pasi gjykimi i tij është i pandarë prej gjykimit të All'llahut të Lartësuar; domethënë, çdonjëri prej dy gjykimeve, është në të vërtetë një gjykim i vetëm.

Gjithashtu, përemri i vetës së tretë i gjinisë mashkullore “*hi*” - “*ai*” në fjalën “*ilejhi*” - “*tek ai*” i referohet ose Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ose gjykimit të tij. Mosvajtjen për t’u gjykuar tek ai, si dhe largimin prej gjykimit të tij, ajeti e hedh plotësisht vetëm mbi atë grup hipokritësh, duke shpresuar se shtresat e tjera nuk janë në atë gradë, sa ta refuzojnë gjykimin e të Dërguarit të All'llahut. Këtu nuk duhet harruar se edhe hipokrizia ka shkallët e veta, ashtu si dhe besimi.

Ajeti i fundit i grupit të ajeteve që janë objekt studimi, shpjegon qartë me tri fraza, rrënjët kryesore dhe faktorët që i shtyjnë hipokritët për të mos iu nënshtruar gjykimit të të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe për të mos iu përgjigjur thirrjes së tij; ajeti njofton se shkak mund të jetë fakti se ata kanë devijuar me zemër nga udhëzimi në rrugën e drejtë, ose dyshojnë e ngurrojnë,

ashtu siç tregon fjala e ajetit: “irtàbù” – “dyshtuan”. Kuptohet se ai që ka ngurrime në besimin e tij, nuk do t’i dorëzohet dhe nuk do t’i nënshtrohet asnjëherë atij besimi.

Shprehja e tretë tregon se sikur ata të mos kishin mohuar dhe të mos kishin dyshtuar, pra sikur të ishin besimtarë, porse ata: **“apo ata dyshojnë dhe kanë frikë se All'illahu dhe i Dërguari i Tij do të gjykojnë me padrejtësi kundër tyre.”**.

Në të njëjtën kohë, qëndrimi i tyre është një kontradiktë e qartë: Si është e mundur për atë që beson në mesazhin me të cilin erdhi Muhammedi (*Paqja dhe bekimet e All'illahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që të kundërshtojë gjykimin e tij dhe gjykimin e All'illahut, duke e akuzuar të Dërguarin e All'illahut për padrejtësi?

Si ka mundësi që All'illahu të bëjë padrejtësi në të drejtën e ndonjërit?

A nuk është padrejtësia pjellë e injorancës, e interesit dhe e mendjemadhësisë?

All'illahu i Lartësuar është i lartë dhe krejtësisht i pastër nga të tilla dukuri të ulëta njerëzore.

Ajeti njofton: **“Por, jo, ata vetë janë të padrejtë.”**.

Hipokritët e dinë se e drejta që kërkojnë nuk u takon; për më tepër, ata e dinë se Profeti më i nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'illahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), nuk ia cënon askujt të drejtën, prandaj nuk i dorëzohen gjykimit të tij.

Për ajetin: **“Mos vallë në zemrat e tyre ka sëmundje, apo ata dyshojnë dhe kanë frikë se All'illahu dhe i Dërguari i Tij do**

të gjykojnë me padrejtësi kundër tyre”, autori i tefsirit “Fij Dhilâlil Kur’ân”, mendon se pyetja e parë e shtruar aty, shërben për të vërtetuar ekzistencën e sëmundjes së hipokrizisë në zemrat e tyre, pasi kjo sëmundje ka ndikim në çështjen e dyshimit në drejtësinë e All'llahut dhe të Profetit të Tij.

Pyetja e dytë shpreh habi: Vallë, si dyshojnë ata në gjykimin e All'llahut, në një kohë kur pretendojnë se janë besimtarë? Mos dyshojnë se All'llahu bën padrejtësi? Ose ata dyshojnë se i Dërguari (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk i ka kompetencat për të vendosur drejtësinë?

Pyetja e tretë bëhet për të hedhur poshtë me neveri punën e tyre, që është e huaj për besimtarët; gjithashtu, me këtë pyetje shprehet qartë edhe kontradikta e tyre diskredituese në mes të pretendimit se janë besimtarë dhe punës që ata bëjnë.

Me të vërtetë, është çudi se si mund të ekzistojë kjo frikë në shpirtin e njeriut! All'llahu është Krijuesi i të gjithëve dhe vetëm Ai është Zoti i botëve. Si mund të dyshojnë njerëzit në gjykimin e Tij? Si është e mundur që All'llahu, me gjykimin e Tij, të gjykojë kundër njërit prej atyre që e ka krijuar Vetë dhe të vendosë padrejtësisht në favor të një krijese tjetër?¹

¹ Tefsiri “Fij Dhilâlil Kur’ân”, vëll. 6, f. 115.

Për frazën e ajetit: **“apo ata dyshojnë”**, autori i këtij tefsiri është shprehur se ajo tregon që ata dyshojnë në drejtësinë e të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ose në gjykimin e tij. Shumë interpretues të tjerë të Kur'anit Famëlartë janë shprehur se kjo frazë e ajetit tregon se ata dyshonin në vetë profetësinë e tij.

Dy hulumtime

1- Sëmundja e hipokrizisë

Nuk është hera e parë që shprehjen *“meredun”* – *“sëmundje”*, Kur'ani e përdor për hipokrizinë. Kjo shprehje është përdorur edhe në ajetin 10 të sures “El Bekare”, gjatë shpjegimit të cilësive të hipokritëve, ku thuhet: **“Në zemrat e tyre ka sëmundje dhe All'llahu e shton edhe më shumë atë sëmundje.”**. Siç e kemi thënë në vëllimin e parë gjatë komentimit të këtij ajeti, hipokrizia është sëmundje dhe devijim nga udhëzimi në rrugën e drejtë; kurse njeriu me zemër të shëndoshë ka vetëm një pamje, që tregon se shpirti dhe trupi i tij janë në harmoni me njëri-tjetrin.

Kur njeriu është besimtar, besimin e tij e shprehin të gjitha pjesët e trupit. Nëse njeriu është jobesimtar, atëherë e jashtëmja dhe e brendshmja e tij zbulojnë mosbesimin dhe devijimin e tij nga udhëzimi.

Kur njeriu hiqet si besimtar dhe në brendësi ka mosbesimin, atëherë ai ka sëmundje në zemrën e tij.

Njerëz të tillë, domethënë hipokritët (*munafikët*), nuk e meritojnë as dashamirësinë e All'lahut e as mëshirën e Tij, për shkak të ngulmimit të tyre në rrugën e devijimit që kanë zgjedhur; këta, All'llahu i ka lënë në gjendjen e tyre, që të sëmuren edhe më shumë.

Në fakt, hipokritët janë grupimi më i rrezikshëm në shoqëri, sepse besimtari nuk e ka të qartë mënyrën se si duhet t'i trajtojë ata. Hipokritët nuk mund të jenë kurrë as shokë e as miq për besimtarin; veç kësaj, ata nuk e shfaqin hapur armiqtësinë e tyre kundër besimtarëve. Hipokritët rrinë në përgjim, që të përfitojnë prej mundësive të besimtarëve. Njëkohësisht, ata bëjnë shumë kujdes që ta ruajnë veten prej ndëshkimit ligjor, i cili zbatohet mbi mohuesit që dalin hapur në mesin e myslimanëve, pasi kanë deklaruar më parë se janë besimtarë. Por hipokritët e fshehin gjendjen e tyre të vërtetë, që është fatale për vetë ata në radhë të parë.

Njerëz të tillë nuk mund të vazhdojnë të ecin në rrugën e tyre për një kohë të gjatë, sepse gjendjen e tyre do ta demaskojë vetë puna e tyre dhe nga ëndërrimet që ata kanë brenda, do të dalë në shesh ajo që fshehin, ashtu siç njoftohet në ajetet që janë objekt studimi dhe ashtu siç e pamë edhe në shkakun e zbritjes së këtyre ajeteve, kur në saje të një procesi gjyqësor, u diskreditua puna e tyre dhe u zbulua edhe e keqja që mbanin të fshehur.¹

¹ Për më shumë sqarime rreth cilësive të hipokritëve, lexo tefsirin "El Emthel", në fillim të sures "El Bekare" në ajetin 10 dhe në ajetet vijuese pas tij.

2- Qeverisje e drejtë është vetëm qeverisja hyjnore

Njeriu, sado që të punojë për të edukuar e për të pastruar vetveten prej veseve të ulëta dhe në veçanti prej mendjemadhësisë (*kibrit*), urrejtjes dhe egoizmit, do të sprovohet patjetër me ndonjërin nga këto vese të këqija edhe pa dashjen e tij, me përjashtim të atyre, të cilëve All'llahu i Lartësuar ua ka mundësuar të ruhen prej gabimeve dhe prej punëve të këqija.

Për këtë, themi se vetëm All'llahu është Ligjvënësi i vërtetë, i Cili ka dituri absolute për nevojat e njeriut. Ai ka dijeni të plota edhe për rrugët se si plotësohen këto nevoja. Vetëm Ai nuk gabon asnjëherë e nuk devijon, për shkak se mund të priret kah dashuria, apo zemërimi, cilësi këto që nuk mund të përshkruhen për të Gjithëfuqishmin e Madhëruar.

Gjykimi i All'llahut dhe i Profetit është gjykimi më i mirë. Për gjykim të drejtë në mes të njerëzve u karakterizua edhe brezi i dytë i myslimanëve (*tabi'inët*), pasardhësit e sahabëve të nderuar. *Tabi'inët* ecën në rrugën e atyre që u mbështetën vetëm në All'llahun, duke përjashtuar ata që u prekën nga "sëmundja" e mendjemadhësisë dhe e dashurisë për vetveten. Është e kuptueshme se një i sëmurë i tillë nuk mund të kryejë me përpikmëri punën e gjykimit, sepse ai priret të gjykojë vetëm sipas asaj rruge që mund të ngopë ambiciet e dëshirat e tij. Sa e bukur është fraza e përdorur në këtë ajet, kur i përshkruan këta njerëz: **"Por, jo, ata vetë janë të padrejtë!"**.

Gjithashtu, edhe kalimi nëpër një provim të tillë, është argument që vërteton besimin ose mosbesimin e njeriut.

Për çështjen që po trajtojmë është shumë domethënëse edhe fjala e ajetit 65 të sures “En Nisa”, ku përshkruhen disa karakteristika të hipokritëve: **“Jo, betohem në Zotin tënd, ata nuk kanë besuar, derisa të të zgjedhin ty për të gjykuar konfliktet që kanë në mes tyre dhe pastaj nuk ndihen të pakënaqur me gjykimin tënd dhe të binden sinqerisht.”**.

Besimtarët e vërtetë, jo vetëm që janë të kënaqur me gjykimin tënd, por ata e dorëzojnë veten në dorën tënde, edhe nëse gjykimi yt nuk është në favorin e tyre.

Kurse hipokritët nuk janë të kënaqur kurrë me gjykimin e All'llahut dhe të Dërguarit të Tij (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*); ata mbeten të kënaqur vetëm atëherë kur u realizohen interesat, pasi janë robër të tyre dhe, ndonëse pretendojnë se janë besimtarë, në të vërtetë, ata janë idhujtarë (*mushrikë*).

Ajetet 51 - 54

◆✌️📦♦️🔔 ◆🔔🔒📦📖 📖🔒🔒🔒🔒🔒🔒
 ✌️♦️🔔🔔 ◆✕✓🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒
 ★✍️📖✌️ 7📦📖🔔 📞✌️📦📦🔒🔒🔒⑩
 ◆📖🔒🔒🔒🔒♦️🔔🔒🔒 🕒🔒📖🔒✍️📦🔒🔒◆⑥◆📦
 📞✌️📦🔒🔒📦🔒→🔔◆③ 📖📦📖 🔒🔒🔒🔒📦🔒🔒④◆📖
 📖 📖◆🔒🔒→♦️📦📖◆📦 📖◆🔒🔒→🔒🔒🔒🔒🔒
 🔒🔒→🔒 📖🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒
 📖◆🔒◆📦 📖🔒🔒🔒 ◆📖🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒
 🕒🔒📖♦️✍️📦🔒🔒◆⑥◆📦 ✌️✍️📖✌️ 📖🔒🔒🔒🔒③
 🔒🔒🔒🔒🔒🔒◆③◆📦 ✌️✍️📖✌️ 🕒🔒🔒③♦️⑥◆📦
 🔒🔒→🔒 📖🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒
 📖 📖🔒🔒🔒 ◆📖🔒🔒🔒🔒✌️📖🔒🔒🔒🔒
 ★✍️📖📖🔒🔒 📞✌️📦🔒🔒🔒🔒🔒◆📦
 🔒✌️🔒🔒🔒 🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒 📖🔒🔒🔒🔒🔒
 📞 🕒🔒🔒🔒🔒②🔒②◆①🔒 🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒
 🔒◆🔒🔒🔒🔒 📞 📞✌️📦🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒 🔒🔒🔒🔒
 ✌️✍️📖✌️ 📖🔒🔒 📖 🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒→🔒🔒
 ◆📖🔒→🔒🔒🔒🔒🔒→♦️🔒 📖🔒🔒🔒🔒 🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒
 ✌️✍️📖✌️ 📞✌️🔒🔒→🔒🔒🔒🔒🔒 🔒🔒→🔒 📖🔒🔒🔒
 📞 ◆✌️🔒🔒🔒🔒🔒🔒 📞✌️🔒🔒→🔒🔒🔒🔒🔒◆📦
 📖🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒 📞✌️🔒🔒🔒🔒◆📦🔒 🔒🔒🔒🔒
 🔒→🔒🔒🔒🔒◆🔒 🔒🔒🔒🔒🔒 🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒
 📖🔒🔒◆📦 📞 🔒🔒🔒🔒🔒🔒🔒 📖🔒🔒
 📖 📞✌️🔒🔒🔒🔒🔒🔒 🔒🔒🔒🔒 📖🔒🔒◆📦



“Kur thirren besimtarët për t’u gjykuar ndërmjet tyre tek All'llahu dhe tek i Dërguari i Tij, ata vetëm thonë: dëgjuam dhe u bindëm; të tillë janë të shpëtuarit.”

“Kush i bindet All'llahut dhe të Dërguarit të All'llahut, ka frikë vetëm All'llahun dhe i përmbahet udhëzimit të Tij, të këtyllë janë fituesit.”

“Ata (hipokritët) betohen me të madhe në All'llahun, nëse ti i urdhëron, ata patjetër do të dalin (të luftojnë); thuaj: mos u betoni, bindja (juaj) është e njohur, All'llahu ka dijeni të plotë për punët tuaja.”

“Thuaj: bindjuni All'llahut dhe bindjuni të Dërguarit, nëse ata kundërshtojnë, secili mban përgjegjësinë me të cilën është ngarkuar, edhe ju mbani përgjegjësi për atë që jeni ngarkuar; nëse i bindeni atij (të Dërguarit), jeni udhëzuar në rrugën e drejtë; i Dërguari s’ka asnjë obligim, përveçse të kumtojë (mesazhin) qartë.”

Komentimi

Besimi dhe dorëzimi i plotë tek All'llahu

Në ajetet para të këtij grupi ajetesh, ne pamë reagimin e hipokritëve, zemrat e të cilëve janë nxirë dhe janë bërë errësirë mbi errësirat. Gjithashtu, pamë se ata nuk i nënshtrohen gjykimit të All'Ilahut dhe të Dërguarit të Tij, nga frika që kishin se All'Ilahu dhe i Dërguari i Tij do të bënëin padrejtësi ndaj tyre dhe nga kjo, ata do të humbnin të drejtën që pretendonin se u takonte.

Ndërsa ajetet që janë objekt studimi, shpjegojnë qëndrimin e besimtarëve ndaj gjykimit të All'Ilahut dhe të Dërguarit të Tij: **“Kur thirren besimtarët për t’u gjykuar ndërmjet tyre tek All'Ilahu dhe tek i Dërguari i Tij, ata vetëm thonë: dëgjuam dhe u bindëm.”**.

“Dëgjuam dhe u bindëm!” - Sa e bukur dhe sa dobiprurëse është kjo shprehje e shkurtër!

Në fillim të ajetit ka ardhur fjala *“in’nemà”* – **“në të vërtetë”** e cila, kur vihet në krye të fjalisë, tregon se është vetëm kështu dhe jo në ndonjë mënyrë tjetër; pra, kjo e kufizon fjalën e besimtarëve vetëm në frazën që ata thanë: **“dëgjuam dhe u bindëm”**. Në realitet, besimi është vetëm brenda këtyre dy fjalëve.

Si është e mundur që një njeri të bëjë që peshorja e gjykimit në mes dy vetëve, të anojë në kundërshtim me gjykimin e All'Ilahut, në një kohë kur ai që gjykon e di mirë se All'Ilahu i Lartësuar ka dijeni të plotë për çdo send dhe se Ai s’ka nevojë për asnjë? Në të njëjtën kohë, ai e di mirë se All'Ilahu është i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti. Një njeri i tillë nuk mund të veprojë ndryshe ndaj gjykimit të All'Ilahut, përveçse të thotë këto dy fjalë: **“dëgjova dhe u binda”**.

Sa mjet i bukur që janë këto dy fjalë për të vënë në provim besimtarët e vërtetë dhe suksesin e tyre në të! Pikërisht për të gjitha këto, ajeti e mbyll bisedën me njoftimin: **“të këtillë janë të shpëtuarit”**.

Pa dyshim që shpëtimi i takon njeriut, që e ka dorëzuar punën e tij vetëm në dorën e All'llahut dhe beson në drejtësinë e në gjykimin e Tij për jetën e vet materiale e morale.

Ajeti i dytë i këtij grupi ajetesh, thotë: **“Kush i bindet All'llahut dhe të Dërguarit të All'llahut, ka frikë vetëm All'llahun dhe i përmbahet udhëzimit të Tij, të këtillë janë fituesit.”**.

Konkretisht, ajeti i përshkruan të bindurit e devotshëm duke njoftuar se ata janë fitues, ashtu siç i përshkruante ajeti i parë ata që i nënshtroheshin gjykimin të All'llahut dhe gjykimin të të Dërguarit të Tij, duke njoftuar se ata janë të shpëtuarit.

Bazuar në burimet gjuhësore, fjala e ajetit të parë *“elmuflihùne”* – **“të shpëtuarit”** dhe fjala e ajetit të dytë *“elfaizùne”* – **“fituesit”** kanë afërsisht të njëjtin kuptim. Kurse Ràgib El Esfehànij, në fjalorin e tij të fjalëve të Kur'anit, për fjalën e ajetit të dytë, **“fituesit”**, thotë: kjo fjalë ka kuptimin “fitore në të mirën dhe arritje e shpëtimit”; kurse për fjalën e ajetit të parë, **“të shpëtuarit”**, thotë: kjo fjalë ka kuptimin: “fitore dhe arritje e dëshirës dhe e qëllimit” {(në origjinë, fjala *“elmuflihùne”* – **“të shpëtuarit”** ka kuptimin *“çarje”* dhe, meqenëse të shpëtuarit çajnë rrugën e tyre drejt qëllimit që kanë dhe i heqin të gjitha pengesat, fjala *“shpëtim”* (në gjuhën arabe *“felàh”*) përdoret edhe për fitoren (në gjuhën arabe *“feuz”*); por meqenëse fjala *“fitore”* në këtë ajet, përdoret për bindjen pa kushte, në ajetin e parë fjala *“shpëtim”*

përdoret për dorëzimin para gjyqimit të All'llahut)); pra, njëra fjalë është në kuptimin e përgjithshëm, ndërsa fjala tjetër në kuptimin e veçantë. Prandaj, rezultati për të dyja fjalët është vetëm një.

Në ajetin që është objekt studimi, për fituesit janë përmendur tri cilësi: ata i binden All'llahut dhe të Dërguarit, kanë frikë vetëm All'llahun dhe i përmbahen udhëzimit të Tij.

Disa interpretues të Kur'anit kanë thënë se fjala “*bindje*” ka një kuptim të përgjithshëm; fjala “*frikë*” është dega e brendshme e fjalës “*bindje*”, kurse fraza “*i përmbahen udhëzimit të Tij*”, është degë e jashtme e bindjes. Në fillim, ajeti flet për bindjen në mënyrë të përgjithshme dhe pastaj për kuptimin e jashtëm e të brendshëm të kësaj fjale.

Domethënia e ajetit vijues dhe shkaku i zbritjes së këtij grupi ajetesh, sipas asaj që kanë thënë disa interpretues të Kur'anit, patën një ndikim shumë të madh të disa hipokritë. Duke marrë parasysh gjendjen e tyre, sidomos pas zbritjes së këtij grupi ajetesh, ku hipokritët qortohen rëndë, ata shkuan te Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe u betuan me të madhe para tij, duke thënë: “Çështjen tonë e kemi dorëzuar në dorën tënde!”; por Kur'ani Famëllartë u përgjigjet hipokritëve në mënyrë të prerë: “**Ata (hipokritët) betohen me të madhe në All'llahun, nëse ti i urdhëron, ata patjetër do të dalin (të luftojnë)**”, pra do të dalin në sheshin e betejës e të luftojnë në rrugën e All'llahut, ose do të lënë shtëpitë e pasuritë e tyre. Ajeti e urdhëron Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që t'u thotë hipokritëve se nuk është nevoja të betohen, por të punojnë në bindje të All'llahut me sinqeritet.

Ajeti njofton: **“thua: mos u betoni, bindja (juaj) është e njohur, All'lahu ka dijeni të plotë për punët tuaja.”**.

Për fjalën e ajetit *“lejahkruxhen’ne”* - **“patjetër do të dalin”**, shumë interpretues të Kur’anit kanë thënë se qëllimi është dalja në luftë në rrugën e All'lahut; por disa interpretues të tjerë të Kur’anit mendojnë se me këtë frazë, qëllimi është që ata të mos humbnin pasurinë dhe jetën, por vetëm të ndiqnin të Dërguarin (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kudo që ai të udhëtonte. Me këtë, ai do të pranonte se ata ishin të bindur ndaj tij.

Fjala **“patjetër do të dalin”** dhe derivatet e saj në Kur’anin Famëlartë, herë kanë ardhur në kuptimin e daljes në luftë në rrugën e All'lahut e herë në kuptimin e lënies së shtëpisë dhe të vendbanimit për hir të All'lahut të Lartësuar; porse ajetet e mëparshme, që flisnin për gjykimin e të Dërguarit të All'lahut (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) si dhe për problemet e ndryshme që kishin hipokritët, na bëjnë të pranojmë interpretimin e dytë, në kuptimin se hipokritët shkuan te Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që të shprehnin bindjen ndaj gjykimit të tij e të dorëzonin punët e tyre tek ai dhe, për këtë, ata u betuan me të madhe se do të jepnin një pjesë të pasurive të tyre e nëse ai i urdhëronte, do të hiqnin dorë nga jeta e kësaj bote.

Nuk ka asgjë që të pengojë bashkimin midis dy interpretimeve; pra ata shprehën gatishmërinë e tyre për të hequr dorë prej pasurive e prej familjeve të tyre dhe se do të dilnin të luftonin e të flijoheshin në rrugën e All'lahut.

Por meqenëse hipokritët e ndryshojnë qëndrimin sipas situatave që ndodhin në shoqëri, ti i shikon ata të betohen kaq shumë, saqë të krijohet bindja se me betimet e tyre, ata në të vërtetë janë gënjeshtarë. Kur'ani Famëlartë u përgjigjet atyre qartë: S'është nevoja të betoheni, por duhet të argumentoni patjetër të vërtetën e betimeve tuaja me punë, sepse All'llahu ka dijeni të plotë për atë që ju bëni; All'llahu e di mirë se ju gënjeni me betimet tuaja dhe se në të vërtetë, s'keni qëllim të vendosni rregull në gjendjen tuaj reale.

Prandaj, ajeti i fundit i këtij grupi ajetesh e thekson qartë këtë kuptim dhe e urdhëron të Dërguarin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me këto fjalë: **“Thuaj: bindjuni All'llahut dhe bindjuni të Dërguarit.”**.

Pastaj, ajeti njofton: **“nëse ata kundërshtojnë, secili mban përgjegjësinë me të cilën është ngarkuar, edhe ju mbani përgjegjësi për atë që jeni ngarkuar.”**.

Nga këndvështrimi i kundërshtimit të All'llahut, secili prej atyre mban përgjegjësi, por edhe ju mbani përgjegjësi për punët tuaja, në një kohë kur detyra juaj është që të tregoni bindje të plotë ndaj Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe: **“nëse i bindeni atij (Profetit), jeni udhëzuar në rrugën e drejtë”**, sepse ai është drejtues dhe nuk bën thirrje tjetër përveçse për të hyrë në rrugën e All'llahut, në rrugën e së vërtetës, në rrugën e drejtë.

Në fund, ajeti njofton se gjithsesi, ai (i Dërguari): **“i Dërguari s'ka asnjë obligim, përveçse të kumtojë (mesazhin) qartë.”**.

Profeti është i obliguar t'u kumtojë të gjithëve gjithçka që All'llahu e ka urdhëruar dhe, nëse ata i binden, kanë përfituar; por nëse ata nuk i binden atij, kanë pësuar humbje, sepse Profeti nuk është urdhëruar t'i detyrojë njerëzit që të hyjnë në udhëzimin e rrugës së drejtë dhe të pranojnë thirrjen e tij.

Në këtë ajet të tërheq vëmendjen fjala **“përgjegjësi”**, e shprehur me frazën *“mà hum'mile”* - **“barrë e rëndë”**; por ky është realiteti, sepse mesazhi me të cilin u ngarkua Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e ngarkonte atë t'ua kumtonte njerëzve këtë mesazh dhe e bënte detyrim edhe për njerëzit që t'i bindeshin atij. Në të vërtetë, kjo ishte një përgjegjësi, barrën e së cilës mund ta mbajnë vetëm ata që janë të sinqertë në besimin e tyre.

Në lidhje me këtë çështje, Imam Bakiri përcjell një hadith prej Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ku thuhet: *“Ju që lexoni Kur'anin, kijeni frikë All'llahun e Lartësuar për përgjegjësinë që Ai u ka dhënë për Librin e Tij! Unë kam përgjegjësi, por edhe ju keni përgjegjësi; unë kam përgjegjësi të kumtoj mesazhin, kurse ju do të pyeteni për përgjegjësinë që u ngarkon Libri i All'llahut dhe syneti im (puna dhe fjala ime).”*.

“Atyre prej jush që besuan dhe bënë punë të mira, All'llahu u premtoi se do t’i bëjë sundues në tokë, ashtu siç pati bërë sundues ata që ishin para tyre; Ai do të mundësojë për ata fenë që Ai ka zgjedhur të jetë feja e tyre dhe në vend të frikës, atyre do t’u dhurojë siguri; ata më adhurojnë Mua dhe nuk më vënë Mua shok asnjë send dhe, kush mohon pas kësaj, të këtillë janë të degjeneruarit.”

Shkaku i zbritjes

Në tefsiret e tyre, interpretuesit e Kur’anit, ndër të cilët Sejuti’ji në “Esbàbun Nuzùl”, Et Tabresiji në “Mexhmaul Bejjan”, Sej’ji Kutub në “Fij Dhilàlil Kur’àn” dhe Kurtubij’ji në tefsirin e tij, janë shprehur (me disa ndryshime) për shkakun e zbritjes së këtij ajeti, duke thënë: “Kur i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) së bashku me myslimanët, emigruan në Medine, ensarët (myslimanët e Medines) u uruan atyre mirëseardhjen; nga ana e tyre, arabët idhujtarë formuan një koalicion kundër myslimanëve. Në këto kushte, myslimanët ishin të detyruar të vigjilonin ditë-natë, me armë në dorë, dhe të qëndronin në gjendje gatishmërie të përhershme. Kjo gjendje ishte aq e rëndë për ta, saqë disa prej tyre filluan të pyesnin njëri-tjetrin se deri kur do të vazhdonte ashtu. A do të vinte ajo ditë, kur ata do të pushonin, kur shpirtrat e tyre të ishin të sigurtë dhe të kishin frikë vetëm prej All'llahut? Ndërkaq

zbriti ajeti që është objekt studimi. Ky ajet u jep atyre sihariqin, se shumë shpejt do të realizohet ajo që ata dëshironin.¹

Komentimi

Qeverisja botërore e të pafuqishmëve

Ajetet e mësipërme flisnin për bindjen ndaj All'Ilahut, ndaj të Dërguarit të Tij dhe të dorëzimit të punëve në dorën e tij. Edhe ajeti që është objekt studimi e vazhdon këtë temë, duke shpjeguar edhe rezultatin e bindjes, që është krijimi i qeverisjes botërore, të cilën All'Ilahu ua premtonte besimtarëve. Këtë premtim, ajeti e përforcon me fjalën e të Lartit: **“Atyre prej jush që besuan dhe bënë punë të mira, All'Ilahu u premtoi se do t'i bëjë sundues në tokë, ashtu siç pati bërë sundues ata që ishin para tyre; Ai patjetër do të mundësojë për ata fenë që Ai ka zgjedhur të jetë feja e tyre”**; domethënë qeverisjen e premtuar, Ai do ta bëjë me rrënjë të forta, të stabilizuar dhe të fuqishme në mes të gjithë popujve të botës. Gjithashtu, ajeti njofton: **“dhe në vend të frikës, atyre do t'u dhurojë siguri; ata më adhurojnë Mua dhe nuk më vënë Mua shok asnjë send”** - dhe pasi qeverisja e Njësimit të All'Ilahut (*Teuhidit*), të jetë bërë sunduese në të gjithë botën, ajo do të zbatojë dispozitat hyjnore, do të vendosë sigurinë dhe do të

¹ Tefsiri “Esbàbun Nuzûli” f. 163; tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 7, f. 152; tefsiri i “Kurtubij'jit”; tefsiri “Fij Dhilâlil Kur'an”, fundi i ajetit që është objekt studimi.

shkulë idhujtarinë. Në vijim, në ajet thuhet: **“dhe, kush mohon pas kësaj, të këtillë janë të degjeneruarit.”**.

Duket qartë se në këtë ajet, grupit të myslimanëve që cilësohen si besimtarë dhe punëmirë, All'llahu u jep tre sihariqe:

1- Ata dhe qeverisjen e tyre, Ai do t'i bëjë sundues në të gjithë tokën.

2- Përhapja e mësimëve të All'llahut kudo, ashtu siç mësohet prej ajetit *“ue lijumek'kinen'ne”* - **“Ai patjetër do të mundësojë”**.

3- Nuk do të ketë asnjë faktor që ngjall frikë e trazim.

Nga të gjitha këto kuptime të ajetit, del qartë se All'llahu do t'i kthejë të gjitha liritë dhe do të mundësojë zbatimin e mësimëve të Tij; askush nuk do t'i bëjë All'llahut shok e ortak dhe në çdo vend do të plotësohet përhapja e *Teuhidit* (besimi se All'llahu është Zoti Një dhe i Vetëm).

Gjatë trajtimit të kësaj çështjeje, do të bëhet e qartë se ku është plotësuar ky premtim i All'llahut, ose kur do të plotësohet.

Hulumtime

1- Komentimi i frazës: “ashtu siç pati bërë sundues ata që ishin para tyre”

Në mesin e interpretuesve të Kur'anit ka mendime të ndryshme rreth myslimanëve, për të cilët ajeti i nderuar tregon se u bënë sundues të tokës.

Disa prej interpretuesve mendojnë se ata janë: Ademi, Daudi dhe Sulejmani (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!*), sepse në ajetin 30 të sures "El Bekare", në lidhje me Ademin (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), All'llahu njofton: **"Unë po vë në tokë një sundues"**; në ajetin 26 të sures "Sàd" në lidhje me Daudin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), thuhet: **"O Daud, Ne të kemi bërë sundues mbi tokë"**; dhe për Sulejmanin (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) që e trashëgoi sundimin prej Daudit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), në ajetin 16 të sures "En Neml" thuhet: **"u bë sundues në tokë"**.

Dijetari poliedrik Et Tabàtànij, në tefsirin "El Mizàn", e kundërshton këtë kuptim dhe mendon se fraza **"ata që ishin para tyre"**, nuk është në përputhje me pozitën e Profetëve, sepse në Kur'anin Famëlartë nuk ka ardhur si shprehje e veçantë për ta, por tregon popujt e kaluar që ishin në atë gradë besimi dhe bënin punë aq të mira, saqë All'llahu i bëri sundues në tokë.

Interpretues të tjerë të Kur'anit Famëlartë mendojnë se ky ajet njofton për Beni Israilët, të cilët u bënë sundues në tokë pas ardhjes së Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe pas shkatërrimit të Faraonit dhe ndjekësve të tij, ashtu siç thuhet në ajetin 137 të sures "El A'ràf": **"Popullin që ishte i nënshtruar, Ne e bëmë trashëgimtar të lindjes e të perëndimit, tokës të cilën Ne e bekuam (me të mira)"**; kurse në ajetin 6 të sures "El Kasas", Kur'ani njofton: **"Dhe atyre t'u japim pushtet në tokë"**, domethënë: *ata që ishin të pafuqishëm, Ne i bëmë sundues në tokë*.

Padyshim që ndër Beni Israilët, madje edhe në kohën e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) kishte njerëz që e pohonin vetë se nuk ishin besimtarë, por sundimi ishte në dorën e besimtarëve punëmirë (me këtë shpjegim mundësohet eliminimi i problemit, në të cilin janë ngatërruar disa interpretues mbi komentimin e këtij ajeti). Nga të gjitha këto interpretime, del qartë se interpretimi i tretë është më afër të vërtetës.

2- Atyre që All'llahu u ka premtuar sundimin në tokë

Besimtarëve punëmirë, All'llahu u ka premtuar se ata do të jenë sundues në tokë, se feja e tyre do të përhapet kudo dhe se ata do të gëzojnë siguri të plotë. Shtrohet pyetja: Çfarë cilësish të veçanta kanë personat që u është premtuar sundimi?

Në mesin e interpretuesve të Kur'anit ka mendime të ndryshme në lidhje me këtë çështje. Disa mendojnë se premtimi për sundim është i veçantë për sahabët e të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), të cilët All'llahu i bëri sundues në tokë në kohën e vetë Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), (kjo frazë e ajetit nuk duhet kuptuar se i bëri sundues mbi të gjithë tokën, pasi në gjuhën arabe edhe për një pjesë, thuhet e gjitha).

Interpretues të tjerë të Kur'anit mendojnë se sundimi i premtuar është vetëm për katër kalifët që u bënë sundimtarë pas të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Disa të tjerë mendojnë se kuptimi i këtij ajeti është i gjerë dhe përfshin të gjithë myslimanët e përshkruar me këto cilësi.

Të tjerë mendojnë se ajeti jep shenjë për qeverisjen e Mehdiut (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), ndaj të cilit do të jenë të nënshtruara lindja dhe perëndimi i botës. Në kohën e Mehdiut (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), sunduese do të jetë e vërteta në të gjitha anët e botës dhe do të asgjësohet trazimi, frika e luftrat. Për njerëzimin do të bëhet realitet adhurimi i pastër prej çdo lloj idhujtarie dhe ai adhurim do të jetë vetëm për All'llahun e Lartësuar.

Krahas kësaj që u tha, s'ka asnjë argument që e ndalon të thuhet se kuptimi i këtij ajeti është përgjithësues. Në këtë përfundim arrihet prej forcimit të bazave të besimit (*imanit*) e të punës së mirë në mesin e myslimanëve në çdo kohë. Gjithashtu, ajeti tregon se myslimanët do të jenë shumicë dhe se sundimi i tyre do të ketë baza të qëndrueshme.

Ata që kanë thënë se fjala e ajetit "*elerd*" - "**tokë**" përdoret për tokën në përgjithësi, tokën pa asnjë kufizim, domethënë përfshin të gjithë globin, me këtë interpretim kanë për qëllim qeverisjen e Mehdiut (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Mirëpo ky interpretim nuk është në përputhje me frazën e ajetit "**ashtu siç pati bërë sundues ata që ishin para tyre**", çka do të thotë se edhe qeverisja e të mëparshmëve, sigurisht që nuk përfshinte mbarë tokën.

Përveç kësaj, edhe shkaku i zbritjes së këtij ajeti e shpjegon qartë arrijten e këtij sundimi në kohën e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), megjithëse ky sundim ka ndodhur nga fundi i jetës së tij.

Rezultat i punës dhe i përpjekjeve të të gjithë Profetëve dhe të Dërguarve është arritja e një sundimi, ku zotërues është *Teuhidi* (besimi se All'llahu është Zoti Një dhe i Vetëm), siguria e plotë dhe adhurimi i kushtuar vetëm ndaj All'llahut dhe i zhveshur nga çdo lloj idhujtarie. Ky sundim do të bëhet realitet me daljen e Mehdiut (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), parardhësit e të cilit janë Profetët. Mehdiu (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) është nip i Profetit më të nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Ky është edhe qëllimi i hadithit të ardhur prej të Dërguarit të All'llahut dhe që qarkullon në mesin e të gjithë myslimanëve: *“Sikur nga kjo botë të ketë mbetur edhe një ditë e vetme, All'llahu e zgjat atë, derisa të vijë një njeri prej familjes time, emri i të cilit është si emri im; ai do ta mbushë botën me drejtësi, ashtu siç ishte e mbushur para tij me imoralitet e padrejtësi”*.¹

Edhe më sipër kemi thënë se këto interpretime të mbështetura në transmetimet islame nuk e kufizojnë kuptimin e ajetit, por janë shpjegim i një kriteri të përgjithshëm; prandaj të vjen keq të shikosh se, kur e kanë trajtuar këtë çështje, disa interpretues të Kur'anit si El Alūsij'ji në “Ruhul Bejân”, i kanë refuzuar këto hadithe e transmetime.

Interpretuesi i njohur synit i Kur'anit Famëlartë, Kurtubij'ji, transmeton një hadith të përcjellë nga Mikdād bin El Esvedit, i cili tregon se i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut*

¹ Në librin “Muntekhabul Ethereh” thuhet se ka më shumë se 123 hadithe e transmetime për këtë çështje prej burimeve të ndryshme islame, sidomos prej burimeve të synitëve. Për më shumë informacion, lexo në këtë libër, në faqen 247 e më poshtë.

qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: “Nuk do të ketë shtëpi mbi sipërfaqen e tokës, në qytete e në fshatra, ku All'llahu të mos fusë në të fjalën e Islamit”.¹

Për më shumë shpjegime rreth qeverisjes së Mehdiut (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe për komentet që janë bërë në lidhje me të në librat e synitëve dhe të shiitëve, lexo komentimin e ajetit 32 të sures “Et Teube” të këtij tefsiri.

4- Objektivi përfundimtar i adhurimit të singertë

Në të vërtetë, fraza ajetit “**ata më adhurojnë Mua dhe nuk më vënë Mua shok asnjë send**”, nga ana letrare, është e njëjtë, qoftë kur ajo merret në kuptimin e kohës së tashme, qoftë kur merret në kuptimin e kohës së ardhme; në të dyja kohët, objektivi përfundimtar mbetet gjithnjë përgatitja për ndërtimin e një qeverisjeje të drejtë me themele të forta, qeverisje me të cilën do të përhapet e vërteta dhe do të ketë siguri të plotë. Kjo qeverisje do të jetë e fortifikuar në themelet e saj, të cilat do të bazohen në adhurimin vetëm ndaj All'llahut dhe në besimin se All'llahu është Zoti Një dhe i Vetëm (*Teuhid*), ashtu siç është përmendur edhe në ajete të tjera të Kur'anit Famëlartë. Në Kur'an shpjegohet qëllimi kryesor i krijimit, ashtu siç thuhet në ajetin 56 të sures “Edh

¹ Tefsiri i “Kurtubij’jit”, vëll. 7, f. 4292.

Dhàrijàt’’: “Unë nuk i krijova xhinët e njerëzit për ndonjë gjë tjetër, përveçse të më adhurojnë Mua.”.

Objektivi më i lartë i këtij adhurimi është edukimi i njerëzve dhe lartësimi i tyre shpirtëror. All'llahu s’ka nevojë për adhurimin e njerëzve, por janë njerëzit që kanë nevojë ta adhurojnë All'llahun gjatë gjithë jetës së tyre.

Bazuar mbi këtë të vërtetë, mendimi islam nuk është si mendimet materialiste, që synojnë vetëm përfitimet materiale dhe mirëqenien në këtë jetë. Jeta materiale në Islam është një vlerë nëse ajo bëhet mjet për realizimin e një qëllimi të lartë moral. Qëllimi me përfitimet materiale është që të bëhet kujdes i madh që adhurimi të jetë i pastër nga ferrat e idhujtarisë, pasi adhurimi i pastër dhe i sinqertë vetëm për All'llahun e Lartësuar, është e kundërta e plotësimit të dëshirave dhe të instinkteve. Është e kuptueshme se ky adhurim krejtësisht i pastër, mund të realizohet vetëm nën sundimin e një qeverisjeje të drejtë.


Formimi i një qeverie të tillë arrihet duke u afruar një grup njerëzish në anën e së vërtetës nëpërmjet edukimit, arsimimit dhe kumtimit të vazhdueshëm të Mesazhit Islam. Kjo gjë mund të realizohet vetëm nën pushtetin e një qeverisjeje të drejtë, të cilën e drejtojnë besimtarët punëmirë. Të gjithë Profetët (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!*) kanë punuar për formimin e një qeverisjeje të tillë, sidomos i Dërguari më i respektuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili sapo mbërriti në Medinen e ndritur, formoi një model të kësaj qeverie.

Nga sa u tha më lart, mund të dalim në përfundimin se zgjidhja e plotë e të gjitha problemeve (lufta, paqja, programet

arsimorë, ekonomike e ushtarake) bëhet realitet vetëm nën drejtimin e një qeverie të tillë dhe në sajë të adhurimit kushtuar vetëm All'llahut, adhurim në të cilin s'ka asnjë gjemb prej gjembave të idhujtarisë.

Kjo nuk do të thotë se nën pushtetin e një qeverie të drejtuar prej besimtarëve punëmirë, të cilëve All'Ilahu u ka mundësuar të përhapin të vërtetën, drejtësinë dhe adhurimin e pastruar prej formave të idhujtarisë, në tokë nuk do të ketë as faktorë e as prej atyre që devijojnë nga udhëzimi. Jo! Ajeti tregon se kjo qeveri do të drejtohet prej besimtarëve punëmirë dhe në të s'ka më vend për idhujtarinë. Por meqenëse njeriu është krijuar i lirë, devijimi nga rruga e drejtë do të jetë i pranishëm edhe në shoqëritë më të mira njerëzore.

Ajetet 56 - 57



“Falemi namazin, jepni zeqatin dhe bindjuni të Dërguarit, kështu do të mëshiroheni.”

“Dhe kurrë mos mendo se ata që nuk besojnë janë të pathyeshëm në këtë jetë, vendi i tyre është zjarri, sa përfundim i keq është ai.”

Komentimi

Pamundësia për të ikur prej gjykimit të të Lartit

Ajeti i mëparshëm u premtonte besimtarëve punëmirë se do të ishin sundues në tokë, kurse dy ajetet që janë objekt studimi, i përgatisin ata që të punojnë për këtë qeverisje, pa marrë parasysh pengesat e mëdha që do të dalin para realizimit të kësaj kauze, pasi ajo ka suksesin në brendi të saj. Në fakt, njëri prej këtyre dy ajeteve vërteton kërkesën dhe ajeti tjetër vërteton pengesën. Në fillim, ajeti urdhëron: *“Ue ekijmus’salâte”* - **“Falemi namazin”**; sepse namazi është mjeti që forcon lidhjen mes Krijuesit dhe krijesës, i afron njerëzit te Zoti i tyre dhe i ndalon të mos kalojnë në imoralitet, apo të bëjnë punë të urryera.

“ue à`tuz’zekâte” - **“jepni zekatin”**. Zekati është mjeti që e lidh njeriun me vëllain e tij njeri, i pakëson faktorët ndarës në mes të pasurve dhe të varfërve dhe i forcon lidhjet e simpatisë mes tyre.

Ajeti urdhëron që për çdo punë të ndiqet i Dërguari (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): **“dhe**

bindjuni të Dërguarit"; në saje të kësaj bindjeje, ju do të jeni prej besimtarëve punëmirë, që e meritoni ta keni sundimin në tokë, sepse: **"kështu do të mëshiroheni"** dhe do të jeni prej atyre që meritojnë të mbajnë flamurin e së vërtetës dhe të drejtësisë.

Nëse ju pandehni se armiqtë e fuqishëm dhe kundërshtarët nuk do t'ju lejojnë që ta realizoni atë që All'llahu u ka premtuar, kjo është krejtësisht e pamundur, sepse All'llahu është i Fuqishmi mbi të gjitha sendet dhe vullnetin e Tij nuk e ndalon asgjë. Prandaj: **"Dhe kurrë mos mendo se ata që nuk besojnë janë të pathyeshëm në këtë jetë."** Mohuesit s'kanë mundësi të shpëtojnë prej dënimit të All'llahut në këtë jetë, përveç dënimit që i pret ata në Botën Tjetër, ashtu siç njofton ajeti: **"vendi i tyre është zjarri, sa përfundim i keq është ai."**

Fjala e ajetit *"mu'xhizine"*- **"të pathyeshëm"** ka kuptimin: *zbatues të fuqisë*. Kjo fjalë mund të jetë në kuptimin: dikush ndjek dikë dhe ai i shpëton prej duarve, kështu që i del jashtë pushtetit të tij, për shkak se kapësi u tregua i pafuqishëm. Pikërisht në këtë kuptim është përdorur kjo fjalë në këtë ajet; por edhe ajeti i parë tregon të njëjtin kuptim. Për rrjedhojë, kuptimi i të dy ajeteve është: në të vërtetë, ju nuk keni mundësi të dilni prej pushtetit të All'llahut.

le të kërkojnë leje prej jush (për të hyrë te ju) në tri kohë: para namazit të mëngjesit, në kohën e pushimit të drekës dhe pas namazit të natës; në këto tri kohë ju nuk jeni të veshur; përveç këtyre tri kohëve nuk është mëkat as për ju e as për ata të hyni te njëri-tjetri; kështu i sqaron All'Ilahu për ju argumentet e Tij, All'Ilahu është i Gjithëdituri, i Urti.”

“Kur fëmijët tuaj të arrijnë moshën e pjekurisë, le të kërkojnë leje (për të hyrë te ju) ashtu siç kërquan leje edhe ata para atyre; All'Ilahu shpjegon për ju dispozitat e Veta; All'Ilahu është i Gjithëdituri, i Urti.”

“Edhe për gratë e moshuara që nuk kanë më shpresë për martesë nuk është mëkat të heqin rrobën mbuluese, por duke mos zbuluar bukuritë e veta; megjithëkëtë për ato është më mirë të jenë të përmbajtura; All'Ilahu është Dëgjuesi, i Gjithëdituri.”

Komentimi

Edukata e hyrjes në dhomën e prindërve

Ashtu siç kemi thënë më lart, çështja më e rëndësishme që trajton kjo sure, është ajo e ruajtjes së nderit në përgjithësi dhe luftimi i degjenerimit moral me rrugë të ndryshme.

Ajetet që janë objekt studimi trajtojnë njërën prej çështjeve që kanë lidhje me ruajtjen e virtytit e të nderit dhe shpjegojnë se fëmijët që kanë arritur moshën e pjekurisë seksuale, si edhe ata që nuk e

kanë arritur këtë moshë, duhet të kërkojnë leje për të hyrë në dhomën e prindërve. Për këtë, ajeti në fillim thotë: **“O besimtarë, ata që ju i keni në pronësinë tuaj (shërbyesit) dhe ata prej jush që nuk kanë arritur moshën e pjekurisë (seksuale), le të kërkojnë leje prej jush (për të hyrë te ju) në tri kohë”**; pra, shërbyesit dhe fëmijët tuaj kanë detyrë të kërkojnë leje për të hyrë te ju në tri kohë: **“para namazit të mëngjesit, në kohën e pushimit të drekës dhe pas namazit të natës.”**.

Fjala e ajetit *“edh’dhahijreti”*, siç e ka shpjeguar Ragib El Esfehànij në fjalorin e tij të fjalëve të Kur’anit, si dhe Fijruz Abàdij në fjalorin *“El Kàmùsul Muhijt”*, nënkupton: kohën në gjysmën e ditës, para faljes së namazit të drekës, kur njerëzit zakonisht heqin rrobat e zakonshme e veshin rrobat e dhomës dhe kur burri shkon të pushojë në dhomën bashkëshortore me gruan e tij.

Fjala *“thelàthe merr’rràtin”* – **“në tri kohë”**, domethënë në tri kohët e veçanta kur jeni në intimitetin tuaj.

Fjala e ajetit *“euràt”* është nxjerrë nga rrënja e saj *“el àru”* dhe ka kuptimin *“turp”*. Këtë fjalë, arabët e përdorin për organin gjenital që i thonë *“auret”*, pjesës së trupit që duhet të jetë e mbuluar patjetër, sepse zbulimi i saj është turp.

Fjala *“auret”* ka edhe kuptimin e të çarës në mur, ose në rroba; herë tjetër, kjo fjalë përdoret në kuptimin e përgjithshëm *“turp”*.

Gjithsesi, fjala e ajetit *“euràt”* - tregon pjesët e trupit që duhen mbuluar – dhe përmenden këto tri kohë, për shkak se njerëzit gjatë tyre janë në gjendje të veçantë, domethënë nuk janë të veshur me rrobat që veshin në kohët e tjera.

Ajeti u drejtohet prindërve e të afërmeve të fëmijëve dhe u kujton atyre detyrën që kanë për t'ua mësuar fëmijëve këto rregulla, sepse ata nuk janë në moshën kur obligohen për zbatimin e urdhrave e të ndalesave të ligjit të fesë.

Kur themi se ajeti është gjithëpërfshirës, kemi parasysh se ai përfshin fëmijët, djem e vajza; gjithashtu, edhe përemri lidhor “*el’ledhijne*”- “**të cilët**”, që ka ardhur në numrin shumës dhe në gjininë mashkullore, nuk përbën pengesë që kuptimi i ajetit të jetë përgjithësues, sepse kjo shprehje është përdorur në shumë ajete të tjera të Kur’anit, kur qëllimi është për të treguar shumicën, siç është përdorur në ajetin që bën obligim agjërimin; prandaj, përemri lidhor “*el’ledhijne*”- “**të cilët**” në ajetin e agjërit, i përfshin të gjithë myslimanët. (ajeti 83, sure “El Bekare”.)

Duhet theksuar se ajeti që është objekt studimi flet për fëmijët që dinë të bëjnë dallimin, pra për ata që i njohin çështjet që kanë lidhje me gjininë, që e dinë se çdo të thotë fjala *vende të turpshme* dhe që ato duhen mbuluar; pikërisht për këtë, ajeti i urdhëron fëmijët të kërkojnë leje për të hyrë në dhomën e prindërve të tyre, kur ata kanë arritur moshën dhe kur e kuptojnë shkakun e kërimit të lejes. Vetë fraza e ajetit “*thelàthe merr’rràtin*” - “**në tri kohë**” përbën një dëshmi tjetër për këtë kuptim. Lind pyetja: Kjo dispozitë (e kërimit të lejes), është e veçantë vetëm për shërbyesit meshkuj, apo i përfshin të dyja gjinitë? Ajo çka thuhet hapur në fjalët e ajetit, mbështetet edhe nga hadithe të ndryshme, pra në këtë dispozitë përfshihen si shërbyesit meshkuj ashtu edhe shërbyeset femra.

Ajeti vazhdon me frazën: “**përveç këtyre tri kohëve, nuk është mëkat as për ju e as për ata të hyni te njëri-tjetri**”,

domethënë se nuk është mëkat për ata, që të hyjnë te ju pa leje jashtë tri kohëve të përmendura. Ajeti mbyllet me fjalët: **“kështu i sqaron All'Ilahu për ju argumentet e Tij; All'Ilahu është i Gjithëdituri, i Urti.”**.

Fjala e ajetit *“tav'vâfûne”* - **“të hyjnë”**, është nxjerrë prej fjalës *“tavâf”*, që ka kuptimin: *“rrotullohet rreth një sendi”*, por këtu ka ardhur në formën e mbiemrit të shkallës sipërore për të treguar hyrje-dalje shumë herë.

Meqenëse fraza *“ba'dukum alâ ba'din”* - **“te njëri-tjetri”** ka ardhur pas fjalës *“tav'vâfûne”* - **“të hyjnë”**, kuptimi i fjalisë është: jashtë këtyre tri kohëve, për ju lejohet të hyni te njëri-tjetri dhe t'i shërbeni njëri-tjetrit pa kërkuar leje.

Në librin *“Kenzul Irfân”*, Fadil El Mikdâd thotë: “Kjo frazë e ajetit është një argument që vërteton se nuk është domosdoshmëri të kërkohet leje jashtë tri kohëve të përmendura në ajetin tonë, sepse puna do të vështirësohej nëse fëmijët do të kërkonin leje sa herë që do të hynin te prindërit.¹

Për fëmijët që kanë arritur moshën kur obligohen me detyrimet e fesë, ajeti vijues e shpjegon qartë mënyrën se si duhet të veprojnë: **“Kur fëmijët tuaj të arrijnë moshën e pjekurisë, le të kërkojnë leje (për të hyrë te ju) ashtu siç kërkuar leje edhe ata para atyre.”**.

Fjala e ajetit, *“elhulume”* ka kuptimin *“mendje”* dhe është metaforë që tregon moshën e pjekurisë, mosha në të cilën te njeriu

¹ “Kenzul Irfân”, vëll. 2, f. 225.

fillon të forcohet mendja dhe të menduarit; është mosha që shënon një fazë të re në jetën e tij.

Thuhet se fjala e ajetit “*elhulume*” ka kuptimin “*ëndërr*”, si metaforë për të treguar gjendjen e të riut, kur ai sheh ëndërr se ka arritur moshën e pjekurisë.

Sido që të merret kuptimi i kësaj fjale, prej këtij ajeti mësojmë se dispozita për ata që kanë arritur moshën e pjekurisë, është e ndryshme nga ajo e fëmijëve që nuk e kanë arritur akoma atë moshë. Këta të fundit janë të detyruar të kërkojnë leje për të hyrë në dhomën e prindërve vetëm në këto tri kohë, për shkak se jeta e tyre vazhdon të jetë akoma e lidhur me jetën e të dy prindërve në një shkallë të atillë, që e bën të pamundur për ta të kërkojnë leje për çdo herë. Veç kësaj, ata nuk i njohin akoma ndijimet seksuale; kurse i riu që ka arritur moshën e pjekurisë, e ka detyrim të kërkojë leje për të hyrë te prindërit e tij në të gjitha kohët.

Kjo dispozitë është e veçantë për dhomën ku pushojnë të dy prindërit, por, kur prindi është në dhomën e ndjenjes, aty ku rrinë edhe të tjerë, as për fëmijët që nuk kanë arritur moshën e pjekurisë e as për ata që e kanë arritur këtë moshë, nuk është nevoja të kërkojnë leje për të hyrë.

Gjithashtu, fraza e ajetit: “**ashtu siç kërkuan leje edhe ata para atyre**”, tregon se fëmijët e rritur duhet të kërkojnë leje prej prindërve, për të hyrë në dhomën e tyre. Fraza “*min kablihim* - “**ata para atyre**” ka për qëllim fëmijët që kanë arritur moshën e pjekurisë, pra ata që janë bërë madhorë.

Për të theksuar rëndësinë e madhe të kësaj çështjeje, ajeti mbyllet me këto fjalë: **“kështu i sqaron All'illahu për ju argumentet e Tij, All'illahu është i Gjithëdituri, i Urti.”**.

Është e njëjta shprehje me fundin e ajetit të mëparshëm, pa asnjë ndryshim, me përjashtim të faktit se në ajetin e mëparshëm është përdorur fjala **“argumente”**, ndërsa në këtë ajet është përdorur fjala **“argumentet e Tij”**, por të dyja shprehjet, nga ana e kuptimit s'kanë asnjë dallim.

Karakteristikat dalluese si dhe filozofinë e kësaj dispozite do t'i trajtojmë në fundin e komentimit të këtyre ajeteve.

Në ajetin e fundit të ajeteve që janë objekt studimi, trajtohet një përjashtim prej dispozitës së mbulimit të gruas dhe ky është vetëm për gratë e moshuara. Në lidhje me këtë përjashtim, ajeti thotë: **“Edhe për gratë e moshuara që nuk kanë më shpresë për martesë, nuk është mëkat të heqin rrobën mbuluese, por duke mos zbuluar bukuritë e veta.”**.

Për këtë përjashtim prej dispozitës së mbulimit (*hixhabit*) kërkohen dy kushte:

Kushti i parë: e moshuara të jetë në atë moshë, kur ajo nuk martohet më; me fjalë të tjera: kur e moshuara i ka humbur të gjitha hiret femërore.

Kushti i dytë: e moshuara të mos bëjë makijazh pasi të heqë rrobën (*hixhabin*). Me këtë shpjegohet qartë se s'ka problem të hiqet hixhabi pasi janë plotësuar këto dy kushte dhe, për këtë shkak, Islami i ka përjashtuar ato prej dispozitës së mbulimit (*hixhabit*).

Kuptohet qartë se me heqjen e mbulesës për të moshuarat që u specifikuan më lart, nuk nënkuptohet heqja e të gjitha rrobave deri në zhveshje, por vetëm heqja e rrobës së sipërme dhe, siç thuhet në disa transmetime, vetëm heqja e rrobës së sipërme dhe e mbulesës që hidhet sipër kokës, që arrin deri afër brezit (*khimâr*).

Në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut, gjatë shpjegimit të këtij ajeti, thuhet se bëhet fjalë për mbulesën e kokës dhe rrobën e sipërme. Përcjellësi i transmetimit tregon: *“Unë e pyeta Imam Sadikun: A mund të hiqet mbulesa para kujtdo?”* Ai m’u përgjigj: *“Para kujtdo qoftë, kur femra nuk është e zbuluar dhe kur nuk bën makijazh.”*¹

Prej Ehli Bejtit kanë ardhur edhe transmetime të tjera me këtë përmbajtje, ose me përmbajtje të përafërt me transmetimin e mësipërm.²

Në mbyllje, ajeti shton: **“megjithëkëtë për ato është më mirë të jenë të përmbajtura.”**

Islami kërkon që gruaja të jetë sa më e virtytshme dhe sa më e pastër. Për të paralajmëruar ato gra që mund të përfitojnë prej kësaj lirie për heqjen e mbulesës, për të folur e për të vepruar në mënyrë jo të përshtatshme me virtytin e me nderin e tyre, ajeti njofton: **“All'llahu është Dëgjuesi, i Gjithëdituri”**; domethënë: çdo fjalë që ju thoni, All'llahu e dëgjon dhe Ai ka dijeni të plotë për çdo të fshehtë që ju mbani në zemrat e në mendjet tuaja.

¹“Vesàilush Shija”, vëll. 14, f. 147; “Kitàbun Nikàhi”, kapitulli nr. 110.

² Për më shumë, lexo burimin e mësipërm.

Hulumtime

1- Filozofia e kërkimit të lejes dhe të këqijat që vijnë nga mosrespektimi i këtij detyrimi

Për të shkukur rrënjët e imoralitetit dhe të punëve të liga, siç janë punët që godasin virtytin e nderin e njerëzve, nuk mjafton mbështetja vetëm mbi përdorimin e forcës. Gjithashtu, nuk duhet shpresuar ndonjë rezultat i kënaqshëm vetëm prej masave ndëshkuese për të tilla punë të liga shoqërore. Lufta kundër imoralitetit dhe punëve të liga kërkon ndjekjen e disa rrugëve, si për shembull rruga e edukimit islam, mësimi i edukatës morale, ndjekja e rrugëve të drejta në trajtimin e problemit në fushën e ndjenjave; krahas këtyre, ndëshkimi do të jetë vetëm një faktor për të frenuar dhe për të ndaluar deri në minimum kryerjen e punëve të liga dhe devijimin nga udhëzimi.

Për të gjitha këto shkaqe, surja “En Nûr”, e cila në të vërtetë është surja e virtytit dhe e nderit, fillon me shpalosjen e dispozitës për ndëshkimin e burrit e të gruas që bëjnë imoralitet. Në të njëjtën kohë, ajo flet për rrugët e lehtësimit të martesës, për ruajtjen e veshjes islame të gruas (*hixhabit*) dhe ndalon shikimet e qëllimshme mbi gjininë e kundërt; gjithashtu, ndalon në mënyrë të prerë (bën haram) akuzimin e të tjerëve në nder dhe, në fund, flet edhe për çështjen e kërkimit të lejes nga fëmijët për të hyrë në dhomën e gjumit të prindërve.

Të gjitha këto tregojnë se Islami nuk anashkalon e nuk lë jashtë vëmendjes asnjë hollësi që ka lidhje me çështjen e virtytit e të nderit.

Edhe shërbyesit kanë detyrë të kërkojnë leje kur duan të hyjnë në dhomën e çiftit, të cilit i shërbejnë; gjithashtu, edhe fëmijët që kanë arritur moshën e pjekurisë të mos hyjnë pa leje në dhomën e prindërve. Në të njëjtën kohë, në këtë sure trajtohet edhe detyrimi për të mësuar fëmijët që nuk e kanë arritur moshën e pjekurisë dhe që akoma janë të lidhur ngushtësisht me të dy prindërit; kërkohet që këtyre të fundit t'u bëhet e qartë se nuk duhet të hyjnë në dhomën e prindërve pa marrë leje prej tyre, ose më e pakta, nuk duhet të hyjnë pa leje në dhomën e gjumit të prindërve gjatë tri kohëve të përmendura në këtë ajet: “para namazit të mëngjesit, në kohën e pushimit të drekës dhe pas namazit të darkës”.

Në këtë ajet shpaloset njëra prej anëve të edukatës islame, por duhet pohuar me keqardhje se kësaj dispozite islame i jepet pak rëndësi, ndonëse Kur’ani e shpjegon me qartësi rëndësinë e saj, ashtu siç e pamë në ajetet që janë objekt studimi. Predikuesit e xhamive dhe shkrimtarët e prekin këtë çështje vetëm në raste të rralla.

Nga fjalët e ajetit del qartë se për këtë dispozitë të urdhëruar në mënyrë të prerë (*farz*), qoftë edhe kur e marrim në gradën e veprimit të preferuar (*mustehab*), duhet të flitet dhe të bëhen hulumtime. Disa mendjelehtë thonë se fëmijët nuk kuptojnë asgjë nga intimiteti i dy prindërve dhe se shërbyesit e shtëpisë nuk janë të interesuar për këto punë, në një kohë kur është vërtetuar e kundërta. Shkujdesja e dy prindërve dhe prania e fëmijëve në një

veprim intim, çon në devijimin moral të fëmijëve, madje në disa raste, ka ndodhur që ata të jenë prekur edhe nga sëmundje psikike.

Ka individë që pohojnë se janë ndikuar seksualisht dhe janë prekur nga një ngërç psikik, për shkak se kanë parë një veprim erotik të prindërve. Kështu, ata kanë në zemrat e tyre urrejtje ndaj dy prindërve, madje urrejtja e tyre ishte aq e fortë sa arrinte deri në dëshirën për t'i vrarë të dy; ose ndodh që urrejtja e krijuar tek ata për shkak të asaj që kanë parë, i shtyn deri në vetëvrasje. Të gjitha këto vijnë si rezultat i ndikimit të shkaktuar në shpirtrat e tyre, si pasojë e shkujdesjes së prindërve për t'u ruajtur nga sytë e fëmijëve gjatë çasteve të intimitetit të tyre bashkëshortor, ose shkujdesjes së tyre për të qenë të rezervuar në prani të fëmijëve edhe në rastet e veprimeve që paraprijnë kryerjen e marrëdhënieve intime bashkëshortore.

Për ne është plotësisht e qartë vlera dhe rëndësia e kësaj dispozite islame, të cilën tani po e publikojnë edhe shkencëtarët bashkëkohorë, në një kohë kur Islami ka ardhur me të para katërmëdhjetë shekujsh. Në këtë dispozitë gjejmë detyrimin islam për të porositur të dy prindërit, nënën dhe babain, që të tregojnë seriozitetin më të madh në jetën e tyre bashkëshortore, të mësojnë fëmijët e tyre se duhet kërkuar leje për të hyrë në dhomën e prindërve dhe të qëndrojnë larg çdo veprimi nga ana e tyre, që mund të ndikojë mbi fëmijët dhe që mund t'i bëjë ata të lëvizin. Nga gjërat që ndikojnë tek fëmijët është edhe kur prindërit flenë në një dhomë së bashku me fëmijët e tyre, që e kanë arritur moshën e pjekurisë. Kjo dukuri duhet eliminuar menjëherë (brenda mundësive) dhe prindërit duhet të dinë se veprimet që

mund të bëjnë në prani të fëmijëve kanë një ndikim shumë të madh në të ardhmen e tyre.

Në lidhje me këtë çështje duhet pasur në qendër të vëmendjes hadithi i ardhur prej të Dërguarit më të madh (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili ka thënë: *“Bëni kujdes të madh kur burri kryen marrëdhënie intime me gruan e vet dhe fëmija në djep i shikon.”*¹

2- Dispozita e mbulimit (hixhabit) të gruas për të moshuarat

Mes dijetarëve myslimanë s’ka asnjë kundërshtim rreth përjashtimit prej dispozitës së mbulimit të grave të moshuara, sepse Kur’ani Famëlartë shprehet qartë për këtë çështje. Megjithatë, kjo dispozitë ka kriteret e saj të veçanta, të cilat pasqyrohen në transmetime të ndryshme islame.

Për moshën që duhet të ketë gruaja për t’u përfshirë tek ato që ajeti i përmend si *“gra që nuk mund të martohen më”*, ekzistojnë disa hadithe e transmetime islame, ku thuhet se qëllimi me këtë term janë gratë e moshuara.²

Në hadithe e në transmetime të tjera islame thuhet se qëllimi i frazës së ajetit: *“gra që nuk mund të martohen më”*, është për ato që nuk kanë më shpresë për martesë.³

¹ “Bihàrul Envàri”, vëll. 103, f. 295.

² “Vesàilush Shija”, vëll. 14, “Kitàbun Nikàhi”, kapitulli nr. 110, vëll. 4.

³ Burimi i mësipërm, vëll. 5.

Disa interpretues të Kur'anit mendojnë se me këtë term nënkuptohen gratë që e kanë kaluar moshën e menopauzës, pra që e kanë arritur moshën kur ato nuk mund të mbeten më shtatzënë; vetëkuptohet që me këtë kategori grash, askush s'ka dëshirë të martohet.¹

Duket se të gjitha këto thënie flasin për një realitet me kufinj të caktuar, që tregon qartë se kjo kategori grash ka arritur në atë moshë, kur zakonisht nuk martohen më, ndonëse rrallëherë ndodh që ndonjëra prej tyre të ketë guximin për ta bërë këtë.

Gjithashtu, në hadithet e në transmetimet islame përcaktohet pjesa e trupit që u lejohet të moshuarave ta zbulojnë. Kur'ani Famëlartë e ka përmendur këtë çështje në formë të përgjithshme, kur thotë: **“nuk është mëkat të heqin rrobën mbuluese, por duke mos zbuluar bukuritë e veta”**; qëllimi me rrobën mbuluese është rroba e sipërme.

Në disa hadithe e transmetime islame ka ardhur edhe përgjigjja për pyetjen se cilat rroba lejohet të hiqen. Imam Sadiku ka thënë se rrobat që lejohen të hiqen janë “rrobat e sipërme” (*xhilbàb*).²

Në një transmetim tjetër, ai ka thënë se bëhet fjalë për “rrobat e sipërme dhe për mbulesën që hidhet mbi kokë e që mbulon gjoksin deri afër brezit (*khimàr*)”.³

Duket qartë se midis këtyre transmetimeve s'ka asnjë kontradiktë. Të gjitha ato shprehin një qëllim: lejimin e zbulimit të

¹ “El Xhevàhir”, vëll. 29, f. 85 dhe “Kenzul Irfàn”, vëll. 2, f. 226.

² “Vesàilush Shija”, “Kitàbun Nikàhi”, kapitulli 110, vëll. 1.

³ Burimi i mësipërm, vëll. 2 dhe vëll. 4.

kokës për gratë që përfshihen në fjalën e ajetit “*el kavàidu*” – “**gra që nuk mund të martohen më**” domethënë, kjo kategori të moshuarash lejohen të mos i mbulojnë flokët, qafën dhe fytyrën, ashtu siç thuhet në disa transmetime të tjera; kurse *fukahatë* (juristët e ligjit të fesë) kanë thënë se përjashtimi përfshin zbulimin deri në kyçet e duarve. Te ne s’ka argument që lejon më shumë se kaq.

Sido që të jetë thënë, ky lejim për këtë kategori grash zbatohet me një kusht: “**por duke mos zbuluar bukuritë e veta**”, pra ato duhet të mbajnë fshehur bizhutë e stolitë e ndryshme që vihen nën veshjen mbuluese, detyrim që e kanë të gjitha gratë. Gjithashtu, grave të moshuara nuk u lejohet të veshin rroba të zbukuruar, pasi këto lloj rrobash tërheqin vëmendjen e burrave; thënë ndryshe: ato lejohen të mos e mbajnë rrobën e jashtme (*hixhabin*), por në rrugë duhet të dalin me rrobë të trashë e të thjeshtë, dhe pa asnjë lloj zbukurimi. Nga këto shpjegime del qartë se kjo dispozitë nuk është obliguese, por më e mira është që edhe ato të dalin të mbuluara si të gjitha gratë e tjera, ashtu siç thuhet edhe në fundin e ajetit, sepse gratë janë gjithmonë të ekspozuara ndaj shkarjeve, qoftë edhe në raste të rralla.

Ajeti 61

𐤀𐤁𐤂𐤃𐤄𐤅𐤆𐤇𐤈𐤉𐤊𐤋𐤌𐤍𐤎𐤏𐤐𐤑𐤒𐤓𐤔𐤕𐤖𐤗𐤘𐤙𐤚𐤛𐤜𐤝𐤞𐤟𐤠𐤡𐤢𐤣𐤤𐤥𐤦𐤧𐤨𐤩𐤪𐤫𐤬𐤭𐤮𐤯𐤰𐤱𐤲𐤳𐤴𐤵𐤶𐤷𐤸𐤹𐤺𐤻𐤼𐤽𐤾𐤿𐥀𐥁𐥂𐥃𐥄𐥅𐥆𐥇𐥈𐥉𐥊𐥋𐥌𐥍𐥎𐥏𐥐𐥑𐥒𐥓𐥔𐥕𐥖𐥗𐥘𐥙𐥚𐥛𐥜𐥝𐥞𐥟𐥠𐥡𐥢𐥣𐥤𐥥𐥦𐥧𐥨𐥩𐥪𐥫𐥬𐥭𐥮𐥯𐥰𐥱𐥲𐥳𐥴𐥵𐥶𐥷𐥸𐥹𐥺𐥻𐥼𐥽𐥾𐥿𐧀𐧁𐧂𐧃𐧄𐧅𐧆𐧇𐧈𐧉𐧊𐧋𐧌𐧍𐧎𐧏𐧐𐧑𐧒𐧓𐧔𐧕𐧖𐧗𐧘𐧙𐧚𐧛𐧜𐧝𐧞𐧟𐧠𐧡𐧢𐧣𐧤𐧥𐧦𐧧𐧨𐧩𐧪𐧫𐧬𐧭𐧮𐧯𐧰𐧱𐧲𐧳𐧴𐧵𐧶𐧷𐧸𐧹𐧺𐧻𐧼𐧽𐧾𐧿𐨀𐨁𐨂𐨃𐨄𐨅𐨆𐨇𐨈𐨉𐨊𐨋𐨌𐨍𐨎𐨏𐨐𐨑𐨒𐨓𐨔𐨕𐨖𐨗𐨘𐨙𐨚𐨛𐨜𐨝𐨞𐨟𐨠𐨡𐨢𐨣𐨤𐨥𐨦𐨧𐨨𐨩𐨪𐨫𐨬𐨭𐨮𐨯𐨰𐨱𐨲𐨳𐨴𐨵𐨶𐨷𐨹𐨺𐨸𐨻𐨼𐨽𐨾𐨿𐩀𐩁𐩂𐩃𐩄𐩅𐩆𐩇𐩈𐩉𐩊𐩋𐩌𐩍𐩎𐩏𐩐𐩑𐩒𐩓𐩔𐩕𐩖𐩗𐩘𐩙𐩚𐩛𐩜𐩝𐩞𐩟𐩠𐩡𐩢𐩣𐩤𐩥𐩦𐩧𐩨𐩩𐩪𐩫𐩬𐩭𐩮𐩯𐩰𐩱𐩲𐩳𐩴𐩵𐩶𐩷𐩸𐩹𐩺𐩻𐩼𐩽𐩾𐩿𐪀𐪁𐪂𐪃𐪄𐪅𐪆𐪇𐪈𐪉𐪊𐪋𐪌𐪍𐪎𐪏𐪐𐪑𐪒𐪓𐪔𐪕𐪖𐪗𐪘𐪙𐪚𐪛𐪜𐪝𐪞𐪟𐪠𐪡𐪢𐪣𐪤𐪥𐪦𐪧𐪨𐪩𐪪𐪫𐪬𐪭𐪮𐪯𐪰𐪱𐪲𐪳𐪴𐪵𐪶𐪷𐪸𐪹𐪺𐪻𐪼𐪽𐪾𐪿𐫀𐫁𐫂𐫃𐫄𐫅𐫆𐫇𐫈𐫉𐫊𐫋𐫌𐫍𐫎𐫏𐫐𐫑𐫒𐫓𐫔𐫕𐫖𐫗𐫘𐫙𐫚𐫛𐫜𐫝𐫞𐫟𐫠𐫡𐫢𐫣𐫤𐫦𐫥𐫧𐫨𐫩𐫪𐫫𐫬𐫭𐫮𐫯𐫰𐫱𐫲𐫳𐫴𐫵𐫶𐫷𐫸𐫹𐫺𐫻𐫼𐫽𐫾𐫿𐬀𐬁𐬂𐬃𐬄𐬅𐬆𐬇𐬈𐬉𐬊𐬋𐬌𐬍𐬎𐬏𐬐𐬑𐬒𐬓𐬔𐬕𐬖𐬗𐬘𐬙𐬚𐬛𐬜𐬝𐬞𐬟𐬠𐬡𐬢𐬣𐬤𐬥𐬦𐬧𐬨𐬩𐬪𐬫𐬬𐬭𐬮𐬯𐬰𐬱𐬲𐬳𐬴𐬵𐬶𐬷𐬸𐬹𐬺𐬻𐬼𐬽𐬾𐬿𐭀𐭁𐭂𐭃𐭄𐭅𐭆𐭇𐭈𐭉𐭊𐭋𐭌𐭍𐭎𐭏𐭐𐭑𐭒𐭓𐭔𐭕𐭖𐭗𐭘𐭙𐭚𐭛𐭜𐭝𐭞𐭟𐭠𐭡𐭢𐭣𐭤𐭥𐭦𐭧𐭨𐭩𐭪𐭫𐭬𐭭𐭮𐭯𐭰𐭱𐭲𐭳𐭴𐭵𐭶𐭷𐭸𐭹𐭺𐭻𐭼𐭽𐭾𐭿𐮀𐮁𐮂𐮃𐮄𐮅𐮆𐮇𐮈𐮉𐮊𐮋𐮌𐮍𐮎𐮏𐮐𐮑𐮒𐮓𐮔𐮕𐮖𐮗𐮘𐮙𐮚𐮛𐮜𐮝𐮞𐮟𐮠𐮡𐮢𐮣𐮤𐮥𐮦𐮧𐮨𐮩𐮪𐮫𐮬𐮭𐮮𐮯𐮰𐮱𐮲𐮳𐮴𐮵𐮶𐮷𐮸𐮹𐮺𐮻𐮼𐮽𐮾𐮿𐯀𐯁𐯂𐯃𐯄𐯅𐯆𐯇𐯈𐯉𐯊𐯋𐯌𐯍𐯎𐯏𐯐𐯑𐯒𐯓𐯔𐯕𐯖𐯗𐯘𐯙𐯚𐯛𐯜𐯝𐯞𐯟𐯠𐯡𐯢𐯣𐯤𐯥𐯦𐯧𐯨𐯩𐯪𐯫𐯬𐯭𐯮𐯯𐯰𐯱𐯲𐯳𐯴𐯵𐯶𐯷𐯸𐯹𐯺𐯻𐯼𐯽𐯾𐯿𐰀𐰁𐰂𐰃𐰄𐰅𐰆𐰇𐰈𐰉𐰊𐰋𐰌𐰍𐰎𐰏𐰐𐰑𐰒𐰓𐰔𐰕𐰖𐰗𐰘𐰙𐰚𐰛𐰜𐰝𐰞𐰟𐰠𐰡𐰢𐰣𐰤𐰥𐰦𐰧𐰨𐰩𐰪𐰫𐰬𐰭𐰮𐰯𐰰𐰱𐰲𐰳𐰴𐰵𐰶𐰷𐰸𐰹𐰺𐰻𐰼𐰽𐰾𐰿𐱀𐱁𐱂𐱃𐱄𐱅𐱆𐱇𐱈𐱉𐱊𐱋𐱌𐱍𐱎𐱏𐱐𐱑𐱒𐱓𐱔𐱕𐱖𐱗𐱘𐱙𐱚𐱛𐱜𐱝𐱞𐱟𐱠𐱡𐱢𐱣𐱤𐱥𐱦𐱧𐱨𐱩𐱪𐱫𐱬𐱭𐱮𐱯𐱰𐱱𐱲𐱳𐱴𐱵𐱶𐱷𐱸𐱹𐱺𐱻𐱼𐱽𐱾𐱿𐲀𐲁𐲂𐲃𐲄𐲅𐲆𐲇𐲈𐲉𐲊𐲋𐲌𐲍𐲎𐲏𐲐𐲑𐲒𐲓𐲔𐲕𐲖𐲗𐲘𐲙𐲚𐲛𐲜𐲝𐲞𐲟𐲠𐲡𐲢𐲣𐲤𐲥𐲦𐲧𐲨𐲩𐲪𐲫𐲬𐲭𐲮𐲯𐲰𐲱𐲲𐲳𐲴𐲵𐲶𐲷𐲸𐲹𐲺𐲻𐲼𐲽𐲾𐲿𐳀𐳁𐳂𐳃𐳄𐳅𐳆𐳇𐳈𐳉𐳊𐳋𐳌𐳍𐳎𐳏𐳐𐳑𐳒𐳓𐳔𐳕𐳖𐳗𐳘𐳙𐳚𐳛𐳜𐳝𐳞𐳟𐳠𐳡𐳢𐳣𐳤𐳥𐳦𐳧𐳨𐳩𐳪𐳫𐳬𐳭𐳮𐳯𐳰𐳱𐳲𐳳𐳴𐳵𐳶𐳷𐳸𐳹𐳺𐳻𐳼𐳽𐳾𐳿𐴀𐴁𐴂𐴃𐴄𐴅𐴆𐴇𐴈𐴉𐴊𐴋𐴌𐴍𐴎𐴏𐴐𐴑𐴒𐴓𐴔𐴕𐴖𐴗𐴘𐴙𐴚𐴛𐴜𐴝𐴞𐴟𐴠𐴡𐴢𐴣𐴤𐴥𐴦𐴧𐴨𐴩𐴪𐴫𐴬𐴭𐴮𐴯𐴰𐴱𐴲𐴳𐴴𐴵𐴶𐴷𐴸𐴹𐴺𐴻𐴼𐴽

“Nuk është mëkat as për të verbërin, as për çalamanin, as për të sëmurin e as për ju vetë të hani në shtëpitë tuaja, ose në shtëpitë e etërve tuaj, ose në shtëpitë e nënave tuaja, ose në shtëpitë e vëllezërve tuaj, ose në shtëpitë e motrave tuaja, ose në shtëpitë e xhaxhallarëve tuaj, ose në shtëpitë e hallave tuaja, ose në shtëpitë e dajallarëve tuaj, ose në shtëpitë e tezeve tuaja, ose në shtëpitë, çelësat e të cilave janë në dorën tuaj, ose (në shtëpitë) e miqve tuaj; nuk është mëkat të hani së bashku ose veçmas; kur të hyni (në ndonjërin prej këtyre shtëpive), përshëndetni veten tuaj (*banorët e atyre shtëpive*) me përshëndetjen e caktuar nga All'Ilahu (me Es Selamu Alejkum), ajo është përshëndetje e bekuar dhe e bukur; kështu i sqaron All'Ilahu për ju argumentet që ju të mendoni (rreth atyre argumenteve).”

Komentimi

Shtëpitë e lejuara për të ngrënë në to

Ajetet e mësipërme bënin fjalë për kërkimin e lejes nga ana e fëmijës, për të hyrë në dhomën e prindërve në tri kohët e përcaktuara, ose për të hyrë në shtëpinë ose në dhomën e veçantë të nënës dhe babait.

Ndërsa ajeti që është objekt studimi, përveç dispozitës që u tha, tregon se jo vetëm që lejohet hyrja në shtëpitë e të afërmve sipas kushteve të përcaktuara, por edhe ngrënia në to pa marrë

leje. Kështu, ajeti thotë: **“Nuk është mëkat as për të verbërin, as për çalamanin, as për të sëmurin.”**.

Në disa hadithe është shpjeguar qartë se banorët e qyteteve, para se ta pranonin Islamin, i ndalonin të verbërit, çalamanët dhe të sëmuret që të hanin me ta në tryezë, për shkak se kishin neveri për ta.

Por edhe pasi pranuan Islamin, ata vazhduan të shtrojnë tryeza të veçanta për tri kategoritë që u thanë, tashmë jo ngaqë kishin neveri të hanin së bashku me ta në të njëjtën tryezë, por thjesht për shkaqe humane; për shembull, i verbri nuk e sheh gjellën e mirë të shtruar mbi tryezë, ndërsa të tjerët e shohin dhe hanë nga ajo gjellë, por kjo është e kundërta e moralit të shëndoshë islam. Kështu qëndron puna edhe me çalamanin e të sëmurin, të cilët mund të hanë më ngadalë, kurse të tjerët që janë të shëndoshë, hanë para tyre. Për të gjitha këto, ata menduan të mos hanin bashkërisht në të njëjtën tryezë; por edhe i verbri, çalamani dhe i sëmuri e përmbanin veten dhe bënë shumë kujdes, që të mos u shkaktonin të tjerëve asnjë shqetësim, madje secili prej tyre e konsideronte veten fajtor nëse do të hante së bashku me të shëndoshët në të njëjtën tryezë.

Për këtë çështje iu kërkua shpjegim të Dërguarit të All'lahut (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Atëherë zbriti ajeti që është objekt studimi e që shpjegon tekstualisht se nuk ka asnjë pengesë që i verbëri,

çalamani, i sëmuri dhe i shëndoshi, të hanë ushqim në të njëjtën tryezë.¹

Disa e kanë shpjeguar këtë përjashtim nga tryeza e përbashkët të atyre që u përmendën më sipër, për shkak se të trija kategoritë janë të përjashtuara edhe nga pjesëmarrja e tyre për të luftuar në rrugën e All'Ilahut (*xhihàd*); ose qëllimi mund të jetë: u lejohet që të pamundurit t'ju shoqërojnë në njëmbëdhjetë shtëpitë, për të cilat tregon ajeti, që edhe ata të hanë në to së bashku me ju në të njëjtën tryezë.

Duket qartë se të dy këto interpretime janë shumë larg nga qëllimi i ajetit dhe nuk përputhen me kuptimin e tij.

Në vijim, Kur'ani Famëlartë shton: **“e as për ju vetë të hani në shtëpitë tuaja.”**

Qëllimi me frazën e ajetit *“bujùtikum”* - **“shtëpitë tuaja”**, është për shtëpitë e djemve dhe shtëpitë e grave tuaja.

- **“ose në shtëpitë e etërve tuaj”**.
- **“ose në shtëpitë e nënave tuaja”**.
- **“ose në shtëpitë e vëllezërve tuaj”**.
- **“ose në shtëpitë e motrave tuaja”**.
- **“ose në shtëpitë e xhaxhallarëve tuaj”**.
- **“ose në shtëpitë e hallave tuaja”**.
- **“ose në shtëpitë e dajallarëve tuaj”**.
- **“ose në shtëpitë e tezeve tuaja”**.

¹ Kjo çështje është trajtuar edhe në tefsirët: “Ed’durr’rrul Menthùr”, “Nuruth Thekalejn”, “Muxhmeut Tibjàn”, Es Sàfij” dhe tefsiri “Kebijr”; fundi i ajetit që është objekt studimi.

- **“ose në shtëpitë, çelësat e të cilave janë në dorën tuaj”.**
- **“ose (në shtëpitë) e miqve tuaj”.**

Sigurisht që edhe për këtë dispozitë ka kushte, por sqarimi i tyre do të bëhet në fundin e komentimit të këtij ajeti.

Në vijim, ajeti shton: **“nuk është mëkat të hani së bashku ose veçmas.”**.

Interpretuesit e Kur'anit kanë thënë se disa grupe myslimanësh nuk pranonin të hanin të veçuar, madje qëndronin të uritur derisa të gjenin dikë që të hante së bashku me ta. Prandaj, Kur'ani Famëlartë i mëson ata dhe u thotë se është e lejuar që ushqimi të merret si me të tjerët, ashtu edhe veçmas.¹

Disa të tjerë mendojnë se një grup prej banorëve të shkretëtirës, mikut ia shtronin ushqimin që të hante vetëm, në shenjë respekti për të; veç kësaj, ata nuk hanin në një tryezë së bashku me mikun, me qëllim që ai të mos ndihej i turpëruar gjatë ngrënies.

Ajeti që është objekt studimi i hoqi të gjitha këto tradita, që konsiderohen si sjellje jo të lavdëruara.²

Disa të tjerë mendojnë se nuk lejohet të hanë së bashku të pasurit me të varfërit, me qëllim që ndarja klasore të ruhet edhe në tryezën e ngrënies; por Kur'ani Famëlartë, vetëm me frazën e

¹ Tefsiri “Et Tibjân”, fundi i ajetit që është objekt studimi.

² Burimi i mësipërm.

mësipërme të ajetit, i hedh poshtë të gjitha këto tradita të gabuara dhe të padrejta.¹

Gjithsesi, ajeti që është objekt studimi mund t'i përmbajë të gjitha këto kuptime.

Në vijim, ajeti thekson njërin prej mësimëve morale dhe thotë: **“kur të hyni (në ndonjërin prej këtyre shtëpive), përshëndetni veten tuaj (banorët e atyre shtëpive) me përshëndetjen e caktuar nga All'Ilahu (me Es Selamu Alejkum); ajo është përshëndetje e bekuar dhe e bukur.”**.

Ajeti mbyllet me frazën: **“kështu i sqaron All'Ilahu për ju argumentet që ju të mendoni (rreth atyre argumenteve).”**.

Disa interpretues të Kur'anit janë shprehur se fjala e ajetit **“shtëpitë”**, ka për qëllim shtëpitë e njëmbëdhjetë personave që u përmendën më lart.

Disa të tjerë kanë thënë se me këtë fjalë, qëllimi është për xhamitë.

Në të vërtetë, duket se fjala **“shtëpitë”** ka kuptim të përgjithshëm dhe përdoret qoftë për njëmbëdhjetë shtëpitë e lartpërmendura, në të cilat njeriut i lejohet ngrënia e ushqimit, qoftë edhe për shtëpitë e tjera, si shtëpitë e miqve dhe të afërmeve. Duhet theksuar se s'ka argument që mundëson ngushtimin e kuptimit të gjerë të këtij ajeti.

¹ Burimi i mësipërm.

Shtrohet pyetja: Cili është kuptimi i frazës: **“përshtëndetni veten tuaj** (banorët e atyre shtëpive)?”

Në lidhje me këtë frazë, disa interpretues të Kur'anit Famëlartë kanë thënë se ka kuptimin “përshtëndetni njëri-tjetrin”, ashtu siç është përdorur në kuptimin “njëri-tjetrin” edhe në tregimin për Benu Israilët në ajetin 54 të sures “El Bekare”, ku thuhet: *“faktulù enfusekum”* - **“vrisni veten tuaj”**, në kuptimin “vrisni njëri-tjetrin”.

Disa të tjerë mendojnë se fraza në fjalë ka kuptimin e përshtëndetjes me “selam” të bashkëshortes, fëmijëve dhe njerëzve të tjerë të familjes, të cilët janë që të gjithë në pozitën e vetvetes, ashtu siç ka ardhur në ajetin tonë me fjalën *“enfusikum”* - **“veten tuaj”**; gjithashtu, kjo shprehje ka ardhur edhe në ajetin 61 të sures “Ali Imran”, në ajetin e mallkimit (*mubàheleh*). Këto ajete shpjegojnë se afërsia e një njeriu ndaj një tjetri arrin deri në atë shkallë, saqë ata të dy të konsiderohen një person i vetëm, ashtu siç ishte Aliu me të Dërguarin e All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Interpretues të tjerë të Kur'anit janë shprehur se qëllimi me fjalën **“përshtëndetni veten tuaj”** në këtë ajet, është përshtëndetja me të cilën burri përshtëndet zakonisht kur hyn në shtëpi, qoftë edhe kur aty nuk ka asnjë njeri. Prandaj, kur hyn në këto shtëpi, njeriu përshtëndet veten e tij me *selam* dhe thotë: *Paqe për ju prej Zotit tonë, paqe për ne dhe për njerëzit e mirë të All'llahut!* Ndërmjet këtyre interpretimeve s'ka asnjë kontradiktë, duke pasur parasysh se përshtëndetja me *selam* është detyrë në çdo shtëpi që hyn, pra besimtarët kanë detyrë ta përshtëndesin njëri-tjetrin me *selam*, ashtu siç është detyrë që edhe pjesëtarët e familjes të përshtëndesin

me selam njëri-tjetrin; por edhe kur në shtëpi nuk gjendet asnjë, me fjalën “selam” burri përshëndet veten e vet, me mendimin që kjo përshëndetje të kthehet në lutje për paqe e për shpëtim për vetë përshëndetësin.

Në një transmetim të ardhur prej Imam Bakirit, kur e kanë pyetur për interpretimin e këtij ajeti, ai ka thënë: “Është përshëndetja me ‘selam’, me të cilën burri përshëndet njerëzit kur hyn në shtëpi dhe pastaj ata ia kthejnë përshëndetjen në të njëjtën mënyrë”. Është pikërisht ky, kuptimi i shprehjes së ajetit **“përshëndetni veten tuaj”**.¹

Në një transmetim tjetër të ardhur prej Imam Bakirit lexojmë se për këtë çështje, ai ka thënë: “Kur ndonjëri prej jush hyn në shtëpinë e tij, nëse aty gjendet dikush, le ta përshëndesë atë me ‘selam’ dhe, nëse aty nuk gjendet asnjë, atëherë le të thotë: “Es’selàmu alejnà min indi rab’binà” (paqe e shpëtim prej Zotit tonë!); ndërkaq All'llahu i Lartësuar ia kthen përshëndetjen: “Tehij’jeten min indil’làhi, mubàreketen taj’jibeten!” (Përshëndetje nga ana e All'llahut, e bekuar dhe e bukur.”.²

¹ Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 627.

² Burimi i mësipërm.

dhe kërkoji All'llahut faljen për ata, padyshim që All'llahu është Gjithëfalësi, Mëshirëploti."

"Thirrjen e të Dërguarit mos e konsideroni si thirrjen ndaj njëritjetrit; All'llahu ka dijeni të plotë për ata që largohen fshehurazi, prandaj le të bëjnë kujdes ata që kundërshtojnë urdhrin e tij (urdhrin e të Dërguarit) se ata do të kalojnë ndonjë sprovë të rëndë, ose ata do të pësojnë një ndëshkim shumë të dhimbshëm."

"Bëni kujdes, nën pushtetin e All'llahut është ç'ka në qiej e në tokë; Ai e di gjendjen tuaj (besimin, ose hipokrizinë tuaj) dhe, Ditën kur ata do të kthehen tek All'llahu, Ai do t'i njoftojë atyre punët që ata kanë bërë; për çdo gjë All'llahu ka dijeni të plotë."

Shkaku i zbritjes

Për zbritjen e ajetit të parë të këtij grupi ajetesh janë përmendur disa shkaqe. Në disa hadithe tregohet se ky ajet ka zbritur për ngjarjen që i ndodhi Handhaleh bin Ebij Ijash, martesa e të cilit përkoi me natën e luftës së Uhudit. Ndërsa i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) po konsultohet me sahabët për çështjen e betejës, vjen Handhaleh dhe i kërkon leje, që ta kalonte atë natë pranë gruas së tij, dhe i Dërguari e lejoi.

Handhaleh u ngrit në mëngjes herët që të bashkohej me radhët e myslimanëve dhe, ngaqë nxitonte, s'pati mundësi të merrte gusël, kështu që hyri në betejë në gjendjen që ishte dhe luftoi derisa ra dëshmor në rrugën e All'lahut.

Për të, i Dërguari i All'lahut (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: “Pashë engjëjt që po e lanin Handhalen me ujin e reve në mes të qiellit e tokës me enë prej argjendi.”.

Për këtë, më pas Handhaleh u quajt “i larë prej engjëjve”.¹

Për zbritjen e këtyre ajeteve, prej Ibni Is'hàkut transmetohet shkaku vijues: Kur i Dërguari i All'lahut (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) mësoi se kurejshët, në koalicion me tributë e shkretëtirës, ishin mbledhur të luftonin kundër tij, ra në një fjalë të përbashkët me sahabët dhe filluan të hapnin hendekun rreth Medines. Në hapjen e këtij hendeku punoi personalisht edhe i Dërguari i All'lahut (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që të ishte motiv për shpërblimin që do të kishin myslimanët në këtë punë. Në fakt, vetë i Dërguari dhe të gjithë myslimanët punuan pa u lodhur. Ishte e natyrshme që hipokritët (*munafikët*) të punonin shumë më pak se i Dërguari i All'lahut (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Gjithashtu, ata punuan edhe më pak se myslimanët; veç kësaj, ata largoheshin fshehurazi dhe shkonin pranë familjeve të tyre pa i marrë leje të Dërguarit të All'lahut (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

¹ Tefsiri i “Ali bin Ibrahimit”, sipas asaj që ai ka cituar prej tefsirit “Nuruth Thekalejn”, vëll. 3, f. 628.

Ndërsa myslimanët, edhe kur do të shkonin për kryerjen e një pune personale të domosdoshme, nuk e linin kurrë punën, pa e njoftuar dhe pa marrë lejen e të Dërguarit të All'Ilahut dhe, natyrisht që ai i lejonte.

Myslimani, pasi e kryente punën për të cilën kishte kërkuar dhe marrë leje, kthehej menjëherë në punë, me dëshirën për të kryer atë punë të mirë dhe duke shpresuar njëkohësisht edhe në shpërblimin për të. Në lidhje me këta besimtarë, All'Ilahu i Lartësuar zbriti ajetin: **“Besimtarë janë vetëm ata...”**; në vijim të ajetit, All'Ilahu i Lartësuar njofton se hipokritët largoheshin nga puna fshehurazi dhe pa i marrë leje Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Për këtë, në ajet thuhet: **“Thirrjen e të Dërguarit mos e konsideroni si thirrjen ndaj njëri-tjetrit...”**.¹

Komentimi

Mos e lini Profetin vetëm!

Disa interpretues të Kur'anit Famëlartë, ndër të cilët i ndjeri Et Tabresij në tefsirin “Mexhmaul Bejjan” dhe Sej'jid Kutub në tefsirin “Fij Dhilalil Kur'an”, janë shprehur për lidhjen që ekziston midis ajeteve të mëparshme, ku shpalosej njëra anë e mënyrës së

¹ Tefsiri “Fij Dhilalil Kur'an”, vëll. 6, f. 126, fundi i ajetit që është objekt studimi.

bashkëpunimit me miqtë dhe të afërmit. Ajetet që janë objekt studimi trajtojnë mënyrën e bashkëpunimit të myslimanëve me udhëheqësin e tyre, Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Në këto ajete theksohet nderimi i thellë i myslimanëve dhe bindja e tyre ndaj tij; gjithashtu, tregohet se ata largoheshin nga kolektivi vetëm me lejen e tij.

Këto ajete flasin për domosdoshmërinë e bindjes ndaj All'llahut dhe të Dërguarit të Tij. Ato njoftojnë se prej shenjave dalluese të kësaj bindjeje ishte mosbraktisja e vendit të punës, ose kryerja e ndonjë pune pa lejen e të Dërguarit. Në ajetin e parë të këtij grupi ajetesh thuhet: **“Besimtarë janë vetëm ata që i besuan All'llahut dhe të Dërguarit të Tij; kur ata janë me atë (me të Dërguarin) për ndonjë çështje të rëndësishme nuk largohen pa i kërkuar leje atij (të Dërguarit).”**.

Qëllimi me frazën e ajetit *“alà emrin xhàmi'in”* - **“për ndonjë çështje të rëndësishme”**, është për çdo punë shoqërore, për kryerjen e së cilës kërkohet bashkëpunimi në mes të njerëzve dhe bëhet fjalë qoftë për ndonjë punë investuese, qoftë për ndonjë çështje që ka të bëjë me luftën në rrugën e All'llahut, ose për të luftuar armikun drejtpërdrejt, ose për faljen e namazit të xhumasë në kushte të jashtëzakonshme, ose për punë të tjera të ngjashme.

Kur themi se disa interpretues të Kur'anit janë shprehur se kjo frazë e ajetit ka kuptimin e konsultimit, ose të luftës në rrugën e All'llahut, ose faljen e namazit të xhumasë, ose faljen e namazit të Bajramit, në të vërtetë ata kanë pasqyruar vetëm njërin anë të kuptimeve të këtij ajeti, në një kohë kur shkaqet e zbritjes së këtyre ajeteve janë një kriter që vërteton se kjo dispozitë është përgjithësuese.

Bashkëpunimi në mes të njerëzve është një prej kushteve të sistemit dhe të organizimit. Asnjë grupim i organizuar dhe i harmonizuar nuk mund ta anashkalojë këtë fakt, pasi edhe mungesa e njërit prej individëve mund të sjellë vështirësi, madje mund të shkaktojë edhe dëm për arritjen e objektivit përfundimtar. Nëse marrim në konsideratë faktin se komandanti i atij grupi ishte vetë i Dërguari i All'Ilahut (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) si dhe kushtet për të cilat flet ajeti i nderuar, atëherë patjetër që kërkohej bindje e plotë ndaj fjalës së tij.

Këtu duhet të theksohet se fjala **“leje”** nuk nënkupton kërkimin formal të lejes, që njeriu të kryejë punët e tij personale, ose që të merret me punët e tij të tregtisë. Jo! Besimtari ishte i sigurtë në kërkimin e lejes dhe, nëse komandanti e shihte se mungesa e atij personi mund ta dëmtonte punën, kishte të drejtë të mos e lejonte që të largohej. Njëkohësisht, ishte detyra e atij që kërkonte lejen për t'u larguar, që të sakrifikonte interesin e tij personal për arritjen e qëllimit më të lartë. Për këtë, ajeti e njofton të Dërguarin me këto fjalë: **“s'ka dyshim se ata që kërkojnë leje prej teje, ata i besojnë All'Ilahut dhe të Dërguarit të Tij; kur ata të kërkojnë leje për ndonjë punë të tyre, jepi leje kujt të duash.”**.

Është e qartë se asnjëri prej atyre besimtarëve nuk kërkonte leje për ndonjë punë të zakonshme, sepse ata ishin të vetëdijshëm se ishin mbledhur për një punë shumë të rëndësishme. Prandaj edhe qëllimi me fjalën e ajetit *“she'nihim”* – **“çështje të tyre”** është në kuptimin: vetëm për punë të rëndësishme dhe të domosdoshme.

Nga na tjetër, kjo nuk do të thotë se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u jepte leje personave që e kërkonin atë, pa e studiuar mirë punën e tyre. Ai merrte gjithmonë parasysh ndikimin që do të kishte prania ose mungesa e atyre individëve; prandaj, kjo frazë e ajetit i lë dorë të lirë Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që të mos i japë leje një personi, kur ai e shikon se prania e tij në kolektiv është e domosdoshme.

Argument për atë që u tha më lart është ajeti 43 i sures “Et Teube”, ku flitet për lejen që u dha Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) disa vetëve, për të mos dalë së bashku me të në luftë: **“All'llahu të fali ty (o Muhammed) që u dhe leje atyre (të mos dalin të luftojnë) para se për ty të bëhej e qartë se cili prej tyre kishte të drejtë dhe cili ishte gënjeshtar.”**.

Ky ajet shpjegon qartë se është bërë detyrim mbi Profetin që, para se të japë leje, ai duhet të vërtetojë e të hetojë punën, për të cilën kërkohet leja; gjithashtu, në këtë ajet shihen edhe dimensionet e përgjegjësisë hyjnore.

Dhe, në mbyllje, ajeti e urdhëron të Dërguarin më të nderuar me këto fjalë: **“dhe kërkoji All'llahut faljen për ata, padyshim që All'llahu është Gjithëfalësi, Mëshirëploti.”**.

Këtu shtrohet pyetja: Cili është qëllimi me këtë kërkesë për falje mëkatesh? A janë ata fajtorë, për shkak se u larguan me lejen e Profetit? Atëherë, përse është e nevojshme të kërkohet falje mëkatesh për ta?

Përgjigja e kësaj pyetjeje duhet parë në dy aspekte:

Aspekti i parë: ai u urdhërua të kërkonte faljen e mëkateve për ta, sepse do të kishte qenë më mirë sikur ata të mos kishin kërkuar leje për t'iu shmangur daljes së bashku me të Dërguarin, ndonëse ai i lejoi. Në të vërtetë, kërkimi i lejes në ato momente, do të thotë që njeriu ka vënë në radhë të parë interesin e tij personal mbi interesin e të gjithë myslimanëve; gjithashtu, kërkesa e tyre ka në brendi atë që quhet “heqje dorë nga puna me përparësi” dhe pikërisht për këtë është i nevojshëm kërkimi i faljes së mëkateve për ta (ashtu siç kërkohet falje prej All'llahut për çdo punë të urryer).¹

Në të njëjtën kohë, kjo frazë e ajetit bën të qartë domosdoshmërinë e mosdhënies së lejes (mundësisht) dhe ndjekjen e rrugës së sakrificës për realizimin e punës më të mirë.

Aspekti i dytë: ka mundësi që All'llahu i Lartësuar e urdhëroi Profetin e Tij të kërkojë falje për ata, kundrejt përkushtimit të tyre me rregullat e edukatës për kërkimin e lejes.²

Në të vërtetë, mes këtyre dy aspekteve nuk ka ndonjë kontradiktë. Gjithashtu, është normale që këto mësimë organizative të mos jenë të veçanta as vetëm për të Dërguarin e All'llahut, e as vetëm për sahabët e nderuar. Në fakt, këto urdhra të ajetit janë obligime që duhen ndjekur ndaj çdo udhëheqësi që bën thirrje në rrugën e All'llahut dhe vlejné qoftë kur komandanti është Profet, Imam apo dijetar, qoftë kur është person i autorizuar prej këtyre dy të fundit, sepse e ardhmja e myslimanëve kushtëzohet në bindjen ndaj urdhrave të komandantit. Duhet

¹ Tefsiri “Kebijr”, vëll. 24, f. 39; tefsiri “Ruhul Me’ani” dhe tefsiri i “Kurtubij’jit”, fundi i ajetit që është objekt studimi.

² Tefsiri “Kebijr”, vëll. 39, fundi i ajeteve që janë objekt studimi.

theksuar se bindjen ndaj udhëheqësit e bën të domosdoshme edhe logjika, sepse vazhdimësia e organizimit qëndron në kujdesin ndaj këtyre parimeve; ndryshe, do të ishte e pamundur të realizohej administrimi i shoqërisë.

Ajeti vijues shpalos një dispozitë tjetër që lidhet me respektin ndaj Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): **“Thirrjen e të Dërguarit mos e konsideroni si thirrjen ndaj njëri-tjetrit.”**.

Kur i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u bën thirrje që të mblidheni, ai e bën këtë për një çështje shumë të rëndësishme hyjnore, prandaj detyra juaj është që t'i përgjigjeni, t'i respektoni të gjitha udhëzimet e tij dhe të mos i lini pas dore, sepse urdhri dhe thirrja e tij janë prej All'llahut të Gjithëpushtetshëm.

Më pas, ajeti njofton: **“All'llahu ka dijeni të plotë për ata që tërhiqen fshehurazi, prandaj le të bëjnë kujdes ata që kundërshtojnë urdhrin e tij (urdhrin e të Dërguarit) se ata do t'i zërë ndonjë sprovë e rëndë, ose ata do të pësojnë një ndëshkim shumë të dhimbshëm.”**.

Fjala e ajetit *“jetesel'lelune”* ka kuptimin e heqjes së një sendi prej vendit të vet, si për shembull: e hoqi shpatën prej këllëfit; gjithashtu, kjo fjalë përdoret edhe për ata që largohen fshehurazi nga vendi i caktuar për t'u mbledhur. Të gjitha këto kuptime përfshihen në fjalën e ajetit *“jetesel'lelune”*.

Fjala tjetër e ajetit *“livàdhen”* ka kuptimin e fshehjes prapa tjetrit, ose të fshehjes prapa ndonjë muri; thënë ndryshe: ata bëjnë disa veprime që të tjerët të mos i shikojnë kur largohen fshehtas

dhe pa leje nga vendi i grumbullimit, ashtu siç vepronin hipokritët kur i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) bënte thirrje për të dalë në luftë në rrugën e All'llahut, ose për ndonjë punë tjetër të rëndësishme. Prandaj, Kur'ani i njofton hipokritët dhe u thotë atyre qartë e shkurt: “Hipokrizia juaj, ndonëse mund të mos merret vesh prej njerëzve, nuk është kurrë e panjohur për All'llahun; Ai do t’ju dënojë në këtë botë dhe në Botën Tjetër për punët që ju bëni (që largoheni fshehurazi dhe që kundërshtoni urdhrat e të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)).

Cili është kuptimi i fjalës: “*fitnetun*” – “**sprovë**”, në këtë ajet? Disa interpretues të Kur'anit kanë thënë se *sprova* është *vrasja*. Të tjerë kanë thënë se kjo fjalë është përdorur në kuptimin e shkarjes në rrugën e humbjes, ndërsa një grup i tretë kanë thënë se nënkupton rënien në pushtetin e një sundimtari tiran. Gjithashtu, është thënë se ka kuptimin e së keqes së vetë hipokrizisë, e cila depërton në zemrën e njeriut.

Ka mundësi që fjala “*fitnetun*” të ketë kuptimin e ngatërresave e të problemeve shoqërore; pra në atë shoqëri do të jenë mbizotëruese vrasjet e trazirat. Ajo do të pësojë disfatë, duke shtuar edhe të gjitha trazirat e tjera me të cilat do të sprovohet, për shkak se individë të saj e kundërshtuan urdhrin e udhëheqësit.

Çfarëdo që të jetë thënë mbi kuptimin e fjalës “*fitnetun*”, ajo ka një përdorim shumë të gjerë dhe përfshin të gjitha punët që u përmendën, si dhe të tjera përveç tyre, ashtu siç e thotë edhe fraza e ajetit “*adhàbun elijmun*” – “**ndëshkim shumë i dhimbshëm**” ndëshkimin vetëm në këtë botë, ose ndëshkimin vetëm në Botën Tjetër, ose ndëshkimin në të dyja botët.

Përveç atyre që përmendëm më lart, ajeti që është objekt studimi ka edhe dy forma të tjera interpretimi:

Epara: fjala e All'llahut, të Lartit: **“Thirrjen e të Dërguarit mos e konsideroni si thirrjen ndaj njëri-tjetrit”**, ka kuptimin: kur të thërrisni Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), duhet ta bëni këtë me edukatën e me respektin që i përshtatet pozitës së tij dhe jo ashtu siç i thërrisni njëri-tjetrit. Shkaku për këtë urdhër të veçantë ishte se disa grupe myslimanësh nuk i kishin mësuar akoma rregullat e edukatës islame të bashkëpunimit me të tjerët. Edhe të Dërguarin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e thërrisnin në emër, por kjo mënyrë thirrjeje nuk mund t'i përshtatej një udhëheqësi hyjnor me pozitë aq të lartë. Ajeti ka për qëllim t'i mësojë njerëzit që ta thërrisnin të Dërguarin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me shprehje të matura që tregonin respekt dhe edukatë, si për shembull: *“O i Dërguar i All'llahut!”*, ose *“O Profet i All'llahut!”*

Ky interpretim gjendet në disa transmetime, por duhet saktësuar se ai nuk përshtatet me kuptimin që shprehin fjalët e ajetit, pra me detyrën për t'iu përgjigjur thirrjes që bënte i Dërguari (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) si dhe me detyrimin për të mos u larguar nga kolektivi pa marrë leje prej tij; në këtë ajet janë të përfshira të dy interpretimet.

E dyta: është e shkallës shumë të dobët dhe e trajton interpretimin në këtë këndvështrim: mos bëni lutje kundër Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ashtu siç bëni lutje kundër një personi; pra mos e mallkoni atë, ashtu siç mallkoni njëri-tjetrin, sepse lutja kundër Profetit

(*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ose mallkimi i tij, bëhet me një llogari shumë të hollësishme e të nënshtruar ndaj mësimëve islame dhe në asnjë rast të mos harrohet që zbatuesi është vetëm All'llahu.

Pikërisht për këtë shkak, ky interpretim s'ka lidhje as me fillimin e as me fundin e ajetit. Për më tepër, s'ka ardhur asnjë transmetim islam i veçantë në lidhje me këtë mundësi, prandaj ajo nuk mund të pranohet.

Vlen të përmendet se dijetarët e bazave të ligjit të fesë e kanë interpretuar frazën e ajetit: **“prandaj le të bëjnë kujdes ata që kundërshtojnë urdhrin e tij** (urdhrin e të Dërguarit).”. Ajeti tregon se urdhrat e të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) janë obliguese, por në këtë deduksion ka mangësi që janë treguar në shkencën e bazave të ligjit të fesë.

Ajeti i fundit prej grupit të ajeteve që janë objekt studimi, dhe që është edhe ajeti i fundit i sures “*En Nur*”, thekson çështjen parimore, atë të Ringjalljes, e cila konsiderohet si motiv shtytës për përvetësimin e të gjitha mësimëve hyjnore. Gjithashtu, çështja e Ringjalljes është garanci për zbatimin e të gjitha urdhrave për veprim si dhe të urdhrin që ndalon kryerjen e disa punëve, ndër të cilat edhe ato që u përmendën në këtë sure. Ajeti njofton: **“Bëni kujdes, nën pushtetin e All'llahut është ç'ka në qiej e në tokë.”**.

... sepse All'llahu i Lartësuar: **“Ai e di gjendjen tuaj** (besimin, ose hipokrizinë tuaj)”, pra All'llahu, jo vetëm që ka dijeni të plotë për mënyrën e sjelljes tuaj me njëri-tjetrin, por edhe për të gjitha punët tuaja, edhe për besimin, për qëllimet tuaja. Të gjitha

këto për të Gjithëpushtetshmin, të Cilit nuk i mungon asgjë e s'ka nevojë për asnjë send, janë fare të qarta. Veç kësaj, të gjitha sjelljet e punët tuaja janë të shkruara në "tabelën" e diturisë së Tij.

Në ajet thuhet: **"dhe, Ditën kur ata do të kthehen te All'Ilahu, Ai do t'u njoftojë atyre punët që ata kanë bërë"**, dhe për punët e ndaluara që ju keni bërë, Ai do t'ju ndëshkojë, sepse: **"All'Ilahu për çdo gjë ka dijeni të plotë."**

Të tërheq vëmendjen fakti se në këtë ajet theksohet tre herë me radhë dituria e plotë që ka All'Ilahu i Lartësuar për punët e njerëzve. Kjo përsëritje bëhet me qëllim që njeriu të ndjejë se është gjithmonë nën kontroll. Ky besim, jo vetëm që ka ndikimin e tij të madh në edukim, por njëkohësisht shton edhe kujdesin për vënien e dëshirave njerëzore nën zotërim kundrejt devijimeve prej udhëzimit. Besimi se njeriu ëshë vazhdimisht nën mbikëqyrjen e All'Ilahut, është një faktor shumë i rëndësishëm, që e bën atë të qëndrojë sa më larg rrugëve që çojnë në kryerjen e fajeve.

O Zoti ynë! Ndriçoji zemrat tona me dritën e diturisë dhe të besimit, fuqizojë dritën e llambës së trupave tanë, që ta ruajmë këtë besim prej çdo devijimi prej udhëzimit!

O Zoti ynë! Ndriçoji sytë tanë me dritën e virtytit, zemrat tona me dritën e diturisë, shpirtrat tanë me dritën e devotshmërisë dhe trupin tonë me dritën e udhëzimit në rrugën e drejtë! O Zot! Na ruaj prej mendjemadhësisë e prej shkujdesjes!

O Zot! Na mbro prej ngacmimeve e prej cytjeve të djallit!

*O Zoti ynë! Forcoji bazat e qeverisjes së drejtësisë islame! O Zot!
Mundësoje që ajo qeveri të zbatojë ligjin Tënd! Ruaje shoqërinë tonë
islame prej shkarjeve e prej rënies në greminën e punëve të ulëta! Vetëm
Ti ke dijeni të plotë për të gjitha gjërat.*

Sure “El Furkan”

Sure “El Furkan” është surja e 25 e renditur në Kur'anin Kerim. Ajo ka zbritur në Mekë dhe përmban 77 ajete.

Përmbajtja

Nga vetë përmbajtja kuptohet se është prej sureve të zbritura në Mekë,¹ sepse shumica e ajeteve të saj trajtojnë çështje që kanë të bëjnë me fillimin e me Ringjalljen. Ato shpjegojnë profetësinë e të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ballafaqimin me idhujtarinë e me idhujtarët, paralajmërojnë pasojat fatale të mosbesimit (*kufrit*) e të adhurimit të idhujve si dhe të kryerjes së fajeve e të mëkateve.

Në tërësinë e saj, kjo sure përbëhet nga tri pjesë:

Pjesa e parë:

Në fillim, në këtë sure hidhet poshtë me vendosmëri logjika e idhujtarëve, shpalosen pretekstet që ata nxirrnin dhe u jepet atyre përgjigje. Në këto ajete frikësohen idhujtarët me ndëshkimin e All'llahut dhe me dhënien e llogarisë në Ditën e Gjykimit; gjithashtu, idhujtarët frikësohen edhe me llojet e ndëshkimeve të dhimbshme në zjarrin e Xhehennemit. Kështu, në këtë sure shpalosen fragmente nga tregimet prej popujve të kaluar, të cilët u sprovuën me pësime të rënda dhe me ndëshkime të ashpra, për shkak se e kundërshtuan thirrjen e Profetëve; të gjitha këto shpalosen në këtë sure si rrugë edukimi, që ata idhujtarë të nxirrnin mësim.

Pjesa e dytë:

¹ Disa interpretues të Kur'anit këmbëngulin se tre ajete të kësaj sureje dhe pikërisht ajetet 68, 69 dhe 70, janë zbritur në Medine. Ata e mbështesin mendimin e tyre në faktin se këto tre ajete trajtojnë disa dispozita që kanë lidhje me vrasjen e njeriut dhe me imoralitetin. Por nëse do të shihet me imtësi në ajetet para dhe pas këtyre, do të bëhet e qartë se rrjedha e ajeteve të kësaj sureje është vetëm një dhe ajo harmonizohet plotësisht rreth "ibadurr Rrahmàni", "robve të të Gjithëmëshirshmit" e shpjegimit të cilësive të tyre. Nga të gjitha këto, del qartë se ajetet e kësaj sureje janë zbritur të gjitha në Mekë.

Në ajetet e sures “El Furkàn” jepen disa argumente të *Teuhidit* (besimi se All'llahu është Zoti Një dhe i Vetëm) si dhe prova të madhështisë së All'llahut në të gjitha botët e qeniet, duke filluar nga ndriçimi i diellit, errësira e thellë e natës, erërat, rënia e shirave, gjallërimi i tokës së vdekur nga thatësira, krijimi i qiejve dhe i tokës për gjashtë ditë, krijimi i diellit dhe i hënës dhe rrugëtimi i tyre në hapësirat qiellore dhe dukuri të tjera të ngjashme.

Pjesa e parë përcakton kuptimin e frazës (*lâ ilâhe*) – s’ka zot – dhe pjesa e dytë përcakton kuptimin e frazës (*il’le-ll’llâh*) – përveç All'llahut.

Pjesa e tretë:

Është një përmbledhje e cilësive të besimtarëve të vërtetë, të atyre që e bëjnë adhurimin vetëm për All'llahun dhe krahasimi i tyre me jobesimtarët fanatikë, të përmendur në pjesën e parë; këtu përcaktohet plotësisht pozita e çdonjërit prej dy grupimeve. Në vijim do të shohim se këto cilësi përbëjnë një grup cilësish të larta e të punëve të mira, luftimin e pasioneve, zotërimin e ndërgjegjes dhe ndjenjën e respektit ndaj përgjegjesisë shoqërore.

Emri i kësaj sureje është marrë prej ajetit të saj të parë, ku Kur’ani është përmendur me emrin “*elfurkàn*” – “*ndarësi në mes të vërtetës dhe të gabuarës*”.

Mirësitë e sures “El Furkan”


Në një hadith të ardhur prej Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thuhet: “Kush e lexon suren “El Furkan” (e studion përmbajtjen e saj dhe punon sipas asaj që thuhet në të), në Ditën e Gjykimit do të ringjallet si besimtar, që ka besuar plotësisht se Ora e Fundit do të vijë patjetër dhe se All'llahu do t'i ringjallë të gjithë banorët e varreve”.¹

Në një transmetim të cituar prej Is'hàk bin Am'màr, prej Imamit Ebù Hasen Mùsà bin Xhafer, lexojmë se ai ka thënë: “O djali i Am'marit, mos e lër pa e lexuar suren: **“i madhëruar është Ai që i zbriti “Furkànin” robit të Tij...”!** Kush e lexon këtë sure çdo natë, atë All'llahu as nuk do ta ndëshkojë e as nuk do ta marrë në llogari; vendbanimi i tij do të jetë lulishtja më e lartë “Firdeus” e Xhennetit”.²

Ajetet 1 - 2

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 7, f. 159, fundi i ajetit që është objekt studimi.

² “Thevâbul A'màli” e Sadukut, f. 109, cituar sipas tefsirit “Nuruth Thekalejn”, vëll. 4, f. 155.



Me emrin e All'llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

“Zotërues i mirësive të vazhdueshme e të përhershme është Ai që i zbriti Furkànin (Kur’anin) robit të Vet që të jetë paralajmërues (Profet) për të gjitha botët.”

“Vetëm Atij i takon sundimi i qiejve e i tokës, Ai s’ka fëmijë, Ai s’ka ortak në sundimin e Tij; Ai krijoi të gjitha sendet dhe i mundësoi ato në mënyrën më të plotësuar.”

Komentimi

Matësi më i lartë për njohjen

Kjo sure fillon me fjalën “*tebàreke*”; rrënja e kësaj fjale është “*bereketun*”, e cila ka kuptimin: “**begati, mirësi e vazhdueshme dhe e përhershme**”. Sendi që ka mirësi të vazhdueshme është i përhershëm dhe dobitë që vijnë prej tij janë të plotësuar, ashtu siç njofton All'illahu, i Larti, me fjalën e Tij: “**Zotërues i mirësive të vazhdueshme e të përhershme është Ai që i zbriti Furkànin (Kur'anin) robit të Vet që të jetë paralajmërues (Profet) për të gjitha botët.**”¹.

Në këtë ajet vërtetohet cilësia e begatisë së përhershme për Krijuesin e Gjithëpushtetshëm, të Gjithëfuqishmin. Kjo begati realizohet me zbritjen e “**Furkanit**” – “**ndarësit**”; pra, Ai ka zbritur një Kur'an që e ndan të vërtetën nga e gabuara. A mund të ketë mirësi e begati më të madhe për njeriun, sesa të ketë në dorën e tij mjetin e njohjes, atë që i mundëson të dallojë të vërtetën nga e gabuara?

Këtu duhet të shpjegojmë se fjala “*el furkàn*” në Kur'anin Famëlartë herë ka ardhur në kuptimin e Kur'anit, herë në

¹ Kuptimi i fjalës “*elberekeh*” është shpjeguar në fundin e komentimit të ajetit 54 të sures “El A'ràf”.

kuptimin e mrekullisë me të cilën dallohet e vërteta nga e gabuara dhe herë tjetër në kuptimin e Teuratit.

Shtrohet pyetja: A tregojnë dy emrat “*Furkàn*” dhe “*Kur’an*” dy gjëra të ndryshme, apo vetëm një të vetme? Kur’an do të thotë tërësia e librit të All’liahut dhe “*Furkàn*” do të thotë detyrimi për të punuar sipas Kur’anit.¹

S’ka asnjë kontradiktë kur themi se “*Furkàn*” janë të gjitha ajetet e Kur’anit dhe se qëllimi me këtë fjalë është se ajetet e Kur’anit që përmbajnë dispozita, vërtetojnë me mënyrën më të qartë ndarjen në mes të vërtetës dhe të gabuarës.

“**Fur’kani**” – “**Ndarësi**” - është dhurata më e madhe e më e rëndësishme për njeriun, sepse Kur’ani Famëlartë e ka përdorur fjalën “**Furkan**” si shpërblimin më të madh për ata që i ruhen frikës së All’liahut (*mut’tekinët*): “**O besimtarë, nëse keni frikë All’liahun, Ai do të bëjë për ju një ndarës** (që me atë të dalloni të vërtetën nga gabuara).” (sure “El Enfâl”, ajeti 29.)

Pa frikën prej All’liahut nuk është e mundur të dallohet e vërteta nga e gabuara, sepse dëshirat, fajet e mëkatet e mbulojnë të vërtetën me një mbulesë të trashë, e errësojnë shikimin e njeriut dhe nuk e lënë as të shikojë në të vërtetën e as të mendojë se si është ajo.

Gjithsesi, Kur’ani Famëlartë është “**Furkani**” – “**Ndarësi**” në shkallën më të lartë.

Në sistemin e jetës njerëzore, Kur’ani është mjeti për të përcaktuar se cila është e vërteta dhe cila është e gabuara.

¹ Tefsiri “El Burhàn”, vëll. 3, f. 155.

Gjithashtu, Kur'ani është mjeti për të përcaktuar se cila është e vërteta dhe cila e gabuara në jetën individuale dhe në atë shoqërore; Kur'ani është peshorja dhe guri i provës në fushën e mendimeve, besimeve, ligjeve, dispozitave, edukatës dhe moralit.

Këtu duhet t'i japim vëmendjen e duhur frazës së ajetit: **“i zbriti Furkànin (Kur'anin) robët të Vet.”**. Vetëm pozita e robërisë së plotë dhe e udhëzimit, e realizon mundësinë e zbritjes së Furkanit (ndarësit të së vërtetës nga e gabuara) dhe vënien e së vërtetës dhe të gabuarës në dy anët e peshores.

Pika e fundit e shtruar në këtë ajet shpjegon me qartësi të plotë se qëllimi përfundimtar i Furkanit është paralajmërimi për të gjitha botët. Ky paralajmërim lidhet me ndjenjën e përgjegjësisë ndaj obligimeve, me të cilat është ngarkuar njeriu; gjithashtu, edhe fjala **“botët”** tregon se ligji i fesë islame është i përbotshëm dhe nuk është i veçantë as vetëm për një rajon të kufizuar, as vetëm për një popull, dhe as vetëm për ndonjë racë të veçantë. Sipas disa interpretuesve të Kur'anit, kjo fjalë tregon se Profeti i Islamit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është vula e të gjithë Profetëve, domethënë se pas tij nuk vjen më asnjë profet. Ata kanë shpjeguar se fjala **“botët”** është e pakufizuar në kohë dhe në hapësirë, pra ajo përfshin edhe të gjithë brezat e ardhshëm.

Ajeti i dytë e përshkruan All'llahun, Zbritësin e Furkanit, me katër cilësi. Njëra prej këtyre cilësive është baza dhe të tjerat janë degë të saj. Në fillim, ajeti njofton: **“Vetëm Atij i takon sundimi i qiejve e i tokës.”**

Po, Ai është Sunduesi i gjithçkaje që ekziston; Ai është Sunduesi i qiejve dhe i tokës; asnjë send nuk mbetet jashtë

qeverisjes së Tij. Nëse vërejmë me kujdes nga ana gjuhësore në të dyja frazat **“Atij i takon”** dhe **“sundimi i qiejve”**, do të konstatojmë se kemi të bëjmë me një argument të përcaktuar, prej të cilit mësohet se qeverisja reale dhe sundimi absolut në qiej e në tokë i takojnë vetëm All'llahut të Lartësuar, për faktin se sundimi i Tij është i përgjithshëm, i përjetshëm dhe i vërtetë. E kundërta ndodh me sundimin e njerëzve, që është sundim i pjesshëm dhe që tronditet; në të njëjtën kohë, sundimi i njerëzve ka lidhje me të Gjithëfuqishmin.

Më pas, ajeti shpalos besimet e politeistëve, njërin pas tjetrit, besimet që ata kishin në lidhje me Krijuesin. Për këtë, All'llahu njofton: **“Ai s’ka fëmijë.”**¹

Më lart thamë se nevoja për të pasur fëmijë shihej si e domosdoshme për përfitimin e krahut të punës, ose që prindi të gjente mbështetje tek fëmija kur të ishte i pafuqishëm dhe i pamundur për shkak të pleqërisë, ose kur të mbetej vetëm; por, dihet mirë se Zoti i Lartësuar është krejtësisht i pastër prej këtyre nevojave njerëzore.

Me këtë arsyetim hidhet poshtë besimi i të krishterëve se **“Mesihu”** (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) është biri i All'llahut, ose besimi i jehudive se **“Uzejri”** është biri i All'llahut, si dhe besimi i politeistëve arabë. Më pas, All'llahu thotë: **“Ai s’ka ortak në sundimin e Tij.”**

Në besimin e politeistëve arabë, Zoti kishte një ose disa ortakë. Në adhurimin e tyre, ata kishin iluzionin që t’i

¹ Më shumë sqarime rreth mohimit të fëmijës për All'llahun e Lartësuar dhe argumentet për këtë të vërtetë, janë dhënë në komentimin e ajetit 116 të sures **“El Bekare”**.

drejtoheshin këtyre ortakëve të All'lahut për ndërmjetësim dhe t'u kërkonin ndihmë për kryerjen e nevojave; madje puna arrinte deri aty, saqë kur këndonin "*telbijen*" ("iu përgjigjëm thirrjes Tënde") gjatë kryerjes së vizitës në Qabe, e bënë këtë me fraza idhujtarie, siç ishte lutja e tyre: "Iu përgjigjëm thirrjes Tënde, ti s'ke ortak, me përjashtim të një ortaku që është vetëm për Ty; Ti e ke nën sundim atë që ka edhe ai nën sundimin e tij". Kur'ani Famëlartë, jo vetëm që i hodhi poshtë të gjitha këto iluzione, por edhe i dënoi shumë rëndë.

Në frazën e fundit të ajetit, i Gjithëfuqishmi njofton: **"Ai krijoi të gjitha sendet dhe i mundësoi ato në mënyrën më të plotësuar."**

Ajeti tregon të kundërtën e besimit të "*thanevive*" (*dualistëve*), të cilët besonin se një pjesë e krijesave të kësaj bote janë krijesa të All'lahut dhe pjesa tjetër janë krijesa të djallit.

Kështu i rendisnin dhe i ndanin ata krijimin dhe krijesat në mes të All'lahut e djallit. Këtë ndarje e bënë ngaqë kishin iluzionin se bota është e përbërë prej së "*mirës*" dhe së "*keqes*". Në këndvështrimin e atij që beson vetëm në All'lahun, Zotin Një e të Vetëm, bota e ekzistencës s'ka gjë tjetër përveç të mirës dhe, kur ne e shikojmë të keqen, ajo ose është e "*pjesshme*", ose "*nuk ekziston*", ose është rezultat i punëve tona.

Dy hulumtime

1- Krijimi i qenieve me të gjitha imtësitë

Sistemi i hollësishëm dhe i përkryer i botës nuk është argumenti i vetëm që tregon urtësinë për njohjen e All'Ilahut dhe të besimit se Ai është Zoti Një dhe i Vetëm (*Teuhid*), pasi argument tjetër i qartë për këtë është edhe fuqia e Tij e plotë për krijimin e sendeve deri në imtësi; madje ne e kemi të pamundur të shprehemi në lidhje me qeniet e ndryshme të kësaj bote, për format që ato kanë, për mënyrën se si janë llogaritur nevojat e tyre deri në hollësitë më të imëta, prandaj edhe befasohemi kur llogaritë nuk përputhen me të gjitha mundësitë që njohim.

Shkencëtarët e kësaj fushe kanë zbuluar disa nga sekretet e habitshme që trullosin mendjen e njeriut dhe që e bëjnë gjuhën e tij vetëm të mërmërisë e të pranojë pa asnjë eksperiment madhështinë dhe fuqinë e Krijuesit.

Në vijim, po shpalosim një rën anë të kësaj çështjeje:

Shkencëtarët thonë se sikur korja e tokës të ishte më e trashë nga sa është, qoftë edhe disa këmbë, oksigjeni, i cili konsiderohet si elementi bazë për jetën, nuk do të ekzistonte; gjithashtu, edhe detrat, sikur të ishin më të thella nga sa janë realisht, qoftë edhe vetëm disa këmbë, me siguri që do të kishin thithur të gjithë karbonin e oksigjenin që është në atmosferë. Për rrjedhojë, jeta nuk do të ekzistonte, as kafshët e as bimët mbi të gjithë sipërfaqen e tokës, për shkak se vetë korja e tokës dhe detrat

do ta thithnin të gjithë oksigjenin dhe njeriu do të rrinte në pritje të rritjes së bimësisë, në mënyrë që të merrte frymë.

Sipas llogaritjeve të hollësishme në këtë fushë, shpjegohet qartë se për oksigjenin ka burime të ndryshme, por cilido të jetë ai burim, sasia e tij është në përputhje të plotë me nevojat.

Nëse shtresa e atmosferës do të ishte më e hollë nga ç'është, me miliona yje që digjen në shtresat e jashtme të atmosferës, do të godisnin të gjitha pjesët e globit tokësor. Dihet se shpejtësia e lëvizjes së këtyre yjeve që digjen, është dyzet e gjashtë milje në sekondë, çka do të thotë se ato do të digjin gjithçka në tokë; por edhe sikur shpejtësia e këtyre yjeve që shkëputen, do të ishte e barabartë me shpejtësinë e plumbit të pushkës, përsëri ato do grumbulloheshin të gjithë mbi tokë dhe përfundimi do të ishte katastrofik, pasi njeriu edhe sikur të përplasët me një yll të tillë shumë të vogël, por që lëviz me shpejtësi që është nëntëdhjetë herë më e madhe se shpejtësia e predhës së pushkës, do të shndërrohej në hi prej nxehtësisë së tij.

Trashësia e mbulesës së atmosferës është e llogaritur saktësisht të jetë vetëm aq sa është e nevojshme, pasi vetëm ashtu, ajo lejon kalimin e rrezeve me efekte kimike, për të cilat kanë nevojë të mbjellat. Këto rreze vrasin mikrobet dhe prodhojnë vitaminat pa e dëmtuar njeriun, me përjashtim të rasteve kur vetë ai, me vullnetin e tij, e ekspozon veten ndaj tyre për një kohë më të gjatë nga sa ç'është e nevojshme. Gjithashtu, edhe me daljen e gazrave prej thellësive të tokës gjatë gjithë kohërave, kur dihet se shumica e tyre janë helmuese, ajri mbetet prapë i pastër, nuk ndotet, nuk pëson ndonjë ndryshim dhe përbërësit e tij janë

gjithmonë në përpjestimin e duhur, që mundëson ekzistencën e jetës së njeriut.

Ekziston një ekuilibër i madh në të gjithë hapësirën e madhe ujore, në detra dhe oqeanë, që janë burimi i jetës, ushqimit, shiut, klimës së përshtatshme; së fundi, njeriu merr prej detrave e oqeanëve të gjithë elementët që i mundësojnë atij jetën. Kushdo që e kupton këtë realitet, do të mendojë dhe në shpirtin e tij do ta ndjejë se ndodhet përpara madhësisë së All'llahut të Lartësuar dhe menjëherë do të pohojë detyrimin e tij për të falënderuar.

2- Përshtatja dhe harmonia midis sendeve

Raporti i mahnitshëm në mes të oksigjenit dhe dioksidit të karbonit në lidhje me jetën e gjallesave dhe me botën bimore, ka ngjallur frikë në sytë e çdo dijetari, që ka menduar për këtë çështje, ndonëse jo të gjithë e kanë kuptuar deri më sot rëndësinë e madhe të dioksidit të karbonit. Dioksidi i karbonit është gazi i zakonshëm që shtohet në shishet e ujit të gazuar; është një gaz me peshë të rëndë dhe, për fat të mirë, ai lidhet me tokën dhe nuk ndahet në dy përbërësit e tij: oksigjen dhe karbon, përveçse në raste të rralla. Kur ndizet zjarri, druri që në shumicën e tij përbëhet nga oksigjeni, karboni dhe hidrogjeni, zbërthehet nën efektin e nxehtësisë dhe karboni lidhet ngushtësisht me oksigjenin, duke përfutur dioksidin e karbonit; edhe hidrogjeni, që çlirohet nga nxehtësia e zjarrit, lidhet me të njëjtin intensitet me oksigjenin, nga ku përftohet avulli i ujit, kurse pjesa më e madhe e tymit është karbon i pastër, i palidhur me ndonjë element tjetër.

Kur njeriu merr frymë, ai thith oksigjenin, i cili kalon në gjak, nga ku shpërndahet në të gjitha pjesët e trupit; është pikërisht ky oksigjen që e djeg ushqimin e tij në çdo qelizë me një ngadalësi të përpiktë dhe me një gradë nxehtësie relativisht të ulët. Nga kjo djegie e brendshme, përftohen përsëri dioksidi i karbonit dhe avulli i ujit.

Nga ky proces, dioksidi i karbonit depërton në të dyja mushkëritë dhe rikthehet në atmosferë në saje të nxjerrjes së frymës; domethënë çdo qenie e gjallë thith oksigjen dhe nxjerr jashtë trupit të vet dioksidin e karbonit.

A mund të ketë sistem më të mahnitshëm dhe balancim më të përkryer se ky që është, i cili e ndalon çdo kafshë, pavarësisht nga egërsia, nga madhësia e trupit apo nga dinakëria e saj, të jetë sunduese mbi botën? Njeriu, dhe vetëm njeriu, e ka mundësinë ta përmbysë këtë barazpeshim të natyrës. Për këtë përmbysje, shumë shpejt mbi të do të bien pasojat, të shoqëruara me përhapje sëmundjesh të ndryshme ndër kafshët, insektet dhe bimët. Katastrofa e ardhshme është e qartë dhe dëshmon për rëndësinë e madhe të këtyre raporteve e ekuilibrave që lidhen me ekzistencën e vetë njeriut.

Para disa vitesh, në Australi njerëzit mbollën një lloj kaktusi, që të shërbente si gardh mbrojtës, por kjo bimë u përhap me aq shpejtësi, sa zaptoi një sipërfaqe të madhe toke, afërsisht sa sipërfaqja e Anglisë, duke shkatërruar të mbjellat. Si përfundim, ato toka u bënë të papërshtatshme për bujqësi; veç kësaj, njerëzit nuk po gjenin ndonjë mjet që të ndalonin përhapjen e kaktusit. Australia u vu nën rrezikun e pushtimit të një ushtrie bimësh të

heshtura, që përparonin në rrugën e tyre, duke i kapërcyer të gjitha pengesat.

Kështu, për ta trajtuar këtë fenomen, u mbledhën shkencëtarë nga e gjithë bota. Së fundi, ata zbuluan ekzistencën e një insekti, i cili jetonte vetëm në këtë lloj kaktusesh dhe nuk hante ushqim tjetër përveç tyre. Për më tepër, ky insekt përhapej me shumë shpejtësi dhe në Australi nuk kishte asnjë armik që ta ndalonte. Kjo ushtri insektesh triumfoi shumë shpejt mbi kaktusët dhe më pas u tërhoq. Prej atij lloj insekti, në Australi ka mbetur fare pak, aq sa është e mjaftueshme për të ndaluar përhapjen e kaktusit një herë e përgjithmonë.

Kështu plotësohen të gjithë rregullatorët dhe ekuilibrat, që në fakt janë përherë në të njëjtën masë.

Përse mushkonja përhapëse e malaries, nuk është gjithmonë sunduese në botë dhe të vrasë njerëzit, ndonëse është e përhapur në të gjitha pjesët e tokës, madje edhe në dy polet e saj? E njëjta gjë mund të thuhet edhe për mushkonjën e llojit tjetër, që përhap sëmundjen e etheve të verdha. Edhe kjo mushkonjë është ngjitur deri në zonat veriore të tokës, madje në një stinë, ajo ka arritur deri në Nju Jork.

Përse miza gjumëvënëse “ce-ce” që jeton vetëm në zonat e nxehta të globit tokësor nuk është zhvilluar e nuk është e aftë të jetojë edhe në zona të tjera të tokës, që ta shuante specien njerëzore? Mjafton të përmendim sëmundjen e murtajes, sëmundjet infektive dhe mikrobet vrasëse, për të cilat deri në të djeshmen e afërt njeriu s’kishte asnjë masë profilaktike, për shkak se ai nuk dinte asgjë mbi rregullat e higjienës e të profilaksisë për

ruajtjen e shëndetit. Qëndrimi i species njerëzore në jetë, krahas gjithë këtyre elementëve e faktorëve asgjësues, është në të vërtetë një realitet që të habit.¹

¹ Marrë nga libri “Njeriu nuk është i vetëm” i autorit Kris Morison, i përkthyer nga Mahmud Sàlih El Felekij, me titull: “Shkenca bën thirrje për besim”, në faqet: 65, 66, 70, 71, 159 dhe 160.

“Mirëpo ata (politeistët) nuk adhurojnë Atë por adhurojnë zota të tjerë që nuk krijojnë asnjë send, sepse vetë janë të krijuar dhe për veten e tyre nuk kanë në dorë as të dëmtojnë e as të sjellin

ndonjë dobi, s'kanë në dorë as vdekjen, as jetën, e as Ringjalljen (pas vdekjes)."

"Ata që nuk besuan thanë: këtë (Kur'anin) e ka shkruar vetë ai (Muhammedi) me ndihmën e disa të tjerëve; ata (politeistët) thanë një të pavërtetë dhe stisën një shpifje."

"Ata thanë (për Kur'anin) janë legjenda të të parëve dhe që ai (Muhammedi) kërkoi t'i shkruanin dhe i lexohen atij mëngjes e mbrëmje."

"Thuaj: atë e zbriti Ai që di të fshehtë në qiej e në tokë, Ai fal shumë, Ai është Mëshirëploti."

Komentimi

Akuza të ndryshme

Këto ajete janë një plotësim i studimit mbi ajetet e mëparshme, që flisnin për shoqërimin e All'llahut me ortakë të tjerë dhe adhurimin e idhujve. Më pas, u kalua në trajtimin e pretendimeve të adhuruesve të idhujve dhe akuzave që ata lëshonin kundër Kur'anit dhe Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Ajeti i parë u bën thirrje adhuruesve të idhujve, që të gjykohen njëri me tjetrin, me qëllim që mendja e tyre të vihej në lëvizje me një logjikë të qartë e të thjeshtë. Në të njëjtën kohë, ky

ajet u flet atyre në mënyrë të prerë dhe i refuzon besimet e tyre të gabuara: **“Mirëpo ata (politeistët) nuk adhurojnë Atë por adhurojnë zota të tjerë që nuk krijojnë asnjë send, sepse vetë janë të krijuar.”**.

Ajeti u thotë atyre se i Adhuruari i vërtetë është Krijuesi i gjithësisë. Gjithashtu, edhe vetë politeistët nuk pretendojnë se idhujt e tyre kanë fuqi të krijojnë. Ata besojnë se edhe idhujt që adhurojnë, janë krijesa të All'Ilahut.

Atëherë, ç'motive i shtyjnë ata të adhurojnë idhujt, të cilët s'kanë fuqi t'i sjellin vetes së tyre as ndonjë dobi e as t'i shkaktojnë ndonjë dëm?! Ata idhujt nuk zotërojnë as jetën, as vdekjen, as Ringjalljen pas vdekjes. Pra, si mund të kenë mundësi për të tjerët?!

Në ajet thuhet: **“dhe për veten e tyre nuk kanë në dorë as të dëmtojnë e as të sjellin ndonjë dobi, s'kanë në dorë as vdekjen, as jetën e as Ringjalljen (pas vdekjes).”**.

Pesë bazat e rëndësishme për njeriun që përmenden në këtë ajet, janë: dobia, dëmi, vdekja, jeta dhe Ringjallja pas vdekjes.

Meqenëse idhujt s'kanë fuqi për këto punë as për veten e vet, si mund t'i kenë në dorë këto punë për idhujtarin që i adhuron ato?!

Ç'është kjo logjikë e pakuptimtë, që e bën njeriu të ulë veten, të drejtohet e të përulet para një idhulli, që s'ka mundësi të veprojë sipas vullnetit të vet?! Si është e mundur që një i pafuqishëm i tillë të veprojë për të tjerët?!

Idhujt janë të pafuqishëm për zgjidhjen e ndonjë problemi të adhuruesve të tyre në jetën e kësaj bote, prandaj prej tyre s'mund të shpresohet ndonjë gjë në Botën Tjetër.

Kjo tregon se adhuruesit e idhujve, për të cilët bëhet fjalë në këtë ajet, në njëfarë mënyre e pranonin Ringjalljen pas vdekjes (ata pranonin ringjalljen shpirtërore, por jo atë trupore). Gjithashtu, Kur'ani u flet adhuruesve të idhujve drejtpërdrejt dhe i njofton ata në mënyrë të prerë, se e hedh poshtë besimin e tyre të gabuar. Kjo mënyrë bisede është e zakonshme, pasi njeriut i ndodh të jetë përpara një personi që e mohon të vërtetën, por ai, me fjalën e tij, tregon se është në përputhje me mendimet e bashkëbiseduesit. Kështu njeriu nuk u kushton kujdes mendimeve të këtij mohuesi të së vërtetës. Në këtë ajet gjendet një argument i brendshëm, që tregon se kur Krijuesi e krijon një send, Ai zotëron jo vetëm vdekjen e kësaj krijese, por edhe jetën e saj. Gjithashtu, Krijuesi e ka në dorë të sjellë dëm ose dobi për krijesën. Krijuesi nuk e krijoi krijesën e Vet pa ndonjë qëllim, por ky qëllim i Tij për njerëzit, nuk mund të kuptohet pa besimin në Ringjalljen pas vdekjes. Nëse me vdekjen e njeriut do të merrte fund çdo gjë, atëherë jeta do të ishte e pakuptimtë. Nga ana tjetër, kjo do të tregonte se një Krijuesi të tillë i mungon urtësia.

Kur mendojmë me kujdes në këtë ajet, do të vëmë re se çështja e *"dëmit"*, është përmendur para *"dobisë"*. Kjo ndodh për faktin se njeriu, në radhë të parë, i largohet dëmit me shpejtësi, prandaj fraza *"sprapsja e dëmit ka përparësi ndaj tërheqjes së dobisë"* konsiderohet si njëri prej ligjeve logjike.

Fjalët: **"dëm", "dobi", "vdekje" dhe "Ringjallje pas vdekjes"** në këtë ajet, kanë ardhur në numrin shumë, me qëllim

që të shpjegojnë se idhujt që adhurojnë idhujtarët nuk kanë fuqi as të sjellin dobi, as të bëjnë dëm. Ata s'kanë fuqi as për vdekjen, as për jetën e as për Ringjalljen pas vdekjes. Atëherë, si mund të mendojë njeriu, se idhujt i zotërojnë këto punë në të gjitha burimet?!

Gjithashtu, në këtë ajet, format mohuese: **“nuk zotërojnë”** dhe **“nuk krijojnë”**, janë përmendur në numrin shumë të gjinisë mashkullore, që në gjuhën arabe përdoren kur bëhet fjalë për qeniet me logjikë, ndërkohë që idhujt e punuar prej guri ose druri, s'kanë as mendje e as ndjenja. Por biseda e drejtpërdrejtë nuk ka të bëjë me këta idhuj, por me njerëzit që adhurojnë engjëjt, ose Mesihun. Në këtë fjali përdoren në të njëjtin kuptim të përbashkët, si sendet pa logjikë, ashtu edhe ato që kanë logjikë. Prandaj, dy foljet e përmendura në ajetin që është objekt studimi, kanë ardhur në trajtën që përdoret për qeniet me logjikë. Është e kuptueshme se kjo mënyrë përdorimi nga ana letrare tregon “shumicë”.

Ka mundësi që biseda e drejtpërdrejtë në këtë frazë, të jetë në përputhje me besimin e atyre që u drejtohet fjala, me qëllim që të vërtetohet pamundësia e idhujve që ata adhurojnë. Në ajet thuhet: Kur ju besoni se idhujt kanë mendje e ndjenja, atëherë përse ata s'kanë mundësi ta sprapsin dëmin prej vetes, ose t'i sjellin dobi vetes së vet?!

Ajeti vijues trajton analizën e jobesimtarëve, ose më saktë argumentet që ata stisnin përballë thirrjes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): **“Ata që nuk besuan thanë: këtë (Kur'anin) e ka shkruar vetë ai (Muhammedit) me ndihmën e disa të tjerëve”**.

Në të vërtetë, jobesimtarët, për të mos e marrë mbi shpatullat e tyre përgjegjësinë e së vërtetës, akuzuan të Dërguarin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ashtu siç patën bërë të gjithë ata që i kanë kundërshtuar udhëheqësit hyjnorë gjatë gjithë historisë. Fillimisht, ata e akuzuan për shpifje e për rrenë. Gjithashtu, nëse do të shohim me kujdes, do të vëmë re se në këtë ajet, në vend të fjalës Kur'an, është përdorur përemri **"ky"**, për të treguar se adhuruesit e idhujve e urrenin aq shumë Kur'anin, sa nuk donin t'ia zinin as emrin me gojë.

Veç kësaj, për të vërtetuar se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e kishte të pamundur të sillte Kur'anin, sepse ardhja më këtë fjalë të qartë e të mbushur me kuptime kërkonte kapacitete të mëdha shkencore, jobesimtarët thanë se ky Libër ishte një plan i rregulluar dhe i llogaritur deri në hollësi dhe se në këtë punë, ai nuk ishte i vetëm, por e kishin ndihmuar njerëz të tjerë. Me **"të tjerët"** ata kishin parasysh tre prej ithtarëve të librave të mëparshëm, që ishin: "Ad'dasi", "Jesari" dhe "Habri", ose "Xhebri".

Sidoqoftë, temat për të cilat fliste Kur'ani nuk njiheshin në mesin e idhujtarëve të Mekës, por një pjesë e tyre, siç ishin tregimet mbi Profetët e mëparshëm, qarkullonin edhe ndër jehuditë dhe ithtarët e librave të mëparshëm. Prandaj, adhuruesit e idhujve të Mekës ishin të detyruar që pretendimet e tyre t'ua adresonin ithtarëve të librave të mëparshëm dhe thanë se ata ishin ndihmës të tij. Këtë shpifje, ata e bënë me qëllim që të shuanin mahnitjen që shkaktohej ndër njerëzit, kur dëgjonin ajetet e Kur'anit.

Por Kur'ani u përgjigjet atyre vetëm me një fjali dhe u thotë: **“thanë një të pavërtetë dhe stisën një shpifje.”**

Në këtë ajet, fjala **“të pavërtetë”**, tregon se burrin besnik, të pastër dhe të sinqertë siç është i Dërguari më i nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ata e akuzuan dhe thanë se ai shpifte kundrejt All'llahut dhe se bashkëpunonte me një grup prej ithtarëve të librave të mëparshëm. Në radhë të parë, me këtë akuzë, ata thanë një të pavërtetë kundër vetes së vet; njëkohësisht bënë një padrejtësi ndaj të gjithë njerëzve.

Edhe fjala tjetër e ajetit **“zùren”** - **“shpifje”**, që ata e thonin me aq ngulm, nuk kishte asnjë bazë, sepse Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u kishte bërë thirrje disa herë që të sillnin vetëm një sure, ose vetëm disa ajete si ato të Kur'anit, por ata nuk patën mundësi ta bënin këtë gjë dhe u treguan të pafuqishëm përballë kësaj sfide të hapur.

Ky fakt tregon se njerëzit nuk i bënin dot ajetet e Kur'anit, sepse sikur të ishte punë që mund ta bënin ata, idhujtarët e Mekës do të kishin mundësi që me ndihmën e një grupi jehudish, ose të ithtarëve të librave të mëparshëm, të bënin ajete të ngjashme me ato të Kur'anit. Prandaj, pamundësia e tyre për ta bërë këtë gjë, është një argument që vërteton gënjeshtërinë e tyre, e cila është edhe një padrejtësi në vetvete.

Për të gjitha këto, fjalia e ajetit thotë: **“thanë një të pavërtetë dhe stisën një shpifje”**, është një përgjigje e arrirë, që hedh poshtë pretendimet e tyre mjerane.

Në rrënjën e saj, fjala e ajetit **“shpifje”**, tregon pjesën e sipërme të kraharorit, por më pas ajo u përdor për të treguar çdo send që anohet dhe nuk është në kufirin e mesit; edhe fjala **“rrenë”**, ka kuptimin e devijimit nga e vërteta dhe animet nga e pavërteta, nga e gabuara, prandaj u quajt **“shpifje”**.

Ajeti vijues trajton një aspekt tjetër të analizave të devijuara dhe të argumenteve mjerane të adhuresve të idhujve në lidhje me Kur'anin, për të cilin thonin: **“Ata thanë (për Kur'anin) janë legjenda të parëve dhe që ai (Muhammedi) kërkoi t'i shkruanin.”**.

Sipas tyre, tek ai s'ka asgjë që të jetë prej tij, s'ka as dituri e as ndonjë gjë të re. Pra, si mund të pretendonte ai për profetësi e për shpallje?! Idhujtarët vazhdonin shpifjen kundër Profetit të nderuar (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe thonin: **“Në të vërtetë, ai ndihmohet nga të tjerë; ai ka mbledhur disa prej miteve e legjendave të vjetra dhe ato i quan shpallje e libër qiellor. Për më tepër, ai pretendon se ato i frymëzohen gjatë natës. Idhujtarët thonin se këtë ai e bënte që të arrinte qëllimin e vet, ashtu siç njofton ajeti: **“dhe i lexohen atij mëngjes e mbrëmje.”****.

Me këto fjalë ata pretendonin se Profeti e merrte ndihmën për qëllimin e tij, në kohët kur prania e njerëzve ishte shumë e vogël, pra herët në mëngjes dhe natën.

Në të vërtetë, këto fjalë të adhuresve të idhujve, shërbejnë si shpjegim dhe sqarim për akuzat e tyre, për të cilat flet ajeti i mëparshëm. Me këtë frazë të shkurtër, ata kishin për qëllim që t'i mvishnin Kur'anit disa pika të dobëta.

Pika e parë e dobët sipas tyre, ishte se Kur'anit nuk është një libër i ri, por thjesht një grumbullim mitesh e legjendash të vjetra.

Pika e dytë e dobët sipas tyre, ishte se Profeti i Islamit s'kishte mundësi ta vazhdonte thirrjen e tij, qoftë edhe një ditë të vetme, pa ndihmën e të tjerëve, se temat e thirrjes i lexoheshin atij çdo mëngjes e çdo natë dhe se detyra e tij e vetme ishte që t'i shkruante ato që i lexoheshin.

Pika e tretë e dobët sipas tyre, ishte se ai dinte të shkruante e të lexonte dhe se pretendimi i tij për analfabetizëm ishte i rremë.

Me këto gënjeshtër e akuza, adhuresit e idhujve të Mekës kishin si qëllim të ndanin e të largonin njerëzit prej Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), në një kohë kur të gjithë të mençurit që kishin jetuar gjatë kësaj kohe në atë shoqëri, e dinin mirë se ai nuk kishte mësuar te asnjë mësues. Veç kësaj, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) s'kishte asnjë lidhje me komunitetin e jehudive dhe me ithtarët e librave të mëparshëm. Megjithatë, idhujtarët e Mekës lëshonin akuza e shpifje të vazhdueshme kundër tij dhe thonin se ai frymëzohej prej të tjerëve çdo mëngjes e çdo mbrëmje. Atëherë, si ishte e mundur që këtë gjë të mos e merrte vesh askush? Ajetet e Kur'anit i shpallehin kur ai ishte në vendbanimin e tij, ose edhe kur udhëtonte, në prani të njerëzve, ose kur ishte vetëm; me fjalë të tjera, atij i shpallehin ajetet e Kur'anit në të gjitha gjendjet.

Ajetet e Kur'anit ishin një përmbledhje mësimesh që kishin të bënin me besimin, me dispozita praktike, me ligje, me tregime nga jetëshkrimet e Profetëve etj. Gjithashtu, këtu duhet shtuar se

në Kur'an gjenden edhe tregime për popujt e mëparshëm dhe, të gjitha këto, nuk ngjasonin aspak me ato që thuhën në dy dhiatat e rishikuara [Teurati dhe Inxhili (Ungjilli) i sotëm]. Këto tregime nuk ngjasonin as me legjendat mitologjike të arabëve. Ndërkohë që të dyja dhiatat e rishikuara janë të mbushura me mite e legjenda, Kur'ani është krejtësisht i pastër nga mitet e nga legjendat e të mëparshmëve. Po të bëjmë krahasimin mes Kur'anit dhe dy dhiatave, do të shihet qartë e vërteta.

Ajeti i fundit u përgjigjet këtyre akuzave mjerane dhe e urdhëron Profetin që t'u thotë atyre këto fjalë: **“Thuaj: atë e zbriti Ai që di të fshehtë në qiej e në tokë.”**.

Kjo frazë e ajetit tregon se përmbajtja e librit dhe sekretet e shumëllojshme që ndodhen në të - dituria, njoftimet, historitë e popujve të kaluar, ligjet, nevojat e njerëzve, deri edhe sekretet e natyrës e lajmet për të ardhmen - dëshmojnë se Kur'ani nuk është nga ato gjëra që mund të bëhen nga njerëzit dhe se ai nuk është bërë me ndihmën e këtij apo të një tjetri. Përmbajtja e Kur'anit dëshmon se ai buron vetëm prej Atij që ka dijeni të plotë për sekretet e qiejve e të tokës, dija e të Cilit përfshin gjithçka.

Megjithatë, Kur'ani Famëlartë e lë të hapur rrugën e edukimit edhe për këta njerëz me qëllim të keq, si dhe për të gjithë ata që kanë devijuar nga rruga e drejtë. Zoti, në fund të ajetit thotë: **“Ai fal shumë, Ai është Mëshirëploti.”**.

Në saje të mëshirës së Tij, Ai dërgoi Profetët dhe zbriti librat qiellorë; në saje të faljes së Tij, Ai do të falë të gjithë ata që besojnë dhe pendohen (për fajet e mëkatet që kanë bërë), edhe nëse mëkatet e tyre janë të shumta.

Një grup prej interpretuesve të Kur'anit janë të mendimit se fjala e ajetit “*iktetebehà*” - “**këtë** (Kur'anin) **e ka shkruar vetë ai** (Muhammedi)”, tregon se me këtë akuzë ata kishin për qëllim të thonin se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u kërkoi të tjerëve që t'i shkruanin këto ajete për të. Gjithashtu, edhe fraza “*tumlà alejhi*” - “**i lexoheshin atij**” ka kuptimin: ata ia lexonin atij dhe ai i mësonte përmendësh. Nëse do të shohim ato që janë thënë më lart, do të konstatojmë se s'ka asnjë argument që këto dy fraza të ajetit të interpretohen në kundërshtim me kuptimin që shprehin fjalët e tij, prandaj interpretimi që bëmë mbetet më i sakti. Në fakt, adhuresit e idhujve të Mekës kishin për qëllim që me anë të stisjes së shpifjeve, ta akuzonin Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*); ata shpifnin vërtet, kur thonin se ai di shkrim e lexim, por hiqet si analfabet.

Ajetet 7 - 10

𐀀 𐀁 𐀂 𐀃 𐀄 𐀅 𐀆 𐀇 𐀈 𐀉 𐀊 𐀋 𐀌 𐀍 𐀎 𐀏 𐀐 𐀑 𐀒 𐀓 𐀔 𐀕 𐀖 𐀗 𐀘 𐀙 𐀚 𐀛 𐀜 𐀝 𐀞 𐀟 𐀠 𐀡 𐀢 𐀣 𐀤 𐀥 𐀦 𐀧 𐀨 𐀩 𐀪 𐀫 𐀬 𐀭 𐀮 𐀯 𐀰 𐀱 𐀲 𐀳 𐀴 𐀵 𐀶 𐀷 𐀸 𐀹 𐀺 𐀻 𐀼 𐀽 𐀾 𐀿 𐁀 𐁁 𐁂 𐁃 𐁄 𐁅 𐁆 𐁇 𐁈 𐁉 𐁊 𐁋 𐁌 𐁍 𐁎 𐁏 𐁐 𐁑 𐁒 𐁓 𐁔 𐁕 𐁖 𐁗 𐁘 𐁙 𐁚 𐁛 𐁜 𐁝 𐁞 𐁟 𐁠 𐁡 𐁢 𐁣 𐁤 𐁥 𐁦 𐁧 𐁨 𐁩 𐁪 𐁫 𐁬 𐁭 𐁮 𐁯 𐁰 𐁱 𐁲 𐁳 𐁴 𐁵 𐁶 𐁷 𐁸 𐁹 𐁺 𐁻 𐁼 𐁽 𐁾 𐁿 𐂀 𐂁 𐂂 𐂃 𐂄 𐂅 𐂆 𐂇 𐂈 𐂉 𐂊 𐂋 𐂌 𐂍 𐂎 𐂏 𐂐 𐂑 𐂒 𐂓 𐂔 𐂕 𐂖 𐂗 𐂘 𐂙 𐂚 𐂛 𐂜 𐂝 𐂞 𐂟 𐂠 𐂡 𐂢 𐂣 𐂤 𐂥 𐂦 𐂧 𐂨 𐂩 𐂪 𐂫 𐂬 𐂭 𐂮 𐂯 𐂰 𐂱 𐂲 𐂳 𐂴 𐂵 𐂶 𐂷 𐂸 𐂹 𐂺 𐂻 𐂼 𐂽 𐂾 𐂿 𐃀 𐃁 𐃂 𐃃 𐃄 𐃅 𐃆 𐃇 𐃈 𐃉 𐃊 𐃋 𐃌 𐃍 𐃎 𐃏 𐃐 𐃑 𐃒 𐃓 𐃔 𐃕 𐃖 𐃗 𐃘 𐃙 𐃚 𐃛 𐃜 𐃝 𐃞 𐃟 𐃠 𐃡 𐃢 𐃣 𐃤 𐃥 𐃦 𐃧 𐃨 𐃩 𐃪 𐃫 𐃬 𐃭 𐃮 𐃯 𐃰 𐃱 𐃲 𐃳 𐃴 𐃵 𐃶 𐃷 𐃸 𐃹 𐃺 𐃻 𐃼 𐃽 𐃾 𐃿 𐄀 𐄁 𐄂 𐄃 𐄄 𐄅 𐄆 𐄇 𐄈 𐄉 𐄊 𐄋 𐄌 𐄍 𐄎 𐄏 𐄐 𐄑 𐄒 𐄓 𐄔 𐄕 𐄖 𐄗 𐄘 𐄙 𐄚 𐄛 𐄜 𐄝 𐄞 𐄟 𐄠 𐄡 𐄢 𐄣 𐄤 𐄥 𐄦 𐄧 𐄨 𐄩 𐄪 𐄫 𐄬 𐄭 𐄮 𐄯 𐄰 𐄱 𐄲 𐄳 𐄴 𐄵 𐄶 𐄷 𐄸 𐄹 𐄺 𐄻 𐄼 𐄽 𐄾 𐄿 𐅀 𐅁 𐅂 𐅃 𐅄 𐅅 𐅆 𐅇 𐅈 𐅉 𐅊 𐅋 𐅌 𐅍 𐅎 𐅏 𐅐 𐅑 𐅒 𐅓 𐅔 𐅕 𐅖 𐅗 𐅘 𐅙 𐅚 𐅛 𐅜 𐅝 𐅞 𐅟 𐅠 𐅡 𐅢 𐅣 𐅤 𐅥 𐅦 𐅧 𐅨 𐅩 𐅪 𐅫 𐅬 𐅭 𐅮 𐅯 𐅰 𐅱 𐅲 𐅳 𐅴 𐅵 𐅶 𐅷 𐅸 𐅹 𐅺 𐅻 𐅼 𐅽 𐅾 𐅿 𐆀 𐆁 𐆂 𐆃 𐆄 𐆅 𐆆 𐆇 𐆈 𐆉 𐆊 𐆋 𐆌 𐆍 𐆎 𐆏 𐆐 𐆑 𐆒 𐆓 𐆔 𐆕 𐆖 𐆗 𐆘 𐆙 𐆚 𐆛 𐆜 𐆝 𐆞 𐆟 𐆠 𐆡 𐆢 𐆣 𐆤 𐆥 𐆦 𐆧 𐆨 𐆩 𐆪 𐆫 𐆬 𐆭 𐆮 𐆯 𐆰 𐆱 𐆲 𐆳 𐆴 𐆵 𐆶 𐆷 𐆸 𐆹 𐆺 𐆻 𐆼 𐆽 𐆾 𐆿 𐇀 𐇁 𐇂 𐇃 𐇄 𐇅 𐇆 𐇇 𐇈 𐇉 𐇊 𐇋 𐇌 𐇍 𐇎 𐇏 𐇐 𐇑 𐇒 𐇓 𐇔 𐇕 𐇖 𐇗 𐇘 𐇙 𐇚 𐇛 𐇜 𐇝 𐇞 𐇟 𐇠 𐇡 𐇢 𐇣 𐇤 𐇥 𐇦 𐇧 𐇨 𐇩 𐇪 𐇫 𐇬 𐇭 𐇮 𐇯 𐇰 𐇱 𐇲 𐇳 𐇴 𐇵 𐇶 𐇷 𐇸 𐇹 𐇺 𐇻 𐇼 𐇽 𐇾 𐇿 𐈀 𐈁 𐈂 𐈃 𐈄 𐈅 𐈆 𐈇 𐈈 𐈉 𐈊 𐈋 𐈌 𐈍 𐈎 𐈏 𐈐 𐈑 𐈒 𐈓 𐈔 𐈕 𐈖 𐈗 𐈘 𐈙 𐈚 𐈛 𐈜 𐈝 𐈞 𐈟 𐈠 𐈡 𐈢 𐈣 𐈤 𐈥 𐈦 𐈧 𐈨 𐈩 𐈪 𐈫 𐈬 𐈭 𐈮 𐈯 𐈰 𐈱 𐈲 𐈳 𐈴 𐈵 𐈶 𐈷 𐈸 𐈹 𐈺 𐈻 𐈼 𐈽 𐈾 𐈿 𐉀 𐉁 𐉂 𐉃 𐉄 𐉅 𐉆 𐉇 𐉈 𐉉 𐉊 𐉋 𐉌 𐉍 𐉎 𐉏 𐉐 𐉑 𐉒 𐉓 𐉔 𐉕 𐉖 𐉗 𐉘 𐉙 𐉚 𐉛 𐉜 𐉝 𐉞 𐉟 𐉠 𐉡 𐉢 𐉣 𐉤 𐉥 𐉦 𐉧 𐉨 𐉩 𐉪 𐉫 𐉬 𐉭 𐉮 𐉯 𐉰 𐉱 𐉲 𐉳 𐉴 𐉵 𐉶 𐉷 𐉸 𐉹 𐉺 𐉻 𐉼 𐉽 𐉾 𐉿 𐊀 𐊁 𐊂 𐊃 𐊄 𐊅 𐊆 𐊇 𐊈 𐊉 𐊊 𐊋 𐊌 𐊍 𐊎 𐊏 𐊐 𐊑 𐊒 𐊓 𐊔 𐊕 𐊖 𐊗 𐊘 𐊙 𐊚 𐊛 𐊜 𐊝 𐊞 𐊟 𐊠 𐊡 𐊢 𐊣 𐊤 𐊥 𐊦 𐊧 𐊨 𐊩 𐊪 𐊫 𐊬 𐊭 𐊮 𐊯 𐊰 𐊱 𐊲 𐊳 𐊴 𐊵 𐊶 𐊷 𐊸 𐊹 𐊺 𐊻 𐊼 𐊽 𐊾 𐊿 𐋀 𐋁 𐋂 𐋃 𐋄 𐋅 𐋆 𐋇 𐋈 𐋉 𐋊 𐋋 𐋌 𐋍 𐋎 𐋏 𐋐 𐋑 𐋒 𐋓 𐋔 𐋕 𐋖 𐋗 𐋘 𐋙 𐋚 𐋛 𐋜 𐋝 𐋞 𐋟 𐋠 𐋡 𐋢 𐋣 𐋤 𐋥 𐋦 𐋧 𐋨 𐋩 𐋪 𐋫 𐋬 𐋭 𐋮 𐋯 𐋰 𐋱 𐋲 𐋳 𐋴 𐋵 𐋶 𐋷 𐋸 𐋹 𐋺 𐋻 𐋼 𐋽 𐋾 𐋿 𐌀 𐌁 𐌂 𐌃 𐌄 𐌅 𐌆 𐌇 𐌈 𐌉 𐌊 𐌋 𐌌 𐌍 𐌎 𐌏 𐌐 𐌑 𐌒 𐌓 𐌔 𐌕 𐌖 𐌗 𐌘 𐌙 𐌚 𐌛 𐌜 𐌝 𐌞 𐌟 𐌠 𐌡 𐌢 𐌣 𐌤 𐌥 𐌦 𐌧 𐌨 𐌩 𐌪 𐌫 𐌬 𐌭 𐌮 𐌯 𐌰 𐌱



“Ata (adhuruesit e idhujve) thanë: ç’është me këtë të dërguar që ha ushqime dhe që ecën nëpër tregje; përse të mos jetë i dërguar një engjëll së bashku me atë që të ishte paralajmërues.”

“Ose atij t’i jepej një thesar, apo të kishte një kopsht prej të cilit të ushqehet; idhujtarët mizorë u thanë (besimtarëve): ju po shkoni prapa një njeriu që e ka zënë magjia.”

“Shiko se çfarë shembujsh sjellin për ty, ata e kanë humbur rrugën dhe s’kanë mundësi të udhëzohen në rrugën e drejtë.”

“Zotëruesi i mirësive të përhershme është vetëm Ai që po të dëshirojë të jep ty edhe më të mirën nga ajo që ata thonë, (të jep) kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe bën për ty palate.”

Shkaku i zbritjes

Në një transmetim të ardhur prej Imam Hasan El Askerij thuhet: “E pyeta babain tim, Ali bin Muhammed: A ka debatuar dhe diskutuar i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me jehuditë dhe me adhuruesit e idhujve? Ai m’u përgjigj: Shumë herë. Një ditë, i Dërguari i All'llahut po rrinte në oborrin e Qabesë, kur Abdullah bin Ubej’j

El Makhzùmij iu drejtua me këto fjalë: 'O Muhammed, ke pretendime shumë të mëdha dhe thua fjalë të padëgjua. Ti thua se je i Dërguari i Zotit të botëve. Si ka mundësi që i Dërguari i Zotit të botëve dhe i Krijuesit të të gjitha krijesave, të jetë një njeri si puna jote, si të gjithë ne të tjerët, që ushqehet dhe ecën nëpër tregje si ne?!' I Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: 'O Zoti im! Ti që dëgjon çdo zë, Ti që ke dijeni për gjithçka, Ti e di edhe atë që thonë robtë e Tu'. Pas këtyre fjalëve, All'llahu zbriti ajetin: '**Ata** (adhuruesit e idhujve) **thanë: Ç'është ky i dërguar...**' deri tek fraza: '**dhe bën për ty pallate.**'"¹

Komentimi

Përse ky i Dërguar nuk ka në pronësi thesare e kopshte?

Në ajetet e mësipërme, Kur'ani shpalos një pjesë të problemeve që ngrinin jobesimtarët në lidhje me zbritjen e Kur'anit Famëlartë dhe u jep atyre përgjigje. Kurse në ajetet që janë objekt studimi shpaloset një pjesë tjetër e problemeve, që jobesimtarët ngrinin kundër vetë të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Si përgjigje ndaj këtyre paradokseve të jobesimtarëve, All'llahu thotë: "**Ata** (adhuruesit e idhujve) **thanë: Ç'është ky i dërguar që ha ushqime dhe që ecën nëpër tregje?**"

¹ Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 4, f. 6.

Ato thonin: Ç'është ky profet, që ka nevojë për ushqim si njerëzit e zakonshëm dhe që ecën nëpër tregje për të bërë tregti? Nuk është kjo rruga e të dërguarve, e mbretërve, e perandorëve! Ky i dërguar nuk mund të kumtojë thirrjen hyjnore, por me këtë ai dëshiron vetëm pushtetin mbi shoqërinë!

Adhuruesit e idhujve mendonin se nuk ishte e përshtatshme që personat e rëndësishëm të shkonin vetë nëpër tregje për të kryer punët e tyre, pasi për të tilla punë, ata duhej të dërgonin shërbëtorët e nëpunësit e vet.

Veç kësaj, ata shtonin: **“përse të mos jetë i dërguar një engjëll së bashku me atë që të ishte paralajmërues”**; së paku, përse All'llahu nuk dërgoi tek ai një engjëll, që të dëshmonte vërtetësinë e thirrjes së tij dhe të paralajmëronte njerëzit?!

Ose thonin: Shumë mirë, le të supozojmë se ne ramë dakord që i Dërguari i All'llahut të jetë njeri. Atëherë, përse ky i Dërguar është i varfër, pa pasuri e pa prona?

Ajeti njofton fjalët e thëna prej tyre: **“Ose atij t'i jepej një thesar, apo të kishte një kopsht prej të cilit të ushqehet.”**.

Ata nuk u mjaftuan vetëm me kaq dhe, më në fund, thanë: nga fjalët e gabuara që kemi dëgjuar prej tij, kemi arritur në përfundimin se ai është i çmendur, ashtu siç thuhet në fundin e këtij ajeti: **“idhujtarët mizorë u thanë (besimtarëve): ju po shkoni prapa një njeriu që e ka zënë magjia.”**. Adhuruesit e idhujve besonin se magjistarët kishin mundësi të ndërhyjnë në mendimet e në mendjet e njerëzve dhe t'ua merrnin atyre mendjen.

Nga ajetet e mësipërme mësohet se adhuresit e idhujve stisnin disa paradokse në lidhje me të Dërguarin e All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i shprehnin ato hap pas hapi.

Ata thonin: Në radhë të parë, i Dërguari duhet të ketë një pronë, kurse për atë që ushqehet si gjithë të tjerët dhe që ecën nëpër tregje, nuk është e domosdoshme prona.

Më pas thonin: Nëse s'ka një pronë, së paku, përse All'llahu nuk i dërgon atij një engjëll, që ta shoqërojë e ta ndihmojë?

Më pas, ata hiqnin dorë nga ky pretendim dhe thonin: Le të supozojmë se i Dërguari i All'llahut është njeri. Kështu, atij duhej t'i vinte një thesar prej qiellit, që të tregonte se ai ishte me të vërtetë nën kujdesin e All'llahut.

Në fund të këtyre paradokseve, ata thanë: Le të supozojmë se ai s'ka asnjë prej këtyre shenjave dalluese, por të paktën nuk duhej të ishte i varfër. Më e pakta, le të ishte një fermer në gjendje të mirë, të kishte një kopsht prej të cilit të siguronte jetesën; kurse ai, s'kishte asnjë nga këto! Megjithatë, ai thotë: "Me të vërtetë, unë jam profet!"

Në fund, ata dilnin në përfundimin se pretendimet e tij kaq të mëdha, ndonëse ishte në ato kushte, tregonin se ai nuk e kishte mendjen në rregull.

Ajeti i dytë i sqaron të gjitha paradokset e adhuresve të idhujve me një frazë kuptimplotë dhe njofton: **"Shiko se çfarë shembujsh sjellin për ty, ata e kanë humbur rrugën dhe s'kanë mundësi të udhëzohen në rrugën e drejtë."**

Kjo frazë e shpreh në mënyrën më të plotë të vërtetën e idhujtarëve, të cilët me të gjitha fjalët e tyre mjerane, të pabazuara në asnjë argument, donin të mbulonin të vërtetën dhe t'i kundërviheshin thirrjes së Zotit, Kur'anit Famëlartë, që dëshmonte e fliste qartë për lidhjen e tij me All'llahun.

Kjo frazë e ajetit i thotë Profetit të All'llahut se, në të vërtetë, adhuresit e idhujve ngjasojnë me atë që ka për qëllim t'u kundërvihet argumenteve Tona logjike me anën e disa argumenteve të rreme; prandaj pa iu përgjigjur aspak paradokseve të tyre, Ne themi: Shiko se me ç'pretendime të kota duan t'i kundërvihen argumentit logjik!

Këto ishin fjalët që thonin adhuresit e idhujve kudo që ndodheshin, ngaqë nuk e kuptonin, ose bënë sikur nuk e kuptonin se argumentet që ata sillnin, s'kishin asgjë të përbashkët me realitetin për shkaqet e mëposhtme:

E para: përse duhej patjetër që i Dërguari të ishte prej engjëjve? Logjika dhe dituria diktojnë që udhëheqësi i njerëzve duhej të ishte patjetër prej njerëzve, ndryshe ai nuk mund të kuptojë plotësisht vuajtjet, dëshirat, nevojat, problemet e çështjet e jetës së njerëzve. Veç kësaj, udhëheqësi është shembulli që duhet të ndjekin njerëzit praktikisht në të gjitha nivelet; gjithashtu, duhet që njerëzit të frymëzohen prej këtij udhëheqësi në të gjitha punët që ndërmarrin. Është e kuptueshme se të gjitha këto objektiva nuk do të realizoheshin kurrë nëse udhëheqësi i njerëzve do të ishte engjëll, pasi kur ky i dërguar engjëll do t'u fliste njerëzve, me siguri që do t'u fliste me gjuhën e përkorë dhe të mosinteresimit të plotë për këtë botë, sepse ai është engjëll dhe s'ka nevojë për gjëra materiale. Gjithashtu, kur i dërguari engjëll do t'u fliste njerëzve

për nderin e virtytin, njerëzit me siguri do të thonin: padyshim që ky nuk e kupton furtunën e instinkteve seksuale, si edhe dhjetëra e dhjetëra të tjera si këto.

E dyta: ku qëndron domosdoshmëria e zbritjes së një engjëlli që të shoqërojë një njeri, me qëllim që të vërtetojë fjalët e tij? A nuk mjaftojnë mrekullitë për të kuptuar këtë të vërtetë dhe në mënyrë të veçantë, një mrekulli kaq e madhe si Kur'ani?!

E treta: ushqyerja si të gjithë njerëzit dhe ecja nëpër tregje, janë shkak që udhëheqësi të bëhet njësh me njerëzit dhe të futet në brendësi të jetës së tyre, pasi vetëm duke jetuar me ta, ai mund të plotësojë kumtimin e mesazhit që mbart në mënyrën më të mirë.

E katërta: madhështia dhe personaliteti i të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk vinin as me thesaret, as me pasuritë e tjera dhe as me kopshtet me hurma e me fruta të tjera të freskëta, siç mendonin jobesimtarët, të cilët thonin se pozita, madje edhe afrimi tek All'llahu, janë të veçanta vetëm për të pasurit. Mirëpo Profetët erdhën për të thënë: O njeri, vlera jote nuk qëndron në këto gjëra, por në diturinë, devotshmërinë dhe besimin!

E pesta: çfarë krahasimi qesharak bënin ata, kur thonin për të Dërguarin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), se atë e ka zënë "magjia", ose ai është "i çmendur"! Ata i thonin këto fjalë kundër një personaliteti, historia e jetës së të cilit, përmbysja e madhe që ai shkaktoi dhe themelimi i kulturës islame prej tij, dëshmojnë se mendja e tij ishte një mrekulli. Si është e mundur të bëhen kundër tij shpifje të tilla kaq qesharake? A është e drejtë të thuhet, se shkatërrimi i idhujve dhe

kundërshtimi për të mos i ndjekur verbërisht të parët, janë argumente që vërtetojnë se ai ishte i çmendur?!

Nga sa thamë më lart, bëhet e qartë se fjala e ajetit “*el emthâl*” – “**shembujt**” ka kuptimin: fjalë boshe, pa vlerë, sidomos kur i krahasojmë ato me fjalët që thuhet në ajetin që është objekt studimi. Gjithashtu, ka mundësi që në ajetin tonë, fjalët e tyre të jenë përmendur me fjalën: “*el emthâl*” – “**shembujt**” për shkak se ata u mvishnin fjalëve të tyre boshe rrobën e së vërtetës, që të dukej se puna qëndronte ashtu siç thonin ata dhe se fjalët e tyre ishin argumente logjike, në një kohë që s’janë të tilla.¹

Është me vend të theksohet se armiq të i vinin nofka Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe e thërrisnin “magjistar”. (Në Kur’an, kjo fjalë ka ardhur në formën e mbiemrit cilësor, por sipas rregullave të gjuhës arabe dhe pozicionit të fjalës në fjali, mbiemri merr kuptimin e emrit, ndonëse ka dallim në kuptim midis emrit “magjistar” dhe mbiemrit cilësor “i magjepsur”).

¹ Shumë interpretues të Kur’anit e kanë trajtuar fjalën “*el-emthâl*” – “**shembujt**” në kuptimin: punë të dyshimta, por nuk kanë sqaruar se cilat janë ato. Disa prej tyre kanë thënë se fjala e ajetit “*el emthâl*” – “**shembujt**” ka kuptimin “**cilësitë**”, sepse ndër kuptimet e fjalës “*emthâl*”, siç shpjegon Ragibi në fjalorin e tij “Mufredat El Fàdhul Kur’ani” është edhe ky, prandaj qëllimi i saj është për gjëra të ngatërruara, që s’kanë asnjë bazë, ashtu siç thuhet edhe në fjalët e fundit të ajetit. Nga njëra anë, ajeti i flet Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me një mënyrë habitore: “A e shikon se çfarë shembujsh sjellin për ty?” Kurse nga ana tjetër, në ajet thuhet: “*Këto fjalë që t’i mveshin ty, i çojnë ata në rrugën e humbjes, prandaj për ta s’ka udhëzim në rrugën e drejtë*”.

Ata thonin se ai është magjistar, për shkak se fjala e tij kishte një ndikim të jashtëzakonshëm në zemrat e njerëzve dhe jobesimtarët nuk donin ta pranonin këtë të vërtetë.

Fjala e ajetit “*mes’hùren*” ka kuptimin: *kanë ndërhyrë në mendjen e tij dhe veprojnë me atë, kanë punuar që t’ia shkatërrojnë shqisat*. Kjo akuzë e tyre u ngrit për shkak se i Dërguari, me thirrjen që bënte, e shkallmonte rrugën e tyre dhe u kundërviehej zakoneve e traditave të tyre mitologjike. Gjithashtu, thirrja e tij dilte kundër interesave të tyre individuale.

Përgjigja për të gjitha këto akuza, del e qartë nga sa u tha më sipër.

Këtu lind pyetja: Përse All'llahu ka thënë: **“ata e kanë humbur rrugën dhe s’kanë mundësi të udhëzohen në rrugën e drejtë”**?

Përgjigje: Njeriu, në një mënyrë ose në një tjetër, ka mundësi ta gjejë rrugën për tek e vërteta, nëse është prej atyre që përpiqet për këtë; kurse ai që e merr qëndrimin e tij qysh në fillim, i bazuar mbi gjykimet e gabuara të paraardhësve, në të vërtetë ndjek injorancën nga mllëfi që ka prej fjalës së vërtetë, duke shtuar këtu faktin se ai vetë nuk është munduar kurrë ta gjejë të vërtetën. Për rrjedhojë, një njeri i tillë do të jetë gjithnjë kundër së vërtetës.

Ajeti i fundit i grupit të ajeteve që janë objekt studimi, ashtu si edhe ajeti para tij, i drejtohet drejtpërdrejt Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), duke i thënë se fjalët e jobesimtarëve janë kaq të neveritshme, saqë nuk meritojnë t’u kthehet një përgjigje. Për këtë, Zoti thotë: **“Zotërues i Mirësive të përhershme është vetëm Ai, që po të dëshirojë të jep**

ty edhe më të mirën nga ajo që ata thonë, (të jep) kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe për ty bën palate.”.

Thënë ndryshe: A ka ndonjë tjetër përveç All'llahut, që u jep të tjerëve pallate e kopshte? Cili është ai tjetri, përveç All'llahut, që i ka krijuar të gjitha këto mirësi në këtë botë dhe bukuritë e Botës Tjetër? Si qenka e pamundur për All'llahun e Gjithëfuqishëm, Dhuruesin e mirësive, të bëjë pallate e kopshte edhe më të bukura?!

All'llahu nuk dëshiron kurrë që njerëzit të besojnë se pozita jote e lartë është për shkak të pasurive, pronave e pallateve. Veç kësaj, si është e mundur që njerëzit të jenë kaq të shkujdesur ndaj vlerave të vërteta? All'llahu i Lartësuar dëshiron që jeta jote të jetë si ajo e njerëzve të zakonshëm, si jeta e atyre që s'kanë përkrahje e që i kanë privuar nga mirësitë e Tij. Ai ka për qëllim që ti të jesh si të gjithë njerëzit.

Fjalët e ajetit ku përmenden pallatet e kopshtet më të mira sesa ato që kanë e që thonë adhuruesit e idhujve, tregojnë se nuk mjafton vetëm thesari për t'i zgjidhur problemet, por duhet që pas një pune të madhe, ai thesar të tjetërsohet në pallate e kopshte. Ata thonin: “Të paktën të kishe një kopsht për të siguruar jetesën”, kurse Kur'ani thotë: *“All'llahu është i Gjithëfuqishëm, që të bëjë për ty pallate e kopshte, por qëllimi për të cilin ti je dërguar, si dhe mesazhi që ti mbart, është tjetër gjë.”.*

Në hutben “El Kàsiah” prej “Nehxhul Belaga”, gjendet një sqarim shumë domethënës për kuptimin e ajetit që është objekt studimi. Imam Aliu thotë: “...Musa bin Imrani dhe vëllai i tij, Haruni (*Paqja e All'llahut qoftë mbi ta!*) hynë te Faraoni të veshur me rroba të punuara prej leshit të bagëtive dhe në dorë mbanin

nga një shkop. Ata të dy i vunë kusht Faraonit të besonte, pasi vetëm kështu sundimi i tij do të ishte i qëndrueshëm dhe madhështia e tij do të ishte e vazhdueshme. Por Faraoni u tha atyre që ishin rreth tij: 'A i dëgjoni se ç'thonë? A nuk çuditeni me këta të dy? Më vënë mua kusht, që sundimi im të jetë i qëndrueshëm dhe që madhështia ime të jetë e vazhdueshme! Shikoni se kush e vë këtë kusht! Ju e shihni se sa të varfër janë dhe i përkasin shtresës më të ulët. Përse nuk u janë dhënë këtyre të dyve byzylykë floriri, por janë veshur me rroba leshi të neveritshme?' Ai i thoshte këto fjalë ngaqë e adhuronte floririn dhe përpiquej të grumbullonte sa më shumë prej tij. Gjithashtu, fjalët e tij shprehin neverinë që ai kishte ndaj rrobave të punuara nga leshi i bagëtive. Sikur All'llahu i Gjithëfuqishëm të kishte shfaqur vullnetin e Tij ndaj Profetëve, kur i ngarkonte ata të kumtonin Mesazhin hyjnor, do të bënte që për ta të ishin të hapura thesaret e sendeve prej floriri dhe argjendi, pemët e kopshteve, madje për këtë punë do të vinte në dispozicion të tyre edhe shpendët e qiellit e bishat e tokës.

Por nëse All'llahu do ta bënte këtë, sprova do të rrëzohej dhe dënimi do të bëhej i pavlefshëm, lajmet do të ishin të paqarta, nuk do të bëhej i detyrueshëm shpërblimi i atyre që sprovohen me fatkeqësi, besimtarët nuk do të meritonin shpërblimin e punëmirëve, kuptimet e emrave do të bëheshin një. Porse All'llahu i Gjithëfuqishëm i ka bërë të Dërguarit e Tij të fuqishëm në vendosmërinë e tyre, ndonëse sytë e jobesimtarëve i shohin ata si të dobët. Në të vërtetë, zemrat e tyre janë të mbushura me kënaqësi, sytë e tyre edhe me aq sa kanë, shohin pasuri të madhe, kurse sytë e veshët e të privilegjuarve mbushen me mundim.

Sikur Profetët të ishin burra të fuqishëm, mendjemëdhej e me aq shumë pasuri, atëherë njerëzit do ta kishin të lehtë që ta merrnin në konsideratë thirrjen e tyre. Nëse ata do të ishin tiranë, njerëzit do të kishin besuar prej frikës së tyre shtypëse, ose nga dëshira për të qenë afër shtypësve; qëllimet do të ishin të përbashkëta dhe të mirat të ndara, porse All'llahu, të Cilit nuk i mungon asgjë dhe s'ka nevojë për asnjë send, kishte shfaqur vullnetin e Tij që ndjekja e të Dërguarve të Tij, besimi në Librat e Tij, përkushtimi e nënshtrimi i plotë për hir të Tij, si dhe dorëzimi i plotë në bindje ndaj Tij, të ishin punë të veçanta vetëm për Atë. Sa më shumë të shtoheshin sprovat, aq më i madh, më i lartë e më i bukur do të ishte shpërblimi.”¹


Vlen të përmendet se disa interpretues të Kur'anit mendojnë se qëllimi me fjalën e ajetit **“kopshte”** dhe **“pallate”**, është për Xhennetin e për pallatet në Botën Tjetër; por ky interpretim nuk është në përputhje me kuptimin që shprehin fjalët e ajetit.²

¹ “Nehxhul Belaga”, hutbeja numër 192.

² Disa interpretues kanë thënë se qëllimi me fjalën **“kopshte”**, është për kopshtet e kësaj bote, kurse qëllimi me fjalën **“pallate”** është për pallatet e Botës Tjetër. Për sa u përket dy foljeve: *“xheale”* – **“bëri”** në kohën e shkuar dhe foljes *“jexh'al”* – **“bën”** në kohën e tashme dhe të ardhme të këtij ajeti, nuk përbën ndonjë problem që janë në këtë mënyrë e në këtë kohë. Kjo për faktin se sipas rregullave të gjuhës arabe, foljet në një fjali kushtore e humbin kuptimin e tyre kohor. “Xhevàmiul Xhà'i", vëll. 2, f. 26.

Ajetet 11 - 16

[illegible]



“Por, ata e përgënjeshtroan Kiametin dhe për ata që nuk besojnë në Ditën e Gjykimit, Ne kemi përgatitur zjarr shumë të forte.”

“Sapo ai (zjarri) i shikon ata nga një largësi e madhe, ata dëgjojnë zhurmën e vlimit e të afshit të tij.”

“Dhe kur ata të flaken duarlidhur në një vend të ngushtë, aty do të kërkojnë të asgjësohen.”

“Tani mos e kërkon asgjësimin vetëm një herë, por kërkon të asgjësoheni shumë here.”

“Thuaj: a është më i mirë ai (zjarri i Xhehennemit), apo Xhenneti i përjetshëm që u është premtuar të devotshmëve si shpërblim dhe vendi ku do të jetojnë?”

“Atje (në Xhennet) për ata ka çfarë të dëshirojnë dhe aty do të jenë përgjithmonë; për Zotin tënd ky ishte një premtim i kërkuar.”

Komentimi

Krahasim midis Xhennetit dhe Xhehennemit

Ajetet e mëparshme trajtuan devijimin e mohuesve në çështjen e Njësimit të All'Ilahut (besimit se All'Ilahu është Zoti Një dhe i Vetëm) dhe të profetësisë. Në këto ajete, Kur'ani Famëlartë trajton një pjesë tjetër të devijimeve të mohuesve në çështjen e Ringjalljes dhe e bën të qartë se mohuesit janë skllevër të trazirave e të devijimeve të tyre në vetë bazat e fesë. Për dy kategoritë e para të devijimeve, mohuesit e morën përgjigjen në ajetet e mëparshme, kurse përgjigjen për kategorinë e tretë e lexojmë në fillim në fjalën e të Lartit: **“Por, ata e përgënjeshtroan Kiametin.”**.

Sipas rregullave të gjuhës arabe, fjala *“bel”* – **“por”** përdoret për të sjellë shembull. Pra, kuptimi i frazës së ajetit është: fjalët e jobesimtarëve në lidhje me Njësimin e All'Ilahut (*Teuhidin*) dhe profetësinë, kanë të bëjnë me mosbesimin e tyre në Ringjalljen pas vdekjes. Kur njeriu beson në gjykatën madhore të dënimit hyjnor, ai nuk i pret të vërtetat me këtë lloj shkujdesjeje e me tallje, siç i presin jobesimtarët. Gjithashtu, besimtari nuk mundohet të nxjerrë pretekste pa asnjë bazë kundër thirrjes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe argumenteve të tij aq të qarta. Veç kësaj, ai që beson në Ringjalljen e në Ditën e Gjykimit, nuk e përul veten e të adhurojë shtatoret që i ka punuar dhe zbukuruar me dorën e tij.

Kësaj shtrese jobesimtarësh, Kur'ani Famëlartë nuk u parashtron argumente logjike, sepse ata nuk janë prej atyre që mendojnë, por u përgjigjet me një kërcënim shumë të frikshëm

dhe i njofton se e ardhmja e tyre do të jetë e zyrtë e me dhimbje të shumta. Kjo mënyrë komunikimi bën më shumë efekt në individë të tillë, prandaj Kur'ani Famëlartë, qysh në fillim njofton: **“dhe për ata që nuk besojnë në Ditën e Gjykimit, Ne kemi përgatitur zjarr shumë të forte.”**¹

Në këtë ajet ka shprehje të qarta, që tregojnë ashpërsinë e ndëshkimit hyjnor:

1- Kur'ani nuk thotë: “ata shikojnë zjarrin e Xhehennemit nga larg, por thotë se zjarri i shikon ata, sikur Xhehennemi të kishte sy e veshë dhe sikur ato i ka përqendruar mbi rrugën ku ecin jobesimtarët dhe është në pritje të tyre.

2- Xhehennemi s'ka nevojë që t'i afrohen jobesimtarët për t'u ndezur me furi, madje ofshama e zjarrit të tij dëgjohet edhe nga një distancë shumë e largët. Sipas disa transmetimeve, ajo dëgjohet aq larg sa ç'është distanca që mund të përshkojë njeriu gjatë një viti.

3- Kur'ani e cilëson zjarrin djegës të Xhehennemit me fjalën “*tegaj'judhan*” – **“britmë nga zemërimi”** ashtu siç çirret e thërret njeriu me zë të lartë në zemërim e sipër.

4- Xhehennemi ka edhe “*zefjren*”- **“ofshamën e rëndë që del prej vlimit”** ashtu siç nxjerr njeriu me vrull frymën prej gjoksit kur është shumë i zemëruar.

Tërësia e këtyre gjendjeve të Xhehennemit tregon se zjarri përvëlues i tij i ka vënë pritë kësaj shtrese jobesimtarësh idhujtarë,

¹ Fjala e ajetit “*sejren*” ka kuptimin: *flakët e zjarrit*, domethënë zjarri i tejndezur që djeg nga të gjitha anët.

ashtu siç i vë pritë bisha grabitqare presë së saj. Kjo gjendje e rëndë e Xhehennemit quhet **“zemërimi i fortë i All'Ilahut.”**.

E tillë është gjendja e Xhehennemit kur i shikon jobesimtarët nga larg, kurse vuajtjet e tyre në brendësi të tij, Zoti i përshkruan me këto fjalë: **“Dhe kur të flaken duarlidhur në një vend të ngushtë, aty do të kërkojnë të asgjësohen.”**¹

Kjo gjendje e ngushtësisë së jobesimtarëve nuk krijohet për shkak se Xhehennemi është i vogël. Në fakt, Xhehennemi është ashtu siç përshkruhet në ajetin 30 të sures “Kàf”: **“Ditën kur Ne i themi Xhehennemit: a je mbushur dhe ai thotë: a ka më shumë?”**.

Fraza e fundit e këtij ajeti tregon se Xhehennemi është vend shumë i gjerë, por mohuesit do të hidhen në një vend shumë të ngushtë brenda tij. Jobesimtarët përjetojnë në zjarr shtrëngimin më të sikletshëm, që i ngjason shtrëngimit të shtyllës brenda murit.²

Gjithashtu, edhe fjala e ajetit *“thubùren”*, ka kuptimin: *asgjësim, shkatërrim*. Kur njeriu gjendet para një sendi që e frikëson se do ta asgjësojë, ai thërret menjëherë me zë të lartë, me mendimin që të vdesë sa më shpejt.

¹ Fjala e ajetit *“mukarr'rrenijne”* është përdorur në kuptimin e *afrimit e të puqjes së dy gjërave*. Për më shumë sqarime rreth kuptimit të kësaj fjale, referohu në ajetin 49 të sures “Ibrahim ” të këtij tefsiri.

² Tefsiri “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 7, f. 163, ajeti që është objekt studimi.

Jobesimtarët e marrin përgjigjen shumë shpejt nga All'llahu, i Cili thotë: **“Tani mos e kërkonit asgjësimin vetëm një herë, por kërkonit të asgjësoheni shumë here.”**.

Pra, për ju s’ka dobi të kërkonit ndihmë për asgjë, sepse nuk do të ketë vdekje e asgjësim; ju do të vazhdoni të jeni të gjallë për ta “shijuar” ndëshkimin e dhimbshëm.

Ky ajet është i ngjashëm me ajetin 16 të sures “Et Tûr”, në të cilën All'llahu, i Larti, njofton: **“Hyni në të, për ju është njësoj, bëni ose nuk bëni durim; dënoheni vetëm për punët që keni bërë.”**.

Kush u flet mohuesve në këtë vend? Shembujt krahasues me ajete të tjera tregojnë se ata janë engjëjt e ndëshkimit, sepse në këtë vend vetëm ata kanë të bëjnë me mohuesit.

Përsa i përket çështjes se përse këtu engjëjt e ndëshkimit u thonë mohuesve: **“Tani mos e kërkonit asgjësimin vetëm një herë, por kërkonit të asgjësoheni shumë here”**, kjo ndodh për faktin se ndëshkimi i dhimbshëm për ta nuk do të jetë i përkohshëm, që të kërkojnë vdekjen e asgjësimin vetëm një herë. Këtë kërkesë, ata do ta përsërisin gjatë gjithë kohës e papushim, sepse ndëshkimet hyjnore për mohuesit mizorë e kriminelë do të jenë të shumëllojshme. Kur secili prej mohuesve do ta shohë vdekjen para syve për çdo ndëshkim që do të pësojë, ai do të thërrasë me zë të lartë: “Ah i mjeri unë!” Kur i duket se mbaroi, do të shohë se është prapë gjallë; kështu do të ndodhë me mohuesit vazhdimisht.

Në vijim, fjala i drejtohet të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ku All'llahu, i Larti, e

urdhëron që t'u thotë atyre të bëjnë krahasimin mes Xhehennemit dhe Xhennetit: **“Thuaj: a është më i mirë ai (zjarri i Xhehennemit), apo Xhenneti i përjetshëm që u është premtuar të devotshmëve si shpërblim dhe vendi ku do të jetojnë?”**.

Ky është Xhenneti ku ata do të gjejnë: **“Për ata atje (në Xhennet) ka çfarë të dëshirojnë.”**.

Në Xhennet, ata do të jenë **“khàlidiyne” – “përgjithmonë”**.

Ky premtim i është kërkuar All'llahut dhe për këtë, ajeti njofton: **“për Zotin tënd, ky ishte një premtim i kërkuar.”**.

Kërkesa për të bërë krahasimin, nuk do të thotë se dikush dyshon për këtë çështje. Kjo nuk lidhet as me mendimin se ndëshkimet hyjnore poshtëruese meritojnë të krahasohen me mirësitë e Xhennetit, mirësi që nuk kanë të ngjashme. Jo! Pyetja dhe kërkesa për të bërë krahasimin, ka për qëllim zgjimin e ndërgjegjeve të përgjumura. Me këtë kërkesë, njerëzit vihen para një detyre shumë të rëndësishme, atë të zgjedhjes midis dy rrugëve: ose zjarrin e Xhehennemit, ose mirësitë e Xhennetit.

Kur jobesimtarët thanë se këto mirësi janë më të mirat e më të mëdhatë, ata dëshmuuan kundër vetvetes, sepse punët e tyre janë e kundërta e asaj që ata pohojnë. Në të vërtetë, me punët e tyre, jobesimtarët mendojnë se ndëshkimi i dhimbshëm në zjarrin e Xhehennemit është më i mirë se mirësitë e Xhennetit, por me ato punë, ata në fakt kanë nënshkruar dokumentin për fajet që kanë bërë. Ky veprim i jobesimtarëve i ngjason rastit kur ne paralajmërojmë një djalë të ri që lë shkollën dhe i themi: “Dije mirë se burgu i pret ata që e braktisin diturinë dhe se ata do të

bien në llumin e degjenerimit”. Vallë, për këtë djalë të ri, a është më i mirë burgu apo arritja e pozitive të larta?!

Hulumtime

1- Duhet të theksojmë këtu, se me fjalën “*khàlidijne*” – **“përgjithmonë”** ajetet kuranore herë përshkruajnë Xhennetin dhe herë tjetër ata që do të hyjnë në të. Ky përshkrim bëhet për të theksuar të vërtetën, se ashtu siç është i përjetshëm Xhenneti, ashtu do të jenë edhe ata përgjithmonë në të.

2- Fjala e All'Ilahut, të Lartit: **“Atje (në Xhennet) për ata ka çfarë të dëshirojnë”**, ka ardhur kundrejt përshkrimit të gjendjes së atyre që do të hyjnë në Xhehennem, ashtu siç e lexojmë në ajetin 54 të sures “Sebe”: **“Dhe ndërhyhet (ndërhyn All'Ilahu) ndërmjet atyre dhe ndërmjet asaj që ata dëshirojnë.”**.

3- Ardhja e fjalës “*mesijren*” – **“vendi ku do të jetojnë”** pas fjalës “*xhezàen*” – **“shpërblim”** në lidhje me Xhennetin, thekson e përforcon të gjitha llojet e shpërblimeve. Kjo shërben si një pikë krahasimi me vendin e atyre që do të hyjnë në Xhehennem, ku siç u shpjegua në ajetin para këtij, ata do të futen në një vend të ngushtë e të kufizuar dhe të ngjeshur njëri me tjetrin.


4- Fjala e All'Ilahut, të Lartit: **“për Zotin tënd ky ishte një premtim i kërkuar”**, tregon se besimtarët kërkojnë prej All'Ilahut të Lartësuar Xhennetin dhe të gjitha mirësitë që janë në të; pra,

besimtarët janë kërkuesit, ndërsa prej All'llahut të Lartësuar kërkohet, ashtu siç thuhet edhe në ajetin 194 të sures "Ali Imran": **"Zoti ynë, na e jep atë që na ke premtuar me (fjalën e) të Dërguarve Tuaj."** Këtë kërkesë, besimtarët ia drejtojnë vetëm All'llahut, sepse gjuha e gjendjes së kujtdo që zbaton urdhrin e të Lartit, e kërkon këtë premtim vetëm prej Tij.

Edhe engjëjt i kërkojnë All'llahut Xhennetin për besimtarët dhe qëndrimin e tyre të përhershëm në të, ashtu siç e lexojmë në ajetin 8 të sures "El Gàfir": **"Zoti ynë, futi në Xhennetet e Adnit që Ti ua ke premtuar."**

Fjala e ajetit "*mes'ûlen*" - "**kërkuar**" interpretohet edhe si premtim hyjnor i padiskutueshëm, domethënë ky premtim është i një forme të prerë dhe besimtarët kanë mundësi t'ia bëjnë All'llahut këtë kërkesë.

5- Për frazën e ajetit: **"Atje (në Xhennet) për ata ka çfarë të dëshirojnë"**, disa mund të shtrojnë këtë pyetje: Banorët e Xhennetit mund të kërkojnë të jenë në pozitën e Profetëve ose të evlijave, por a u jepet atyre ajo pozitë? Ose ata mund të kërkojnë shpëtimin e të afërmeve dhe të miqve të tyre fajtorë, që e kanë merituar Xhehennemin. A u plotësohet atyre kjo kërkesë, apo dëshira të tjera të ngjashme me këto? Përgjigjja bëhet e qartë nëse marrim në konsideratë faktin se ajo perdja që kishin banorët e Xhennetit, tani nuk është më para syve të tyre. Për rrjedhojë, ata i kuptojnë të vërtetat shumë mirë dhe shikimi i tyre tani është i plotësuar. Pra, atyre as që u shkon në mendje t'ia bëjnë All'llahut të Lartësuar të tilla kërkesa. Thënë ndryshe, kjo do të ishte sikur ne



“Ditën kur All'Ilahu do të mbledhë ata që në vend të All'Ilahut adhurojnë idhujt së bashku me të adhuruarit e tyre (idhujt); All'Ilahu u thotë të adhuruarve të tyre: a ju i çuat robtë e Mi në rrugën e humbjes, apo ata vetë e humbën rrugën?”

“Ato (të adhuruarit) thonë: Ti nuk ke ortak e asnjë mangësi o i Madhëruar, ne nuk mund të kishim mbrojtës tjetër përveç Teje; për ata dhe për të parët e tyre Ti bëre kënaqësi të shumta dhe nga kjo ata të harruan Ty dhe ishin njerëz të shprishur.”

“Ja, ata (të adhuruarit tuaj) u përgënjeshtrojnë për fjalët që thoni, ju s’kini mundësi as të shpëtoni e as të ndihmoni veten tuaj dhe cilido prej jush që bën padrejtësi, atë Ne e dënojmë me një ndëshkim të ashpër.”

Komentimi

Gjykimi midis të adhuruarve dhe adhuruesve që kanë devijuar në rrugën e humbjes

Në ajetet e mëparshme u trajtua e ardhmja e besimtarëve dhe e adhuruesve të idhujve në Ditën e Gjykimit, si dhe shpërblimi ose dënimi për të dy grupet. Edhe ajetet që janë objekt studimi vazhdojnë ta trajtojnë këtë çështje, por në një formë tjetër. Pyetja që u drejtohet të adhuruarve (idhujve) në Ditën e Gjykimit dhe përgjigja e tyre, e bëjnë të qartë të ardhmen e dy grupeve (adhuruesve dhe të adhuruarve). Pyetja drejtuar të adhuruarve është një mënyrë e rëndë paralajmërimi për idhujtarët. Në këtë paralajmërim, All'Ilahu i Lartësuar u thotë: Kujtojeni ditën kur All'Ilahu do t'i mbledhë ata që i vënë shok Atij: **“Ditën Kur All'Ilahu do të mbledhë ata që në vend të All'Ilahut adhurojnë idhujt së bashku me të adhuruarit e tyre (idhujt).”**.

All'Ilahu i pyet të adhuruarit e idhujtarëve:

“All'Ilahu u thotë të adhuruarve të tyre: a ju i çuat robtë e Mi në rrugën e humbjes, apo ata vetë e humbën rrugën?”

Në përgjigje, të adhuruarit e idhujtarëve thonë:

“Ata (të adhuruarit) thonë: Ti nuk ke ortak e asnjë mangësi o i Madhëruar, ne nuk mund të kishim mbrojtës tjetër përveç Teje.”.

Me fjalë të tjera, të adhuruarit përgjigjen: Ne nuk u kemi bërë atyre thirrje të na adhurojnë. Përkundrazi, ne e kemi pohuar vazhdimisht madhërinë Tënde dhe nuk kemi pranuar kurrë se ka të adhuruar tjetër përveç Teje.

Shkaku që idhujtarët devijuan nga rruga e drejtë, ishte se All'illahu i Lartësuar i furnizoi ata me mirësi e me dhunti të shumta në këtë botë. Edhe të parët e tyre u kënaqën me këto mirësi e dhunti të All'illahut, por në vend që të falënderonin, ata u dhanë pas plotësimit të dëshirave dhe harruan të kujtojnë All'illahun, ashtu siç njofton ajeti: **“për ata dhe për të parët e tyre Ti bërë kënaqësi të shumta dhe nga kjo ata të harruan Ty.”**. Për këtë, ata u asgjësuan, sepse: **“dhe ishin njerëz të shprishur.”**.

Këtu, All'illahu i Lartësuar ua drejton fjalën adhuruesve të idhujve dhe u thotë: **“Ja, ata (të adhuruarit tuaj) u përgënjeshtrojnë për fjalët që thoni.”**.

Fjala *“jadhlim”* – **“bën padrejtësi”** ka një kuptim shumë të gjerë, por në ajetin që është objekt studimi, kjo fjalë ka kuptimin e vënies shok All'illahut në adhurim (*shirk*), që është njëri prej vërtetuesve më të dukshëm të padrejtësisë.

Në frazën e ajetit *“ue men jadhlim”* – **“dhe cilido prej jush që bën padrejtësi”**, folja **“bën padrejtësi”** ka ardhur në kohën e tashme. Frazja e fundit u drejtohet adhuruesve të idhujve në këtë botë, me qëllim që zemrat e tyre të përgatiten për të pranuar besimin (*iman*) në All'illahun, Zotin Një dhe të Vetëm, kur të dëgjojnë diskutimin ndërmjet adhuruesve dhe të adhuruarve në Ditën e Gjykimit; pra, debati i të dyja palëve (adhurues e të adhuruar) në Ditën e Gjykimit, transferohet në këtë botë dhe

All'Ilahu i njofton adhuruesit e idhujve me fjalën e Tij: **“dhe cilido prej jush që bën padrejtësi, atë Ne e dënojmë me një ndëshkim të rëndë.”**¹

Hulumtime

1- Cili është kuptimi i fjalës “të adhuruarit”?

Për këtë pyetje, interpretuesit e dëgjuar të Kur'anit kanë dhënë dy interpretime:

Interpretimi i parë: Fjala **“të adhuruarit”** mund të ketë për qëllim një njeri, si për shembull Mesihu (Jezusi), ose një djall (ose xhind), ose engjëjt, pasi adhuruesit e idhujve adhurojnë njërën prej tri kategorive të përmendura dhe ato janë prej atyre që kanë mendje, ndjenja dhe që kuptojnë. Prandaj është e mundur që ata të merren në pyetje dhe t'u kërkohet llogari, në mënyrë që të vërtetohet plotësisht se adhuruesit e idhujve gënjejnë kur thonë se të adhuruarit u bënë thirrje për adhurim. Të adhuruarit e

¹ Fjalja e fundit e këtij ajeti mund të jetë vazhdim i dialogut ndërmjet All'Ilahut dhe adhuruesve të idhujve në Ditën e Gjykimit. Gjithashtu, edhe fakti që folja *“jadhlim”* në këtë ajet, ka ardhur në kohën e tashme, nuk përbën asnjë problem, sepse fraza **“dhe cilido prej jush që bën padrejtësi”**, është përmendur në formën e një ligji të përgjithshëm (fjali kushtore). Në fjalinë kushtore foljet e humbasin kuptimin kohor që shprehin dhe mbetet vetëm lidhja midis kushtit dhe përgjigjes që ai shpreh.

idhujtarëve pyeten nëse ky pretendim i adhuruesve të idhujve është i vërtetë, por ata e përgënjeshtrojnë hapur e qartë.

Interpretimi i dytë: Një grup prej interpretuesve të Kur'anit Famëlartë kanë thënë se në Ditën e Gjykimit, All'llahu i Lartësuar u jep idhujve të ngurtë një lloj aftësie për të ndjerë e për të kuptuar, në mënyrë që të mund të merren në pyetje dhe t'u kërkohet llogari. Pra, All'llahu u jep atyre edhe aftësi që të përgjigjen e të thonë fjalët e duhura. Atë Ditë, idhujt do të thonë: "O Zoti ynë! Ne nuk i çuam ata në rrugën e humbjes, por ata shkuan vetë drejt saj, kur u dhanë pas kënaqësive të epshit, mashtrimeve e mendjemadhësisë".

Pra, fjala e ajetit "**të adhuruarit**" mund të përfshijë si të adhuruarit me mendje e ndjenja e me aftësi për të menduar, të cilët do t'i pohojnë me fjalët e tyre ngjarjet e ndodhitë, ashtu edhe të adhuruarit që s'kanë as mendje e as ndjenja, por që edhe ata do ta pohojnë të vërtetën me gjuhën e gjendjes së vet.

Shembujt krahasues përputhen më shumë me interpretimin e parë. Gjithashtu, foljet dhe përemrat e përdorur në këtë frazë të ajetit, tregojnë se pala dialoguese është prej atyre që kanë mendje, ndjenja dhe aftësi për të menduar. Siç e thamë më lart, ky interpretim është në përshtatje me të adhuruarit, si Mesihu, engjëjt dhe të ngjashëm me këta.

Këtu duhet shtuar se fraza e ajetit: "*fekad kedh'dhebùkum*" - "**ata** (të adhuruarit) **u përgënjeshtrojnë**", tregon se idhujtarët kanë pretenduar më parë se ishin të adhuruarit e tyre, ata që i çuan në rrugën e humbjes. Ata thonë se të adhuruarit e tyre u kanë bërë thirrje atyre për adhurim. Ky pretendim është larg

logjikës, sepse adhuruesit e idhujve, ashtu siç tregohet në ngjarjen e Ibrahimit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) ishin të vetëdijshëm se idhujt e tyre nuk mund të flisin. Për këtë, në ajetin 65 të sures “El Enbijà”, thuhet: **“Ti e dije se këta nuk flasin.”**.

Një shembull tjetër tregohet në ajetin 116 të sures “El Mâide”, ku flitet për Mesihun: **“a ti u the njerëzve: më besoni mua dhe nënën time për zota dhe jo All'llahun?”**.

Pretendimi i atyre që i bëjnë shok All'llahut në adhurim dhe i adhuruesve të idhujve, është një pretendim mjeran, pa asnjë bazë, sepse të adhuruarit e tyre nuk u kanë bërë thirrje njerëzve për adhurim.

Gjithashtu, të bie në sy fakti se të adhuruarit, në përgjigje të pyetjes drejtuar atyre, nuk thonë: *“Ne nuk u bëmë atyre thirrje të na adhurojnë”*, por: *“Ne, për veten tonë, s’kemi adhuruar ndonjë tjetër përveç Teje”*. Madje këtë pohim, ata e shoqërojnë me fjalën: *“subhâneke”* - **“Ti s’ke ortak e asnjë mangësi”**, si dhe me frazën tjetër: *“mà kàne jenbegij lenà”* - **“ne nuk mund të kishim mbrojtës tjetër përveç Teje.”**. Fjala *“subhâneke”* dhe kjo frazë shprehin edukatën më të lartë dhe ritheksojnë faktin se ata kanë bërë thirrje që të besohet se All'llahu është Zoti Një dhe i Vetëm (*Teuhid*).

2- Shkaku i devijimit nga Teuhidi (besimi në Zotin Një dhe të Vetëm)

Të adhuruarit thonë se shkaku kryesor i devijimit të këtij grupi politeistësh, është jeta e begatë dhe mirëqenia që ata

gëzojnë. Ata thonë: “O Zoti ynë! Me mirësinë Tënde, Ti u dhurove atyre e të parëve të tyre, begati të shumta në këtë botë. Kjo mirëqenie u bë shkak që ata të harrojnë dhe, në vend që të njohin e të falënderojnë Dhuruesin e këtyre begatave të shumta e të jenë të bindur vetëm ndaj Tij, ata u zhytën edhe më tepër në shkujdesjen e tyre dhe në llumin e mashtrimin e të mendjemadhësisë.”.

Tek njerëzit me horizont të ngushtë dhe me besim të dobët, mirëqenia çon në shfaqjen e mendjemadhësisë. Kur ata arrijnë të kenë mirësi të shumta, e harrojnë veten e tyre, harrojnë edhe All'llahun. Madje edhe Faraoni, nga mirëqenia e madhe që gëzonte, arriti deri aty, sa të deklaronte disa herë se ai ishte Zoti.

Nga ana tjetër, individë të tillë priren të çlirohen nga çdo lloj kufizimi që i pengon për të shijuar të gjitha llojet e kënaqësive, të lejuara ose të ndaluara qofshin ato. Ata duan të çlirohen nga kufizimet që i pengojnë në arritjen e qëllimeve, prandaj nuk duan të jenë të nënshtruar ndaj ligjeve dhe urdhrave të fesë. Madje, ata nuk duan as të pranojnë se në Ditën e Gjykimit të madh, do të japin llogari dhe do të dënohen.

Ne e shohim se ata që jetojnë në mirëqenie nuk janë ndjekës të fesë së All'llahut dhe të mësimave të Profetëve. Në të njëjtën kohë, vërejmë se ata që nuk kanë pasuri, janë ndjekës të vendosur, e duan me një dashuri të zjarrtë fenë e All'llahut e janë besnikë ndaj saj. Sigurisht që ka përjashtime në të dyja rastet, por përgjithësisht ndodh kështu.

Nga përmbajtja e këtij ajeti, rezulton se shkaku për këtë devijim, është se ata që jetojnë në mirëqenie, të tillë i kanë pasur edhe të parët e tyre. Është e vërtetë se kur njeriu lind e rritet në mes të mashtrimeve e mirëqenies, do ta shohë shumë shpejt se

dallon dhe është më i privilegjuar se të tjerët. Prandaj, ai nuk është i gatshëm dhe nuk e ka të lehtë ta kapërcejë gjendjen kur i humb përfitimet materiale dhe dobitë që ka nga jeta në begati të plotë. Ndërsa zbatimi i urdhrit të All'llahut dhe i mësimëve të fesë, kërkon që njeriu të ndjejë dashuri e mëshirë edhe për tjetrin. Ndonjëherë, një zbatim i tillë mund të kërkojë që njeriu ta lërë vendin e vet dhe të emigrojë, ose që ai të luftojë në rrugën e All'llahut dhe të bjerë dëshmor apo të durojë sprovat të shumta dhe të mos i dorëzohet armikut. Të gjitha këto punë rrallëherë përputhen me karakterin e atyre që jetojnë në mirëqenie, me përjashtim të atyre të pasurve që shpirtërisht qëndrojnë më lart sesa jeta e tyre materiale. Njerëzit që e kalojnë çdo ditë të jetës duke e falënderuar All'llahun, as nuk tronditen e as nuk shqetësohen. Me fjalë të tjera, ata e kanë nën kontroll jetën e tyre materiale dhe nuk kontrollohen prej saj. Ata janë prej atyre që e jetojnë jetën në mirëqenie, por nuk janë robër të saj.

Nga ky shpjegim mësohet se fjala e All'llahut, të Lartit: *“nesudh’dhikre”* – **“harruan të kujtohen”**, ka kuptimin: ata harruan ta përmendin All'llahun. Një gjë e tillë përmendet edhe në ajetin 19 të sures “El Hashr: **“dhe mos u bëni si ata që e harruan All'llahun”**; ose e harruan Ditën e Gjykimit dhe gjykatën e drejtësisë hyjnore, ashtu siç thuhet në ajetin 26 të sures “Sàd”: **“ata do të kenë një ndëshkim shumë të rëndë për shkak se harruan Ditën e dhënies llogari”**; ose i harruan të gjitha mësimet hyjnore.

3- Fjala e ajetit: *“bùr”*

Në rrënjën e saj, kjo fjalë ka kuptimin e brengosjes së rëndë. Gjithashtu, ajo përdoret edhe për korrupsionin dhe për të treguar prishjen morale të njerëzve.

Duke u nisur nga ky shpjegim, fraza e ajetit: *“kànu kaumen bùren”* – **“ishin njerëz të shprishur”**, tregon se ky grup njerëzish, që bazoheshin gjithnjë e më shumë në jetën e mirëqenies materiale, e harruan All'llahun dhe Ditën e Gjykimit. Për rrjedhojë, ata u shkatërruan, aq sa zemrat e tyre u bënë si shkretëtirë e thatë dhe e zhveshur nga çdo vlerë njerëzore.

Gjendja e popujve të zhytur në mashtrimin e mirëqenies në ditët e sotme, është fare e qartë. Për shkak të mirëqenies materiale, ata janë bërë tepër të shkujdesur ndaj All'llahut dhe ndaj njerëzve. Kjo gjendje e kësaj kategorie njerëzish në ditët e sotme, e shpjegon qartë kuptimin e këtij ajeti. Ata janë zhytur në degjenerim moral dhe zemrat e tyre janë boshatisur nga virtytet njerëzore.

Ajeti 20

Shkaku i zbritjes

Paria e kurejshëve, si Utbeh bin Rebij'ah dhe të tjerë, shkuan tek i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut*)

qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe i thanë: “O Muhammed, nëse ti dëshiron të jesh i parë, ne të bëjmë kryetarin tonë. Nëse dëshiron pasuri, ne kemi mbledhur për ty prej pasurisë tonë”. Por kur i Dërguari i All'lahut (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i kundërshtoi këto propozime të parisë kurejshe, atëherë ata i kërkuan argumente dhe i thanë: “Si mund të jesh i Dërguar i All'lahut, kur ti ushqehesh dhe merresh me tregti?!” Ata e qortonin veçanërisht ngaqë hante ushqim si të gjithë njerëzit apo ngaqë ecte e lëvizte nëpër tregje; ata donin që i Dërguari të ishte engjëll. Vetë i Dërguari i All'lahut (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u fliste atyre për punët e tregtisë së tij, në një kohë kur ata mendonin se perandorët, mbretërit e tiranët, i përkisnin një rangui të lartë dhe nuk mund të merreshin me punë të tilla. I Dërguari i All'lahut (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte çdo ditë së bashku me ta nëpër tregje, i urdhëronte për disa punë dhe i ndalonte nga disa të tjera. Për këtë arsye, ata menduan se ai kishte për qëllim që të bëhej sundimtari i tyre. Por si mund ta donte ai këtë, kur sjellja e tij ishte e kundërt me atë të mbretërve? Atëherë, All'lahu u përgjigjet idhujtarëve kurejshe me fjalën e Tij dhe i zbriti Profetit këtë ajet: **“Para teje Ne kemi dërguar Profetë të tjerë, por edhe ata hanin ushqim dhe ecnin nëpër tregje”**; prandaj, ti mos u zemëro dhe mos u dëshpëro, sepse ata s'bëjnë gjë tjetër veçse dyshojnë që ti je i Dërguar dhe të qortojnë për punët që bën.¹

¹ Përmbajtja e transmetimit të mësipërm është shkruar në shumë tefsire, por ne e kemi cituar të plotë, ashtu siç ka ardhur në tefsirin e Kurtubij'jit “El Xhàmiu liahkàmil Kur'an”, vëll. 7, f. 4721.

Komentimi

Kështu kanë qenë të gjithë “Profetët”

Ajetet e mëparshme flisnin vetëm për njërin nga pretekstet që nxirrnin adhuresit e idhujve për t’iu kundërvënë të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kur thonin: “Përse i Dërguari i All'llahut ha ushqim dhe ecën nëpër tregje? Kësaj pyetjeje i erdhi një përgjigje gjithëpërfshirëse dhe shumë e shkurtër. Edhe ajeti që është objekt studimi rikthehet në të njëjtën temë, për të dhënë një përgjigje më të detajuar e më të qartë. All'llahu, i Larti, thotë në Kur’an: **“Para teje Ne kemi dërguar Profetë të tjerë, por edhe ata hanin ushqim dhe ecnin nëpër tregje.”** Në këtë ajet, All'llahu njofton se të gjithë Profetët ishin njerëz dhe jetuan në mesin e njerëzve. Ai thotë: **“Ne u bëmë ju sprovë për njëri-tjetrin”**, pra u bëmë që ta provoni njëri-tjetrin.

Sprova mund të ketë lidhje me faktin se Profetët u zgjodhën prej mesit të njerëzve, madje prej atyre që u mungonin shumë gjëra, që siguronin një mirëqenie krejt të thjeshtë. Prandaj kjo zgjedhje ishte një provim shumë i madh në vetvete. Disa nuk pranonin të drejtoheshin prej njerëzve të kësaj kategorie, veçanërisht kur profeti i përkiste një shtrese të ulët ose kur kishte mundësi të pakta materiale. Në mendësinë e tyre, profeti duhet të kishte shumë pasuri, ose të jetonte më gjatë, ose më e pakta, të ishte prej njerëzve që gëzonin famë në shoqëri.

Gjithashtu, provimi mund të qëndrojë edhe në faktin se, në përgjithësi, njerëzit janë sprovë për njëri-tjetrin; ata që qëndrojnë

në shtëpi, njerëzit me të meta fizike, të sëmurët dhe të moshuarit, janë sprovë për të fuqishmit dhe për ata që gëzojnë shëndet të plotë, por edhe e anasjellta.

Midis këtyre dy interpretimeve s'ka ndonjë kundërshti, kështu që ato mund të bashkohen në kuptimin më të gjerë të ajetit, sipas të cilit, të gjithë njerëzit janë sprovë për njëri-tjetrin.

Në vijim, ajeti u flet të gjithëve në vetën e dytë dhe u thotë: *"e tasbirune"* – **"a do të duroni?"**.

Cilësitë më të rëndësishme për të pasur sukses në të gjitha këto sprova, janë durimi, drejtësia dhe trimëria. Këto tri cilësi i kundërvihen mendjemadhësisë, e cila e ndalon pranimin e së vërtetës. Gjithashtu, durimi dhe drejtësia janë cilësitë kryesore për zgjidhjen e problemeve, që dalin prej përgjegjësisë të misionit të profetësisë dhe kumtimit të Mesazhit hyjnor. Të gjitha këto përgjegjësi kërkojnë qëndrueshmëri e vendosmëri para vështirësive dhe vuajtjeve të dhimbshme, që janë të pranishme në jetën e njeriut.

Si përfundim, themi: Ky provim i madh hyjnor në mes të njerëzve mund të kalohet me sukses vetëm në saje të fuqisë për të marrë qëndrime të drejta dhe për të shfaqur durim.¹

Në fund të ajetit, All'llahu, i Larti, njofton në formë paralajmërimi se: **"Zoti yt sheh çdo gjë"**, prandaj të mos i shkojë ndërmend askujt se diçka prej veprimeve të tij në raport me provimet hyjnore, do të mbetet e fshehur dhe nuk do të zbulohet prej "syrit" të All'llahut dhe prej diturisë së Tij. Për All'llahun,

¹ Për më shumë shpjegime rreth çështjes së provimeve hyjnore dhe të qëllimit të tyre, lexo studimin tonë të detajuar në komentimin e ajetit 155 të sures "El Bekare".

asnjë send nuk mund të jetë i fshehur. Ai shikon me imtësi në të gjitha sendet dhe vetëm Ai ka dijeni të plotë për to.

Këtu mund të kërkohet ky shpjegim: Kur'ani u përgjigjet adhuruesve të idhujve në ajetet e mëparshme, se të gjithë Profetët kanë qenë njerëz, por kjo përgjigje nuk e zgjidh problemin, por e bën atë edhe më të mprehtë. A kanë mundësi idhujtarët që me këtë përgjigje, ta përgjithësojnë paradoksin e tyre mbi të gjithë Profetët?

Përgjigje: Ajete të ndryshme të Kur'anit tregojnë se paradoksi i tyre në lidhje me Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) qëndronte në faktin se ata besonin që i Dërguari duhet të kishte një gjendje të veçantë. Për këtë, ata pyesnin: "Si është puna me këtë të Dërguar?!"

Në përgjigje të dyshimit të tyre, Kur'ani Famëlartë thotë: Kjo gjendje (pra ushqyerja dhe lëvizja nëpër tregje) nuk është karakteristikë vetëm për të Dërguarin më të madh (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sepse edhe të gjithë Profetët e mëparshëm kanë pasur të njëjtat cilësi. Duke supozuar se adhuruesit e idhujve do ta shtrijnë paradoksin e tyre mbi të gjithë Profetët, Kur'ani Famëlartë u përgjigjet atyre në ajetin 9 të sures "El En'am, ku All'llahu thotë: "**sikur Ne ta bënim atë** (të Dërguarin) **engjëll, atë do ta bënim** (në formën) **e njeriut**", sepse vetëm duke qenë njeri, i Dërguari ka mundësi të jetë shembull dhe model për njerëzit në të gjitha fushat e jetës. Me këtë fjalë, All'llahu, i Larti, u tregon adhuruesve të idhujve se njeriu mund të jetë udhëzues për njeriun. Gjithashtu, All'llahu njofton se vetëm duke qenë njeri, i Dërguari ka mundësi të jetë pranë nevojave të njerëzve dhe problemeve që ata kanë.

Përktheu: **H. Selim Stafa**

PËRMBAJTJA

Surja “El Mu’minûn”	5
Mirësitë e sures “El Mu’minûn”	6
Pëmbajtja e sures “El Mu’minûn”	7
Ajetet 1 – 11	10
Komentimi.....	11
Cilësitë e dukshme të besimtarëve.....	11
Hulumtime	23
1- Paevitueshmëria e shpëtimit të besimtarëve.....	23
2- Përrulja - shpirti i namazit.....	23
Ajetet 12 – 16	26
Komentimi.....	27
Etapat e plotësimit të embrionit në mitër.....	27
Hulumtime.....	31
1- Konstatimi i fillimit të krijimit dhe i Ringjalljes me një provë të vetme.....	31
2- Etapa e fundit në plotësimin e embrionit të njeriut në mitër.....	32
3- Veshja e mishit mbi kocka.....	33
4- Veshja, mbrojtje për eshtrat!.....	34
Ajetet 17 – 22	35
Komentimi.....	36
Edhe një herë me botën e njësimin.....	36
Ajetet 23 – 25	45
Komentimi.....	46
Logjika e frikacakëve të verbuar nga mendjemadhësia.....	46

Ajetet 26 – 30	49
Komentimimi.....	50
Fundi i jetës së një populli kokëfortë.....	50
Ajetet 31 – 41	54
Komentimimi.....	56
Fundi i dhembshëm për popullin e Themudit.....	56
Hulumtime.....	60
1- Jeta në luks dhe pasojat e saj fatale.....	60
2- “Pluhuri” dhe “kockat”.....	61
3- Ç’do të thotë “githa’un”?.....	62
4- Përfundimi i përgjithshëm.....	62
Ajetet 42 – 44	64
Komentimimi.....	65
Vdekja e popujve kokëfortë njëri pas tjetrit.....	65
Ajetet 45 – 49	68
Komentimi.....	69
Ngritja e Musait dhe vdekja e faraonëve.....	69
Ajeti 50	73
Komentimi.....	73
Një shpallje tjetër nga shpalljet e All’llahut (ose një ajet tjetër nga ajetet e All’llahut).....	73
Ajetet 51 – 54	76
Komentimi.....	77
E gjithë bashkësia (ymeti) është një dorë e vetme.....	77
Ajetet 55 – 61	84
Komentimi.....	85
Të nxituarit në bërjen e veprave të mira.....	85
Ajetet 62 – 67	89
Komentimi.....	90
Zemrat në injorancë janë të humbura.....	90
Ajetet 68 – 74	96
Komentimi.....	97

Justifikimet e ndryshme të mohuesve.....	97
Hulumtime.....	102
1- Ndjekja e së Vërtetës apo e dëshirave personale?.....	102
2- Cilësitë e udhëheqësit.....	103
3- Pse shumica e njerëzve nuk priren nga e Vërteta?.....	104
Ajetet 75 – 80	108
Komentimi.....	109
Rrugët e ndryshme të ndërgjegjësimit hyjnor.....	109
Ajetet 81 – 90	116
Komentimi.....	117
Kur'ani u bën thirrje ndërgjegjeve për gjykim.....	117
Hulumtime.....	121
1- Kuptimi i një numri fjalësh.....	121
2- Konfirmimi i Ringjalljes duke u mbështetur në fuqinë e përgjithshme të All'llahut.....	122
3- Ndryshimi i fundit të ajeteve.....	123
Ajetet 91 – 92	125
Komentimi.....	125
Përçarja e tërheq botën drejt shkatërrimit.....	125
Ajetet 93 – 98	130
Komentimi.....	131
Kërkoni mbrojtjen e All'llahut nga nxitjet e djajve.....	131
Hulumtime.....	134
1- Ç'janë nxitjet e djajve?.....	134
2- Përgjigjja ndaj së keqes me të mire.....	135
Ajetet 99 – 100	137
Komentimi.....	137
Kërkimi i të pamundurës.....	137
Hulumtime.....	139
1- Kush është bashkëbiseduesi në thënien e të Madhërishmit: “O Zoti im, më kthe!”	139
2- Shpjegimi i shprehjes “në botën që kam lënë”	140

3- Ç'është ajo që mohon fjala "kurrresi"?	142
4- Çfarë është Barzakhu?	143
<i>El Barzakh</i> dhe lidhja me botën e shpirttrave	149
Pamje nga bota e "Barzakhut" (<i>jetës së ndërmjetme</i>)	149
Ajetet 101 - 104	154
Komentimi	155
Një aspekt i ndëshkimit të keqbërësve	155
Hulumtime	159
1- Dita kur njeriu nuk tregon ndonjë vëmendje	159
2- Historia prekëse e El Esmajut	161
3- Përshtatja e ndëshkimit me gabimin	164
Ajetet 105 - 111	165
Komentimi	166
Mos flisni!	166
Ajetet 112 - 116	169
Komentimi	170
Bota dhe mosha e shkurtër e saj	170
Hulumtime	174
Vdekja nuk është fundi i jetës	174
Ajetet 117 - 118	177
Komentimi	177
Të fituarit dhe të humburit	177
Sure "Nur"	181
Mirësia e sures "En Nur"	182
Përmbajtja e sures "En Nur"	182
Ajetet 1 - 3	186
Komentimi	187
Masa e dënimit ligjor për laviren dhe lavirin	187
Hulumtime	196
1- Rastet kur mbi imoralin zbatohet dënimi sipas dispozitës ligjore	196
2- Përse lavirja është përmendur e para?	197

3- Përse zbatohet dënimi haptazi?.....	197
4- Si ishte masa e dënimit në të kaluarën për imoralitetin?.....	199
5- Ndalimi i tejkalimit të masës dhe lënia mangët në zbatimin e dënimit.....	199
6- Kushtet e ndalimit të martesës me laviren dhe lavirin.....	200
7- Filozofia e ndalimit kategorik të imoralitetit.....	201
Ajetet 4 - 5	203
Komentimi.....	203
Dënimi për shpifjen.....	203
Hulumtime.....	207
1- Qëllimi me fjalën “shpifin”	207
2- Përse duhen katër dëshmitarë?.....	208
3- Kushti i rëndësishëm për pranimin e pendimit.....	210
4- Dispozita për sharjen (për hedhjen e fjalëve diskredituese).....	211
Ajetet 6 - 10	214
Shkaku i zbritjes.....	215
Komentimi.....	217
Ndëshkimi për atë që akuzon gruan e vet.....	217
Hulumtime.....	221
1- Përse janë përveçuar dy bashkëshortët prej zbatimit të dispozitës së ndëshkimit për shpifjen?.....	221
2- Mënyra e shfajësimit me anë të mallkimit të vetvetes.....	222
3- Dënimi i hequr në këtë ajet.....	223
Ajetet 11 - 16	225
Shkaku i zbritjes.....	226
Vërtetimi i çështjes.....	234
Komentimi.....	237
Ngjarja ndikuese e shpifjes.....	237
Ajetet 17 - 20	246
Komentimi.....	247
Ndalimi i rreptë i përhapjes së imoralitetit.....	247
Hulumtime.....	251

1- Ç' do të thotë "përhapje e imoralitetit"?	251
2- E keqja e madhe e përhapjes së fjalëve të pavërteta.	254
Ajetet 21 – 26.	257
Komentimi.	259
Ndëshkimet janë llogaridhënie.	259
Hulumtime.	269
1- Kush janë "të këqijat" dhe "të këqijtë"?	269
2- A është kjo konstruktive apo ligjore?	272
3- Përgjigje ndaj komentimit.	273
Ajetet 27 – 29.	276
Komentimi.	277
Mos hyni në shtëpitë e të tjerëve derisa të lejoheni!	277
Hulumtime.	280
1- Siguria dhe liria për gratë e shtëpisë.	280
2- Cili është qëllimi me frazën e ajetit: "shtëpi të pabanuara"?	284
3- Dënimi për atë që vjedh në shtëpitë e të tjerëve.	285
Ajetet 30 – 31.	286
Shkaku i zbritjes.	287
Komentimi.	288
Hulumtime.	295
1- Filozofia e veshjes islame për gruan (hixhabi).	295
2- Vështirësia që sjellin kundërshtarët e veshjes islame të gruas (hixhabit).	301
3- Përgjigje të fytyrës dhe i pëllëmbëve të duarve.	304
4- Cili është qëllimi me fjalën e ajetit: "grave të tyre"?	306
5- Komentimi i frazës së ajetit: "si dhe robërve, që ajo ka në pronësi".	307
6- Komentimi i frazës së ajetit: "ose shërbëtorëve meshkuj që nuk ndjejnë nevojë për gra".	307
7- Cili fëmijë përjashtohet prej kësaj dispozite?	309

8- Përse nuk janë përmendur xhaxhai dhe daja ndër të afërmit?.....	310
9- Ndalimi i rrugëve të eksitimit me anë të shenjave.....	311
Ajetet 32 – 34	312
Komentimi.....	313
Këshilla për martesë me pak shpenzime.....	313
Hulumtime.....	321
1- Martesa është rrugë hyjnore.....	321
2- Qëllimi me frazën e ajetit: “...robërit e robëreshat tuaja që janë të ndershëm e të ndershme...”	325
3- Si bëhet lirimi i robit me marrëveshje kundrejt kompensimit?.....	326
Ajetet 35 – 38	329
Komentimi.....	330
Ajeti i dritës.....	330
Hulumtime.....	348
Ajetet 39 – 40	351
Komentimi.....	352
Punë e pavërtetë.....	352
Ajetet 41 - 42	358
Komentimi.....	358
Të gjithë e madhërojnë All'Ilahun.....	358
Hulumtime.....	360
1- Kuptimi i shprehjes së ajetit: “a nuk e di?”	360
2- Madhërimi i përgjithshëm i të gjitha krijesave.....	361
3- Madhërimi i veçantë i shpendëve.....	363
4- Fraza e ajetit “çdonjëri nga ata e di lutjen e tij dhe madhërimin (që ka detyrë të bëjë)”	364
5- Cili është kuptimi i fjalës “salat”?.....	365
Ajetet 43 – 45	367
Komentimi.....	368
Anë tjetër e krijimit të mahnitshëm.....	368

Përgjigje për një pyetje.....	371
Hulumtime.....	376
1- Ç'kuptim ka fjala e ajetit: <i>"prej ujit?"</i>	376
2- Përgjigje për një pyetje.....	377
3- Format e ndryshme të jetës.....	378
Ajetet 46 – 50	381
Shkaku i zbritjes.....	382
Komentimi.....	383
Besimi dhe pranimi i gjykimit të All'lahut.....	383
Dy hulumtime.....	388
1- Sëmundja e hipokrizisë.....	388
2- Qeverisje e drejtë është vetëm qeverisja hyjnore.....	390
Ajetet 51 – 54	392
Komentimi.....	393
Besimi dhe dorëzimi i plotë tek All'llahu.....	393
Ajeti 55	400
Shkaku i zbritjes.....	400
Komentimi.....	401
Qeverisja botërore e të pafuqishmëve.....	401
Hulumtime.....	403
1- Komentimi i frazës: <i>"ashtu siç pati bërë sundues ata që ishin para tyre"</i>	403
2- Atyre që All'llahu u ka premtuar sundimin në tokë.....	404
3- Objektivi përfundimtar i adhurimit të singertë.....	408
Ajetet 56 – 57	410
Komentimi.....	410
Pamundësia për të ikur prej gjykimit të të Lartit.....	410
Ajetet 58 – 60	413
Komentimi.....	414
Edukata e hyrjes në dhomën e prindërve.....	414
Hulumtime.....	421

1- Filozofia e kërkimit të lejes dhe të këqijat që vijnë nga mosrespektimi i këtij detyrimi.....	421
2- Dispozita e mbulimit (hixhabit) të gruas për të moshuarat.....	424
Ajeti 61	427
Komentimi.....	428
Shtëpitë e lejuara për të ngrënë në to.....	428
Ajetet 62 - 64	435
Shkaku i zbritjes.....	436
Komentimi.....	438
Mos e lini Profetin vetëm!.....	438
Sure “El Furkan”.....	449
Përmbajtja.....	450
Mirësitë e sures “El Furkan”.....	452
Ajetet 1 - 2	453
Komentimi.....	454
Matësi më i lartë për njohjen.....	454
Dy hulumtime.....	459
1- Krijimi i qenieve me të gjitha imtësitë.....	459
2- Përshtatja dhe harmonia midis sendeve.....	461
Ajetet 3 - 6	465
Komentimi.....	466
Akuza të ndryshme.....	466
Ajetet 7 - 10	476
Shkaku i zbritjes.....	477
Komentimi.....	478
Përse ky i Dërguar nuk ka në pronësi thesare e kopshte?.....	478
Ajetet 11 - 16	488
Komentimi.....	489
Krahasim midis Xhennetit dhe Xhehennemit.....	489
Hulumtime.....	494
Ajetet 17 - 19	497

Komentimi.....	498
Gjykimi midis të adhuruarve dhe adhuruesve që kanë devijuar në rrugën e humbjes.....	498
Hulumtime.....	500
1- Cili është kuptimi i fjalës “të adhuruarit”?.....	500
2- Shkaku i devijimit nga Teuhidi (besimi në Zotin Një dhe të Vetëm).....	503
3- Fjala e ajetit: “bùr”.....	505
Ajeti 20	506
Shkaku i zbritjes.....	506
Komentimi.....	508
Kështu kanë qenë të gjithë “Profetët”	508

الأمثل في تفسير كتاب الله المنزل

مؤلف: العلامة الفقيه المفسر ناصر مكارم الشيرازي

الجزء الثامن عشر

الترجمة الى اللغة الألبانية: سليمان تويچيني و الحاج سليم اصطفى (ره)

تيرانا: 2018

نام کتاب: الامثل فی تفسیر کتاب الله المنزل (جزء هجده هم)

نویسنده: فقیه مفسر حضرت آية الله العظمی ناصر مکارم شیرازی (دام ظلّه)

ترجمه به زبان آلبانی: سلیمان تومچینی و الحاج سلیم اصطفی (ره)

زیر نظر: وُلَّتْ مِرْیَا

ویرایش: کلودیانا سمایلا

تصحیح ادبی: ویولسا کارای

صفحه بندی و جلد: صبریه فزا

ناشر: جمعیت "نسیم"

چاپ: انتشارات "لیلو"

تیرانا: 2018